
LEK PERVIZI



BOTIMET FISHTA

GJENERALI

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

GJENERALI

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

© Dorian
Rue de la Victoire 18
1060 Bruxelles
D/2014/11.451/10
ISBN 978-2-9308531-11-3

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

GJENERALI

Jeta e veprimtaria e atdhetarit
Gjeneral Prenk Pervizi

KUJTIME

Pregatitun nga i biri

LEK PERVIZI

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

DORIAN

Disa botime:

*-- Prenk Pervizi: Shënime për organizimin e Kombit për luftë,Sh.Usht., Tiranë 1935.
*-- Prenk Pervizi, Intervistë mbi Luftën Abisinisë, Besa, Tiranë, 1936.
*-- Prenk Pervizi, Relacione mbi luftën e Abisinisë, Buletini Ushtarak, Tiranë 1936.
*-- Préenk Pervizi, Relacione mbi Manovrat e Mëdha të Italisë, Buletini Ushtarak, Tiranë, 1936.
*-- Prenk Pervizi, Lufta e Abisinisë, Lulu, NY, 2012
*-- Idem, Bruksel, 2014
*-- Gjeneral Prenk Pervizi në shtypin shqiptar, Dorian, 2010
*-- Idem, Lulu, NY, 2011
*-- Julian Amery, Sons of the Eagle, London, 1946.
*-- David Smiley, Assignemant in Albania, London, 1984.
*-- Robert Elsie: The Tribes of Albania, Chapter 7, 2015
*-- Robert Elsie, The Biografical Dictionary of Albanian History,
*-- Walther Speinsipp: Das Folk der Schipetaren, Wien, 1985
*-- Hajrush Haliti-Akturk/: Gjeneral Prenk Pervizi shtigjëve të nacionalizmit, Zeri, Prishtinë, 1995.
*-- Lek Perviizi: Tingëllime të Vona, Dorian, Bruksel, 2014
*-- Wikipedia Prenk Pervizi, në disa gjuhë të huaja.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



GJENERAL PRENK PERVIZI
Skuraj 1897–Belgjikë 1977

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Një prindi shembullor,
ushtarak i lartë e patriot i shquar,
që jetën dhe veprimtatinë e tij ia kushtoi
gjithë kohën Atdheut e Kombit shqiptar

“ Miku dhe mbrojtësi ynë,
Gjeneral Prenk Pervizi luejti një rol
të randësishëm në revolucionin e 1924-ës.
Me Muharrem Bajraktarin, Fiqri Dinen
dhe Hysni Demën, formuen « quadrumviratin »
me anë të cilit regjimi i mbretnisë u vendos.
FU LIAN AMERY

BIBLIOTEKA PUBLIKE
“MARIN BARLETI”
SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Përse shkruhët ky libër

Patjetër se vjen pyetja, pse shkruhet ky libër. Pse me kaq vonesë, për një figurë ushtarake e patriote të njohun e të përmendun të botës shqiptare. Një pikëçuditëse për historianët e indotrinuem ose të paindoktrinuem që nuk e kanë përfshi në faqet e librave te tyne. Një e metë e gabim i pafalshëm nga ana tyne. Kur dihet botnisht se ai ka qene shoqnues aktiv i gjithe historisë shqiptare nga 1914 deri 1946, sa qëndroi në Shqipni, dhe ma vonë në mërgim deri ditën e fundit të jetës tij, 6 shtator 1977. Pra ka një arësye, dhe kjo asht ajo që lidhet me pushtimin italian dhe me diktaturën komuniste. Ma se një gjysmë shekulli, që emni i Prenk Pervizit nuk mund të përmendej dhe jo ma të përfshihej ne faqet e librave, shtypit, botimëve, etjera forma. Nga ana tjetër ne, bijt e tij, ishim të mbyllun në burgjet e kampet e internimit, ku luftonim për vetë ekzistencën tonë. Në ato kushte nuk kishim as ma të voglën mundësi për të radhitë përshkrimin e jetës tij. Jo që me të gjet shkrime të tilla e pagueje shtrejt. Fatmirësisht ai na kishte lanë kujtimet e veta gojarisht. Çdo dokument i shruem prej dorës tij e te tjerë dokumentë kishin përfundue ne flakën që partizanët "çlirimtarë" u kishin kallë shtëpive tona në Laç e Sluraj. Si dhe të konfiskimit të shtëpisë në Tiranë. Kështu u zhduk gjithë ç'farë ruhej nga jeta e veprimtaria e t'im etit, dhe mbeti për t'u mbështetë kryesisht mbi rrëfimet e tij. Këto kujtime janë të përforcueme edhe prej njerëzve që e kishin njohun dhe shërbye nën urdhnat e tij. Pesë dekada heshtje grumbulluen mbi të pluhunin e harresës, që ne tashti kërkojmë ta shkundim pas kaq vitesh. Diktatura komuniste kundrejt figurave të tilla, megjithëse ua njihte shumë mirë jetën, veprimtarinë e randësinë intelektuale e patriotike, ndoqi politikën e asgjësimit, mohimit, heshtjës e harresës. Kjo gjeti zbatim të mirëfilltë tek akademia e shkencave dhe historianet e saj, të indoktrinuem plotësisht. Ata e përmbysën dhe fallsifikuen fund e krye historinë e Shqipnisë me gjithë protagonistët e saj: përsonalitete ushtarake dhe të shoqërisë civile, që kishin dhanë kontribut të çmueshëm në krijimin e forcimin e shtetit shqiptar, të parin në historinë tonë, t' Evropës e të botës, që u krijue në Kongresin e Lushnjës më 21 janar 1920.

Kështu unë i nënshkruemi, bir i tij, që i mbijetova mrekullishst përsekutimit komunist, u gjeta para problemit për ta rregjallë atë figurë, përmes kujtimeve që ai vetë na kishte trasmetue. Të cilëve u bashkangjitën ato personale të miat, të vllazënve, të afërmve e të bashkëpuntorve që ndanë jetën e detyrat me të. Kjo, që jeta e veprimtaria e tij të njihej jo vetëm nga

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

publiku shqiptar, por që ta njihnim prindin tonë edhe ne vetë, njerëzit e tij, në përmasën sa ma të vërtetë. Qoftë në jetën familjare ashtu dhe në atë të detyrave si bashkëshoqnues i historisë shqiptare. Libri merr vlerë të randësishme për historianët, pse hedh dritë mbi ngjarje të panjohuna ose të nenfleftesueme deri të injorueme e fallsifikueme që do të vlenin për një radhitje të drejtë të historisë.

E thamë se ky liber po shkruhet sipas kujtimeve për një arësye logjike, sepse me djegëjen e shtëpijave u asgjesue gjithçka kishte brenda tyne. Ky asgjësim nuk mjaftoi me kaq, sepse edhe ma vonë pas vdekjës tij në mërgim, disa shqiptarë të pa ndërgjegje dhe pa principe humane, njerëz të pa burrni, deri dhe agjentë të regjimit komunist, vunë dorë mbi plaçkat e dokumentët e tij duke i zhdukë, pa i dhanë llogari askujt. Kjo e fundit ishte si një goditje e dytë vdekjeje, sepse kërkonte të zhdukte edhe atë çka kishte shpëtue prej komunistëve. Po ashtu, zhdukët dosja e tij nga arkiva e Krujës, që për çudi ishte ruejtë deri pas shëmbjës së diktaturës, për të cilën nuk asht dhanë as jepet asnjë shpjegim. Pse e për ç'far interesi e ç'far qëllimi ? Mister !

Sidoqoftë pas shëmbjës së regjimit komunist, nisi të kujtohet e të dali në pah figura e tij, ku luejtën rol gazetarë të ndryshëm, dhe persona që ia kishin dëgjue historinë prej baballarëve të tyne dhe njerëzve që kishin shërbye nën urdhnat e tij. Filloi të dalë edhe ndonjë dokument e fotografi nga arkivat e shtetit. Kjo nuk ishte tjetër veçse një rilindje e kësaj figure ushtarake e patriote, që bashkë me kolegë e patriotë të tjerë kishin kontribue në historinë e Shqipnisë.

Një oficer pedagog ne Akademinë e Mbrojtjës, i ndjeri N/Kolonel Dr. Pjetër Hidri, i kushtoi një monografi që u botue më 2002 e që u mirëprit, sepse nxori në dritë një figurë të naltë ushtarake që ishte lanë në hije, thuej në harresë të plotë. Në sajë të Dr. Hidrit, emni i Prenk Pervizit u përfshi në botimin e dytë të Fjalorit Enciklopedik. Shkrimtarë e studiues të huej kontribuen në paraqitjën e tij në veprat e tyne deri dhe në Wkipedia etjerë site ne disa gjuhë europiane deri kineze dhe esperanto. Të gjithë këto fakte më frymëzuen që t'i kushtoj këtë libër, si një homazh e nderim ndaj tij.

Libri ndjek një stil tregimtar të lirë e të rrjedhshëm pa ngarkesa të tepërta. Aty përcaktohën mirëfilltas ngjarjët e ndryshme siç faktikisht janë zhvillue. Të vjen keq kur shikon se në radhën e dezinformuesve e falsifikatorve përfshihët edhe ndonjë figurë e njohun, që duke abuzue nga emni e pozitat që kanë pasë, kanë trillue e trillojnë haptasi ngjarje të paqena e tue ua vesh të qënat të tjerëve; të paqenë.

Vlen të theksohet se një dokument me vlerë të madhe asht nje interviste qe ai ia kishte dhane ne Bruksel të Belgjikës më 1974 gazetarit kosovar, Hajrush Haliti-Akturk, që përputhet me përmbajtjen e librit, në vështrimin e

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

fakteve historike të përjetuem prej Prenk Pervizit. Ky dokument u ba i mundun të njihet kur dolëm në Belgjikë dhe u takuem me gazetarin që përmendëm, i cili atë intervistë e kishte botue ne gazetën "Zeri" të Prishtinës, më 1995 pas shembjës së komunizmit. Ma përpara një gja e tillë ishte e pamundshme. Një intervistë autentike që jep gjithë historinë e Shqipnisë te jetueme prej Prenk Pervizit në rol vendimtar. Zotit Akturk i shkon një falëndrim i posaçëm për ruejtjën e botimin e intervistës, që mbetët si një dokument autentik i marrë dretpësëdrejti nga Prenk Pervzi. Një dëshmi nga një autoritet i lartë ushtarak, shumë i vlefshëm për historianët.

Në këtë vepër kujdesi kryesor ka qenë me nxierrë në dritë personalitetin dhe karakterin e Prenk Pervizit. Përgatitjën e lartë ushtarake, ndër shkollat ma prestigjose t'Evropës. Kushtimin e tij ndaj Atdheut e Kombit shqiptar duke krye me nder e sukses detyrat që iu ngarkuen e që mori përsipër vetë. Kundërvenja faktike ndaj pushtuesit të huej siç ishte Italia fashiste, duke mos e lejue ushtrinë shqiptare të luftojë krah asaj italiane, në asnjë rast, as kundër popullit të vet as kundër fqinjëve kufitarë, siç ndodhi ne luftën italo-greke, ku me urdhën të tij ushtria shqiptare e braktisi frontin. Me randësi asht dhe përkujdesi i tij ndaj çeshtjes kombetare per te mbrojtë kufijt etnikë në Kosovë, dhe kundërvenja e vendosun ndaj sllavo-komunistëve që morën pushtetin dhe tradhëtuen Kosovën duke i masakrue pa mëshirë e mizorisht patriotët kosovarë. Sa ishte Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare e Ministër i Mbrojtjës, kambë serbi nuk shkeli në Kosovë.

E gjithë kjo e perciellun me një emocion të papërmbajtun, në kujtimin e një prindi, që përveç detyrave te nalta në dobi t'atdheut, tregonte një përkujdes të madh për ne bijt e tij. Të edukohëshim e studionim në shkollat ma të mira t'Evropës, për t'i sherbye denjësiht athdeut. Si njeri i dashtun për familjën : ndaj nanës burrneshë që e rriti, si jetim të një prindi trim e luftëtar i lirisë ; ndaj grues besnike e të vendosun me perbalue jetën me të mirat e të këqiat si grue e vërtetë shqiptare. Ndaj t'afërmve e besnikëve, që i ndejtën gjithmonë pranë, në çdo situatë të vështirë dhe qe nuk nguruen të sakrifikohën për të. Ndaj burrave të fisit, që i qëndruen triminsht e të papërkulun regjimit shtypës komunis duke shkrue faqe te lavdishme heroizmi. Ndaj miqve e kolegëve të tij, po aq patriotë e figura të shquema shoqnuese të historisë shqiptare.

Ky emocion e mallëngjim, bashkë me rrjedhën e jetës tij, gjetën përmbledhje pas 45 vjet para varrit tij të vetmuem e pothuej të harruem në Belgjikë. Ne, t'afërmit e të dashtunit e patën mundësi me vendosë një tufë lulësh të freskëta mbi atë varr, pas një gjysmë shekulli teper të gjatë vuejtjësh dhe izolimi nga bota e qytetnueme. Aì u detyrue me braktisë atdheun e me gjetë shpëtim në dhè të huej, me brengën e madhe që po vdiste larg trojëve të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

shejta t'atdheut, të cilit i kishte kushtue gjithë jetën dhe energjitë e aftësitë e tij duke i shërbye me përkushtim e besnikëri të madhe.

Ky i gjithë shtjellimi i këtij libri për me kujtue e me vleresue një figure ushtarake e patriotike mjaft të randësishme të historisë e botës shqiptare.

Bruksel, 26 qërshor 2016

Falënderim

Falenderojmë miq e dashamirë, qe kanë ruejtun e na kanë dorëzue e dergue fotografi të prindit tonë, tue ditë se me djegien e shtëpive tona në Laç e Skuraj, dhe konfiskimin e shtëpisë në Tiranë, u zhdukën bashkë me dokumente e dorëshkrime, gjithë koleksioni historik i fotografive nga jeta e tij shkollore në Shkodër dhe Vjenë t'Austrisë deri te veprimtaria gjatë viteve nga 1918 - 1944, si dhe albumet e relacionet shkrimore nga misioni në Luftën e Abisinisë dhe Manovrat e Mëdha të Italisë. Një falederim i posaçëm u shkon Lordit Amery dhe Kolonelit britanik David Smiley, që sa morën vesh ardhjen tonë në Belgjikë na dërguen fotografitë prindit nga jeta e malit me misionin anglez më 1944, si dhe librat e tynë kushtue asaj periudhe.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Periudha e Rinisë

1897-1918

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kur të qesh fati

Historia e çdo njeriu në vetvete asht një përshkrim që do të quhej kronologjik, po ta marrim nga ana e shtjellimit të ngjarjeve të njëpasnjeshme që e shoqnojnë atë, nga dita e parë e ardhjës në këtë botë deri në ditën e fundit të largimit prej saj. Por duke analizue situatat e ndryshme që ai përjeton me ndërlikimet e të papritunat e jetës, historia e tij kalon edhe në përmasa lëgjendare, sipas kushtëve që marrin ngjarjet në të cilat ai gjëndet. Ka njerëz që kalojnë një jetë normale e ka të tjerë që e kalojnë të përveçme. Për ata që kalojnë një jetë normale nuk ke çka me diftue, përveç se si lindën, jetuen e vdiqën. Për ata që kalojnë një jetë të përveçme deri dhe të jashtëzakonshme, ke ç'far me thanë e nuk ia del dot me i tregue të gjitha. Tek këta të fundit shfaqen edhe përmasat lëgjendare. Nga ana tjetër, janë disa çaste që përcaktojnë jetën e njeriut, çaste që vijnë të papritunа e që duhet me vendosë për me i shfrytëzue ose jo. Kështu i ka ndodhë prindit tim, që një çast ia ndryshoi gjithë jetën. Prandaj, tregimi fillon pikërisht nga ajo rrethanë që i dha piknisje jetës së tij vepruese drejt afirmimit si figurë e personalitet i botës shqiptare. Tregimi rreshtohet sipas rrëfimit të vetë tim etit, sigurisht i radhitun në një mënyrë sa ma të plotë dhe i pasunuem me përshkrime të njerëzve me të cilët ishte lidhë dhe kishte nda detyrat në rrethana të caktueme, të mira apo të këqija. Patjetër se në këtë rast peshon edhe dëshmia ime si shoqnues i jetës dhe veprave të prindit tim, ashtu edhe të familjarëve të tjerë e të atyne që e shoqnuen e i ndejtën afër gjithë kohën, bashkë me atë pjesë të historisë në të cilën ishim përfshi.

Rrëfimi nis në një ditë të javës së fundit të korrikut 1914. Im atë, ishte shtri nën hijen e një fiku të madh, jo fort larg hanit të Gjet Toskës në Skuraj. Ai kishte mbarue gjimnazin françeskan në Shkodër e kishte ardhë në Skuraj me kalue pushimet verore e me u përgatitë me u nis për në Vjenë ku do të vazhdonte shtudimet e nalta ushtarake. Një ngjarje e papritun ia kishte mbyllë atë rrugë. Të shtënat e revolverit në Sarajevo mbi arkidukën e Austrisë Franc-Ferdinandin, më 28 qërshor 1914, i kishin kallë flakën fuqisë së barotit të Ballkanit, Europës e mbar Botës. Kishte plasë Lufta e Madhe Botnore. Perandoritë e Austro-Hungarisë, Gjermanisë, bashkë me aleatët e tyne, Turkia, Bullgaria, Portugalia, etj., kishin nisë luftën kundër Antantës, me Francën, Anglinë, Italinë, Rusinë, Shtetet e Bashkueme të Amerikës, Japoninë, me aleatët ma të vegjel si Serbia, Romania, Greqia, Polonia, Mali i Zi, etj. Zjarri i kësaj lufte kishte përfshi mbarë rruzullin tokësor, si dhmos Evropën. Ushtritë ndërluftuese kishin fillue të hidhëshin me egërsi barbare mbi njena tjetrën,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

duke u përlesh në beteja të përgjakshme. E pra ishin qenje që Zoti i kishte krijue sipas shëmbëlltyrës së vet. Vllazën. Kaina e Abela. Kush Kaini e kush Abeli ? Kush vrasësi e kush viktima ? Kush ngadhjimtari e kush i munduni ? U mbetej historianëve, shkrimtarëve e filosofëfe me e zgjidhë dilemën. Një gja ishte e sigurt : në atë kasaphane, dashje pa dashje, ata do vllaznohëshin përfundimisht në vdekjen. Anmiq përsegjalli e vllazën përsevdekmi. Ma e keqja, ishin milona djelm të ri të cilëve u pritej jeta në lulëzimin e saj. Miliona nana te shkreta të veshuna ne zi. Miliona fëmijë pa baballarë. Ndërkohë ishin mbyllë mundësitë e njerëzve për të qarkullue lirisht nga një shtet në tjetrin. Perënditë moderne të transformuem në Fuqi të Mëdha siç ishin të Shtatë Krajlat, të ngujuem në « Olimpin » prallor të pallateve të tyne të stileve klasike, gotike, baroke, moderne, etj., loznin me fatin e njerëzimit për shtatëpalëqejfe. Hyjnesha e ngatërresës e kishte hedhun mollën e artë të sherrit mes gostisë së tyne. Kësaj radhe ajo nuk kishte shkrue mbi të « ma së bukurës » por « ma të fuqishmit ». Kush do ta ndante këtë gjyq ? Ku me e gjet një Parid tjetër ? Çeshtja nuk ishte aq e thjeshtë. Së pari nuk dihej se kush do te paraqitej. Tri Hyjnesha të bukura si perri apo tre Hyjni mjekrosha ? Këto mendime shtjellohëshin në mendjen e atij djali të ri 17 vjeç, aty nën hijen e një fikut të madh, ku nuk depërtonin dot rrezet e diellit. I pashëm. Sy zi. Flokë zi. Shtat hedhun. Me ia pasë zili vetë Paridi. Vapa ishte e madhe, dhe afshi i saj sikur shtohej nga kanga monotone dhe e parreshtun e xhingallave. Ai quhej Prenk, që kishtekuptimin, i parë, e që përkonte fort bukur me emnin Parid. Fantazia po i punonte. Sikur vërtet t'i dilnin përpara tri hyjnesha të bukura. Por mund t'ishin edhe tre hyjni mjekrroshë. Ndërkaq mendimi i fluturonte tutje, dhe si në një film i shfaqëshin përpara vitet e fëminisë : prindi, që ia kishin vra dhe që e kishte lanë jetim nandë vjeç, për të cilin ai ruente një kujtim të pashlyeshëm. I kujtohej shkolla, mësuesit e profesorët. I kujtohej axha i madh Gjin Pjetri që e kishte çue me vazhdue studimet në Shkodër. Pas vdekjes t'atit, ai ishte kujdes për të edhe ma tepër. I kishte sigurue bursën për vazhdimin e studimëve në Vjenë. Ai e mbante pranë gjatë pushimeve verore, duke e njohun me traditat, kanunet, zakonet dhe veprimtarinë patriotike e luftarake të fisit, të krahinës e të Shqipnisë. Gjatë atyne pushimeve kryente rolin e sekretarit t'axhës duke i mbajtë në rregull letërkëmbimin e dokumentët. Ma se një letër ishte shkrue nga dora e tij, e diktuem nga axha i madh. I kujtohej kur Gjin Pjetri e kishte çue me e marrë nga shkolla, bashkë me disa studentë të tjerë të krahinës, për me qenë të pranishëm në nderijen e flamurit në Milot në mëngjesin e 28 Nëndorit 1912, ku ishin mbledhë gjithë luftëtarët e Kurbinit, Krujës, Mirditës, e të krahinave të tjera. Në Milot nuk kishte ndërtesa të nalta me ballkone si në Vlonë. Flamuri ishte vendos nga një djalë i ri mbi vidhin e madh të Kokajve, midis Milotit. Gjin Pjetri e kishte marrë fjalën :

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

- Burra, sot ne Vlonë, ngrihet flamuri kombëtar e shpallet pavarësia nga patrioti i madh Ismail Qemali, bashkë me atdhetarë të tjerë të mbledhun rreth tij. Mbas 500 vjet robnie, flamuri i Gjergj Kastriotit që valon mbi këtë vidh shekullor, na lajmëron se e kemi shporr turkun e se kemi fitue lirinë. Rroftë Flamuri ! Rroftë Liria !

Sa kishte thanë këto fjalë, Gjini e kishte nxierrë karadaklijën prej brezit duke e shprazun gjashtë herë n'ajri, që ishte pasue nga krismat e pushkëve të luftëtarve të mbledhun aty, kurbinas,kruetanë, mirditorë, leznjanë, malësorë, etj. Ngjarje të paharrueshme, që do ta frymëzonin e brymosnin me ndjenjat e atdhetarizmit, që do t'i vlenin në shtjellimin e mëtejshëm të jetës së tij. Këto kujtime i shkonin nëpër mend si vegime dhe nuk kishin të sosun.

Axha i madh , Gjin Pjetri, kishte vdekun papritmas në atë shkurt 1914, pra para pesë muejsh. Por edhe sikur të kishte qenë gjallë, çdo mund të bante për deri sa kishte plasë lufta e rrugët ishin mbyllun ? Sa do të zgjaste ky konflikt ? Mos vallë dhjet vjet sa Lufta e Trojës ? Troja ishte një qytet, po një botë e tanë ?

Ndërsa rrinte ashtu zhytun në këto andrrime me sy hapët, me duert të kryqëzueme pas kokës, i shtrimë nën hijen e atij fiku, ndigjoi një za që thërriste emnin e tij. Ishte Gjoni, një nga kushërinjt moshatarë.

- Pren, çohu se po të kërkojnë ! Kanë ardhë nja tre të huej me të cilët nuk po din kush me u marrë vesh. Simbas gjasës janë austriakë, i tha me një frymë Gjoni e pastaj shtoi, mue me shkoi mendja se ti vjen e pushon nën hijen e këtij fiku.

- Tre të huej, austriakë the ? Ç'fat do t'i ketë sjellë këndej ? Si duket i ka zanë lufta e nuk dinë se nga me ia mbajtë. Shkojmë ! Në këto fjalë e sipër të dy të rijtë u nisën.

- I ra ndërmend Gjet Toskës për ty, po i shpjegonte rrugës Gjoni, gjejeni Prenkën se këndej rrotull do të jetë. Ai ka me dijtë me u marrë vesh me ta. Gjetë Toska kishte një han pranë rrugës kambësore midis Milotit e Skurajt. Aty ndalëshin me pushue udhëtarë të ndryshëm. Shërbente edhe si bujtinë rrethanore për shtegtarë që i zinte nata, e si dyqan e pijetore për fshatarët përreth. Im atë shkonte shpesh andej, ku kishte mundësi të takonte njerëz të ndryshëm kalimtarë e të merrte vesh se ç'bahej me atë luftë të matkueme, që i kishte pre rrugën për në Vjenë. Shtypi nuk ekzistonte e lajmet kalonin nga goja në gojë me deformime e sajime. Kur mori vesh për të huejt, sigurisht austriakë, seç i shkrepi në mendje : Po sikur t'ishin vërtet tri perendi ?... Qeshi me vete.

Sapo hyni në han, e thirri Gjeta :

- Sa mirë që erdhe or Pren ! Nuk po dijmë të merremi vesh me këto tre të huejt. Janë austriakë. U kam dhanë me hangër e u kam qitë nga një gotë raki. U gëzuen fort. Dukëshin të uritun. I çova mat mënë që të mos i besdiste kush. Eja këndej.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Gjeta e kishte ftue babën pas banakut ku e kishte kalue nëpër një deriçkë. Kur kishte dalë matanë ishte gjet para tre burrave me tre gisht mjekërr, të ulun galuc rreth nji tabakëje mbi të cilën ishin vendosë disa pjata plot me meze, djath, vezë të zime, domate, qepë, buk misri dhe tri gota uji me raki. Mbanin do pantallona kilotë e këmisha të përhimta, këpucë me qafa të mbërthyeme me lidhëse prej lekure, si të alpinistëve. Gjith pluhun e të palamë. Gazetarë, gjeologë apo turistë ? Në një qoshe të dhomës kishin vendosë çantat e shpinës dhe tre shkopij në formë kazmëje të vogël që zakonisht përdomin turistët e gjeologët. Në rrypat e mesit mbanin revolverë në këllefa, dhjetëshe austrie. Njëni prej tyne mbante syze të rrubullakta me skelet te zi metalik të hollë. Ky ishte flokëzi, dy të tjerët leshverdhë. Mosha e tyne rrotullohej rreth të tridhjetave. Të tri veshtrimet e austriakëve ishin drejtue nga ai djalë i ri shtatgjatë e i pashëm që mbante një uniformë studenti. Djaloshi e kishte thye menjëherë atë çast hutimi duke folun gjermanisht:

-- Guten Apetit meine Herren. Wie geht's Ihnen ?... Wie kann ich Ihnen helfen ? *Ju baftë mirë, zotnij të nderuem. Si jeni? Në ç'farë mund të ju ndihmoj ?* Ata kishin mbetun gojë hapun, e pas hutimit të parë i ishin hedhun në qafë

-- Unser Retter, unser Retter!! *Shpëtimtari ynë! Shpëtimtari ynë!*

Po ia merrmin frymën duke e përqafue. Mbasi u qetësuen ia kishin shtrue bisedës. Im atë e kishte përvetësue gjermanishtën në gjimnaz ku kishte pasë profesor për këtë gjuhë, vetë Dom Ndre Mjeden, dhe të tjerë, që kishin krye studimet në Austri.

Tre austriakët, bashkëmoshatarë, ishin shokë e miq të ngushtë qyshë nga bankot e shkollës. I përkisnin familjeve të ngrituna të Austrisë. Njeni, Eduard Von Grimm, kapiten, rridhte nga nji familje aristokrate, brez pas brezi gjeneralë të përardorisë. Tjetri, Hermann Von Kirshner, fisnik, edhe ai kapiten, banonte e punonte ne Vjenë, por kishte pasuni e shpia edhe në Prage. I treti, Emil Brozovly, kont hungarez, mjek ushtarak, kapiten, me banim e me punë në Vjenë e me prona, pasuni e shpia në Budapest. Te tre ushtarakë, kapitena. Kishin ardhë në Shqipni me detyrë të posaçme për studimin e vendit. Merreshin jashtë detyrës, me arkeologji, histori, etnografi, etj. I kishte zanë lufta ne malet e Shqipnisë dhe kishin mbetun pa ushqime e nuk dinin kah me shkue. Prandaj kishin rastisë tek ai han për të kërkue bukë, vezë, qumesht, etj. Me kë me u marrë vesh ? E falënderonin harxhiun që kishte tregue i sjellshëm e bujar. U kishte dhanë me hangër e me pi e u kishte lane me kuptue me shenja se do ta gjente një njeri që fliste gjermanishtën. E çnjeri se ? Një alamet djaloshi e shpëtimtar i tyne ! Zunë miqsi menjëherë. Kur morën vesh se si e kishte punën me shkollën e se si edhe ai ishte bllokue në Shqipni prej luftës, i propozuen që ta merrnin me vete, po ai u siguronej kalimi deri në frontin bullgar. Bullgaria ishte aleate luftë me Austrinë. Ata e kishin kuptue se ai i përkiste nji familje të randësishme të vendit. Im atë i qetësoi dhe i ftoi në

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

shpi, ku mund të pushonin dhe të vendosnin si me veprue. Që nga ai çast ata ishin nën mbrojtjen e fisit të tij. Nuk guxonte kush t'i prekte e t'i trazonte. Mbasi u përshëndetën me Gjet Toskën duke e falënderue për mikpritjen u nisën. Ata kishin dashtë të paguenin por Gjeta në asnjëmënyrë nuk kishte pranue. Ndërkaq im atë e kishte porosit Gjonin me lajmerue axhën, Ndrec Pjetrin, zotin e shpisë, se po vinte me tre miq austriakë, që kishin humbë rrugën e kishin kërkue ndihmën e tyne. Arritën te perroi i Urdhazës e u afruen te tre mullij, rresht njeni pas tjetrit. Iu ngjitën kodrës së Lekbibajve, kështu quhej ajo kodër ku ngrihëshin kullat. Ma në fund u afruen të ato kulla ku u doli përpara një varg shkambor, sikur t'ishte krijue nga dora e njeriut, që formonin një si mur ciklopik, e pertej tij, kompleksi prej tre kullave gurore të ndërtueme në tri terraca me prita muri, që formonin tre oborre, sipas nivelit të ndërtesave. Dalloheshin dyert me qemerë harkorë prej guri të bardhë, me zbukurime floreale të skalituna me mjeshtri. Im atë pati kohë me u tregue diçka per ato ndërtesa gurore që quhëshin Kullat e Gjin Pjetrit, në kujtim të udhëheqësit të kry engritjës Kurbinit, qe kishin njohun luftimet kundër turqëve e që ishin djegun e shembë disa herë prej forcave osmane.

Kishte dalë për t'i prit vetë zoti i shpisë, Ndrec Pjetri, vellai ma i vogël i Gjin Pjetrit, burrë i urtë, trim dhe i mençur. Trup gjatë dhe i pashëm, me një pal musteqe të zbardhuna, i veshun me kostumin kurbinas, me tirq e xhamadan dhe kësulën e bardhë rrafshatake. Nën vetullat e trasha ndrisnin sytë e tij të kaltërt. Një plak i hishëm. Austriakët e shikonin me admirim. Ç'rracë këta shqiptarët ! Im atë, ia shpjegoi axhës gjëndjen e austriakëve dhe propozimin që i kishin ba. Ndrec Pjetri i ndëroi miqtë me një pritje qe i la ata të mahnitun. Hypën nalt nëpër një shkallë të drejtë prej druni në atë që quhej oda e miqve. Një odë e madhe katërkandësh me një oxhak prej guri të gdhendun. Para oxhakut një prak katror i shtruem me rrasa të bukura. Miqtë zunë vendin e nderit pranë votrës në anën e djathtë të oxhaku, ku ndizej një zjarr i qetë. Përballë, në anën e majt të oxhakut, rrinte Ndrec Pjetri i pari i fisit, i cili mbasi u hodhi miqve kutinë e duhanit, dhe i pyeti e përshëndeti me anë të t'im etit që i rrinte pranë e ia përkthente fjalët, filloi ceremoninë e pjekjes së kafës. Mbushi xhezmën e madhe me ujë të nxehtë nga një ibrik që mbante afër zjarrit. Hodhi kafën e sheqerrin. Nxori filxhanat nga dollapi i vogël i futun në mur, bri oxhakut. Mbasi i mbushi filxhanat, një nga burrat që rrinin nga fundi i odës u çue dhe ua vuni përpara miqve. Oda e madhe ishte shtrue me qylyma endun me fije leshi, ku dominonte e kuqja dhe e zeza, me figurat e stilizueme të shqipës dykrenare. Kujtimi i flamurit të Gjergj Kastriotit ruhej në çdo orendi e zbukurim shtepijak. Mbi qylymat ishin vendosun postiqe dhensh. Gratë nuk hynin aty. Shërbimet kryeshin prej meshkujve.

Në pjesën fundore të dhomës ishin radhitë burrat e tjerë e disa të rij, që vetëm dëgjonin e kryenin ndonje shërbim sipas urdhnit të zotit të shpise.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2016)

Austriakët, ndonse kishin problemin e tyne ndiqnin me vëmendje çdo lëvizje e gjest të këtyne shqiptarve të vërtetë, që ruenin të pa cënueme traditat e zakonet e tyne shekullore. U tërhiqte vëmendjen struktura e asaj ode të madhe me mure të tymosun, dritare të vogla dhe disa frengji të ngushta, për raste luftimi. Tratë e trashë prej lisi të tavanit të nximë prej thirrit. Vargu i krrabave ku ishin varun nje radhë pushkësh të markave të ndryshme. Tatë Ndreca, kështu e thërriste baba, fliste me ngadalë e i matun, duke i dhanë nga një të fërkueme mustakëve. I siguroi miqtë se do t'i përcillte ai vetë me Prenkën atje ku dëshironin, me një grup burrash t'armatosun. Ata ishin në besën e mbrojtjen e shpisë dhe të fisit e nuk kishin pse të shqetsohëshin ma tash e tutje. Por kryesorja ishte të pushonin e ta merrnin veten. Të lahëshin e të ndërrohëshin. Ai u kishte dhanë urdhën grave që të përgatisnin ujët e ngrohtë dhe të merrëshin me larjen e rrobave e ndërresave të austriakëve.

Miqtë kishin mbetun të çuditun nga ajo sjellje fisnike. Ata patën mundësinë të lahën e të hiqin mjekrrat. Veshën ndrresa të pastra nga ato të shpisë, dhe me kënaqësinë ma të madhe zunë vendet e tyne rreth oxhakut. E ndienin veten të lehtesuem e te çlodhun. U afrue mbramja dhe nuk vonoi e u shtrue sofra, mbushun me meze të çdo lloj, melçi të skuqura, djathë, petulla me mjaltë, qepë, turshi, etj. me gotat e rakisë secili perpara. Oda ndriçohej nga tri llampa vajguri. Njena mbi oxhak e dy të tjerat mbi muret anësorë, që lëshonin dritë të mjatueshme. Miqt e ndjenin veten mirë e shihej se ishin të kënaqun nga ajo pritje e ngrohtë që u bahej. Ndërkaq Ndreca kishte ngritë gotën:

- Kjoftë lëvdue Krishti e mirë se na keni ardhë. Përtëmir e ju priftë mbarë ! Im atë përkthente.

Kur austriakët e morën vesh domethanjën e fjalëve, mbetën të çuditun. Në atë përshëndetje përmblidhej e gjithë qëndresa shpirtnore shekullore e shqiptarve kundër pushtimevet të hueja dhe t'atij të fundit 500 vjeçar turk. Ishte nji përshëndetje që përsëritej prej 1800 vjetësh !

Rakia vazhdoi do kohë. Austriakët e pinin me qejf. Pastaj u shtrue darka. Miqtë patën rastin të shijonë mishin e pjekun në hell të një ftujaku, rritun në kullotat e përmenduna të Skurajt, që e banin mishin ma të shijëshëm. Ndreca, kishte ndërhy përsëri :

- Miq të nderuem, rrini do ditë këtu bashkë me ne. Pushoni. Kur ta shifni vetën ma mirë, nisemi.

Ajo pritje bujare dhe ajo darkë do të mbetëshin në kujtesën e tyne tanë jetën. Ata vendosën të rrinë disa ditë aty, për ta marrë mirë veten, sepse kishin vuejtë e ishin dobësue nga endjet poshtë e nalt pa pushim, duke u ushqye keq e duke mos e njohun gjumin.

Ndërkohë me anë të një harte ushtarake shumë të mirë të Shqipnisë që kishin, bashkë me Prenkën dhe dukë pyet tatë Ndrecën, që i njihte si në pëllambë të dorës ato vende, ata caktuen se si e ku duhej të dilnin në

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Maqedoni për te zona e luftimeve. Atje mund të ndeshnin forcat e bullgarëve, aleatë të tyne. Kështu erdhi dita e nisjes. Ndërkohë im atë kishte folë me t'amën, nanë Mrikën, duke i shpjegue se si i kishte dalë fati me shkue në Austri bashkë me këto tre miqtë. Nanë Mrika ia kishte dhanë menjëherë pelqimin e bekimin. Ajo, vërtet që e kishte djalë të vetëm, por njeriu disa herë duhet të dinte ta kapte fatin e vet, dhe ajo kishte besim se djalit të saj fati i kishte ardhë në dorë e nuk duhej ta lëshonte. Ajo ishte një grue kurajoze, që ishte rritë mes tymit të barotit dhe kishte përjetue luftimet e djegien e shpijave prindore nga turqit, si edhe ato ku kishte shkue nuse. Burrin ia kishin vra, duke e lanë të vejë me atë fëmi nandë vjeç, që tashma ishte ba burrë. Ajo nuk e pengonte në këtë nismë. Të shkonte, të shkollohej e të kthehej me i shërbye atdheut.

Erdhi dita e nisjes. Im atë u përqafue dhe një herë me nanën e me robt e tjerë të shpisë, që kishin dalë me përciellë atë cdhe miqtë.

Lumin e Matit megjithëse ishte fry nga shiu që kishte ra malëve e vinte i trubullt e kaluen pa vështirësi. Ndërsa po visheshin, im atë u kishte tregue se ai vau që ishte dhe një vend i bukur me rrapa viganë ishte pronë e tij e trashëgueme nga i ati. Pasi u veshën e mbathën u nisën.

Udhëtimi vazhdoi tre dit nga miku në mik. Natën e fundit ata e kaluen të një shpi mike në Dibër të Madhe, në territorin e Maqedonisë. Aty morën vesh ku zhvilloheshin luftimet midis serbëve e bullgarëve. Dy burra të shpisë e morën përsipër t'i përciellnin natën deri aty ku ata mendonin se mund të ndeshnin në forcat bullgare. Njeni nga tre miqtë, hungarezi Brozovly, i njihte gjuhët sllave dhe fliste bullgarishten dhe serbishten. Kjo ishte diçka e mirë dhe e favorshme për ta. Dy shoqnuesit i përcollën deri në një far vendi, dhe mbasi ua shpjeguen drejtimin, u kthyen dalë.

Kapiteni Von Kirschner që kishte përvojë për situata të tilla e mori komandën. Me anë të busullës, tue caktue drejtimin që duhej marrë, u prini nëpër errësinë. Ecën ashtu për do kohë nën dritë e yjeve. Hana kushedi ku shetiste. Ecnin me kujdes, me armët në gatishmëni për çdo të papritun. Mbrritën te një gropore, ku vendosën me qëndrue deri kur të sbardhte dita. Sa agoi, ashtu siç rrinin të strukun në atë gropore, u degjuen disa zana. I banë veshët pipëz

- Mbani heshtje ! Kishte folë Brozovly. Ishte një za komandues në gjuhë sllave.

- Shpëtuem ! Janë bullgarë ! Nxirmi shpejt një shami të bardhë ! Thirri hungarezi.

Lidhen një leckë të bardhë maje nji pushke, dhe e ngritën nalt. U dëgjue prap zani i parë. Brozovly, që e kuptoi c'thoshte bullgari atanë u çue në kambë dhe iu përgjigj bullgarisht. Bullgarët u afruen dhe oficeri që kishte folun erdhi e u takue me austriakët me përzemërsi. Çështja u zgjidh në vend. Ndrec Pjetri e tre shoqnuesit u përshëndetën me miqtë e huej dhe me nipin e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

morën rrugën e kthimit. Bullgarët i shoqnuen tre austiakët e Prenkën deri në komandën e tyne. Aty austriakët dhanë shpjegimet e duhuna. Qëndruen atë ditë të mirëpritun nga komanda bullgare sa me e marrë pak veten. Të nesëmen u nisen me një mjet ushtarak për në Shkup e prej aty në Sofie. U paraqitën në ambasadën austriake, ku u pritën si heroj. Qëndruen dy dit në Sofie, miq të ambasadorit. Dolën me Prenkën, të cilin e pajisën me rroba e ndërresa të reja, duke ia hequn kostumin e gjimnazistit që ai mbante. I erdhën vërdallë për qejf kryeqytetit të Bullgarisë, ku vizituen kishën e Shën Sofisë, Pallatin Mbretnor etjera ndertesa të randësishm. Im atë tashma po njihte e shijonte një jetë ma të qytetnueme, në një vend ballkanik që ishte afrue nga Evropa. Rrugë të shtrueme, hekurudhë, drita, pallate e shtëpi të bukura. Ndërsa në vendin e tij, sundonte pisha e bishtuku i vajgurit. Pa rrugë, pa ura, ku qytetet ishin si fshatna, me kasolle e shtëpi përdhese prej çerpiçi. Shkodra ku ishte rritë, po i dukej tashma një lagje e varfën e Sofies. Pastaj i hypën trenit për në Budapest. Qëndruen dy dit të tjerë pranë Kontit Brozovly, i cili, për hatër të tim etit, i bani me vizituc këtë qytet, që për bukurinë e tij tërhiqte turistë nga gjithë bota. Sigurisht se Budapesti ia kalonte shumë Sofies. Urat metalike monumentale mbi Danub që ndanin Budën nga Pesti. Muzeumet e Galeritë e Artit. Kafenetë, teatrot dhe sallonet e kontëve hungarezë. Mandej drejt e në Vjenë. Madhështia dhe bukuria e kryeqytetit perandorak e mahniti. I dukej vetja ne një botë prallore. Tashma ishte në qendër të qytetnimit evropian, ku dominonin pallatet, katedralet, kishat, monumentet, parqet, shatërvanët, teatrot, muzika. Danubi me urat bukura, etj., etj. Lufta kishte fillue e aty në Vjenë nuk ndihej fare. Faktor kryesor ishte se në atë kohë nuk ekzistonte aviacioni luftarak e qytetet nuk rrezikohëshin nga bombardimet ajrore. Lufta zhvillohej në fronte te largëta. Njerëzit e vazhdonin jetën e tyne normale, me punë e aktiviete të ndryshme kulturore, ku dominonte muzika e ballot në sallonet e shoqnisë si ngritun Vjeneze. Ky kontakt i menjëhershëm me qytenimin evropian, e kishte trondit shpirtnisht. Shqipnia kishte mbetë në gjendjen mesjetare. Pushtimi 500 vjeçar turk, e kishte izolue krejtësisht nga bota e qytetnueme. Profesorët e tij të gjimnazit të Shkodrës, i dukëshin tashti heroj të vërtetë. Ata kishin njohun qytenimin e kulturën evropiane, ku kishin krye shkollat e nalta, dhe ishin kthye në atdheun e tyne për ta ngritun nga prapambetja, për të çue pakëz dritë në atë errësinë shumëshekullore. Edhe ai ashtu do të vepronte.

Im atë tashma ishte ba me tre miq, tri shtëpi, tri familje. Kush e kush të kujdesej ma mire e ma shumë për të. Nga ana tjetër mi më, që ishin të njohun, e paraqitën dhe e regjistruen menjëherë në «Kadettenschule» të Vienës (Akademia Ushtarake) ku pranohëshin vetëm djemt e familjeve fisnike të Perandorisë. Sigurisht se i vlejti diploma e maturës që kishte marre me vete, e që njihej nga Ministria e Arsimit të Austrisë. Rregullat ishin rregulla. Në universitete e akademitë ushtarke s'mund të hyje pa diplomën e maturës*.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Mbasi mbaruen këto formalitete edhe disa punë të tjera, e shetitën mikun e ri për disa ditë nëpër gjithë Vjenën. E njohen me monumentet kryesore si Katedralja e Shën Stefanit, Pallatin Perandorak në Shönenbrunn, Pallatin e Parkun e Belvedere, Pallatin e Operas, Teatrin e Qytetit, Parlamentin, urat mbi Danub, kafenetë e hotelet kryesore e te tjera ndertesa me vlera arkitektonike etj. E çuen pastaj të Muzeu historik i Vjenës ku ai pati kënaqësinë të admironte e të prekte me dorë shpatën dhe kokorën e Skënderbeut me një emocion të madh të papërmbajtun.

Pastaj e përcollën në Kadettenschule ku do të jetonte si konviktor e do të vazhdonte studimet për të dalë oficer. Sigurisht se im atë ne atë moshë të re kishte mbetë i mrekulluem nga madhështia dhe bukuria e Sofjes e dhe Budapestit, por kryeqyteti Përandorak e kishte magjepsun krejtësisht. Miqtë e paraqitën edhe te familjet që i përkisnin rrethëve të elitës fisnike vjeneze, duke e prezantue si shpëtimarin e tyne dhe si pinjollin e një familje fisnike të randësishme shqiptare, siç e tregonte dhe vetë paraqitje e tij. Nuk i munguen atij njohjet me vajzat e këtyne familjeve, që ndiqnin me sy kurrështarë këtë të ri aq të pashëm e fisnik e që përmatepër e fliste gjermanishtën aq bukur.

Rrëfente im atë, se në ato kushte të reja që u krijuen ashtu si për mrekulli, rrinte tue mendue si ndodhi që ata të huejt të vinin pikërisht aty te hani i Gjet Toskës ? E pse ai qëlloi aty ? Kur u njoh me ta, në çast i shkoi në mendje se fati po i jepte një shans të papritun, që duhej kapun patjetër e s' duhej lëshue. Njëherë të vjen zogu në dorë ! Nga gjithë zhvillimi i kësaj ngjarje nxirret përfundimi se jeta e njeriut asht e shkrueme, siç thotë populli. Krijohen disa rrethana e situata të atilla të paprituna që i japin jetës një kthesë të caktueme të paparashikueshme, që njeriu vetë nuk do mund të realizonte. Në rastin e tij rethanat u zhvilluen në një mënyrë të atillë, sikur i drejtonte nji forcë e padukshme, nji fuqi jashtë përmasave njerëzore e pakontrollueshme, sëcilës nuk mund t'i shmangesh as t'i shpëtosh. Nga ana tjetër del se në këtë kontekst ndikon edhe vullneti i njeriut. Asht njeriu që duhet të marri vendimin për po ose për jo, për mirë ose për keq. Pra midis fàtit dhe vullnetit të njeriut krijohet nji lidhje që kushtëzon nji situatë të caktueme e cila gjen nji zgjidhje pozitive apo negative sipas shembullit të ndarjes së dy rrugëve, ku njëna do të merrej patjetër. Në rastin konkret, lypsej guxim, të dalë ku të dalë ! Im atë kishte nji simpati të veçantë për Aleksandrin e Madh. Kur ai u gjet para nyjes së pasgjidhshme

---

*-- Persa i perket shkollave te larta, si Univesitete e Akademi Ushtarake s'mund te hyje pa pasë diplomën e maturës, të njohur prej Ministrisë së Arsimit të Austrisë. Po e themi këtë, sepse ka patur e ka shqiptarë qe pretëndojne se baballarët e tyre paskëshin krye Akademinë ushtarake ne Vjenë, pa pasur asnjë dokument shkollor, sikur dhe të fillorës.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

të Gorgonit, pasi i hodhi një vështrim, nxori shpatën dhe e ndau në vend. I dha zgjidhje një problemi që kishte shekuj që qendronte i pazgjidhun. Ishte një gjest frymëzues për vendime guximtare. Im atë e tregoi që në atë çast që vendosi me shkue me austriakët, se ishte njeriu i guximit, një cilësi që do ta shoqnonte gjithë jetën e që do ta ndihmonte me përballue me sukses situata shumë të vështira. Në fund të fundit, guximtarve u prin fati. *Audaces fortuna juva*





Prenk Pervizi në moshën 10 vjeç, 1907,
me kostumin me kësulë të kuqe të "Konviktit të Malëve" në Shkodër.
(Nga një foto e zbulueme në fototekën Marubi, Shkodër, pas 110 vjet)

Shënim :

Gjithë sa u tregue deri këtu i përgjigjet rrethanave te vërteta në të cilat im atë u përfshi. U banë shkak ato tre austriakët që ai të mund të arrinte me vazhd e te kryente Akademinë Ushtarake. Njëkohësisht nëpërmjet kujtimeve të ti, j na jepën përshkrime që lidhën me mjedisin e jetës së shqiptarve në kushtet primituve ku e kishte katandisun pushtimi osman. Nga ana tjetër del ne pah roli i fatit në jetën e njeriut që hyn në rrjedhën e rrjedhjeve të papritura, pothuej si të paracaktueme. Del sheshit edhe kontaki i befasishëm me qytetnimin që kishte marrë zhvillim edhe në shtetet fqinjë si Bullgaria, e me radhë Hungaria deri në Austri, ku qytetet shqiptare i ishin dukun si fshatna të prapambetun.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

Midis historisë e lëgjendës

Tregimin e nisëm fillimisht me nji ngjarje vendimtare për jetën e prindit tim. Tani na duhet me u kthye pakëz mbrapa në kohë për të marrë vesh se kush ishte ky djalë.

Lindi në Skuraj me 4 maj 1897, në ato kullat historike të Gjin Pjetrit, në nji familje që mbante emnin fisnik të Pervizit të Skurajve të Kurbinit. Stema e Skurajve ishte një luan (ose uk) në kambë me një brazdë të tërthortë, dhe një dekor lule zambaku. Nji stemë krejt e veçantë për nga forma dhe paraqitja figurative. Ajo u zbulue nga konsulli e studiuesi austriak; Teodor Ippen, më 1907, në kishën e Zojës Nunciata në kodër Marlekaj të Lezhës. Pllakë e varrit të princit Anton Skura, sh. XIII. Ruhët në Muzeun Kombëtar në Tiranë. Dikur Principata e Skurajve shtrihej nga Kurbini deri në Berat e Vlonë. Mendohet se ajo ishte krijue rreth shekullit XII. S'ka dyshim se asaj i perkistee ashtuqquejtuna principatë e Arbnit me Progonin e bijt, Gjini e Dhimitri me kryeqytet Krujën. Principatë që për histotianët qednron akoma e pa studiueme mirë, dhe së cilës nuk i dihet emërtimi i vërtetë. Fill pas vdekjes së Car Dushanit e shpërbamjes së mbretnisë tij (1355), ku ishte përfshi Shqipnia, u krijuen disa principata ndër to principata e Skurajve, e cila ishte forcue me Princin Aleksandër Skurën, që sundonte në Vlonë. I pari princ shqiptar që përmendet historikisht, në analet rumune, për pjesmarrje në një betejë të një koalicioni ballkanik të vitit 1378 që u zhvillue kundër turqëve në Rumeli, ku ai komandonte ushtrinë shqiptare. Ma vonë principata u dobsue edhe u kufizue në krahinën e Kurbinit me qendrën e saj në Skuraj, duke kalue fillimisht nën sundimin e Topijajve pastaj nën atë të Kastriotëve. Fisi i Pervizit të Skurajve qendroi përkrah Katriotëve qyshë me Gjon Kastriotin e pastaj me të birin, Gjergj Kastriotin Skandërbeun. Princat Skuraj moren pjesë në Beslidhjën e Lezhës në mas 1444, e gjatë gjithë kohës deri 1468, i qëndruen atij krah për krah. Skënderbeu kishte vendosun në mallet e Skurajt, një bazë të fortë prej ku ndermerrte sulmet mbi hordhitë pushtuese osmane. Vlerësonte shumë vendosmëninë e banorëve dhe trimninë e burrave të Kurbinit, që përbanin gardën dhe një pjesë të mirë të ushtrisë tij. Mbas vdekjes së Skëndërbeut kreu i fisit, princi Ndue Skura me dy djemtë e disa kushrij u detyrue me u largue për në Itali në krahinën e Ankonës, ku andej nga viti 1520 figuronte një fisnik me emnin Dhimitër Skura. Ma vonë në Durrës mori randësi Ipeshkvi Mark Skura, i cili u përpoq për shkollën shqipe e të tjera çeshtje, lidhun me kundështimin ndaj pushtimit osman. Por dikush kishte mbetun për të vazhdue mbijetesën e fisit. Gojdhana ma e hershme asht ajo e Pervizit të Madh të Skurajve, të cilit nuk i asht përcaktue mirë koha. Mendohet të ketë qenë para ardhjës së Skandërbeut, kur turqit e mundën

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Gjon Kastrioti më 1413-14 dhe morën Krujën duke e pushtue principatën e tij, ku pas vdekjës tij, ia zuni vendin një Guvernatot turk. Ky deshi të zgjanojë pushtimin në zonat malore drej veriut dhe ndeshi në qëndresë e Pervizit të Skurajve. Emni i Pervizit vjen historikisht nga një lashtësi ma se 2000 vjeçare, që u ruejt i pacenuem e i pandryshuem brez pas brezi ndër shekuj dhe ku rezulton se qendra e tyne ka qenë pikërisht në Skuraj. Por kjo asht një tjetër bisedë. Komandanti trim Pervizi i Madh (siç quhej) arriti me u qëndrue në kalanë e tij në Ferrë-Skuraj sulmeve pa sukses të turqëve, që kërkonin të dëpërtonin në zonat veriore, pas fitorës mbi Gjon Kastriotin dhe vdekjës së tij. Ai nuk i pranoi propozimet e turqëve për pozita të nalta të shoqnueme me dhurata të çmueshme e me flori. Atëhere Turqit vendosën me e eliminue fizikisht dhe e banë për veti probatinin për me ia zanë vendin, i cili arriti ta vrasë Pervizin me pabesi gjatë një gjuetije ne pyllin aty afër. Besnikët ia morën hakun kështjellarit trim duke e vra tradhëtarin. Princi u varros aty ku u vra, sipas fjalës që kishte lanë, që të varrosej aty ku trupi tij të binte për dhè. Ai varr, rrethue me gurë, ruhet sot e kësaj dite. Turqit, përfituen nga vrasja e princit. Ndërhynë dhe e shembën kalanë dhe dogjën kishën e Shën Gjergjit dhe rrënuen fshatin. Nga inati u munduen me zhduk familjën e fisin e Pervizit , që u strehuen në malet e ashpra të Skurajt. Historia e Pervizit u ruejt djalë pas djali në gojdhanat e popullit. Fisi mbijetoi e u forcue dhe njëkohësisht nuk pushoi së kundërshtuemit pushtimin turk duke marrë pjesë në të gjithë kryengritjet që plasën në krahinat veriore. Dëshmi janë rrënojat e kalasë e të kullave të tyne të djeguna herë pas here nga hordhitë anadollake.

Ndërkohë fisit iu desht me ndërrue disa herë emnin për t'i ikun përsekutimit të turqëve. Nga viti 1650 mbajti emni Ukasanaj me të cilin gezonte autoritet të fortë. Ky emën vinte nga stema e Skurajve me figurën e luanit ose ukut, siç e quente populli, pra si fisi i Ukut, Ukasanaj. Kjo deri në kohën e Gjin Pjetër Markut, kreu i fisit, i cili për të vu në vend nderin dhe emnin e derës, mblodhi kuvendin e Dëlbnishtit me 5 - 6 - 7 gusht 1906 me 54 pleqt të Kurbinit dhe të semtit të Krujës, të cilët ia njohën autoritetin si Gjin Pjetër Mark Pervizi Skuraj i Kurbinit, duke e rikthye emnin e fisit ne vendin e vet të nderit, si fis i vjetër fisnik, dhe vetë Gjinin, e njohën plak të parë të 54 pleqve të Kurbinit dhe të Semtit të Krujës, përfaqësues i vegjelisë (popullit). Populli e kishte gjetë udhëheqësin e vet te Gjin Pjetër Pervizi dhe ia njihte atij të gjithë të drejtat e meritat që i takonin sipas traditave shqiptare. Në aktivitetin e tij patriotik e luftarak ai ishte i lidhun e ne marreveshje me patriotë të tjerë rilindas, si Bajram Currin, Isa Buletinin, Abdyl Frasherin, Murat Toptanin, Fuad, Vehbi e Refat Toptanin, Ded Gjo Lulin, Ded e Gjeto Cokun, Mehmet Shpendin, Luigj Gurakuqin, At Shtjefën Gjeçovin, Nikoll Kaçorrin, Prend Bardhin, Ismail Qemalin, Ndre Mjeden, Gjergj Fishten, Preng Bib Dodën (Preng Pashën), kapidanin e Mirditës Marka Gjonin, Zef Ndocin, Abat Doçin, Parinë e Krujës, e të tjerë patriotë. Sigurisht se pleqt e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

vitit 1906 i dinin punët ma mirë se ata të vitit 2016. Një dam të madh solli diktatura komuniste kur emni i Pervizit as nuk mund të përmendej dhe jo ma të vlerësohej. Kjo nga fakti se kreu i fisit, im atë, Gjeneral Prenk Pervizi, nuk i përfilli komunistët dhe u qëndroi kundërshtar i vendosun, si gjatë kohës që ndejti në Shqipni ashtu dhe i arratisun jashtë shtetit Si pasojë i gjithë fisi iu nënshtrue një përsekutimi të paparë dhe historia e tij u hesht dhe u mbulue me pralla kalamajsh për njerëz të tjerë të pa kurrfarë vlere, barij dhensh e dhishë e banditë rrugësh, për të paraqitë historinë e Kurbinit të çveshun nga çdo vërtetësi dhe nga çdo figurë të shqueme që lidhej me emnin e Pervizit. Edhe kur regjimi komunist u detyrue të njohë veprimtarinë patritioke të Gjin Pjetrit dhe biles ta dekorojë atë, nuk ia përmendi kurrë mbiemnin Pervizi, duke e mbajtë në anonimat, mbiemën i cili ishte vu në shënjestrën e regjimit komunist për t'u zhdukë nga faqja e dheut.

Pra, im atë lindi në atë kohë kur në të gjithë Kurbinin kërciste pushka mbi turqit. Populli e kishte njohun Gjin Pjetrin si udhëheqës dhe ishte hedhë pas tij në kryengritjen e përgjithëshme kombëtare, që në Kurbin mori përmasa të randësishme. Historiani i njohun Zef Valentini e përcakton kryengritjën e Kurbini me Gjin Pjetër Pervizin në krye si ajo që i dha nismë kryengritjës së përgjithëshme kombëtare. Kurbini kishte çue krye kundër Stambollit edhe ma përpara në Kryengritjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në 1878, që u shtyp barbarisht nga taborret e turqisë të Dërvish Pashës më 1881, që dogjën kullat e Pervizajve në Skuraj. Ato kulla do të digjëshin përsëri nga turqit më 1911. Po ato ndërtesa ku kishte lindë Prenk Pervizi, mbas rindërtimit të tyne. Ma vonë ato kulla nuk do të kursehëshin as nga partia komuniste shqiptare qe me brigatat partizane terroriste do t'i digjte për te tretën herë më 17 janar 1945, pikërsih në ditën e vdekjës së Gjergj Kastriotit. Rastësi ?

Stambolli kujtonte se me të tilla masa shtypëse, mund të mposhtej populli i Kurbinit. Kishte harrue se pikërisht Kurbini ishte një ndër krahinat ma të vendosuna e të papërkulshme, që bashkë me Mirditën, Lezhën, Kthellën, Dukagjinin e Malsinë e Madhe, formonin atë zonë të pathyeshme, që ruejtën të pacenueme besimin e tyne kristian-katolik gjatë 19 shekujve. Kishin harrue se fisi i Pervizit që përfaqesonte Kurbinin nuk ishte nga ato që mposhtëshin kollaj. Faktikisht, ndonse e lidhun historikisht pas Krujës, Kurbini nuk u mposht e nuk pranoi të ndryshonte fenë e të parëve, as me forcë as me hatër. Edhe musulmanët e Kurbinit e të Krujës i ndejtën përkrah Gjin Pjetrit. Ata ishin të ndërgjegjshëm se të parët e tyne kishin qenë katolikë. Kurbini u ba prita e pakapërcyeshme e mosnënshtrimit ndaj pushtuesit osmanlli. E kur filloi të fryeje flladi i lirisë, u çue në kambë e i roku armët për të mbrojtë të drejtat e veta dhe çeshtjen kombëtare shqiptare nën udhëheqjen e burrit ma të spikatun të krahinës, Gjin Pjetër Mark-Pervizit të Skurajve, për të cilin dhamë shpjegimet e duhuna ma sipër. Emni tij do të radhitej me emnat e atdhetarëve të mëdhej të Rilindjës.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Lindja e tim etit u prit me gëzim të madh, dhe u përshëndet me krisma pushkësh e me gosti. Ai ishte fëmija i parë dhe i vetmi i Frrok Prendit, ky, djalë axhe me Gjin Pjetrin. Nga dita e martesës së tij me Mrikën, vajzën e Preng Nikoll Palit nga Bulgëri, kishin kalue 11 vjet pa fëmijë, dhe pothuej e kishin fjetun mendjen se mund të kishin ndonjë. Kur ja, Zoti ua fali ! « Zoti e ban mirë !» shkonte tue thanë gjithmonë nanë Mrika, gjyshja jonë, grue e dëvotshme, dhe Zoti mirë e bani, që i fali një djalë. Ajo kishte përjetue mjaft ngjarje që në rininë e saj. Kishte ndjekë luftimet e çetave të Lidhjes së Prizrenit e kishte përjetue djegien e kullave atnore të Preng Nikoll Palit në Bulgër, prej ushtrisë turke në moshën 21 vjeçe, më 1881, kur u dogjën dhe kullat e Pervizajve në Skuraj. Prej atyne rrethanave ishte martue në moshën 26 vjeçe, me Frrok Prendin. Këto rrethana të bajnë me mendue, se fati i njeriut vëndoset e zhvillohet sipas një paracaktimi të padiskutueshëm, për ata që kanë përvojën e jetës dhe ndjekin anën e misterëshme të fenomenëve të ndryshme që lidhen me besimin në Zotin dhe me fatin e njeriut që nga djepi e deri në vorr. U ba festë e madhe, dhe pagëzimi u krye në kishën e vjetër të Sh'na Prenës (Shën Veneranda) në malin e Skurajt, ku iu vu emni i gjyshit tij, Preng ose Prenk. Tradita do të ndiqte vijën e saj shumëshekullore, brez pas brezi. Prenk t'im etit i mbeti nga periudha e Austrisë, ku gjermanisht, shkronja "g" shqiptohet "k". Dhe ne vazhdimin e shkollës, emni iu shkrue sipas shqiptimit gjemanisht dhe i mbeti i tillë. Ngjarjet e mavonshme e shohin atë akoma kërthiqe, që merr shtigjet e maleve në kurriz të nanës për t'i shpëtue hordhive turke, kundër së cilave kishte fillue pushka në Kurbin, me qendër Skurajn. Jemi më 1897. Gjin Pjetri kishte largue të gjitha gratë me fëmijë të vegjël, pleqtë e fëmijët e mitun, nga kullat e tij dhe familjet e luftëtarve të tjerë, për me u strehue në thellësi të maleve pranë ilakave dhe miqësive. Nanë Mrika me djepin mbi shpinë, kishte marrë rrugën për në fshatin Kryezez të Lezhës, fillikat e vetëm, ku kishte të martueme motrën, Dilukën, te Pal Gjin Kryezezi. Aty ajo më fëmijën qëndruen gjashtë muej. Kur kaloi vala e trubullinave u kthyen në Skuraj. Ngjarjet historike po e përfshinin tim etin që në moshën e foshnjërisë, si një paralajmërim për ngjarje të mavonshme. Kur im atë sa kishte kalue moshën gjashtë vjeçe, Gjin Pjetri vendosi ta dërgonte në shkollë në Shkodër, bashkë me fëmijë të tjerë Kurbinas, Mirditas e të Malësisë së Lezhës. Në fakt, i kishin çue fjalë nga Shkodra, ku ishte krijue "Konvikti i Maleve", që të dërgonte disa fëmijë nga këto krahina, të zgjedhun nga po aq shpi të mira. Gjini, për shpinë e vet, vendosi me dërgue Prenkën, që dallohej për squetsi mbi fëmijët e tjerë. Gjini i kishte kërkue pelqimin t'ati, Frrok Prendit, i cili ia kishte dhanë menjherë. I zoti i shtëpisë, në familjet patriarkale, nderohej e respektohej. Fjala dhe vendimet e tij ishin ligj dhe askush i shtëpisë nuk i kundështonte. Ishte vetë Gjin Pjetri që e përcolli Prenkën në "Konviktin e Maleve" bashkë me baballarët e fëmijëve të tjerë. Gjini e kishte synin te Prenka i vogël për me vazhdue trashigiminë e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

udhëheqjes së fisit dhe të krahinës. Bashke me tim etin Gjini kishte dergue edhe fëmijë të tjerë, jo vetën nga Kurbini por dhe nga Mirdita e Lezha ndër ta, që mbaj mend, Preng Jakun, Gjon Fushën, Pal Prendin, Lek Margjinin, etj. Im atë e vazhdoi shkollën rregullisht ku shkëlqeu në mësime e aktivitete shkollore. Prandaj, siç shihet, bashkë me fatin hyjnë edhe vendimet e vetë njeriut, dhe për çudi, po t'i kundërvihësh fatit punët nuk të shkojnë mbarë. Gjyshja jonë, megjithëse mbeti e vejë, vetëm me atë djalë, nuk ndërhyni kurrë me ia ndryshue drejtimin që kishte marrë, duke e lanë me ndjekë fatin që i kishte dalë. Në Shkodër, ku vazhdonte gjimnazin, im atë pati fatin e nderin të kishte për mësues e profësorë, ajkën e kulturës shqiptare të kohës dhe të gjithë historisë sonë, si Gjergj Fishtën, Ndre Mjeden, Luigj Gurakuqin, Kol Kamsin, Anton Harapin, Mati Logorecin, Hil Mosi, Pjetër Giadrin, Luigj Shalën, Ndoc Nikajn, etj., siç e kemi tregue ma përpara. Përveç profesorëve që përmendëm, ai pati shokë shkolle që ma vonë do bahëshin me emën, si Çatin Saraçin, Luigj Muzhanin, Sandër Saraçin, Zef Shirokën, Nush Topallin, Zef Serreqin, Loro Muzhanin, Spiridion Kaçaroçin, e te tjerë, që do të zinin pozita shtetnore e shoqnore me randësi. Këto përshkrime, përveç se nga im atë i kisha marrë nga vete disa të siperpermendunit me të cilët kisha nda kohën e internimit në kampin e izolimit të Kuçit të Kurveleshit, më 1954-1958. Ma vonë, rastësisht edhe nga Prof. Luigj Shala, kur isha i internuem ne Lushnje, ku ai kishte vajzën, Marien, të martueme me Z. Ali Ypi, agronom i fermës ku ne punonim, e mik i vjetër i familjës, si bir i Abdyl Ypit. Luigj Shala kishte qënë profesor i tim etit para 50 vjet, dhe me tregonte për të se si ishte një ndër studentët më të dalluem. Prandaj njohja me të tilla figura të shqueme të kulturës dhe të patriotizmit qyshë në bangot e shkollës, e brumosen atë me ndjenja të një atdhetarizmi të flakët. Mësimet, këshillat dhe porositë e tyne, i mbeten të ngulituna në mendje gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij. Ai ruejti një respekt të madh për ato burra që ma vonë iu banë miq të shtrejtë, kur ai vetë u afirmue si figurë e randësishme në jetën ushtarake, politike e shoqnore të vendit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Gjimnazi salesian i Shkodrës ku kreu mësimet Prenk Pervizi, 1904-1914.
Mes këtij grupi ndodhej edhe ai, por ku s'mund te dallohet nga vogëlsia dhe vjetërsisa e fotografisë e para 110 vjetëve



Shkodra siç e njohu Prenk Pervizi më 1904-1914, ndërsa vazhdonte shkollën në atë qytet, në gjendjën e një fshati të madh

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Fotografi historike e rallë. E viti 1907. Gjin Pjetri me tre fëmijë kurbinasa që ai kishte çue në "Konviktin e Malëve" në Shkodër, ku i pari në rresht asht nipi i tij Prenk Pervizi në moshën 10 vjeç ndërsa ai majtas Preng Jaku, ai lart i panjohun. Fëmijët mbajnë kostumet e e Konviktit me kësula të kuqe si shej dallues se asaj shkolle.

(Foto Marubi 1907)

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Kur luftohej për Liri

Ndërsa im atë vazhdonte shkollën në Shkodër, në Kurbin kishte marrë hov kryengritja kundër pushtuesit osman. Turqit ishin inatosun keq dhe kërkonin të asgjësonin Gjin Pjetrin, që po u shkaktonte trubullina dhe disfata, tue fillue nga shpartallimi i tyne në Fushën e Tallajbesë në Krujë më 1904-1906, në Pllanë (Pdhanë) më 1911 e gjetke. Kështu vendosën ta sulmojnë në çerdhen e vet në Skuraj, për t'i dhanë fund veprimtarisë së tij kryengritëse. Por po i banin hesapet pa të zotin, sepse kur taborret turke arritën në Skuraj, u gjetën para një kalaje të pamposhtshme. Mali shkambor i Skurajt midis lumit Mat dhe atij të Urdhazëz, kishte një pozicion të mbrojtun prej vetë natyrës. Ushtria turke u gjet para pengësave natyrore dhe para qëndresës së vendosun të burrave trima të Kurbinit. Megjithë goditjet e artilerisë dhe sulmëve të parreshtuna të ushtrisë osmane, pushkët e luftëtarve shqiptarë gjimonin ma shumë se topat e turkisë e banin kërdinë ndër nizamë. Kjo paraqitet me pak rreshta në një kangë popullore:

... N'at Urdhazë ka ra ushtria,
bjen daullja e bjen burija,
gjimon topi e trandët mali,
trandët shkambi, trandët zalli,
kërset pushka edhe alltia
prin Gjin Pjetri si duhija ...
……..
Shkon Urdhaza kuq me gjak,
kuq me gjak, me gjak nizami,
luftë po ban Gjin Kapidani .....

Gjyshja jonë, kësaj radhe nuk i mori shtigjet malore me djep në kurriz, por qëndroi pranë luftëtarve, sepse ishte e lirë nga përkujdesia ndaj djalit që vazhdonte shkollën në Shkodër. Gjin Pjetri kishte mbajtë gratë pa fëmijë ose me fëmijë të rritun në prapavijë për furnizim me ushqime n ar'më e municione, mjekime e kujdes për të plagosunit e të tjera shërbime të rastit. Ajo e përjetoi nga afër gjithë luftën e malit të Skurajt. Pa me sy të vet, ajo dhe gratë e tjera, se si disa nizamë vendas, tradhëtarë e mercenarë të ushtrisë turke, kishin depërtue mes tymit të luftimit, dhe u kishin vu zjarrin kullave të Gjin Pjetrit e gjithë objekteve të tjera përreth. Se si lufta u ndez ma e ahspër, deri sa turqit u tërhoqën të mundun, duke lanë mbrapa të vramë e të plagosun e shum material luftarak. Në këto luftime nuk pati asnjë të vramë nga ana e kryengritësve përveç ndonjë të plagosun lehtë, ndërsa turqit pësuen humbje në

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

njerëz. Kjo tregon se sa me përvojë luftarake ishin të pajisun luftëtarët kurbinas, përvojë e fitueme qyshë nga kohnat heroike të Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Gjin Pjetri ishte një udhëheqës me aftësi luftarake e dijti të përballojë të gjitha situatat e luftës duke ia përshtatun terrenit malor e duke përdorun taktikën e goditjeve të rrufeshme e befasuese të një lufte popullore të organizueme mirë. Im atë ndërsa ndiqte studimet e veta, krenohej duke ndigjue jehonën e trimnive të axhës së madh që printe në krye të burrave trima të Kurbinit.

Ditë ma të lavdishme po afrohëshin. Turkia kishte marrë tëposhtën. Filluen të dëgjohen tingujt buçitës të këmbanave të lirisë. Gjin Pjetri dërgon njerëz për të marrë studentët kurbinas e mirditorë që të gjendëshin ditën e 28 nëntorit 1912 në Milot, ku do të ngrihej Flamuri Kombëtar pas 479 vjet robnie. Atij i kishte ardhë telegram (tejshkrim) nga vetë Ismail Qemali, për ditën e shpalljës së Pavarësisë. Flamurin të qëndisun nga motrat stigmatine në Shkodër, ia kishte dorëzue Imzot Nikoll Kaçorri, në kishën e Rubikut. Faktikisht flamuri do të ngrihej nga Gjin Pjetri në kalanë e Krujës, ku e kishte ngrit Gjergj Kastrioti më 28 nëntor 1443, para 469 vjet. Por kruetanët e njoftuen Gjin Pjetrin me telegram (tejshkrim), që flamurin ta ngrinte ne Milot, sepse në Krujë kishin ardhë forcat serbe. Ky një fakt historik. Im atë, 15 vjeç, u gjet atë ditë, siç e kemi tregue, pranë axhës Gjin, bashkë me studentë e te rij të tjerë, kur ky përshendeti me fjalë të zjarrta shpalljen e lirisë dhe të pavarësisë duke shkref gjashtën e Karadakut, se cilës iu bashkuen krismat e armëve të luftëtarve kurbinas e të krahinave fqinje. Tre dit rresht Miloti e festoi këtë ngjarje, me gosti, haré, kangë e lojna popullore. Prangat e robnisë ishin coptue. Shqipja fluturonte krenare dhe e lirë mbi mbarë kombin shqiptar ! Këto ngjarje ku mbizotnonte heroizmi, trimnia dhe vendosmënia e luftëtarve të lirisë si dhe aftësitë e tyne për të luftue dhe arritë fitore kundër një anmiku ma të madh në numër e ma të fuqishëm në armatime, ia mbushnin zemrën, mendjen e shpirtin me entuziazëm e frymëzim për me iu përkushtue artit ushtarak, që atij i përshtatej ma mirë, për t'i shërbye sa ma denjësisht Atdheut. Ai, siç kemi tregue, kishte mbetun jetim për babë qyshë në moshën nandë vjeç. Prandaj axha Gjin i kishte kushtue një përkujdesje të veçantë atnore. Pushimet verore dhe të festave fetare të të Krishlindjeve dhe Pashkëve ai i kalonte në Skuraj pranë nanës se vet, e cila mëzi priste të rrinte ndonjë dite për t'u çmallë me të birin. Nga ana tjetër Gjin Pjetri e mbante pranë për ta brumosun me dije dhe tradita shqiptare, njohjen e ligjeve e të kanunëve dhe rregullave e traditave ndërfisnore, shprehje të urtësisë popullore, të besës, trimnisë, burrnisë, bujarisë, miqësisë, e të tjera virtute arbnore. Nipi kujdesej për dokumentat, letrat e shkresat e shumta që i ishin grumbullue. Ma se një letër e Gjin Pjetri gjatë atyne viteve, mbanin dorën e t'ini etit, e kushedi ku kanë përfundue. Dokumenta me vlerë të madhe historike që mjerisht u

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

damtuen e humben me djegien e kullave prej turqëve e ma vonë prej komunistëve, varrmihësve të kombit.

Shpesh i kujtohëshin këshillat e axhës Gjin :

- Pren, koha e jonë ka marrë fund. Koha e padijës dhe e koburës, pra koha e ballhutës. Një e ardhme e ndritun paraqitet para jush të rijve. E ardhmja e kulturës dhe e dijes që ju do të përvetësoni në shkollat tona dhe në ato të huejat. Dijet që do të fitoni ju afrojnë me Evropën e me gjithë botën e qytetnueme, ku shqiptarët janë populli ma i vjetër. Prandaj duhet që të arrini të marshoni me hapin e kombëve të tjerë të zhvilluem të këtij kontinenti, për me zhdukë prapambetjen që na pruni pushtimi 500 vjeçar turk. Unë kam besim në ty. Të zgjodha midis fëmijve të tjerë sepse dallova te ti, squetsi e gjykim, dhe pse ishe djal i vetëm i Frrok Prendit, të atij burri të rrallë për nga trimnija e besa shqiptare. Atë e kam pasë ma shumë se kushri e vëlla : një shok të pandamë e luftëtar të rrebtë. Të jeshë gjithmonë krenar për babën, për fisin, për emnin fisnik që trashëgon, për krahinën dhe Atdheun tand të shtrejtë. Të na nderojsh në mësime, në detyra e në vepra që do të kryejsh gjatë jetës, si në atdhe ashtu dhe në vende të hueja, ku mund të ndodhësh ose të çon puna e detyra.

Këto ishin fjalë që nuk mund të harrohëshin kurrë. Ai do të kalitej e të formohej për të njohun ma mire botën shqiptare, së cilës do t'i kushtonte aftësinë e veprimtarinë e tij.

Im atë i jepte randësi të madhe përvetësimit të gjermanishtës që mësohej në gjimnaz, duke lexue shumë e duke kontaktue me austriakë që ndodhëshin në Shkodër për përsosjen e të folunit. Gjatë kohës së vazhdimit të mësimeve, para ngjarjeve që përshkruem, zhvillohej dhe një aktivitet i madh kulturor në mjedisin e studentëve, ku vend të parë zinte repërtori teatral. Poeti i madh Gjergj Fishta, kishte krijue disa drama që viheshin menjëherë në skenë. Im atë ishte përfshi në atë aktivitet dhe ndër të tjerat i kishin caktue rolin kryesor në melodramën "Juda Makabeu" që duhej të shfaqej për nder të Vezirit në Shkodër. Shfaqja u prit me entuziazëm të madh dhe im atë u dallue në mënyrë të jashtëzakonshme, në atë rol kryesor, duke fitue duertrokitjet e vazhdueshme të publikut.

Veziri vetë kishte kerkue të ia paraqitnin atë djalë që kishte luejt aq bukrur rolin kryesor të melodramës. I kishte dhurue sahatin e vet prej flori ni me gjithë qestek, me firmën e tij të skalitun mbi kapak për të shprehun vlerësimin që ai i kishte dhanë interpretimit të përsosun të atij të ri, që quhej Prenk. Ky sahat mbeti si relike muzeale në shtëpinë tonë të Laçit deri vonë, dhe humbi bashkë me të tjera sende me vlerë kur shtëpia u plaçkit e u dogj nga komunistët në shtator 1944. Këto ndodhina i rreshtova për të plotësue sa ma mirë një tregim, që synon të paraqesë prindin tim në aspektin sa ma të vertetë të jetës tij. Duhet pasë parasyshë se jeta e tij do të lidhej ngusht me atë pjesë të historisë shqiptare që i përk!iste kohës së re, kur shqiptarët arriten të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

afirmohen në një Shtet Shqiptar të parë ligjor para botës. Mbas ngritjes së Flamurit në Milot, Gjin Pjetri mori pjesë në ngritjen e Flamurit në Lezhë më 6 dhjetor 1912, përkrah Ded e Gjeto Cokut, Mirajve, Sykëve, Gjergj Fishtës, e nga paria shkodrane nga që garnizoni turk ishte largue përfundismisht prej këtij qytetit të lashtë. Mandej ai ishte kthye në Skuraj ku ishte marrë me rindërtimin e kullave të djeguna, që u ripërtërinë përsëri si përpara. Ndërkohë ai merrte pjesë në mbledhje të ndryshme krahinore për çështje pleqnie e kanunore, duke qenë një njonës dhe zbatues shumë i mirë i Kanunit. Siç dihet, ai kishte bashkëpunue me Shtjefen Gjeçovin, kur ky qëndronte në Laç e merrej me mbledhjen e redaktimin e ligjeve kanunore. Shtjefen Gjeçovi kështillohej vazhdimisht me Gjin Pjetrin. Gjeçovi, Kanunin e Bajrakut të Kurbinit që u vendos në Dëlbnisht me 5 - 6 - 7 gusht 1906, e kishte përfshi në librin e vet, si ndër kanunet ma të randësishëm, sepse në të ishin vendosë vendime politike. Kuvendi pati praninë e Imzot Nikoll Kaçorrit dhe At Shtjefen Gjeçovit si dëgjues e dëshmitarë. Shtjefen Gjeçovi ndërkohë kishte përpilue një dorëshkrim prej 116 faqesh kushtue kryengritjës së Kurbinit dhe veprimtarisë së Gjin Pjetrit, për përiudhë 1903-1906, mbetun i panjohun 100 vjet deri pas shembjës së diktaturës, për turp të akademisë dhe historianëve komunistë që nuk e kishin nxierrë e botue ma perpara. Atë e zbuloi rastësisht një nip i Gjin Pjetrit, Kastriot Marku, dhe për herë të parë u botue nga unë i nënshkruemi në revistën Kuq e Zi dhe në librin kushtue Gjin Pjetrit me rastin e 100 vjetorut të Pavarësisë.

Në ngjarjet që treguem të Kurbinit ishte i perfshi edhe Esad Pasha, që hasi në kundërshtimin e Gjin Pjetrit. Duke dashun ta bante për vete i kishte çue një besnik, Man Mustën, me dhurata, flori dhe propozimin e nji pozite te naltë ushtarake. Gjini ia kishte pre shkurt e me përbuzje Man Mustës, dhe e kishte përciellë me besnikët e tij jashtë kufinit të Kurbinit.

Më atë shkurt të vitit 1914, mbasi u kthye nga një mbledhje, Gjin Pjetri ra befasisht i sëmunë randë dhe vdiq papritun në moshën 56 vjeç. Ishte 22 shkurti 1914, që ai ndërroi jetë në një moshë akoma të fortë për të kontribue me urtësinë e burrninë e tij për të mirën e vendit. U hap fjala se e kishin helmue turqit ose Esad Pasha me anë të një tradhëtari të paidentifikuem. Siç e kemi thanë, ngjarjet në atë periudhë hapëshin me fjalë e kalonin gojën në gojë. Qarkullimi bahej me kafshe e me kambë. Në këto kushte, pa shtyp, pa gazetarë e pa asgja që lidhej me komunikimin, informatat jo vetëm që humbisnin por dhe shtrembnohëshin. Megjithatë lajmi i vdekjës së Gjin Pjetrit u përhap menjëherë.

Për këtë ngjarje studentëve kurbinas e mirditorë tim etit me disa shokë, iu dha leje e posaçme për të marrë pjesë në mort, ku kishin ardhun nga të gjithë krahinat e qytetet, kur lajmi i zi u përhap. Ndër ta patriotë e figura të shqueme shqiptare. Gjergj Fishta do ta pasqyronte në gazetën "Leka". Zija mortore zgjati disa ditë. Me vdekjen e Gjin Pjetrit mbyllej kapitulli ma heroik

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

dhe ma i lavdishëm i historisë së Kurbinit, dhe i një pjese të nderueme të historisë së Shqipnisë. Im atë pësonte humbjen e dytë të dhimbshme, mbas asaj të babës. Kujtimi për tatë Gjinin (siç e quente) do të mbetej i pashlyeshëm në mendjen dhe zemrën e tij. Siç e kemi thanë, zot shpie u ba Ndrec Pjetri, vëllai ma i vogël i Gjinit, që për ironi të fatit nuk kishte femijë. Prandaj edhe Ndreca e përqëndroi kujdesin e tij mbi Prenkën, në të cilin dallonte një pasardhës të denjë të Gjin Pjetrit, të mbar fisit e të Kurbinit. Ai do t'ishte ripërtëritësi i emnit të lavdishëm të fisit se Pervizit të Skurajve.

Ligji natyror së bashku me fatin përcaktojnë vijimin jetësor të njeriut mbi tokë, ku përsonaliteti i vetë njeriut luen rolin vendimtar në çaste të caktueme, si një katalizator në reaksionet kimike.



Kryengritës kurbinas e mirditorë . Ne karrikë, vëllai i Gjin Pietrit Ndrec Pjetër Marku. Këmbëkryq, kushëj të Gjin Pjetrit Nikoll Llesh Gjoka Frrok Prend Marku, Gjergj Llesh Marku. Në këmbë luftëtarë mirditorë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



GJIN PJETER MARK PERVIZI
Udhëqësi i Kryengritjës Kurbinit.
1856-1914

(Foto Marubi, 1912)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Stema e principatës së Skurajve që ruhet në Muzeun Kombëtar në Tiranë, shek. XII. Stema u gjet nga studiuesi austriak Teodr Ippenm në pllakën e varrit të princit Anton Skura, sh. XIII, në kishën Zoja Nunciata, në rrethin e Lezhëz. Një dëshmi e shtrimjës të kësaj principate.. Qyteti i Tiranës e ka krijue stemen e vet me luanin e stemës së Skurajve. Nga kjo stemë fisi i Pervizit mori për një kohë emni Ukasanaj, si fis i Ukut që populli dallonte ne atë figurën e stemës E veçanë në ketë stemë asht paraqitja e lulës zambakut që lidhet me simbolin e zambakut të qytetit të Firencës dhe gjithashtu të Francës.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

TRE MIQT AUSTRIAKE



Baron Von Kirshner



Dr. V. Brozovly



Gjeneral Eduard Grim Von Heinfels

Një miqësi që do të vazhdonte gjithë jetën.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Periudha e Vjenës

Për kohën e Vjenës, asht vetë im atë që na ka tregue. Ai kishte qejf të fliste për kohën e bukur të rinisë te kalueme në kryeqytetin perandorak. Qëndrimi në Vjenë i vlejti për t'u njohun me jetën e një shoqnie të ngritun te një shteti evropian, ku qytetnimi kishte arritë kulmin e zhvillimit. Perandoria Austro-hungareze ishte një fuqi e madhe dominuese në Evropë. Duke iu dhanë mundesia të jetonte në mjedisin shoqnor fisnik të miqve të tij, ai përvetësoi etiketën e sjelljeve e të edukatës se një shoqnie të ngritun që do t'i vlenin ma vonë në kontakte e shumta me botën evropiane, ku do ta çonte detyra. Ndërkohë ai u miqësue me shumë bashkatdhetarë të tjerë, studentë, tregtarë e figura të njohuna ose që po afirmohëshin, kryesisht shkodranë. Ai u njoh me Dr. Gjergj Pekmezin, i rritur e shkolluem ne Vjenë, dhe që ishte si një përfaqësues i shqiptarve aty. Sherbente në një punë shtetnore, si përkthyes në shqip e gjuhë të tjera. Njeri me kulturë të gjanë, i nderuem e respektuem. Veçanërsiht nga shqiptarët të cilët i ndihmonte pët çështje dokumentësh etjera probleme jetike. Një tjetër shqiptar ishte Ahmet Zogu, i cili në Vjenë kishte ardhë që më 1914, sa plasi lufta e deri në mbarim të saj më 1918. Ma mirë se im atë askush tjetër nuk mund të dinte për Zogun për kohën e Vjenës. Por edhe për kohën e pastajshme. Qëndrimi në Vjenë e mundësonte Zogun e ri (rreth 19 - 23 vjeç) që të gëzonte kredibilitet te bashkombësit e të zhvillonte veprimtarinë e tij në favor të çështjes shqiptare. Kjo asht e pranueshme. Megjithëse ai në atë periudhë nuk përfaqësonte asgja dhe askënd. Zogu, rrëfente im atë kishte mjaft t'ardhuna e jetonte mirë. Se nga i vinin, vetëm ai e dinte. Në Vjenë im atë ishte njohun me Zogun në lokalet që frekuentonëshin nga shqiptarët. E kishte takue edhe në ndonjë mbramje festive. Kadetët e akademisë ushtarake të Vjenës merrnin pjesë në festat e shoqnisë e të aristokracisë vjeneze, me u dhanë atyne ma shkëlqim, e me gjalinue ballot që shoqërohëshin nga tingujt e muzikës e valsëve të muzikantëve me të njohun të kohës, Shtraus, Lehar, Kalman, Offenbach, etj. Zogu që të njohë zuni miqsi me të, e dinte se i kujt fisi ishte, dhe i kujt biri dhe nipi. Zogu, si matjan, kojshi me Kurbinin dhe Skurajn, e njifte origjinën fisnike të fisit të Përvizit të Skurajve, me të cilin fisi i tij kishte lidhje miqsore. Ashtu dhe me veprimtarinë patriotike e luftarake që ai fis kishte zhvillue gjatë shekujve. Me luftën e Gjin Pjetër Pervizit kundër pushtuesve osmanë. Këto Zogu i dinte shumë mirë, sepse nder te tjera ai kishte pasë lidhjë me vetë Gjin Pjetrin, me anë të axhave a dajave, për të bashkepunue në dobi të çështjës shqiptare dhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

i kishte takue, megjithëse i ri, me u njoft vetë me Gjin Pjetrin. Zogu gjatë qëndrimit në Austri e përvetësoi gjermanishten të folun, ndërsa edhe turqishtën e zotnonte mirë. I pajisun me një inteligjencë të natyrshme të rrallë, kishte arritë me përfitue një kulture të mirë në kontaktet me shoqninë vjeneze. Gëzonte respektin e rretheve shqiptare të Vjenës, me të cilët mbante marëdhanie shoqnore e miqsore të mira që i vlejtën ma vonë kur erdhi në fuqi. Shumë prej atyne bashkatdhetarve, kryesisht studentët që ishin diplomue në Austri, do të zinin pozita të larta në qeveri, ushtri dhe administratën e Shtetit shqiptar. Por në veçanti atij i vlejti miqësia me Prenk Pervizin, i cili do t'i gjendej pranë, siç do ta tregonte koha, në situatat ma të vështira, për të dhe për Atdheun. Një tjetër lidhje miqsore im atë dhe Zogu e kishin me shkodranin Çatin Saraçi, si dhe meshkodranë të tjerë, që do të vazhdonte edhe ma vonë me veprimtari e detyra në Atdhe.

Im atë gjatë kohës që shoqnohej me Zogun e nga bisedat që zhvillonte me të, e kishte formue një opinion të qartë se ai ishte i bindun në vetvete se do të lozte një rol të randësishëm në Shqipni, kur të kthehëshin atje. Ai e ndiente veten si të destinuem me sundue në atë vend, dhe gjithë veprimtarinë e kontaktet që kishte në Austri, ua kushtonte kësaj ideje të njeriut që do arrinte në pozita të nalta shtetnore. Sa që shprehimisht jo vetëm t'im etit por edhe shqiptarve të tjerë u kishte thanë se ata do të emnohëshin në detyrat e tyne në Shqipni me urdhën e firmën e tij. Kjo bindje i ishte e ngulitun në mendje, e kishte ra në sy. Shqiptarët nuk ia varnin fort dhe e quenin si një lloj megalomanie. Por koha do të tregonte se ai do t'i realizonte ato synime që u kthyen në realizime faktike. Gjithë kjo të Zogu ishte një lloj qellimi, që ai i kishte vu për detyrë vetes me e ndjekë e zbatue. Koha do t'i jepte të drejtë. Im atë s'i kishte ndërhy kurrë në ato plane, por e kishte fare të qartë se ai do të bante çmos për t'i realizue. Ndërkaq,, përveç Zogut , Gjergj Pekmezit e Çatin Saraqit, im atë ishte njohun e kishte zanë miqësi me studentë shqiptarë e të tjerë bashkatdhetarë që jetonin e punonin në Vjenë, që ma vonë do të shquehëshin në Shqipni pë aftësitë e tyne ne detyrat që do të kryenin, si Ali Erebara, Llesh Topallaj, Muharrem Bajraktari, Zef Serreqi, Zef Shiroka, Sandër Saraçi, Dervish Duma, Ceno Kryeziu, Lek Margjini, Gjon Derani, e të tjerë. Ai u njoh edhe me oficerin austriak, Gustav Mirdashi (Mirdatzy), që do t'ishte nje ndër miqt ma të ngushtë, kur atë do ta sillte në Shqipni vetë Zogu, më 1926, si keshilltar e organizator i ushtrisë shqiptare, ku do të arrinte gradën gjeneral e shef i shtamadhorisë. Një tjetër austriak ishte Hermann Von Kirshner, mik i tij, që edhe ai do të shërbente në Shqipni ne ushtrinë shqiptare deri me gradën gradën kolonel. Në Vjenë, siç kemi thanë, rrinte dhe Dr. Gjergj Pekmezi, njeri i ngritun, burrë i mençun e shqiptar i mirë. Im atë kishte zanë njohje të mirë me të, sepse ndër të tjera, ai kishte miqësi me një nga

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

austriakët miq te tim etit. Dhe i kishte ba përshtypje për vazhdimin e Akademisë ushtarake e zotnimin aq mirë të gjermanishtës. Për sa treguem, lidhet me dëshminë e saktë të prindit, për të pergënjeshtrue gjithë sajimet hamendore që u thurën rreth Zogut për kohën e qëndrimit të tij në Vjenë. Për emnat që u përmendën e të tjerë të papërmendun të me falin lexuesit, sepse kanë kalue aq shumë vjet dhe nuk mbahën mend të gjithë. Sa për Muharrem Bajraktarin, ai kishte ardhë në Vjenë më 1917. Prenk Pervizi zuni menjëher miqësi me të. Miqësi që do të vazhdonte gjithë jetën. Për studentë që vazhduen studimet në Austri, ushtarakë, civilë apo fetare, për me i vu kapak kësaj çeshtje, duhet falënderue z. Uran Asllani që ka botue një libër për studentët shqiptarë të Austrisë dhe të Francës, ku dokumentohët për ato studentë shqiptarë që kanë krye shkollat e larta në ato dy shtete. Një dokument i randësishëm që fshin gjithë hamendjët e trillimet pa përgjegjësi që janë thanë e shkrue e thuhën e shkruhën nga njerëz të pa përgjegjësi e ndërgjegje. Një historian ose shkrimtar i pandërgjegje nuk asht tjetër veçse një injorant me dipllomë. Na ruejt Perëndia prej tyne ! Por po ka të tillë, sepse janë krejt trillime ato që thuhën se Zogu në Vjenë paskej bashkëpunue me Bajram Currin, Hasan Prishtinën e Faik Konicën, alucinacione të vërteta, të shpikuna për me ia zbukurue biografinë. As parë as dëgjuar pallavra të tilla. Bajram Curri e Hasn Prishtine s'kan luej prej Kosovë gjatë gjithë kohës së luftës. Faik Konica ka qendrue në Svicër gjithë atë periudhë , prej ku s'mund të lëvizte. Apo nuk asht shpik edhe një tjetër rrenë, se Zogu qenka mbajt peng nga Austriakët, krejtësiht e sajueme si ajo e Stambollit, ku ai paskej qene marrë peng në moshën 9 vjeç (si Skënderbeu). Po kujt i thuhën e shiten këto budallalleqe ? Prenk Pervizi dhe shqiptarët e tjerë nuk kanë përmendun të tilla histori fare të paqena. Ngjarje që s'kanë ndodhë kurrë. E vetmja anë pozitive e qëndrimit të Zogut në Vjenë ka qenë se filloj të njihet si një personalitet që do të kishte peshë në çeshtjen shqiptare. Qëndrimi në Vjenë, i vlejtën kur u ngrit në rang presidenti e mbreti. Me kaq kemi dhanë gjithçka im atë na kishte tregue për Ahmet Zogun sa kohë që ndejti me të në Austri. Mund te na ketë ikun diçka nga kohëzgjatja e madhe prej 72 vjet që u ndamë prej tij. Shtojmë se kujtimet e tij hedhin poshtë gjithë trillimet të sajueme për Zogun sa qendroi në Vjenë.

Jeta e t'im etit në Vjenë, si ajo shkollore dhe ajo shoqnore, ishte për të, plotsimi i brumosjes së tij me veti dhe edukatë e sjellje fisnike si dhe me kulturë të gjanë nga ana intelektuale. Ne mjedisin e shoqnisë ma të rafinueme të Evropës, ai i përvetesoi ma së miri rregullat dhe etiketën e asaj shoqnie, bashkë me kulturën që zhvillohej e trajtohej në atë kryeqytet, qendër e qytetnimit evropian.

Gëzonte respekt dhe e ndiente veten mbi studentët austriakë, nga fakti

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

që zotnonte përveç gjermanishtës, italishtën, fliste hungarishtën dhe kishte njohuni shkollore të latinishtës, që ishte landë mësimi në Gjimnazin e Shkodrës. Kjo eksperiencë e Vjenës do t'i vlente ma vonë për të qenë i nderuem dhe i respektuem në rrethet ma të nalta të shoqnisë shqiptare dhe të huej. Ai do të përfaqesonte Shtetin Shqiptar kudo që do dërgohej si përfaqësues madhor i ushtrisë shqiptare, në takime, konferenca, manovra, deri në konflikte luftash. Shtojmë se ma vonë ai do të shtonte njohunitë gjuhësore me frengjishtën, anglishtën, serbo-kroatishtën, greqishte etj. Nga ana ushtarake, ai do të arrinte përvetësimin e plotë t'artit ushtarak që do të plotësohej ma vonë me përvojën e luftës popullore, që ai do të zbatonte në operacionet e ndryshme që do të ndermerrte në atdhé. Nga katedrat e Akademisë ushtarake së Vjenës, ai kishte dëgjue duke folun profesorë të shquem, që e vlerësonin pa masë figurën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, si një ndër strategët ma të përmendun, që duke komandue një ushtri të pakët të një vendi të vogël, arriti t'i baje ballë me nder dhe fitimtar për 25 vjet rresht, fuqisë ma të madhe ushtarake të kohës që ishte Perandoria Osmane, duke ia përshtatun strategjinë dhe taktikën e luftës popullore terrenit të thyem e malor të Shqipnisë. Gjergj Kastrioti paraqitej si mbrojtës e kampion i krishtënimit dhe i qytetnimit evropian. Im atë ndiente një mburrje legjitime dhe krenohej të ishte nga ajo krahinë e Kurbinit, ku malin e Skurajt Heroj Kombëtar e kishte si bazë ushtarake, e për krah të cilit kishin luftue stërgjyshët e tij. Këtë e kishin marrë vesh në ambientin shkollor, dhe ai gëzonte një respekt të veçantë, si nga shokët e bankove ashtu nga profesorët dhe drejtuesit e akademisë ushtarake. Jo që ishte ndër nxanësit ma të mirë, ku kishte shkelqye si nga ana e përvetësimit të mësimëve ashtu dhe nga gjuha. Ai fliste e shkruente një gjermanishte të përsosun. Për këto cilësi kishte fitue edhe medalje shkollore për rezultate të mira, që ruhëshin në shtëpinë tonë në Laç. Për të gjithë sa treguem ma sipër, ne i kishim dokumentët, fotografitë, medaljet e të tjera sende të asaj kohë. Por që, siç e ka marrë vesh lexuesi, u zhdukën në zjarrin e brigatave kriminale komuniste, që pretendonin të quhëshin "clirimtarë".

Dihet se nga shkaku i luftës, qarkullimi në Evropë ishte vështirësue, e për në Shqipni ishte i pamundun. Pushimet verore baba i kalonte në Hungari, pranë familjes Brozovly që kishte prona e vila jashtë Budapestit e shtëpia në atë kryeqytet. Ai shkonte edhe në Pragë, pranë familjes tjetër të Von Kirschner. Hermann Baron Von Kirshner ma vonë e solli në Shqipni me Gustav Mirfatzy-n, ku qëndroi deri më gusht 1944, pranë Komandës shqiptare me gradëbn kolonel, e ndryshe nga Gjeneral Mirdashi u kthye në Austri ku arriti grada dhe pozita të larta ushtarake. Ndërsa në Vjenë, liridaljet e të dielave i kalonte të familja e Eduard Von Grimit. Ky i përkiste një familje fisnike, gjenëralë brez pas brezi të Perandorisë. Në përmjet tyne ai kishte zanë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)


miqësi edhe me vjenezë të tjerë. Në këto rrethana ai tashma u ba i njohun në rrethet shoqnore e miqsore të miqve të tij, që filluen ti bajnë propozime fejese me vajzat vjeneze, të Budapestit e Pragës, ku ai i njihte e kontaktonte vazhdimisht në pritjet e festat e ndryshme. Por ai u a kishte ba të qartë se ishte i fejuem në Shqipni dhe nuk e shkelte vendimin e prindëve, pra nuk mund të pranonte propozimet që i bahëshin.

Shënim :

E gjithë sa u përmend ma nalt i përgjigjen ngjarjëve të vërteta të përjetueme e të tregueme nga prindi ynë, por dhe nga të tjerë shqiptarë të kohës së Vjenës, me të cilët kemi pasë rastin me kalue jetën në burgjet e kampet e internimit gjatë periudhës së diktaturës komuniste, bashkëshoqë e miq të tij, të cilët njëkohësisht e kishin shoqërue jetën e Zogut në Austri, që përputhet me gjithçka u tha ma sipër.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)


ELITA INTELEKTUALE QE PRENK PERVIZI PATI FATIN TE KETE EDUKATORE E PROFESORE GJATE SHKOLLIMIT TIJ NE SHKODER ME 1904-1914.




GJERGJ FISHTA



LUIGJ GURAKUQI



NDRE MJEDA



ANTON HARAPI



KOLE KMSI




NDOC NIKAJ



VINCENC PRENDUSHI



MATI LOGORECI



H[illegible] MOSI

Ma vonë kur im atë do përfshihej në detyra të randësishme ushtarake e shtetnore ai do të vazhdonte të ruente e zhvillonte miqësinë me këto figura të larta të shoqnisë shqiptare, për të cilër ruente respekt e admirim të përveçëm.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Krenët e Malsisë në Vjenë

Mbasi fjalën e kemi për kohën e Vjenës nuk mund të mos flasim për një ngjarje që e bani rrëmujë kryeqytetin perandorak, ku shkaktarë e protagonistë kryesorë ishin disa krenë të Malsisë së Madhe. Perandori plak Franc Jozefi, më 1916, gjashtë muej para se me dek, kishte urdhnue për me sjellë në Vjenë një delegacion nga paria e Malsisë. Nga ana tjetër kishte njoftue gjithë shoqninë vjeneze dhe rrethet aristokratike si dhe ato qeveritare e shtetnore, që të respektonin sjelljet e zakonet e shqiptarve, që do të qëndronin për do ditë miq të tij në kryeqytetin austriak. Ata i përkisnin një ndër popujve ma të lashtë të Evropës dhe races së pastër Ariane e flisinin një gjuhë të tyne të përveçme shumë të vjetër. Kanë ligje dhe sjellje të natyrshme, për të cilat janë krenarë, sepse i kanë trashëgue të papërlyeme prej shekujsh. Nuk e njohin qytetnimin tonë, bile atyne mund t'u duket i çuditshëm dhe i papërshtatshëm. Pushtimet e hueja dhe veçanërisht pushtimi 500 vjeçar otoman i ka lane mbrapa nga qytetnimi, por të pamposhtun, sepse u nguliten në malet e tyne të ashpra e të paarritshme, ku ruejtën të pacënueme të gjitha vetitë e stërgjyshëve të lashtësisë. Nuk dijnë të shkruejnë e të lexojnë, por dijnë të flasin bukur, me shprehje figurative. Kjo pak a shumë këshilla e Perandorit, që vjenezët u angazhuen të respektojnë. Kur studentët shqiptarë e morën vesh ardhjen e krenëve të malësisë, u ngriu gjaku, sepse mendonin sekusjedi se çfar mund të ngjante. Shkollat u dhanë leje speciale për t'i shoqnue malsorët, si përkthyes dhe ciceronë, për kohën që do rrinin në Vjenë. Edhe im atë u gjet i përfshimë në këtë aksion, si shoqnues e përkthyes. Kjo punë do të udhëhiqej nga Dr. Gjergj Pekmezi, që ishte rrit e kishte kalue jetën në Vjenë. Ai duhej të rrinte në ballë të kësaj ndërmarrje të pritjes dhe përcielljes së kreshnikëve të maleve, të këtyne trashgimtarve të Mujove e Halilëve legjëndarë të Shqipnisë ! Ja çka kemi mundun me regjistrue në kujtesë nga tregimet e babës, që kënaqej me i tregue herëpashere, duke i veshun edhe me figura e përshkrime hiperbolike e të ndërthuruna me humor. Për atë, ajo ngjarje mbetej si një kujtim i bukur e gazmor i rinisë. Përshkrimi im i peregjigjet të përgjithësi kujtimeve të tim etit dhe anës së humorit me të cilin ai vishte.

Gjithë Vjena e mori vesh se erdhën krenët malësorë. Shqiptarë e kurreshtja i shtyni njerëzit me dalë me i pa e me i njoftue. Para syve të tyne u shfaqën disa trupa të mëdhej, me veshje fantastike. Kësula pipiruce të bardha e të mbeshtjella me shalle po të bardhë si turbanta. Jelekë të qëndisun me fije t'arta e ngjyra të tjera. Tirqë të bardhë të zbukuruem me gajtana të zij. Breza të gjanë të kuq e ngjyra ngjyra, ku spikasnin pisqollet dhe jataganat me doreza t'argjenda. Ata ecnin grumbull me hapa të gjata e kambë të hapuna si kapadai.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Mbathnin opinga prej lekure lope të lidhuna me gjalma ku spikasnin kollçikët (çorapët) prej leshi të qëndisun bukur. Dukëshin si vigaj. Nuk mbanin mjekrra por musteqe të zeza si penda e korbit, vesh e n'vesh. Veshtrimet e tyne të rrebta dilnin për nën tubën e dendun të vetullave, si shkreptina rrufeshë. Flisnin me za të naltë e kumbues si britmë arushe, me gjeste të hapuna krahësh e duersh. Njeni mbante dorën mbi dorezën e pisqollës, tjetri të jataganit. Lëshonin shtëllunga tymi si vullkanë duke thithë nga disa llulla me tre pëllambë bisht. As donin të ia dinin se ku ishin. Pallatet për rreth mund t'u ngjanin si pyjet e çetinave apo si faqet shkambore të maleve. E njerëzit që kishin dalë me i pa, buburreca ! Ishin bajraktarët e krenët e gjithë Malsisë, nja dhjetë vetë të zgjedhun, mbi dy metra, si katallaj. Vjenezët i kishin zgurdullue sytë kurrështarë, për të zbulue vetitë e këtyne shqiptarve të përshkrueme prej Perandorit të tyne. Estravagancat e shqiptarve do t'i tejkalonin përmasat e prituna e të paracaktueme. Ato do të ishin të jashtëzakonshme, lëgjendare. Delegacioni i malësorve u caktue të qëndronte në një kat të një hotelit të madh të Vjenës, i rregulluem e i pajisun kastile për të pritun miqtë e nderuem e aq të veçantë. Salloni kryesor ishte i pajisun me një oxhak madhështor ku zjarri i druve qëndronte vazhdimisht i ndezun, megjithëse ishte muaj i prillit. Por ashtu ua donte zakoni këtyne shqiptarve. Malësorët zunë vend në dhoma të përbashkëta të ndërlidhuna mes tyne.

Duke qenë të udhëzuem për zakonet e shqiptarve, shërbimi i hotelit u shpjegoi mysafirëve, me anë të Dr. Pekmezit, se si duhej të vepronin për me kërkue pije e kafe ose për të ngranë, etj. duke shtyp pulla të bardha, të kuqe, të verdha apo të zeza, sipas rastit. Se si me hap e me mbyll rubinetat e banjove, të WC - ve e të tjera marifete. Dr. Pekmezi do të qëndronte në atë hotel për çdo rast, si kujdestar i tyne. Dukej se gjithshka do shkonte mbarë. Para se me ra me fjetë, burrat e Malsisë u mblodhën kambëkryq rreth oxhakut, ku në krye të vendit rrinte kryebajraktari. Te tjerët sipas rangut që u caktonin ligjet zakonore. Nxorën qeset e kutijat e duhanit, duke ia hedhë njeni tjetrit dhe ndezën çibukët me gacat e zjarrit. Ia shtruen muhabetit duke marrë fjalën me rradhë, thue ishin të mbledhun në kuvend. Flisnin me za të naltë si arusha mali. Pas do kohë, kur çibukët u boshatisën, duheshin shkundun, dhe filloi goditja mbi rrasat e mermerta të votrës së oxhakut. Godit njeni, godit tjetri, godit me dhjetra çibukë, ata të katit poshtë u zgjuen, u çmendën e nuk guxonin të protestonin ! Porosia e Perandorit ! Ajo mbramje ma ne fund kaloi, kreshnikët u ulën me fjetë e u duk se ra qetësia edhe në apartamentin e shqiptarve. Trimat e Malësisë i zuni gjumi. Por, pa dalë mirë drita, njeni pas tjetrit malësorët çohen dhe grumbullohen rreth oxhakut të madh me jorganët apo batanijet mbi kokë, sikur t'ishin në kullat e tyne gurore. Mbasi mbushën e ndezën çibukët, e mbasi filluen me nxjerrë shtëllunga tymi nga goja dhe nga zgavrat e hundëve, dikujt i ra ndëmenda për kafe. Si me ia ba si mos me ia ba.

- Hajde të porosisim kafen or burra !... Pa shtype atë pullë të kuqe or

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Dedë Bajraktari ! Foli kryebajraktari, Gjeto Vuksani*. Deda e zgjati gishtin dhe e shtypi pullën, thue po shponte murin. Kaloi do kohë, çibukët duhej të shkundëshin. Krisi poterja. Ato të katit poshtë u zgjuen përsëri të llahtarisun. Ndërkaq troket dera. Kafja ! Dera hapet. Duken dy vajza të bukura si perri me tabakët me filxhana. Malësorët kthejnë kokat andej. Zana, Orë apo Shtojzovalle ? Dikush çohet me gjithë jorganin mbi krye e pas tij të tjerët. Kamerieret u tmerruen, kur panë dhjetë lugetën para tyne, që po i shikonin sikur t'i gllaberonin të gjalla. Leshuen klithma që u dëgjuen deri në zemër të Vjenës. Tabakët u ranë prej duersh e u ba potere e madhe, dhe vajzat e shkreta ia mbathën me të katra duke uluritun e dhanë kujën. U desh të vinte policia për të vu rregull ... dhe për... t'u kërkue të fala krenëve të Malësisë për këtë ... incident. Dr. Pekmezit i shkonin djersë të ftohta dhe të ngrohta... ndërsa përkthente dhe orvatej me i dhanë shpjegim të pashpjegueshmës. Ky nuk ishte veçse fillimi i trimnive të tjera të kreshnikëve të maleve, që kishin ardhë në Vjenë për ta pushtue me praninë e tyne të pakundërshtueshme ! Malësorët u treguen zemërgjanë dhe i pranuen shfajsimet e austriakëve ! Kësaj radhe, ishin kamierë meshkuj që ua sollën kafet që ato i pranuen dhe filluen t'i thithin ne gjithë qejf. Por. .. njenit prej bajraktarve ... iu shkrep që të bante banjo. Prej kohësh që s'e kishte rjep lekurën e vrazhdë. Një kamerier e përcolli tek dhoma e banjos ku ishte një vaskë e madhe. Ia hapi rubinetat e ngrohta e të ftohta, duke i tregue si perdoreshin. Bajraktari dha me kuptue se gjithçka ishte në rregull (e s'kishte marrë vesh asgja). Dera u mbyll dhe uji sa vinte e ngrihej në vaskë. Heroj ynë u orvat të mbyllë rubinetat dhe i hapi ma tepër. I shtypi gjithë pullat që i dilnin para syve. Luej këndej e luej andej, vaska u mbush plot e përplot dhe uji filloi të mbushte edhe kthinën. Malësori desht të hapë derën dhe e mbylli fare. Atij tani i vinte turp të thërriste apo të trokiste mbi derë. Uji filloi me u çue e arriti dy pëllambë e ma tepër mbi dyshemenë dhe nga presioni arriti me depërtue një fije përtej derës, e mbyllun pothuej hermetike. Një kameriere që rastisi të kalojë aty pari, e dallon currilin e ujit që dilte nga dera e banjos dhe leshon alarmin. Grumbullohet personeli i hotelit me në krye Dr. Pekmezin.

- 0 Zot çdo ketë ndodhë ! thoshte ai me vete. Dera ishte mbyllun nga brenda dhe bajraktari nuk dinte si ta hapte. Sidoqoftë, pas disa orvatjeve, dera u thye dhe uji vërshoi me vrull si përrue tëposhtë shkallëve dhe arriti deri në rrugë, për çudinë e kalimtarve. Qyteti u mbush me historitë donkishoteske të bashkatdhetarve tanë kreshnikë të ardhun nga Bjeshkët e Namuna të Mujos dhe Halilit. Por e gjithë kjo u gjykue si një veçori e këtyre njerëzve që mbanin të gjallë trashigimin e traditave shumëshekullore e që vepronin krejt natyrshëm e të lirë nga paragjykimet dhe kriteret e jetës moderne. Të së cilës nuk ia njihnin as sjelljet as përdorimin e orendive e sendeve të jetës së përditshme. Nëse sjellja e tyne dukej jashtë realitetit të qytetnimit evropian të kohës, nga ana tjetër dallohej se ata ishin vërtet përçuesit e qytetnimeve të

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

lashta të vetë Evropës, e prandaj sjelljet e tyne duhëshin shikue në këtë prizmë dhe duhej me i dhanë arësye gjykimit të matun të Perandorit për këta përfaqësues autentikë të asaj rrace të pastër që banonin në malet e larta shqiptare e që Vjena kishte përparësinë t'i njihte nga afér ashtu siç vërtet ishin. Siç thamë, studentët shqiptarë ishin caktue me i ndejtë pranë këtij delegacioni malësorësh, por ata mund të rrinin deri ne një orë të volitshme të mbramjes, pastaj duhej të kthehëshin në konviktet e tyne. Studentet që i mermin vesh të gjitha aventurat e bajraktarve trima, ia tregonin njeni tjetrit me përmasa humoristike dhe gajasëshin së qeshunit. Këto ngjarje vërtet që u veshën me humor, por nga ana tjetër tregonin se shqiptarët sillëshin natyrshëm dhe jo konform disa rregullave të caktueme cerimoniale gjithë etiketë e pa kurrfarë lirie shprehje e veprimi. Prandaj ata filluen të shikohëshin me simpati dhe mirëkuptim nga vjenezët deri edhe në admirim e entuziazëm të sinqertë.

Duke i rreshtue ngjarjet, nuk mund të rrimë pa diftue edhe aventurat e tjera të kreshnikëve tanë, siç kënaqej duke na i tregue im atë, që ishte një njeri tepër serioz, por në këto tregime nuk mund të përmbahej së qeshunit, sepse i përfytyroheshin si ne një film skenat e sjelljeve të malësorve që i kishte përjetue vetë. Ai pastaj i zmadhonte e qendiste me humor për kenaqësinë tonë e të shoqnisë.

Në programin perandorak ishte parashikue që këta përfaqësues te rracës të pastër Ariane, të nderohëshin në rangun e mysafirve ma të shquem e ndër të tjera ishte caktue një pjesmarrje e tyne në një shfaqje në Operan e Vjenës, ku do të vinte vetë Perandori. Lajmërimi u dha kudo në reklamat qe shfaqja bahej për nder të shqiptarve dhe në atë mbramje teatri i operas ishte plotpërplot. Opera ishte e Mozartit, *Grabitja nga Haremi,* e zgjedhun posaqerisht, për përmbajtjen orientale që i përshtatej shqiptarve nën sundimin turk. Gjithë aristokracia e Vjenës ishte aty e pranishm me ftesë të veçantë nga vetë Perandori, me kostumet e cerimonive të mëdha. E gjithë salla shkelqente nga xhevairet e margaritarët e damave të shoqnisë së lartë. Malësorët u shpëmdanë nga tre nga tre në lozhat anës asaj qëndrore ku do të zinte vend Perandori me djalin,Princ Karlin e disa nga personalite të aristokracisë dhe të Shtetit. Im atë gëzoi privilegjin që të rrinte në lozhën e perandorit për të përkthye e t'i dhanë shpjegime pyetjve që ai mund te bante mbi shqiptarët e sjelljet e tyne, sepse Dr. Pekmezi ishte në rolin organizatorit e kontrollit të situatës për të papritunat që mund të vinin nga keto bij të shqipes, që kishin zbritun nga çerdhet e tyne shkambore. Tregonte im at se si e ndjente veten te emocionuem në atë rol aty pas kolltukut të Perandorit dhe në ankth mos malësorët i kalonin kufijtë me të papritura e tyne e si me ia shpjegue Perandorit. Te papritura që nuk munguen dhe i kapëroven caqet, dhe Dr. Pekmezi sa nuk po çmendej. Dukja e Perandorit bashkë me djalin, Princ Karlin me të shoqën, ishte prit me duertrokitje, ku nuk munguen shuplakat e forta të trimave shqiptarë, si krisma pushkësh. Deri në ato çaste ata po rrinin të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

qetë e të rregullt në lozhat e përgatituna enkaz për ta, me nga një student shqiptar që t'u përkthente e shpjegonte. Madhështia dhe shkelqimi i teatrit i kishte magjepsun. Sytë e gjithë atij publiku të zgjedhun ishte ngulitë mbi ta. Ishin përsonazhet ma të veçanta që po njihte Vjena. Aristokratët aty të mbledhun, princa, konta, markezë e baronë, ishin të vetëdishëm se gjendëshin para burrave që për nga fisnikëria qëndronin në një rang me ta, me tipare, zakone, tradita e ligje të tjera, krejt primitive por nga ana tjetër të vërteta dhe të natyrshme, që shprehëshin me lirinë e veprimeve dhe të sjelljeve, të pa kushtëzueme nga asnjë kompleks artificial të etiketës oborrtare, kujt ata vetë ishin të detyruem t'u nënshtrohëshin. Në një nga lozhet afër asaj perandorit rrinte kryebajraktari. Një burrë i gjatë mbi dy metra, me trup atletik e shpatullat sa për dy vetë, që dukej dhe ma i madh dhe i fuqishëm prej veshjes tradicionale që mbante. Spikasnin në brezin e tij, pisqollat e jataganët, thue ishte gati për të dale me luftue në fushë të mejdanit. Ata ishin porositë që të rrinin ashtu të ngjeshun me armë e pajisje të tjera, që të jepnin paraqitjën sa ma të vërtetë të tiparëve shqiptare. Mustakët e zi e të përdredhun i shkonin bajraktarit vesh e n'vesh, dhe aty i ulun në lozhë e leshonte veshtrimin e tij të rrebtë mbi publikun e zgjedhun thue se ishte një hero mitik, nga që kishte tipare të bukura e të rregullta, si të skalituna nga dalta e Praksitelit. Nga ana tyne spektatorët, e veçanërsht seksi i bukur, nuk mund të rrinin pa hedhun sytë nga ai përsonazh imponues e krenar, taman si shqipe mali ... Prandaj quhëshin shqiptarët... bijt e shqipës ! Dritat u mekën dhe filloi opera. Orkestra dhe kangëtarët filluen me tregue mjeshtrinë e tyne, mes heshtjës së publikut. Mbasi kaloi do kohë në qetësi të plotë, papritun kumboj zani i fuqishëm i kryebajraktarit, sikur po thërriste për kushtrim nga një maje në tjetrën të bjeshkëve:

- Or ti Mark Bajraktari... ç'ka je ka thue or burrë për këto lodra e kangë që po ndigjojmë ... fort të bukura po na duken... por s'po marrim vesh gja ! Gjithë publiku i befasuem nga kjo vikamë e papritun. Gjithë sytë u kthyen andej. Edhe Perandori kishte lëshue shikimet mbi atë lozhë nga dilte ai za i fuqishëm. Ç' po ndodhte ? Perandori që mori shpjegimin nga përkthyesi, buzëqeshte i kënaqun. Kush nga oborrtarët e tij do të guxonte ... ?

- Qe besa or Bajraktar, nuk po jam kah marr vesh gja as unë ... por duhet me i ndejt lojës se kështu i ka zakonet Nemcja ! U përgjigj Marku nga ana tjetër e teatrit, me një za po aq të fortë e kumbues.

- Njaj burri që po asht kah këndon, qe besa e paska zanin fort të bukur ... paj ... a thue do dinte me ia marrë nji kangë maje krahut si Gjergj Pllumi i Thethit ? Ia priti një bajkraktar tjetër.

- Allahile ? .. Mirë po thue or burrë ! .. se bash po e paska zanin pushkë! ... Or Mark, po jam kah e ndez nji duhan, po s 'kam kah me ta lshue qesën ! ... Thirri kryebajraktari, sa po dridhej gjithë teatri e zani i tenorit në skenë dukej si za mice.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

- T'u rrit ndera or Bajraktar, se jasha zotin dhe unë po e ndez çibukun, se mjaft ndejti në brez. Briti nga ana tjetër ai Marku e shyqyr që nuk u perzien të tjerët në atë bisedë malesh, se do ishte shemb teatri.

Im atë (siç na tregonte) që rrinte gaditu pas kulltukut të perandorit në uniformën e bukur të kadetëve, kishte mbetë haru, por e kishte marrë veten dhe i përkthente e shpjegonte Perandorit se si zhvillohej ajo bisedë me britma ciklopike, dhe se kështu e kishin zakon të flasin malësorët nga një maje mali në tjetrën. Perandori pohonte me kokë i kënaqun... Wunderbar… wunderbar… das ist sehr shöhn ! (mrekulli, mrekulli, shumë bukur). Malësorët si pa të keq e pa ça kokën për asgja, i kishin ngjeshë me duhan lullat. Kur ja, si të shtime pushke, u dëgjuen krismat e masatëve mbi strallin të kohës së gurit për të ndezun eshkët, që e mbushnin sallën me një erëz të kandshme të pashijueme ndonjë here nga vjenezët. Të pranishmit në sallën e teatrit kishin mbetun gojë hapun. Nuk vonoi shumë dhe prej llozhave të shqiptarve filluen të përhapen re tymi mbi gjithë sallën, thue po shpërthtente një stuhi e fill pas u ndigjuen trokitjet e shkundjeve të çibukëve pas parmakëve të lozhave si rrëbesh breshni. Tashma e gjithë vemendja e publikut ishte përqendrue te këta qenie jashtëkohore. Por askush nuk jepte shenja nervozismi e shqetësimi. Ata vërtet se po thyenin rregullat e mirësjelljes së shoqnisë vjeneze, por ama po tregonin dhe veti të theksueme të pavarësisë e lirisë së sjelljeve të tyne, të pa kushtezueme nga asnjë tjetër imponim rastësor ose ligjor. Ndoshta kjo ishte ajo force e brendëshme që u kishte lejue këtyne bijve të rrebtë të shqipës t'i banin ballë pushtimeve të hueja e të ruenin të pa cenuem identitetin e tyne si popull e si komb. Edhe ajo mbramje ose natë kaloi si kaloi. Vjenezët kishin material të bollshëm për të gjallnue bisedat e tyne. Im atë me shokë sikur u liruen nga shqetësimi se këta burra që kishin zbritun nga malet e ashpra shqiptare mund t'i turpnonin. Publiku vjenez po tregonte një mirësjellje e mirëkuptim të jashtëzakonshëm ndaj tyne, bile po kënaqej që i ishte dhanë një rast i tillë unik dhe i papërsëritshëm.

Duke kapërcye disa raste të tjera arrijmë te pritja e madhe që dha Perandori për nder të delegacionit shqiptar, në pallatin perandorak të Shönebrunit, që u kunorzue me një darkë madhështore të përgatitun enkas për ato malësorë t'ashpër, trima e burrnorë. Ne këtë veshtrim i kishte çmue Perandori, duke i vlerësue në aspektin e vërtetë të traditave, zakoneve dhe sjelljeve të tyne të lira. Dhe kishte urdhnue që ajo darkë të shtrohej e veçantë për ta. Dhe kështu darka u shtrue kryesisht me mish dashi të pjekun ferlik, dhe deshët u sollën ashtu siç kishin dale prej hellit dhe u vendosën në pjetanca të mëdha për gjatë tavolinave. Vena u soll në poce prej balte të pjekun. Shqiptarët do të hanin e pinin sikur t'ishin rreth sofrave të tyne. Një radhë kamerierësh rrinin pas tyne në gatishmëni për t'u shërbye. Ma e bukura ishte kur erdhi çasti i përshendetjeve dhe e mori fjalën Perandori. Ai ishte ngrit në kambë me gotën e venës në dorë e pas tij gjithë të ftuarit e aristokracisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

vjeneze. Ai shprehu kënaqësinë e tij dhe të popullit vjenez e të shoqnisë perandorake, që u njohën me burrat e maleve shqiptare, zakonet e traditat e tyne të mrekullueshme dhe autentike. Të një populli të lashtë e të pamposhtun, që dijti t'u qëndroje stuhive shekullore të historisë me kurajo e force të madhe shpirtnore, që shprehej në çdo sjellje e gjest të tyne, sado të thjesht e të vogël, por me
kuptim të madh, që shfaqej tek ata me ndjenjën e lirisë. Shqiptarët njihen si një popull i pa bindun dhe i pa nënshtrueshëm, pikërisht sepse liria për ta ishte dhe asht gjaja ma e shenjtë. Kohnat kaluen e me kohnat kaluen dhe pushtimet e hueja. Pushtimi turk i katandisi shqiptarët në një periudhë t'errët mesjetare, por që nuk arriti t'u hiqte ndjenjën e lirisë. E ardhmja do të jetë edhe për popullin shqiptar, me plot shpresa për të qenë të lirë e të bashkuem si shtet e si komb. Populli austriak do të jetë gjithmonë mik i popullit shqiptar, dhe në çdo rast do ta ndihmojë dhe përkrahë pa rëzerva, në përpjekjet e tij për të gëzue lirinë e pavarësinë dhe për t'u rimkamb dhe u barazue me popujt e kombet e tjerë të Evropës, ku shqiptarët bajnë pjesë si një ndër popujt ma të vjetër. ... Ky pak a shumë ishte kuptimi i fjalës së Perandorit, që im atë me shokë ua përkthenin malësorve.

Fjala e Perandorit u prit me duertrokitje të gjata. Nërkaq Kryebajraktari u ngrit si vigan duke mbajtë gotën në dorë siç bani Perandori. Një heshtje e madhe ra mbi të pranishmit nga ajo e papritun. Çdo të thoshte ky katalla i maleve ? Zani i kumbueshëm i tij si za i fuqishëm baritoni e mbushi sallën. Vëmendja e të gjithëve ishte përqëndrue në këtë burrë të pashëm si herojt e lashtësisë. Dr. Pekmezi që kishte detyrën delikate për të përkthye drejpërsëdrejti fjalët që do të rreshtonte kreu i malësorve, mbeti ai vetë i çuditun për aftësinë shprehëse të Kryebajraktarit, së cilit nuk i binte një fjalë për tokë. Perandori e të pranishmit ndiqnin me vemendje dhe aprovim çdo fjalë që përkthente Dr. Pekmezi, edhe ky i detyruem me ngrit zanin që ta ndigjonin të gjithë të pranishmit. Në heshtjen që ishte krijue, fjala malësorit vigan kumboj e madhërishme:

- I nderuemi Perandor, të përshendes ty dhe përshendes të pranishmit besnikë të tu dhe miq tanë. Të falemi nderës për ftesën dhe prijen bujare. Ti je miku ynë i madh, miku i gjithë shqiptarve. Ne jemi disa malësorë që kanë mbetun prapa botës dhe nuk mund të krahasohemi me qytetnimin e madh të Austrisë e të vendeve të tjera të Evropës. Por, për ne mbi të gjitha asht Liria, dhe atë dijtëm ta ruejmë. Ndoshta jemi të vrazhdë dhe dukemi t'egër, por qe besa veç kështu ne mund t'i shpëtonim asgjesimit nga valët e pushtimeve të hueja të njëpasnjëshme gjatë dymijë vjetëve, veçanërisht pushtimit 500 vjeçar turk, që deshti me na shue fare. Nuk ja arriti sepse në shpirtin tone rrin gjithmonë e ndezun flaka e pashueshme e lirisë, gjaja ma e shtrejtë për çdo shqiptar. Të falemi nderës dhe për fjalët shpresëdhanëse për t'ardhmen e kombit shqiptar dhe për përkrahjen tuej bujare. Me miq si ju, shqiptarët

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

patjetër se do të përparojnë në rrugën e qytetnimit! I nderuemi Perandor, rrofsh sa malet ! Perandori vetë u çue në kambë e pas tij gjithë sa ishin aty, të emocionuem e plot admirim nga ai fjalim i skalitun aq bukur, dhe ngritën gotat për nder të kreshnikëve të maleve shqiptare. Tregonte im atë se si ai vetë, dhe shqiptarët e tjerë, kishin mbetun të habitun e t'emocionuem nga ajo gojtari e perkryeme e Bajraktarit. Duertrokitje të stuhishme e të gjata shpërthyen njëherësh e u dëgjuen thirrjet : bravo ... bravo ! Perandori vetë kishte mbet tepër i kënaqun për ato fjalë burmore.

Pasi u ngrit dollia, filloi darka. Shqiptarët u lëshuen me duer e me dhambë mbi mishin e dashit sikur t'ishin te stanet e tyne malore, e mbasi i qeronin e i lëpinin mirë kockat, i hidhnin pas shpine. Kamerierët u gjetën para detyrës së vështirë me mbledhë kockat që përplasëshin mbi pllakat e mermerta, thue po binte breshën. Të pranishmit, burra dhe gra aristokrate, dhe vetë perandori, shikonin me kurreshtje dhe një far kënaqësie së shkallës së admirimit, ato sjellje të natyrshme njerëzore, të një populli që u detyrue të marri malet, për të mbijetue e ruejtë identitetin dhe lirinë, që shprehej edhe në gjestet ma të thjeshta, siç ishte vetë ngranja. Tavolinat sumptuozë të shtrueme me mbulesa të bukura dhe orendi të çmueshme, nuk ishin ma të denja për një darkë të tillë, se sa sofrat prej druni të malësorve në odat e tymosuna të kullave të tyne krenare të ndriçuem nga flaka e pishës. Ky krahasim atyne nuk u hynte fare në sy, dhe në ato çaste ata e ndjenin veten rreth sofrës tyne dhe ashtu sillëshin dhe vepronin. Në këtë përfundim arritën të pranishmit, dhe admirimi e simpatia për ato burra shtohej ma tepër. Qytetnimi modern ia kishte grabitun njeriut anën ma të mirë të sjelljës së tij, atë të lirisë. Im atë e studentët e tjerë që ardhjen e malësorve e kishin marrë me frikë, e kuptuen se kishte ndodhë e kundërta, sepse ata dolën të nderuem e të respektuem, dhe këshillat e Perandorit, gjetën jo vetëm zbatim por dhe admirim e vleresim ndaj këtyne burrave 100 x 100 shqiptarë ! Mbetët për të tregue ndarjen nga Perandori, i cili i priti shqiptarët ditën që do të nisëshin. Ata i dhanë dorën me radhë, njeni pas tjetrit, në prani të Dr. Pekmezit që i përkthente Perandorit çdo fjalë të tyne. Kur morën me u largue, befasisht njëni prej tyne, nja dy e ma shumë metra i gjatë, si Herkul, u kthye dalë e duke zatetë para Perandorit, iu drejtue me një shprehje shumë serioze e me za të fortë. Perandori krejt i befasuem dhe i çuditun u detyrue të dëgjonte. Babës dhe shqiptarve të tjerë, që ishin aty të pranishëm, u hyni frika mos ndodhte ndonjë incident i papëlqyeshëm. Vetë Dr. Pekmezi kishte ngri e nuk dinte çka me ba. Malësori kolos me dy pëllambë musteqe, me duert të ngjeshuna pas armëve, foli me za të naltë :

- Or ti Krajl i Nemces a do ta mbajsh fjalën që na ke dhanë ? Kur ke me na e çue kollomoqin që na ke premtue ?.. Kaq pata me thane. Foli malësori dhe iu kthye Dr. Pekmezit :

- Hajt, thueja këto fjalë Krajlit ! Perandori iu drejtue pyetës Dr. Pekmezit:

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

- Ç'pati ky burrë ? Pse foli kaq serioz ? Dr. Pekmezi, të cilit i erdhi fryma, e drodhi bisedën :

- Madhni, ai deshi të ju falënderojë përsonalisht, për pritjen bujare, dhe shqiptarët zakonisht flasin me ton serioz e za të naltë.

Perandori kishte buzëqëshë dhe kishte shprehun kënaqësinë e tij për...falënderimin. Vërtet të çuditshëm këta shqiptarët !

Malësori iu kthye Dr. Pekmezit si me inat :

- He, çka po prallis ky krajli ? Dr. Pekmezi mbasi u përtyp pak ia ktheu :

- Mos kini merak, se krajli e mban fjalën e kollomoq ka me u çue me bollek ! Bajraktari mbeti i kënaqun nga përgjigja. Përshëndeti me nderim ushtarak dhe u nis bashkë me shokët.

Franc Jozefi do të semuhej e vdiste pas gjashtë muej, vendin e tij e zuni i biri Karli I. Nuk dihet nëse perandori i ri e mbajti fjalën për kollomoqin e premtuem. Me këto tregime plotëshet një pjesë e jetës së t'im etit, që atë kohën e Vjenës e kujtonte me kënaqesi e qeshte e zbavitej me miqt dhe me ne familjarët për ato rrethana të çuditshme, që ndonse të vërteta, mbas aq vitesh, merrmin ngjyrën e lëgjendës. Keto kujtime të rinisë ishin per të një si një çlodhje mendore e një ripërtëritje e jetës së kalueme të moshës ma të bukur të djalërisë e të jetës studentore.

Si do t'u jenë dukun vjenezëve krenët e Malsisë.



Kemi marrë këtë foto të Idriz Seferit me luftëtarë të tjerë kosovarë, vesh e ngjesh n'armë, që po i paraqesim këtu si shembëll te veshjve të shqiptarve të Kosheś së Vjenës

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



Po ashtu edhe këtë fotografi të disa bajraktarë të Malsisë në kostumet tradicionale, si ato që mbanin krenët e malësisë që shkuen në Vjenë.



Foto të kohës. Disa nga malësorët e delegacionit shqiptar në Vjenë : Gjelosh Gioka, Vojvoda i Kastratit; Marash Vata , Bajraktari i Shkrelit; Abdi Kola, Bajraktar i Shalës e Lesh Mjeti prej Zadrime. Austiakët u kishin vu në dispozicion këto lloj veturash për t'i shoqitë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Delegacionii shqiptar i malësorëve u prit edhe nga Arkiduka Max në Augarten Palais. Kështu krenët e malësisë takonin personalitete të nalta të Perandorisë, princa, dukë, e konta që i ftonin në pallatët e tyne si mysafirë të nderuem e të veçantë.

Foto të kohës botue në gazetën "Vëllazënija" e Shoqnisë "Dija", Vjenë.

AKADEMIA USHTARAKE E VJENES




Vjenë : Akademia ushtarake e kambsorise ku ndoqi studimet dhe u diplomue oficer Prenk Pervzi , 1914-1918. Fotografi koleksioni e vjetër, 1905.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Wien 3. Bezirk, Landstraße Boerhavegasse u. Kadettenschule
(Akademia Ushtarake e Vienës) në një fotografi të mavonshme

Prenk Pervizi i përjetoi të dy perandorët. Ai pati mundësi t'i shihte në vizitat në Akademinë Ushtarake, dhe në festat e ndryshme ku kadetët merrnin pjesë për të gjallërue ballot.Në raste të veçanta si me malësorët ai u kishte shërbye si përkthyes.


F RANC JOZEFI
1830-1916


KARLI I
1887-1922

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

Perandori Franc-Jozefi siç e njohu Prenk Pervizi me shqiptarët e tjerë që punonin e studionin në Vienë. Ai vdiq në moshën 86 vjeç, pas 68 vjet mbretnim (1867-1916).

I biri Karli I sundoi më 1916-1918, dhe me të, pas humbjës e luftës, mori fund perandoria e dinastisë së Hausburgëve. Ai vdiq në mizerje në një ishull ku e kishin internue.

Shkollat e Kadetëve (Akademitë) banin pjesë në arsimin dhe formimin ushtarak të oficerëve të Austro-Hungarisë, dhe i perkisnin institucionëve të mësimit t'artit të luftës. Ato ishin të caktueme me u transmtue nxanësve edhe njohunitë e përgjithshme të edukimit teorik, që shërbenin për përgatitjen profesionale të oficerëve, dhe për mundësinë e një formim të mëtejshëm, se si ata do ti plotësonin detyrat gjatë rrjedhës së shkollimit dhe edukimit të tyne.

.

.



Trupi mësimor i Akademisë Ushtarake të Vienës në 1914-1918, kur vazhdonte shkollimin Prenk Pervizi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



Prenk Pervizi student në uniformën e kadetëtit, 1914-1918

Pallatet monumentale të Vienës ku patën nderin të pritën Krenët e Malësisë.



Teatri i Operas së Vienës ku dhanë "shfaqje" kreshnikët e malëve tona.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



Vienë, Shönenbrunn, pallati perandorak ku perandori shtroi darkën për nder të krenëve të Malsisë

Kthimi në Shqipni

Perandorisë Austro - Hungareze i erdhi fundi. Aleanca me Gjermaninë nuk dha frutet e duhuna dhe përfundoi me një disfatë të madhe, që përmbysi dy Perandoritë ma të forta evropiane, atë të Hohenzollërve të Gjermanisë dhe të Hausburgëve të Austro-Hungarisë. Mbas traktatit të Bukurestit 7 maj 1918, ku u muer vesh se tashma Austro-Hungaria kishte marrë teposhtën në një tentativë të fundit, Perandori Karli I, kishte urdhnue që të bahej mobilizimi i gjithë kadetëve të akademive ushtarake për të mbrojtë Vjenën. Por ai e ndërroi menjëherë mëndimin se do t'ishte një qendresë e kotë ku do merrëshin në qafë me mijera të rij. Ai e pezulloi atë mobilizim. Shkollat ushtarake u mbyllën me që tashma ishte dhe fundi i vitit shkollor. Kështu edhe Komanda e Akademisë së Vjenës e të tjera, ndanë dëftesat e diplomat dhe i lanë kadetët të lire të kthehëshin në shpitë e tyne. Shqiptarve iu desh të prisnin pesë muej për t'u nisë për në Atdhe deri kur u nënshkrue armistici më 3-4 nëntor 1918 sepse nuk ishin hapun kufijt dhe transporti ishte akoma i bllokuem. Im atë u strehue, gjatë kësaj pritje të përfundimit zyrtar të luftës, pranë miqve të tij. Kjo pritje vazhdoi deri në nënfor kur, siç thamë, me 3-4 të atij muej u firmos armistici midis Italisë e Austrisë, në Villa Giulia afër Trentos. Kjo mundësoi qarkullimin e lirë të trenave për në Itali. Këtu ndërhyni Ahmet

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2019)

Zogu, të cilit i shkonte fjala në mjedisin e shqiptarve të Austrisë. Në një mbledhje të tyne ai u tha se duhet të nisëshin të gjithë së bashku, grup i pandamë, sepse në Itali kishin plasë trubullina e rruga me tren ishte shumë e gjatë, ajo përshkonte krejt Italinë nga veriu në Jug, dy ditë e ma tepër udhëtim, për të arritë në Bari, ku do të hypnin në anije për të kalue në Shqipni. Shqiptarët e pranuen këtë propozim dhe u nisën në grup. Disa prej tyne, tropojas, lumnianë e dibranë, ndoqën rrugën nëpërmes Jugosllavisë, edhe ajo mjaft e rrezikshme. T'im etit miqtë austriakë, i ishin lutë që të rrinte dhe do kohë sa të qetësohej e normalizohej gjendja. Rrugëtimi i gjatë nëpërmjet Italisë paraqiste rrezik, sepse atje mbretnonte anarshia e kaosi politik dhe ordiner. Por im atë nuk mund të ndahej prej shokëve dhe malli për atdhe ishte i madh dhe atij nuk i bahej të priste ma gjatë për t' u kthye në Shqipni. Ai u nda nga miqt e shtrejtë me urimin se do të kishin rast për t'u takue në rrethana të tjera ma të volitshme, tani që lufta kishte mbarue. E kështu shqiptarët e Austrisë u nisën për në Atdhé pas katër e ma shumë vjet ndarje prej tij.

Në fakt në Itali, sa mori fund lufta, kishte fillue përleshja politike dhe organizimi i bandave, qoftë për qëllime politike apo ashtu për banditizëm ordiner. Kishin nisë sulmet e vrasjet, vjedhjet e grabitjet. Kush e kush të fitonte supremacinë politike apo mafioze. Treni ku kishin hipun shqiptarët rastisi të ndalojë disa herë, por pa ndonjë telashe. Kur arritën në qytetin Bolonja, që ishte stacioni kyç i shpëndarjes së linjave veri - jug, treni duhet të ndërrohej dhe u desh me qendrue do kohë aty. Shqiptarët zunë vend në sallën e pritjes të stacionit, bashkë me shumë udhëtarë të tjerë italianë, burra, gra e fëmijë, familje të tana. Shqiptarët ishin shumica djelm të ri dhe nuk kishin asnjë femën në mesin e tyne. Ashtu siç po rrinin në pritje, u dukën aty rrotull disa individë të dyshimtë t'armatosun. Pas pak nja dy a tre prej tyne u futën në sallë me sjellje kërcënuese e me armë nëpër duer. Udhëtarët u befasuen dhe u hyni frika. Në çast im atë çohet me një revolver "Kolt" në dorë e duke e dijtë italishtën, u foli rrebtë italianëve duke theksue se ishin shqiptarë që kthehëshin në atdhé, e mos të guxonin t'i provokonin, se do ta pësonin keq. Banda sa mori vesh se ishin shqiptarë, u shpëmda sa hap e mbyll sytë. Udhëtarët italianë morën frymë dhe e falendëruen atë të ri guximtar. Im atë fitoi lëvdatat e shokëve e veçanërisht të Ahmet Zogut, sepse rezultoi se asnjënit prej tyne s'i kishte shkue mendja me sigurue një armë.

- Hajde, hajde, kishte thanë Zogu, si s'u kujtue asnjëni me ngjesh nje patllake, tue ditë se ç'rrugë do përshkonim ! Të lumtë Prenk se na ke nderue e meriton me ta shtrëngue dorën !

Me këtë tregim hidhen poshtë gjithë thanjet e shkrimet se Zogu na qenka shmang në Romë me një grup patriotësh ku paskej qendrue do kohë, deri dy muej. Krejt një sajim qesharak, duke qenë se ai udhëtim u zhvillue ashtu siç e treguem ma sipër, ku Zogu kishte ndejtë në shtoqni të shqiptarve nga Austria në Shqipni, pa u nda një çast prej tyne. Pse trillohën këto situata të genjeshtra

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

? Asht krejt e pandershme. Në këtë udhëtim nga Vjena në Durrës, Zogu e kishte mbajtë gjithë kohën pranë Prenkën, dhe miqësia e tyne u forcue ma tepër. Zogu e kishte porositë që të qëndronte në Skuraj, deri sa t'i vinte emnimi në detyrë ndoshta prej dorës së tij. Ashtu i porositi dhe te tjerët. Kjo do të thoshte se ai ishte ma se i sigurt për rolin që do të kishte në drejtimin e shtetit shqiptar. Pjesa tjetër e udhëtimit shkoi pa probleme e pengesa dhe nga gjysma e nëndorit 1918 arritën në Durrës, prej ku morën rrugën për në shtëpitë e tyne, si mundën, sepse nuk kishte mjete transporti as rrugë, përveç kambëve, karrocave, qerreve e kuajve apo të ndonjë automobili karakatinë, me rrota të mbushuna, që punonte për Tiranë nëpër një rrugë primitive fushore.
Ahmet Zogu me disa Tiranas u nisen me një nga ato makina, ku im atë shkoi me ta deri në Vorë, ku kishin ardhë edhe disa shkodranë. Prej Vore u nisën së bashku deri në Milot, ku pastaj shkodranët vazhdue për në qytetin e tyne.

. Kthimi i t'im etit u muer vesh menjherë e u prit me gëzim të madh. Lajmi kishte fluturue deri në Skuraj. Ai u përcoll me njerëz e të shtëna pushkësh nga Miloti deri te kullat e Gjin Pjetrit, ku kishin dale për ta pritun Ndrec Pjetri me nanë Mriken, kushrijt e t'afërmit e tjerë të fisit si dhe dashamirë nga katundi i Skurajt e të Kurbinit. Ai konsiderohej perfaqësuesi ma i denjë i fisit dhe i krahinës, i zgjedhun prej vetë Gjin Pjetrit si një pasardhes i tij, të cilit i kishte hap rrugën drej shkollimit ma të naltë të kohës. Me mbarue studimet në Vjenë t'Austrisë, ishte një privilegj dhe arritje e madhe. Në Skuraj e priste edhe e fejuemja, Prena Gjokolaj. U ba festë dhe dasme e madhe, ku morën pjesë të ftuem nga të gjithë Kurbini dhe krahinat përreth. Merrte kështu fund periudha e rinisë pa andralla e tim etit dhe fillonte ajo e burrnisë me detyra familjare dhe me detyra shtetnore. Për kohën e ardhshme do t'i hynin në punë vitet shkollore të Shkodrës dhe të Vjenës, miqësitë e lidhuna gjatë jetës studentore, kultura shqiptare dhe ajo evropiane, gjuhët e hueja e miqësitë e forta që ai lidhi në Shqipni, në Austri, Hungari e Çeki. Veçanërisht lidhja e miqësia me Ahmet Zogun do t'ishin vendimtare. Ai ndejti në Skuraj deri nga fundi i vitit, sepse edhe s'kishte kah me shkue e me bredhë. Rrugët mungonin. Mungonin komoditetet. Qytetet pothuej nuk ekzistonin. Tirana nuk ishte tjetër veçse një fshat i madh me shtëpi prej çerpiçi, kandila e bishtukë vajguri e rrugë të pashtrueme ose me kalldrem me gurë zalli.

Nga muej tetor i erdhi emnimi si rrethkomandant i Krujës me gradën Toger nga qeveria provizore e Durrësit. Zuni shpi me qëra te krushtani Sul Parja, me gruen dhe nanën. Ishte fillimi i asaj karriere ushtarake që do t'i hapte rrugën drejt arritjesh të lavdishme në shërbim të Atdheut. Ndërkaq shkon në Tiranë ku takohët me Ahmet Zogun. Aty merr vesh se po pregatitej shpallja e Shqipnisë si shtet ligjior, ku Zogu i dha me kuptue se do të zinte një pozitë të randësishme ne qeverinë që do të formohej. Kështu im atë po përfshihej në ato ngjarje historike të krijimit të Shtetit shqiptar.

Andrrat dhe dëshirat e axhës së madh, Gjin Pjetrit dhe të babës tij Frrok

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Prendit, po realizoheshin. Shqipnia kishte nevojë për njerëz të ngritun që ta udhëhiqnin drejt qytetnimit evropian ku ajo ishte e pranishme qyshë në agimet e para të njerëzimit. Pa dyshim se një nga ato njerëz ishte dhe Prenk Pervizi.



Villa Giulia, afër Trentos, ku me 3 nëndor 1918 u firmos armistici midis Italisë e Austrisë dhe pushuen luftimet, duke lejue qarkullimin e njerëzve e mjetëve midis këtyne shtetëve.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

---

*-- Siç del nga tregimi i sipërm i drejpërdrejtë i Prenk Pervizit, në kthimin në Shqipëri në nëntor 1918, në grup me shqiptarët e tjerë, Zogu nuk është shkëputur nje cast të vetëm prej tyre dhe ka ndenjur gjithë kohën me Prenk Pervizin pranë. Prandaj hidhen poshte pretendimet e trillimet se ai na qenkesh shmangun në Romë, ku paskej qendruar dy muaj duke gënjeshtër bajate që u shtohët të tjerave në dam të historisë shqiptare. Ky udhëtim asht i domosdoshëm të regjistrohët nga historianët, sepse i përgjigjet së vërtetës absolute lidhur me Ahmet Zogun. Sigurisht për ata që trajtojnë historinë e tij.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Nga Liria në Pushtim

1918-1946

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Në shërbim të Atdheut

Emnimi me detyrë si rrethkomandant i Krujës erdhi ne nje kohë kur Shqipnia sa kishte dalë prej luftës botnore. Ndersa austriakët që kishin humb luftën ishin kthye ne vend të tyne, forcat e tjera si ato serbe, italiane, franceze, greke e bullgare, qendronin akoma në territorin shqiptar, me qëllime të këqia të një ndarje mes tyne të trojeve arbnore. Forcat serbe kishin zbrit deri ne Mat e afër Krujës. Italianët ishin vendos në Vlorë duke u shtri mbi gjithë Kurveleshin deri në Gjirokastër e Sarandë, duke i perzanë Grekët. Francezët ishin vendosë në Korçë e bashkëpunonin me Grekët, të cilët nga ana tyne donin të aneksonin Korçën dhe synonin për Vorio Epirin. Qyshë në prag të luftës më 1913 kishte pasë orvatje të tilla dhe kishin plasë luftime çetash midis forcave greke e atyne shqiptare. Shteti shqiptar i shpallun i pavarun më 1912 nuk arrinte te kontrollonte e përballonte situatën, pa ushtri, pa armatime e mjete. Ismail Qemali ishte detyrue me dhanë dorëheqjen dhe ishte largue në Itali. Dihet se Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1913, kishte marrë vendime të padrejta ndaj Shqipnisë, nga ku kërkonin të përfitonin fqinjët toksorë dhe të përtej detit. Orvatja me krijue një principatë apo mbretni me princin gjerman Wilhelm Von Wied dështoi, i cili u deturye të largohet pas gjashte muej mbretni, duke ia hap vendin Esad Pashë Toptanit i cili kërkonte të sundonte mbi një shtet të cunguem, midis lumit Mat e Shkumbinit, si pas principatës së Topijave. Ai ua kishte lëshue Shkodrën malazezëve dhe pjesën jugore, Gjirokastër e Korçë e kishte lanë në dorë të grekëve. E vetmja vepër e mirë e Esadit ishte shtypja e kryengritjës proturke të Haxhi Qamilit, që përfundoi i varun. Edhe Esadit s'i vajti mirë puna dhe iku në Francë ku e mbylli jetën tragjikisht nën plumbat e revolverit të Avni Rustemit. Në këto rrethana më 25 dhjetor 1918 u mblodh Kongresi Kombëtar në Durrës ku u formue një qeveri tjetër provizore. Aty u hodhën bazat për një kuvend kombëtar për formimin zyrtar te një Shtetit ligjor, që do të arrihej në Kongresin e Lushnjë më 21 Janar 1920. Qeveria e Durrësi kryesohej nga Turhan Pasha, që pati mëritën të përfaqësojë Shqipninë në Konferencën e Vesailles më 1919. Ku me ndërhyemjën e Imzot Luigj Bumcit pranë Papës Benedikti XV iu njohën Shqipnisë kufijt e tanishëm, duke i shpëtue nga një coptim ma të madh. Në këto rrethana emnimi i Prenk Pervizit me detyrë në Krujë vinte nga Qeveria e Durrësit. Im atë kishte shkue në Tiranë, ku ishte takue me Ahmet Zogun, i cili e kishte siguruë që me formimin e një qeverie ligjore në përspektivë, ku ai patjetër do të zinte një post, do të mendonte edhe për të, aq ma tepër se ishte ndër fare të paktët oficerë me Akademi ushtarake të kryeme, e ku se? Në Vjenë t'Austrisë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Ai ishte rrethkomandanti i parë shqiptar i emruem nga një qeveri shqiptare. Kruetanët e pritën mirë oficerin e ri, që i përkiste një fisi të njohun e të nderuem, me të cilin kishin pasë gjithmonë lidhje miqsore e kishin luftue përkrah Gjin Pjetrit, në bëtejen e Tallajbesë e gjetke, dhe kishin qënë në ngritjën e flamurit në Milot. Kruetanët ruenin një respekt e admirim të madh për Gjin Pjetrin. Tim etit i ra me takue njerëz që kishin qënë përkrah Gjinit në kryengritjën e artmatosun kundër turqëve. Im atë i lidhi dhe ma fort ato miqësi dhe tregoi aftësi ushtarake të nivelit të mirë, në kryemjen e detyrave, duke fitue simpatinë e të gjithëve. Kur erdhi koha për të lindun e nisi gruen në Skuraj. Fëmijët e tij do të lindnin atje ku kishin lindun të parët. I pari fëmi ishte vajzë, me emnin Marie, por ajo nuk jetoi ma shumë së gjashtë muej. Ne të tre djemt e tij, Valentini, Genci e Leka, do të lindnim të gjithë në Skuraj. Djalin e parë, Valentin, ia fali Zoti me 1 korrik 1920.

Në këto rrethana rrezikshmënie nga ana e serbëve, ai i shtoi stërvitjet duke angazhue e mobilizue edhe vullnetarë civilë me forcat e pakta efektive që kishte. Në këto stërvitje i ndodhi një incident. Duke ba stërvtje në qitje i kishte plasë pushka, dhe baroti i kishte ra në fytyrë e në sy. Rrezik t'ishte qorrue po mos të kishte qëllue një mjek popullor që arriti të ia pastrojë sytë me marifetet e veta. Pastaj mori mjekime ma cilësore në spitalin ushtarak të Tiranës, dhe fytyra dhe sytë i erdhën në rregull. Por prap se prap disa vjet ma vonë që i ishte shfaq një si alergji në fytyre ishte detyrue me shkue në Vjenë për ta kurue, e nuk pati ma shqetsime. Në Janar 1920 merr pjesë në mbrojtjen e Kongresit të Lushnjës, me forcat e tjera shqiptare, që rrezikohej nga ndërhyrja e ushtrisë italiane, që ishte përqendrue në kodrat e Ardenicës. Ai i kishte vendosë trupat e tij në Vajkan, përballë forcave italiane. Italianët e kuptuen se një nedërhyrje e tyne do përballohej me qëndresën e vendosun të shqiptarve, për të mbrojtë punimet e Kongresit. Kështu që orvajtja tyne dështoi dhe italianët u dëbuen po atë vit nga Vlona, si pasojë e luftës heroike të popullit të Labërisë. Në ato kushte im atë i forcoi lidhjet me shumë kolegë, oficerë të rij si ai, me të cilët ma vonë do të miqësohej ma tepër dhe me të cilët do të bashkëpunonte në veprimet e ndryshme luftarake për stabilitetin e vendit. Nga Kongresi i Lushnjës doli një qeveri me Kryeministër, Sulejman Delvinën; Ministër i Jashtëm Mehmet Konica dhe i Brendshëm Ahmet Zogu; kurse Ministër i Financës, Ndoc Çoba dhe i Arsimit Sotir Peci. Kongresi kishte zgjedhë edhe një Keshill të Naltë për në krye të shtetit, dy myslymanë e dy të krishtenë: Aqif Pashë Biçaku, Avdi Bej Toptani, Imzot Luigj Bumçi e Dr. Mihal Turtulli. Fill mbas Kongresit im atë caktohet në Tiranë pranë Komandës së Përgjithëshme me detyrë të posaçme e kalon në dispozicion të Ministrisë Brendëshme, ku e kishte themelun Ahmet Zogu, i cili tashma e konsideronte mik të shtrejtë dhe kishte dallue tek ai veti të spikatuna burmie e trimnie si dhe aftësitë ushtarake, të cilat do të shfaqëshin në detyrat që do të kryente. Prej atij çasti, im atë qëndroi në marëdhanje të ngushta me

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

Zogun, në të gjithë kohën që u gjet në Shqipni. Zogu e mbante atë, si krahun e djathtë e bensnik të madh, e kështillohej vazhdimisht me të, siç do ta tregonte koha. Im atë, ndonse oficer i ri, por si akademist që ishte, zuni vend kryesor në komandën e operacionëve për zonat e veriut, kryesisht për dëbimin e forcave serbe që kishin përfitue nga lufta për të depërtue në Shqipni e mos me luejt ma prej saj. Serbët kishin kalue në zonat veriore, Tropojë, Dibër, deri në Mat dhe poshte deri te Shkalla e Tiranës, me qëllim destabilizimi të gjëndjës. Por planet u kishin dështue sepse forcat e armatosuna shqiptare u mobilizuen nën komandën e burrave si Bajram Curri, Preng Jaku, Prenk Pervizi, Elez Isufi, Alush Aga i Lumës, Gjon Fusha, Muharrem Bajraktari, Lek Margjini, Dervish Duma, Ahmet Sata, Ali Erebara, Ceno Beg Kryeziu, Hysni Dema, Fiqri Dine, Murat Kaloshhi e të tjerë, ku bashkohej herë pas here edhe Ahmet Zogu. Jo vetëm që u dëbuen serbët nga trojet shqiptare, por u vendos dhe rregull e qetësi, duke u zhdukun bandat kriminale ordinere e duke u ba dorëzimi i armëve. Në këto operacione, im atë u dallue dhe u afirmue si një oficer me përgatitje e aftësi të spikatuna ushtarake. Ndërkohë, fatkeqësisht, kishte fillue dhe lufta politike, dhe grupe të ndryshme rebele nën maskën e opozitës kërkonin të destabilizonin vendin për të marrë pushtetin në dorë me anë të forcës së armëve. Ishte një kohë kur lëvizjet ishin të kushtëzueme nga mungtesa e rrugëve e qarkullohej nëpër shtigje me kambë e kafshë mbartëse.

Ndonse ishte emnue një Këshillë i Naltë dhe funksiononte një qeveri ligjore, opozita, në vend që të zhvillonte një luftë parlamentare orvatej të krijonte situata të rrezikshme, shkurt, të bante një grusht shteti, duke shkaktue trubullina të njëpasnjëshme. Im atë, tashma kapiten, ishte transferue me bataljonin e tij në Shijak, për të mos lejue shregullime dhe organizime kundër qeverisë në fuqi, e cila po bante hapat e para drejt stabilizimit të gjëndjes në mbarë vendin. Duhet ditun se gjatë Luftës së Madhe, ne Shqipni kishin vërshue armët e të gjithë shteteve ndërluftuese. Vendi ishte mbushë me mauzere austrie, turku e maliher greku, pushkë italiane, franceze, serbe, belgjike, e të tjëra marka, si dhe me municione të të gjithë llojëve. Populli ishte fumizue mirë dhe pushka kërsiste ditë e natë, në dasma, kinidje, festa , ... por, fatkeqësisht, dhe për hakmarrje e banditizëm. Banda kriminale, siç e thamë, sulmonin e grabitnin shtegtarët, karvanet, shpitë, stanet. Kjo veçanërisht në zonat veriore : Mirditë, Kthellë, Tropojë, Lumë, Kukës, Mat e Dibër, etj. Paraqitej urgjente dorëzimi i armëve nga ana e popullsisë e zhdukja e bandave. Për këtë punë ishin krijue forcat e xhandarmërisë të përforcueme nga ato të ushtrisë, të cilat ishin vu në dispozicion të Ministrisë së Brendëshme. Ministri i Brëndëshëm, Ahmet Zogu, me gradën kolonel, kishte caktue në komanden e operacioneve oficerët ma të aftë si Major Preng Jakun, bashkë me oficerë të tjerë të rij, si Prenk Pervizin, Muharrem Bajraktarin, Fiqri Dinen, Hysni Demën, Gjon Fushën, Lek Margjinin, Lek Marashin,

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

Osman Gazepin, etj., ku shquhej Bajram Curri me gradën kolonel kreshnik. Këto ushtarakë ishin dallue në detyrat e tyne. Im atë kishte fitue eksperiencë të madhe dhe ishte shque në operacionet kundër forcave serbe, siç e kemi thanë. Një ndër pficerët ma të njohun të kohës ishte major Preng Jakun, me përvojë të madhe ushtarake, krijues i bataljonëve autonomë (baone) shetitës (shetica), që kishin detyrën për të lëvizun vazhdimisht nga një vend në tjetrin, me shpejtësi dhe befasi. Siç dihet major Preng Jaku vdiq nga plasja e një kallepi dinamiti, ndërsa gjuente peshk në lumin e Valbonës, që i këputi krahun e djathtë. Tirana u lajmërue menjëherë dhe erdhi një avion i postës që e çoi majorin në Tiranë. Sado që arriti gjallë, ku urgjentisht e bani operacion kirurgu ma i mirë i kohës, Dr. Sinani, i mbeti atij në dorë, për arësyen që thamë të humbjës së gjakut. Spitalet nuk i kishin akoma mjetet e nevojshme e të tjera shërbime. Ishte një humbje e madhe për ushtrinë shqiptare, dhe për Shqipninë, sepse Preng Jaku kishte dhe tiparet e një burrë shteti, e përspektivat për të ishin të favorshme e të shkëlqyeshme. Besnikët e kushrijtë e tij deshën ta vrisnin kirurgun sepse, sipas tyne, nuk e kishte ba operacionin mirë. U desh ndërhyemja e tim etit e të Ahmet Zogut që të ftofnin gjaknat. Preng Jaku gëzonte simpati e influencë tepër të madhe në popull, kryesisht në Veri, e në radhet e ushtrisë. Mik i ngushtë i Bajram Currit, Prenk Pervizit dhe Ahmet Zogut, me ndikim të madh në Mirditë dhe krahinat e tjera veriore. Me babën miqësia shtrihej ma thellë në lidhje ma të vjetra ndërfisnore, prandaj emnat e këtyne dy oficerëve nuk mund të përmendeshin pa njeni tjetrin, edhe për arësye se i bashkonte i njejti koncept i artit ushtarak dhe i atij të luftës popullore, të kalitun në të njejtat shkolla e të njetat kushte të traditave luftarake të shqiptarve.

Edhe me Bajram Currin, im atë ishte lidhë me miqësi të fortë. Jo vetëm sepse i kishte ra me luftue se bashku kundër serbëve, por dhe për faktin se Bajram Curri kishte pasë takime e marrëveshje me Gjin Pjetrin, për të bashkëpunue në levizjen kryengritëse kundër turqëve që kishte përfshi mbarë veriun. Baca Bajram kishte qenë në Skuraj e ishte takue e marrëvesht me Gjin Pjetrit për bashkëveprim në kryengritjën kundër Stambollit. Ai mendonte se nipi i Gjinit i kishte cilësitë e një komandanti të shquem, i denjë me i pri ushtrisë shqiptare. Bajram Curri mendonte për t'ardhmen dhe shtjellimet që mund të vinin, kryesisht për një bashkim kombëtar, dhe e vlerësonte Prenk Pervizin si një ushtarak shumë të përgatitun, që do të lozte rol kryesor në ngjarjet që do të interesonin çështjen kombëtare si komandant i forcave t'armatosuna shqiptare, ku do të përfshiheshin dhe çetat e luftëtarve vullnetarë në Kosovë. Kur i takonte me zbrit në Tiranë Bajram Curri vinte ne shpinë tonë, ku kalonte mbramjet deri natën vonë, me tim atë e patriotë të tjerë, duke bisedue për çështjen shqiptare, gjithmonë në kuptimin e bashkimit kombëtar. Çështja e Kosovës ishte në plan të parë të politikës popullore për ta dallue nga ajo zyrtare e qeveritarve që përlyhej me interesa meskine

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

vetjake. Për të tilla interesa e allishverishe, çeshtja e Kosovës mbeti pezull e mund ta themi me plot gojë që u nënvleftësue e u sabotue vazhdimisht në forma të hapta dhe të fshehta, jo vetëm nga serbët e përkrahësit e tyne, por edhe nga disa shqiptarë renegatë e të shitun për përfitime t'ulta vetjake. Në këto vizita në Tiranë Bajram Curri takohej vazhdimish me Zogun me të cilin kishte miqësi të fortë. Kishte qëllue që me Ahmet Zogun të takohëshin me t'im atë edhe në shtëpinë tonë.

Tregonte im atë se kur luftonin kunfër forcave serbe, ku Ahmet Zogu vinte në ispektim, rrinin në një çadër, ku mblidhësin me Bajram Currin, Preng Jakun dhe të tjerë oficerë për të marrë vendime e hartue plane. Dhe gjithkush ishte çudit kur Bajram Curri mori krahun e opozitës, që kishte arritë ta mashtronte e ta bante për vete. Në këtë kurthë të opozitës kishte ra edhe Elez Isufi. Prandaj punët e Shqipnisë nuk shkonin mbarë, përderisa, burra në za e patriotë nuk binin dakord midis tyne dhe arrinin edhe të anmiqësohëshin pa një arësye të bindshme. Sigurisht se në këto veprime të damshme për vendin, kishte gisht politika e të huejve, dhe mjerisht në Shqipni kishin depërtue edhe idetë komuniste që ushqehëshin nga Moska dhe Belgradi dhe që opozita donte t'i zbatonte në Shqipni. Bajram Curri dhe Elez Isufi ishin burra ne za dhe luftëtarë e patriotë të shquem, por të pashkolluem e analfabetë, ku propaganda komuniste zinte vend. Kjo gjëndje i hapte rrugë rrezikut të destabilizimit të Shtetit shqiptar të sapo krijuem. Sepse opozita kishte vendos me perdorë forcën e armëve për të rrexue qeverinë ligjore dhe me ia zanë vendin. Ajo nga një anë shpaloste idetë e revolucionit francez të mpleksun nga ana tjetër me propagandë komuniste që ushqehej e diktohej drejt nga Moska.



Tropojë, zonat malore të kufizës kundër forcave serbe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Burrat qe dëbuan serbet nga Shqipëria me 1920-1921



AHMET ZOGU



BAJRAM CURRI



ELEZ ISUFI



PRENG JAKU



PRENK PERVIZI



M. BAJRAKTARI



FIQRI DINE



HYSNI DEMA



ALI SH AGOLLUMES

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Operacione qetësuese

Pas Kongresit të Lushnjës qeveria shqiptare u gjet para problemit të çarmatosjës së vendit. Siç e kemi thanë, Shqipnia ishte mbush me armë gjatë periudhës së luftës 1914-18. Ndërkaq vepronin edhe banda ordinere grabitëse, veçanërisht në zonat e veriut. Njëkohësisht disa krahina të varfëra vuenin për bukë. Ndër to Mirdita, që njihej si një krahinë e ashpër, sa që, as Turkia nuk e kishte randue me taksa, duke i lanë një far autonomie duke e njohun shpinë e Gjomarkajve si Kapidana të saj, në rang princor. Nga ana tjetër qeveria pa asnjë kriter dallues, kërkonte nga të gjithë krahinat që të paguenin taksa shtetit, ku përfshihej dhe Mirdita. Mirditorët ishin revoltue. Ata nuk i kishin pague taksa Turkisë e jo të ia paguenin një qeverie shqiptare. E ku t'i merrnin paret, mos vallë binin nga qielli ? Në këtë kohë, im atë tashma kapiten, ishte përfshi në batalionin e Major Preng Jakut si adjutant i tij. Bataljoni ishte caktue me ba dorëzimin e armëve dhe me zhduk banditizmin që ishte përhapë dhe krijonte pasiguri. Në ato kushte primitive njerëzit udhëtonin në kambë apo kafshë ngarkese, ku binin pré të hajdutëve t'organizuem në banda. Por kryesor mbetej çarmatimi, ku, siç e kemi thanë, vendi ishte mbushë me armë të çdo lloj marke gjatë kohës së luftës.

Në këto operacione, bataljoni kaloi veprues në Mirditë, ku ishin shkaktue disa trubullina, që u paraqitën si rebelizëm kundër shtetit nga ana e Jugosllavisë.

Si rodhën punët? Kapidani i Mirditës Marka Gjoni, kishte shkue me u takue me Mehdi Frashërin, asokohë Ministër i Brendshëm, në zyrën e tij. I paraqet gjendjen e mjerueshme te Mirditës, ku banorët po vuenin deri për bukën e gojës. Qeveria nuk kishte vu dore fare për t'i ardhu në ndihmë krahinës. Biles kerkonte të vilte taksa, qe edhe nën sundimin e Turkisë nuk i kishin pague. Fjalë në fjalë e biseda acarohet. Mehdi Beu e fajson Kapidanin, që nuk ka ba dorëzimin e armëve dhe se mirditorët nuk pranojnë me pague taksat e detyrueshme të shtetit. Kapidani revoltohet në kulm nga ajo përgjgje e del prej zyres pa ia dhanë dorën e duke përplas derën e fill - në Orosh ku mbledh krenët e Mirditës. Mirditorët vendosën me e kundërshtue vendimet e qeverisë, deri dhe me armë. Këtu filloi ashtuquejtuni rebelimi i Mirditës e paraqitur si kryengritje. Mehdi Frashëri, ngarkon major Preng Jakun e Prenk Pervizin, për rivendosjën e rregullit atje, dhe fillon operacioni për qetësimin e gjendjës. Në këtë komandë merrte pjesë oficerë të tjerë si Lek Margjini, Preng Marka Perzefi, Gjin Noku, Ded Luli, etj. Operacioni kishte qëllim ma tepër me vendosë qetësinë e me ba dorëzimin e armëve se sa me ndez luftë dhe derdh gjak. Dhe ashtu ndodhi. Mirditorët që ishin përqëndrue në Orosh,

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

aritën të mbajnë të rrethuem bataljonin në kishën e Oroshit. Rrezik me kris pushka dhe me u derdh gjak. E keqja ishte se batalioni ishte mangut me ushqime sa kishte arritë puna me nda nga një grusht misër për njeri në ditë. Preng Jaku konsultohët me oficerët, dhe nëntogeri Ded Luf ngarkohët me dalë prej rrëthimit për me kerkue perforcime dhe ushqime. Deda arri të kalojë. Por duhet ditun se çdo lëvizje bahej me kambë, dhe veç pas dy ditëve erdhën përforcimet me Ndrec Lufin, axhën e Dedës, që kishte ngarkue disa mushka me ushqime e municione. Forcat e Ndrecës filluen të gjuejnë batare me pushkë. Mirditorët e hoqën rrethimin dhe u drejtuen për në Shpal. Preng Jaku, iu ngjit mbrapa e i rrethoi në Shpal. Mirditorët s'patën kah me ia mbajtë dhe u shpërndanë. Kështu mori fund rebelimi i Mirditës. U ba dorëzimi i armëve dhe u vendos një far qetesie. Qeveria e tërhoqi vendimin e taksave. Por Marka Gjoni u detyrue të kalojë përkohësisht në Kosovë me njerëzit e tij. Që pati një formë rebelimi, pranohet, por thjesht për çështje ekonomike e varferinë që sundonte në atë krahinë. Por Jugosllavia e kishte ngritë çeshtjën e Mirditës në Lidhjen e Kombëve, se ajo krahinë katolike kërkonte të ndahej në një Republikë të pavarur, por qeveria shqiptare e formueme me musulmanë, po e shtypte me ushtri. Lidhja e Kombëve kishte dërgue menjëherë një komision të kryesuem nga profesori suedez Soderholm, që raporton se në Mirditë mbretnonte qetësia e plotë dhe se Marka Gjoni ishte largue në Kosovë.

Kështu ajo çeshtje u mbyll. Sa e vërtetë qendron kjo punë, u mbetët historianeve të paanshëm ta gjajnë. Fakti asht se qellilmisht janë krijue trillime të teprueme, sepse po t'ishte e vërtetë, Kapidani i Mirditës ishte në gjëndje të mblidhte 5000 mirditorë të armatosun e t'organizuem, të cilëve zor t'u bante ballë kush. Nga kjo punë, të vjen keq se kane perfitue disa njerëz për të rrit prestizhin e tyne, duke trillue se kanë marrë pjesë me forcatt e tyne (cilat forca ?) për të shtyp "kryengritjën" e Mirditës, sa qe kanë krijue edhe dokumentë fallso për të marrë përsipër veprime qe nuk i kanë krye kurrë. Pra rrena me bisht.

E treguem këtë ngjarje sepse në të ishte përfshi im atë. Shuemja e rebelimit iu dedikue Preng Jakut e Prenk Pervizit. Prandaj e kemi ditë shumë mirë se si shkuen punët. Asht spekullue për ta paraqitë çështjën, siç e treguem, sikur Mirdita po donte me u shpall Republikë me Kapidan Marka Gjonin në krye, dhe me mbështejen e Jugosllavisë. As parë as dëgjuar do thoshte torka. Faktikisht për sa kemi jetue në Shqipni nuk e kemi dëgjue kurrë prej askujt një gja të tillë. As prej t'im etit as prej rrethit tij ushtarak, duke fillue nga oficerët deri te ushtarët e thjeshtë, që kishin marrë pjesë në atë operacion qetësues. Sipas një dëshmie të besueshme, siç asht ajo e Dom Ndoc Nikajt, që kishte qenë famullitar në Mirditë, mirditorët kishin ngritun krye, nga fukaralleku e mungesa e bukës e kërkonin ndihmën e qeverisë, që nga ana e saj ngulmonte të pagueshin taksat që ajo kishte caktue Ishte një periudhe e keqe ekonomike, e kishte shkue puna deri aty sa me u përzie mielli me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

tallazhin e sharrës (thanje të popullit) e me u ushqye me lende e lakna t'egra.

Në këtë periudhë, Kryeministër ishte Iliaz Vrioni e Ministër i Brendëshëm, Mehdi Frashëri. Ahmet Zogu ishte caktue në komandën e përgjithëshme të operacioneve për Veriun, me qëndër në Shkodër. Ai ndërhyni për pajtimin mes kundështarëve, e me u marr vesh me Kapidan Marka Gjonin. Në këtë pajtim luejtën rol Preng Jaku dhe Prenk Pervizi, që kishin lidhje gjaku dhe krushqi me Gjomarkajt.

Duke u kthye përsëri tek e ashtuquejtuna "kryengritje" e Mirditës, ajo mbetet një çështje e pa sqarueme mirë historikisht. Dokumentat janë të pakta, për mos me thanë se nuk ka fare, ose janë të manipuluem. Ata që ishin protagonistët kryesorë nuk u pyetën për të dhanë dëshmitë e tyne të mirëfillta, si Prenk Pervizi, Muharrem Bajraktari etj. që jetuen deri vonë në Belgjikë. Disa që u orvaten të shkruejnë historinë ia veshën me hamendje, kodra pas bregut, sipas oreksit të tyne politik, partiak, fetar, krahinor e klanor.

Asht për t'ardhun keq por ja që asht e vërtetë. Diktatori Hoxha e kishte leshue vetë udhëzimin e fallsifikilmit të historisë. Sipas tij sistemi komunist nuk do shuhej kurrë, dhe kështu e gjithë historia do ju servirej si e vërtetë rinisë shkollore të brezave të ardhshëm. Por shembja e komunizmi i prishi ato plane dhe historia do të rikthehët në binarët e saj. Theksojmë këtë, sepse në tregimin që po rreshtojmë të jetës e veprimtarisë së prindit tim, pasqyrohen ngjarje siç kanë ndodhun realisht, duke qenë se ai ishte i lidhun ngusht me gjithë atë pjesë të historisë ku ishte përfshi nga 1918 deri më 1946, që përbën atë periudhë ma të paqartë të historisë sonë, sepse e dominueme dhe shkrueme nga njerëz e historianë të angazhuem politikisht, krahinorisht, klanorisht, fetarisht dhe ideologjikisht. Lene që asokohë nuk ka pasun as shtyp të rregullt as gazetarë dhe aspak historianë. Këto u shfaqen dhe u formuen shum ma vonë, mjerisht si komunistë, për t'i shërbye diktaturës së cilës i ishin bashkangjitun. Nuk ka dyshim se pas leximit të këtij libri lexuesi (edhe historiani) do të gjendet para fakteve e ngjarjeve që ai, jo vetëm nuk i ka dëgjue por edhe që ia kanë paraqitun tjetër për tjetër, te veshuna me përshkrime krejtësisht të sajueme, për të fallsifikue jo vetëm ngjarjet, por edhe për të injorue njerëzit që u përfshinë në to. Me këtë tregim të zgjanuem të prindit tim, ku hyjnë dhe ngjarjet e marëdhanjet që shoqnuen e shoqnojnë familjen tonë, lexuesi të jetë i sigurtë se do të njihet me fakte e situata krejtësisht të vërteta. Erdhi koha që ato të thuhen. që historia moderne shqiptare të njihet e të shkruhet ashtu siç u zhvillue, sepse e tregueme nga dikush që atë histori e ka shoqnue nga afër, nëpermjet vetvetes dhe njerëzve me të cilët ndau të mirat e të keqijat. Kam pasë fatin të jetoj në një mjedis njerëzish që banë historinë shqiptare, nga ngjarjet ma të vogla në ato ma të mëdhatë, ku një vend nderi e zen dhe im atë. Ai bashkë me kolegë e bashkatdhetarë të tjerë patriotë, u gjend gjithmonë në ballë të situatave ma të rrezikshme për vetë ekzistencën e kombit tonë. Arriti t' zgjidhë ato me aftësitë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
SHKODËR (2018)

e tij ushtarake, kur dihet se roli i ushtrisë asht vendimtar në kushtet e krijimit të një shteti të ri, siç ndodhi me Shqipninë, që për herë të parë në histori u njoh si shtet më 21 Janar 1920 në Kongresin Lushnjës. Ky rol ushtarak njihet në të gjithë botën si vendimtar, përveç se në Shqipni, ku as që përmendet, veçse shkarazi. E pra ky rol ka qenë ma se vendimtar, për ata që kuptojnë. E kam fjalën për periudhën para 1944. Asht pikërisht nga udhëheqësit ushtarakë, fitoret ose humbjet e tyne, që krijohet e shkruhet historia e një populli dhe e një Kombi. Politikanët nuk janë tjetër veçse përciellës e sajues situatash ne kontekstin diplomatik dhe administrativ, por asnjëherë zgjidhës faktikë të tyne. Në qoftë se ka zgjidhje, veçanërisht në Shqipni, ajo vjen nga ushtria, e kur themi nga ushtria, nënkuptohet se nga udhëheqësit e strategët e saj. Këto zgjidhje situatash reflektohen te qeveria e politikanët, që i përvetësojnë për vete duke lanë në hije ata që ua dhanë në dorë. Kështu u veprue në Shqipni. Në rastin e Ahmet Zogut, gjithçka iu vesh atij, duke qenë se punët i kryenin të tjerët. Ai u paraqit si një "Superman". Sigurisht se merita e tij si burrë shteti qëndron, por pa ato burra të tjerë që ia hapën rrugën kudo dhe e përkrahën fuqimisht ai nuk mund të kishte ba një hap përpara. Asht sipas këtij kandvështrimi që duhet kuptue e shkrue historia shqiptare. Ata ushtarakë që e mbështeten Zogun, panë tek ai shqiptarin që i përmbushte të gjitha kushtet e një burrë shteti të aftë dhe autoritar. Të vendosun dhe mponues. I zoti me udhëheq shtetin, dhe i vetëdishëm se pa njerëz me cilësi e aftësi ushtarake nuk mund të arrinte asnjë sukses, as qellimin e tij madhor, që të bahej Mbret i Shqiptarve. Im atë dhe të tjerë kolegë e miq ushtarakë, ia dinin edhe të metat, po i kapërcenin ato për të mirën e vendit.

Pas vendosjës së një farë qetësië, keshilli i parë i Naltë dha dorëheqjen dhe u zevendësue nga një katërshe tjetër : Ymer Pashë Vrioni, Refik Bej Toptani, Sotir Peci e Ndoc Pistulli. Kryeministër Abdyl Ypi, Ministër i Brendshëm, Ahmet Zogu. Këtë detyrë Zogu e përdori, dhe për këtë ka meritë, për të vendosë rendin e qetësinë, pas shregullimëve të mëdha që kishte shkaktue Lufta e Madhe. Kjo i shërbente me forcue edhe pozitën e tij në hypjen e shkallës së pushtetit deri në krye të vendit. Këtë synim ta kishte imponue vetvetës, dhe bani çmos që ta realizonte. E kemi thanë se si im atë e kishte psikollogjisë qyshë në Vjenë, se Zogu ishte i vetbindun se do të ndikonte në politikën shqitare dhe se do të zinte pozita të rralta. Një lloj ambicje që e shtynte të përdorë çdo lloj mjeti për të arrit qëllimin. Ai s'e kishte lexue Makiavelin as s'e dinte se kush ishte, por faktikisht ndoqi atë parimin e tij kryesor: Qellimi justifikon mjetin. Ishte një kohë kur mungonte stabiliteti prej mosfunksionimit të shtetit shqiptar pas shpalljës së Pavarësisë, ku qeveria e Ismail Qemalit u detyrue të binte dhe të zevendesohej nga një qeveri e Durrësit, me Princ Vidin, dhe pastaj me Esad Pashën. Ky, pas largimit të Vidit, donte me ia zanë vendin si princ ose mbret. Dhe ishte i

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MIRIM BARLETI"
SHKODËR (2018)

gatshëm të shiste gjysmën e Shqipnisë për principatën e Topijajve për të cilën andrronte dhe i luente të gjithë gurët. Ai për këtë qëllim do të ia kishte shit shpirtin djallit për së gjalli, por nuk ia arriti, e mbeti me ia shit përsë vdekmi. Kongresi i Lushnjës u dha fund këtyne allishvërishëve dhe i dha afirmim Ahmet Zogut si një burrë shteti i ri dhe i aftë me sundue. Për çdo ditë e ma tepër ai po imponohej si njeriu që do të merrte në dorë fatet e Shqipnisë dhe të Kombit. Parashikimet e tim etit dolën ma së të vërteta.



Major Preng Jaku mes dy kapitenëve Lek Margjini e Prenk Pervizi, kolegë e miq të pandamë, që shuan rebelimin e Miridit, 1921

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Komandant operacionesh

Duhej patjetër të bahej çarmatimi i vendit. Prenk Pervizi iu besuen zonat veriore, Kruja, Kurbini, Mati, Kthella e Dibra. Këtë detyrë ai e kreu me nder. Këto zona u pastruen nga armët me marrëveshje e mirëkuptim, e ku e lypte puna edhe me ushtrimin e forcës.

Te merret vesh mire, se nuk pati dhunë e pushkatime. Nuk u dogjën shtëpi as u burgosën e internuen njerëz e familje. Ndryshe nga si do të vepronte regjimimi komunist që do të zbatonte terrorin total, me zjarr e hekur, pa mëshirë, në çdo krahinë, duke djegë, pushkatue, burgosë e intennue, jo me qindra por me mija të pafajshmë, të gjithë viktima të një genocidi kriminal te paparë në historinë e Shqipnisë. Dhe kanë pasë turpin të paraqitën si "çlirimtarë", duke pas ba krime ma të shumta e të shëmtueme se pushtuesit e huej.

E kemi fjalën për historinë moderne. Se sa për historinë e vjetër, nën pushtimin turk, masakrat i tejkalonin përmasat njerëzore, ku me kokat e shqiptarve ngrihëshin piramida.

Emni i Prenk Pervizit sa vinte e fitonte respekt e afirmim. Një ndër operacionet ma të randësishëm ishte ai i Dibrës, ku i takoi me shkue për herë të parë. Dibranët u treguen të arësyeshëm dhe i dorëzuen në përgjithësi armët pa incidente. Dibranët e pritën shumë mirë komadantin e ri. Im atë pati rastin të njihej e të miqësohej me parinë e Dibres : Dinejt, Kaloshët, Demajt, Ndreajt, Shehët, Sinajt, etjerë. Këtu i ndodhi një e papritun e pëlqyeshme, sepse mori vesh se një fis i randësishëm i Zerqanit mbante emnin e Pervizit. I ra puna me shkue në Zërqan, dhe i bani një vizitë asaj shpie, ku u prit me nderime e dashuni vllaznore. Ndërkohë që bisedonte në odën e madhe të miqve me burrat e shpisë, i paraqesin një plakë 100 vjeçe (jemi më 1921) me medjën esull, e cila nisi të tregoje historinë e fisit të vet, që e paskej pasun origjinen pikërisht nga Pervizajt e Skurajve. Prej atje kishin dalë në Dibër me mbiemnin Marku. Ma vonë ishin kthye në musulmanë. Pas shpalljës së Pavarësisë, ishin rikthye në mbiemin Pervizi. Plaka e cuditi Prenkën, sepse i tregoi historinë e Pervizit të Madh, fill e për pe, siç ai e kishte degjue kur ishte i ri, nga vetë Gjin Pjetri, nga nana e të tjerë pleq të Skurajt dhe të Kurbinit. I tregoi dhe për lëgjendën tjetër të pesë vllazënve me një moter që ishin shpëmda. Njeni nga ato vllaznit kishte ardhun në Dibër, nga ishte formue fisi i Pervizajve të Zerqanit, që u kthye musulman. Jemi në 1921 ngjarja e ndarjes kishte ndodhë 300 vjet ma përpara pra rreth vitit 1600, që përkonte me çka dinin pleqt e fisit. Fisi i Pervizit të Zerqanit ishte i nionun për veti shqiptare e patriotizëm. Miqësia me Prenk Pervizin u forcue me këtë lidhje të vjetër gjaku. Në kohnat e mavonshme, kur im atë ishte gjeneral e Ministër i

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR 2019

Mbrojtjës, dy vllaznit Mahmud e Bajazit Pervizi, u lidhën ngusht me të, në kuptimin e forcimit të lëvizjes së Bashkimit Kombëtar. Veçanërisht Bajaziti, pati kontakte e takime të vazhdueshme për këtë çështje me tim etin, duke marrë përsipër e duke krye detyra të randësishme.

Gjatë qëdrimit në Dibër, im atë u takue dhe me mikun e vjetër Elez Isuf Ndreun, që e priti mysafir në shpinë e tij. Ata kishin luftue së bashku për dëbimin e forcave serbe. Aty ia shtruen bisedëst duke kujtue luftimet kundër serbëve dhe shoqninë e miqësinë që kishin lidhun ndërmjet tyne dhe me komandantët e tjerë si Preng Jakun, Bajram Currin, Alush Agën e Lumës e të tjerë luftëtarë. Në një çast të caktuem Elez Isufi i drejtohet shprehimisht:

- Or kapidan Prenga, ti duhet të kalojsh me ne, or burrë, për me rrexue atë qeverinë e Tiranës ! Ti meriton grada e pozita ma të nalta, se ato që të kanë dhanë. Hiqmu atij Ahmet Zogun, se vallahi kurrë s'ke me ia pa hajrin as ti as vendi !

Im atë kishte hesht pak, dhe mbasi kishte thithë dy tri herë cigarën që kishte në dorë, i ishte përgjigj:

- Or Elez Isufi, kemi qenë, jemi dhe do të mbetemi miq… Kemi luftue së bashku me shporr serbët, për të forcue Shtetin e ri Shqiptar të sapo krijuem. Unë jam betue njëherë me i sherbye Atdheut e qeverisë ligjore që e drejton. Jam ushtarak e nuk merrem me politikë e partina e nuk kam si me e thye besën e dhanë. Prandaj or Elez Isufi, nuk luftoj as për grada as për pozita, por ta dijsh se aty ku jam aty qëndroj ! ... Miqësia mbetet miqësi e detyra, detyrë !

Elez lsufi kishte ndigjue me vemendje dhe kishte pohue me kokë se fjalët e kapidanit ishin me vend. Kishin vazhdue me biseda të tjera dhe ishin nda miqësisht. Miqësia me fisin e Ndreajve do të vazhdonte gjithë kohën e mavonshme, pavarësisht nga disa rrethana kur Elez Isufi dhe Prenk Pervizi do të gjendëshin ballë për ballë si kundërshtarë.

Në Dibër ai pati kontakte të shumta me parinë lokale duke u njohun me problemet e ndryshme të banorëve të asaj krahine. Ndryshe nga si do të vepronin komandantët komunistë të brigatave partizane, që do të digjnin, vrisnin, pushkatonin e burgosnin me qindra Dibranë, në operacionin e Prenk Pervizit nuk ngjau asnjë gja e tillë. As u dogj ndonjë shpi, as u pushkatue kush, as arrestue e burgosë, as u internuen familje. Ai bile gëzonte respektin dhe simpatinë e banorëve. Repartet ushtarake kishin zanë pika të caktueme e varëshin nga komanda qendrore, prej ku merrnin urdhnat operative. Ndodhi që një toger, komandant i një reparti afër Peshkopisë, të vinte në gjendje alarmi forcat e veta, mbasi i kishin raportue se dibranët, burra të armatosun me gra dhe fëmijë, po zbrisnin grupe grupe për në Peshkopi. Ishin dëgjue krisma pushkësh. Oficeri nxiton me e u paraqit te komandanti i operacionit, të cilit i raporton për çka po ndodhte. Im atë pasi e degjon raportin e oficerit, mendohet pakëz dhe pyet:

- Mor, ç'ditë asht sot ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Oficeri raportues i thotë

- Sot jemi me 14 mars, zotni kapiten !

- Kthej ushtarët në kazermë. Asht nata e Shën Gjergjit, festa ma e madhe e dibranëve. Sonte dhe nesër, le të qesin pushkë e le të bajnë qejf sa të duen ! Ka 500 vjet që e festojnë, qyshë në kohën e Skënderbeut ! Kjo tregon se si im atë i kushtonte kujdes njohjes së traditave e zakonëve të krahinave ku i takonte të zhvillonte operacionet ushtarake. Kjo thanje e tij u përhap dhe mbeti e ngulitun në mendjën e dibranëve. Pas 70 vjeteve unë e degjova edhe nga goja e një dibrani emigrant që takova në Paris më 1993.



Pështkopia në kohën e operacionit të Prenk Pervizit, 1921.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Lufta e Tiranës, 8 mars 1922

Mbas operacionit të Dibres, Prenk Pervizi ishte kthye në Shijak, ku ishte dislokue bataljoni i tij. Ndërkohë trazimet nuk pushonin. Opozita kërkonte me çdo kusht që të përmbyste situatën në favor të saj duke inkurajue një kryengritje për me rrexue qeverinë në fuqi. Kryeshist e kishin inatin me Ahmet Zogun, që ndonse ishte vetëm Ministër i Brendshëm, gezonte reputacion e influencë të madhe, si në qeveri ashtu në popull. Me thanë të drejtën të gjiithë e kuptonin se ai e kishte synimin me dale në krye të shtetit, në çdo formë qoftë. Ata që e përkrahnin mendonin se ia vlente me e mbështetë në këtë arritje, për të mirën e vendit. Që Shqipnia të fitonte stabilitet, vendosjën e rendit kudo, dhe hapjen e mundësive për zhvillimin ekonomik nepërmjet investimëve të hueja. Me t'ardhunat e brendëshme nuk realizohej asgja. Nga mund të dilnin t'ardhunat kur vendi ishte i katandisun në një prapambetje thue ishte në kohën e mesjetës ? Ndërsa kundërshtarët që formonin opozitën, ia dinin aftësitë imponuese e dominuese, e që ishte i pajisun me një inteligjencë të spikatun. Këto premisa i shqetësonin, se ishte një far vetbindje, ku ai me çdo kusht do ta mbante dhe ta naltësonte pozitën e tij për të arritë në krye të shtetit. Për këtë qëllim ai kishte afrue rreth vetes ushtarakët ma të aftë e të njohun, që gëzonin simpatinë e popullit dhe besimin e ushtrisë. Por këtu dilte dhe ana tjetër e medaljës. Edhe në vetë opozitën kishte oranizim të mirë. Ajo kishte afrue e ba për vete disa figura të njohuna si luftëtarë e patriotë, si Bajram Curiin e Elez Isufin, por të pashkolluem e analfabetë, që stononin me intelektualët që formonin udhheqjën e opozitës. Opozita ndiqte një vijë e program komunist, me fjalë të bukura shumë joshëse, për një barazi shoqnore e udhëhequn nga njerëz të dalun nga populli, e të tjera profka. Këta lidera popullor të veriut ranë në atë propagandë si miza në qull. Iu bashkangjitën opozitës qorrazi pa ditë se ku i çonte mushka. Në këtë kohë kishin ndodhë disa ndryshime, dy anëtarë të Regjencës, Aqif Pashë Biçaku dhe Monsignor Bumçi kishin dhanë dorëheqjen. Ishte formue nje ministri direktoriale e përbame nga sekretarë të përgjithshëm.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2019)



AHMET ZOGU



PRENK PERVIZI

Ahmet Zogu, ministër i brendshëm, dhe kapiten Prenk Pervizi, protagonistët kryesorë të dështimit të grushtit të shteiti të 8 marsit 1922, me shpartallimin e forcave rebele të cilat sulmuen pabesisht për të pushtue Parlamentin e rrexue qeverinë. Prenk Pervizi u gradue kap. Kl. I-rë për merita lufte dhe me medaljën e artë të trimnisë.

Një përçarje e madhe ishte krijue ne rrethet politike, ku secila palë kërkonte të merrte frenat e shtetit në dorë. Nga lufta parlamentare, opozita po bahej gati me kalue në luftë të armatosun. Edhe ne këto veprime, secili grup kërkonte t'i dilte zot punës ne mënyrë të pavarur për të kapë pushtetin e karrikën. Me nxitjen e Aqif Pashë Biçakut, Elez Isufi, lidhun me Halit Lleshin, Mustafa Krujën, Hamt Bej Toptanin (feudal rebel), Bajram Currin (i mashtruem), deshën të ngrejnë krye andej nga fillimi i marsit 1922. Prej tyne vetëm Elez Isufi mundi të arrije në Tiranë me forcat dibrane, afro 500 burra të armatosun. Në fillim të marsit 1922 sulmi u ba nga ana e Dajtit, ku rebelët u ndeshën në një njësi xhandarësh të komanduem nga major Meleq Frashëri. Krisi pushka dhe në atë përpjekje mbeti i vramë në krye të detyrës major trim, bashkë me disa xhandarë. Kjo goditje erdhi e papritun dhe nga frëziku. Këshilli i Naltë, Qeveria e Parlamenti u transferuen urgjentisht ne Elbasan. M 8 mars Brenda mureve të parlamentit kishte mbetë vetëm Ministri i Brendshëm Ahmet Zogu, me një grup nënoficerësh. Edhe ky në gatishmëni me u largue. Në ato çaste aq kritike aty kishte qëllue Prenk Pervizi, që kishte takim me Zogun. Kur u muer vesht se ç'po ndodhte, Prenk Pervizi ndërhyn dhe e siguron Zogun se ai e merrte përsipër të përballonte e të thyente sulmin e rebelëve, mjafton që të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

furnizohej me mitrolozë dhe municione. Mori gjysmën e nënoficerëve me dy mitrolozë e arkat me municione e shkoi e zuni vend te pusi i madh në fund të pazarit të vjetër, që ndodhej aty ku rruga e Dibres dilte te sheshi i sotëm Skënderbeg. E zgjodhi atë pozicion sepse e dinte se forcat e çregullta rebele do të sulmonin andej për të mësye parlamentin, duke kujtue se pas vrasjes së major Meleq Frashërit, nuk do të hasnin në ndonjë qendresë tjetër. Ishin informue se në Tiranë nuk kishte forca ushtarake, që ishin shpërda andej këndej. Pas pazarit të vjetër shtrihej fusha e zotit, ku bahej pazari i kafshëve dhe i druve. Gropore, ferra e kaçuba xunkthi. Disa rrafshina ku zhvillohej pazari dhe asgja tjetër. Kryengritësit, që nuk dyshonin asgja, u turrën me vrap për të dalë aty që t'i versulëshin parlamentit, por si thonë : Ndalu beg se ka hendek ! sa mbërritën nga fundi i rrugës së Dibrës, u gjetën nën rrebeshin e plumbave të mitrolozëve dhe u detyruen të strehohëshin pas mureve prej qerpiçi të banesave përdhese matanë rrugës. Nga doli kjo qëndresë ? Luftimi u ndez i furishëm, por mitrolozët të grinin dhe rebelët mbetën të gozhduem në vend e s'banin dot xhap !

Im atë e dinte se forcat e çregullta dibrane, me pushkë të çdo lloj marke e me nga një rryp përgjysmë me fishekë, nuk kishin ç'tu banin mitrolozëve që kormin edhe fijet e barit. Ata rrinin të strukun pas mureve prej çerpiçi e gjuenin qorrazi, sepse nuk guxonin të nxirmin kokën me marrë nishan. Elez Isufi që herë pas here shikonte me dylbi e kishte dallue e njohë Prenk Pervizin. Ku paskej qëllue bash ai burrë aty ? Nuk iu durue dhe i lëshoi za :

- Or kapidan Prenga, na liro rrugën bre burrë, t'i lajmë hesapet një herë e mirë me Ahmet Zogun me shokë. A e mban mend çka të kam thanë në Dibër ?... banu me ne, or burrë se nuk ndahesh keq...!

Im atë ia kisht kthye përgjigjen menjëherë :

- Ndigjo or Elez Isufi, të pata thanë se nuk e thej betimin që i kam dhanë atdheut e shtetit ligjor. Aty ku jam aty qëndroj !

Lufta u ndez ma e rrebtë. Tregon im atë për triminë dhe vetitë burrnore të Elez Isufit. Ndërsa luftimi vazhdonte pandërprerje, ai kishte dallue me anë të dylbive se si një dibranë ishte plagos në njenën faqe, të cilit si dukej i kishte mbet plumbi në gojë dhe i kishte thye dhambë e dhëmballë. Elezi kishte qëllue aty pranë. Luftëtari i kishte dalë përpara me gojën e hapun e tanë gjak. Shefi dibranë e kishte kap për kryet të plagosunin dhe i kishte shti gishtin në gojë duke i nxierrë plumbin e dhambët e thyem, pastaj duke ia vu pushkën ndër duer i kishte dhanë urdhën të vazhdonte luftimin. Dibrani ishte turr me zanë pozicion sikur s'kishte ndodhë asgja. Ka edhe të tilla sudina.

Kur ra mbramja dhe erresina e natës filloi të shtrihej, im atë u shmang drejt parlamenti, duke i porositë nënoficerët që të mos e ndalnin zjarrin, deri sa ai të kthehej me municione të tjera. Kur hyni brenda murit rrethues të parlamnetit, e dallon Ahmet Zogun që shetitte poshtë e nalt me nervozizëm

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

dhe i ngjeshun n'armë si cub. Tregon im atë se kur e kishte pa tue vrapue, Zogu krejt i alarmuem i kishte thirrë :

- Prenk !... Si asht puna....Mos mori fund gjithçka ?

- Jo mor burrë, asgja s'ka marrë fund... Po ti, pse je ngjesh kështu si cub? Ia kishte kthye im atë.

- E po… s'na ka mbet tjetër veçse me dalë në mal ! Kishte vazhdue Zogu ..

- S'kam ardh me mbath opingat, por për municione !

- Municione e armë kemi me bollek ! Ishte përgjigj Zogu, dhe u kishte dhanë urdhën nënoficerëve të vihëshin në dispozicion të kapitenit, për me çue arkat me municione te pusi.

Ky shkëmbim fjalësh asht vu këtu ashtu siç janë shkëmbye realisht në ato çaste dramatike, ashtu dhe gjithë veprimet siç jane tregue nga im atë dhe njerëzit që qëlluen aty në atë rrethana. Lufta e Tiranës asht nënfleftësue, ndërsa pasojat që do të rridhnin në rast të një suksesi të forcave rebele, do t'ishin katastrofike për Shqipninë, që do të gremisej në një destabilizim të rrezikshëm, drejt edhe coptimit të saj. Asht në këtë prizmë që duhej e duhet annalizue kjo luftë dhe me u radhitë në faqet e historisë. Të kapërcesh të tilla situata do të thotë të mos jeshë historian. Mbi këtë ngjarje asht spekulue duke ia ngjeshë Ahmet Zogut, ndërsa ai po bahej gati të braktiste Tiranën, po mos të kish qenë Prenk Pervizi që t'i dilte zot atij grusht shteti për të përmbys qeverinë e marrjën frenat e shtetit në dorë nga një grup injorantësh të udhëheqën nga injorantë. A e supozon i dashun lexues sikur shteti të binte në duert të atyn rebelëve dhe udhëheqësve të tyne analfabetë ? Nuk mjafton të jeshë patriot e luftëtar për çështjën e Atdheut, duhet të jeshë i pajisun edhe me dije e njohuri që vijnë nga arsimimi i naltë i atyne që duen ose marrin përsipër të drejtojnë një shtet. S'jemi në kohën e barbarisë. Po shprehëmi kështu sepse jo vetëm në këtë rast, por dhe në të tjerë, ngjarjet janë paraqitë ndryshe se si janë zhvillue ose u janë ngjesh përsonave që s'kan qënë përfshi në to. Prandaj në rastin konkret i gjithë shtjellimi i situatës që përshkruem mbështetet mbi fakte konkrete, për t'i dalë zot së vërtetës në aspektin ma real të saj. Edhe pjesa e mëposhtme që lidhet me këtë ngjarje asht anashkalue nga ata që kanë dashtë me i dhanë vlerë Ahmet Zogut, ku ka qenë vetëm si spektator në pritje të përfundimit të asaj beteje. Pra suksesi e dështimi ishte varun mbi shpatullat e Prenk Pervizit. Asht ma se e kuptueshme se në rast dështimi Zogu do të ishte largue në Elbasan, siç u larguen parlamenti e Qeveria. Por herët a vonë e vërteta del në shesh, dhe ky libër vlen për zbulimin e atyne të vërtetave që nuk janë thanë, në historinë e shqiptarve. Në qoftë se ky libër trajton jetën e veprimtarinë e t'im etit, nuk asht për të thanë se sa burrë i mirë ka qenë, por me tregue atë pjesë të historisë moderne të Shqipërisë që ai ka ndjekun në rol të randësishëm hap pas hapi. Jo si një individ i izoluem, por, siç botnisht dihej prej shqiptarve nga veriu në jug, krah për krah me Ahmet Zogun dhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

personalitetet e figurat e tjera historike të kohës. Në nuk do të rrimë duke radhitë emna varg e vistër siç bajnë disa për të tregue se po flasin të vërtetën ndërsa thurin gënjeshtra të pashije, duke deformue historinë deri në fallsifikim të saj.

Të rikthehëmi te ngjarja. Ndërkaq im atë e kishte sqarue Zogun për gjëndjen. Ai mund t'i bante ballë rebelëve deri sa të vinin forcat nga Shijaku, prandaj Zogu të mos shqetsohej sepse situatën e kishin në dorë. Në këto çaste ia kishte behun aty diplomati anglez H. Ayres, për të marrë njoftime mbi gjendjën e krijueme. Zogu në atë rast ia kishte paraqitë kapiten Prenk Pervizin , si njeriun që po i bante ballë situatës e që kishte gozhdue rebelët të pusi në fjalë. Anglezi kishte mbetun i befasuem nga temperamenti guximtar i kapiteni të ri dhe aq ma tepër ishte çuditë kur i ra me shkëmbye me të disa fjalë gjermanisht. Ai e kishte kuptue se kishte të bante me një ushtarak të përgatitun dhe t'aftë. Ayres kishte marrë përsipër me ndërhye si ndërmjetës paqtues. Ndërkaq lufta të pusi u ndez ma e rrebtë me ardhjen e municioneve te tjera. Tashma dibranët të bllokuen e të thyem u tërhoqën drejt Dajtit. Grushti shtetit kishte dështue.

Kështu u zhvilluen ngjarjet në atë ditë të 8 e 9 marsit 1922, jashtë shkresurinave që historianët kërkojnë si fakte. Sepse sipas tyne, ne kete rast, Prenk Pervizi duhet të kishte ba një proçes verbal ose vërtetim ku të shkruhej se si luftoi, se si foli me Zogun e me diplomatin anglez Ayres, se si....se si....të vulosun, të protokollosun e të arkivosun. Po ku ishin ato kondita në ato rrethana dramatike! Nuk thonë shyqyr që paskan ngelë do njerëz që i dinë t'i tregojnë për fill e për pè ?

Luftimi kishte zgjatun 16 orë pandërpremje, deri sa erdhen përforcimet nga Shijaku nën komandën e major Nëshat Kolonjës. Rebelët tashma ishin grumbullue rrazë Dajtit. Ndërkohë kishte ndërhyn H. Ayres i cili pati mundësi të vepronte e të ndikonte. Ai u ba ndërmjetës e u takue me Elez Isufin duke ia mbush mendjen me fjalë e me flori, që të tërhiqej prej andej e të kthehej në Sllovën e tij. Në këto bisedime kishte marrë pjesë edhe im atë, që kishte njohje e miqësi personale me Elez Isufin e dibranët e tjerë.

Në atë rast Elez Isufit, nuk kishte ndejtë pa e ngacmue:

- Si mor Preng, bash ti me qëllue aty ! T' na kishe hapë rrugë or burrë...!

Këto ngjarje ku ishte i përfshimë im atë, nuk u shkruen as u përmendën në sferat zyrtare, por për çudi i njihte e i përhapte populli. Pra jemi në një paraqitje të fakteve në dy aspekte. Nga ana zyrtare, çdo gja që shkruhet duhet t'i përgjigjet anës zyrtare dhe personazheve politike e meritare, të cilët janë ata që janë destinue të bajnë historionë. Kështu që vendoset një çenzurë e heshtun që eliminon çdo fakt bashkë me personazhin që e kryen, për të ia vesh një tjetri që s'ka ba asgja. Ose mos me u përmend emni fare. Njohja me H. Ayres dhe biseda qe im atë pat shkëmbye me të dhe shoqnimi në takim me Elez Isufin, nuk nxirret asgjëkundi, dhe vetë H. Ayres ka "meritën" mos me e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

përmendë emnin e tij për të ruejt marëdhanje sipërfaqore me Ahmet Zogun e rrethin e tij. H. Ayres me paturpësi gënjen kur shkruen se si Elez Isufi e Ahmet Zogu qënkan takue e i paskan shtrëngue dorën njeni tjetrit burrnisht. Krejtësish një sajim i paciptë për të iu servilos Zogut, dhe për me anashkalue meritat e asaj fitorëje nga kapiteni trim Prenk Pervizi, që i doli ballhaptas qendresës dhe shpartallimit të rebelëve dhe dështimit të grushti të shtetit, ndërsa Ministri Ahmet Zogu rrinte i ngujuem brenda murëve të parlamentit, ku priste përfundimin e atij luftimi. Qendresa doli e sukseshme me fitore, dhe i duhej të shijonte suksesin që i jepej pështqesh me fisnikëri të pashoqe, nga ai Prenk Pervizi, që i kishte qëndrue mik e besnik në çdo situatë. Kjo e luftës së Tiranës një nga ma të vështirat. Jetë a vdekje. Por si i thone, "kalova lumin.... Fan Noli vetë, do të shkruente se ajo kryengritje kishte dështue për meritë të një kapiteni trim, ishte fjala për Prenk Pervizin të cilit ia deformonte emnin, pa e ditun të saktin, i cili me një togë ushtarësh kishte shpartallue sulmin e 500 forcave kryengritëse dibrane, duke e dështue atë grusht shteti. Pra Fan Noli vetë i jep vlerë dhe shprehët me admirim për atë kapiten të ri që zgjidhi me trimni një krizë historike. Pavarësisht se s'i shkonte për shtat opozitës. Përfundimisht u muer vesh nga i gjithë populli se ishte pikërisht Prenk Pervizi që e kishte zgjidhë atë krizë të përmasave kombëtare, sepse në ato çaste rrezikohej jo vetëm stabiliteti i një qeverie, por vetë Shtetit, i posa krijuem. Serbët, Grekët e Italianët mezi prisnin rastin e shkakun për me ndërhy e me nda e coptue Shqipninë mes tyne. Ato rrinin si orla grabitçarë me u sul mbi prenë e lakmueme në rastin ma të parë që t'u paraqitej.

Im atë, që luejti rolin vendimtar për zgjidhjen e asaj krizës u rrit një gradë për merita lufte, nga kapiten i thjeshtë në kapiten i klasit I-rë. U nderue me medaljen e trimnisë e të tjera. Gjithashtu u graduen dhe u dekoruen nënoficerët trima. Ndër ta për t'u përmendun tre që kam njohun vetë : kushërini ynë, Llesh Nikoll Lleshi prej Skuraj, Selë Ymeri prej Shullazi e Gjin Noku prej Selitës Madhe. Të tjerët kishin qëllue skraparli. Im atë kishte një përshtypje të mirë për skraparlijtë dhe i çmonte, sepse i kishin dalë në çdo rast burra besnikë, trima e guximtarë. Ngjarja mori përpjestime legjendare në popull, që i thuri dhe kangë. Ja disa fragmente :

Mitrolozat kanë gjimue,
Tan Tirana asht trishtue.
Te një pus në fund t'pazarit
Po lufton zogu i shqiptarit.
Te një pus veç lufta nisi:
Kapidani Prenk Pervizi :
- Mor Elez ku don me shkue,
Nuk te laj ktu me kalue.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

……
Ahmet Zogu n'parlament
Mirë po flet e mirë kuvend :
- Prenk Perviz të qofsha falë,
Trim mbi trimat veç ke dalë !
Meriton nder e levdata,
Grada t'nalta e dekorata!"

Prenk Pervizit i jehoi nami në të gjithë votrat shqiptare dhe emni tij u ba i njohun në gjithë Shqipninë, veçanërisht në veri. Mjerisht në atë kohë nuk ekzistonte një shtyp i vertetë e ngjarjet e lajmet kalonin me fjalë, nga një gojë në tjetrën. Ma vonë, kur u stabilizue gjëndja dhe u krijue shtypi, disa gazetarë, shkrimtaruca e pseudohistorianë nuk i dhanë jehonë asaj çeshtje, që zgjidhi një krizë me pasoja të këqija të paparashikueshme. Servilizmi e konformizmi politik ua qorronte sytë, e duke pasë ujkun përpara, i shkonin pas gjurmëve. Në këtë rast meritat e mëdha i fitoi Ahmet Zogut, që në atë nëndor u ba Kryeministër. Por trazimet nuk kishin marrë fund. Prenk Pervizit iu desht të luftonte e të shpartallonte bandat e Hamit Toptanit, në Pezë, Shijak e përqark Tiranës, dhe grupe të tjera që orvatëshin me ngrit krye kundër Shtetit Shqiptar. Asokohë Këshilli e Naltë përbahej nga Refik Bej Toptani, Sotir Peci, Xhaferr Ypi dhe Gjon Çoba.

Këto përfundime nuk vijnë nga mendja ime, por nga rrëfimet i vetë prindit tim qe ishte përfshi në atë ngjarje, dhe i kishte dhanë një zgjidhje me qendresën te Pusi duke i detyrue rebelët me u largue nga Tirana e me u kthye nga kishin ardhë. Pra tentativa e grushtit të shtetit për rreximin e qeverisë ligjore në fuqi kishte dështue. Në këtë vështrim ndërhyrja e Ayres ishte vetëm me mbush xhepat e kryengritësve me napolona florini si shpërblim për mundimin që kishin pasë tue zbrit nga Dibra, me mendje të madhe dhe tue u kthye pa mend, por për fat të tyne me duert plot me napolona florini. Ec e jepi kuptim historisë shqiptare.(*) Nuk dihet pse kjo ngjarje asht trajtue dhe trajtohet si diçka sekondare, veç si kuriozitet. Po a nuk mendoi kush për pasojat që do të vinin po qe se rebelët të kishin pushtue parlamentin, përzanë ose vra Zogun ? Mos vallë Elez Isufi do bahej kreu i vendit, President apo queje si të duesh ? E të bante qeveri me dibranët e tij e me Bajram Currin gjeneral e ministër luftës, në mos kryeministër ? Vërtet dy patriotë të shquem, por ama krejt te pashkolluem, analfabetë e injorantë me patentë. Po Fan Noli, intelektual i lartë e mendje ndritur me shokë ku do ta gjenin vendin vallë ?*

Ngjarja merr e ka randësi vendimtare për vetë ekzistencën e shtetit shqiptar, sepse ajo do të shkatonte një krizë të tillë të madhe, nga e cila do të përfitonin fqinjët me u turr si bisha mbi vendin duke e coptue midis tyne. Për deri sa shqiptarët nuk dinë të ndërtojnë shtetin, e mermin ata përsipër për t'i qeverisë sipas ligjëve të tyne. Ky do t'ishte përfundimi i fitorës së rebelëve

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

në atë 8 mars 1922. Datë tepër e randësihme historike për fatet e Shqipnisë, ja me shpëtue ja me humbë njiherë e mirë !

Historianët ta kenë vath në vesh këtë ngjarje, me i dhanë randësinë e kuptimin e saktë. Historia e Shqipnisë duhet ta gjaje rrugën e saj, jo thjesht për këtë ngjarje për të cilën folëm, por për çdo ngjarje tjetër ku vihëshin e vihën në lojë faten Atdheut dhe të Kombit.


Prenk Pervizi zgijdhi një krizë nga ma te rrezikshmet kur sa kishin kalue dy vjet nga Kongresi i Lushnjës, ku u hodhën bazat e shtetit dhe u formue qeveria e parë ligjiore e Shqipnisë. A s'e mendojnë histotianë se ç'katastrofë do ti ndodhte Shqipnisë ne rastin e suksesit të atij grusht shteti?

(*) Për të tregue se si edhe figura të njohuna me emën e me pozita, nuk kanë turp ta ulin vetën me i fallsifikue ngjarjet. Po përmendim këtu Ekrem Bej Vlorën që në kujtimet e tij të botuara në Itali, duke folur pikërisht për luftën e Tiranës, ai jep, nga një anë, tregimin real të asaj ngjarje, ku Elez Isufi u bllokue dhe u thye aty te Pusi i Madh, por me një kryezëm të maskuem dhe ligësi të papërmbajtun, ku atë luftë ia dedikon Osman Gazepit, në vend të Prenk Pervizit. Ç'e shtyni në këtë absurditet me genjye haptasi, sado burrë i mirë që ndahej ? Mos vallë edhe ana fetare sepse Prenk Pervizi si katolik cilësohej pas shpinë si "kaurr" ? Ky asht një shembëll se si fallsifikohën ngjarjet historike, ku dëshmia e dikujt me "miza në kokë", i mbushet mendja të trillojë, duke u mbeshtetun mbi reputacionin qe ka fitue ose trashëgue si bej turkoshak, që nuk e honeps zotësinë e lavdinë e një "kaurri", dhe prandaj I've vizë për ta zevendësue me një të sektit tij. Osman Gazepi ishte një oficer kreshnik, por burrë trim. Mik i ngushtë i Prenk Pervizit, Por pikërsiht më 8 mars, në atë çaste kritike nuk ishte fare ne Titanë. Vetë Osmani kur i ka rastisë e ka lëvdue botnisht Prenk Pervizin për atë luftë të Tiranës, duke ia ngritë në qiell meritat. Historia e Shqipnisë, pra, nuk mund të shkruhët me hamendje ose me ndikime sektare e klanore. Ekrem bej Vlora qëndrë i ndërruar për punë të tjera, por këtu ka gabuar rëndë.

BIBLOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Fotograf e vjetër, ku rruga e Dibrës dilte në seshin para xhamisë, ku u zhvillua beteja kundër grushtit shtetit që dòshtoi me shpartallimin e forcave rebele nga kapiteni Prenk Pervizi, më 8 mars 1922.



Tirana e vjetër më 1922

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Një kurthë e pabesë

Në vazhdim të operacionëve ai arriti në Kthellë, ku u gjet ballë për ballë me një repart të xhandarmërisë nën komandën e oficerit kreshnik P.M. që kishte marrë anën e opozitës. Opozita kishte dëpërtue edhe në krahinat veriore dhe kishte arritë me ba për vete disa oficerë kreshnikë. Një nga këto ishte kapiteni P.M. i këthellas nga një shpi e mirë. Ky kishte një lidhje miqsore me Prenk Pervizin, i cili kishte për grue një mbesë të tij. Kapiteni në fjalë, duke dashtë ta joshte prindin tim me u bashkue me opozitën, e thërret në një takim vetëm për vetëm, në një vend të caktuem. Tashti, ndonse miq, ishin kundërshtarë. Im atë që e njihte dhe kishte pasë gjithmonë marëdhanje të mira me të, dhe duke e respektu si ma i moshuem, pranon të shkonte në atë takim, dhe i hipën kalit të tij qimekuq dhe si njeri i besës dhe i fjalës, niset fillikat e vetëm sipas marrëveshjes.

Adjutanti i tij, toger Preng Mark Perzefi, i kishte thane që të mos shkonte ashtu vetëm, sepse mund t'ishte një kurthë. Im atë i ishte përgjigjë që P.M-në e njihte mire dhe e kishte mik e nuk besonte se mund ta tradhtonte. Por disa udhëzime të rastit ia kishte lanë adjutantit besnik e trim, që të rrinte në gatishmëni dhe të caktonte një njeri që të ndiqte takimin fshehurazi. Në qoftë se do të ndiente krisma armësh ose zbuluesi e njoftonte për rrëzik, të ndërhynte menjëherë. Im atë njihej për nga trimnia, por kjo po i tejkalonte përmasat dhe ai po shkonte me u fut drejt e në strofkën e ujkut... Kur mbrriti te vendi i caktuem, u gjet përballë një toge xhandarësh t'armatosun. Komandanti tyne qëndronte disa hapa përpara. I kishin ngrehun pabesisht një kurthë. Si me ia ba ? Ai mbante vetëm nagantin në brez. Nuk e dha veten dhe zbriti nga kali e qendroi disa hapa larg kundështarit, të cilit i foli me ton t'ashpër:

- Nuk i kishim fjalët kështu !... A e lamë me u takue vetëm për vetëm ?... Por nejse ... çka kishe me më thanë ?

Komandanti kundërshtar, ishte përgjigjë me një buzëqeshje ironike:

- Or Prenk, po na jemi jo vetëm kolegë por kryesish miq ! Prandaj mund të merremi vesh kollaj. Kalo n'anën tonë, sa nuk asht vonë !... N'daç me vazhdue karrierën si oficer e me fitue grada ma të nalta me shkollat që ke mbaruue …. Së shpejti na e marrin pushtetin në dorë e do t'i qërojmë hesap me Ahmet Zogun e kompani... Nuk ka rrugdalje tjetër... Ja bani me ne, ja...

Pezullimi i frazës linte me kuptue punë të këqija. Im atë nuk i kishte kthye fjalë, sepse ishte para një rreziku të madh. Për të shpetue nga gracka që i kishin ngrehun vendosi të përdorë befasinë. Vendroi rrufeshëm, duke nxierrë nagantin dhe duke ua drejtue anmiqve:

- Mos lueni vendit ! Kishte thirrë, i parë që leviz e pret plumbi në ballë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

Ndërkaq i ishte afrue kalit.

- Ndigjo or P.M., nuk e kam prit prej teje këtë pabesi. Vërtet që jemi miq, por jemi dhe oficerë të Shtetit Shqiptar, të cilit i jemi betue me i ndejtë besnikë ... Unë i shërbej atdheut të c ilit i jam betue... Ti paske vendosë me i ra hasha betimit e atdheut. Paq veten në qafë !

Duke i thanë këto fjalë e duke qitë dy herë mbi kokat e kundështarëve, kishte hyp me shpejtësi kalit, i cili ia kishte dhanë revanit me të katrat, sikur ta kishte kuptue rrezikun. Nuk thonë kot se kali asht nje nga besniket ma të mëdhej të njeriut. Kundërshtarët kishin mbetun shtang nga ai veprim i rrufeshëm e tepër i guximshëm. Sa e kishte marrë veten nga ai veprim i papritun, komandanti anmik kishte vikat me të madhe :

- Bini bre se na iku !... Dhe e kishte shprazë revolverin e tij njeherësh. Fill mbas tij e kishte vu pushkën për faqe e kishte gjuejtë rreshteri Dod Gjok Marku, e pas tij të tjerët. E çuditëshmja asht se këta ushtarë, mirditas e kthellas, kishin shërbye edhe nën t'im atë dhe e njihnin deri edhe përsonalisht. Plumbat i kishin kalue anash e mbi krye, duke ia shpue në dy tre vende fletët e xhaketës. Ai ishte shtri i tani mbi kalë. Një plumb e kishte godit kalin në njenën kambë të prasme, por kafsha besnike nuk e kishte ndalue vrapin deri sa ishte zhdukë pas disa pemëve. Ndërkohë, toger Preng Marku, që ishte njoftue nga zbuluesi dhe ndigjoi krismat e armëve, kishte msy përpara me ushtarët e tij duke shprazë armët n'ajër, për t'u shti frikën kundërshtarve. Këta ishin tërhequn dhe ishin bashkue me forcat e tjera. Im at sa mbrriti te bataljoni, dha urdhnat përkatëse dhe me një manovrim të shpejtë e duke njohun mirë terrenin, filloi t'i rrethojë anmiqtë, të cilët shpejtuen të largohën. Kështu im atë i la të shkonin forcat kundërshtare, për të mos shkaktue gjakderdhje të kotë. Por ma vonë, kur u ba zonë-komandant, rreshter Dod Gjokën që kishte zbatue menjëherë urdhnin e komandantit të vet me gjuejt mbi të, e kishte marrë në shërbim me gradën kapter, si njeri besnik dhe trim dhe zbatues i urdhnave të eprorit. Kjo sjellje për t'i vlerësue njerëzit për nga besa, zotësia e trimina ia shtonin admirimin e simpatinë në radhët e ushtrisë dhe popullit.

Kalin që i shpëtoi jetën, ai e mbajti gjithmonë duke dhanë urdhën që të trajtohej mirë, deri kur kafsha fisnike i sosi ditët e veta. Unë nuk arrita ta shoh atë kale. Vllazni e mi po, jo vetëm ta shihnin, por edhe të shëtisnin kaluer tij.

Ma vonë ai do të takohej përsëri me atë kapitenin , që e kishin marrë përsëri në shërbim pas afatit prej 10 ditësh që kishte lëshue Presidenti Zog për kuadrot ushtarake e civile fanolistë që të kthehëshin në shtepitë e postët e tyne pa pesue asgja. Krejt ndryshe nga si do të veproninkomunistët kur hypën në fuqi, që ato kuadro ushtrakë (gjoja kundërshtarë) i pushkatuen, burgosën e internuen pa meshirë, ku një pjesë e mirë e tyne ishin akademistë.

Nga ana tjetër më familjën e atij oficerit, që kishte dalë edhe në pension, dhe kishte 5 djem e nja dy-tri vajza, që siç thamë, ishte dajë i së

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

shoqës, nuk mbajti inat. Duke e njohun mirë gjëndjën e keqe ekonomike të tij, përkundrazi, ndërhyni me kompenecat e tij dhe djalin e dytë ia çoi me mbarue akademinë ushtarake në Itali, prej ku doli oficer, dhe djemt e tjere në shkolla, dy prej tyne në Normalën e Elbasanit. Një tjetër e kishte marrë në trup rojën e tij me gradën rreshter. Kurse djalin e madh ia siguroi me punë si kryetar komune. Kjo nuk asht një histori e kotë, sepse unë përsonalisht i kam njohun gjithë përsonat e asaj familje, qe përmatëpër ishin dajat e mamës, pra, sipas traditës shqiptar, edhe daja e kushërij tonë. Djali oficer akademist me emnin Mark; pat hy në Gardën Mbretnore. Arriti gradën major dhe u ba kohët e fundit adjutant i t'i etit. Diktatura e burgosi 10 vjet. Jetoi gjatë deri në moshën 84 vjeç.

Tregimi i mësipërm, pavarësiht nga fakti që paraqet një rrezik që përballoi im atë, nga ana tjetër vlen për me tregue shpirtin shqiptar të tij, që nuk përdori autoritetin që kishte për t'u hakmarrë, por në të kundërtën i erdhi në ndihmë asaj familje, ku kapiteni P.M., ndonse me vonesë, e kishte kuptue se në lidhje me tim atin kishte gabue randë. Njëkophësisht
ngjarja jep me kuptue për çarjën që ishte shkaktue në shoqninë shqiptare
nga kundërvenja politike, ku kryesisht ajo,që quhej opozitë kërkonte me çdo kusht me marrë pushtein. Në këtë përpjekje kishte joshun e ba për vete disa ushtarakë të paformuem. Rasti i masipërm tregon se kjo përçarje kishte hy edhe në rrethe miqsore deri dhe familjare. Fatkeqësi e madhe për një popull kur përfshihët nga sherri dhe armiqësia, që u errësojnë sytë e medjën.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)




Prenk Pervizi, Kapiten i Kl. I-rë, Shkodër 1923.
(Në Fototekën Marubi, Previzi Prenk)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

24 qërshor - 24 dhjetor 1924.

Ndërkohë gjendja ishte keqësue. Forcat opozitare ishin fuqizue e po përgatitëshin me sulmue Tiranën e me rrëzue qeverinë e Ahmet Zogut. Anëtarët e Këshillit të Naltë kishin dhanë dorëheqjen. Opozita duke marrë shkak nga vrasja e Avni Rustemit, që u paraqit si e urdhnueme nga Ahmet Zogut, si hamarrje ndaj vrasjës së dajës Esat Toptanit, kushëri i nanës tij. Duke përfitue nga situata e ndeme dhe shpërndarja e forcave qeveritare dhe shregullimi i institucionëve, opozita vendosi të veprojë. Disa reparte ushtarake nën komandën e disa oficerëve renegatë, sulmuen në befasi Tiranën, nga jugu dhe nga veriu. Më 10 Qërshor 1924, Ahmet Zogu me gjithë qeverinë dhe rrethin e ngushtë të besnikëve te vet, ushtarakë e civilë, kaloi në Dibër, për me dalë në Jugosllavi. Kjo iu mundësue nga kunati, Ceno Beg Kryeziu, që kishte marrëdhanje të mira me autoritetet jugosllave, ku i ecte fjala e puna. Ndërkaq më 24 qëshori 1924 në Tiranë u vendos qeveria opozitare që u quejt Fanoliste, nga që opozita e kishte thirrë Fan Nolin nga Amerika për ta vu në krye të saj. Një të ardhun në fuqi, për çudi të çudive rolin e regjëncës prej katër vetësh, që ishin dorëhequn, e kishte marrë vetë kryeministri Fan Noli, pa u zgjedh e pa u emnue prej askujt. Dashje pa dashnje kjo punë po merrte formën e një diktature të tipit komunist. Jo më kot një gazetar i huej e quejti Nolin "pështkopi i kuq". Se si rrodhën ngjarjet, tashma dihet. Ai ishte nje grusht shteti i mirëfilltë, dhe jo revlucion demokratik. Prandaj qeveria fanoliste dështoi e nuk u njoh nga Lidhja e Kombëve as prej asnjë shteti, përveç Bashkimit Sovjetik, me të cilin po donte me vendosë maredhanjet diplomatike. Parlamenti kishte mbajtë një minut zi me flamurin kombëtar në gjysmë shtize për vdekjen e Leninit. Noli ngjalli kështu një zemërim të madh si brenda ashtu jashtë vendit. Veprime që alarmonin Evropën për krijimin e një çerdhëje bolshevike mes mbretnive ballkanike e mes Evropës, prandaj nuk e njohën atë qeveri. Prej këtij rreziku kërcënues ishin kryesisht Anglia dhe Franca që e përkrahën rikthimin e Zogut në Shqipni si përfaqësues e kryetar i një qeverie ligjore, anëtare e Lidhjes së Kombëve. Ky fol iu bësue Jugosllavisë. Gjithë këto allishverishe bahëshin pën rrogozë e paraqiteshin ndryshe para opinionit. Jugosllavia ishte e interesueme për një Shqipni që të bante politikën e saj. Jo vetëm që e pranoi Zogun por e lejoi që të organizohej ushtarakisht, duke e mbeshtetun edhe financiarisht e me armatime. Kështu Zogu, krijoi Komandën e operacionit ndërhyrës. Ai kishte grumbullue rreth vetes oficerët ma të mirë te ushtrisë e xhandarmërisë me të cilët formoi shtabin e ngushtë ushtarak të kryesuem prej tij me kapitenët

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



FAN NOLI



AHMET ZOGU

Dy burra shteti që duhej të merrëshin vesh për të mirën e popullit e të Kombit shqiptar. Megjithëse iu kundër vunë njeni tjerit, sëfundi u paqtuan. Eshtë meritë e MbretiT Zog, kujdesi e respekti që tregoi ma vonë ndaj Peshkopit të nderuar, i cili e ngrysi jetën në Amerilë.Fotot i përgjigjen kohës së luftës politike midis tyre kur të dy ishin kryeministra.

: Prenk Pervizi, Muharrem Bajraktari, Fiqri Dine, Hysni Dema, dhe oficerë të tjerë të njohun, si Selaudin Blloshmi, Ceno Beg Kryeziu, Llesh Topallaj, Zef Serreqi, Gjon Derani, Ahmet Sata, Luigj Berisha, Osman Gazepi, Gjon Fusha, Hysen Selmani, Xhemal Aranitasi, Ali Erebara, e të tjerë.

Në i kishim në shpi fotografitë e kohës së qenrdmit në Belgrad, ku në njënën ishte Zogu me të katër kapitenët që përmendëm, me të cilët kishte formue shtabin e tij të ngushtë.

U krijue një situatë e keqe për përkrahësit e familjet e tyne. Ato duhet të internoheshin, t'u digjeshin shtëpitë dhe t'u konfiskoheshin pasunitë, sipas sistemit bolshevik sovjetik. Fan Noli vetë e kishte shfaq këtë mendim, nën ndikimin e masave të qeverisë bolshevike të Rusisë. Familjes sonë iu desh me u fshehë : gjyshja pranë vllaut në Bulgër ; mama në Skuraj me dy fëmijë, njeni katër tjetri dy vjeç. Forcat fanoliste ishin ngjit në Skuraj me befasi. Mamës iu desh me u largue shpejt e shpejt e me u strehue pranë një familje mike me gjithë fëmijët. Fanolistët kontrolluen të tre kullat e Gjin Pjetrit, ku njena ishte e Prenk Pervizit, të cilën e gjetën bosh, pa njeri brenda. Ata kishin urdhën për ta djegun, por komandanti që njihej me t'im etin si koleg e si mik, me pretkstin se mund të digjëshin edhe dy shtëpitë e tjera e i lëzulloi atë veprim. Ai u mjaftue me marrjen e një sqap nga bagëtitë e Prenk Pervizit, i cili u poq në hell për të ushqye ushtarët. Pasi hangrën, forcat ndëshkuese u larguen.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Mama u kthye me dy vllaznit e mi. Edhe gjyshja u bashkue me to. Me këtë përshkrim, kuptohet se si ishte krijue një përçarje e pa nevojshme mes shqiptarve, nga forcat politike që nuk zbatonin një politikë kombëtare të afrimit, por kishin zgjedhun një ideologji të huej, nga ma të mbrapshtat, siç ishte ideologjija komuniste, për të ia imponue vendit. Disa dekada ma vonë ajo ideologji bolshevike do të shkaktonte fatkeqësi të kobshme në Shqipni, me njerëz të tjerë që i kishinn humbun vetitë e virtytet të traditave ma të mira shqiptare. Ku me djeg shpija, vra, burgosë e internue ishte një "zbavitje" sadiste të një kategorie njerëzish arrivistë, të pa skrupuj, siç ishin komunistët shqiptarë të lidhun pas qerrës së Moskës e Belgradit.

Ndryshe do të vepronin ma vonë komunistët ndaj familjës sonë e fisit nga shkaku i Gjeneral Prenk Pervizit, i cilësuem armik nr.1 i regjimit. Do të digjnin shtëpinë tonë në Laç dhe tre kullat e Gjin Pjetri në Skuraj ku njena ishte jona.Do të grabisnin pasuninë, gjanë e gjallë e çtë gjenin. Do të konfiskonin pronat. Do të vrisnin, pushkatonin, burgosnin burrat e të internonin familjet, pleq gra e fëmijë. Jo për ndonjë vit, por për gjithë periudhën 46 vjeçare, me një varg viktimash që arrijnë në 23 vetë dhe dënime prej 700 vjet, shtatë shekuj. Do të vijmë ma vonë në këtë problem, por e pamë t'arësyeshme të bajmë një krahasim me kohën e Fan Nolit dhe asaj të diktaturës që mburrej me emnin e tij.

Fan Noli, që ishte një figurë shumë e shqueme intelektuale e pajisun me një kulturë enciklopedike : shkrimtar, poet, historian, publiçist, përkthyes i madh, deri dhe kritik arti dhe muzikant, nuk ishte aspak burrë shteti, as politikan as diplomat, e ra në kurthën e rretheve filo - komuniste simpatizues të Bashkimit Sovjetik. Lene pastaj që ai kishte shkue edhe në Moskë ku ishte ushqye me ideologjinë marksiste, aq sa me e perkrahë atë ideologji dhe me e zbatue në Shqipni. Jo më kot u quejt, siç e thamë, "Pështkopi i kuq". Ky qëndrim i gabuem doli sheshit, siç e thamë, me mbajtjen e zisë mes parlamentit e vendosjen e flamurit në gjysmë shtize për vdekjen e Leninin dhe me lidhjen e marrëdhanjeve diplomatike me Rusinë bolshevike. Ky qe akti që çoj në dështimin e atij që u quejt gabimisht «revolucion demokrat » ndërsa nuk ishte tjetër veçse një grusht shteti i mirëfilltë !

Këto ngjarje i dhanë krah Zogut që t'imponohej e të zgjidhej si njeriu e përsonaliteti ma i përshtatshëm për të sundue mbi Shqipninë e shqiptarët. Qyshë në Belgrad u hodh teza e mundësisë së krijimit të një lloj principate apo mbretnie, që t'u konformohej mbretnive ballkanike dhe evropiane. Evropa kërkonte të garantohej nga infiltrimi i komunizmit, e tjetër rrugë zgjidhje nuk kishte. Për një republikë as që bahej fjalë. Shqiptarët le ta zgjidhnin apo ta krijonin një "dinasti" princore ose mbretnore, edhe pse pa gjak blu, e rrethanat u shtjelluen të tilla sa që zgjidhja të bahej me anën e Ahmet Zogut. Këtij i ra zogu në dorë dhe nuk e la që i ikt.

Operacioni i ndërhyemjës nisi me 15 shtator nga Dibra. Zogu kaloi aty

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

i mbeshtetun nga dy kapitent Fiqri Dine dhe Hysni Dema, ku hasën në qëndresën e Elez Isufit i zanun në befasi, i cili u vra në ato luftime. Kjo hapi rrugën të marshimit mbi Tiranën. Kurse në Jug, nga Greqia, u nisen Koço Kota e Myfit Libohova, të cilët me forcat e tyne e morën Korçën. Muharrem Bajraktari kishte marrë nën kontroll Tropojën, Lumën e Kukësin.

Im atë arriti fshehurazi në Skuraj, me 18 dhjetor 1924, prej ku lëshoi kushtrimin dhe brenda tre ditësh rreth tij u grumbulluen të gjithë njerëzit që kishin shërbye me të, të armatosun, sepse nuk i kishin dorëzue armët. Bashkë me kapiten Gjon Fushën që vepronte në malësinë e Lezhës, e togerin Prenk Marka Perzefin, adjutanti i tij, e të tjerë oficerë, brenda tre ditëve e shtinë në dorë gjithë zonën nga Lezha në Tiranë. Para veprimit të rrufeshëm të tyne, forcat fanoliste u zhdukën si gjethet kur i merr era, dhe kryeqyteti u çlirue pa pushkë të shtime. Parlamenti dhe institucionet e tjera qeveritare ishin boshatisë nga fanolistët, që nga frika, disa kishin ikun në mal të tjetë jashtë shtetit. Pas vrasjes se Elez Isufit, Zogut iu hap rruga për në Tiranë, qe e gjeti të çlirueme e ku u prit me lule, sepse forcat e tim etit e kishin ba punën e vet. Kryeqyteti ishte nën kontrollin e tij. Kjo vërtetohet nga fakti, se Ahmet Zogu e emnoi menjëherë zonë-komandant të qendrës (Tiranës). Nuk ka asnjë dyshim se im atë kishte lidhje të ngushta përsonale me Zogun. Aq sa ishte krijue opinioni në mbar populli se ai ishte krahu i djathtë i Zogut. Edhe sot e kësaj dite po ta përmendësh emnin e tij në krahinat veriore, gjen përgjigjen se emni i Prenk Pervizit ishte i pandamë prej atij të Ahmet Zogut.

Duhet pasë parasyshë se ngjarjet e rrethanat që lidhnin Prenk Pervizin me Zogun, i përkisnin mbrotjës e forcimit të atdheut dhe afirmimit të Shtetit Shqiptar. Im atë me oficerë të tjerë që kishin pozita drejtuese e komanduese në ushtri, kishin deklarue se ushtria mbetej e pavarun dhe përgjigjej vetëm për mbrojtjen e sigurimin e vendit. Njëkohësisht njihnin qeverinë e ligjëshme që e drejtonte shtetin si të vetmen të përshtatshme dhe Ahmet Zogun si njerinn ma t' aftë për të drejtue vendin. Prandaj ata e përkrahën dhe ia njohën autoritetin Zogut për të mirën e vendit e të çështjes kombëtare. Sigurisht se ata e kishin lidhë një marrëveshje me Zogun, së cilës ishin zotue t'i qëndronin reciprokisht besnikë. Baza e kësaj marrëveshje, mjerisht gojore, ishte përspektiva e ardhme për një Shqipni etnike dhe për reforma ekonomike në favor të fshatarsisë, siç mund ishte një reformë agrare në pjesën e tokave shtetnore. Heqja e disa priviliegjeve të bejlerëve dhe rishikimi i pronave tepër të medha të tyne, të përfitueme jo si trashëgim familjar por si shpërblim i qeverisë turke ndaj shërbimëve në favor të Stambollit. Një tjetër konditë ishte ajo e ngritjes së nivelit drejtues e organizues të ushtrisë e xhandarmërisë, me kuadro të afta që do të formohëshin në shkollat dhe akademitë ushtarake europiane, kryesisht të Italisë, Francës e Austrisë. Në Shqipni do të rigrihëshin kurse ose shkolla plotsimi për oficerë e nënoficerë të drejtuem nga oficerë akademistë. U thirrën keshilltarë ushtarakë të huej, anglezë, hollandezë dhe dy oficerë të shquem

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

austriakë, Gustav Mirdhashi dhe Hermann Von Kishner të njohun që në periudhën e Vjenës nga im atë dhe Zogu. Në këto reforma hynte dhe përsosja e nivelit të administratës shtetnore, për të cilën do të përgatitëshin kuadro brenda e jashtë shtetit. Mbështetja që im atë me kolegë i dhanë Ahmet Zogut ishte e sinqertë dhe pa pretendime e interesa vetjake. Por të respektimit e njohjës së aftësive të tyne dhe të kontributit që kishin dhanë, që ishin premisa të mundësisë që të ngrihëshin në pozita te nalta shtetnore. Ata nuk e njihni servilizmin, lajkat, kodoshlleqët, intrigat e prapaskenat. Për këto kishte njerëz të tjerë që i vinin rrotull Zogut. Sigurisht se nekuptohej se ata do te zini vende kyçe, të premtueme e parashikueme. Ahmet Zogu e dinte shumë mirë se vetëm me këta njerëz ai mund të arrinte të përmbushte e të realizonte planet e tij. Im atë njhej nga ushtria, populli dhe shoqnia shqiptare e asaj kohë, si mik e besnik i Zogut. Edhe këtu hynte dhe origjina fisnore e atyne burrave, dhe veçanërisht e Prenk Pervizit, që vinte nga një fis, i konsideruem fis e familje e vjetër të rangut fisnik, një ndër familjet katolike ma të përmenduna të veriut krah asaj të Gjomarkajve. Ahmet Zogu që ishte komshi me Kurbinin dhe Mirditën i dinte mirë ato punë dhe prandaj Prenk Pervizin e mbajti pranë dhe e vlerësoi gjithmonë, pavarësisht nga intrigat që oborrtarët kishin ajam të endnin për ta prishë atë lidhje e miqësi. Jagot e Rasputinët janë pjesë e pandarë e oborrëve princore e mbretnore, ku gjejnë fushë veprimi për prapaskenat dhe kurdisjet e tyne. Kështu që edhe në oborrin e vogël të mbretit shqiptar do të infiltrohëshin si gjarpij helmues.



Ushtria shqiptare 1924-1930

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Tirana më 1924-1929



Tirana 1934-1939

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Katër Zonë-komandantët e Shqpinisë, 1924-1929.



FIQRI DINE PRENK PERVIZI MUHARREM BAJRAKTARI HYSNI DEMA
Katër Zonë-komandantët e Shqpinisë, 1924-1929.

Oficeriu britanik Julian Amery do te shkruebte ne librin e tij
Sons of the Eagle, faqe 20

" ***Ishin Muharrem Bajraktari, Fiqri Dine, Prenk Pervizi e Xhemal Herri[1], që kishin ndjekun Zogun në Jugosllavi ata që luejtën një rol të randësishëm në revolucionin që ndodhi. Me kryerjen e detyrave që kishin, ata fituen influencë të madhe, por kur ata e plotësuen qëllimin e mbretit, Zogu ua theu fuqinë, e cila një ditë mund të rrezikonte dhe atë vetë. Në vend të tyne ai vuni njerëz të rij që tregohëshin ma të bindun ndaj dëshirave të tij sepse ishin ma të varun ndaj privilegjeve që ai u jepte. Keshtu brenda një periudhe prej pesë vjetësh diktatura mbretnore u ba absolute.***

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

1). Jo Xhemal Heri por Hysni Dema, gabim i Julian Amery (shiko foton). N/kolonel Xhemal Herri, shef i zyrës sekrete të Mbretit Zog, u vra në shtëpinë e tij në Krujë, nga vetë Abaz Kupi

Citati i mësipërm i Julian Amery e jep fare të qartë randësinë e kontributin e katër zonë-komandantëve, që brenda pesë vjetëve i dhanë shtetit shqiptar stabilitet të plotë, meritë e padisikutueshme e tyne për fuqizmin e afimimin e Zogut si President e Mbret. Një fakt fare i saktë e historik, që mjerisht historianët e molepsun e të çoroditun shqiptare e kan anashkalue e s'e kanë përfshi në faqet e veprave të tyne.

Faktikisht Ahmet Zogu, qyshë Kryeministër vendosi te organizojë vendin duke u mbeshtet mbi këto katër oficerë. Ai kishte ba një mbledhje të veçantë me ta, ku u kishte paraqitë e shpjegue planin e tij për ndamjën e Shqipnisë në katër zona administrative ushtarake, ku ata do të vendosëshin si zonë-komandantë në rol guvernatorësh ushtarakë të plotfuqishëm. Ata do të mbanin po ato grada si kapitena, duke qenë se asokohë grada kapiten lozte rol të madh në popull, në vështrimin "kapidan" udhëheqës luftëtarësh. Katër kapitenat që u quejtën zonë-komandantë siç dihet ishin : Prenk Pervizi, Muharrem Bajraktari, Fiqri Dine e Hysni Dema. Prenk Pervizi u caktue në Tiranë si Zonë komandant i Qendrës. Kapitenat e tjerë si zonë-komandantë të tri zonave të tjera : Muharrem Bajraktari në Veri-lindje; me qënder ne Krumë; Fiqri Dine në Veri-perëndim, me qëndër në Shkodër; Hysni Dema në Jug, me qendër në Vlorë. Për të sqarue lëxuesin ma mirë, përsa i përket gradave, Prenk Pervizi ishte një gradë para kolegëve si Kap. Kl. I, kurse tre të tjerët si kapitenë të thjeshtë, prandaj edhe ndryshimi i mavonshëm, kur Prenk Pervizi u ngrit në gjeneral dhe tre shokët në kolonelë. Ndërkaq, keto katër zonë-komandantë do të varïështi drejtpërsëdrejti nga Zogu e nuk do të merrnin urdhna prej askujt tjetër. Zogu kishte marrë në dorë gjithë drejtimin e vendit, ku qeveria kryente vetëm punë administrative. Vendimet i merrte ai vetë. S'ikishte Ministri të Mbrojtjës as komandë të përgjithshme të ushtrisë, ku këto detyra i mbante vetë. Prandaj kjo periudhë ishte e dominueme nga këto katër komandantë me Zogun në krye. Të mos e vlerësosh këtë periudhë do të thotë ta cungosh e fallsifikosh historinë e Shqipnisë.

Mbrenda një kohë të shkurtën ata vendosën kudo qetësinë, rendin, rregullin dhe banë të mundshme fillimin e investimeve dhe punimeve, së pari për ndërtimin e rrjetit rrugor e urat. Kjo ndërmarrje iu ngarkue një Shoqnie Italiane, "Ragazza", që mbrenda një kohë prej pesë vjetësh hapi e shtroi gjithë rrjetin rrugor nga veriu deri në jug. Filloi qarkullimi i njerëzve dhe i mallnave me një transport ma të shpejtë siç ishin makinat, që, për kënaqësinë e popullit, nisën të vrapojnë mbi rrugët e shtrueme me kalldrëm e çakull e mbi ura te bukura mbi gjithë lumejtë e Shqipnisë, ku ma e randësishmja ishte ajo mbi lumin Mat qe u quejt Ura e Zogut, që as diktatura komuniste nuk arriti të ia heqë emnin nga goja e nga mendja e popullit. Veprat e mira mbesin të pavdekshme. Shqipnia po dilte nga mbrapambetja 500 vjeçare të sundimit turk, kur nuk ekzistonte asgja : as rrugë, as urë, spitale, shkolla, posta, skele detare, as qytete, rrugë të shtrueme, kafe, klube e restorante, hotele, dyqane,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

vila e pallate, as kazerma, zyra, punishte, axhensi udhëtimi, banka e të tjera. Në qytetet kryesore u hoqën llampat, kandilat e bishtukët e vajgurit e u instaluen centrale elekrike me naftë ose qymyr që siguronin dritë ditë e natë, sigurisht vetëm në qytetet. Filluen të punojnë postelegrafat e telefonat....dhe të ndigjohej kudo zani i radios. U hapën sallat e para të kinemave. Unë vetë një çilimi, e mbaj mend kalimin e Tiranës, nga një fshat me kandila e bishtukë me vajguri në një qytet me dritë elektrike. Kjo për të tregue sa larg janë historianët nga njohja e gjendjës së një Shqipnie që kishte dalë nga një prapambetje te papërshkrueshme, dhe shkruejnë pa përgjegjësi profesionale duke shkel mbi kriteret e vërteta të rradhitjes së historisë. Lene pastaj se këtë përiudhë të sundimit të katër zonë-komandantëve, kyçe e vendimtare për Shqipninë, nuk e kanë pasqyrue as po e pasqyrojnë gjëkundi në "veprat" e tyne shpifarake as sot e kësaj dite që u çliruen nga diktatura komuniste. Por si duket ideologjia bolshevike ka zanë strofull në trunin e tyne.

Prandaj duhet të kuptohet drejt se të gjitha ato që përmendëm nuk mund të arrihëshin pa vendosjen e rendit të plotë në gjithë Shqipninë, që u arrit me asgjesimin e bandave kriminale që sulmonin karvanet tregtare, grabisnin udhëtarët e vidhnin bagëtitë e fshatarsisë fushore si dhe pa zhdukjen e rebelizmit politik, të asaj lufte për pushtet, që mbillte terror në popull. Prenk Pervizi pati patjetër një rol kryesor e të randësishëm, sepse iu caktue qendra, pra Kryeqyteti ma zonat përrreth. Mbrenda një kohë të shkurtën ai u imponue me autoritetin e tij, duke i dhanë fund shregullimeve që kishin lindun në zonat rreth kryeqytetit si pasojë e kundështimit ndaj qeverisë, prej disa bejlerëve, kryesisht prej Hamit Toptanit, që nuk e honepste fare Zogun e kishte mjaft ndikim në banorët e pronave të tij që përbanin disa fshatna perreth Tiranës. Bejlerët nuk donin të pranonin reformat e reja, që ua kufizonin ushtrimin e forcës e të dhunës ndaj fshatarëve që punonin si bujqë në pronat e tyne. Im atë kishte mbledhë pas vetes njerez besnike dhe guximtare, kurbinas e mirditore, ku spikasnin oficerët e rij, Preng Mark Perzefi, Gjin Noku, Ded Lufi, Pal Prendi, Frrok Gjok Meta, Preng Bardhoku, dhe nenoficerë trima si Llesh e Ndue Nikoll Lleshi, Sel Ymeri, Ded Gjok Syziu, Dervish Rama, Ndue Pal Gjini, Bib Brozi, Preng Nikoll Gjergji, etj. Me operacione të rrufeshme u dha fund shregullimeve të pasuesve të Hamit Toptanit me shoke. Në gjithë qarkun e Tiranës u vendos qetësi e plotë. Gjatë kohës së detyrës si zonë-komandant, im atë mbante lidhje telefonike speciale, drejt me pallatin dhe urdhnat i merrte vetëm nga Presidenti, e nuk i jepte llogari askujt tjetër. Ishte ne kontakt të vazhdueshëm me të dhe Zogu ia ndigjonte fjalën për çdo veprim që duhej ba dhe çdo masë që duhej marrë për mirëvajtjen e drejtimit e konsolidimit të shtetit. Ishte koha kur Zogu e kishte përqëndrue fuqinë e pushtetin në duert e veta, duke kapërcye hierarkinë ushtarake dhe atë të administratës civile. Prandaj roli i katër zonë-komandantëve që varëshin drejtpërsëdrejt nga Presidenti e ma vonë Mbreti, ishte i madh dhe i

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

jashtëzakonshëm. Por do të ndodhnin ngjarje të tjera të rrezikshme për Shtetin Shqiptar, ku im atë do të ishte i pazëvendshueshëm e vendimtar si gjithmonë.

Ndikimi dhe randësia e Prenk Pervizit ngrihej çdo ditë e ma tepër për konsideratat e mira ndaj tij, prej ish shokëve studentë të Vienës që ishin ngritun në pozita shtetnore, kështu që ai jetonte e vepronte ne një rreth shoqnor e miqsor të zgjedhun. Kjo afërsi me Zogun kuptohet nga letërkëmbimi që kishte me ish komandantin e mikun e tij, Major Preng Jaku, ku ky në një letër të viti 1921, i shkruente që të ndërhynte pranë Zogun për me ia fal jetën një far Llesh Gjok Lalës, nga Malibardhë i Kurbinit, i denuem me vdekje me varje, dhe për disa ndryshime në njerëzit e administratës së Lezhës, e te tjera kërkesa. Pra kuptohet qartë se Prenk Pervizi në atë periudhë kishte ndikim të madh te Zogu, dhe kjo ishte në dijeni të gjithëve dhe sidomos të kryeqytetit. Ndërkohë mama si grueja e tij, ishte në suitën zojave të oborrit mbretnor. E ama e Zogut, zoja Sadije, tashma Nana Mbretneshë, e donte dhe e afronte pranë vetës. Ajo e thërriste nusja e Prengës. Mama ishte e çlirueme nga bestutnitë e fanatizmat, dhe i peshonte fjala si grueja e Zonë komandantit. Kështu që Nana Mbretneshë bashkë me mamën dhe disa zoja t'emancipueme të shoqnisë kryeqytetëse si Sara Blloshmi, etjera gra, me iniciativën e vetë asaj e me aprovimin e të birit, Zogut, i cili i mbështeste këto nisma që i çlironin gratë shqiptare nga skllavnimi i zakoneve te tilla te mbrapambetuna e te hueja, siç ishte ferënxheja dhe burka, mbeturina të sundimit osman, që ua ndrydhnin grave me pahir lirinë e personalitetin e tyne. Kjo nismë e fushatë pati sukses dhe u përqafue menjeherë nga femnat shqiptare, duke fillue nga kryeqyeti. Në fakt Tirana dukej një qytet arab, ku femnat musulmane, nuk mund të dilnin me fytyrë të zbulueme as me veshje moderne, por ashtu të mbylluna në "burka" të zeza. Një ndër femnat e para musulmane që dhanë shembull, ishte vajza e Mehdi Frashërit, Sheriaj, e ndjekun nga vajza e femna të tjera musulmane. Brenda një kohë të shkurtën femnat shqiptare musulmane e fituen lirinë e tyne duke i braktisë ato veshje e mbulesa të fytyrës e të trupit, që ishin shfaqje të një prapambetje të huej anadollake e mesjetare të imponueme nga pushtuesi otoman e jo e racës as e karakterit të shqiptarit. E dhamë këtë ngjarje si një shembëll që tregon se Zogu donte ta shkëpushte vendin njëherë e mirë nga prapambetja ku e kishte katandisë sundimi turk.

Vjen pyetja, kur Zogu u rikthye në Shqipni më dhjetor 1924 dhe u ba President, pse e ndau Shqipnine ne kater zona, duke u vu në krye katër kapitenët e përmendun si zonë-komandantë ose guvernatorë ushtarakë të plotfuqishëm ? Patjetër se ata, miq të pandamë e besnikë, dhe ushtarakë me vlerë, kishin luejt rol kryesor në rimarrjen e pushteti nga ana e tij. Ai e kishte kuptue se me anë të tyne do ta kishte ba zap Shqipninë. Ndarja në ato katër zona u jepte fuqi e autoritet katër komandantëve dhe e lehtesonte punën e tyne për të vendosë rendin dhe për të pasë nën kontroll krahinat që përfshihëshin në to. Prandaj periudha e zonëkomandave që zgjati pesë vjet, patjetër se asht

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

pjesë e pandame e historisë shqiptare dhe nuk mund t'anashkalohet. Historianët t'i kthehen asaj kohë e ti kushtojnë mirë vëmendjen. Historia nuk lejon që të anashkalohën ngjarje e fakte sipas hamendjës dhe interesave të individëve ose klanëve, besimeve e krahinave si dhe të partive politike.

Nderkaq Zogu u kishte premtue, qyshë në Belgrad (fjalë burrash) se do t'u jepte pozita të randësishme ushtarake në qeverisjën e vendit. Siç dihet gjithçka shkoi mirë dhe qeveria legale u rikthye në Shqipni, ku Zogu nga kryeministër u ba President, me pushtet të pakufizuem. Duke kapërcye hierarkinë ushtarake (siç e thamë) dhe qeveritare, e ndau Shqipninë në ato katër zonat që përmendëm, duke ua dorëzue katër besnikve të tij, që ishte si një paradhanje për detyra ma të nalta e të randësishme. Këtë katërshe burrash, që një anglez do të quente me të drejtë "Kuadrumvirat" (sundimi i të katërve), Zogu e mbajti të lidhun pas vetes, në kuptimin që ata i merrnin urdhnat vetëm prej tij. Shkurt, për pesë vjet rresht, nga 1924 deri 1929, ishin ata që e qeverisën Shqipninë bashkë me Zogun, në këtë formë katërzonale. Dhe ky projekt i tij që u vu në zbatim, asht një nga reformat ma të mençura e te pikasuna për t'i dhanë stabilitet dhe afirmim Shtetit të ri, si dhe të përsonalitetit të tij vetjak, si njeriu ma i përshtatshëm për me sundue e me drejtue shtetin shqiptar, jo vetëm si President por pse jo, edhe si Mbret. Pranohet prej të gjithëve, edhe nga ana e kundështarëve, se ai kishte kontribue aktivisht e me aftësi e diplomaci të një politikani e burrë shteti të mirëfilltë për krijimin e shtetit të parë shqiptar ligjor që u regjistrue në hartat politike të botës ku akoma nuk ishte shenue e nuk figuronte fare. Sa që Bismarku në Kongresin e Berlinit e përcaktoi Shqipninë si një "shprehje gjeografike" (por me sa dukët nuk ishte ai qe e kishte thane atë fjali) sepse faktikisht Shqipnia nuk shenohej në asnjë hartë të kohës si shtet, vend apo emën, e pushtueme siç ishte nga Turkia dhe e ndame në katër vilajete me emërtime të ndryshëm po asgjëkundi me emnin e saj, Shqipnia ose Albania.

Periudha pesë vjeçare e sundimit të katër kapidanave lëgjendarë ia dorëzoi vendin përfundimisht Ahmet Zogut, krejt të stabilizuem e të qetësuem. Prandaj asht i padiskutueshëm roli i tyne në hypjen e Zogut në shkallët e pushtetit nga ministër, kryeministër, president e Mbret i shqiptarve. Pa këto burra Shqipnia nuk do të kishte gjet vetveten as si Republikë as si Mbretni. Ata përbanin atë shkallë që Zogu hypi hap pas hapi deri në kryet të shtetit. Se sa do të vlerësohet kjo nga historianët shqiptarë të mirëfilltë mbetet në vullnetin e ndërgjegjën e tyne dhe të aftësive intelektuale të lueme nga ndikimet ideologjike e të tjera ndikime obstruksioniste që kërkojnë t'i shmangën procesin të vërtetë historik duke krijue botkuptime hamendore të pa asnjë bazë reale por fund e maje të shpikuna deri dhe mohuese. Dhe kjo do t'ishte një fatkeqësi në mos një katastrofë për historinë e Shqipnisë e të Kombit Shqiptar.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Kryengritja e Dukagjinit, 1926

Uji fle, anmiku nuk fle. Forcimi i pushtetit të Zogut në këto përmasa ngjalli pakënaqësi në Jugosllavinë fqinje, sepse Zogu nuk i la asaj frymemarrje në detin Adriatik siç kishte shpresue e kërkue Pasiçi. Përveç dhe çështje të tjera ku Zogu ishte angazhue me fjalë (ndoshta dhe me shkresa) por që nuk i zbatoi. Kështu Jugosllavia nisi një poiltikë destabilizimi duke e paraqitun Zogun si një anadollak filoturk qe do t'u binte në qafë katolikëve të veriut. Nga ana tjetër Zogu po afrohej me Italinë, e cila i ofronte ndihma të mëdha prej disa milionë liretash dhe merrte përsipër ndërtimin e rrugëve e modernizimin e Tiranës si kryeqytet i mirëfilltë. Prandaj Jugosllavia i luejti gurët e saj dhe gjeti disa elëmentë të dobët që i bani për vete me flori dhe premtime te tjera joshëse, si pozita e grada. Plani ishte që krahinat veriore katolike të shkeputëshin nga Shqipna e të bashkohëshin me Malin e Zi te Krishtenë (Jugosllavinë), për me shpëtue nga kthetrat turkoshakëve që kishin marre fuqinë në dorë me Ahmet Zogollin ne krye, që do të zbatonin politikën e Stambollit. Ishte 28 nëndori 1926, kur plasi kryengritja që u quejt e Dukagjinit me epiqendër në Shalë e Shosh, por që u zgjanue deri në Pukë. Ndërsa Mirdita nuk iu bashkangjit. Kjo tregon mençurinë e Kapidan Marka Gjonit që s'ra në kurthën e Jugosllavisë. Edhe Italia kishte gisht në këtë punë me disa prifta dritshkurtën qe u dukej mirë ajo punë. Kështu Nok Gjeloshit, këtij agjenti të Jugoqllavisë iu bashkangjitën disa prifta si Dom Loro Caka e nja dy-tri të tjerë, njeni prej tyne dhe deputet. Faktikisht ishte Dom Loro Caka që hyri në Shqipni nga Jugosllavia dhe u ba organizatori i asaj kryengritje, bashkë me Nok Gjeloshin e malësorë të tjerë. Preteksti, siç e thamë, se në Shqipni po sundonte qeveria anadollake e Ahmet Zogut, që do të vazhdonte të bante politikën e Turkisë, etj., në dam të katolikëve të Veriut, kishte ndikue në mashtrimin e popullsisë katolike të zonës Dukagjinit. Kryengritësit kishin arrit një sukses të parë të Shtegu i Dhenve në Shalë, ku kishin bllokue ushtrinë qeveritare të komandueme nga kapiteni Fiqri Dine. Kishte pasë edhe lufitime, por Shtegi u i Dhenve ishte i pakalueshëm Rebelët kishin zanë rob kapiten Fiqri Dinën me shtabin e tij dhe po bahëshin gati me sulmue e pushtue Shkodrën. Nga ana tjetër kryengritësit kishin grumbullue familje të tana malësore me bagëti e plaçka, për të kalue masivisht në mënyrë demonstrative në Mal të Zi, për me alarmue opinionin ndërkombëtar. Ky ishte një plan djallëzor i shpikun nga ana e Jugosllavisë, që çeshtja të ndikonte në Shoqninë e Kombëve. Ishte një gjëndje tepër kritike e tepër e rrezikshme. Një krizë e madhe që mund të destabilizonte jo vetëm Shtetin Shqiptar por mbar Kombin. Rreziku ishte i madh dhe dukej pa rrugedalje. Dështimi i parë ndërhyemjes së ushtrisë e alarmoi Presidentin. Duhej veprue urgjentisht e sa

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

ma parë, për të përballue rrezikun. Por duhej gjet njeriu që mund ta kryente me sukses atë detyrë. Ishte ora dy pas mesnate të atij dhjetori 1926, kur befasisht kishte ra telefoni në shtëpinë e Prenk Pervizit në Tiranë. Zogu e kërkonte urgjentisht në pallat, ku po e priste me padurim. Sa im atë kishte hy në zyrë, Zogu i kishte folë shprehimisht:

- Prenk, jemi përfshi në një krizë të madh e të rrezikshme. Siç e ke marrë vesh, ka plasë një kryengritje në Dukagjin, veri, Shalë e Shosh. Ajo asht një orvatje e hapun nga ana e Jugosllavisë, për të destabilizue situatën e coptue Shqipninë. Gjendja po bahet tepër kritike. Kryengritësit kanë bllokue ushtrinë dhe kanë zanë rob Fiqri Dinen. Ato po bahen gati me i ra Shkodrës. Do t'ishte një katastrofë. Si mund ta përballojmë situatën dhe a mud t' i dalim në krye ?

Im atë i ishte përgjigjë se e merrte përsipër ta zgjidhte problemin me sukses, mjafton që t'i jepëj urdhën, ushtri dhe fuqi të jashtëzakonshme. Presidenti ishte i bindun se ai ishte i vetmi qe mund ta zgjidhte atë krizë, sepse kishte dhanë prova në atë drejtim dhe i dha kryekomandën e operacionëve me fuqi të plotë (karta bianka). Të merrte ushtri e armatime sa të donte. Prenka i ishte përgjigjun se i mjaftonte një bataljon efektiv e 100 vullnetarë, ish ushtarë të tij, burra të zgjedhun e me përvojë nga krahinat e tija, që do t'i mblidhte gjatë rrugës, kaq. Zogu, kishte mbet pak i çuditun nga forcat e pakta që kishte kërkue kapiteni. Por ai tashma ia njihtë aftësitë dhe i dha liri veprimi. Im atë u nis e çoj fjalë në Kurbin, Malësi të Lezhës, Krujë e Kthellë, prej ku mblodhi 100 trima të zgjedhun me gisht. Ai i njihte të gjithë fiset e atyne krahinave dhe kishte influencë të madhe në ato vise. Me një fjalë të tij, njerëzit ishin të gatshëm me u hedh në zjarr. U vuni si komandantë oficerë trima si Prenk Marka Përzefin, Gjin Nokun, Ded Lufin, Shefki Shatkun etj. njerëz të sprovuem në situata të vështira luftarake.

Ndërkohë te Shtegu i Dhenve, kishin ndodhun ndryshime. Një kapter mirditas, Gjet Staka, kishte arritë të shpëtonte Fiqri Dinën, por kjo s'kishte sjellë ndonjë dobi e ishte tërheq në Shkodër. Kur im atë arriti me forcat e veta, menjëherë u hap lajmi i ardhjës së tij si kryekomandant i operacionëve dhe ushtria mori zemër. Malësorët nga ana tyne ishin ma se të siguртë se nuk kishte ushtri që të kalonte Shtegun e Dhenve, ku mjaftonin pak veta me mbajtë një ushtri të tanë. Im atë i kishte hedh një sy vendit dhe pasi ishte konsultue me vartësit e tij, mori vendim. Thirri vullnetarët, djelm malesh, dhe u dha afat një ditë për të hap nji shteg, aty ku zor të kalonte edhia e egër, per hypjen e ushtrisë në anën e kundërt të Shtegut të Dhenve, pas shpinës së kryengritësve. Pastaj mbrenda natës, të hipej lart ushtria me gjithë armatimet. I gjithë ky aksion duhej ba në heshtje e pa zhurmë brenda asaj nate. Nga ana tjetër urdhnoi që nga ana e Shtegut të Dhenve të bahëshin lëvizje e provokime luftarake për të tërhequn vemendjen e kryengritësve se po përgatitej ndonjë sulm andej. Kishte ra borë e madhe dhe vendi kishte ngri akull. Megjithatë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (20 I 6)

vullnetarët arritën të krijojnë shtegun e ri e ta hypnin një pjesë të ushtrinë siç kishte urdhnue komandanti. Duke kapërcye tregimin e t'im etit, po rrefejmë ma poshhtë dëshmitë autentike të ushtarakëve, oficerë e ushtarë, që kishin marrë pjesë në atë aksion luftarak. I gjithë aksioni u zhvillue si vijon.

Si morën urdhnin, vullnetarët arritën të hapnin një shteg asaj faqeje mali shkambore mes akullit e borës dhe e ngjitën atje lart me anë të litarëve, një pjesë të ushtrisë me gjithë armatimet. Atje zunë pozicionet dhe e rrethuen gjithë vendin pa i pikasun malësorët, që ishin përqendrue te Shtegu i Dhenve, të alarmùem se po bahej një orvajtje sulmi andej. Ndërsa familje të tana malësore ishin grumbullue rreth disa zjarrëve të mëdhej me gra e fëmijë e bagëti, mes ftohtit e borës, gati për t'u nisun me dalë të tanë në Mal të Zi. Kështu burrat kryegritës, kur të siguronin familjet, do të sulmonin me pushtue Shkodrën. Komandanti, Prenk Pervizi ishte ngjitun atje dhe kishte dhanë urdhën që me ndejtë ashtu në gatishmëni dhe heshtje të plotë deri sa të dilte dita. Pa urdhën të tij nuk do të kryhej asnjë veprim apo lëvizje. Sa filloi të agonte, Prenk Pervizi dha urdhën që të gjuhej pëmjëherësh e pa pushim me të gjitha armët mbi kokat e njerëzve. Gjama e armëve, mitrolozave, pushkëve, bombave, ushtoi e madhe dhe aq ma e madhe u ba prej jehonës që përplasej nëpër grykat e thella të maleve. Malësorëve u kishte hy tmerri, sepse nuk po kuptonin se si kishte dalë ajo ushtri prej asaj humnere ku nuk kishte shkelë kurrë kambë njeriu. Tregonin ushtarët se si Prenk Pervizi ndërsa po kalonte në kontroll nëpër pozicionet, shef disa nga oficerët që po rrinin të strukun pas shkëmbejve, ndërsa ushtarët gjuenin me mitrolozët e armët e tjera.

- Po ju, ç'bani këtu ? Hajt ! Kapni shpejt mitrolozët. Nuk kemi ardhë për me pi shampanjë si në Shtëpinë e Oficerëve por me luftue !

Sa kishte thirrë kështu, oficerët ishin çue me nxitim dhe i kishin kap mitrolozët, tuj gjuejt me to krah për krah me ushtarët.

E dhamë ketë fakt për të vërtetue autenticitetin e gjithë ngjarjës që shoqëroi ndërhymjen e Prenk Pervizit, siç e kishin përjetue ata që kishin qenë vetë në atë ngjarje si ushtarë. Ne kishin disa kushrij, oficerë e ushtarë, që kishin marrë pjesë në atë aksion e na tregonin si shkuen punët. Ato historianë apo shkrilmtarë, që kanë shkrue mbi këtë kryengritje, pa përmendë Prenk Pervizin, dhe pa tregue ngjarjet siç janë rreshtue në këtë libër, kanë manipulue e dezinformue pa kritere logjike dhe pa përgjegjësi profesionale për turpin e tyne. S'arrihet të kuptohët ky qëndrim negativ ndaj historisë ku ngjarje të tilla historike mohohën e mbulohën me dokrra të kota pa asnjë lidhje me realitetin e atyne ngjarjëve. Jo që janë krijue tregime fantastike për ngjarje kurrë të ndodhuna.

Vazhdojmë me tregimin. Pas disa minuta poterieje dhe gjemimi shurdhues e çoroditës të armëve, im atë kishte dhanë urdhën të ndalej zjarri. Kryengritësit kishin ngritun një lecke të bardhë në shenjë dorëzimi. Kështu mori fund ajo kryengritje fillimisht zullumemadhe dhe përfundimisht e

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

dështueme. Disa nga krenët e kryengritjes të pranishëm, ishin dorëzue vetë. Disa si Nok Gjeloshi e Dom Loro Caka me të tjerë kishin ikun në Jugosllavi. Ata që u dorëzuen, nja 15 vetë, u rreshtuen per me i çue në Shkodër, prej ku kishin ardhë forcat e xhandarmerisë të Fiqri Dinës. Kur u vunë në radhë të prangosun, një malësor i moshuem i ishte drejtue tim etit.

- Or Kapidan, po ta kërkojmë nji rixha... a s'po na fal njat djalin e ri, Gjergj Pllumin, lahutarin ma të mirë të Malsisë ?

Im atë kishte buzëqeshë dhe dha urdhën që ta lironin lahutarin, një djalë i ri i pashëm. Ndërkohë plaku nuk e kishte ndalë fjalën e kishte vazhdue :

- Or Kapidan, të na falish por e kemi dhe një rixha tjetër... Njaj trimi i ri, Gjon Bala, asht djal i vetëm e po të vdesë, shuhet shtëpija e tij. A ban me na e falë ?

Im atë kishte ndejt pak i mendueshëm dhe pastaj kishte dhanë urdhën me e lirue Gjonin. Të tjerët, nja trembëdhjetë vetë u çuen në Shkodër. Ndër ta ishte dhe një prift, i cili nuk kishte pranue me ua dorëzue ushtarëve maliherin grek që mbante :

- Këtë maliher ia dorëzoj vetëm Prenk Pervizit ! Kishte thanë.

Kur fetari ishte gjet para tij, ndërsa zgaste pushkën, kishte folë:

- Zotni Kapidan, mbajeni si kujtim këtë maliher ! Keni tregue se jeni burrë e strateg. Ne gabuem !

Im atë e kishte marrë pushkën ndërsa i shtrëngonte dorën priftit, burrnisht. Prifti ishte ndër krenët e kryengritjes e u përcoll bashkë me të tjerët në Shkodër. Atë pushkë, ma vonë, do ta qëndiste me flori Muharrem Bajraktari si kujtim mikut të tij të ngushtë që tregoi aftësi të madhe ushtarake për të mposhtë aq shpejt një kryengritje që rrezikonte vendin e Shtetin. Ajo pushkë rrinte e varrun në murin e dhomës së pritjes në shtëpinë e Laçit me armë të tjera antike. Por kur u transferuem në Korçë im atë e mori me vete si një kujtim të çmueshëm.

Ndërsa operacioni në Shalë kishte pasë sukses, e që shënonte përfundimin e operacionit të shtypjes së kryengritjes së Dukagjinit, siç u quejt, nga Luma e Dibra kishin ra në zonën e Pukës forcat e Muharrem Bajraktarit e të Hysni Demës, i cili kishte ardhë nga Vlona me forcat e tij për këtë problem. Këto forca, për hir të së vërtetës, nuk u sollën fort mirë me popullsinë, e pati raste keqtrajtimesh e abusimësh, krej ndryshe nga se si e përballoi im atë operacionin në Shalë e Shosh, ku nuk u shkaktue asgja prej forcave nën kontrollin e tij, siç e shpjeguem ma nalt. Në këtë operacion, ku s'pati luftime, nga forcat ushtarake vdiq vetëm një ushtar, jo i vramë, por nga helmim ushqimi.

Operacioni do të vazhdonte edhe për do kohë, sepse duhëshin mbledhë armët e kishte akoma malësorë që rrinin të arratisun në mal. Im atë kishte shpallun falje për të gjithë ata që dorëzoheshin brenda dhjetë ditëve e kishte

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

vendosë shtetrrethim të rrebtë. Askush nuk mund të lëvizte pa leje. Faktikisht organizatorët kryesorë e ma të randësishmit të kryengritjes si Ndok Gjeloshi (i plagosun) me Dom Loro Cakën e me disa të tjerë, kishin shpëtue pa u kapë dhe kishin dalë në Jugosllavi, ku do të vazhdonin veprimtarinë e tyne antishqiptare.

Duke e njohun besën e burrninë e Prenk Pervizit, pothuej gjithë ata të tjerët që ishin fshehun, u dorëzuen e u kthyen në familjet e tyne e nuk i trazoi kush ma. Komandanti kishte zanë vend te një shpi, i zoti i së cilës, Ndue Delia, nuk ishte dorëzue. Aty, në një pjesë të sajë, im atë kishte vendosë komandën. Nuk vonoi dhe u dukën këshilltarët anglezë me majorin Sterling si dhe disa oficerë hollandezë. Ata e përgëzuen Prenkën për suksesin e arritun, por nga ana e tjetër i shprehën çudinë e tyne se si mund të shtypej një kryengritje kundër Shtetit pa vra, djeg e rrenue.

- Ne nuk po shohim as të varun, as të pushkatuem, as flakë e tym të shpive të djeguna as arrestimin e atyne që përkrahën rebelizmin dhe internimin e familjeve të tyne! Pse kështu shtypet një kryengritje ? Ishte shprehun koloneli anglez. Im atë ishte përgjigjë menjëherë.

- Ju jeni mësue të veproni kështu në kolonitë tueja, zotnij ! ... Ne kemi të bajmë me popullit tonë, vllaznit e motrat tona. Ajo që duhej u arrit. Kryengritja u shue. Fajtorët kryesore u dorëzuen vetë... populli s'ka faj ! Të huejt kishin mbetun shtang:.

-Këta shqiptarët vërtet ishin të çuditshëm !

Nji ditë prej ditësh aty ishte paraqitë vetë i zoti i shpisë, Ndue Delia, i cili kishte pas ndejtë i fshehun në një strehim në formë të nji shpelle, të cilën ai e kishte pasë gërrye jo larg kullës. Vend i fshehtë që e dinte vetëm familja. Malësori në fjalë, që ishte një nder krenët e vendit, ishte paraqitë i armatosun. Rojet e kishin lajmerue komandantin se filan malësor donte me u takue me të, por ishte i armatosun. Le ta linin me hy me gjithë armët, kishte pas urdhnue im atë. Kështu ndodhi që Ndue Delia, vetë i zoti i shpisë u gjet ballë për ballë me kapidan Prekën.. Malësori i kishte hjekë armët me ia vu përpara si shenjë nënshtrimi. Im atë i kishte folë që ishte i falun e t'i mbante armet, bile e kishte ngarkue me detyrë ndërmjetësi me malësorët e tjerë që kërkonin me u dorëzue. Kush do të dorëzohej nëpërmjet tij, mund të kthehej prapa familjes se vet pa frikë. Im atë e siguroi se nuk do të merrte as nji dhoj masë ndëshkimore ndaj malësorve që dorëzohëshin, për derisa trazimet në Shalë e në Shosh e krejt Dukagjinin ishin qetësue. Kjo sjellje fisnike i kishte mahnitë ato burra të ashpër të malësisë, që tashma e shikonin Kapidanin me admirim e simpati për këto veti burrnore. Ndërkaq në shtëpinë ngjitun me komandën ku rrinte im atë kishte dasme. Martohej djali i parë i Ndue Delisë, Marashi. Ishte gjendje shtetrrethimi e çdo levizje e mbledhje ishte e ndalueme. E lajmerojnë se drejt fshatit po vinte një karvan me krushq që përcillnin një nuse që do të vinte pikërisht në shpinë ku kishte komandën. Krushqit mbanin armë. Im atë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLEJTI" SHKODËR (2018)

kishte dhanë urdhën që të respektohej zakoni. Krushqit mund të shpraznin armët e dasma të zhvillohej rregullisht. Ai vetë mori pjesë në dasmë me disa oficerë, duke i dhanë gjallni dasmës me bresheritë e armëve të tyne. Me këto sjellje ai fitonte simpatinë e nderimin e banorëve të atij vendi. Ma vonë në kushte internimi u njohëm me pjestarët e asaj familje malësore dhe me vetë nusën, që quhej Rina, se cilës i shoqi, Marashi, ishte arratisë. Ne u njohëm me të dhe kunatin e saj, Ded Ndoja, qyshë në kampin e Tepelenës, ku i kishin internue. Ajo tregonte se si ndodhi martesa e saj ku kishte marrë pjesë edhe vetë Prenk Pervizi. Kapidani e kishte dorovitë atë sipas zakonit, dhe te zotin e shpisë e kishte falë. Ndërsa, ma vonë, pushteti komunist do të tregonte egërsinë e tij barbare, duke ua vra e burgos trimat, vetë zotin e shpisë Ndue Delinë, dhe familjet do t'ia internonte në Tepelenë. Kjo ndodhi kur Mehmet Shehu u gjet te Shtegu i Dhenve, ku hasi ne qendresën e malësorëve dhe e pati pisk. Nuk kalonte dot. Ç'ndodhi ? Një malësor që kishte përjetue operacionin e Prenk Pervizit, paraqitet e i tregon Mehmetit planin që im atë kishte zbatue, duke hap ne malin e thepisun nje shteg për ushtrinë. Menjëherë Mehmeti e zbaton atë plan dhe i rrethon malesoret. Ndryshe nga Prenk Pervizi, ai perdori dhunën e terrorin, duke pushkatue me dhjetra malesorë, arrestue e burgosë të tjerë dhe internue familje të tana e duke u vu zjarrin shpive të bajraktarëve. Ate malësorin spiun e kishte mbajtë do kohë gjoja si korrier deri sa një ditë prej ditësh e kishte pushkatue, që të mos dilte sekreti se si ai kishte ndjekun strategjine e Prenk Pervizit, por t'i mbetej atij si një sukses personal. Kjo na u tregue nga vetë malësorët që ishin në kampin e Tepelenës me ne. Krejt ndryshe se si ka shkrue vetë Mehmet Shehu me i dhanë randësi vetvetës si strateg, ndërsa e kishte tregue veten si kriminel duke i masakrue malsorët.

Lajmi i shuemjës së kryengritjes brenda pak ditëve mori dhenë dhe emni i Prenk Pervizit ishte në çdo gojë përveç se në veshin e gojën e gazëtarëve, historianëve e shkrimtarucave të tjerë servilë, që nuk i banë jehonë ngjarjes, sepse dikujt nuk i pëlqente të zmadhohej fama e atij kapiteni (*). Megjithëse asokohë, s'kishte as gazetarë as shtyp dhe aq ma pak historianë, që të paraqitnin se si Prenk Pervizi arriti të mposhtë atë kryengritje antikombëtare dhe tradhëti e hapun ndaj Atdheut.

Kleri katolik ishte i zemruem sepse ishin arrestue disa prifta që kishin qenë të mpleksun me kryengritjen, deri dhe një që ishte dhe deputet, ky u gjykue dhe u denue për tradhëti të naltë me varje e prandaj nuk donin me shkrue asgja të mirë, ose ma mirë me thanë, nuk shkruenin hiq ose shkruenin keq. Kryengritja e Dukagjinit ishte krejtësisht antikombëtare, e ne qoftë se pati prifta që e përkrahën ose u mpleksën me të, nuk mund t'i iknin gjyqit të historisë, për tradhti të lartë ndaj Atdheut.

Ndërhymja e Jugosllavisë dhe Italisë dukështin haptas, dhe asnjë shfajsim nuk mund të kërkohej për ata që u vunë në shërbim të anmiqve të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kombit shqiptar, për të përça e coptue Shqipninë, që sapo kishte dalë para botës me bukurinë e saj të pavdekshme duke zanë vend mes shoqeve të tjera të Kombëve si një nuse e re apo mbretneshë krenare. Ceno Beg Kryeziu, do të skadalizohej. Ai i kishte ba vizitë tim etit në shpi krejt i revoltuem, ku i kishte tregue se si e kishte ngrit çeshtjën para Zogut e parlamentit. Asht mama që na e tregonte se si Ceno Kryeziu ishte shprehun :

- Prenk Pervizi meriton të vihet në krye të ushtrisë me gradën gjeneral! Zogu kishte mbet i befasuem dhe i mendueshëm, por këshilltarët e Rasputinët e oborrit, të alarmuem, kishin ndërhy.

- Aman, Ahmet, mos i jep fuqi "kaurrit" se asht tepër i ri dhe mund t' i rritet mendja ! Kuptohë se e kishin fjalën për Prenk Pervizin, të cilin pas shpine e quenin "Kaurr".

Prandaj Presidenti nuk ndërmori asnje lloj nderimi ndaj atij që kishe thirrë me urgjencë në ora dy mbasmenate, i cili ia kishte hjekë genshtenjat nga zjarri, duke shue një kryengritje të përmasava serioze, për rrezikun që paraqiste, mos shkatohej një incident me pasoja të randa per Shtetin shqiptar qe sapo e merrte veten. Me këtë rast nuk pati as grada as dekorata, dhe pakenaqësia e Ceno Beg Kryeziut reflektonte zhgenjimin e rretheve ushtarake për këtë anashkalim dhe mos evidencim të aftësive te atij oficeri te ri, që i doli zot atdheut në ato rrethana aq të vështira e të rrezikshme. Tashti kalojmë në anën tjetër të medaljës, ku dallohet reagimi antikombëtar i krenëve të asaj kryengritje, që kishte për qëllim "separatizmi", pra shkëputjën e krahinave katolike veriore nga Shqipnia për t'u përfshi në Jugosllavinë, me pretkstin që ato vise rrezikohëshin nga një qeveri me ne krye një turkoshak siç e quenin Ahmet Zogun. Sipas kandveshrimit të disa malësorve të pagdhendun dhe shkodranë pa intelekt të shëndoshë na del se ajo kryengritja e Dukagjinin paskej qenë e drejtë, sepse i kundërvihej Ahmet Zogut, këtij anadollaku të lidhun pas qerrës së Turkisë, që donte me e rikthye Shqipninë nën varësinë e Stambollit. Një absurditet, sepse Zogu ndaj Turkisë ndoqi një politikë të ftoftë e nuk pranoi asnjë orvatje të saj për të fut hundët në Shqipni. Jo si sot që Turkisë i janë hapun dyer e dritare e po hedhin fjalë se jemi vllazën me ato tartarë të ardhun nga fundi i mongolisë. Shqiptari nuk asht as turk as arab, por tjesht shqiptar dhe europian.

Nuk po duem me vazhdue për këtë kryengritje për të cilën kem folun e kemi dhanë shpjegime të qarta. Duem të evidencojmë se si faktet flasin vetë për atë kryengritje të kurdisun nga ana e Jugosllavisë. Nuk do të merremi me dokumenta por me ngjarje konkrete. Që Nok Gjeloshi me shokë ishin agjentë të Jugosllavisë del fare qartas me faktin flagrant të atentatit që ai me një far Aziz Çamin i banë Zogut midis Vjenës me 1931. Pra ata për pesë vjet ishin mbajtë prej Jugosllavisë, dhe informatat dhe udhëzimet vinin prej andej. Atentati dështoi nga vetmohimi i majorr Llesh Topallaj, që i vuni gjoksi e vet plumbave. Nuk mjaftoi kaq dhe Noka vjen me trupat italiane me uniformën e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

zezë e shpatat e lilktorit si një kolonel i milicisë merçenare fashiste Ai kishte qendrue në Itali nja tetë vjet duke hangër paret e fashizmit me të cilin zbarkoi në Shqipni edhe ai vetë si pushtues, me justifikimin si anmik i Zogut. Por nuk vonoi e aty gjeti plumbin. Shqiptari nuk ta fal tradhëtinë. Asnjë nga ata që u përfshinë në atë kryengritje, qoftë malësor, oficerë apo fetarë, nuk i ikën vulës së tradhëtisë sado që mundohën që të dalin si burra të mirë. Sigurisht se pati gjyqe e dënime me vdekje, por për aktin ma të dënueshëm të tradhëtisë së lartë ndaj Atdheut. Ligj që zbatohët në çdo shtet të botës. Prandaj punët e shqiptarve shkojnë rrokopujë, sepse ata i ngrejnë në idhuj herojt e paqenë, dhe ato të vërtetit i lajnë në harresë. Ka çit pushkë midis Vjenës ! Mburret malësori për Nokën dhe i ngref dhe kangë. Kleri katolik pretendon të shpallët martir kleriku deputet që ishte nxitës i asaj kryengritje në marrëveshje me jugosllavët dhe italianët. Aktet gjyqsore flasin qartë. Martir shpallët një klerik apo dhe besimtar i thjeshtë katolik, në qoftëse torturohët dhe ekzkutohët për çeshje të besimit fetar, dhe aspak për çeshtje politike. Për këtë arësye historia e Shqipnisë dhe e shqiptarve nëpërkambet duke ngrejtë në heroizma anët ma antikombtare që ka pesue Shqipnia. Kemi një radhë shembujsh të tillë, që nuk po i përmendim, por që dihen. Duke nenvleftësue gjithë ngjarjet që lidhen me politikën e shtetit shqiptar te sapo krijuem, janë disa raste që janë regjistrue si kryengritje, që historianët e indoktrinuem komunistë, i paraqesin si pozitive, sepse ishin kundër Mbretit Zog, pavarësisht se ato mund të destabilizonin vendin deri dhe në coptimin e tij midis fqinjëve. Vetëm për lëvizjen e Dukagjinit edhe vete historianët komunistë e pranojnë se ishte antikombëtare dhe tërthorazi e quejnë të dobishme shtypjën e saj. Ku dashje padashje vlerësohet strategu që i dha fund asaj, Prenk Pervizi, por pa ia permend asgjëkundi emnin.

Përfundimisht ajo që u quejt kryengritje e Dukagjinit nuk ishte gja tjetër veçse një orvajtje e Jugosllavisë me destabilizue vendin me anë të disa elementëve të shitun e tradhtarë, për të cilën nuk mund te pranohet asnjë justifikim, tue qenë se faktet që u shkruen ma sipër i përgjigjen të vërtetës absolute.* Te vjen keq kur shikon se si anashkalohen disa periudha historike me randësi të madhe, bashkë me njerëzit që ishin në role kryesore të tyne. Pa dyshim se periudha e katër Zonë-komandave ka mbetun e patregueme dhe e pashpjegueme, në harresë të plotë, me dashje të theksueme sepse aty para shqiptarve dilnin disa burra me të vërtetë të tabanit shqiptar, si dhe strategë ushtarakë me udhëheq ushtrinë shqiptare, por edhe burra shteti për të udhëheqë Shqipninë. Prej një pjese ma të dobët të shoqnisë shqiptare të molepsun me injorancë dhe vese të këqia, intrigantë, servilë e lakej të oborrit mbretnor, kjo katërshe e lavdishme u paraqit si një force e rrezikshme që mund te merrte fuqinë në dorë, me simpatinë dhe influencën që kishin fitue duke krye me nder detyrat që u ishin ngarkue. Po ta kishin pasë ndërmend atë punë, e kishin ba pa ndonjë vështirësi, por ata nuk e kishin frymen arriviste që

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kishte pushtue të tjerët, për me marrë me çdo kusht pozita e kolltuqe. E thamë ma përpara se si kapiteni anglez Julian Amery e kishte përkufizue mirë atë periudhë dhe njerëzit që kishin luejtë role kryesore e vendimtare, për fuqizimin e mbretit Zog, dhe si pasojë "shperblimi" pasi kishte kalue lumin. E vërteta asht e hidhun, por asht e dobishme dhe e domodoshme të thuhet. Në rastin e kësaj ngjarje, pse nuk supozohët e kundërta ? Pasojat katastrofale të suksesit të kryengritjës : shkëputje e gjithë zonës katolike të veriut me një aneksim në Jugosllavinë, siç ishte plani i kurdisun, me disa tradhtarë e renegatë të shitun të Jugosllavia e Italia, për t'i ba gropën Shqipnisë. Asht në këtë aspekt që duhet analizue e kuptue randësia e suksesit të shuerjës së asaj krynegrtje antikombëtare nga Prenk Pervizi. Kësaj thonë të shkruhët historia drejt*.



PRENK PERVIZI
kryekomandant i operacioneve për ngjeshjen
e kryengritjës së Dukagjinit, 1926.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)



Shtegu i Dhenve që quhej i pakapërcyeshëm ushtarakisht,
lëgjendën e të cilit e theu Prenk Pervizi siç u tregue në këtë pëshkrim

---

(*) Për shuerjen e kryegritjës së Dukagjinit, një vlerësim të paanshëm jep Xhelal Staravecka në librin e tij, "Para Gjyqit të Historisë",ku thotë shprehimisht "....detyrohëm të theksoj se oficerët me kontingjentin që u dërgua për shtypjën e asaj lëvizje tradhëtare, për guximin e tyre, meritojnë lëvdatat më të mëdhaja, pse, si të vendosur që ishin, nuk u kursyen t'u jepnin dënimin e merituar shkaktarëve ....të komplotit e shpërthyerjës së asaj lëvizje. Ai s'e përmend Prenk Pervizin, vetëm nga fakti se ai ishte katolik. Staravecka ka dyshim se jep disa të vërteta të padiskutueshmej, për disa ngjarje që janë lanë në heshtje nga historianët e molepsun me ideologji komuniste dhe të tjerë me miza në kokë.
Dikush, injorant me brirë, ka shkuar, se ne attë kryengritje u dogjen njëmijë shtëpi, u vranë e u burgosën me qindra malësorë, e u intertnuan me qindra familije. Si kanë guximi të shpikin e trillojnë të tilla situatav krejt të paqena ! Ky libër vulos të vërtetën.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Prenk Pervizi (kapelë) krijoi e drejtoi kurset e para të plotësimit
prej ku dolën mjaft kuadro oficerësh të ushtrisë shqiptare.




Gjeneral Percy dhe Prenk Pervizi midis oficerëve të rij të xhandarmërisë
të dalun nga kurset e plotsimit, Tiranë 1928.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Gjeneral Percy më 25 vjetorit e Pavarësisë, Kol. Shefki Shatku, komandant i Xhandarmërisë, ku dhe Kolonel Prenk Pervizi i pari në rresht (28 Nëndor 1937).



I ashtuquejtuni "Pallati Presdencial" seli e Presidentit Zog që shërbente si qendër e aktiviteteve të tij.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



Ahmet Zogu,
President 1926-1928, me gradën kolonel

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Zogu I-rë Mbret i Shqiptarve

Sigurisht se prej këtyne suksesëve të njëpasnjëshme, perfitimi kryesor i kalonte Ahmet Zogut, që pas dy vjetësh, me 1 shtator 1928 shpallte Mbretninë duke hypun në fron, si Zogu I-rë Mbret i Shqiptarve.

Për të përmbyllun këtë periudhë ngjarjesh të njëpasnjëshme, plot rreziqe për Shtetin e ri të cilat ngjarje u përballuen me sukses kryesisht nga Prenk Pervizi , dhe kolegët e tij zonë-komandantë, dhe për të përcaktue ma drejt veprimtarinë e tij historike, të lanun mangut nga historiografët tanë, dhe se qyshë ai u « shpërblye » për meritat e tij, po përmendim përsëri atë të huejin mjaft të shquem, siç ishte Lord Amery (ish kapiteni Julian Amery) që në librin e tij " Sons of the Eagle" në faqen 304 shkruen (botimi anglisht 1946):

- Miku dhe mbojtësi ynë, Gjeneral Prenk Pervizi, luejti një rol të randësishëm në revolucionin e vitit 1924, dhe bashkë me Muharrem Bajraktarin, Fiqri Dinën dhe Xhemal Herrin(*) formonin atë "kaudrumvirat " me anë të cilit u vendos regjimi i Zogut. Kur e arriti qëllimin e tij, Zogu ia hoqi komandën dhe e caktoi në një detyrë pranë Komandës Përgjithëshme, ku ai gëzonte nderime por jo influencë.

*(*Sqarim: i katërti ash Hysni Dema dhe jo Xhemal Heri, një gabim i Julian Amery)*

Këto fjalë të anglezit Julian Amery vlejnë sa për një kapitull të një libri. Me ato pak rreshta percaktohet mirëfilltas ajo periudhë historike ku në rol të parë e vendimtar për stabilitetin e Shtetit të Ri shqiptar ishin ato katër komandantë të shquem, e kryesisht im atë, Prenk Pervizi, mbi të cilin Zogu kishte mbështetë gjithë besimin, sepse e dinte se ai kurrë nuk do ta shkelte atë besim. Mjerisht, deri më sot, asnjë historian apo tjetër shkrimtar nuk ka arritë që ta përshkruej atë periudhë e të vlerësojë ato ngjarje. Jo vetëm kaq, por kanë krijue një histori të paqenë të saj. Ishin këto oficerë e burra të vërtetë që duhën vleresue për ndikimin e kontributin faktik që kanë dhanë në krijimin e forcimin e Shtetit shqiptar, duke e mbështetun Ahmet Zogun si të vetmin burrë shteti që mund t'i rrinte në krye Shqipnisë e shqiptarve. Sdomend, ne një kohë kur Zogu ishte në qendër të politikës shqiptare, dhe aftësitë nuk i mohohën, veçse ai nuk kishte si me veprue fare vetëm por sipas thanjës "trimi i mirë me shokë shumë".

Prenk Pervizi e kishte shprehun sa herë në rrethin familjar dhe të miqve të ngushtë se perkrahja që ai me shokë e kolegë i kishin dhanë Zogut ishte

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2019)

krejtesish e me vetbindje të plotë se ata po mbeshtenin njeriu ma të aftë për të drejtue vendin. Ky ishte një besim i sinqertë se ai i përmbushte ato kushte të domosdoshme me u ngrit në shkallën ma të naltë të pushteti siç ishte shpallja e tij Mbret i Shqiptarve. Ky synim nuk ishte rastësor. Im atë kishte dallue qyshë në rini, kur ishin në Austri se Zogu kishte synimin e arritjës në krye të vendit që shprehej maninë e veshjës me uniforma të fisnikëve hungarezë. Qejfi tij ishte të mbante ato kostume plot gajtana, pulla e spaleta me xhufka t'arta. Sa që ne qe e njihnim, thoshte im atë, tallëshim duke i thirrun, kont, princ e mbret. Mirë, mirë thoshte ai, talluni sa të doni, por një ditë do të më shifni mbi fronin e Shqipnisë e do të përuleni para meje ! Ne e kishim me te qeshun ndërsa ai e kishte përnjëmend, dhe përnjëmend doli.

Vend ma të përshtatun nuk kishte se sa Shqipnia që për herë të parë në histori po bahej shtet, e pse mos te bahej mbretni ? Kjo ishte logjike. Në një Ballkan me mbretni, s'kishte vend për një republikë. Prandaj Zogu gjeti mbështetje e përkrahje të brendshme e të jashtme. Të katër zonë-komandantët ia kishi hap rrugën, tuj ia dorëzue shtetin të stabilizuem në dorë. A meritonin të shpërblehëshin e si ? Këtu Zogu nuk ndërmori t'u japë ngritje gradash, pozita të nalta në qeveri, shpërblime, etj. Asgja. U mjaftue me do lëvdata gojore të thata e ndonjë detyre formale pa ushtrim influence. Patjetër se intrigantët e servilët që formonin oborrin mbretnor dhe i rrinin perreth, i kishin shti frikën se me namin që ata kishin marrë në popull e në ushtri, mund të rrezikonin edhe atë vetë, siç shprehet bukur fort anglezi Julian Amery. Po a e kishin ata vetë atë mendje ? Jo kurrë. E kemi thanë ma nalt. Ata i sherbyen Zogut me sinqeritet e mirebesim të plotë. Të bindun se Zogu do t'i përbushte premtimet e fjalën që u kishte dhanë, në Belgrad, kur ishte ngusht dhe i duhej mbështetja e tyne. Sidoqoftë Shqipnia u ba mbretni dhe Zogu pati kurajon e forcën, që të hypi në fron me titullin Zogu i Parë Mbret i Shqiptarve. Titullin e kishte zgjedh me vend, dhe për këtë asht për t'u levdue, sepse në kumorën e Shqipnisë ai përfshihëshin gjithë shqiptarët, që ishte si një paralajmërim i një bashkimi të mundshëm kombëtar. Kjo ne fakt asht meritë, sepse ai haptasi i dilte zot çeshtjës kombetare të bashkimit të trojëve arbnore. Por fatkeqësish kjo mbeti një dëshirë apo andërr e parealizueme.

Koha nuk do t'i jepte mundësi sepse u tradhtue në vetë planet e tij, ku roli diplomatik që ishte i natyrshëm në të, nuk funksionoi e dështoi përfundimisht, duke ia grabitun mbretninë prej duerve njëherë e përgjithm onë. Krijimi i mbretnisë shqiptar u prit mirë dhe u përshëndet nga gjithë mbretnitë europiane, e në veçanti nga ato ballkanike. Mbreti Zog i erdhën telegrame nga të gjithë mbretnit që e përgëzonin për këtë zgjedhje. Një republikë aty mes Balkkanit ishte si një plagë kancerozë e pasherueshme. Me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



ZOGU I
Mbret i Shqiptarve
1928-1939

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

shpalljën e mbretnisë mbyllej kapitulli i parë i historisë modene shqiptare, ku Shqipnia që s'figuronte në hartat politike e gjeografike të botës, me fitmin e Pavarësisë dhe me krijimin e Shtetit që u arrit në Kongresin e Lushnjë më janar 1920 u fiksue në ato harta me emnin Albania. Në Enciklopëditë e ndryshme do të shkruhej Albania, Mbrertni me Mbret Zogun e parë Mbret i Shqiptarve. E ky ishte një sukses i madh. Nga kjo ngjarje historike të shtatorit 1928 të shpallës së Mbretnisë Shqiptar, do të niste një kapitull i dytë, me reforma të dobishme e vepra konkrete drejt zhvillimit e përparimit t
ë Shqipnisë, deri kur Mbretnisë shqiptar t'i vinte papritmas fundi.



Pallati i Bashkisë së Tiranës, vepër monumentale e kohës se Mbretnisë, i cili u shemb e u zhduk nga faqja e dheut nga regjimi komunist. Një akt barbarizmi i pashembëlt i diktarurës bolshevike shqiptare, urdhëruar nga vetë diktatori E.H

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Afrimi i kundërshtarëve

Në këtë kontekst hyn edhe afrimi i kundështarëve, të cilëve siç dihet Zogu u dha afat 10 dit për t'u kthye në detyrat, punët e shpitë e tyne. Ai ishte një afat formal, sepse u zgjat në kohë dhe u zbatue edhe ma vonë. Jo vetëm që me këtë afati shumica e njerezve qe kishin perkrahun qeverine e Fan Nolit, u kthyen në shpitë e detyrat pa pësue asgja, e u ngritën dhe në pozita, por përfshiu edhe figura të shqueme, si Faik Konicën, e vetë Fan Nolin, dhe të tjerë fuksionarë civilë e ushtarakë me emën. Krejt e kundërta me sjelljet e komunistëve, e të vetë kreut të saj, Enver Hoxhës, që kundërshtarët i ndoqën e vranë, i pushkatuen e burgosën, pa mëshirë me gjyqe e pa gjyqe. Aq sa diktatori pushkatoi kunatin e tij, Bahri Omarin, që hynte ne radhën e intelektualëve dhe atdhetarëve të shquem shqiptarë. Aq ma tepër që Bahriu e kishte mbrojtë, perkrahun, strehue e ndihmue financiarisht vazhdimisht.

Një përsonazh ekuivok ishte edhe Abaz Kupit, që nuk hynte fare në radhën e kundështarëve politikë, por njihej si koçak e cub i ndjekun nga të gjithë qeveritë e kohës. Afrimi me qeverinë e Zogut asht paraqitë krejt ndryshe nga si ka ndodhun vërtetësisht. Zogu nuk ka pasun kurrë ndonjë lidhje apo kontakt me të, deri pas 1924. Bazi kishte qenë pjesmarrës në trubullinat e vitëve 1922-1924, së bashku me Hamit Toptanin, Mustafa Krujën, Elez Isufin, Bajram Currin etj. Por tentativa e përmbysjës së Qeverise dhe të heqjës qafe të Zogut me grusht shteti, kishte dështue në 8 Marsin 1922 për të cilin folëm ma nalt. E përmendim këtë çështje sepse im atë kishte njohje e miqësi me shpinë, familjën e vllaznit e vetë Bazin, qysh kur ishte rreth komandat në Krujë, ku ai kishte urdhën për ta ndjekun Bazin, por nuk ndërmori asnjë veprim ndaj tij për hatër të këtyne lidhjeve mirësore. Por dihet se më 1921 Major Preng Jaku e kishte rrethue Bazin në Krujë, me e kapë ose vra me urdhën të Ministrit Brendshëm Mehdi Frasheri. Bazi arriti me shpëtue duke i dalë rrethimit i veshun si grue me një grup grash kruetane. Atij i ishin ngarkue disa vrasje.

Në ndryshimet që kishin ndodhun pas 1924-ës, kur im at ishte zonë-komandant i qendrës, e Zogu President, i ishte ankue se duhëshin njerëz për të forcue xhandamërinë dhe i kishte kërkue që ai të angazhohej në atë armë, ku do t'i jepte një komandë të randësishme. Im atë i ishte përgjigjun se akademinë e kishte krye për armën e kambsorisë dhe do të qëndronte në ushtri. Nuk e ndiente veten të përshtatshëm për të shërbye në radhët e xhandarmërisë. Dhe kjo kuptohet përse Zogu e kishte vazhdue bisedën, se ku me i gjetë disa njerëz të aftë për atë detyrë, duke ditun se në disa krahina nuk kishin rrethkomandantë, si Kruja, Peshkopia, Mirdita, etj. Im atë i kishte thanë se sa për Krujën ia gjendte rrethkomndantin: Abaz Kupin. Zogu ishte

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2019)

befasue sepse ai vetë kishte leshue urdhën për ta ndjek, kapun e vra. Im atë e kishte sigurue se Bazi ishte i përshtatshëm për atë detyrë, dhe do t'i qendronte besnik gjithmonë. Im atë garatohej për këtë afrim. Zogu i dha pëlqimin. Kështu im atë i çon fjalë Bazit për takim te kullat në Skuraj. Ia ban propozimin dhe i garantohet për çdo gja. Bazi pranon dhe emnohet rrethkomandant në Krujë me gradën toger, ku arriti deri në major. Duhet pranue se duke u afrue me Zogun, ai i qëndroi besnik gjithmonë dhe e kreu detyrën e rrethkomandantit masëmiri në të gjitha rastet e drejtimet. Por në popullin, që ia dinte mbrapshtinat, opinioni ishte i keq. Sepse edhe në detyrën që iu dha vazhdoi të sillej si cub dhe kreu dis mbrapshtina.

Shtojmë se në popull flitej se edhe Bajram Curri duhej të kishte pranue afrimin me Zogun, me të cilin kishin qenë miq dhe bashkëluftarë kundër serbëve e të tjera veprime. Asgja nuk do ta kishte gjet, veç respekt e nderime si një patriot e luftëtar i lavdishëm. Çeshtja e Bajram Currit mbetët si mister, sepse ai jo vetëm se kishte qenë i afërt dhe i miqësuem me Zogun, por me të gjithë oficerët e ushtrisë shqiptare me të cilët kishte bashkëpunue në luftën për dëbimin e serbëve e të tjera aksione. Mik i madh i Major Preng Jakut, i t'im etit, dhe ushtarakëve të tjerë si dhe autoritetëve shtetnore e ministra, si Mehdi Frasheri, Mustafa Kruja, Xhaferr Ypi etj., deri me Kshillin e Naltë e patriotë të tjerë.

Në këtë fushatë afrimi im atë kishte ndërhy edhe për të tjerë që nuk ishin paraqitë brenda afatit: Për disa oficerë e ndonjë bajraktar, që kishin përkrahun Fan Nolin. Në këtë vështrim, përveç disave nga radhet e fanolistëve, që u larguen jashtë shtetit, të tjerët u afruen nga Qeveria e Ahmet Zogut tue u kthye në shpitë e detyrat e tyne civile dhe ushtarake. Kështu pjesa ma e madhe e ish kundërshtarëve pranuen me vazhdue punën si perpara, e nuk u ndodhi asgja e keqe. Kjo formë falje vazhdoi edhe ma vonë, siç ndodhi me oficerë që kishin përkrahun Kryengritjën e Dukagjinit, si Vas Kiri, Dod Nikolla, Lek Margjini, Lek Marashi e të tjerë, që vazhduen shërbimin e tyre si oficerë dhe përparuen me grada. Ishte toger Vas Kiri, që bani qëndresën në Fier kundër forcave rebele që donin me rrëzue qeverinë. Pra ndryshe nga regjimi komunist, që do të bante kërdinë mbi kundërshtarët, regjimi monarkist i falte e u jepte shansin me vazhdue me i kryer detyrat e tyne si pas aftësive profesionale, e nuk bante dallime. Kjo formë afrimi ishte vendosë nga vetë Mbreti Zog. Kujtojmë si shembull edhe të birin e Elez Isufit, Cen Elezin, që nderohej e respektohej në kohën e Zogut, e disa nga djemt e tij u banë oficerë, si Medi Ndreu që kam njohun unë vetë, i nipi Dali Ndreu e të tjerë. Ndërsa regjimi komunist i përsekutoi pasardhësit e Elez Isufit. Ia vrau te birin, Cen Elezin, dhe nipin Dali Ndreun, e të tjerë nipa ia burgosi dhe internoi me gjithe familjet. Ndërsa Elezin e ngritën si atdhetar sepse ishte radhitë me levizjen fanoliste, si kundërshtar i Zogut. Këto janë paradokset qe fatkeqësisht karakterizojnë shoqninë dhe historinë shqiptare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Regjimi komunist të gjithë ata që u banë anmiq të Zogut, i ngriti në piedistalin e herojve, pavarëshst se kishin krye veprime te shkallës së tradhëtisë tue kompllotue e organizue lëvizje të armatosuna e grushte shteti kundër qeverisë të asaj Mbretnie. Të gjithë kryengritjet kundër shtetit shqiptar : si ajo e Elez Isufit në mars 1922, Fan Nolit më qërshor 1924, e Dukagjinit më nëndor 1926, e Fierit më 1935 dhe e Delvinës më 1937, hyjnë në radhën kryengrtjëve antishqiptare për destabilizimit të shtetit dhe të tradhëtisë ndaj Atdheut.

Me këtë paraqitje të afrimit të kundërshtarëve, që asht një meritë e padiskutueshme e Zogut, kuptohet fare mirë se marëdhanjet e t'im etit me Zogun ishin të ngushta e të sinqerta. Në atë përiudhë Zogu e mbante gjithmonë afër dhe këshillohej vazhdimisht me të, si për çështje ushtarake ashtu dhe punë të tjera që kishin lidhje me mirëvajtjën e Shtetit që ai drejtonte. Kjo lidhje e banshkëpunim vazhdoi deri kur im atë kaloi në Itali, për të vazhdue Shkollën e Luftës (shtatmadhorisë) në Torino, më 1929-1933, kohë që u zgjat deri më 1935, kur u emnue inspektor i studentëve shqiptarë të Italisë. Me kthimin në Shqipni pas pesë vjet ndarje, ishin krijue situata të tjera, ku Zogu kishte fillue me u distancue prej atyne që e kishin përkrahun dhe i kishin hap rrugën deri sa me u ngrit në shkallëm e një Mbreti, pa pasun asnjë veçori justifikuese të një dinastie sikur dhe anonime. Zogu, tashma dihet botnish se kishte ra në duert e intrigantëve të oborrit dhe thashëthemeve që i frynin ne vesh, i të cilave binte viktimë duke krye veprime të pamatuna.



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Tirana më 1928, sheshi Skënderbeg ishte Pazar i bagëtiv

Aventura e Parisit

Im atë, duke qenë se Zogu hasi në kundërshtimin e oborrit për t'i dhanë grada e pozita të nalta, si shpërblim mori prej tij një lejë gjashtëmujore për të shëtitë Evropën bashkë me të shoqën. Një lloj vlerësimi që Mbreti Zog ia bante personalisht ma shumë si mik se sa si sundues. Udhëtim që e lejoi qiftin me vizitue Italinë : Romën, Firencën, Venecien, Milanon e Torinon, ku vazhdonin shkollën dy vllaznit e mi, Valentini e Genci. Prej këndej ata shkuen drejt e në Paris ku qëndruen afro gjashtë muej, n ga janari deri në qërshor 1929. Atje im atë kishte angazhue një zonjushë parisiane, Fransi, studenteshë universitare, për t'i shoqnue gjithë kohën, gjatë vizitave të ndryshme në muzeumet, pallatet mbretnore e perandorake, vendet e defrimeve, teatrot, galeritë e artit, ekzpozitat e ndryshme, shëtitjet, etj. etj. Si dhe për të përfeksionue frëngjishtën. Ai kishte zanë një apartament të mobiluem. Ndërsa mama arriti të flasë në atë gjuhë, e të paisej me mirësjelljën dhe etiketen parisiane, përpos modës e sjelljeve në shoqëri. Ishte një eksperiencë e shkollë e vërtetë. Në Paris ata takuen shqiptarë e francezë që kishin njohun Faik Konicën, të cilët kishin folë fjalët ma të mira, duke u shprehun plot admirim për të, si njeri e si intelektual i naltë. Dihet se Konica kishte ndejtë në Francë deri më 1897, ku ishte kthye katolik me emnin Dominik, prej ku kishte kalue në Belgjikë e kishte themelue e botue revistën "Albania", e pastaj në Londër; e se fundi në Amerike, ku Mbreti Zog do ta emnonte Ambasador, megjithëse e kishte pasë kundërshtar. Im atë dhe mama ime, do të kishin pas rast të njiihëshin me Konicën në Shqipni ku ai kishte ardhë e pati organizue një mbramje "çaji", që ai vazhdimisht organizonte në New York, dhe i kishte dalë zani për këto pritje të "çajit" të Konicës ku mblidhej një shoqni e ngritun intelektuale e merrnin pjesë, përveç shqiptarve dhe amerikanë e diplomatë të vendeve të ndryshme.

Për "çajin" e organizuem në Tiranë, tregonte mama, se si Konica e përgatiste vetë çajin, dhe ua servirte vetë mysafirëve, ku njeni prej tyne, ignorant e anadollak i veshun me smoking, pasi vuni në buzë fildhanin dhe thithi një met, i thotë :

- Zoti Konica, më falni po ky çaji nuk paska sheqerr !

Faiku ia kishte kthye aty për aty :

- Zotni, ky është çaj i Konices dhe jo shërbet bakllavaje !

Ndërkohë nga disa shqiptarë kishin marrë vesh se Zogu, sa u ba mbret kishte ardhë inkonjito në Paris, e fill e në teatrot *Folie Bergère e Mulin Rouge*.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Në teatrin *Folie Bergère* paskej zanë merak në një balerinë ruse, Tania Visirova, të cilës i kishte çue njerëz me e ftue me kalue pushimet verore në Durrës me gjithë t'amën. Im atë nga një anë u çudit, po pse mbret u ba me shkue pas fustanëve ? Por s'i kishte dhanë randësi asaj pune.

Ditët e bukura kaluen dhe kthimi në Shqipni u përshpejtue, nga që mama priste nji fëmijë e ky fëmi isha unë që duhej të lindja patjetër në Skuraj ku kishin lindun fëmijët e tjerë. Kështu që unë mbeta pa lindë në Paris.

- Atje ku kanë lindun brez pas brezi te parët, gjyshët e stërgiyshët, do të lindin edhe fëmijët tanë, i kishte thanë im atë.

Kështu në atë fillim qërshori 1929, mama ishte gjendun te kullat historike të Gjin Pjetrit në Skuraj ku unë linda me 26 të atij mueji, dhe qifti u ba me tre djelm, Valentin, Genc e Lek. Siç thamë Valentini e Genci vazhdonin shkollën në kolezhin salesian në Lanzo Torinese, themelue nga vetë Don Xhovani Bosko. Ai u kishte thanë edhe kolegëve e miqve të vet, që fëmijët duhet t'i shkollonin në shkollat evropiane, që të lirohëshin nga prapambetja materiale e shpirtnore ku i kishte katandisë shqiptarët pushtimi 500 vjeçar i Turkisë. Në këtë kohë mori vesh ma mirë atë që i kishin diftue për Mbretin Zog e balerinën ruse. Sipas thashehemëve Zogu e mbante si dashnore por thuhej se kishte ndërmend të martohej me të. Im atë s'u perzi n'atë punë. S'ishte në karakterin e tij të merrej më asi punësh banale. Në takimin që pati me Zogun e kishin kalue kohën duke bisedue për aventurën në Paris të t'im e s'u përmend fare çeshtje e balerinës. Nga ky takim do të kalonin pesë vjet pa të shifëshin prap. Im atë në atë shtator do të nisej për në Torino, ku do të vazhdonte Shkollën e Luftës. Kështu u nda përzemërsisht me Zogun i cili i uroj kryerjën me suksese të asaj shkolle. Nga kjo aventura e Parisit, im atë solli dhe e mbushi shpinë me kujtime të çmueshme, si një bust 40 cm prej bronxi të Napoleonit. Dhe për çudi një bust të poeteshës greke Safo. Kishte sjellië disa albume me pikturat ma të zgjedhuna të Luvrit. Disa objekte dekorative, si Tur Eifël dhe nja tre piktura të vogla pejzazhe origjinale nga piktorë të njohur, ku me dukët se njëna ishte e piktorit të shquem Renuar. Këto sende që zbukuronin shpinë e Laçit, të gjitha do të zhdukëshin në zjarrin e banesës nga trimoshat partizanë, mjeshtra në këto barbarizma e vepra kriminale.

X

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Shkolla e Luftës e Torinos

Në situatën e re që u krijue pas shpalljes së mbretnisë, Zogu i shkarkoi të katër kapitenët nga detyra zonë-komandantëve, duke i caktue në funksione të tjera pranë Ministrisë Brendshme dhe asaj të Mbrojtjës. Im atë, tashma major, vendosi të kryej Shkollën e Luftës së Torinos, shkolla ma e naltë ushtarake me prestizh nderkombetar. Vetë Mbreti Zog e kishte aprovue atë vendim. Ushtria shqiptare kishte nevojë për oficerë të rangut të naltë. Kjo u binte përshtat edhe oborrtarëve servilë e intrigantë që kishin rrethue Zogun, sepse Prenk Pervizi do të rrinte nja katër-pesë vjet larg Kryeqytetit dhe larg Pallatit, prandaj nuk ndërhynë për me prishë punë, siç e kishin zakon. Kështu në atë shtator 1929, major Prenk Pervizi, u nis me vazhdue e krye Shkollën e Luftës në Torino. Me këtë rast ai e tërhoqi dhe familjën, mamën, nanën e tij dhe mue, ku unë u bashkova me vllaznit që nuk i njihja. Në kursin e t'im etit vazhdonte edhe princi trashëgimtar i Italisë, Umberti II, si dhe adjutanti i mbretit të Anglisë e princa nga Siami e Japonia, oficerë të vendeve të tjera evropiane e t'ushtrisë italiane. Kështu im atë u ngrit si oficer i karrierës i nivelit sipëror, nga ana e përgatitjes se plotë shkollore, dhe nga veprat që kishte krye në shërbim të atdheut. Shkolla zgjati tre vjet dhe ai e kreu me sukses e bile u dallue në manovrat e fundit të mbylljës së trevjeçarit të shkollës dhe për mirëvajtjën e studimeve e të manovrave ku u shque. U dekorue me urdhnin e naltë kalorsiak SS Maurizio e Lazzaro. Unë u gjeta atje në moshën dy deri gjashtë vjeçe. Ndërsa vllaznin vazhdonin shkollën, siç e kemi thanë, në Kolezhin San Xhovani Bosko në Lanzo Torineze, qyshë nga 1929. Në konditat e vijimit të asaj shkolle, t'im etit iu dha rasti të njihet me kolegë italianë e të huej që do të naltësohëshin në t'ardhmën në grada e funksione të nalta në ushtrinë e shteteve përkatëse. Veçanërisht për t'u kujtue miqësia me Princin trashëgimtar Umberti II, i cili e thërriste dajë, sepse sipas tij malazezët ishin edhe ata ilirianë si shqiptarët, e prandaj kishte të drejtë me e thirrë dajë. Sigurisht se ishte diçka edhe gazmore, por në thelb Princit i pëlqente, sepse në vështrimin historik shqiptarët konsiderohëshin pasardhës të Ilirëve dhe po ashtu malazezët. Kjo vinte nga fakti se e ama, Mbretnesha Elena, ishte malazeze bijë e Kral Nikollës. Kështu u lidh një far miqësie midis tyne. Kur u kthyem në Shqipni, morën vesh prej dy vllazënve të mi, se Prnci kur shkonte për vizitë në Kolezhin Don Bosko, ku ai kishte ndjek e mbarue gjimnazin, i takonte ato dhe i daroviste duke rue në atë mënyrë të lidhur me tim atë. Jo që rastiste të vinte prej tij ndonjë letër ose kartolinë urimesh për festat kryesore. Unë i e merrja vesh prej pullave të postës që ua hiqja zarfëve e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kartolinave. Ashtu edhe për shokë të tjerë të asaj shkolle me të cilët mbante korespondencë. Me mbarimin e Shkollës së Luftës, im atë u gradue Nënkolonel dhe u caktue si ispektor i studentëve shqiptarë në Iitali, ku u vendos në Firence. Ndër studentët që studionin në atë qytet ishte dhe piktori i shquar Abdurrahim Buza, që e respektonte shumë tim etin, sepse e dinte se ai kishte pasë miqësi të fortë me Bajram Currin. Curri e kishte përkrahun si familje kur kishin ardhë nga Kosova, dhe i kishte sigurue vijijimin e studimëve në Shkodër . Ku ma vonë i doli bursa për vijimin e Akademisë së Artëve Figurative në Firence. Ndërsa një tjetër artist i madh shqiptar, Odhise Paskali, ishte njohun e afrue me familjën tonë në Torino, ku vinte shpesh me gjithë të fejuemen torineze, Caterina. Ai përsoste dhe gjermanishtën me tim etin, që kishte nis me mësue. Odhiseja ndiqte universtietin për letërsi e filosofi dhe njëkohësisht vazhdonte një kurs për skulpturë pranë një artisti të njohur italian. Ai kishte respekt të madh për babën, që vazhdoi edhe kur u kthyen në Atdhe. Në Torino vjen për vizitë kapiteni Gjon Fusha, me të cilin kishim miqësi familjare. Gjoni që vinte drejt nga Tirana solli plot lajme. Ndër to, mpleksjën e Zogut me balerinën ruse, që ishte hap fjala se do martohej me të. Por kishte hasë në kundështimin e s'amës toptaneshë fanatike dhe të motrave smirzeze. Por edhe të vetë balerinës, që e mbante veten me origjinë princore, të ikur nga Rusia prej komunizmit. E si të martohej me një mbret pa dinasti ? Zogu atëherë paskej organizue një martesë "morganatike", jo zyrtare, për të justifikue atë mpleksje. Se si do shkonte puna s'dihej. Im atë s'i jepte randësi asaj pune, që shifej se s'do vazhdonte gjatë. Por i vinte keq se si Zogu sa u ba mbret nisi aventurat me femnat, sikur ky paskej qenë qëllimi tij. Ne e mbështetëm e i dolëm zot për të mirën e Atdheut dhe jo që ai të merrej me balerina e femna të tjera. Mirë që ajo balerina s'paska mbet shtazane. Atëherë do të ia kishte pa sherrin asaj pune. Tregimet e Gjonit shoqnohëshin me zbavitje e te qeshuna, megjithes kishin një shije t'idhtë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

---

*Nisja për në Torino, ndër të tjera, u dha si lajm i vecantë deri ne Gazetën Albania në New York, të shtatorit 1929, që varej nga Faik Konica, ku thuhej shprehimisht se "... major Prenk Pervizi u nis për në Torino ku do të vazhdojë Shkollën e Larte për Shtatmadhor. Ky lajm që u dha deri në Amerikë tregon randësinë që ai kishte asokohë në botën shqiptare.



Në këtë shtëpi të familjës Toska, Prenk Pervizi banoi me familjën nga 1924 deri 1929, kur shkoi në Tiorino, dhe pastaj më 1934-1936. Çuditërisht në këtë banesë, në pjesën përdhese (gysmë bodrum) do të themelohej partia komuniste shqiptare.




Tirana më 1929 si e kishte lanë Prenk Pervizi kur shkoi në Torino.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Ndërkaq kazani po vlonte. Ngjarje të tjera do të ndodhnin, sepse Mbreit Zog kishte afrue rreth vetes ose i i ishin afrue me akroballeqe të ndryshme njerëz të paaftë e sahalëpisë të kryesuem nga mixha i tij Abdyl Rrahman Krosi, i quejtun Lala Kros, injorant e krye intrigant i pa skrupuj, një lloj Rasputini i oborrit, të cilit poeti i madh Gjergj Fishta, kur Lala Kros e pyeti se ç'bejte mund t'i sajonte, aty për aty, Fishta ia qëndsisi:

Lala Kros, Lala Kros,
Vetë shkruen e vetë vulos,
E kush s'i thotë mos

Gjatë kohës së Torinos, në pushimet verore, im atë udhëtonte në Paris, në Romë e në Vjenë, ku kishte miqësitë e tij. Për në Romë mbaj mend, se kur me përcolli njëherë vetë për në shkollë, zuni vend në Hotel "Regjina Karlton" ku e pritën me respekt si një klient i vjetër i hotelit. Nga e kuptova se sa herë që ai vinte në Romë, zinte atë hotel. Pra kishte ardhë herëpashere në kryeqytetin e Italisë për punët e tij.



Pallati i Shkollës së Luftës të Torinos

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



Biblioteka e Shkollës së Luftës së Torinos



Prenk Pervizi midis trupit mesimor dhe koleget e tij italianë të huej të Shkollës së Luftës (ne mes me uniformë t'errët)

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Prenk Pervizi me trupin mesimor dhe kolegë të huej dhe italianë të Shkollës Luftës, (me uniforme t'errtë).



Torino, 1933, Prenk Pervizi, në shoqëri të kolegëve të huaj, në Shkollën e Luftës.

(me geta te bardhë)

Këto fotografi na u dërguen nga Genc Koka, i biri i kolonel Sami Kokës, . koleg e mik i ngushtë i Prenk Perizit, që edhe ai kishte qenë në Torino për Shkollën e Luftë, por u semur keq dhe e ndërpreu në vitin e dytë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Disa mosmarrëveshje

Mbretnia e filloi qeverisjen e vendit me ndryshime të dyfishta, nga një anë u larguen nga detyrat katër zonëkomandantët që kishin stabilizue vendin e forcue shtetin, të cilët u kufizuen në detyra të tjera ku nuk mund të ushtronin autoritet, pra u kthyen në zyrtarë t'administratës ushtarakë (nuk arrihet të kuptohet pse Zogu u suell aq mosmirënjohës). Nga ana tjetër Zogu, afroi në oborrin e tij njerëz të nivelit t'ultë nga ana e përgatitjes profesionale dhe të mpleksun me vese e sjellje të papëlqyeshme, përveç se të pa shkollë, të pajisun me aftësinë e intrigave e të prapaskenave neveritëse, deri dhe banale dhe imorale. Kjo të çudit fort !

Për të qenë të qartë në këtë çeshtje, duhet ditun se kur ishin në Belgrad, ku Zogu kishte krijue shtabin e operacioneve për ndërhymje t'armatosun për me u rikthye në pushtet, u kishte premtue (fjalë burrash) se do t'u jepte pozita në qeveri, si ma poshtë : Muharrem Bajrkatari Komandant i përgjithshëm i xhandarmerisë, Fiqri Dine, Ministër i Brendshëm dhe Zv. Hysni Dema, ndërsa im atë Ministër i Mbrojtjës. Sigurisht me grada të nalta. Siç kemi tregue ata u caktuen në detyrën delikate e prestigjoze si Zonë-komandantë, që kishte kuptimi, e guvernatorëve ushtarakë. Detyrë qe ata kryen me plot sukses në pesë vjet, që ishte edhe një parathanie e detyrave ma të nalta që gjoja do të merrnin. Këtu ngeci puna. Zogu, tashma Mbret, e hangri fjalën e caktoi njerëz të tjerë.

Përsërisim përkufizimin e Julian Amery::

- Ishin Muharrem Bajraktari, Fiqri Dine, Prenk Pervizi e Xhemal Herr[2], që kishin ndjekun Zogun në Jugosllavi ata që luejtën një rol të randësishëm në revolucionin që ndodhi. Me kryerjen e detyrave që kishin, ata fituen influencë të madhe, por kur ata e plotësuen qëllimin e mbretit, Zogu ua theu fuqinë, e cila një ditë mund të rrezikonte dhe atë vetë. Në vend të tyne ai vuni njerëz të rij që tregohëshin ma të bindun ndaj dëshirave të tij sepse ishin ma të varun ndaj privilegjeve që ai u jepte. Kështu mbrenda një periudhe prej pesë vjetësh diktatura mbretnore u ba absolute.

Një përkufizim nga parathania ku ban pasqyrën e historisë shqiptare nga lashtësia deri në kohën tonë, që Amery e paraqet si ngjarje historike vendimtare, pikërisht periudhen pesëvjeçare të katër zonë-komandatëve që ai i quen me termin latin "kuadrumvirat" (sundimi i të katërve). Një përcaktim që përmbledh në pak rreshta ngjarjën ma të randësishme që i dha stabilitetën

[2] Siç e kemi thane, ishte Hysni Dema i katerti dhe jo Xhemal Herri, siç gabimisht ka venë Amery.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

përfundimtar Shtetit të ri shqiptar, që çuditnisht nuk përmendët asgjëkundi nga historianët shqiptarë, dhe duhet të dalë një " Sir ose Lord" anglez që t'u thotë: po pse kaq tru thatë jeni që nuk e kuptoni se historia mbështetet në të tillë fakte kyçe në historinë e çdo kombi e jo ma të Shqipnisë ? Nuk ka fatkeqësi ma të madhe për një popull se sa kur i mohohën ngjarjet a faktet historike që kan ndodhun bashkë me ata burra e patriotë që u përfshinë në to.

Në këto rrethana, im atë, nuk nguroi të ia bante të qartë se ishin krijue situata të tilla që ai, Zogu, nuk po realizonte premtimet që u kishte dhanë me rastin e rikthimit të suksesshëm të qeverisë ligjorc ne dhjetorin 1924 në Tiranë, kur kishte kërkue mbështetjen e plotë të tyne (katër kapitenëve). Jo vetëm nuk po zbatohëshin reformat ekonomike, por as ato organizative, politike e ushtarake, duke e ditun se ushtria ishte shtylla kurrizore e shtetit. Jo ma që kishte mbledh rreth vetes njerëz jo të nivelit që kërkohej.

Mbreti ishte përgjigjun se tani për tani ia donte puna të vepronte ashtu, sepse reformat e premtueme nuk mund të bahëshin nga presioni i madh i bejlerëve, që donin të ruenin privilegjet e pronat që u kishte dhanë Turkia. Nga ana tjetër lypsëshin njerëz të tillë deri sa të formohëshin kuadrot e reja me përgatitje të mire shkollore. Të kishte besim tek ai, se me kohë çdo njeri dhe çdo gja do të vihej në vendin e vet të merituesshëm. Reformat përmirësuese do të kryeshin dhe administrimi i vendit do të kalonte në duer të afta. Për t'i vu kapak kësaj pune, Zogu i propozon babës që të bahej adjutanti i tij, ku do të fitonte gradën gjeneral e privilegjet rrjedhëse. Im atë i ishte përgjigjun se ishte nji detyrë që nuk mund të pranonte, sepse nuk mund të luente rolin e një shërbëtori, qoftë dhe mbretnor, e për këtë nuk e joshnin as gradat as privilegjet. S'ishte nga ata që t'i mbanin pallton e kapelën, e t'i banin lajka. Bile po i vinte çudi se si ia kishte propozue një gja të tillë. Kur im atë e refuzoi propozimin për adjutant i kishte rekomandue Zogut, Zef Serreqin, si i përshtatshëm për atë detyrë dhe faktikisht kështu ndodhi. Kjo shkoi në favor të Zef Serreqit i cili e pranoi detyrën e adjutantit menjëherë e si me « urdhën të peshkut » nga kapiten u ba gjeneral. Ndërsa duhet ditun se adjutantët e Mbretit ishin dy, Llesh Topallaj e Zef Serreqi, ndërsa Hysen Selmani, që ishte matjan dhe kushri me Zogun, u ba komandant i gardes me gradën N/kolonel. Hyseni nuk kishte pergatitje shkollore të duhun ushtarake, ashtu si disa oficerë të tjerë matjanë, që Zogu kishte afrue si besnikë të tij, por ishte njeri burrnor e i besës. Mik i ngushtë i Prenk Pervizit. Këto ishin çështje të brendëshme të oborrit mbretnor, dhe ishte e logjikshme që kështu të ndodhte. Dikush duhet tï kryente ato detyra. Por jo ata që ishin të pajisun me dinjitet e prestizh, veti që nuk i lejonin të kthehëshin në vartës të shkallës së shërbëtorve e të lakejve, qoftë dhe të një oborri mbretnor shqiptar si ai i mbretit Zog..

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Intriga e rreziqe

Kjo gjendje solli një revoltim të ligjëshëm tek im atë me shokë dhe ata menduen që të banin diçka për të vu rregull në këtë drejtim, prandaj ia parashtruen Zogut mendimet e tyne kundërshtuese ndaj situatës që ishte krijue. Si pasojë, Muharrem Bajraktari u prish me Mbretin, të cilit i kishte kërkue të largonte nga pallati Lal Krosin, dhe nga qeveria Musa Jukën, Xhemal Aranitasin dhe Abdurrahman Dibrën. Siduket këta njerëz, për Bajraktarin me shokë ishin tepër negativë dhe ndikonin për keq mbi Mbretin. Duke hasë në mospranimin e Mbretit, Bajraktari ishte largue ne Lumën e tij. Im atë ndodhej në Torino, ku Bajraktar kishte shkue e takue, dhe kishte gjetë përkrahjen e babës për sa kishte veprue. Edhe Fiqri Dine e Hysni Dema me oficerë e miq të tjerë i ishin bashkangjit veprimt të Bajraktarit për me gjet një zgjidhje të përshtatshme për ndryshimet e mësipërme pa cenue Mbretin Zog. Këto ndryshime e të tjera duhëshin ba në të gjithë strukturat shtetnore, nga adminsitrata civile tek ajo ushtarake. Duhej që bashkëveprimi midis tyne të ishte i hekurt dhe i vendosun. Për hir të së vërtetës, ishte Muharrem Bajraktari ma i vendosun ne ketë, sepse ai ia kishte shprehun troç Zogut se me njerëz si Lalë Krosi, Musa Juka e Xhemla Aranitasi me shokë të atij kallepi nuk mund të drejtohej shteti, dhe se ai nuk pranonte me i shërbye vendit me ta. Në këtë shtjellim ishte përfshi dhe Gjon Markagjoni e disa përsonalitete të larta krahinore si dhe oficerë akademistë të ushtrisë dhe të xhandarmërisë. Ata do ti parashtronin Zogut programin e tyne, dhe t'i kërkonin mbështetjen si udhëheqës e Mbret i shqiptarve. Por Lal Krosi, që ishte torla e dreqit, i doli para kësaj pune me anë të spiunëve të tij dhe ia paraqiti Zogut orvatjen e tyne si kompllot e grusht shteti. Veçse katër kapidanat kishin edhe ata besnikët e tyne kudo dhe u njoftuen për rrezikun që u kanosej, kështu ata u detyruen të largohëshin e të qëndronin jashtë shtetit. Im atë ishte në Torino por te tjerët ikën dhe u vendosën në në Vjenë e në Paris. Im atë që ndërkaq vazhdonte Shkollën e Luftës në Torino, shkonte e vinte nga Vjena, që ishte caktue si qendër e tyne. Qeveria ua kishte pre rrogat e ata fërguhëshin me njetet e veta. Im atë si njohës i mire i disa gjuhëve, punonte në përkthime për të përballue nevojat familjare, sepse ai e kishte terhequn familjen në Torino: gjyshën, mamën e ne të tre vllaznit. Ndërsa bursën e Shkollës së Luftës s'ia kishin prek. Unë ishta dy vjeç, pjestar i pandamë i familjes Vllaznit, siç kam thanë ma sipër, vazhdonin shkollën në Lanzo Torinese aty afër Torinos.

Muharrem Bajraktari, Fiqri Dinja, e të tjerë oficerë, besnikë të tyne, e pritnin pa durim ardhjen e babes në Vjenë, i cili ishte caktue me pasë kontakte me ambasadat e hueja, prej zotnimit të gjuhëve, për të gjetë një zgjidhje kësaj pune. Im atë në Vjenë kishte edhe miq e vjetër austriakë, por kishte zanë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

një hotel me nja tre oficerë shqiptarë kolegë të tij. Ndërsa Muharremi me Fiqriun, rrinin në një hotel tjetër. Hysni Dema kishte qendrue në Itali dhe vinte takohej tim atë në Torino. Në kontaktet me ambasadat e hueja, ata kishin marrë përgjigjen e preme se kundër Zogut nuk mund të ndërmerrej asnjë veprim ushtarak apo politik. Shqipnia kishte gjetë qetësi me instalimin e Mbretnisë dhe kjo u mjaftonte vendeve Evropiane. Kjo përgjigje negative i kishte dishprue. Nuk dinin si me veprue. Shpresonin se Zogu do t'arrinte me kuptue se ata nuk kishin qellime të këqija ndaj tij e se ishin intrigat e Lal Krosit me shokë që e kishin krijue këtë situatë të keqe. Sigurisht se këto rrethana kishin shkaktue shqetësim tek Mbreti Zog, sepse katër oficerët ma me prestizh dhe ma besnikë i ishin largue, pikërisht për shkak të rrethit oborrtar e qeveritar të tij. Problemi nuk ishte aq i thjeshtë. Ai vendosi me i lanë kohë kohës. Me prit. E kishte aprovue premjen e rrogave, por pa i cenue nga ana personale e pa marrë asnjë vendim e mase tjetër ndaj tyne. Këtu Zogu tregoi anën e urtësisë e mençurisë së tij natyrale.

Në qëndrimn e fundit në Vjenë, një mbramje, im atë vendosi me shkue te miqt e tij, Muharremi e Fiqriu, dhe i lajmëron shokët se ndoshta nuk kthehej atë natë në hotel. U nis, por nuk i gjeti miqtë në hotelin e tyne. Se ku kishin shkue. Kështu ai u kthye dalë, dhe me që ishte vonë, u drejtue në dhomën e vet për të fjetun. I takonte me kalue para derës së shokëve që ata e kishin lane pak të hapun, duke e ditë se Prenka nuk ishte aty. Në kalim e sipër dëgjon emnin e tij, ndalet e shtang në vend. Po flitej për një plan vrasje të tij në një lokal të njohun në "Praeter", një qendër argëtimi në përiferi të Vjenës, ku zakonisht shkonin së bashku me kalue ndonjë mbramje. Ata do ta ftonin atë që të shtunën mbrama ta kalonin në atë lokal e ta vrisnin sipas një plani djallëzor që të mos i kapte policia. Në atë lokal kishin ndodhë disa vrasje politike dhe ordinere. Do të merrnin masa që Muharremi me shokë të mos shkonin me ta. Në këtë mënyrë ata do të ia hidhin fajin Prenk Pervizit për t'u pajtue me Zogun. Në këtë punë dukej se kishte gisht Raspuntini i pallatit mbretnor. Im atë e kishte përmbajtë veten, dhe kishte vendosë me e luejt rolin e viktimes deri në fund….pastaj do t'ua tregonte qejfin. Ishte e mërkurë. Të premten "shokët" e ftuen me e kalue mbramjen e të shtunës në atë lokal në "Praeter" . Im atë kishte pranue me gjithë qejf, bile i lavdëroi për atë inisiativë të bukur.

- Po Muharremi me Fiqriun nuk do të vijnë ? Kishte pyet.

- E po menduem të mos bahemi shumë, aq vende ka dhe taksia që kemi angazhue.

Erdhi e mbramja e të shtunës dhe erdhi dhe taksia. Hypën të katërt si ishin. Im atë hypi prapa midis dy kolegëve. Bukur fort! Udhëtimi shkoi mirë me shaka e biseda të kandshme. Në atë lokal kishte femna të bukura, që ata i njihnin. Thue se nuk do të ndodhtë asgja. Im atë e ferkonte dorezën e revolverit që mbante në xhepin e djathtë të xhaketës, gati për çdo të papritun. Priste me padurim që të arrinin në vend me i qerue hesapet me ato tradhëtarë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

e spiunë të ndyrë. Ai sillej krejt natyrshëm që ata të bindëshin se ai nuk dyshonte për asgja. Por ai vërente që, sa ma shumë që i afrohëshin vendit, fytyrat e tyne sikur mpihëshin e zbehëshin. Ma në fund arritën, dhe zunë vend në një qoshe të lokalit veror midis lulesh e pemësh zbukuruese. Im atë atëherë ndërhyni:

- Ju më ftuet, por jam unë që do t'ju qëras kësaj radhe, sepse kam fitue diçka me përkthimet e mia.

E kishte thirrë një kamerier që shërbente aty përreth. U porositën birrat e mezet dhe kamerieri ua solli dhe ua vuni përpara me cerimoni. Ai e pagoi në vend kamerierin duke i dhanë një bakshish ma tepër se duhej.

- Ç'ban or Prenk, mos ke pare me derdh ? Foli njeni prej tyne.

- Jo vetëm që kam pare me derdh, por kam dhe plumba, qenbirqena ! Kishte bertitë duke u çue në kambë e duke ua drejtue revolverin sëcilit në kokë. Po kujt doni ju me ia hedhë? A e dini se ua tres trutë n'erë ?.... Por nuk due t'i ndyej duert me do semsile si ju. Hajt nxirrni armët mbi tavolinë, e mos guxoni të lueni as gishtin ! Dëshet me më vra për t'i shkarkue fajet mbi mue ? A po jo ?

Të tre shokët i kishte zanë tmerri, Ku e kishte marrë vesh atë punë ? Mbetën të ngrimë e pa za nga frika. Nxorën revolet dhe i vendosën mbi tavolinë. Im atë ua mori dhe ua treti larg mes pemëve.

- Më vjen keq, se mbetët pa i pi këto birra dhe pa armë. Tani çohuni e ikni e mos më dilni ma kurrë para syve. Ishim shokë, kolegë e miq, por paski qenë skutha e semsile e keqe. Hajt, mbathjani, para së të më ndërrojë mendja ... Zhdukuni !

Ne si familje i njihnim ato përsona, por kurrë nuk i kemi lejue vetes as nuk ia lejojmë që t'ua permendim emnat. Im atë s'e uli kurrë veten që të merrej ma me ta edhe kur puna e detyra e sillnin që të ishin nën urdhnat e tij. As Muharremit, Fiqriut e Hysniut nuk u tregoi, për të mos sjellë acarime të papëlqyeshme, sepse pseudoatentatorët e deshtuem kishin marëdhanje e lidhje gjaku me ta. Ky tregim tani, pas kaq vjetësh lejohet, për të përcaktue se sa poshtë kishte ra katundi nga prania dhe veprimtaria e damëshme e Lal Krosit me shokë, që do të kishte pasoja edhe ma të zeza në zhvillimet e mavonshme.

Këto ngjarje që lidhen me prindin, dhe janë në dukje ma tepër personale, tregohen për te ndjekun vijimin e jetes tij, jo vetëm ne anen private. Ato lidhen edhe me vijimin historik të Shqipnisë. E kemi thekstue se nuk do të merremi me analiza politike e diplomatike, të ngarkueme me emna, data, takime, tubime, e të tjera zhvillime zyrtare, që janë si një veshje e jashtme e historisë, një paraqitje skematike ose teatrale, ndersa zhvillimi real asht ai që ndiqet hap pas hapi nga një njeri që i ka përjetue e shoqnue ato ngjarje dhe ka qenë vendimtar në zgjidhjen e tyne.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Qendra Praeeter e Vjenës në një foto të tanishme, për të cilën treguem ma sipër.
Kjo qendër ka ekzistue prej kohësh si vend argëtimi e lojrash, lokalësh të bukura,
por dhe ku kryhëshin vrasje ordinere e politike

.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Një atentat i deshtuem

E kemi thanë se në marrëveshje me katër majorët ishte dhe Kapidani i Mirditës, Gjon Markagjoni. Ai nuk kishte lëviz nga Mirdita. Por çështja ishte paraqitë krejt anapolla dhe me insinuata se Kapidani, si Princ i Mirditës ishte një kandidat potencial për me ia zanë vendin Zogut. Rasputini i oborrit, që arriti të anmiqsojë Mbretin me katër ish besnikët e tij, nuk do mjaftohej me aq. Ai me rrethin e vet, kishin vendosë të eliminonte Gjon Markagjonin. Preteksti ishte se ai kishte lidhje e miqesi të fortë me kater majorët. Këto ishin të gjitha hamendje e shpikje të mendjës së Lalës dhe të besnikëve të tij në qeveri, ministra e oborrtarë. Për këtë punë, përmes Bazit të Canës dhe Musa Jukës ishte angazhue komiti ma i famshëm i kohës, mirditori Nikoll Gjoka, të cilin e sollën në Tiranë vetë të pestin, me katër cuba besnikë e trima, me makinën e Bazit. Në Tiranë i treguen Nikollës se duhej eliminue një kundërshtar e anmik i rrezikshëm i Mbretit Zog, të cilin s'ishte nevoj të ia dinin emnin (kështu ishte plani), përkundrejt një pagese të majme prej napolonash florini. Ata i sistemuen ne Hotel Internacional. Në ditën e orën e caktueme do të qëndronin në sallën e pritjes së Hotelit, karshi hyrjës kryesore. Kur t'u jepej sinjali, njeriun e parë që do të hynte nga ajo derë në sallon, ata do ta vrisnin në vend sa të dukej në derë, sepse vetëm ai njeri do të hynte në atë çast. Siç e thamë, për personin, nuk ishte nevoja ta dinin se kush ishte dhe cubave as u shkonte nëpërmend, se kush, në mirëbesim se po i shërbenin qeverisë e mbretit Zog, duke zhdukun një anmik të tij aq të rrëzikshëm. Plani ishte djallëzor. Po të vritej Kapidani, hapej lajmi se e kishin vra Mirditorët e tij. Pastaj ata do t'i pinte e zeza. Patjetër do t'arrësohëshin e denohëshin me vdekje për atë krim. Kështu qeveria e Mbreti dilnin të lamë. Mendohet se Mbreti nuk ishte fare në dijeni të këtij plani, që do t'i paraqitej si një hakmarrje e Mirditorve për ndonjë padrejtësie të Kapidanit. Ishte jashtë mëndjës që Zogu të lejonte një krim të tillë politik. S'ka dyshim se pasojat do t'ishin shumë të këqija në rast të kryerjës së vrasjës.

Në pritje siç po rrinin të pesë trimat në sallonin e hotelit në orën e caktueme dëgjohen zana e hapa. Dikush u jep shej se erdhi çasti i duhun, të rrinin gati. Ata vunë duert në revolet. Hapet dera, e ka me pa vetë Kapidan Gjoni ! Nikolla me cubat shtangën në vend. Si ishte e mundun ? Po pse për të vra Kapidanin i kishin pru aty ? Kapidani sa i pa rrjohu dhe e kuptoi gjëndjen.

- A jeni si jeni burra !Tunjajeta, or Nikoll Gjoka !... Ç'e mirë iu paska pru këndej ? Kishte folë Kapidani duke u përshendetë e përfalë përzemërsisht me Nikollën dhe me të gjerët, sipas zakonit.

- Me të vra ty or Kapidan…. Largohu sa ma parë se ne për të heq qafet

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

ty na kanë pru këtu, por pa e ditë se kush ishte ai që do të vrisnim, u përgjigj Nikoll Gjoka.

Kapidani ia kishte shtrëngue fort dorën Nikollës :

- Mos u mërzitni meca, se mbet Kapidani nuk fiket Mirdita, ka Kapidana të tjerë. Por Nikoll, tashti ruejeni ju veten !

Sakaq salloni ishte mbush me njerëz dhe shoqnues të Kapidanit, i cili menjëherë u kthye dale në aeroport dhe u nis me një avion për në Shkodër. Asokohë punonin privat disa aviona njëmotorësh me dy flatra për postën, por transportonin me pagesë të mirë edhe një udhëtar, aq mbante ai lloj ajrori.

Nikoll Gjoka u gjet ballëpërballë me Lal Krosine e Musa Jukën, që e kishin thirrë në zyrë. Musa Juka, i ishte drejtue gjithë nerva:

- Pse nuk e kryet porosinë për të cilën ishi pague aq mirë ? Si e patëm fjalën ?

- Ç'ka je ka thue brè burrë ? Me vra na Kapidanin, babën tonë ?... Punë që s'bahet kurrë ! Na ktheni në Mirditë se nuk i duem paret e jueja !

Ata kërkuen me marrë një taksi ose makinë tjetër private me pagesë, por nuk pranonte askush. Ishte dhanë urdhën që asnjë makinë të mos i merrte. Atëhere doli nipi i Bazit Canës i cili u vuni në dispozicion veturën, me të cilënh i kishte sjellë prej Mirdite. Mirditorët, prapë në mirëbesim, pranuen, duke mos dyshue. Sespe ishte Bazi që ishte Bazi që i kishte rekrutue e sjellë në Tiranë. Ishin t'armatosun vetëm me nga një revole nagant. Kur arritën në Borizane, nipi i Bazit e ndaloi makinën, gjoja për një difekt. Sa ai zbret, gjoja për të shikue se ç'kishte ndodhë, dëgjohet nga kodrat fishkëllima i një bilbili. U kishin vu pritë. Krisi pushka. Nikoll Gjoka e vret në vend shoferin që kërkonte t'ikte. Por revolet nuk i banin ballë dhjetra pushkëve të xhandarëve. Kështu ndodhi që Nikoll Gjoka u vra vetë i pesti, sepse nuk pranoi me vra Kapidanin, babën e vet. Populli i thuri kangë që këndohej në gjithë krahinat veriore sidomios ne Mirditë e Kurbin. Kanë mbet në kujtesë vetëm këto katër vargje.

.....

Kodër n'kodër bjen bilbili :
- Ndal shofer or zog kopili
Se s'ke pa Mirditë me sy
Që vret veten edhe ty !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



GJON MARKAGJONI
Kapidan i Mirditës

Një hij zezë ra mbi Lal Krosin e Musa Jukën të cilët ishin strumbullarët i gjithë kësaj kurdisje. Njollë edhe mbi Bazin e Canës, ku, rrjedhimisht si dinte si s'dinte, dilte i përlyem edhe Zogu. Këto ishin prapaskenat e turpshme që përdornin xhahilët që kishin rrethue Mbretin, i cili tashma ndjehej i pafuqishëm për t'i kontrollue e ndalue veprimet e tyne që baheshin në emnin dhe autoritetin e tij. Pra, të gjitha këto mbrapshtina, pavarësisht se abuzime të Lalës dhe rrethit tij binin në kurriz të vetë Mbretit Zog. Në kohën e sotme ato do të quhëshin veprime mafioze. Kjo ngjarje u muer vesh sepse Nikoll Gjoka ia kishte diftue një miku të ngushtë të tij, edhe ai mirditor. Ndërsa ngjarjën e pritës ne e morëm vesh drejt nga goja e xhandarëve që kishin qenë në atë pusi, ku ishte i pranishëm vetë Bazi. Jo që dihej prej të gjithëve se ai vazhdonte të merrej me të tilla prapshtina.

Nuk asht fjala për të tregue se si ndodhi kjo ngjarje, që mund të duket se nuk ka lidhje me tregimin tonë, por asht pikërisht ky qëllimi, sepse të tilla ngjarje lidhen me një fije të vetme, që asht ajo e zbatimit të një politikë spastrimi e menjanimi ndaj personaliteteve me ndikim të madh në popull, me pretekste bajate dhe me prapaskena të mynxyrta. Rasti i Gjon Markagjonit ishte ashiqare një orvajtje për të zhdukë figurën ma prestigjoze të katoliqizmit verior, ku Mirdita zinte vendin e parë. Atë që nuk kishte arrit të bante Turkia, që në të kundërtën e kishte njohun shpinë e Kapdanëve si Princa të Mirditës,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

donin me e realizue disa qarqe antishqiptare anadollake. Lal Krosi i qëndronte kësaj pune në krye si organizator dhe nxitës. Ç'pret prej një të tillë injoranti e fanatiku, të cilit i ishte lanë dorë e lirë me u perzie edhe në çeshtjet shtetnore ? Mbajtja e Lalës në oborrin mbretnor, ishte gabimi ma i madh qe kishte ba Zogu. Me këto sjellje, mixha kërkonte me sigurue së pari vetveten, sepse ishte aq i mençur, dhe e dinte mirë se do të vinte një ditë që ai do të bahej i panevojshëm për shoqninë shqiptare, dhe vetë Mbreti do ta hidhte në koshin e plehnave, kur t'i hapëshin sytë. Mjerisht Zogut sytë iu hapën kur gjimuen topat e Italisë fashiste në Durrës. Ishte tepër vonë. Lal Krosi e kishte kullot livadhin e vet pa e trazue kërkush, ndërsa përkundrazi ai i kishte trazue e i trazonte të tjerët. Ngjarja e atentatit të dështuem ndaj Kapidanit të Mirditës, e gjeti Prenk Pervizin në Torino. I vajti fjala atje, nëpërmjet mikut të tij, major Gjon Fushës, që i kishte ba nje vizitë. Gjon Fusha kishte për grue vajzën e madhe të Gjon Markagjonit, Davën. Këtë punë e mori vesh gjithë Shqipnia dhe mirditorët, të cilët ishin inatosun.

Në këtë rast Gjon Markagjoni nuk e perdori forcën e vet për hakmarrje. Ai e kishte atë mundësi, sepse gjithë Mirdita çohej në kambë për një fjalë të tij. Krenët e Mirditës i kishin kërkue me marrë hak për Nikoll Gjokën me shkokë. Në një takim që kishte pasë ma vonë me tim etin, që e kishte dhe kushri, Kapidani i kishte thanë, se sa nuk iu mbush mendja me u hakmarrë, i nxitun edhe nga mirditësit e tij, por e kishte gjykue se ajo punë binte keq për Shqipninë e mund të shkaktonte trubullina të rrezikshme për vetë shtetin. Ndërsa Bazi Canës, prej asaj dite, ruhej e nuk qarkullonte lirshëm si ma përpara, sepse njerëzit e Nikoll Gjokës dhe të shokve të tij ishin betue me marrë hak. Ngjarja e sipërtregueme ka ndodhun rreth vitit 1933.

Shtojmë se major Gjon Fusha, u tregoi prindëve dhe për atë mpleksjën e Zogut balerinën ruse. Ku ishte hap fjala se mund të martohej me të. Por ndodhi se ajo balerina me gjithë nanën e saj ishin largue, sepse ajo s'e kishte pranue atë propozim. Zogu u paskej blerë vilë ne ishujt Antibe, dhe mbush me xhevairë e brilanta, peliçe e sende të kushtueshme. Im atë kishte qeshë, tue u shpreh se nuk po çuditej fort sepse Zogun e njihte mirë, ai e kishte atë dobësi të sfilitej pas femnave. Por në Shqipni ai s'guxonte të merrej me femnat shqiptare dhe kështu Lal Krosi me shokë ia sillnin nga jashtë, anonime, sepse kishin marrë mësim nga Tania Visirova, që u ba çeshtje publike.

Për sa u shkrue ma nalt për atentatin ndaj Kapidan Gjonit, ajo asht nje ngjarje tepër e randësishme që s'asht përmendun ne faqet e historisë shqiptare. Mjafton të mendohet se po të ndodhte një gja e tillë pasojat do të binin shumë të rrezikshme. e katastrofale. Faktikisht ishte perdorun një plan tepër djallëzor, sikur Kapidanin e kishin vra vetë mirditorët, të cilët pastaj do t'i zhduknin (vrisnin), për të justifikue veprimin si një akt kriminal i izoluem. Pra shteti e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

vetë dhe Mbreti Zog dilnin të larë. Po kujt kujtonin se ia hidhnin ? Cilat do t'ishin konseguencat ? Së pari pesë bajrakët e Mirditës, të bashkuem me bajrakët e Kthellës, Pukës, Lezhës e Kurbinit, si dhe Shkodra me Malësinë, do çohëshin në kambë e të rroknin armët, që vetëm Mirdita nxirrte 5000 luftëtarë. S'e hante kush atë kurdisje kriminale. Hakmarrja do t'ishte e paevituzeshme që do të çonte në një destabilizim të rrezikshëm të Shqipnisë. Kush do t'i bante ballë hakmarrjës të atynë 20 bajrakëve, që në Kapidan Gjonin njihnin Kreun suprem të tyne me titull princor dinastik, pasardhës së Lek Dukagjinit ? Mos vallë hante bar populli mirditor ? S'ka dyshim se Mbreti Zog s'ishte fare në dijeni të atij plani djallëzor. Kur ka marrë njoftim, i asht paraqit si një akt kriminelësh dhe prandaj forcat e xhandarmërisë i kishin ndjek dhe vra ato cubat mirditorë. Kjo kuptohën sepse Zogu, siç e permendëm, tregonte gjithmonë respekt ndaj Kapidan Gjonit e Gjomarkajve, si oxhak i parë jo vetëm për Mirditën por mbar Shqipërinë. Duke i kuptue hilet e prapaskenat e Lal Krosti me shokë, ai ua tërhoqi vrejtjën, sepse e kuptoi se në atë ngjarje ata kishin gisht. Ngjarja hyn në ketë libër kushtue Prenk Pervizit, pse e lidhun me procesin e situatave që kalonte vendi. Aq ma tepër se në rast të realizimit të atentatit ndaj Kapidan Gjonit, detyrimish do t'ishte i angazhuem edhe im atë me mbajt qëndrim. Jo vetëm ai por edhe gjithë shoqëria e tij, kryesisht ushtarakët, ku gëzonte ndikim të madh. Mos radhitja e kësaj ngjarje në historinë shqiptare, tregon dobësinë e madhe të historianëve.



Tirana më 1928 me 16513 banor

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Përsëri në Atdhe

Jemi në një periudhë kyqe. Nana Mbretneshë, ishte një grue mentare dhe ushtronte ndikim mbi të birin. Ajo arriti t'i marrë vesh të gjitha këto prapaskena të Lalës, por duke mos pasë fuqi për me e dëbue nga pallati, ku kishte ngulë rranjë të thella, e këshilloi të birin, Mbretin Zog, që të mos sillej ashtu mosmirënjohës ndaj atyne që e kishin përkrahun në kohët ma të vështira e i kishin ndejtë besnikë deri në fund, tuj ia hapë rrugën deri në pozitën ma të naltë të shtetit, siç ishte ajo e Fronit Mbretnor. Pse ata nuk i honepsnin njerëzit që ai mbante në oborr e qeveri, s'ishte ndonji faj, për deri sa ia kishin vu në dukje drejpërsëdrejti. E mos të lëjonte që të prekëshin figura të tilla si Gjon Markagjoni, nga kurdisjet e Lal Krosit me shokë, që vetë Turkia e kishte njohë si derë princore. Njerëz pa gabime nuk ka, prandaj të ishte ma zemërgjanë ndaj shokëve të luftës dhe të përpjekjeve për krijimin e forcimin e Shtetit Shqiptar dhe krijimin e Mbretnisë Shqiptare. Njerëz që ta kan dashtë gjitmonë të mirën e të kan dalë besnikë në çdo rast. Njerëz ma t'aftë e besnikë ai nuk kishte ku me i gjetë, aq ma tepër që ata gëzonin prestizh e kishin influencë mbi popullin. E sa për Lal Krosin, mos t'ia vinte fort veshin se nuk ishte aspak burrë i mirë, por një lajkatar e mashtrues i madh, i zoti vetëm për intriga e ngatërresa. Mixhë... mixhë, por te rrinte në punën e vet. Zogu nuk e kundërshtonte kurrrë nanën dhe i pranoi vrejtjët e saj. Ai arriti të kuptojë se nuk duhej sjellë ashtu ndaj atyne që e kishin përkrah dhe i kishin hap rrugën deri në Fronin e Shqipnisë. Kështu që vendosi t'i falë komandantët e miqtë e shtrejte, duke dhanë urdhën t'u paguhëshin gjithë rrogat e prapambetuna dhe që të vazhdonin funksionet e tyne në ushtri dhe xhandarmeri, dhe në çdo detyrë tjetër si perpara.

Ndërhymjen e nanës Mbretneshë e mori vesh mama jonë, drejt për gojës saj, me rastin e një vizite që mama i bani mbas kthimit nga Italia. Nana Mbretneshë e donte fort mamën tonë dhe e çmonte Prenkën për aftësitë dhe fisnikërinë e tij, dhe e dinte shumë mirë, që ai i kishte zgjidhë birit të saj, Zogut, probleme të vështira, që i njihte tanë Shqipnia. Por Zogu nuk mundi të pëngojë largimin e kapidanave nga Tirana, nën presionin e rrethit oborrtar. Ata u caktuen në detyra në qytete të ndrysme për t'i mbajtë larg njeni-tjetrit, që të mos kishin mundësi me vazhdue lidhjet e ngushta midis tyne. Edhe me Gjon Markagjonin, Zogu, i përmirësoi marëdhanjet, duke i shprehun respekt e nderime kurdoherë, e duke i dhanë bursa të forta për djemtë për vazhdimin e studimeve të nalta në Itali, sipas rangut që u takonte si princa të Mirditës. Lal Krosi mbeti pak keq dhe e mori një qorrim. Por ai lloj Rasputini i regjun, nuk mund të hiqte dorën nga veset e veta të pista.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Ne, im atë, unë; gjyshja e mama, përveç vllazënve që vazhdonin studimet në Torino, u kthyem përfundimisht në Shqipni nga fillimi i vitit 1935 ku im atë u caktue me detyrë në Korçë si Komandant i Qarkut me gradën nënkolonel. Ndërkohë kishte përfundue ndërtimi i shtëpisë së Laçit, ku im atë kishte ble rreth 30 hektarë tokë. Shtëpia e Laçit ishte si qendër e një ferme bujqesore e blegtorale, ku punonin disa bujqë. Aty ne kishim mundësi me kalue pushime verore duke i gërshetue me ato që kalonim në bjeshkët e Skurajt, te kushërijt tanë.

Përgatitja e naltë ushtarake i vlejti Prenk Pervizit moralisht si ngritje të autoritetit tij si shtatmadhor, por siç e kemi theksue disa herë, intrigantët dhe dashakeqët mbillnin vetëm ferra në rrugën e tij, për ta pëngue me çdo kusht për arritje ma të larta. Prandaj sa u kthye nga Italia, ku kishte fitue shtamadhorinë, transferohet pa asnjë arësye në Korçë. Pra largohët nga Tirana. Ai transferim pa asnjë arëye bindëse të një nga ofierët që ishte dërgue me mbarue shkollën e shtamadhorisë dhe përfundoi në skajin ma jugor te vendit befasoi të gjithë kuadrot e ushtrisë shqiptare. Pse një masë e tillë e pavend ? A kishte dijeni Mbreti se ç'bahej pas shpinës tij ?

Korça në fakt ishte si një qendër përqendrimi i njerëzve të dyshimte, civilë apo ushtarakë. Kjo masë siduket përfshiu edhe Prenk Pervizin, i cilësuem pas shpine si "kaurr" i rrezikshëm. Edhe disa oficerë të tjerë me grada ma t'ulta që nuk i parapelqenin oborrit mbretnor i binin në Korçë. Por Zogu, që siduket mori vesh atë transferim pa vend në Korçë e solli përsëri Prenkën në Tiranë më 1935 pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me detyrë organizative. Në këtë detyrë ai i vuni randësi formimit të kuadrove të nalta ushtarake, duke dërgue shumë studentë, kryesisht në shkollat ushtarake të Italisë, por edhe në Francë e gjetke. Njëkohësisht përmirësoi e forcoi kurset e plotësimit për oficerë në Tiranë, ku jepte mësim edhe vetë mbi artin dhe historinë ushtarake.

Siç dihet më korrik 1935 ndodhi ajo që u quejt kryengritja e Fierit, që u nis nga një grup antizogist i organizuem nga një oficer shkodran i xhandarmerisë, Musa Kraja, i cili sulmoi Fierin e arrestoi Nënprefektin dhe Rrethkomandantin, por hasi në qëndresën heroike të toger Vas Kiri, që e theu hovin sulmuse te rebelëve, të cilët kishin vra gjeneralin Gilardi, me origjinë belge, në kalim e sipër nëpër Fier. Kjo lëvizje u duk se do merrte përpjestime të mëdha por doli flluskë sapuni sepse u shue menjëherë. Nxitësi kryesor ishte kapiteni fanolist Riza Cerova, i cili kur dështoi qeveria e Fan Nolit u largue në Bashkimin Sovjetik më 1925 dhe u kthye në Shqipni më 1935, me ide e synime të hapta komuniste, ku menjëherë u aktivizue për përmbysjen e Mbretnisë. Gjeti disa njerëz që iu bashkangjiten të cilët i shtyni me e nisë këtë kryengritje. Por me ndërhymjën e vendosun të forcave qeveritare ai rebelim u mposht. Riza Cerova desh të dilte në Jugosllavi, por u rrethue dhe u vra në këtë orvajtje më 22 gusht 1935. Im atë asokohë gjëndej me detyrë pranë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Ministrisë Mbrojtjës e nuk u paraqit ndonjë rrezik i madh ku mund të jepte kontributin e tij. Tashma shteti shqiptar ishte i organizuem e i forcuem mirë, me garnizone ushtarake e forca të xhandarmërisë në çdo qytet, nën komandën e oficerëve të aftë e me përvojë, të dalë nga kurset e plotësimit dhe Akademitë e Italisë e Francës. Megjithatë kishte dhe raste komandatësh të pashkolluem, për mungesë kuadrosh që akoma nuk ishin formue e vazhdonin studimet përkatëse.



Tirana më 1935-1939

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Me detyrë në Tiranë

Siç treguem ma nalt, në fillim të vitit 1935 ne u kthyem nga Korça në Tiranë dhe u vendosëm në të njëjtën banesë ku familja kishte banue më 1924-1929, para se im atë të transferohej në Torino. Ajo ishte pronë e familjës Toska. Një shtëpi tipike dy katëshe tiranase, me shkallë betoni nga jashtë, në të dy anët, para e prapa. Në katin sipër rrinim ne, ndërsa në pjesën përdhese rrinin ushtarët ordinancë e shërbëtorët. Guzhina ishte në një ndërtesë të veçantë në oborrin prapa. Shpia ishte e rrethueme me një mur, që përfshinte nga ana e përparme një lulishte, ku ngrihej një kumbull e madhe. Ne kufizonim nga veriu me anë të një deriçke me familjën e Engjull Serreqit, vëllaj i gjeneral Zef Serreqit, adjutant i Mbretit Zog. Te dy vllaznit shokë shkolle dhe miq të shtrejtë të tim etit. Nga jugu me familjen Toska, pronarë të shtëpisë ku ne banonim me qëra.

Më që flasim për këtë shtëpi, aty ne banonim në periudhën 1924-1929, kur im atë ishte zonë-komandant, ajo ishte si një qendër e randësishme takimesh. Aty vinin herë pas here miqt e kolegët të tij, M. Bajraktari, Fiqri Dine, Hysni Dema, Gustav Mirdashi, Hermann Von Kirshner, Aqif Permeti, Ceno Kryeziu, Osman Gazepi, Gjon Fusha, etj., e dy tri herë Ahmet Zogu, gjithmonë në rroba ushtarake si kolonel. Ishte po ajo shpi ku dikur vinin Bajram Curri, Major Preng Jaku, e të tjerë patriotë.

Shtëpia pothuej se ishte kthye ne një zyrë ushtarake, sa qe ndodhte që vinin dhe qeveritarë si Mehdi Frashëri, Abdyl e Xhaferr Ypi, etj., si miq e si zyrtarë. Vinte dhe gjenerali anglez Percy, kolonel Sterling e ndonjë tjetër oficer huej, anglez, francez apo hollandez. Këta oficerë të huej kishin ardhë për organizimin e xhandarmëris e ushtrisë shqiptare. Aty qëndronin vazhdimisht dhjetë nënoficerë të zgjedhun, si njerëz të vendosun tërma e besnikë, kurbinas e mirditorë, që kryenin shërbime të ndrysme dhe zbatonin urdhnat që u jepëshin.. Kjo ka qenë periudha ma e ngarkueme me punë e tim etit në një kohë kur kishte mungesa të mëdha infrastrikturale. Mjetet e qarkullimi e komunikimt ishin të pakta e primitive. Puret kryeshim me kambë, karroca me kuaj, sa që midis Tiranës qarkullohej si në ato filmat e kaubojve, me qytetet gjithë rrëmujë e pluhun, me lëvizje kafshës e karrocash nëpër rrugët akoma të pashtrueme. Mjeti krysor i transportit urban në Tiranë ishin pajtonat me nga një kalë. Makimat e para sa kishin fillue me ardhë, dhe nja dy a tre të tilla ishin në dispozicion të Presidentit. Disa kamionë me rrota të mbushuna për transportin e ushtrisë. Kryeministrave, Ministrave u rrnofshin kambët dhe pajtonat. Zogu kishte dhanë urdhën që të bahej lidhje e posaçme telefonike me shtëpinë tonë, linje direkte me Pallatin Presidencial. Folëm për këtë shtëpi ku ma të shumtën e kohës banoi familja jonë sa që edhe unë e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

arrita në moshën 6 vjeçe, mbasi u kthyem nga Italia, dhe zumë po atë banesë. Kjo përfshirje e saj në ato situata historike nuk do të mbyllej me aq.

Banesa do të hynte në histori edhe ma vonë, jo për mirë, për mos me thanë për keq, sepse aty do të themelohej partia komuniste shqiptare më 1941, pikërisht në katin përdhes. Unë që dyshoja a ishte a s'ishte ajo banesë, në verën 2000 kur shkova në Tiranë, kalova nga rrugica që çonte te ajo; dhe aty e mora vesh se pikërish shtëpia ku kishim banue ne, kishte qenë shtëpia e themelimit të partisë.

Siç thamë, im atë ishte caktue me punë në Ministrinë e Mbrojtjës si drejtor i diskaterit të kuadrove, ku ai organizonte dërgimin e studentëve në shkollat dhe akademitë ushtarake jashtë shetit, kryesish në Itali, për formimin e kuadrove të ngrituna, për organizimin ma të përsosun të Ushtrisë shqiptare. Ai me merrte ndonjëherë në zyrën e tij, duke me paraqitë te kolegët e tjerë, kështu për qejf. Sigurisht si ma i vogli i familjës që isha, gezoja kujdesin dhe llastimin e tij.

Në këtë kujdes me mori me vete në manifestimin e mbylljës së vitit shkollor 1935, që bahej në fushën sportive të futbollit të Shallvarës. Kjo fushë asokohë, ishte krejt fushë e zotit, siç i thonë, pa një fije bari, truell dheu i rrafshuem. Krejt e rrethueme me me një avlli dërrasash, dhe fusha vetë me një rrjet teli, pas së cilit rrinin në kambë spektatorët. Nga ana e perëndimit ishte një si podium me derrasa i mbuluem, që shërbente si tribunë për përsonalitetet. Kështu u vendosëm aty ku ishin disa karrika. Aty kishin zanë vend edhe përsona të tjerë me të cilët im atë u përshëndet, të gjithë miq e të njoftun, me pozita shtetnore.

Pas pak erdhi vetë Mbreti Zog, me adjutantin e tij Zef Serreqin, dhe dikën tjetër, në uniforma verore të bardha, ashtu si dhe im atë. Të gjithë të pranishmit ishin çue në kambë. Ai i ndëroi dhe zuni vend në kolltukun e përgatitun kastile për të. Mbreti Zog erdhi thjesht, pa pompozitet e pa roje e bodigarda siç perdorën tani udheheqësit e shtetit. Ne ishim sistemue pothuej ngjit me të. Mbreti pasi u ul, shkëmbej disa fjalë të rastit me babën, dhe e pyeti për mue. Im atë i tregoi se unë isha djali i vogël. Si quhet? Lek? Sa mirë, e gezofsh emnin piçiruk bukurosh, eja këtu. Unë isha afrue krejt i turpshëm, ai më përkëdheli ne faqe dhe më fërkoj kokën dhe qiti një napolon ari dhe ma futi në dorë. Unë isha ba kuq spec nga turpi e me ndjezj fytyra dhe të dy miqtë qeshnin. Kështu vazhdoi manifestimi gjimnastikor i nxanësve të shkollave për atë vit. Si përfundoi manifestimi Mbreti u çue me sukue, dhe pasi përshëndeti të pranishmit, ato pak që zinte podiumi, u përfol me babën tuj dhanë dorën dhe me mue tuj më përkëdhel faqen. Një skenë e tillë nuk do të përsëritej ma dhe për mue do t'ishte kujtimi i parë e fundit për Mbretin Zog. Rrethanat u krijuen të tilla, pse në atë dhjetor baba u nis për në Abisini, ku kishte plasë lufta italo-abisine, si përfaqësues i Shqipnisë në Komisionin Ndërkombëtarë të Vezhguesve që ishte caktue me ndjekë nga afër zhvillimin e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR 2018

luftimëve.

Im atë ishte një njeri i premë dhe autoritar, qendrim që ndikonte dhe ne familje, pavarësisht se ai sillej i dashtun dhe i qetë. Ai kishte respekt e nderim të madh për nanën e tij, nanë voglën, siç e quenim, dhe nuk e fshihte dashuninë ndaj saj, duke ia plotësue çdo dëshirë e duke u përkujdes për shëndetin e saj çdo herë që ajo, për moshën që kishte, ndiente ndonjë shqetësim. Edhe ndaj mamës, ruente marrëdhanje bashkëshortnore shumë të mira, dhe ndodhte që e falënderonte qe ajo i kishte falë tre djem të shëndetshëm dhe të paraqitshëm, pa ndonjë të metë fizike e mendore. Shifet se je sojnike, i thoshte. E sojnike mama ishte me të vërtetë, se i përkiste familjës së bajraktarit të parë të Kthellës, ku të parët e saj kishin privilegjin që të mbanin taki (kësulë) të kuqe, që ishte nje shenjë fisnikërie nga kohnat e kalueme. Sigurisht se për ne fëmijët ishte një idhull, duke qenë se përveç dashunisë e respektit ndaj atij që ishte prindi ynë e zot i shtëpisë, ndikonin dhe historitë që dëgjonim për të kudo shkonim e rrinim.

Përsonaliteti tij i kapërcente muret e shtëpisë dhe të shoqnisë, sepse ai ishte gjetë në situata të tilla të vështire e të rrezikshme (për atë kohë), që i kishte përballue e zgjidhë në sajë të guximit dhe përgatitjës së tij ushtarake, që kalonin në shkallën e heroizmit dhe ishin ba lëgjendë. Pra, edhe ne si fëmijë e vështronim me admirim. Kujdesi për ne ishte shembullor. Mjafton të dihet se ai na drejtoi në shkollat ma të mira të Italisë, duke na pajisun ma së miri për paraqitjen tonë të jashtme, së cilës i jepte randësi, në kuptimin e proverbit shkodran "veshë e kopileshë", por duke theksue e kërkue prej nesh që ta përfaqësonim familjën, prindët dhe vetvetën në naltësinë e duhun edhe në vijimin e mësimëve. Nuk vlen paraqitja pa aftësinë mendore e profesionale. Këto me pak fjalë disa të dhana mbi prindn tonë, jashtë detyrave zyrtare shtetnore.

Respekt për vendlidjën

Im atë ruente kujtime të mira për vend-lindjen, Skuraj, dhe për njerëzit e fisit. Një respekt të veçantë për burrat e vjetër që akoma ishin gjallë, qysh nga koha e Gjin Pjetrit kur ai u kthye nga Austria dhe bani dasmë e martesës tij në Skuraj.

Detyrat e ndryshme dhe jeta e lidhun me kryeqytetin në atë periudhë shumë të ngarkueme me punë, si dhe kalimi në Itali, në shkollën e Luftës në Torino, bashkë me familjen, nanën, gruen dhe fëmijët, e kishin shkëputë nga vendlidja. Kur u kthyem në Shqipni, për Pashkët e vitit 1935, ai vendosi ta kalojë festën në Skuraj, duke me marrë edhe mue me vete, që isha gjashtë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

vjeç. Mbrritëm në Milot, e prej aty mbi kuaj, të shoqnuem nga besnikët tanë, ushtarakë e civilë, hypëm deri te kulla e Nikoll Llesh Gjokës, në Grykën e Bilbilave, e para në radhë e kullave të fisit. Nikoll Lleshi na priti shumë i gezuem për këtë vizitë qe bante baba, që për respekt e thërriste tatë Nikolla. E kaluem atë natë aty, ku u shtrue rakia e mezet dhe darka e pasun me gjithçka. Dy djem të tij shërbenin si nënoficerë e roje me babën, bashkë me nipin e Gjin Pjetrit, Ndue Pal Gjini, Bib Brozin e disa të tjerë që ua kam harrue emnat. Nikoll Lleshi, kushri dhe shok i ngushtë i gjyshi tonë, Frrok Prendit (i ati i babës), banonte në atë kullë të vjetër 100 vjeçare, që sundonte e vetme në gjithë atë grykë të rrethueme me kodra e male, që quhej Gryka e Bilbilave. Nje familje patriarkale prej 30 robsh, prej dy barqëve, të gjyshit të Nikollës, Gjok Nikolla dhe vellajt Ndue Nikolla. Njerëz teper besnikë. Shpia e tyne njihej si shpi e fortë dhe shpi buke, ku gjenin strehim të sigurtë, njerëz të ndjekun nga qeveria dhe nga hakmarrja e hasëmni të tjera personale, për çeshtje gjaku. Aty ishte strehue dikur Abaz Kupi i ndjekun nga forcat e xhandarmërisë të qeverive të ndryshme. Pastaj Mustafa Kruja, nga forcat e Bazit. Edhe komiti i njohun Gjon Rranxi, që gjurmohej për t'u kap ose vra. Ky ishte një komit i rrezikshëm për të cilin ishin leshue edhe një çmim me napolona florini. Rranxi u pre në besë në shpinë e një miku të tij në Mirditë, mbi të cilën akoma dhe sot qendron vula e turpit. Im atë u kenaq me tatë Nikollën, duke kujtue kohët e vjetra, luftat dhe aventurat e tij me gjyshin tonë, kur ishin të ri. Nikolla kishte qenë një ndër luftëtarët ma trima dhe nishantar i madh. Ai kishte marrë pjesë në gjithë luftimet, nga Tallajbeja, Pedhana dhe në rrethimn në Skuraj, ku si nishntar që ishte, Gjin Pjetri e kishte caktue, bashkë me vellain e tij Ndrec Pjetrin, Nikoll Bardhokun nga Malibardhë, Ndue Nikoll Prengën, dajë i babës, nga Bulgëri e të tjerë nishantarë, me gjuejt mbi topçijt turq, që ata i asgjësuen me armët e reja, siç ishin Mauzerët e Austrisë që vrisnin larg e me precizion. Do t'ishte hera e fundit që im atë shihej me tatë Nikollën, sepse nuk do ta lejonin ma detyrat Prej aty duke kalue në Skuraj, im atë vizitoi tre mullijt e Gjin Pjetrit, ku i pari ishte yni e quhej i Frrok Prendit nga gjyshi. Këtë mulli e kishm përgjysme me Gjergj Lleshin, kushri i gjyshit, me të cilin im atë u takue dhe u ndal do kohë me të, pse edhe ai kishte qenë një shok i ngushtë i gjyshit tonë e luftëtar i rrebtë. Kulla e parë, sipër në kodër ishte ajo e Ndrec Pjetrit, vellai ma i vogël i Gjin Pjetrit, ku ky banonte vetëm me të shoqën, sepse nuk kishin pasë fëmijë. Ndreca tashma 75 vjeç, na priti i përmalluem. Ai e kishte dashtë babën fort, dhe kishte ndikue në nisjen e tij për n'Austri, duke e perciellë vetë me tre burra të fisit, deri në Maqedoni, bashke me tre austriakët që kishin kërkue ndihmën e fisit tonë, ku asokohë, Ndreca ishte zot shpie e kryetar i fisit.

Nuk qëndruem shumë aty, vetëm sa për t'u çmallë, dhe kaluem te tri kullat e Gjin Pjetrit, ku njena ishte jona, e dy të tjerat, njena e të birit të Gjinit, Pal Gjin Pjetri, dhe tjetra e nipit, Zef Gjok Pjetri. Pali ishte martue me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

të bijën e Ndue Gjonit, vellaj i Marka Gjonit, e kishte katër djem dhe pesë vajza. Zef Gjokës, nje djalë i kishte dek krejt i ri e ishte ba me tetë vajza, pra kishte dale fare. Ashtu si dhe Ndrec Pjetri. Ne qendruem atë natë aty, ku u ba festë e madhe dhe erdhën edhe të tjerë burra nga fisi që ishin lajmerue, nga brezi i Bib Dodës, që kishte lanë pesë djem. Do të kalonte shumë kohë që im atë të dukej aty, por asaj radhe si gjeneral dhe i dalun në mal, ku ndejti një muej me misonin anglez në ato kulla, siç do të tregojmë ma tutje. Treguem për lidhjen që im atë e ruente me njerëzit e fisit që do t'i dilnin shumë besnikë e do ta ruenin nga orvajtjet e sigurimit, për ta kapë ose asgjësue. Ato do të pësonin dhe ndjekje e tortura, e do të burgosëshin e internohëshin, por askurrë me e tradhtue njeriun e gjakut tyne. Duke mos iu mposhtë komunizmit, asnjenji prej tyne nuk do të pranonte me hy në radhet e partisë dhe as do t'i shërbente regjimit në detyra shtetnore. Nipat e Gjin Pjetrit e të Prenk do të kryenin vepra heroizmi në qendresën kundër diktaturës, ku u vranë e nuk u dorëzuen kurrë gjallë, duke ruejtë traditën e krenarisë e të vetmohimit të të parëve të tyne të lavdishëm. Mbetet një trishtim, vorret e tyne nuk u gjetën kurrë, sepse kriminaliteti i komunistëve s'kishte kufi, sa që edhe vorret ua kishin tretë pa lanë gjurmë. E ndjej për detyrë t'i përmend emna e tyne, aq ma tepër qe unë vetë i kam njohun të gjithë nga afër, dhe kur i kujtoi përmallohëm, aq ata ishin njerëz të mirë e të dashun, por edhe burrnorë, trima e besnikë. Regjimi komunist, tue gjet shkak te Prenk Pervizi, si personalitet e figurë madhoren e fisit dhe krahinës së Kurbinit, veçanërisht të Skurajt, që i përkiste fisit tonë, u vardis mbi ta dhe ua dogji dhe atyne shpitë bashkë me t'onën, pikërisht më 17 janar (1945), që çuditërisht përkonte me ditën e vdekjës së Skënderbeut. Këta kushërij, qëndruen në mal me armë në dorë, duke krye edhe aksione guximtare në përpjekje të vazhdueshme me forcat e ndjekjës. Familjet e tyne ishin internue, gra, pleq e fëmijë. Qëndresa e tyne ishte e tilllë sa që fshati i Skuraj rezultonte i pa çliruar deri më 1952, kur ato u vranë të gjithë. Në fakt në Skuraj nuk ishte vendosë as këshill popullor as organizatë partie. Kush ishin këta trima, luftëtarë të lirisë që qëndruen të pamposhtun ndaj diktaturës ma t'egër që kishte përjetue shqiptari ? Së pari vjen Zef Gjok Pjetri, nip i Gjin Pjetrit dhe kreu i fisit, që u vra nga sigurlmi më 1946. E motra, Mrika, ishte e shoqja e Gjon Markagjonit. Vijnë pastaj tre vllaznit, Ndue, Gjin e Nikoll Pali, bijt e djalit të Gjin Pjetrit, dy u vranë, Ndou e Nikolla, kurse Gjini vdiq në kampin e Tepelenës. Nga barku i Gjergj Lleshit, kushri i babës, janë dy vllaznit, Ndue e Mhill Gjergji. Mhilli i arrëstuem e i mbytun nën tortura më 1949. Ndërsa Ndou, një ndër luftëtarët ma të shquem të Kurbinit e Mirditës, pas vrasjës së Mark e Lleshi Gjomarkaj, u vra në një pritë në përpjekje për të shpëtue shokun që ishte plagos. Ndue Gjergji ishte udhëheqësi i të arratisunve të gjithë zonës Kurbin, Mirditë, Lezhë e Pukë. Ndër të arratisunit u shque, nipi i tyne Preng Lleshi Gjergji , që u ba tmerri i sigurimit, sa që u hap fjala "Preng e lis", aq u vinte hakut forcave të ndjekjës,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

ku në çdo përpjekje, si nishantar i madh që ishte, ai eliminonte komandantët e komisarët. Kjo qëndresë vazhdoi deri me korrik 1952, ku vrasja e tyne zuni faqet e para të gazetave komuniste si .një lajm i randësishëm i asgjësimit të nipave të Prenk Pervizit e të Gjon Markagjonit. Për të plotësue këtë pjesë të shkrimit rreth kujdesit për fisin, ai pat çue ne shkollë me bursë, disa nga fëmijët e kushrive por edhe të fshatit tij Skuraj të Kurbinit dhe Mirditorë. Ata që mbaruen gjimnazin paten fatin te vazhdojnë shkollat dhe akademitë ushtarake në Itali dhe u banë oficerë. Të tjerë si kryetarë komunësh, nënoficerë të xhandarmërisë dhe në gardën mbretnore.

Në Luftën e Abisinisë

Më dhjetor 1935 plasi konflikti italo-abisin. Kur u paraqit kërkesa për të dërgue një përfaqësues ushtarak pranë Komisionit të Veshguesve Ndërkombetar në atë luftë, ishte emni i tim etit që u përfol dhe u propozue. Vetë Mbreti Zog kishte ndërhy, sepse oborrtarët nuk donin, e kërkonin të shkonin vetë, sepse ai ishte një rast ku do të fitonin namë, sipas tyne. Pra po lufohej me brryla, kush e kush të dali përpara.

- Asnjë prej jush nuk mund ta përfaqësojë Shqipninë ma mirë se Prenka, kishte thanë Zogu, jo vetëm si ushtarak i rangut të naltë por edhe si njohës i disa gjuhëve te hueja e me kulturë të gjanë, prej të cilit vetëm nder do të kishte vendi. Në atë mision ai do te ketë njohje e kontakte me personalitet ushtarake të nalta te hueja, dhe veç ai i përgjigjet asaj situate.

Pra në çastet vendimtare, im atë ishte gjithmonë vendimtar. Asnjë tjetër nuk mund t'i dilte përpara, dhe për këtë kishte dhanë prova në të kaluemen e do të jepte të tjera në të ardhmen.

Komisioni ndërkombëtar përbahej nga oficerë të huej shtatmadhorë, amerikanë, austriakë, hungarëzë, portugezë, rumunë dhe japonezë me një bagazh shkollor ushtarak e kulturor siperor. I gjithë ekipi italian i Shtabit të Naltë të Luftës, ishte i përbamë me gjeneralë e kolonelë, disa prej të cilëve im atë i kishte pasë shokë shkolle. Në Krye të kësaj fushate ishin Marështalli De Bono dhe dy gjeneralët e shquem, Badoljo e Graziani. Prandaj Zogu kur e mori vesh si ishte puna, ishte këshillue me gjeneralin italian Pariani, që ishte dhe ambasador i Italisë në Shqipni, i cili kishte shpreh pëlqimin e tij për Prenk Pervizin, që i përmbushte konditat të një vezhguesi ushtarak me kompetencë e aftësi të një oficeri të naltë siç e kërkonte ai mision. Zogu dha urdhën të premë që në atë Komision dhe në takime të tjera ndërkombëtare, si përfaqësues

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

i Mbretnisë në çështje ushtarake do të caktohej gjithmonë Prenk Pervizi. Në këtë kontekst, oborrtarët dhe intrigantët e tjerë u tërhoqën e nuk kundërshtuen, sepse kështu ato shihnin edhe një shkëputje e largim të Prenkës "kaurrit" nga jeta aktive në Shqipni, ku gezonte respekt e mund të ushtronte shumë ndikim.

Lufta e Abisinisë zgjati gjashtë muej e manovrat vazhdonin me javë të tana. Përveç se ai kishte mungue pesë vjet, kur kishte vazhdue Shkollën e Luftës. Shkurt, rrethit oborrtar u interesonte që ai të rrinte sa ma larg Mbretit Zog, i të cilit dihej se ishte mik e besnik për kokë. Duke e mbajtë larg, Prenk Pervizi mbetej i nderuem dhe i respektuem, por jo ma aq i rrezikshëm sa me ua zanë pozitat në krye t'ushtrisë. Sigurisht mund të krijohej ndonjë rast që ta gjente ndonjë aksident, për të cilin do të derdhnin lot krokodili. Edhe lufta e Abisinisë mund të shërbente në atë drejtim. Ç'nuk ndodh në një luftë !

Pjesmarrja e komisionit të vezhguesve ndërkombëtarë që do të ndiqnin nga afër operacionet e ushtrisë italiane në Abisini, u paraqit edhe në një film dokumentar « Luce » e në gazetat italiane e të hueja (por jo shqiptare) që mjerisht nuk janë gjetë, ndonse diku mund të ekzistojnë.! Ndërsa në Shqipni, ku vazhdimisht shtypi jepte lajme mbi atë luftë, për fat të mirë, kur im atë u kthye nga Abisinia, u mbajtë një takim në kinema "Rozafat"me kuadrot e ushtrisë shqiptare, ku ai foli për zhvillimin e operacioneve ushtarake që kishte ndjekë nga afër, sipas relacioneve të tij, që u botuen edhe në Buletinin Ushtarak të kohës. Gazeta « Besa », nga ana e saj, i kushtoi një intervistë që u paraqit në 16 numëra rresht të asaj gazete, më qërshor 1936. Ai mbajti edhe disa konferenca në Shtëpinë e Oficerëve dhe vende të tjera. Por ishte koha kur në Shqipni nuk ishin ngritun strukturat e medias e nuk ekzistonte nje stacion radio dhe as mikrofonë. Shumë aktivitete kulturore mbetëshin pa u përhapë ose zhvillohëshin pothuajse primitive.

Si qendronte puna e këtij komisioni ?

Kur kishte plasë Lufta e Abisinisë, Musolini kishte kërkue nga Shqonia e Kombëve që të dërgonte një grup vëzhguesish ndërkombëtar. Shqonia e Kombëve i kishte vendosë Italisë sanksionet (bllokadë) ekonomike, dhe kështu vetëm gjashtë vende që nuk i ishin bashkangjitë sanksioneve i dërguen vëzhguesit e tyne në atë luftë: SHBA, Shqipnia, Austria, Portugalia, Rumania e Japonia, të gjithë oficerë madhorë, kolonelë e N/kolonelë. Nga Shqipnia, siç e thamë, u caktue prindi im, ahere N/kolonel. Ishte dhjetori 1935 kur ky komision u nis për në Abisini nga Napoli, ku kishte shkue vetë Duçja për me i takue, për me tregue se kishte përkrahje ndërkombëtare. Kjo u paraqit në një dokumentar viziv "Luce" siç e përmendem ma sipër, por ku nuk jepej shkëmbimi i fjalëve mes tyne. Kur ishte ba prezantimi me përfaqësuesin e Shqipnisë, Duçja nuk kishte ndejtë pa fol me spicë:

- Ah si, l'Albania ! la nostra piccola vicina d'oltre mare !

(Po, Shqipnia, kojshija jonë e vogël përtej detit)

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Im atë nuk kishte durue dhe ia kishte kthye :

- Edhe napoloni asht i vogël, por vlerën e ka të madhe !

Ky shkëmbim frazash ishte shoqnue me të qeshuna, por fjalët e Musolinit kishin një nënkuptim me shije të hidhun për Shqipninë. Aty qiste krye ideja e fshehtë e Musolinit per Shqipninë, ku dallohej deshira e tij gllabëruese, për ata që donin me kuptue. Çeshtja në të tilla raste asht me dashtë ose mos me dashtë me kuptue.

Fushata e Abisinisë zgjati afro gjashtë muej, dhe komisioni i vëzhguesve i ndoqi operacionet nga afër, pranë shtabëve të komandave italiane të frontit të luftës, kryesisht pranë atyne të Gjeneralëve De Bono, Badoljo e Graziani, këto dy të fundit dy kryekomandantët e dy fronteve përkatës, verior e jugor. Në këto komanda im atë kishte takue edhe disa nga ish shokët e Shkollës së Luftës së Torinos, kolonelë e gjeneralë.

Duke kapërcye zhvillimin e ngjarjeve të luftës, mund të themi se në ato kushte ai arriti të formojë bindjen se viktima tjetër e oreksit gllabërues të fashizmit musolinian do të ishte Shqipnia. Ky pohim, qe lihej me u kuptue, vinte nga vetë goja e kokave ma të shqueme ushtarake të Italisë, si Badoljo e Graziani, përveç se nga oficerët e tjerë shtatmadhorë, gjatë takimeve, gostive e bisedave shoqnore etj., etj.

Musolinin e kishte pushtue megalomania e ringjalljes së perandorisë romake, me anë të fuqisë ushtarake që ai e ngrinte në qiell, nga fakti i luftës se suksesshme të Abisinisë, ku potenciali ushtarak modern italian kishte pasë epërsi absolute mbi një ushtri primitive me shpata, heshta e shigjeta, të një populli të prapambetun e të pazhvilluem, akoma në gjëndjen e kohës së gurit.

Në këtë kontekst betejash të njëpasnjëshme, në shoqni të kolegëve të tjerë vëzhgues, një miqësi të mirë baba e kishte lidhë me kolonelin amerikan, që më sa më kujtohet e në mos gabohem, quhej Palmer. Ai kishte mbetë i befasuem nga përgatitja e naltë e kolegut shqiptar dhe një ditë prej ditësh i kishte propozue që të shkonte në SHBA, ku do të vlerësohej sipas meritave e do të arrinte sukses e pozita të nalta në ushtrinë amerikane, ndërsa në një vend të vogël e të prapambetun si Shqipnia karriera e tij nuk do të kishte asnjë përspektivë të ndritun. Im atë, duke e falendërue, i ishte përgjigjë se arritjet shkollore i vlenin për t'i shërbye atdheut të tij, të cilit do t'ia kushtonte jetën dhe veprimtarinë sa të kishte frymë, e nuk do të pranonte kurrë të vihej në shërbim të ndonjë shteti tjetër, pavarësisht nga përfitimet e privilegjet e mëdha që mund të fitonte. Respekti për të u rrit tepër në sytë e amerikanit dhe të kolegëve të tjerë vëzhgues. Por edhe ata, kishin arritë me kuptue se Shqipnia do të bahej objekt pushtimi nga ana e Italisë, fill pas luftës së Abisinisë. Kjo shtrohej në bisedat e tyne. Për kujtim, kur u kthyen dhe u ndalën pak në Suez, ato kishin ble disa kuti cigaresh prej argjendi se veta ishin, ku kishin skalitë të një argjëndar firmat e tyne. Përveç fotografive me kushtim e adresave që kishin shkëmbye mes tyne, Mbetën duer thatë ndaj lexuesit,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

sepse nuk ka shpëtue asnjë shenjë e kujtimeve të atij misioni, që ata kishin kalue së bashku, që të mund ta paraqitnim figurativisht në këtë libër, nga fakti i djegies së shpive tona prej komunistëve. Im atë kishte me vete një aparat Agfa me të cilën kishte marrë qindra fotografi, ndër to dhjetra me kolegët e miqt e tij vezhgues dhe gjeneralëve italianë Badoljo e Graziani e te tjerë të shtabëve të asaj lufte. Po ashtu fotografi nga jeta e banorët abisinë, shumë interesante, ku paraqitej gjëndja primitive e një populllsie krejt të prapambetun.

Lufta zgjati nga dhjetori 1935 deri në prill 1936. Kur im atë u kthye në atdhe, Mbreti Zog e priti në audience të veçantë, vetëm për vetëm, si zakonisht. Kjo ishte diçka e çuditshme. Pse ? Që të mos merrej vesh biseda mes tyne ?

Im atë i kishte sjellë si dhuratë dy shpata të çmueshme të Rasëve (princave) abisinë, për të cilat Zogu ishte kenaqë shumë. Im atë kishte folë mbi misionin e kryem. Por me forcë kishte theksue se viktima e dytë do t'ishte Shqipnia. Këtë e kishte kuptue fare qartë nga bisedat në shtabin drejtues të operacionëve. Vetë Badoljo dhe Graziani kishin lanë me kuptue synimin e Musolinit ndaj Shqipnisë, në fjalimet e tyne në mbledhjet e shtabëve, ku naltësonin politikën e Italisë të ringjalljës së Perandorisë Romake, për ku po e drejtonte Musolini. Prandaj lypsej me i ba ballë këtij kërcënimi me një organizim të mire të mbrojtes të atdheut. Musolini donte të ndiqte politikën ekspansioniste të romakëve kur sulmuen Ilirinë duke u nisun nga brigjet shqiptare, e pikërisht nga Durrësi, Apolonia e Vlona. Prandaj i lutej që t'ia besonte mbrojtjen e vendit për me u nda me nder, sa nuk bahej vonë. Zogu e kishte dëgjue me vëmendje duke e falënderue për përfaqësimin e denjë në Luftën e Abisinisë. Për sa shtronte ai mbi rrezikun italian, i kishte thanë shprehimisht :

- Or Prenk, me Italinë kurrë ma mirë s'i kemi pasë marëdhanjet. Shko e rri i qetë e mos u sëkëlldis fort për këtë punë… Unë do ta studioj çeshtjen. Po të vijë puna, përveç teje s'kam kujt të ia besoj organizimin e mbrojtjës. Fjalët e mira e gurët në strajcë.

Këto janë fjalët tekstuale të thana nga mbreti Zog, sipas vetë dëshmisë së dhanë nga prindi im në familje dhe në rrethin e ngushtë të miqve të tij. Siç i thonë, vjen çasti që dielli nuk mund të mbulohet me shoshë. Im atë nuk e kishte zgjatë biseden, atë që duhej thanë e kishte thanë, kush kishte vesh për të dëgjue le të dëgjonte. A buon intenditor, poche parole ! thotë nje prover italian (degjuesit të mirë, fjalë pak). Por diçka të linte me mendue. Kur Mbreti po e merrte vesh se nje rrezik po afrohej, dhe kur i shprehej Prenk Pervizit se po të lindte problemi i mbrojtjës, vetëm atij do të ia besonte, pse e la atje larg në Korçë ? E pse s'e mblodhi shtabin e naltë të shtamadhorisë për konsultim, ai që ishte Kryekomandanti suprem i ushtrisë shqiptare ?

Këto biseda të zhvillueme sy për sy pa dëshmitarë, nuk hyjnë në

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

repertorin e historianëve shqiptarë. Në këtë kontekst im atë me Zogun kanë folun e marrë gjithmonë vendime të randësishme për vetë fatët e Shqipnisë verbalisht në mënyrë direkte, pa shkresurina e proces verbale, bile pa dëshmitarë të pranishëm. Duhet falëndërue Zoti që me ka ruejtë deri në këtë moshë, për të dhanë ato dëshmi që nuk janë dhanë kurrë, sepse mue përsonalisht, që në moshën fëminore më ka ra me qenë i pranishëm në rrjedhat e ngjarjeve shqiptare, ku im atë ishte përfshi. Këto njohuni vinin jo vetëm drejtpërsëdrejti prej tij, por edhe prej njerëzve që e rrethonin dhe e kishin shoqnue në të gjithë veprimtarinë ushtarake e shoqnore. Mjafton të dihet se kam pas fatin të njoh vetë njerëzit që kishin marrë pjesë në operacionet e luftimet që ai kishte zhvillue gjatë kohës 1918-1929, dhe më pas në zhvillimet e tjera, deri te paralajmërimet që i kishte ba mbretit ma se njëherë për nevojën e përballimit të rrezikut të sulmit fashist, që fatkeqësisht ndodhi, duke e gjetë Shqipninë fare të pa përgatitun e pa asnjë mbrojtje efektive.

Për këtë mision në Abisini u organizue për popullin e Tiranës edhe një konferencë e hapun ne sheshin para bashkisë se Tiranës, ku im atë foli hypun në një tavolinë të madhe e rrethueme nga autoritete e kryeqytetit, ndër to Ministri i Mbrojtjës, me shumë oficerë të Ushtrisë Shqiptare e plot popull. Një konferencë tepër primitive për një mision aq të randësishëm, por të tilla ishin kushtet e asaj kohë, ku mungonin mikrofona, altoparlantë, radio, etj., etj. mjete e kondita. Ne i kishim fotografitë, ku im atë i hypun mbi atë tavolinë të madhe, mbi të cilën ishte shtrue në sexhade, paraqitej duke folë me letër në dorë, i rrethuem nga personalitete ushtarake e civile e shumë popull. Por këto fotografi u zhdukën, siç e kemi thanë nga zjarri i barbarëve të shekullit njëzet, komunistët. Ndoshta gjendet, me të tjera, në ndonjë thes të pa hapun të Arkivit të Shtetit. Në këtë ankth të zhdukjës së çdo dokumenti, një natë andërr me doli përpara ajo fotografi, ashtu identike e gjallë siç ishte realisht, e mbeta aq i ndikuem nga ajo andërr, sa që thashë mos vërtet ajo fotografi me kishte ra në dorë. Nga ana tjetër mendova, se me siguri ajo dhe të tjera fotografi do të jene në ndonjë skutë të arkivave të Shqipnisë, pranë institucionëve apo ministrive të ndrysme, por kush i gjen në gjithë atë rrëmujë dokumentash hedhur rifuxho e ngjeshun në thasë ?

Im atë gjatë misionit në Abisini, ndër të tjera kishte marrë shumë fotografi të drejtpërdrejta me aparatin e vet Agfa, jo vetëm nga operacionet luftarake, nga shtabi i naltë italian dhe shokët e kolegë vëzhgues, por dhe nga mjedisi i shoqnisë abisinase, ku dallohej jeta primitive e banorëve me dukuni përtej epokës së mesjetës. Fotografitë u rreshtuen në dy albume të mëdhej e përbanin një dokument të bukur të atij misioni unik, në një toke e në një lufte ku nuk kishte shkel kamba e shqiptarit deri në atë kohë. Fotografitë ishin shoqnue me shënime shpjeguese nga dora e tij. Ishim ne qëmtë që i vendosëm aty me kujdes të madh. Albumet përbanin një dëshmi të mirëfilltë historike të atij misioni. Ai kishte sjellë dhe orëndi të veçanta të atij populli, si shpata,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kama, punime karakteristike në bakër e bronx e ndonjë objekt florini. Një baule të tanë plot e përplot, për miqtë dhe për shpinë, që italianët ua kishin lejue me i marrë vezhguesve të huej, nga plaçka e pasun e luftiës, si kujtim e dhuratë të atij misioni të tyne të veçantë e të papërsëritshëm. Dy shpata princore shumë të rralla e të çmueshëm ia kishte dhurue Mbretit Zog, siç thamë, i cili e kishte vlerësue shumë atë dhuratë dhe e kishte falenderue babën për atë gjest bujar. Me kushtet që u krijuen nën diktaturën komuniste, humbën shumë vlera materiale dhe kujtimore. Ndonjë shpatë abisine mund të qëndrojë e varun në murin e ndonjë dhome qytetare Tiranase, dhe askush nuk e din se nga ka ardhë e kush e ka sjellë e pse gjëndet aty. Pas 51 vjet mbyllje dhe heshtje hermetike (1939-1990) të Shqipnisë, duke shtue edhe, 26 vjet nga 1990 deri më sot që shkruhet ky libër, ç'mund të presish përveçse harresës ? Faktikisht janë punë që kanë ndodhun, sepse unë kam njohun një zonjë të nderueme, arsimtarën e njohun Fatbardha Gega më 1948, kur akoma nuk isha arrestue, e cila kur e mori vesh se i biri i kujt isha më tha se në shpinë e saj ruhëshin dy shpata të bukura abisine, që im atë ia kishte sjellë dhuratë babes së saj, nga që e kishte mik të ngushtë. Ajo më ftoi në shpi, ku unë nuk munda me shkue për disa arësye të mia. Me ka mbetun peng e nuk di a mund ta gjej ma atë shpi e familje. Nga ana tjetër me grabitjen e pallatit mbretnor me 7-8 prill 1939, që u çvesh fare, fund e maje nga populli tiranas i tërbuem prej ikjës tij, shpatat e dhurueme Zogut kushedi ku kanë përfundue dhe a ua di kush vlerën.

Gjithë sa u përmend ma sipër, ndërsa jepet pjesmarrja e Prenk Pervizit si shoqnues i luftës italo-abisine, nuk asht vetëm për me i dhanë vlerë figurës tij, por me nxierr në pah, se aty ai e mori vesh fatin që do të kishte Shqipnia e përfshimë në planet e andrrat e Musolinit, për rikrijimin e Pernadorisë Romake, prandaj invadoi e pushtoi Ethiopinë, për të dhanë titullin "Perandor" mbretit xhuxh të Italisë. Ky synim perandorak romak do të realizohej me pushtimin e Shqipnisë që u hapte rrugë për pushtimin e gjithë Balkanit (ish Ilirisë) siç vepruen paradhësit romakë. Prenk Pervizi e mori vesh mirë, dhe ia çoj në vesh Mbretit Zog, i cikli, siç e kuptoni edhe lexuesi i këtij libri, e bani veshin e shurdhët, e shprehu mendimin se nga Italia nuk i vinte Shqipnisë asnjë e keqe. Po t'shte për një të keqe, hajde de, por Shqipnisë i erdhën shumë të këqija.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Gazeta " Besa " 16 prill 1936

Nga ky njoftim kuptohet se im atë kishte mbajtë disa konferenca, ku nuk ka mbetun asnjë shkrim, por Gazeta Besa botoi një intervistë të plotë te Prenk Pervizit, mbi luftën e Abisinisë, në 16 numëra të saj.



Nënkolonel Prenk Pervizi mban një seri konferencash mbi Operacionet italjane n' Afrikën Lindore

Dje, ora 5 : 30 mbas dreke, në prani të Gj. Myrdacz, Kol. Maddi, Nënkolonel Hysen Selmani dhe të lart nga treqind oficerave madhorë e inferiorë të Garnizonit të Tiranës, që mbushnin sallonin elegant të Shtëpisë s' Oficerave, Nënkolonel Prenk Pervizi filloi serinë e konferencave të lajmëruara rreth operasioneve ushtarake italjane n' Afrikën Lindore.

Në këtë konferencë, e cila ishte si parathanie dhe u ndigjua edhe prej një grupi ndigjuesash civilë, oratori dha një kuadër të plotë e të kjartë mbi gjendjen tokësore e klimatike t' Afrikës Lindore, mbi popullsitë e ndryshme si dhe mbi organizimin civil e ushtarak të Abisinisë e të kolonive italjane, prej ku kanë filluar luftimet që sot vazhdojnë të tërheqin interesimin e krejt botës.

Kjo përmbledhje e themës së konferencës është me të vërtetë shumë e varfër në barazin me përshkrimet e bukura e të plota që bëri oratori mbi viset që ka pasur fatin t' i shohi pak javë më parë, kur që i dërguar si delegat i Shqipërisë në grupin e observatorve oficera të dërguar prej Shteteve që u treguan miq t' Italisë duke mos marë sanksione kundra saj.

Konferenca e z. Pervizi zgjati lart nga një orë e gjysëm edhe tërhoqi interesimin e të gjithë ndigjuesve të cilët, duke ndjekur përshkrimin e oratorit, mundnë të marin një ide më të kjartë jo vetëm mbi gjendjen e vërtetë të viseve ku sot zhvillohen betejat midis Italisë dhe Ethiopisë, por edhe patën rastin të mësojnë kuptimin e shumë fjalëve abisine që përmenden për ditë ndër komunikatat zyrtare dhe ndër lajmet e fletoreve që përshkruajnë fazat e luftimeve.

Në mbarim N-Kol. Pervizi u drejtoi fjalë falenderimi e mirënjohje autoriteteve italjane n' Afrikën Lindore si për pritjen bujare asht dhe për qendrimin miqësor e konfidencial karshi tij dhe kolegëve të cilët u l[illegible] me anë fjalurimesh [illegible] të vizitojnë ballet e luftës si edhe [illegible] përkatës në veprim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Manovrat e Mëdha

Pas katër muejsh, im atë u caktue në delegacionin shqiptar në Manovrat e Mëdha të Italisë bashkë me major Sami Kokën, manovra që do të zhvillohëshin në zonën Irpinia, të provincës Kampania, në Korrik – Gusht 1936. Aty merrnin pjesë përfaqësues ushtarakë nga e gjithë bota. Duçëja donte t'ï jepte madhështi forcës ushtarake goditëse të Italisë, si një Romë e re perandorake (e kishte fitue këtë titull prej Perandorisë Abisine) për t'u afirmue si Fuqi e Madhe e klasit të parë. Këtë fuqi ai do t'a shpallte në mënyrë bombastike në një fjalim që mbajti mbi potencialin luftarak italian prej "tetë milion bajonetash" e mjete lufte nga ma të fuqishmet, si flotë detare, ajrore, nendetesa, tanke etj., etj., duke befasue Evropën e Amerikën deri sa dhe Hitleri u bind dhe vendosi të lidhet me Duçen në boshtin Romë-Berlin, së cilit iu ngjit menjëherë Japonia, aq zulmemadh ishte paraqitë biri i kovaçit Benito Musolini në arenën ndërkombëtare. Manovrat e Mëdha të Irpinias, një demostrim teatral shumë i bukur, ua mbushi mendjen delegacionëve të hueja të gjeneralëve dhe kolonelëve aty të pranishëm, se Italia me të vërtetë ishte ngritë në rangun e një shteti të fuqishëm që do të lozte rol të parë në Evropë e ne
botë. Mendja e madhe e zeza e te zot !

Duke u kthye në tabanin tonë, në mbylljen e manovrave, Mbreti Viktor i ltalisë dhe Musolini shkuen të përshëndesin delegacionet e hueja, ku i pari në radhë qëndrontë "Albania" sipas alfabetit. Mbreti e njihte babën nga Shkolla e Luftës në Torinë, ku Monarku italian shkonte herë pas here në raste festash e të tjera aktivitete. Mbreti Viktor u përshëndet me dashamirësi me Prenk Pervizin, duke i përmendun se Shqipnia kishte nxierrë një strateg të madh ushtarak si Skënderbeun, që studiohej në të gjithë shkollat e Akademitë ushtarake. Mbreti Viktor, kur ishte nda e kishte porositë t'i bante të fala Mbretit Zog. Erdhi radha e Duçës. Ky kur ia presentuen, si duket iu kujtue nga takimi që pati me vëzhguesit e huej në luftën e Abisinisë e duke i dhanë dorën foli me fodullek, siç e kishte zakon.

- La nostra piccola e coraggiose Albania. La faremo grande !...
- Eccellenza, a noi ci basta cosi' comm'è ! Ai kishte kthye flakë për flakë im atë, që e kishte kuptue ku rrihte fjala. Duçja kishte zgurdullue sytë, që i kishte mjaft të mëdhej, i befasuem nga ajo përgjigje e papritë, dhe duke mos ia lëshue dorën, pas pas pak heshtje, ishte nda me këtë përshëndetje :
- Saluti ... Saluti .... Saluti ... a tutti duke kalue tutje.

Si duket desh me i ba te fala Mbretit Zog, por pastaj u tërhoq. Kjo sjellje ishte kuptimplote. Sa ishin aty mbeten të çuditun nga ajo përshëndetje e konklavitun, por shqiptari e kishte kuptue se cka mendonte Musolini.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Kur u kthye në Tiranë, pati serishmi një audiencë speciale me Mbretin Zog, që donte me dintë si shkuen manovrat. Im atë i foli për zhvillimin e mirëvajtjen e manovrave ku ishin shfaqun armatime të reja e shumë ma moderne nga ato të paktat që dispononte Shqipnia. I tregoi se si kishte ndërhy për furnizimin me armatime të reja të ushtrisë shqiptare, por kishte hasun në një refuzim të premë nga autoritetet ushtarake e qeveritare, sa që kishte mbet i çuditun. Pastaj i tregoi për takimin me Mbretin Viktor, që i çonte përshendetjet e tija dhe për bisedën e çuditshme me Duçen, që linte me kuptue se ai e kishte vendosë me e realizue andrrën e peranorisë Romake, duke fillue nga Shqipnia, siç kishin veprue paraardhësit e tij të lashtë me legjionet e tyne kundër Ilirisë. Prandaj Musolini kishte krijue legjionet e këmishave të zeza fashiste në shëmbullin e legjoneve romake. Edhe simbolin e shpatës së liktorit e kishte marrë prej romakëve. Sa nuk ishte vonë, i tha mbretit, të përgatitej mbrojtja e vendit me forcat ushtarake efektive dhe mobilizimin e popullit, për t'u nda me nder, karshi një sulmi të asaj fuqie të madhe që dispononte armë moderne, flotë e aviacion të fuqishëm. Mos të thoshte ma vonë se nuk ishte paralajmerue për ketë punë. Mbreti Zog, përsëri i buzëqeshun si radhën e parë, i ishte përgjigjë tekstualisht :

- Prenk, e kuptoj shqetësimin tand, por mos ia ven fort veshin Duçes, sepse ashtu e ka zakon me i lëshue fjalët... Marëdhanjet me Italinë s'kanë ku shkojnë ma të mira. As për njëqind vjet nuk na gjen gja prej saj… Pastaj ne kemi Zefin në Romë (Zef Serreqin), i cili do të na njoftojë për çdo gja... Megjithatë unë do të bisedoj me qeverinë. Po te jetë puna me organizue mbrojtjen e vendit, veç në ty e mbështes besimin. Ishin fjalë n'erë. Po të njetat si herën e parë që tingëllonin si proverbi popullor, "Fjalët e mira e gurët në strajcë". Përfundimi, Prenk Pervizi u la atje larg në Korçë, kur ashiqare po shifej se Italia fashiste do lëshonte legjionet e veta mbi brigjet shqiptare, siç i kishte lëshue Roma dikur në brigjet e Ilirisë. Por ama Ilirët luftuen trimnisht me në krye mbretnit e mbretneshat e tyne.

Im atië ishte kthye në Korçë, krejt i zhgënjyem se asgja nuk do të bahej, por edhe i pafuqishëm me veprue vetë, edhe po të donte. Punët po shkonin sipas shprehjes latine « ad kalendas grekas », pra, tiq e mos këput. Për oborrtarët e ministrat një organizim i mbrojtjës ishte punë që s'bahej pse kërkont shpenzime të mëdha për armatime. Përderisa nuk dallohej as pritej ndonjë rrezik nga Italia, pse me ba gjithë ato shpenzime të kota? Mo ia ve veshin "kaurrit" se kërkon me i dhanë randësi vetes. Mbreti ju ishte kushtëzue këtyne ndërhymjeve që e kisihi paralizue e s'arrinte të kuptonte se rereziku i varej mbi krye si shpatë e Damokleut.

Përfundimi nga këto dy ngjarje madhore ishte se Prenk Pervizi e formoi bindjën e saktë të planit të pushtimit të Italisë fashiste, jo vetëm nga gjeneralët e kolonelët e ushtrisë italiane, ku disa i kishte pasë shokë shkolle në Torino, por nga vetë diktatori fashist, Benito Musolini, me të cilin kishte ra rasti me

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
SHKODËR (2018)

shkëmbye fjalë e me ia kuptue qëllimin. Këtij i kishte këcye mendja të ndiqte lavdiinë e Perandorisë Romake, dhe prandaj ia kishte vu vetes emnin Duçe, nga termi latin Dux, që shkruhëj kudo me gërma të mëdha, sa që, fill pas pushtimit, u shkrue në gjithë faqen e sipërme të malit të Dajtit me shkronja të bardha. Megalomania i tij i kalonte caqet dhe synimi ishte pikërisht ai, i rrugës së romakëve duke u hedhun nga brigjet shqiptare e pastaj mbi Greqinë e me pushtue gjithë Ballkanin, (Ilirinë) e me çue në vend megalomaninë që e kishte pushtue. Por i kishte ba hesapet keq, sepse përfundoi i varun për kambësh nga vetë italianët, pasardhësit e romakëve.

---

*--Lexuesi dhe aq me tepër historiani do të kenë kuptue randësinë e prestizhin që gëzonte Prenk Pervizi në Shqipni, dhe besimin e vlerësimin e Mbretit Zog ndaj tij. Ku kuptohët se Mbreti vetëm atij ia besonte misionet të karakteri ushtarak me përfaqësue Shqipninë jashtë shtetit. Por nga ana tjetër, Zogun, njerëzit rrethi tij oborrtar e qeveritar, e mbanin jashtë disa masave që ata merrnin, pa dijeni të tij, dhe që pastaj, kur ai i merrte vesh, i justifikonin me insinuata tepër bajate. Siç ndodhi kur ai u kthye nga Italia, pasi kreu Shkollën e Luftës së Torinos, që vlerësohej së shkollë e shtamadhorisë. Pra Prenk Pervizi që ishte ngritë në shkallën ma të lartë të pregatitjës ushtarake me kthimin e tij, pritej emnimi në postinn e Ministrit të Mbrojtjës me gradën gjeneral. Ç'ndodhi ? Ai, për habi të të gjithëve, transferohet në Korçë si komandant garnizoni pa asnjë arësye dhe në kundërshtim me vetë strukturën e kuadrove ushtarake, ku ai ishte me pregatitjen ma të lartë që mund t'arrinte një oficer shtamadhor. Zogu, i ra hilës dhe e kthej në Tiranë, pranë Ministrisë Mbrotjës. Pastaj i besoi misionin si vëzhgues ushtarak ne Luftën e Abisinisë dhe në manovrat e Mëdha të Italisë. Përsëri, pas këtyne detyrave të larta, u përdor e njejta intrigë e largimit tij nga qendra, ku ai ushtrone ndikilm e kishte miqësi të forta. Patjetër për ta mbajtë edhe larg Mbretit Zog, me pretekste tepër banale deri në cilësimin e tij pas shpine si "kaurr". Kjo mund te duket qesharake por ishte shumë e vërtetë. Kështu me 7 prill, Mbreti Zog erdhi ne vete e u ba esull, kur tashma ishte tepër vonë. Prenk Pervizi, patjetër në rol sipëror n'ushtri, do t'i kishte ba ballë pushtuesit italian me aftësitë e tij ushtarake e dinjitet shqiptari. Këto janë mothanat që kushtëzuen qëndresën e shqiptarve, ndonse ndaj një armiku me potëcial luftarak të madh, pa lëshue një kushtrim në mbrotje t'atdheut dhe pa asnjë qëndresë të organizume me në krye oficerët ma të mirë të ushtrisë shqiptare, e cila dolli luq e mbeti krejtësisht jashtë loje. Prenk Perviizit të izoluem në fund të vendit në Korçë dhe i panjoftuem për sulmin fashist, s'i mbeti tjetër veç me prit, mbrojt e përciell mbretin në Greqi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)




Manovrat e Mëdha t'Italisë në Irpinia 20 Korrik -30 Gusht 1936. Mbreti Viktor, Musolini, gjeneralë italianë e delegacione të huaja duke ndjekun nga një podium parakalimin e trupave në përfundimin e manovrave. Kolonel Prenk Pervizi n'uniformë verore të bardhë që shikon me dylbi.



Manovrat e Mëdha të Italisë, korrik-gusht 1936. Në foto: Prenk Pervizi me dylbi, treguar me shigjetën e zezë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Musolini duke pëshendetur trupan italiane parakaluese në përfundimin e manovrave, ku mbajti një fjalim para delegacionëve ushtarake të huaja, ndër to Prenk Pervizi, . Në atë fjalim Duçëja përmendi '8 milion bajonetat' dhe potencialin luftarak të Italisë , për të impresionue të pranishmit. Një fjalim bombastik e propagandistik. Dallohën në radhë të parë oficerêt e lartë anglezë, francezë, Gjermanë, etj.



Princi Umberti II në ispektim në manovrat e mëdha. 1936

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Letër e Prenk Pervizt dergue Atë Gjergj Fishtës
lidhun me një porosi të poetit për n'Abisini..

I ndritshmi Zotni P. Gjergji, *

Në rastin që u takuem, mbas kthimit nga Abisinia, më patët pvet në-se u përdorte n'ato vise lahuta-; unë u kjeçë përgjigjë se nji të këtillë instrument primitiv atje nuk kishe pa-.

Tani, tuj kqyrë në nji gazetë të stolisun me piktura, pash ket fotografi qe po Ju paraqes, në të cillën figuron nji asi instrument si lahutë; kështu të kuptohët se n'ato vise përdoret nji e këtillë vegel.

Ndoshta Z. Juaj keni me e konsiderue si të tepër me këtë letër qi po Ju shkruej për një gja aq të vogël e të pa randsshme, por unë e bana ket hap për me plotsue përgjigjen positive.

Mbasi Korçën pikturore e pat në stinën e dimnit, duhet të vini e ta shifni edhe në stinën e verës , e cilla, besoj ka me t'ju pëlqye ma tepër, po flas për natyrën , se ambienti asht i njajti.

Pranoni, me ket rast, nderimet e posaçme e të falat e mija të sinqerta.

Kolonel Prenk Pervizi.

Korçë, 22/1/1937

---

*--Patër Gjergj Fishta erdhi në Korçë në atë verë 1937 dhe i solli t"im etit dhe Prof. Lugj Muzhani, librin e Lahuës së Malcisë sa ishte botue, me një kushtim të gjatë në gjuhë kopërtinën me bojë kine. Im atë dhe Lugj Muzhani ishin nxanës të tij, dhe më vonë u banë miq të ngushtë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

25 vjetori i Pavarësisë
28 Nëndor 1937

Qyshë në fillim të vitit 1937 ishte shpallun kremtimi i 25 vjetorit të Pavarësisë. Im atë po merrej me stervitjen e trupave për parakalim, ku ishin mobilizue dhe nxanësit gjimnazistë e studentët e liceut francez, për të përmbushë radhet e bataljonit korçar parakalues, sepse kontingjenti i ushtarëve efektivë nuk e plotësonte numërin e duhun të njerëzve as të rreshtave që duhet të parakalonin. Unë, si fëmi që isha shkoja te kazermat bashkë me fëmijë të tjerë, për të pa si bahëshin stërvitjet, nën drejtimin e oficerëve. Ushtarët e veçanërisht studentët ankohëshin me mue :

- Na mori shpirtin ai baba i yt !

Unë si djalë i mirë i thosha babës se po i lodhte shumë ushtarët. Ai qeshte, sepse ashtu ia donte puna që bataljoni i Korçës të paraqitej sa ma mirë në parakalimin festiv që do bahej para Mbretit në Tiranë, ditën e 28 Nëndorit 1937. Qeveria kishte dekretue një pushim të gjatë të shkollave, nj javë. Nga Italia kishin ardhë studentët e shkollave dhe akademive ushtarake, që do të parakalonin me uniformat e tyne të bukura. Edhe studentëve të shkollave civile të Italisë u ishte dhanë leje për këtë ngjarje përkujtimore. Kështu që e gjithë familja u transferue nga Korça në Laç, ku konditat e jetesës ishin shumë të volitshme. Në ditën e festës ne do të ishin të gjithë të pranishëm aty në llozhën kryesore ku do të rrinte vetë Mbreti Zog me familjen, suitën e tij dhe personalitetet qeveritare, ku bante pjesë dhe prindi ynë në uniformë cerimoniale, sepse ai hynte në radhën e oficerëve të naltë shtatmadhorë, që në këtë rast rrinin rreshtue me Mbretin Zog, i cili, siç dihej, ishte kryekomandanti suprem i forcave të armatosuna shqiptare. Dallohej aty edhe kapidani i Mirditës, Gjon Markagjoni me dy djemt, Markun e Nduen, të ardhun kastile nga Italia, ku vazhdonin studimet univesitare. Ne do të shihnim edhe Valentinin që do të parakalonte me studentet e tjerë shqiptarë të shkollave ushtarake të Italisë. Atmosfera festive kishte përfshi gjithë kryeqytetin e festa u përshendet me te shtena topash, kur u dha himni komoçtar, që u këndue nga mbarë populli pjesmarrës. Pastaj Mbreti Zog mbajti fjalimin e rastit e përshëndeti midis brohoritjëve të popullit. Një emocion i madh kishte përfshi njerëzit aty të pranishëm dhe unë dallova lot mallëngjimi në fytyrat e e shumë kujt, si dhe të mamës sime, që ishte një grue me ndjenja të mëdha atdhedhashunie. Aty ishin rreshtue edhe Ambasadorët e vendeve të hueja, veshun me kostumet cerimoniale. Kishte ardhë kastile, i ftuem, gjenerali anglez Sir Jocelyne Percy, dhe të tjerë mik të huej. Parada para podiumit Mbretnor vazhdoi rreth dy orë dhe u duertrokit vazhdimisht nga të pranishmit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Ne kishim zanë vend në një hotel të Begejëve, miq tanë, që ndodhej në rrugën e Dibres pranë selvisë. Pas parakalimit, njerëzit u shpërdanë rrugëve e nëpër kafenetë e lokalet e tjera defryese. Ne vizituem edhe ekzpozitën e 25 vjetorit të Pavarësisë, ku patën rastin të shikojmë të vendosun dhe fotografinë e madhe të gjyshit tonë Gjin Pjetër Mark Pervizit, punue nga Kel Marubi, me disa objekte të tija, si kostumi kurbinas, gjashtën e karadakut me dorezën të derdhun në serm, sahatin e tij me çestekët po prej argjendi, cigarishtën prej fildishi e sermi, dekoratat që ishin akordue nga Austria, pushka historike "Huta", e zbukurueme me pulla sermi e fildishi, siç tregohej edhe në fotografinë e ruejtun në arkiven e studios së Kel Marubit, ku e kishte gjetë im atë. Ai ishte dekorue me urdhnin e flamurit të klasit të parë. Gjin Pjetri kishte ngritë flamurin kombëtar në Milot, pikërisht katër orë para se ai të ngrihej në Vlonë, siç e kemi tregue, në shenjë solidariteti me Ismail Qemalin, prej të cilit kishte marrë telegramin e ditës së caktueme për këtë ngjarje madhore. Aty me ne ishte dhe i biri Gjinit, Pali me të birin Ndue, dhe nipi Zef Gjoka, e të tjerë njerëz të fisit dhe kurbinas e kruetanë të veshun me kostume kombetare. Ku kishin ardhë nga të gjithë krahinat me veshjet e tyne karaktersitike. Gjithë kjo na mbushte me krenari legjitime, dhe unë do ta mbaja mend gjithmonë atë 25 vjetor të Pavarësisë. Sa ra nata festa u përshëndet me fishekzjarre, që i dhanë flakë e bukuri qiellit të Tiranës, mes gezimit e haresë të popullit e veçanerisht të ne fëmijëve që të tilla pamje na pushtonin mendjen, zemrën e shpirtin, si dukuni të bukura prallore. Kështu u mbyll ajo ditë e gjatë festive, e të nesërmen u kthyem në Laç, ku na priste një festë tjetër, ajo e familjes për nder të Gjin Pjetrit. Në dritarët ballore të shtëpisë ishi vendosë flamurët kombëtarë. Shtëpia ishte mbushë me miq që vinin e shkonin për urimin e festës. Ata që mbanin armë nuk rrinin pa përshëndetë sikur t'ishin në dasme, e dasmë ishte, dasma e 25 vjetorit të Pavarësisë. Ditën e 28 nëndorit ishte festue edhe në Milot me cerimoninë e ngritjes së flamuri, po nalt mbi vidhin e madh të Kokajve, ku e kishte ngrit Gjin Pjetri. Ngritjën e Flamurit e përshëndeti nipi i Gjinit, Ndue Pal Gjini, që jetonte me ne, dhe kishte shprazë gjashtë herë revolën e Gjin Pjetrit, ndjekun nga të shtenat e pjesmarrësve të tjerë kurbinas, të mbledhun enkas për këtë festë. Nipi, Ndue Pal Gjini, kishte këndue me çifteli një kangë trimnie kushtue Gjin Pjetrit që ai vetë e kishte krijue për këtë rast, e që ma vonë u ba një kangë që këndohej me çifteli në çdo shtëpi të Kurbinit, ku bukur tingëllonin vargjet heroike:

"....Shkon Urdhaza kuq me gjak,
Kuq me gjak, me gjak nizami,
Luftë po ban Gjin kapidani...."

"....Në Milot Gjin Pjetri foli,
N'vete sot Shqipnia doli,

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Gjashtë herë krisi veç alltia,
Rroftë Flamuri, rroftë Liria!

Për me ma ba qejfin mue, asokohë tetë vjeç, Ndue Pali, nipi i Gjin Pjetrit me bani me gjuej dy herë me koburën e gjyshit, që mezi ia tërhoqa kambëzën me dy duer aq e fortë ishte, për gisht burrash dhe jo çilimijsh.

Siç thashë, ishim bashkue të gjithë familja në Laç, ku erdhi dhe im atë, për të kalue dy ditë me ne. Asht për t'u theksue, se kjo ishte hera e fundit që ne do të ishim të gjithë se bashku, sepse do të krijohëshin ngjarje të tilla të këqija, që familja do të shpërdahej e të katandisej në situata fatkeqe, vuejtjesh e mundimesh të pa fund e krye. Këto do të shpjegohen ma tutje.



Kjo foto asht realizue me 28 nëntoir 1937 në festimin e 25 vjetorit të Pavarësisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Një prapaskenë e pabesë

I hymë këtij përshkrimi të festës së 25 vjetorit të pavarësisë, edhe për një arësye tjetër. Siç thamë, im atë kishte ardhë me kalue dy dit me ne. Ai nuk dispononte veturë të veten, por kishte porositë një veturë që do të vinte ta merrte, në mëngjesin e ditës së tretë, n'ora njëmbëdhjetë, të posta e xhandarmerisë së Laçit, sepse akoma nuk ishte hapë rruga e makinës për në shtëpinë tonë. Atë mëngjes ishim çue të gjithë herët për ta përciellë. Ai do nisej si gjithmonë me disa besnikë të armatosun, nëpër rrugën e fshatit që dilte nga shtëpija e jonë në xhade e pastaj te posta. Ndërsa po bahej gati me u nisë, ndërhyni vëllai im i madh Valentini.

– Jo andej babë, ma mirë bjeri shkurt nëpër shtegun që çon drejt e te posta se sa me u sjellë po nga ajo rrugë që ke ardhë. Nuk asht mirë.

Im at ishte mendue pak, dhe i kishte dhanë të drejt, andej do të kalonin, dhe u nis me katër shoqnuesit që ishin ushtarakë e besnikë, që qëndronin gjithmonë pranë nesh në Laç, Ndue Pali, Bib Brozi, Ndue Molla e Frrok Përvuka. Qielli ishte i vrejtun e pikonte një shi i imtë. Nuk kaluen dhjetë minuta dhe nga ana që u nisën, u dëgjue krisma e një pushke. Ç'kishte ndodhë vallë ? Nuk u dëgjuen të shtena të tjera, pra asgja. Në drejtim të Ndue Palit, papritmas nga një gëmush ferrash kishte lëvizë diçka e madhe, që atij i ishte dukë si një njeri i fshehun. Ai menjëherë e kishte shprazë pushkën në atë drejtim. Kur çka me pa, ishte çue një çabe e madhe peshku, siç e quenin fshatarët, që kishte marrë fluturim nga frika, kur kishte dëgjue afrimin e njerëzve. Nuk u kishte mbetë veçse të qeshnin, dhe ma vonë shokët e tij tallëshin me të, po si o Ndue t'u ba çabja lugat ? Ata arritën të posta, dhe baba hypi nalt te zyra e komandantit, një kapter shkodran, Hil Shllaku. Ai e priti babën me nderime dhe i liroi vendin në tavolinën e zyrës. Porositi një xhandar që të binte kafe e nja dy gota raki nga hani i kruetanit Shim Hoxha që ishte aty ma poshtë. Im atë ishte lagun pakëz. Besnikëve u kishte thanë ta prisnin në han e të merrnin diçka për me pi. Sigurisht raki, pija zyrtare e Kurbinasve. Duhej pritun ma se një orë derisa te vinte makina. Ndërsa po rrinin duke bisedue e duke thithë nga një met raki, ra telefoni. Kapteri e mori. Zani i folësit matanë dëgjohej.

- Urdhnoni zotni, po une jam!, foli kapteri
- A kemi ndonjë të re andej ? U dëgjue ai za që babës iu duk i njohun.
- Jo zotni, asgja.
- Si, nuk ka ndodhë asgja ?
- Jo zotni, asgja nuk ka ndodhë. Qetësi e plotë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Im atë i kishte ba me shej kapterit :

- Bani të fala prej meje.

- Zotni, keni të fala nga Kolonel Prenk Pervizi që asht në zyrën time.

Ishte dëgjue zhurma e mbylljes së telefonit me inat. Im atë dhe kapteri kishin veshtrue njeni tjetrin në sy. Diçka po kuptohej që do të vërtetohej fill pas pak. Nga dritarja që shikonte nga hani, ishte dukun një varg prej nja gjashtë vetësh, të lagun qull, me pushkët e gjata grykë poshtë që ishin drejtue nga lokali, ku hynë brenda. Tani puna po dilte sheshit. Të dy burrat e kishin kuptue pse kishte ra ajo telefonatë e ngutshme e pse ishte mbyllë aq me inat. Im atë e kishte njohun zanin e folësit, ndërsa kapteri e dinte fare mirë se kush e kishte thirrë e pse. Pra, paskej qenë fjala për të. Dikush e paskej marrë vesh ditën e orën kur ai do të dilte te posta. Ato gjashtë burrat po kthehëshin nga prita ku kishin përgjue më kot për një gjah aq të majm ! Një prapaskene pabesë ë felliçqun. Kishin për ta marrë vesh mirë kush ishte Prenk Pervizi ! Im atë i bani me shej kapterit që të ulëshin poshtë deri te hani me nja dy xhandarë, ku ishin edhe besnikët e tij. Hyni në han, e, mbasi përshëndeti hanxhinë, Shim Hoxhën, një kruetan trim e besnik, ishte kthye nga civilët, që kishin zanë nji tavolionë, të cilët kur e panë ishin ba dyll të verdhë dhe kishin ulë kokat.

- Tunjatjeta juej or burra… Si duket nuk u paska shkue mbarë gjahu!.. Pa jepu nga nji gotë raki or Shim Hoxha se qenkan ba qullë e paskan mbetë duer thatë ! Ato të shkretët ishin mpi e zbardhë në fytyrë, dhe e donin veten shtat pash nën dhè.

– T'u rritë ndera zotni, murmuritën me gjysmë zani.

I kishte zanë frika, sepse ia njihnin dufin e rreptësinë.

Ai u kishte hedhë një vështrim përçmues. I kishte njohun disa prej tyne, dhe kishte ardhë ndot për ta, që e kishin ulë veten aq poshtë për do verdhushka të qelbuna. Vendosi t'i poshtnojë përfundimisht.

- Nuk e kam dite se rosat e egra mund të gjuhen edhe me pushkë lufte.... sot po e marr vesh. Apo nuk dilki me gjuejt kështu grup së bashku. Bukur fort ! Çka nuk mëson njeriu në jetë !

Si tha këto fjalë doli prej aty. Foli diçka me kapterin, duke e porositë që nuk ia vlente të merrej me ato semsile. Ndërkaq erdhi vetura dhe u nis për në Tiranë. Ju kujtue Valentini që e kishte këshillue me ndërrue rrugë. Po mos ta kishte dëgjue atë, nuk do të bante ma hije mbi tokë. Ja ku po i çonte mushka disa lloj njerëzish injorantë. Në atë nërvozizëm që e kishte përfshi sa mbrriti në Tiranë kishte shkue drejt e te Lal Krosi duke i kërku ne shpiegim. Sigurisht se Lala bante se nuk dinte gja dhe betohéj se do merrte masa të rrepta ndaj atij që e kishte kurdisë atë punë. Im atë s'kishte durue :

- Dëgjo Abdyl Rrahman Krosi, mos më thançin Prenk Pervizi po nuk ta shova farën në këtë tokë, po u përsërit edhe incidenti ma i vogël, se ma ke pru në maje të hundës e të kam durue mjaft, ty dhe servilët e tu, që po të më

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

mbushet mendja po t'i var si ceraga të thata midis pallatit. Unë dhe ti e dijmë mirë se kujt ia kishe ngarkue atë detyrë, sepse ia njoha zanin në telefon. Më vjen keq për Mbretin që e ke rrethue me lloj lloj semsilesh e lastrokësh dhe po e shtyni drejt greminës me këshilla të mbrapshta. Ban ç'të dyesh me Mbretin tand, se nip e ke, por tash e mbrapa, mue me len rehat ose përdryshe jam unë që s'kam me të lanë rehat ty… dhe ato bashibuzhukët e tu... atëhere nuk ka forcë që të të shpëtojë, e kuptove ? Kaq pata me të thanë ! E bani të fala atij Musa Jukës, me të cilin i ndani këto prapaskena. Por me mue nuk u hec ! Lal Krosi ishte terë në fytyrë, dhe i kishte hy frika në palcë. Mori frymë vetëm kur im atë ishte largue. Prej asaj dite, ai nuk guxonte ma t'i dilte përpara, bile u mundue të sillej sa ma burrnisht me të për të ia zhdukë zemrimin. Im atë kishte marrë vesh se ai i kishte folë Mbretit se Prenk Pervizi duhej të ngrihej në gradën gjeneral dhe të vihej në krye të ushtrisë si Ministër i Mbrojtjes, pasi asnjë oficer tjetër shqiptar nuk e kishte pregatitjen e tij. Mjaft kishte ndejtë Xhemali në atë post. Bile i kishte pohue se ishte sjellë pak keq me Prenkën, i shtymë nga disa spiunë zemërligë.

Atij të cilit ia kishte njohun zanin në telefon, që shitej si mik, i kishte çue fjalë me një njeri besnik, që ia kishte një borxh për atë kurdisje gjuetarësh, dhe të ruhej mirë tash e tutje, për në dashtë mos me iu zhduk fara mbi tokë. Por tashma kishte fillue tëposhtja. Ngjarje të kobshme po përgatitëshin për Shqipninë. Mbretin Zog e kishin mbështjellë merimagat e vetë rrethit të vet. Ai nuk po dinte si me veprue karshi kërcënimit të hapun që po vinte nga megalomnia e Musolinit. Këshilltarët i kishte fare të këqij e të molepsun me pabesi. Agjentët e fashizmit në Shqipni po banin punën si uritha për të çthur organizimin administrativ e ushtarak të vendit. Një far agjenti Xhiro, po shpërndante torba e teneqe me napolona florini. Kjo doli sheshit kur Murat Kaloshi erdhi dhe e shprazi strajcën me napolona florini mu përpara Mbretit, duke i thanë:

-Naltmadhni, asht një Murat Kalosh që po t'i kallzon florijt e Italisë, po a thue ka Murata të tjerë ? Ndodhi që një far majori, i pashkolluem e ingorant, rrethkomandant diku, e merr ne telefon Mbretin, duke i tregue se si t'ia bante me napolonat që i kishin ofrue italianët. Zogu e falenderonte per besnikerinë, dhe napolonat, punë e madhe, le t'i mbante. E di se më je besnik... Pra, shiko ku i çonte mushka disa shqiptarë që e mbanin veten si burra të mirë, e ndryshe nga Murat Kaloshi, kërkonin të tregoheshin besnikë duke e njoftue Mbretin për paret e fëlliquna të Italisë, pse e dinin se Zogu do t'ua linte... Pra, njerëz dy faqesh. Çudia ma e madhe vjen nga vete Mbreti Zog, si nuk e mori vesh se ç'po i kurdisej pas shpine, ku ashiqare dilte se Italia po neutralizonte shqiptarët me pozita, me thanë me fjori për qëllimin gllabërues të saj ? Xhiro kishte shkue edhe në Korçë dhe kishte njoftue se do i bante vizitë t'im etit në shtëpi. Ai i kishte thanë mames, se po t'i përmendte ndonjë send, do t'ia tregone mirë qejfin. Xhiro nuk kishte guxue me u shty

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

dhe ishte tregue gjentil dhe i respektueshëm. Roli i tij dilte sheshit dhe veç Mbreti nuk dinte ose bante se nuk dinte. Mbetët mister, sepse ato napolona florini nuk derdhëshin kot. Sakaq këshilltarët ushtarakë italiane, me anë të Ministrisë së Mbrojtjës e kishin shpërnda ushtrinë shqiptare në skuta e pika pa kurrfarë randësie, larg zonave bregdetare, me qellim të paracaktuem. As një mase mbrojtëse efektive nuk ishte ndërmarrë gjekundi, në asnjë qytet bregdetar, si Durrësi, Vlona, Saranda e Shëngjini. Janë gjithë rrena ato që .shkruhën e shiten nga shtypi dhe nga individë pa taban intelektual dhe aspak historianë. Ministria e Mbrojtjës nuk kishte ba asnjë mbledhje të shtamadhorisë shqiptare, ku përfshihej dhe im atë, për të marrë masa si me iu përgjigjë kërcënimëve të Musolinit. Mbajtja larg e Prenk Pervizit, atje në Korçë, ishte për t'a neutralizue atë, që të mos kishte mumdësi veprimi. Patjetër në këto lojna dukej dora e këshilltarëv italianë, që kishin mbush kryeqytetin. Me largue e mbajt larg gjithë ata që mund të iu kundërvihëshin sulmit që Musolini, Duçëja i tyne, kishin planifikue. Jeta vazhdonte sipas teorisë së strucit, me kokën në ranishte e trupin jashtë. Ndërkohë makina ushtarake nazi-fashiste e kishte fillue marshimin e vet, dhe po provonte forcat në luftën e Spanjës, si stërvitje përfundimtare për aksionet pushtuese që do të ndërmerrëshin me anë të anshlusëve. Hitleri do të sulmonte e pushtonte Çekosllovakinë e aneksonte Austrinë. Hitleri dhe Musolini i kishin nda zonat e ndërhyemjes e të ndikimit. Por po i banin hesapet mirë, siç do të dilte ma vonë. Pritej vetëm ndezja e dritës jeshile për sulmin vendimtar drejt katastrofës botnore. Patjetër për si po shkonin punët, Shqipnia do të ishte nje viktimë e parë. Im atë ishte ma se i bindun pòr këtë fatkeqësi që do ta gjente atdheu, por ishte i pafuqishëm, sepse ia kishin punue shumë postërsisht pas shpiine. Transferimi tij në Korçë kishte një kuptim të keq. Si mbahej larg nga Qendra një oficer i lartë shtatmadhor kur rreziku i një sulmi nga Italia Fashiste dukej sheshit ? Pse vetë Mbreti s'e mblodhi Këshillin e lartë ushtarak të shtamadhorisë me e shtrue çeshtjën e këtij rreziku që mund t'i kanosej vendit ? Në këto rrethana ai i kishte dalë borxhit Mbretit me parlaimerimet, dhe kishte prit që ai të reagonte, siç i kishte premtue, se në rast rreziku atj do të ia besonte mbrojtën e vendit. Fjalë që i mori era. Prit gomar kur të dal bar.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Martësa e Mbretit Zog

Pavarësisht nga ç'farë po përgatitej për shpërthimin e luftës së dytë botnore, Mbreti Zog kishte vendosë me u martue. Ai kishte pasë propozime nga Stambolli për një mbesë të Sulltan Hamidit dhe nja dy vajza bejlerësh turq, që nuk i kishte pranue.Edhe fejesën me vajzën e Verlacit e kishte prishë, tue u anmiqsue me të, sa që Verlaci ishte betue se do të hakmerrej. Zogu kishte nderhy pranë Mbretnisë Italiane për një nga princeshat Savoia, por kishte marrë përgjigjne negative se Dinastia mijavjeçare Savoia nuk mund t'ia jepte vajzat një personi pa as një lloj dinastie. Në analët e Mbretnive, nuk ekzistonte një e tillë dinasti shqiptare. Kështu ai u drejtue në anë të tjera dhe papritun dikush e orientoi drejt Hungarisë ku jetonte një konteshë e re hungareze, që quhej Gjeraldina Apponyj. Thuhet se Zogu e kishte pa ne një fotografi të botueme ne nje revistë të huej. Ndërhyrja pati sukses. Konteshës së re hungareze i kishte pëlqye ky burrë e mbret aq i pashëm, pavarësiht nga mosh e shtyme e tij, rreth 45 vjeç. Ndersa Zogun e kishte zanë vërtet qymyri, siç thonë shqiptarët për atë bukuri të rrallë. Propozimi që ajo të bahej grueja e tij, pra Mbretneshë e Shqipnisë, ishte pranue nga Gjeraldina, nga e ama dhe rrethi i saj shoqnor i aristokracisë dhe Qeverisë hungareze. Por duhej edhe aprovimi i Selisë Shejtë, që një katolike të martohej me një musulman, edhe pse në rang mbretnor. Kjo leje u dha nga Papa Pius XII, me kusht që Mbretnesha të ruente fenë a saj katolike dhe femija qe do të lindte të pagëzohej, si dhe ajo të kishte kishën e saj personale me një prift për ritet e cerimonitë fetare. Ky aprovim i papës çoj në martesën dhe Shqipnia përjetoi atë ngjarje me shumë entuziazëm e haré. U ba dasmë e festë e madhe kombëtare për martesën Mbretit Zog me konteshën e bukur hungareze, e cila me bukurinë e ambëlsinë e saj ua fitoi zemrat gjithë shqiptarve. Në dasmën madheshtore që u ba në Pallatin e ri mbretnor, u mblodh gjithë elita e naltë shqiptare, Ambasadorët e diplomatët e huej, ku im atë ishte i ftuem me gjithë mamën dhe i nderuem pranë qiftit, ku mund të shkëmbente fjalë me Mbretneshën e re sepse zotnonte gjermanishten dhe hungarishten dhe Gjeraldinën e kishte pas njohun ma përpara, në një vizitë në Budapest, ku kishte mikun e tij, kontin Dr. Brozovly. Ajo punonte pranë një biblioteke, dhe i kishte dalë zani për bukurinë e saj dhe origjinën e naltë fisnike. Me rastin e kësaj feste të madhe zonjat shqiptare kishin veshun enkas fustane festive të reja, që t'i përgjigjeshin ngjarjes në naltësinë e duhun, dhe ishin stolisë si asnjherë me gjerdanë e xhevahirë të çmueshëm, që jepnin shkëlqim sallonit të madh të pallatit. Edhe mama ishte përgatitë për atë dasmë si asnjëherë ma mirë. Italia e mori pjesë në atë cerimoni me Ministrin e Jashtëm të saj, Kontin

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Çiano, dhandërr i Musolinit, që u ba dhe kumbarë i qiftit, me një dhuratë marramendëshe (thonë një diamant shumë karatësh me vlerë milionash) që e bindi përfundimisht mbretin Zog, se Italia kurrë n'e kurrës nuk do të ia bante të keqen Shqipnisë. Por thanja latine e poetit romak Virgjili, "Timeo danaos et dona ferentes" (kam frikë nga grekët dhe dhuratat që sjellin) fort mirë përkonte me kuptimin që duhej me pasë frikë nga dhuratat, sado të çmueshme të ishin. Por kjo nuk u muer parasyshë. Në fakt gjithë Evropa e kishte pritë mirë këtë martesë. Mbreti Zog po u tregonte shqiptarve rrugën drejt Evropës dhe qytetnimit perendimor. Urime erdhen nga e gjithë bota. Mbas kremtimit solemn të martesës, qifti mbretnor u nis për me e kalue muejin e mjaltit në Paris. Njerëzit mendonin se tashma vendi kishte gjetë qetesi e stabilitet të plotë për të marshue drejt përparimit e zhvillimit të mëtejshëm. Ishte 28 prilli 1938. Kazani i Evropës po ziente nga zjarri i luftës së Spanjës, ku kishin marrë pjesë disa shtete evropiane kundërshtare, gjoja me forca vullnetare. Rroftë sebepi. Aty kishin rastin me provue arsenalin e armëve të tyne të vjetra e të reja. Italia e Gjermannia kishin ndërhy në krah të Frankos, kundër komunistëve. Sa për njoftim, edhe Bashkimi Sovietik kishte dergue me mija « vullnetarë » përkrah komunistëve. Qellimi i Stalinit ishte me krijue një shtet komunist në Evropë, në varësi të tij, për të shtri dorën mbi shtete te tjera simpatizuese. Shkurt : me pushtue Europën. Kur lufta mbaroi « vullnetarët » u kthyen në Rusi. Pas do kohë u arrestuen, u burgosën dhe u pushkatuen pothuej të gjithë, nën pretekstin se ishin infektue me frymën borgjeze e kapitaliste perendimore. Në atë luftë kishin shkue edhe disa komunistë shqiptarë, që morën pjesë ne atë që u quejt lëvizje çlirimtare, ndërsa ishte lëvizje komuniste, e ma vonë zunë pozita të nalta shtetnore në regjimin komunist, dhe nuk lanë krime pa krye mbi popullin shqiptar. Njeni ma i tmerrshmi prej tyne do t'ishte Mehmet Shehu. Njeri i egër e gjakatar. Të tjerë si Hulusi Spahiu, Petro Marko e ndonjë tjetër perfunduen në burg, sepse me mendime demokratike, që diktatura komuniste nuk i pranonte dhe i denonte. Askujt s'i shkonte mendja se ai prill i hareshëm i martesë mretrore do të kthehej në një prill ogurzez.

Në 28 Nëndorin e po atij viti 1938, përsëri u ba festë e madhe, sepse ishte i pari 28 nëndor për mbretneshën e re e të bukur që stoliste mbretninë shqiptare e për të cilën krenohej i gjithë populli arbnor. Nuk kishte familje shqiptare që nuk e mbante portretin e saj në shtëpi. Në atë nëndor, që do t'ishte i fundit i mbretnisë, mama kishte zgjedhun një fustan ngjyrë krem, shumë të bukur, me të cilin kishte dalë në fotografi në shkallët e shtëpisë së Korçës para se me u nisë në Tiranë, në pritjen që jepte pallati për festen e flamurit. Ishte e vetmja fotografi e mamës që do të shpëtonte nga stuhia komuniste, ashtu kot, e ruejtun nga një person, të cilit i kishte ra në dorë rastësisht. Në këtë pritje të fundit, im atë, që po ndiqte me kujdes zhvillimet e ngjarjeve në Evropë, po dallonte se lufta e Spanjës po shkonte nga fundi i saj, çka do të thonte kthimi i qellimit pushtues të Musolinit drejt Shqipnisë. E

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

kishte kuptue se ai fashisti Xhiro po derdhte flori me thye shqiptarë e pa taban shqiptari. Nderkohe Hitleri kishte fillue anshluset. Kazani po vlonte. Kështu që nuk ndejti pa i kujtue mbretit Zog, edhe në mes asaj feste, se rreziku i fashizmit italian ishte në prak të derës, e sa nuk ishte vonë, t'i dilnin para punës. Por Zogu që tashma po fluturonte në qiellin e lumturisë bashkëshortnore, me një ndër femnat ma të bukura të kohës, nuk donte me ndigjue nga ai vesh, dhe keshtu katastrofa shqiptare po shkonte drejt realizimit të saj, me pasoja aq të tmerrshme për t'ardhmen e vendit, i cili do të kalonte nën pushtimin fashist dhe pastaj nën një nga diktaturat komuniste nga ma të egra të Evropës. Por këto ishin perspektiva që nuk i shkonin ndërmend askujt. As edhe politikanëve ma të shquem të botës e jo ma të Shqipnisë. Paralajmërimet e prindit tim kishin humbun si zani në shkretinë. Vetëm sot pas 75 vjetësh ato fjale kumbojnë si sirena alarmi ndaj çoroditjes që kishte përfshi botën politike shqiptare deri dhe vetë Mbretin Zog.

Kjo ishte arësyeja që më shtyni me shkrue këtë libër për të nxierrë të vërteten ndërsa po ka akoma nga ata që duen ta fshehin minarën në thes. Sado e hidhur të jetë e vërteta duhet thanë.



I pari n radhë Prenk Pervizi në Martesën e Mbretit Zog me Gjeraldinën, 28 prill 1938

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Mbreti Zog



Prenk Pervizi

Lidhur me miqësi qyshë në Vienë 1914-1918 deri kur mbreti u largue në Greqi, dhe ma vonë në mërgim . Prenk Pervizi i qendroi Mbretit gjithmonë besnik e njeri i detyrës, por kurrë idhtar, lajkatar e servil .



Oficerët shtamadhorë*, kolonelët e Mbtertnisë Shqiptare : Prenk Pervizi, Fiqri Dine, Hysni Dema, Gjon Fusha, Aqif Permeti,... (?), Muharrem Bajraktari,... ?), ...(?), Hysen Selmani, foto e vitit 1936, me uniformat e vjetra.*

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

*-- Si ka mundësi që këta shtamadhorë me 7 prill 1939 mbetën pashtë loje dhe nuk u informuan fare për sa po përgatitej e po ndodhte ? Paraprakisht nuk pati asnjë mbledhje të shtatmadhorisë për të shqyrtue çështjën e rrezikut që kanosej vendit dhe masat mbrojtëse që duhëshin marrë. Vetë Mbreti Zog (nuk po flasim për të tjerë) si nuk pati kohë e mundësi të

kapi telefonin e të njoftojë komandantët e garnizonëve të qytetëve, dhe në rastin konkret, si mos me lajmërue atë që konsideronte mik e besnik të tij të vjetër, Prenk Pervizin oficerin madhor ma të lartë i degdisun atje tutje në Korçë me qindra kilometra larg bregdetin ku forcat pushtuese po zbarkonin pa i trazue askush ? Kur mori vrapin e iku, atëherë i ra ndërmend e shkoj e u dorëzue në duer të tij, kur desh të largohej në Greqi. Kjo asht e mbetët krejtësish e pakuptueshme dhe e pashpjegueshme për historinë shqiptare. Bilé asht mangësia dhe e meta ma e madhe e historisë sonë, ku çdo hipotezë që hidhet nuk gjen shpjegim.

Tani një sqarim nga një dokument që asht gjet pas 80 vjet, në Bibliotekën Kombëtare një liërth nga Prenk Pervizi, , me titull, Shënime mbi organizimn e kombit për Luftë, Shtypshkronja Ushtarake, Tiranë, 1935. (katër vjet para pushtimit të Sqhipërisë).

Një lloj parashikimi dhe alarmi për si duhej me pregatitë popullin, dhe me u organizue ushtarakisht, ndaj rerezikut të sulmit nga një shtet armik. Me shumë hollësi dhe këshilla. Në një kohë që askush në Shqiperi, si nga ana e qeverisë, apo e Ministrisë Mbrojtjës, dhe deri vetë Mbreti Zog s'e kishin vu ujët në zjarr për atë punë. S'mund të thuhej se s'ishin hedhë të dhëna paralajmëruese, për mbrojtjën e Atdheut. Por këto fjalë hynin në një vesh e dilnin në tjetrin, dhe vetë Mbreti Zog s'ndërmori asnjë hap në drejtim të mbrojtjës, se si me iu përgjigj një rreziku të mundshëm sulmi të një fuqie të kuaj. Ai s'bani dot një mbledhje më oficerët shtatmadhorë të sipërpërmendur, apo i mbante sa për figurë. Lene pastaj që Prenk Pervizi do t'i dilte borxhit me ndërhyrje të drejtpërdrejta e sy për sy, se Italia fashiste e Musolinit, e kishte synimin drejt pushtimit të Shqipërisë.

Shënim :

Një pjesë e fotografive që paraqitën në këtë libër vjen nga miq e dashamirë, të cilët e dinin se s' na kishte mbetur asgjë nga tonat që kishin përfundue në zjarrin e shtëpive. Ne i kemi pasë të gjitha si koleksion, nga vitet e para deri vonë, si të periudhës së Shqipnisë ashtu të jetës jashtë shtetit, si në Francë, Itali, Jugosllavi (me Zogun), etj. Falendërojmë miqtë që na kanë dhanë nga të tynet, e veçanërsiht për Shkollën e Luftës së Torinos e Manovrat e Medha, z. Genc Kokën, bir'i Kolonel Sami Kokës, koleg e mik i ngushtë i t'im eti. Mundet që dhe pranë familjesh të tjera oficerìësh, kolegë e miq, të ruhën fotografi ku të jetë përfshi edhe im atë. Ne nuk kemi arritë të kontaktojmë, pasi ka kalue një kohë ma tepër 70 vjeçare pa kontaktue me to, siç jemi të shpërndamë nëpër botë. Një falenderim i veçantë i shkon anglezëve Julian Amery (Lord Amery) dhe Kolonelit David Smiley që patën mirësinë të na dërgojnë nga Londra fotografitë e qendrimit të t'im etit në mal në Shqipni me misionin anglez. Ashtu edhe librat që kishin shkrue e bptue për atë kohë. Një dam tjetër që na asht ba ka qenë ai i degjes së studios të Foto Macës në Tiranë, fotograf zyrtar i asaj periudhe, dhe i familjës sonë Foto Macën, pata rast ta takoja më 1945, në studion e djegun, që e kishte riparue, ku ai me priti mirë e me tregoi për damtimin e madh, zhdukjën e gjithë arkivit fotografik të tij, si përcjellës i historisë shqiptare. Dhe i vinte keq që ishin zhdukë edhe të tonat. Ai meritë një respekt e nderim të veçantë për t'im etin. Nga ky takim me Foto Macën mora vesht prej tij se studioja u dogj gjatë asaj që u quejt lufta e Tiranës, por jo nga gjermanët, por nga komunistët (partizanët) që donin me tregue se po luftonin, dhe studion ia kishin djeg qëllimisht, sepse e dinin se aty ruhëshin fotoghrafi dokumentare që nga koha e Turkisë, dhe sidomos të Mbretnisë e deri me 1944. Me këto akte kriminale komunistët e tregonin veten se sa antishqiptarë ishin, duke pasë përqafue ideologjinë e bolshevizmit pansllav që drejtohej nga Stalini dhe zbatohej në Shqipni nga "birkoja" Enver Hoxha.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Disa nga dekoratat e akorduara Prenk Pervizit 1920-1939



Medalje e Trimufit të Legalitetit



Urdhëri Scanderbeg



Urdnni i Lartë i "Besës
më 25 vjetorin e Pavarësisë



Urdhëri SS Maurizio e Lazzaro
përfundimit Shkollës së Luftës.



Urdhni i Lartë i Kurorës së Italisë
me rastin e të misionin në Luftën e Abisinisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Një pauzë e vogël

Nga gjithë sa u shkrue deri këtu mund të mendohët se a kishte kohë ky njeri, me pergatitje kaq të lartë, që të merrej me çështje kulturore e si e shrytëzonte kohën e lirë në disa raste qetësie ? Patjetër se ai e gjente kohën, veçanërish pas mbarimi të Shkollës së Luftës, kur edhe gjëndja në Shqipnisë ishte stabilizue.

Njohës i disa gjuhëve dhe jeta jashtë shtetit, Austri, Itali, Francë, Hungari, i kishin dhanë mundësinë të njihej nga afër me kulturën europiane. Mbante lidhje miqsore e korespindencë me kolegë të tij. Vinin letra nga vende të ndryshme, që ishin ba turrë, për kënaqësinë tonë si fëmijë, që merrnim pullat. Ai ishte i abonuem në disa gazeta të hueja, nga Franca, Italia, Gjerlmania e Austria e ndonjë revistë të karakterit ushtarak por edhe kulturor. Ai mendonte edhe per bibliotekën e shpisë, e pëqëndrueme në Laç. Radhitëshin aty Larusi, Trekani e një enciklopedi Gjermane. Ajo ishte e pasun, si me libra të profilit tij, që i përkisnin historisë se luftave e të strategëve të mëdhej, ku spikasnin emnat e Jul Qezarit, Aleksandri të Madh, Pirros, Napoleonit, pa harrue Skënderbeun e të tjerë gjeneralë. Por e pasun ishte edhe me veprat klasike të lashtësisë, të Rilindjës dhe të kohës moderne duke fillue nga shkrimtarët e mëdhej francezë, rus, anglezë e gjermanë të shek. XIX dhe XX. E kisha pa duke lexue shkrimtarë të kohës si Kronin, Stainbek, Pearl Buck, Keneth Roberts, Margaret Mitchell, Sinclair Lewis, dhe shkrimtarët hungarezë që kishin fitue famë, si Lajos Zilahy, Mihaly Foldi, Ferenc Herzeg, Kelmendy, etj. Për çudi në biliotekë zuni vend edhe vepra e Shollohovit, "Doni i Qetë" në botimin italisht të Bompianit. Ai merrej edhe me shkrime dhe pat botue disa artikuj në një buletin ose revistë ushtarake.Siç e kemi përmend ma sipër, një libër, "Shënime mbi gatishërinë e populli për luftë". Por që askush s'ia vuni veshin. Ai kishte hartue dhe shënime mbi luftën e Abisinisë shoqnue me fotogtafi. Dorëshkrimet e tij me kujtime që prisnin të botohëshin bashkë me kumtesa e artikuj të ndryshëm me tematikë ushtarake. Mbramjëve deri vonë ai degjonte lajmet nga stacione të ndryshme, por edhe muzikë klasike. Kishte sjellë, nga një udhëtim në Vienë, koleksionin e pllakave të operetave Vieneze dhe të repertorit muzikor të Shtrausit, si dhe të kompozitorve të mëdhej, kur akoma nuk kishte fillue të përhapej radio.

Sa ishim në Torino e Firence, e mbaj mend kur na çonte ne teatro, koncerte dhe kinema. Na kishte ba me vizitue vende, muzeume, galeri arti e monumente të randësishëm. Në rast festash, merrte njëse në pritje e në mbramje vallzimi, ku shkonte me mamën. Pra, përveç kohës që i hante veprimtaria tij patriotike dhe detyrat e ndryshme si ushtarak, ai e shrytëzonte atë edhe në drejtim të jetës familjare dhe të asaj kulturore. Në Shqipni kishte

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

miqësi me Mitat Frasherin ose Lumo Skëndo, sa që me kishte takue me më marrë me vete në librarinë e tij në Tiranë. Takohej e rrinte me ish studentë të Austrisë e Gjermanisë, si, Abdyl Ypin, arkelogu Hasan Ceka. Miqësi të madhe kishte me Gjergj Fishtën, që vinte e na vizitonte, e ndër të tjera, kur u botue "Lahuta e Malcisë", poeti kishte ardhë deri në Korçë me ia sjellë tim etit, dhe njëkohësisht Prof. Luigj Muzhanit, dikur nxanës të tij e ma vonë miq. Ai kishte një respekt të veçantë për Ndre Mjedën, që e kishte pasë profesor, dhe gjithashtu për Luigj Gurakuqin, Mati Logorecin, Anton Harapin, e të tjerë intelektualë shkodranë, qyshë të kohës kur vazhdonte gjimnazin në Shkodër.

Ndër të huejt, ai mbante korespondencë me miqtë e vjetër të Austrisë e Hungarisë, ku u kishte ba vizitë herë pas herë. Mbaj mend qe shkëmbente letra me Dukën e Bergamos (kushri i Mbretit Viktor), dhe nja dy gjeneralë italianë, deri dhe me një princ nga Siami dhe një tjetër japonez, ushtarakë të lartë gjermanë, anglezë, francezë dhe austriakë, shokë të Shkollës së Torinos. Nga oficerët me të cilët qëndroi vëzhgues ne Luftën e Abisinisë.Thashë se ne fëmijët ishim mbushë me pulla nga letrat që vinin nga vende të ndryshme.

Kështu në vija të përgjthshme jeta e tij jashtë detyrave dhe veçanërisht jashtë kohës fillestare të krijimit, forcimit dhe stabilizimit të shtetit shqiptar i sapo krijuem, deri në shpalljën e Mbretnisë, ku u duk se Shqipnia gjeti karar. Periudhë tëpër e ngarkueme me ngjarje e situata që kërkonin zgjidhje me anë të forcës ushtarake, ku ai ishte i përgatitun dhe kompetent.



Monumeti i Mujo Ulqinqkut e kalaja ku ai luftoi trimërisht me vetmohim duke dhënë jetën për mrojtjën e Atdheut. Askush tjetër s'mund të guxojë të pretendojë se atë ditë të zezë të 7 prillit të ketë shkrep pushkën kundë invaduesit fashist.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Pushtimi i Shqipnisë
7 prill 1939

Viti 1938, përveç martesës së mbretit Zog, nuk kishte shënue ndonjë ngjarje të vëçantë. Shqiptarët prisnin me padurim lindjen e një princi trashëgimtar, nga që Mbretnesha ishtë shtatzanë. Unë tashma, nga një shtatori isha në Romë ku vazhdoja mësimet në Kolezhin Santa Maria, bashkë me vllaun e mesëm Genc, dhe nuk erdhëm në Shqipni për pushimet shkollore te Krishtlindjeve e të Vitit të Ri 1939, që sgjasnin 20 ditë. Prandaj ngjarjet që vazhdojnë i kam marrë nga prindët dhe njerëzit tonë, si dhe të rrethit miqësor të tim etit dhe besnikëve e oficerëve që kishin shërbye nën urdhnat e tij.

Në atë verë 1938 vijnë në Korçë tre gjeneralë grekë, të cilët i bajnë vizitë private Prenk Pervizit në shtëpi. Ku u pritën ma së miri dhe ku ishte shtrue biseda mbi një rrezik e një sulmi të mundshëm nga ana e Italisë fashiste. Pra grekët kishin arrit me i kuptue qëllimet e Musolinit ndaj Shqipnisë dhe shprehnin frikën se ai do t'i vërsulej edhe Greqisë, po të hidhej në atë aventurë pushtuese, në shembullin e romakëve. Aventurë që po nxitej nga kolegu i tij, Hitleri, që kishte krye aneksimet e shteteve te vogla fqinje të Çekosllovakisë e Austrisë. Kështu ata e siguruen Prenk Pervizin se në rast të një rreziku të tillë do ta kishin mbështetjen e Greqisë, që nënkuptohej se ajo donte ta mbante larg vetës rrezikun që mund t'i kanosej edhe asaj pas Shqipnisë. I lanë atij kartvizitat e tyne, duke e ftue që t'i vizitonte një ditë në Greqi. Përfundimisht, me atë vizitë të gjeneralëvë grekë, kuptohej se çeshtja e pushtimit të Shqipnisë nga fashizmi italian ishte në rend të ditës. Vërtet ishte një vizitë private miqsore, por që përmbante bindjën për këtë rrezik, në një situatë të tillë t'Evropës ku po ndahëshin zonat e influecës dhe të pushtimeve nga tri fuqi të mëdha të lidhuna në një aleancë ushtarake të fortë, që u quejt Boshti Romë-Berlin -Tokio. Haptazi shihej se kjo treshe i kishte vu për qellim vetes me dominue botën.

Ndonse ai 28 Nëndor 1938 kaloi i qetë në sipërfaqe, përmbrenda vlonte vorbulla e prapaskenave që po përgatitëshin për fijimin e Shqipnisë dhe askush nuk e luente gishtin as e qante kokën në atë drejtim. Kjo festë e kishte mbledhë përsëri parinë e Shqipnisë në pallatin mbretnor. Ku isha i pranishëm dhe i nderuem si askush tjetër ambasadori i Italisë, gjeneral Pariani bashkë me Jakomonin e të tjerë diplomatë, ku merrnin pjesë ambasadorët e vendeve të tjera mike, të akredituem në Tiranë. Askujt nuk i shkonte mendja se ai do t'ishte 28 Nëndori i fundit i Mbretnisë Shqiptare, përveç Gjeneral Parianit, Jdhe funksionarëve të tjerë t'Ambasadës italiane, nder ta Jakomoni, që do të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

zëvendesonte ma vonë Parianin si mikambës mbret. Por ata shfaqëshin miqësorë e dashamirë e nuk linin me kuptue asgja, nga çka ata dinin mirë dhe ishin udhëzue nga Roma. Siç e thamë ajo do t'ishte festa e fundit e ditës së Flamurit e të Pavarësisë të Mbretnisë Shqiptare.

Viti 1939 hyni me një dimën të madh, që kishte mbulue me borë gjithë Shqipninë, si për ta mbrojtun nga një kërcënim të mundshëm. Apo mos vallë ajo borë ishte qefini i vdekjes së Mbretnisë ? Kushrini ynë Ndue Pali, që rrinte me në Laç, me shkruente se nga bora e madhe dhe te ftohtit zogjt trumcakë strehohëshin ndër krillat prej druni të dritarëve të shpisë. Pranvera solli një gëzim të madh: më 5 prill gjimuen topat e sihariqit aq të pritun të lindjes së princit trashëgimtar, Leka i parë. Festë e madhe në të gjithë vendin. Urime erdhën nga të katër anët e botës dhe ma të bukurat nga Italia. Megjithëse marëdhanjët me Italinë kishin fillue me u prishë me disa nota kërcënuese, urimet kishin ardhë nga qeveria fashiste e Musolinit, edhe nga Mbreti i Italisë. Kjo i shtynte politikanët shqiptarë dhe oborrtarët e pallatit mbretnor që të vazhdonin të jetonin sipas thanjës "bane Zot andërn" ndërsa ulkonja e zezë fashiste i kishte ngulë mirë dhambët në prapanicat e tyne. Mbreti Zog ishte i përfshimë nga gëzimi i lindjes së trashëgimtarit dhe nuk shihte përtej mureve të pallatit ose të dhomës ku pushonte princi vogëlush dhe mbretnesha lëhonë. Bane Zot andërr, bane Zot andërr !

Por Zoti e bani zhgjandërr, sepse befasisht sa nuk ishte shue ushtima e topave të harëshëm të lindjes së princit trashëgimtar, herët në mëngjesin e shtatë prillit, n'orën 06:30 gjimuen ogurzezë nga deti topat e anijeve (pa gjyle) dhe nga qielli avionët e Italisë që në vend të bombave hidhnin fletushka propagandistike. Por nga deti u sulën mbi Durrësin balozat e zi fashistë, bersaljerët me pupla te zeza këndezi ku i priti vetëm mitrolozi i një kapteri të marinës shqiptare, Mujo Ulqinaku, qe vendosi me flijue veten në mbrojtje të atdheut, n'emën të të gjithë shqiptarve, me që nuk kishte shqiptarë të tjerë pranë tij që të luftonin rreptësisht deri ne vdekje për mbrojtjën e Atdheut. Ja vdekje, ja liri ! Thirri djaloshi trim. Ma mirë me vdek me nder si shqiptar, se sa me jetue si skllav ! Mujo me qendresë e tij, me siguri mendonte se do të hidhej i gjithë Durrës dhe do të çohej ne kambë gjithe Shqipnia në Mbrojtë të Atdheut. Askush s'luejti nga vendi. Një shqiptar i vetëm i doli zot vatanit në ditë ma të zezë të tij, kapteri i marinës Mujo Ulqinaku. E kjo të kuptohet mirë! Ai e meriton të përjetshëm titullin e lavdishën, Hero i Kombit. Për emna të tjerë, asht turp me i përmendë. Nuk e shkrepën një pushkë dhe ikën si lepuj. Por qenë shumë të zot me krijue një prallë e mashtrim të madh të një qëndrese të tyne heroike të paqenë, ndërsa mezi shpëtuen pa u mbyt në kënetën e Gjolit që të mos i zinin rob breshkamanët. Një tjetër shok i tyne super genjështar do të shkruente në një gazetë , se qëndresa heroikë vazhdoi në kënetën e Ishmit ku u vranë 10.000 italianë. Zoti na ruejt deri ku ka shkue fantazia e çproditun e disa shpifsësh e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

rrenacakësh injorantë të kryesisë së legalitetit për të justifikue pushtimin pa pushkë të shprazun, prej vetë Mbretit që duhët t'i kishte ndejt në krye asaj pune, e me pranue me dek për popullin dhe Atdheun, dhe jo me ia mbath si mos ma keq. Na del dhe një tjetër byçim shqiptari që na shpallet se ajo luftë e një heroi të paqenë paskej vazhdue me ditë të tana ! Një rrenë e madhe kur dihet botnish se të nesërmen trupat italiane hynin fitimtarë në Tiranë dhe Konti Ciano zbriste qete qetë nga avioni në mengjesin e 8 prillit në aeroportin e Tiranës, i pritun truimfalisht.

Ana qesharake asht trillimi që gjoja parlamneti e kishte vendosë që Mbreti të largohej. Ku e dinin ata se Italia do të sulmonte pikërisht ditën e 7 prillit ? Askush. As Mbreti as Lal Krosi, hija e zezë e tij, as qeveria me ministrat e saj, dhe aq ma pak Ministri i Mbnrojtjës, një anadollak e copë injoranti, që hante bukën e Shqipnisë e bante duvanë e turkut. Po t'ishte se për Mbretin paskej qenë marrë vendim që të largohet, ai do ta kishte ba atë veprim me qetësi e rregull, dhe jo siç ndodhi që ia mbathi me të katrat krejt i çoroditun e pa lajmërue kërkënd, hajnisht. Si ta kishin ndjek shtatëqind dreqën, ndërsa asnjeri, veç hija e vet. Italianët patën frikë se po del në mal e lëshon kushtrimin. Kur e pikasën që kishte marrë rrugën me dalë në Greqi, e lanë rehat që të kalonte pa e trazue kush, sepse fort kollaj e kishin me çue disa avionë me parashutistë e me ia pre rrugën e zanë rob. Nuk rezulton asnjë urdhën lëshue ushtrisë italiane që ta ndiqnin e ta zinin rob Mbretin Zog. Për ta vra sigurisht se nuk bahej fjalë. Dikur mbretët e princat i prinin në krye popullit dhe ushtrisë. Qyshë nga kohët e vjetra, ne e dimë, që Aleksandri i Madh ishte i pari që hidhej në betejë. Ashtu Jul Qezari, Hanibali, Mbreti Pirro, Agroni, vetë Mbretnesha Teuta, Genci e me radhë deri te Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Po Zogu, a nuk ishte një Mbret pasardhës i tyne që të jepte shembël e t'i printe popullit në një qëndresë heroike kundër pushtuesit fashist. Kush e pengoi ? Veç mendja e vet. Nuk mund të thotë kush se nuk iu propozue të lëshonte kushtrimin e të udhëhiqte rezistencën kundër okupatorit. Këtë do ta shohim ma tutje në tregimin tonë.

Ana humoristike ash ajo kur Konti Ciano kthehet në Romë e takohet me vjerrin Musolinin. Ndërsa përshëndeten Ciano i thote Duçës se si kishin pas frikë mos Mbreti Zog dilte ne mal e lëshonte kushtrimin popullit. Por ai ishte largue në Greqi. Duçëja i ishte kthye : Po i doshun Ciano pse qenkej Mbreti Zog ? Po për të fluturuar ... për të fluturuar i doshur Ciano! E një të ia dhanë të dy të qeshurit. Ky tregim vjen nga një nga sekretarët që qenkej present në atë takim, i cili kishte miqësi me një shqiptar që punonte po në Pallatin Venezia. Jepët për herë të parë në këtë libër.

Të kthehëmi të e vërteta tragjike e asaj dite. Në mengjesin e shtatë prillit, brenda ma pak se dy orë u pushtuen Durrësi, Vlona e Shëngjini. Mbreti Zog, i zgjuem dhe i tronditun në atë mengjes të kobshëm përfundoi në Qafë-Thanë, ku Jugosllavët nuk e lanë me kalue. Ata lejuen vetëm Mbretneshën me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

fosnjën dhe gratë që e shoqnonin. Zogu u ndal me marrë frymë të posta e xhandarmerisë së Qafë-Thanës, me gjithë oborrtarët që e kishin ndjekun, të zhgënjyem nga refuzimi i Jugosllavisë. Ndërsa rrinin aty të mërzitun, kapteri i postës, një matjan, u kishte qit nga një fixhan kafe që ta mblidhnin veten dhe Mbretit sikur i erdh pakëz qerja dhe foli :

- Po ne kemi Prenkën në Korçë ! – dhe i dha urdhën kapterit që të lidhej me Korçën e të thirrte kolonelin në telefon. Sa kapteri bani me ngrit telefonin, veç kur u lëshuen si bisha nja dy oborrtarë e ministra sipër aparatit duke e bllokue :

- Aman mos, Naltmadhni, se na more në qafë ! "Kaurri" ka me na pre në besë ! Aman mos ! Zogu kishte mbet i çuditun.

- Ç'thoni more njerëz ? E njoh mirë Prenkën. Në Korçë do të shkoj patjetër ! Asht i vetmi njeri mbi të cilin kam besim !

Oborrtarët kishin mbetë haru. Ç'ti banin Mbretit ? Atë natë Mbreti u ndal në Pogradec, ku u prit me nderime, pavarësisht nga e keqja që i kishte ra atij dhe gjithë Shqipnisë. Të nesërmën mbrama u nisën për në Korçë. Ishte urdhni i Zogut, sepse ditën mund të rrezikohëshin nga aviacioni italian. Ata kaluen me shumë vështirësi, sepse ajo pjesë e gardës që e shoqnonte ecte ne kambë e veturat ishin tepër të ngarkueme me plaçka e ecnin ngadalë në një rrugë që ishte e shtrueme vetëm me çakull. Arritën mbasmesnatës vonë në Zemblak te shpia e Gani Kullës, ku u strehuen dhe ranë të gjumë nga raskapitja e madhe e mërzia që i kishte zanë. Zogu e kishte porositë të zotin e shpisë, Gani Kullën, me i çue fjalë Prenk Pervizit të vinte urgjentisht aty. Tepër vonë ! Ndërsa po atë ditë, me 8 prill, në orën 8.30, Konti Ciano fluturonte qetë qetë me avion mbi Tiranën, ku çdo gja i ishte dukë normale e zbriste në fushën e aviacionit, i pritun me brohori dhe nga gjeneralët dhe ushtria italiane. Trupat fashiste italiane hynin triumfalisht në kryeqytet, dhe pas dy ditësh pushtonin krejt Shqipninë, nga jugu në veri, pa pushkë të shtime. Mbeti pezull mbi qiellin e historisë së Shqipnisë, vetëm jehona e përjetshme e mitrolozit të Mujo Ulqinakut. Kjo e gjithë historia e qëndresës shqiptare ndaj sulmit të pabesë të italisë fashiste. Disa gazeta franceze botonin lajme fallse per një qendresë të fortë ku italianët paskëshin qenë zbrapsur tri herë në det, me të vramë e të plagosun. E se Durrësi e qytetet shqiptare paskëshin qenë bombardue nga avioniacioni italian duke shkaktue shkatërrime e vdekje. Krejt rrena e prralla gazetareske per kundervenje ndaj fashizmit italian dhe vetë Musolinit si diktator e agresor popujsh. Ndërsa vërtetësisht brenda ma pak se dy orë Durrësi dhe skelet e tjera, ishin pushtue. Ato pak italianë që mbetën të vramë, i kishte korrë mitrolozi i Mujo Ulqinakut. Që aviacioni italian kaloi mbi Durrësin e qytetët e tjetë dihet, jo për të hedhë bomba, por me miliona fletushka propagandistike ku Italia fashiste paraqitej si shpëtimtare nga diktatura shtypëse e satrapit Zog.

Mbasi treguem diçka mbi pushtimin e Shqipnisë nga Italia fashiste, nuk

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

mund të rrimë pa tregue disa episode domethanës të mungesës së mbrojtjes dhe të tradhëtisë që doli sheshit. Dëshmitar i parë okular një kushri yni, rreshter Gjin Pali nga Skuraj, që shërbente në repartin e artilërisë në kodrën e pallatit Mbretnor, me komandant kapitenin shkodran Ahmet Rroj. Ai na tregonte:

- Në repart mbrennonte qetësia. Nuk kishim pasun asnjë inspektim ose kontroll nga ndonjë oficer sipëror të Ministrisë Mbrojtjës. Nuk na kishte ardh asnjë njoftim ose udhëzim nga nalt. Me 7 prill sapo zbardhi dita, u dha befasisht alarmi, dhe kur dolëm jashtë nga kazerma, u gjetëm para pamjes së frikshme të flotës italiane që kishte nxi detin para Durrësit. Komandanti, kapiteni Ahmet Rroj, menjëherë dha urdhën të ngarkohëshin topat me predha, vazhdonte rrefimin kushrini. E kishim flotën italiane si ne shuplakë të dorës, dhe thonim me mend se do të banin kërdinë mbi të. U leshuem me vrap mbi topat dhe i ngarkuem me predhat e morëm nishan mbi luftanijet. Sa u dha urdhni, nga vetë kapiteni, "zjarr", topat shkrepen bosh njeni pas tjetrit. Çka kishte ndodhë ? Ishin hequn gjylpanat, siç thuhet popullorçe. Si ishte e mundun ? Kush kishte arritë ta bante atë sabotim ? E kur ? Kapiteni urdhnoi menjëherë rreshtimin e repartit, dhe krejt i tërbuem dhe me lot në sy na foli:

- Djema, Shqipnia ka mbarue ! Tradhëtia po del sheshit. Ju e patë vetë me sytë e juej. Kush i hoqi gjylpanat ? Dikush tradhtar ka veprue. Kush ? Çdo gja ka marrë fund ! Prandaj jeni të lirë me u kthye në shpitë tueja. Merrni armët e ç'të keni mundësi. Nuk ban me kalue nga Durrësi se na zajnë rob, duhet me i ra kënetës për mes me kalue tutje.

- Ndërkaq,vazhdonte me tregue Gjini, veç ku u dukën në qiell disa avionë e na hyni frika mos bombardonin. Por çka me pa ? Në vend të bombave vinin poshtë me miliona fletushka që shkuen e ranë shumica mbi qytetin e Durrësit e mbi ne. Në fletushkat bahej thirrje për qetësi sepse Italia vinte me na shpëtue nga tirania e Mbretit Zog e të tjera profka. U dëgjue krisma e topave të anijëve, por asnjë gjyle nuk ra me shpërthye në qytet as në kodrën tonë. Po gjuenin "salve", vetëm me ba zhurmë. Na kapi dëshpërimi sepse po e shifnim se kjo ishte haptazi një tradhëti e madhe:

- U nisëm. Me ne u bashkuen ushtarë e xhandarë të tjerë të primë prej kapiten Nikoll Mëlyshit, krejt i revoltuem sepse Durrësi ishte lanë pa mbrojtje efektive, në dorë njerëzish pa aftësi e kompetencë ushtarake. Bazit të Canës nuk ia kishte pa kush kund as hijën. Një gjysmë ore u kishte mjaftue italianëve, siç na tregonte kapiten Melyshi, për të hy në Durrës. Nikolla nuk dinte gja për qëndresën vetmohuese të Mujo Ulqinakut që u mue vesh ma vonë. Kështu duke ça përmes kenetës kaluem në Fushë Krujë, ku u përshëndetem me njeni tjetrin dhe u kthyem në shpitë tona. Keshtu e mbaroi tregimin i kushrinin tonë Gjin Pali.

Lexuesi do te mbetet pak i dyshimtë per si shkuen ato pune, ku italianet zbarkuen ne brigjet shqiptare pa hasun ne asnjë qendrese te organizueme, ose

BIBLOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

siç thote populli, pa i u hy nje ferre ne kambe. Qëndresa e Mujo Ulqinakut ishte heroike, vetmohuese, por ajo s'pëshonte fare për ndalimin e pushtimit. Mbeti si një simbol i sakrficës supreme për mbrojtjën e Atdheut. Që sepakut të thuhej se pushtuesi fashist u prit me pushkë nga shqiptarët, edhe pse ishte një i vetëm që i doli zot Atdheut. Nga ana tjeter lëxuesi do te deshironte te dinte se si u zhvilluen shkembimet e notave dhe ultimatumeve. Faktikisht (nuk asht thane prej askujt deri tani), qellimi i Musolinit ishte qe Shqipna te bahej shtet vartes, dhe Mbreti Zog te vazhdonte te qendronte ne fron si mbret të formës vasale. Sigurisht se Zogu i refuzoi ato propozime deri ne fund, por bani gabimin e madh qe nuk e permblodhi veten e nuk i kushtoi randesine e duhun situates, për ta përballue me një qëndresë efektive me ushtrinë, së cilës ishte Komandanti suprem. Ndoshta nga fakti qe sapo kishte lindun trashegimtari dy ditesh dhe mbretnesha ishte akoma ne gjendje lehonie e dobet dhe me probleme shendetsore. Ndoshta ishte i qellimte sulmi i pabese, qe perfitonte edhe nga kjo gjendje psikologjike e randueme nga rrethanat e lindjes se femijes, ku dashunia atnore peshonte ma teper se froni mbretnor dhe Atdheu. Ose Zogu nuk i kishte marre fare seriozisht kercenimet e Musolinit, duke i shikue ma teper si ekstravaganca e mburrje deri dhe budallalleqe te Duçes. Nje mister mbetet. Konti Çiano shkruen në Ditarin e tij, se andej nga mesnata e 6 prillit ne seline e Pallatit Venecia, ku rrinte Musolini me shtabin e tij e te tjere ministra e funksionare te nalte te qeverise dhe partise fashiste, kishte ardhun nje mesazh drejt prej Mbretit Zog. As pa as lexue. Konti Ciano e permend në ditarin e tij shkarazi. Sekretari qe e njoftoi, i kishte thane se mesazhi permbante propozime te reja nga vete mbreti Zog. Duçja ishte çue prej gjumit e kishte pyet. Per ç'far flitej ? Propozime të reja ? Ashtu ? Ai nuk ia kishte varë fare atij njoftimi. Vendimi ishte marre. Tashma flota me ushtrine italiane ishte nis. Shqipnia te nesermen do te sulmohej e pushtohej. Ishin marre te gjitha masat dhe siguria qe nuk do te kishte ndonjë qendrese. Agjentet e italise e kishin krye fort bukur misionin e tyne me verdhushka tingelluese florini. Ai telegram i fundit i Zogut kushedi ku u zhduk. Siç e thame mbetet nje mister. Ndosha nje dite del ne shesh, rastesisht, ose ka perfundue ne zjarr. Ky telegram i asaj mesnate, te ban me mendue, pse Mbreti Zog nuk luejti vendit e nuk mori asnje mase per ti dale zot atdheut ne diten me tragjike te tij? Mendohet se ai nuk e priste aq te shpejte ndervmjen ushtarake te Italise. Sepse ai mesazhi permbante nje far kompromisi ku Mbreti Zog pranonte te mbetej ne fron, me disa kushte. Dihet, nga vete konti Ciano, qe ai mesazh as nuk u pa as nuk u lexue. Vetëm u supozue. Prandaj ndodhi largimi i Zogut aq i ngutshem dhe i pershpejtuem ndaj te papritmes qe i doli, qe u quejt pabesi. Keto nuk jane mendime te mija, por vijne nga bisedat qe im ate bante me miqt e tij. Dhe nga opinioni i përgjithshëm i shqiptarve. Permbyllje : ngjarjet e perjetueme flasin ma mirë se çdo prallisje tjetër që asht shkrue e shkruhet nga disa pseudohistorianë të shpërlamë, pa

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

ndërgjegje shqiptare e pa aftësi profesionale. Lene pastaj ata qe flasim kuturumthi e nuk dinë se ku lidhet gomari, dhe ia këpusin me trillime e rrena të pakapërdishme. Për të plotësue sa ma mirë se si u ba zbarkimi i ushtrisë italiane pa asnjë qëndresë efektive, përveç aktit individual heroik të Mujo Ulqinakut, paraqesim këtu dëshminë e dy burrave kurbinas nga Malibardhë, që mbramjën e 6 prillin kishin ardhë në Durrës gjoja me luftue. Po pse kështu organizohet mbrojtja e Atdheut me dy civilë e dy pushkë të shrembta e një rryp përgjysë me fishekë, kundër një flote të fuqishme krej topa e çelik e mbi 40.000 trupa t'armatosuna deri në dhambë ? Këta ishin Llesh Gjok Lala, një meso burrë që kishte luftue në çetat e Gjin Pjetrit e kishte emën në krahinën e Kurbinit. Tjeri ishte Gjergj Nikoll Ndreu nga shpija e përmendun e Qipit. Të dy miq te Abaz Kupit, që si duket u kishte çue fjalë me u gjet në Durrës (me pi kafe ?) kundër rrezikut të zbarkimit të Italisë fashiste që flitej, por që nuk dihej se kur do të ndodhte. Ata kishin bredh gjithë qytetin duke pyet poshtë e nalt e nuk kishin pa as Bazin as hijen e tij aty përqark. Bazi asokohë, major, ishte emnue qark komandant i xhandarmërisë, por aspak komandant i mbrojtjës së Durrësit. Në rastin tonë konkret Bazi ishe tuj pi raki ose tuj fjet rehat rehat në Krujë. Sidoqoftë dy miqt, vendosën me e kalue atë natë në një hotel. Të nesërmen çohën, prej zhurmave që po ndienin dhe zbresin poshtë për me marrë vesh ç'po ndodhte. Ku befasohën nga prania e ushtarëve italianë, që kishin mbush hotelin. Këta i afruen, i pyetën, dhe kur u panë rrypat e fishekëve, u kërkuen armët. Ata hypën e i morën pushkët dhe ua dorëzuen ushtarëve, të cilët i lanë me shkue dhe u kthyen në shpitë e tyne. Kjo ishte qëndresa e Durrësit me 7 prill 1939. Po Bazi ku paskej qenë që askush nuk e takoi as ditën e as natën e 6 prillit dhe as të nesërmen ditën fatale të 7 prillit ? Mister. Pse do të thoni ? Po kemi dëshminë autentike të një oficeri efektiv që ishte transferue nga Elbasani për në Durrës, gjoja për përforcim, pa asnjë ushtar apo xhandar me vete, fillikat. Ky ishte kapiteni Nikoll Melyshi, nga bajraktarët e Kthellës (Rrëshen). I cili kishte bredh gjithë Durrësin me gjet Bazin e kërkund se gjeti as nuk e pa. Kur zbardhi dita e 7 prillit deti ishte mbush plot anije luftarake, dhe avionët vinin mbi Durrës duke e bombardue me fletushka e filloi zbarkilmi i trupave italiane, që menjëherë zunë pozicionet kyçe të qytetit, pa hasun në asnjë qëndresë t'organizueme. Nuk pati bombardim të qytetit as nga bombat e avionëve as nga gjyletat e topave të anijëve luftarake, qe si duket gjuenin pa predha, veç me ba zhurmë. Nikolla e kuptoi menjëherë se gjithshka kishte marrë fund, dhe bani si bani e mblodhi disa xhandarë dhe u prini me kalue nëpër kenetën e Gjolit, mos me ra në duert e Itaianëve që brenda dy orëve i dhanë fund pushtimit të Durrësit. Mbi qytetin fluturonte qetë qetë avioni i Kontit Çiano që kënaqej duke soditun trupat e bersaljerëve me pupla të zeza kërdezi mbi biçkleta që mbushnin rrugë e qytetit tashma të pushtuem dhe që fluturoi deri në qiellin e Tiranës, ku rruga prej Durrësit deri në Tiranë ishte fare boshe. As mjete as

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

njeri i gjallë. Çiano ishte sjellë mbi një Tiranë krejt të qetë, ku qytetarët qarkullonin lirshëm për punët e tyne të përditshme. Po Bazi ku ishte që i thuri vetës gjithë atë lavdi të qëndresës në Durrës ? Sipas dëshmive që treguem dhe sipas një dëshmije ma të saktë, nga një oficer tjetër akademist, siç ishte Xhelal Staravecka, veç se ka ba "ta-ta" edhe asht zhduk. Shoku i ngushte i Xhelalit, Isa Manastiri edhe ai oficer kishte qenë me Bazin në Durrës dhe i tregonte Xhelalit e te tjerëve se nuk patën rast të shkrepnin qoftë dhe një herë pushkët që patën në dorë, dhe për t'i ikun rrezikut të kapjës nga italianët që kishin zanë Urën e Dajlanit, mezi kishin kalue me ujin deri në gjoks kënetën e Durrësit. Pse e kush e shpiku një qëndresë të paqenë me heroj të paqenë ? Pse gjithë këto prallisje, gënjeshtra e trillime, që janë rreshtue e po rreshtohën dhe në librat e historisë me mashtrue shqiptarët ? Askush tjetër nuk mund të përmendët për qëndresën e Durrësit, përveç një Mujo Ulqinaku, që mbetët hero i përjetshëm i sakrificës supreme për mbrojtjën e Atdheut. Kësaj i thonë të rishikohët e të shkruhët drejt historia e shqiptarve ! Në këtë kontekst po paraqesim dhe një kangë popullore qe e jep masëmiri e me pak vargje të gjithë gjithmonë historisë me kangët e tij rapsodike,siç e ka përjetue vetë.Ka variante të tjera, zgjodhëm nje ma të përshtatshëm.



Trupat fashiste të bersaljerëve me pupla këndezi e në biciklet, pas vrasjës së Mujos, e pushtuan Durrës në më pak se dy orë. Të mnesërmem hynin triumfalisht në Tiranë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

KANGE PER SHTATE PRILLIN
(një variant kangë popullore,1939)

Me shtatë prill tridhjetënandë
U nxi deti me denamë,
U mblue qielli me aeroplanë :
Gjimuen topat e Italisë
Për mjerimin e Shqipnisë.
Zoti madh çka me diftue,
Se fashizmi ka sulmue,
Duçe zeza ka urdhnue
Tan Shqipninë për me pushtue.
Ku asht Mbreti, ku asht ushtria,
Me na mbrojtë nga Italia ?
Zogu zog paska qëllue,
Në Greqi ka fluturue,
Për mjerimin e Shqipnisë
Që u pushtue prej Italisë.
Veç një burrë na ka qillue,
Një kapter, një djal i ri,
Po lufto sa për nji ushtri:
Mitrolozin e ka kapë
I ka dhanun tym e flakë.
Ndal baloz ku don me shkue,
Gjallë nuk t'laj ktu me kalue !
Po lufton Muj Ulqinaku,
Këmishzi po derdhet gjaku.
Ndal mor Duçe qen i zi,
Se ktu i thonë besa Shqipni
Nuk durojmë na kurrë robni,
Jetën japim për liri !
N'krye të detyrës Mujo ka mbetë,
Me u kujtue për mot e jetë,
Trim mbi trimat luftëtar,
Hero i madh i Kombit shqiptar!

---

*-- Ka disa variante kangësh kushtue 7 prillit e Mujo Ulqinakut.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Korça me 7 Prill 1939

Po në Korçë ç'far po ndodhte vallë ?

Im atë, atë mengjes, ishte çue si zakonisht heret dhe kishte ndezë radion per te dëgjue lajmet nga stacioni i Barit, që mbulonte dhe Shqipninë e pastaj me radhë nga stacionet e hueja. Këtë e bante çdo mpëngjes para se me shkue në zyrë. Mama ndërkaq i kishte sjellë kafen, që ai kishte nisë ta pinte ulun në poltronen pranë oxhakut, të shoqnueme me cigaren që nuk i hiqej kurrë prej gojës. Kur befasisht kumbuen fjalet entuziaste të spikërit italian: Komunikatë e jashtëzakonshme. Sot ne orën 06.30 trupat e lavdishme të Ushtrisë Mbretrore të Italisë kanë fillue zbarkimin me sukses ne brigjet e Shqipnise, në portet e Durresit, të Vlonës të Shengjinit e Sarandës, pa gjetun ndonjë qëndresë efektive...

- ….O Zot, nuk asht e mundun ! …Kishte thirrë im atë duke brof në kambë ndërsa kërkonte stacionet e hueja. Filxhani i kafës fluturoi për tokë copa copa. Parisi, Berlini, Londra, etj. të gjithë stacionet jepnin të njejti lajm. Italia fashiste po pushtonte Shqipninë. U tërbue. Mama kishte shpërthye ne vajë. Një katastrofë e madhe kishte pllandosë mbi vendin. Ra telefoni. Ishte prefekti Veli Vasiari:

- A i dëgjove radiot zoti kolonel ? Ç'është kjo e zezë që na ka zënë ? Tirana nuk përgjigjet. Ç'i thonë kësaj pune ? Ç'të bëjme zoti kolonel ?

- Po zoti prefekt, një katastrofë e pa pritun dhe e pa degjueme, një çmenduni. Si ore ta marrim vesh nga radiot pa asnjë njoftim nga Tirana ? Të mblidhemi te Postelegrafa, atje shofim e bajmë, ishte përgjigj im atë. Ndërkaq u orvat të lidhej me Tiranën, Pallatin e Mbretit dhe Ministrinë e Mbrojtjës. Nga postelegrafa iu pergjigjen se nuk bahet asnjë lidhje.

I kërkoi mamës t'i nxirrte flamurin, të cilën shkoi dhe e vendosi vetë mbi ballkon. Në vilën rrinte dikur Konsullata Jugosllave qe e kishin vendosë mbajtësën e shtizës. Ndërkaq ushtarët që rrinin si ordinancë e njoftuen se e kërkonin oficerët e tij. I la të hynin brenda, ishin kapiten Muf. Delia me toger Mehdi Ndreun e disa oficerë të tjerë të garnizonit. Të gjithë të alarmuem e të tronditun nga ai lajm ogurzez. Si asht e mundun, si asht e mundun… ! Nuk u vinte për me besue se kishte ndodhë ajo fatkeqësi. Im atë u shpjegoi se nuk kishte as një lloj njoftimi, as paraprak as të çastit që po jetonin. Lajmi ishte dhanë nga radio italiane e ato e huejat. Gjithë Korça ishte tronditë. Njerëzit ishin terbue.

- Te Postëtelegrafa, u tha im atë, kurse ti Mehdi me disa oficerë dhe ushtarë shkoni te depoja e armatimeve, para se të sulmojë populli, që të mos ndodhin shregullime. Po qe puna me u armatosë ua shpërdajmë armët popullit. Ndër këto fjalë para shtëpisë ishin grumbulluë plot korçarë:

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

- Duam armë, duam armë ! Na prini përpara, nuk e lëshojmë pa gjak vatanin ! Poshtë Italia fashiste ! Poshtë breshkamanët ! Armë, armë ! Ja vdekje, ja liri ! Disa flamuj kombëtarë valvitëshin mes turmës. Im etit iu desh të flasë :

- Ndigjoni, të dashun korçarë, këtë lajm të zi po na e japin radiot e hueja. Si ne ashtu dhe ju nuk kemi asnje njoftim. Tani të gjithë të shkojmë te Postëlegrafa, mos lidhemi me Tiranën. Ta marrim vesh mirë se çka po ndodh. Në qoftë se duhet me luftue, do të luftojmë !

Ai nuk e dinte se do të vinte puna që ai nuk mund ta mbante fjalën. E kush se ! Ma në fund të gjithë sa ishin grumbullue para shpisë u vunë pas atij dhe oficerëve të tjerë duke vazhdue britmat e tyne të dëshpërimit e të dëshirës për të luftue. Gjithë Korça ishte çue në kambë e drefjtohej te Postelegrafa. Shpirti i patriotizmit kishte përfshi mbarë qytetin, bashkë me zhgënjimin e kësaj heshtje të Tiranës, që të bante me mendue për punë të këqija. Gratë e vajzat qanin si për të vdekun. Zi e madhe kishte ra mbi gjithë qytetin. Kur arritën te Postelegrafa atje u bashkuen me turmat e tjera korçare që vinin nga çdo anë. Im atë me personalitetet lokale ishin futë në godinën e Postes. Me prefektin Veli Vasiari kishin ardhë gjithë autoritete e qytetit, ndër ta Prof. Abaz Ermeni, Prof. Luigj Muzhani, me disa kolegë të tjerë dhe studentët e liceut francez, krejt të inatosur për atë tradhëti të madhe që dilte sheshit, por që akoma nuk donin ta besonin. Të merrëshin vesh me Tiranën si ishte puna. Ia lanë tim etit që ti rrinte mbi kokë ndërlidhjës. Në ato kushte, ishte mbi atë që korçarët mbështesnin shpresën e fundit të një qëndrese. Më kot. Askush nuk përgjgjej prej Tirane. As Pallati as Miinistritë. Prit e prit. Jashtë vlonte tërbimi i turmës, që po e kuptonte se diçka e mbrapshtë ishte krijue. Heshtja e Tiranës ishte e dyshimtë.

- Duam armë, duam armë ! Dikush thërriste: na prini në luftë! Ja vdekje, ja liri ! Kumbonin kangët patriotike: Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë… Rreth flamurit të përbashkuar…. Eja mblidhuni këtu, këtu… Një atmosferë patriotizmi e papërmbajtun kishte pushtue njerëzit. Telefonat e telegramët nuk gjenin përgjigje. Si me veprue ? Erdhi një lajm i shëmtuem. Depoja e armëve, krejt pa roje, ishte gjetun bosh. Lajmi e tërboi popullin. Tradhëti, tradhëti ! Poshtë tradhëtarët !… në litar… në litar !... Duam armë... armë... armë !… Degjohëshin edhe thirrje si, Rroftë Mbreti ! Të na prijë në luftë kundër pushtuesit fashist ! I shkreti popull që nuk e dinte se Mbreti tyne ishte i pari që ia kishte mbathë kambëve ! Nuk asht akuzë e lyerje, por një e vërtetë e pamohueshme.

Kaloi ajo ditë, kaloi nata, erdhi dita tjetër. Asnjë përgjigje nga Tirana. Njerëzit kishin mbetë pa gjumë, pa ngranë e pa pi, aty te gozhduem para postës pa luejtë vendit. Lajmet e hueja flisnin për Tiranën e pushtueme. Për Mbretin e ikun. Për trupat italiane që marshonin drej veriut e jugut. Kur ja papritun bahet lidhja me Tiranën, drejt me Pallatin Mbretnor.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

- Halo, halo... kush flet ? Këtu Korça, foli vetë im atë në telefon.

- Këtu Pallati. U përgjigj një za i panjohun.

- Çdo me thanë që tash dy dit nuk kemi lajme nga Tirana ndersa radiot e hueja na njoftojnë se Shqipnia tashma u pushtue prej Italisë fashiste ? Ku asht Mbreti ? Ku asht Qeveria ? Kemi dy dit qe rrimë gozhdue para postës. Populli korçar asht çue në kambë e kërkon armë e armë nuk kemi !

- Mos u besoni radiove të hueja. Gjëndja asht nën kontroll. Italianët janë orvatë me zbarkue por i kemi zbrapsun. Mbreti dhe Qeveria janë largue nga Tirana për siguri. Do të ju çojmë armë. Prisni udhëzimet tona. Ishte përgjigjë i panjohuni matanë.

- Ore, kush je ti atje që flet kaq bukur e serbez nga Pallati ? Këtu kërkon llogari kolonel Prenk Pervizi n'emën të gjithë një qyteti që asht çue ne kambë me luftue ! Sa kishte thanë këto fjalë, u dëgjue përlasja me inat e telefonit. Tradhëtia po dilte sheshit. Radiot e hueja nuk genjenin, që njoftonin pushtimin e Durrësit,Tiranës, Shkodrës, Vlonës, Sarandës, Gjirokastrës, e po marshonin drejt Elbasanit. Po i binte radha dhe Korçës. Po Mbreti nga ia kishte mbathun ? Mos vallë kishte dalë në mal ? Kjo do t'ishte diçka heroike. Në mal do dilte i gjithë populli shqiptar për të mbrojtë atdheun !

Populli para Postelegrafës ishte në kulmin e tërbimit. . Si me ia ba ? Im atë thirri oficerët e dhe u dha udhëzime që të grumbullonin ato pak ushtarë e t'i mbanin në gatishmeni. Nga ana tjetër bisedoi me oficerët e tij e me autoritetet lokale si me i mobilizue dhe armatosë njerëzit. Kishte mundësi qe greku t'i furnizonte me armë, për t'i dalë para rreziku te vet. Siç e kemi thanë, ai kishte pritë vizitën e tre gjeneralëve grekë, që i kishin premtue e sigurue se Greqia do t'ishte përkrah Shqiptarve ne çdo rrezik që t'u kanosej nga Italia fashiste. Patjetër për t'i dalë para rrezikut që i kanosej edhe asaj.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Prerje fotografie ku kolonel Prenk Pervizi, si komandant i garnizonit të Korcës, kishte dalë me Shtabin e tij të oficerëve me rastin e 28 Nëntorit 1938, që do t'ishte i fundit i Mretërisë shqiptare.

7 Prilli e gjen të pa njoftuar për sulmim fashist , që jepnin radiot e hueja. Në orvajtje për të krijuar një qendresë detyrohët të mbrojë Mretin i ardhur ne Zemblak për ta përciellur në kalimin e tij në Greqi, më 9 prlli 1939. Fundi i Mbretërisë shqiptare.



Pamje nga qyteti i Korçës, siç e gjeti 7 prilli 1939, në qetësi të plotë, i pa njofuem tre ditë rresht për sulmin e pushtimin nga Italia fa

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Gjeneralët italianë të pushtimit.



Gjeneral GUZZONI



Gjenral Renzo DALMAZZO

Gjeneral Guzzoni ishte kryekomandanti i ushtrisë italiane të pushtimit me 7 prill 1939, vendin e tij e zuni pastaj Gjenerali Dalmazzo deri në kapitullimin e Italisë më 8 shtator 1943, i cili ia dorëzoj komandën palës shqiptare të kryesueme nga Gjeneral Prenk Pervizi., që në tetor 1943 u emnue Ministër i Mbrojtjës, Komandant i përgjhithshëm i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Dy mëkëmbësit e Mbretit t' Italisë, 1939-1943



Gjeneral Alberto PARIANI
Mëkëmbës, 1939-1941.



Françesko, JAKOMONI
Mëkëmbës, 1941+1943

Gjenerali Pariani ambasador në Shqipni e pasatj Mëkëmbësmbret në pushtimin italian deri kur ia dorëzoj atë pozitë Gjenralit Françesko JAKOMONI, edhe ky amnbasador para pushtimit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Të lëshojmë kushtrimin

Në këto çaste dramatike veç kur i afrohet një djalë i Gani Kullës nga Zemblaku dhe e njofton se mbreti Zog e priste në shtëpinë e tyne, ku kishte mbrritë atë natë. Planet u prishën. Duhej mbrojtë mbreti që tashma ishte në besë të tij. Ishte rrezik të vinin italianët e ta zinin rob. Nga ana tjetër po ta merrte vesh populli i Korçës, nuk dihej se ç'mund të ndodhte prej tërbimit që kishte kapë njerëzit. Kishin të drejtë. Por çdo gja e keqe që mund të ndodhte binte mbi të. Thirri oficerët në vartësi, dhe i urdhnoi që të mbanin kontrollin mbi ushtarët, deri sa të merrnin një njoftim prej tij. Mori një taksi dhe shkoi drejt e në shpi. E thirri mamën të cilës i tregoi për Mbretin Zog. Sigurisht se Zogu do të kërkonte me dalë në Greqi. Atje do ta ndiqte edhe ai, e nuk do të kthehej ma. Prandaj ajo të bante si te bante e të shkonte në Laç. Dy ushtarët mirditorë besnikë që rrinin si ordinanca i porositi që të rrinin pranë familjes deri kur ajo të kthehej në Laç. Pare kishin që të përballonin mungesat e mundshme. Djemtë ishin në Itali, e fati i tyne mbetej në dorë të Zotit. Mamën tepër të merakosun e të mërzitun për fëmijët, u mundue ta qetesojë. Ai do ta gjente mundësinë për me i nxjerrë prej andej. Si dha këto porosi u nis, por jo pa i thanë mamës, që të mos pranonte ta hiqte flamurin nga ballkoni me dorën e saj. Pastaj u largue bashkë me djalin e Gani Kullës me makinën që kishte angazhue. Djali i Ganiut i tregoi rrugës se Mbreti me ministrat, me një pjesë të gardës e pasues të tjerë kishin sosë vonë pasmesnatës te raskapitun e të mërzitun, të pa ngranë e të pa gjumë. Mbreti me suiten kishte zanë gjumi në dhomat e shpisë. Të tjerët ku të gjenin vend, rrazë gardhëve e murëve. Shyqyr që koha ishte e mirë. As roje as rregull. Ishin detyrue me ba roje vetë me njerëzit e familjes e të fshatit, nga frika se mos ndodhte ndonjë e papritun. Im atë nuk kishte folë fare veç tundte kokën. Si asht e mundun…si asht e mundun…?! Ishte për të dalë mendsh !

Kur mbërritën afër shtëpisë së Kullajve, zbritën nga makina. Ato që i tha djali i Ganiut rrugës, po i shihte me sytë e vet. As roje as rregull. Njerëz të shtrimë kudo, ushtarakë e civilë. Një oficeri i kishte dalë gjumi dhe e njohu. Zgjoi shokët rreth tij, që u çuen dhe u gjallëruen kur e panë kolonelin. Im atë ju foli pak si ashpër.

- Si e keni lanë vendin pa roje ? A e dini se ushtria fashiste italiane po ia mbrrin? Shpejt zgjoni njerëzit, vini roje kudo. Oficerët moren kurajo dhe filluen me zbatue urdhnat.

Si tha këto fjalë u drejtue te banesa e Kullajve ku i doli përpara vetë Ganiu me djemt e tjerë, ndër ta Mediu, toger në gardën mbretnore. Ganiu me Mediun i prinë përpara deri në dhomën e muvë ku pushonte Zogu me suitën. Te gjithë të shtrimë në minderët që rrethonin dhomën e madhe, në gjumë të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

thellë. Sa vuni kambën brenda në dhomë, Mbreti, që e kishte gjumin shumë të lehtë, u çue menjëherë, e njohu, dhe siç ishte u ngrit dhe iu hodh në qafë, duke mos përmbajtë lotët e të qarit si fëmijë.

- Ah Prenk, nuk të dëgjova ty por u mora me këto maskarenj që me kanë rrethue. Më kanë dalë të gjithë tradhëtarë. Prej tyne t'i mohova gradat e meritat dhe nuk t'i dëgjova këshillat. Tashti t'i njoh të gjitha por asht tepër vonë, ka marrë fund gjithçka, ishte shfry Mbreti Zog.

Ne po e japim shkurtazi shfryemjën e Mbretit, pse faktikish shkëmbim i fjalëve mids tyne ka qenë shumë ma dramatike. Ndërkaq ministrat dhe oborrtarët kishin fillue me u zgjue, në divanët përreth dhomës ku ishin shtri me fjetë: Xhemal Aranitasi, Lalë Krosi, Musa Juka, Hysen Selmani e disa të tjerë. Kur e panë babën të përqafuem me Mbretin, u kishte hy frika se mos ai "kaurri" ua bante ndonjë te pabërë. Ata i kishte zanë "kaurrfobia", si anadollakë e turkofilë që ishin.

Im atë kishte ndërhy:

- Naltmadhni, i lajmë këto fjalë pa bereqet. E vërteta asht ma e hidhun. Kam dy dit që rri me gjith popullin patriot të Korçës para Postelegrafës për me u lidhë me Tiranën. Askush nuk përgjigjej. Lajmin e sulmit fashist e kemi marrë vetëm nga radiot e hueja. Edhe dy–tre ditë përpara, pavarësisht nga lajmi i lindjës së trashëgimtarit, si mos me çue asnjë njoftim se si zhvillohet situata. Kaq poshtë paskej ra mbretnia e qeveria ? As një njoftim nga Ministria e Mbrojtjes. Si mos me u mbledh shtabi i shtatmadhorisë ? As nga Kryeministria. As nga Mbreti ynë. Po kjo, me braktisë vendin e popullin ? Ku asht mbrojtja e atdheut ? Po telefonin a nuk mund ta kapshe për besnikët e tu ? Në duer të kujt e ke lanë qëdresen, kur komandantët e ushtrisë nuk dinë asgja as kanë marrë urdhna për gatishmëninë e mbrojtjës së Atdheut ? Po pse këtyne lloj semsilesh që ke mbledh rreth vetes u ke besue fatet e Shqipnisë ? Të kam pas dalë borxhit për gjithshka, po nuk ma vune veshin. Tashti asht vonë, ishte sfry im atë. Pastaj kishte shtue :

- Jemi akoma në kohë me i dalë zot situatës. Të leshojmë kushtrimin e të fillojmë luftën në mal, si dikur të parë tanë.

Zogu kishte mbetë pa fjalë dhe shikonte nga oborrtarët e ministrat me përbuzje. Por kur dëgjoj fjalët për lëshimin e kushtrimit, ndërhyni:

- Jo Prenk, asht punë që s'bahet. Një të keqe ia kam sjellë vendit, e nuk due që populli të damtohet e të vuej edhe me tepër për mue... e sa për këto servila e batakçi që me janë ngjitë mbrapa, mos t'u a shof ma bojen. Të më shporrën syshë, sepse këta janë shkaktarët e gjithë kësaj fatkeqësie që na ka pllakosë !

Mbreti, ashtu i nevrikosun, mirë po fliste, por tepër vonë. Fjalë n'erë. Në vazhdim, mbreti nuk la gja pa u thanë, ndërsa ata rrinin kokë ulun e pa fjalë. E ndjenin veten krejtësish të dërmuem e të marrun fund njeherë e përgjithmonë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2016)

Si mbaroi mbreti, e mori fjalën im atë, që ua qorri maskat me të gjithë të palarat që kishin krye, duke ba fajtorë e shkaktarë të të gjithë mbrapështinave e prapaskenave në kurriz të Mbreti Zog e të Atdheut. Duke ia largue besnikët e duke e çthurun ushtrinë, ku shumë oficerë ishin vu në shënjestren e dyshimit, duke përfshi atë vetë. Aq me poshtërsi sa me e quejt pas shpine "kaurr". Pse në kohën e pushtimit turk jemi ? Fakti i fundit, jo vetëm mos paralajmërimi i rrezikut por edhe moslajmërimi i zbarkimit të ushtrisë fashiste. Ç'do me thanë kjo ? Tradhti e hapun ! Këto në përgjithësi shkëmbimet e fjalëve në ato çaste dramatike. Por përmbyllja nga ana e tim etit u kalli tmerrin oborrtarëve e ministrave.

- Ç'të baj se jeni në besën time, e mos me thançin Prenk Pervizi, po mos do ju kisha varë të tanëve këtu si cironka, more maskarej të maskarejve, që e katandiset Shqipninë, Mbretninë e Mbretin Zog në këtë ditë të mjerueshme. Morët vesh ?

Mbasi u thane të gjitha sa duhëshin e nuk duhëshin thane, im atë iu kthye edhe njëherë Mbretit Zog:

- Mbret, tashti zgjidh, ja me lshue kushtrimin për luftë popullore, ja me u largue prej këtu sa ma shpejt, para se të mbrrijnë italianët. Mos harro, se po ta marri vesh populli i Korçës se gjëndemi këtu, vjen e na ban fertele, duke mos kursye ndoshta as ty as mue, por këto të tjerët me siguri se do t'i shqyente. Vendos. Une jam gati të zbatoi urdhnin tand.

Zogu, kishte dëgjue gjithë shfryrjen e babes, e kishte mbetë i shastisun nga të palarat e të pabërat të rrethit oborrtar. Pasi kishte ndejtë pak i heshtun, kishte folë

- Prenk, çdo gja ka marrë fund. Merr komandën e na prij në Greqi, nuk ka tjetër rrugë-zgjidhje. Nuk besoj se Grekët do të pëngojnë. Gjeraldina ka kalue në Jugosllavi me gjithë fëmijën e do të vijë të bashkohet me mue në Greqi. Atje shofim e bajmë. Këto ishin fjalët e fundit të Mbretit Zog. Im atë nisi një djalë të Gani Kullës, me lajmërue oficerët e tij dhe autoritetet e Korçës, si prefenktin Veli Vasiari, Prof. Abaz Ermenin, e të tjerë, se si qendronte puna e se mbreti po largohej në Greqi. Kështu atë erdhën e u bashkuen me shoqëruesit e tjerë.

Asht shkrue e folë për këtë ngjarje, ne mënyrë abuzive, duke marrë përsipër veprime të paqëna, nga njerëz të pa ndërgjegje e ndërshmëni, kur e kishte marrë vesh gjithë Shqipnia se kush i doli zot Mbretit Zog në ditët e fundit të qendrimit të tij në fronin e Mbretnisë shqiptare. Gjysmë shekulli i diktaturës komuniste ndikoi për të shue çdo kujtesë e fakt të asaj kohë, si edhe njerëzit që morën pjesë, dhe kryesisht Prenk Pervizin, emnin e të cilit e kishin fshi nga çdo faqe të historisë. Mjerisht pas shëmbjes së diktaturës, në vend që historia të kthehej në binarët e saj, ajo u katandis të deformohet edhe ma tepër prej deshmive të rreme e trillimeve fantastike që shpiknin mendje të çorodituna, duke perfitue nga nga vdekja e personazhëve realë të atyre

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

ngjarjeve. Prandaj, duke i pasë shpëtue mrekullisht termetit të terrorit bolshevik shqiptar, në moshën 87 vjeç që jam, mbetëm një dëshmitar i gjallë i asaj periudhe ku ishim të përfshimë familjarisht me gjithë rrethin tonë shoqnor. Kështu që jam i destinuem të flas të vërtetën për sa kam përjetue vetë, pa shtue asgja tepër veç në lansha mangut nga koha tepër e gjatë që ka kalue. Përveç disa datave dhe disa emnave, vijimin historik të ngjarjeve e kam paraqit fare të qartë. Për këtë të jetë i sigurt lexuesi. Sidomos historianët që në mos tjeter, duke përjashtue përshkrime vetjake, ata mund te nxierrin ngjarjet e faktet që kane ndodhun vërtetësisht e ti pajisin me data dhe emra, sipas zhvillimit të tyne. Por assessi me i ndryshue.



Shtëpia e Kullajve në Zemblak të Korces, ku u strehua Mbreti Zog dhe u takua me Prenk Pervizin e prej ku u largua në Greqi. Kullajt u përsekutuan më tepër se përkrahën Prenk Pervizin t'arratisët në Greqi se sa për pritjën e Mretit Zog. Shtëpia e Kullajve shënon qëndrimin e fundit të Mbretit Zog në tokën shqiptare, e kjo s'asht një akuzë për fajë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Fundi i Mbretnisë Shqiptare

Im atë i mblodhi oficerët e u dha urdhnat përkatëse që jo vetëm të ruenin por edhe të mbanin rregullin, sepse ishin me qindra, mos mija, ato që po përcillnin Mbretin Zog dhe që donin të shkonin pas tij në Greqi.

Bashkë me komandantin e gardës, Kolonel Hysen Selmanin, djalibn e Gani Kullës, toger Medi dhe disa oficerë besnikë e trima, si Mul Delinë, Medi Ndreun, etj., organizoi kalimi në Greqi që u ba pa incidente. Autoritetet kufitare që ishin lidhun me Qendrën dhe vetë Mbretin e Greqisë, kishin marrë urdhën që të lejonin kalimin e Mbretit Zog me gjithë turmën e madhe të pasuesve. Veçse u mbajtën armët. Im atë kishte marrë me vete maliherrin e stolisun në flori, kujtim nga Muharrem Bajraktari, e me gjithëse ai e paraqiti si kujtim e një objekt muzeal, u detyrue me ia dorëzue kapitenit komandant të postës kufitare, ashtu pa asnjë lloj dokumenti, në mirëbesim. Në atë rast im atë kishte harrue se çdo të thoshte "Fides Greca" (besa e grekut). Kështu karvani me Mbretin Zog e gjithë suitën e tij kaluen dhe u vendosën provizorisht në Folorinë, ku autoritetet greke u kishin lirue disa banesa, për Mbretin, për oficerët madhorë e personalitete civile. Të tjerët nëpër çadra e në fushë të zotit, nga që koha mbajti e mire. Theksojmë këtu, dhe lexuesi t'i kushtojë vëmendje, sepse asht prallisë shumë se Mbreti Zog vodhi thesarin e Shtetit (arin). Asht shkrue se si në Greqi paskëshin kalue kamiona me arkat e florini. Asgja e vërtetë. Mbreti Zog mezi kishte ardhë deri aty me ato dy-tri veturat e Pallatit e me çka mundi me mbledhë e marrë në Pallat. Bile, kishte marrë një sasi shumë të madhe kartmonedhë, që grekët nuk ia pranuen, sepse me pushtimn e Shqipnisë, vlera e kartmonedhës shqiptare kishte humbun. Atij i mbeti vetëm sasia e napolonave të florinin që kishte në Pallat dhe xhevairet e Mbretneshës. Lalë Krosi me shokë kishin ma shumë Napolona florini se Mbreti. Mbreti ishte me paret e veta, se ndryshe nuk do të kishte shkue si lypsar nëpër Europë dhe me e mbajtë bujarisht Mbreti Faruk në Egjypt. Kjo të jetë e kjartë. Por regjimi komunist i krijoi gjithë këto gënjeshtra për të mashtrue popullin. Edhe gazetarët fashiste të Italisë kishin shkrue të tilla lajme të gënjeshtra. Sa për dijeni, ari i shtetit shqiptar u siguru nga qeverija e fundit me Keshillin e Regjencës më 1944 që në bashkëpunim me qeverinë e Ibrahim Biçakut, e siguruen me anë të gjermanëve në Gjermani, prej ku anglezët, pas mbarimit të luftës, e sollën në Angli, dhe del se nga i kemi marrë vesh këto punë ? E po, prandaj po shkruhet ky libër me skjarue anët e errëta të historisë shqiptare, deri dhe kjo e arit. Im atë ishte në dijeni të plotë të çeshjës, si Ministër i Mbrojtjës, dhe ka qenë puna ma e mirë që u ba, që ari mos me ra në dorë të komunistëve. Ato gjermanët që u quejtën pushtues e kriiminelë (prej komunistëve), për çudi u treguen aq të ndershëm e fisnikë, duke e përciellë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "HARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

arin, pa u damtue e shpërdorue, në bankat gjermane në emën të shtetit shqiptar. Po mos të kishte ndodhun incidenti i Korfuzit, ari do t'ishte akoma sot i ruejtun në bankat gjermane, dhe sa do të protestonin komunstët nuk do tu'a dorezonte kush. Ndoshta, pas renies se diktatursë, Gjermania do të na e kishte kthye, por ma mirë që nuk u ba ajo punë, se ari do të kishte mbushë shumë xhepa të pushtetarve të ri në fuqi e pa fuqi. Dhe asgja për ekonominë e popullin shqiptar. Besoj se me këtë rrëfim, asht thanë ajo e vërtetë, me pak fjalë, për çështjen e arit. Jam i ndërgjegjshëm se kundërshtime do të vijnë nga ata që nuk dinë asgja, veç se hamendësojnë, veçanërisht komunistët nostalgjikë, që vazhdojnë t'ushqehen me qumështin e gjakosun të të mërhumës nanës parti.

Pas dy tre ditësh mbreti i largoi pothuej gjithë ministrat e oborrtarët, me Lalë Krosin në krye, që shkuen ne Stamboll. Prenk Pervizi me Hysen Selmanin e disa oficerë rrinin në një banesë, karshi asaj të Mbretit. Nuk kaloi shumë e aty erdhi Mbretnesha Gjeraldinë me foshnjen e motrat e Zogut. Aty u dukën edhe gjenëralët që i kishin ba vizitë babës në Korçë, të cilët u takuen me Mbretin Zog, dhe i treguen se si i kishin ba vizitë kolonel Pervizit para gjashtë muejve, për të cilin kishin respekt e konsideratë të madhe, duke e sigurue për përkrahjen e Greqisë në rast të një sulmi të mundshëm të Italisë, siç dyshohej. Mbreti kishte mbetë pak keq, sepse po e kuptonte se mbajtja larg nga Tirana e Prenk Pervizit, ishte një nga prapaskenat e kurdisuna prej rrethit tij oborrtar e qeveritar, që e kishin damtue kauzën shqiptare në këto rrethana tragjike te pushtimit. Ngjarjet do t'ishin zhvillue krejt ndryshe po t'ishin marrë parasyshë paralajmërimet e këshillat e Prenk Pervizit, që patjetër do t'i kishte dalë zot mbrojtjës efektive të Atdheut.

Mbretit nuk i mbeti tjetër veçse me dergue disa nota proteste Lidhjes së Kombëve dhe fuqive të mëdha, me anë të Ambasadave të akreditueme në Greqi, të Anglisë, Shteteve të Bashkueme të Amerikës, Francës, Gjermanisë, etj. Asnjë përgjigje. Askush nuk shprehu keqardhje e jo ma me ndërmy në këtë mes. Gazetat e radiot flisnin për pushtimn e plotë të Shqipnisë, brenda tre ditëve. Biles thuhej se banorët e qytetëve i kishin prit italianët me lule dhe se zbarkimi i italianëve ishte përshëndetë me telegrame urimi nga disa personalitete shqiptare. Por ma vonë doli se ishin lajme të gënjeshtra për të çoroditë popullin dhe dezinformue opinionin e jashtëm. Kryeministri anglez Çamberlen, kur e kishin pyet për këtë pushtim në dhomën e komuneve, ishte shprehun me një mënyrë cinike: **Shqipnia nuk paraqet ndonjë interes për Anglinë (?!).**

Pas dy javësh, me tituj të mëdhej dhe fotografi, shtypi italian paraqiste dorëzimin e kunorës së Shqipnisë mbretit të Italisë në një pritje madhështore në pallatin mbretnor të Kuirinalit në Romë, prej një delegacioni qeveritar e personalitetesh shqiptare, të gjithë civila me në krye Shefqet Verlacin, kundërshtari e anmiku historik i Zogut, sepse ky e kishte prishë fëjesën me të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

bijën e Verlacit, për me u martue me Gjeraldinën. Asnjë oficer i ushtrisë shqiptare nuk ishte i pranishëm në atë cerimoni, as merrnin pjesë klerikë katolikë, orthodokse e musulmanë. Vetëm ministra e funksionarë civilë, dhe një grup malësorësh veriorë e jugorë me kostume tradicionale, të detyruem me iu ngjit pas atij delegacioni. Kur i kishte marrë vesh këto lajme, mbreti Zog fillimisht ishte mërzitë, por pastaj në një takim me ato pak besnikë që e kishin ndjekun, ishte shprehun :

- Ky asht haraçi i randë që i munduni ia paguen fitimtarit. Ashtu ka ndodhë në të kaluemën. Shqiptarët u banë vezirë, guvernatorë e pashallarë të Turkisë e nuk u tha kush tradhëtarë. Ligji i luftës. Kush fiton sundon. Kjo ka ndodhë gjithmonë. Mjerë të mundunit ! Por duhet mendue që vendi të mos përfshihet në trubullina dhe fatkeqësi të tjera. Na vjen keq për sa po shohim e dëgjojmë, por tashma nuk na mbetet veçse me prit mbarimin e kësaj lufte botnore që ka me plasë së shpejti. Ndoshta ajo sjell përfundime të mbara për Shqipninë. Veçse jam prek për një punë që nuk e pritsha prej Verlacit, sado që ishim anmiqsue. Duhet të kishte tregue pakëz burrni.

I shkreti Mbret që nuk mund të parashikonte ç'far do t'i ndodhte Shqipnisë e shqiptarve, jo nga ky pushtues që si erdhi do të shkonte, por nga një pushtues edhe me i egër dhe barbar, që do t'ishte sllavo-komunizmi, i cili do t'i kthente shqiptarët në skllavën e bujk-robër, duke zbatue një terror të pashembullt të markës bolshevike staliniane.

Ditët po kalonin, dhe çeshtja shqiptare u la në harresë. Evropa po ziente nga mosmarreveshjet midis fuqive të mëdha, dhe perspektivat e një lufte të dytë botnore tashma ishin të kjarta. Në këto kushte Zogu nuk kishte çka me ba, deri sa e kishte humb mbretninë dhe po shikonte se si askush nuk po i dilte përkrah, së pakut moralisht.

Tregon im atë :

- Ne e kishim banesën përballë asaj të Mbretit. Një natë prej netësh dalluem se dritat e sallonit rrinin ndezun, ku mbreti shëtiste poshtë e lart pa pushim. Kështu kaloi e gjithë nata. Sa doli dita, çon e më therret. U gjeta para tij dhe dallova nga shprehja se ai kishte marrë një vendim të rëndë. E njihja mirë. Ai po kerkonte të gjente një zgjidhje asaj gjëndje të randë të krijuem nga gjithë ato njerëz që e kishin ndjekun për t'i shprehun besnikërinë në çastin ma të vështirë të jetës së tij. Por të cilëve nuk mund t'u përgjigjej as me i mbajtë as me i ndihmue, as kishte zemër me i kthye.

- Prenk, të kam thirrë për një çeshtje shumë të randësishme, që askush tjetër përveç teje nuk mund ta zgjidhë, filloi të flasë Mbreti dhe vazhdoi, a i sheh gjithë këto njerëz që kanë ardhe pas meje duke braktisë familjet, shtëpitë e pasunitë e tyne ? Ku t'i çoj e çka të baj me to ? Nuk due që ato të merren në qafë për shkakun tim. Unë mendoj se duhet të kthehen në familjet e tyne. Por nuk mundem t'u dal përpara e t'u flas pranda, kërkoj prej teje qe t'u flasësh në emën tim, tha mbreti.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

- Mirë, naltmadhni, do t'u flas. Po a do të pranojnë të kthehen vallë, me fjalën time ?

- Prenk, patjetër se do të pranojnë kur të shohin se edhe ti po kthehesh me ta.

- Kush, unë ? Asht punë që s'bahet ! Çdo me thanë kjo ? Jam i vetmi që nuk duhet të kthehëm ma në Shqipni, në këtë situatë ! E kam porositë gruen që të mos më presë. Ajo e di si me veprue. Fëmijët në Itali nuk besoj se i gjen gja. Ndoshta munbd t'i tërheq me ligjet ndërkombëtare.

Im atë kishte folë pak me ashpërsi. Ai nuk mund të pranonte nji gja të tillë prandaj iu kundërvue mbretit që të mos përsëriste ndonjë gabim tjetër ndaj tij, siç kishte ndodhë në të kaluemen.

Zogu që e dinte mirë se im at do të përgjigjej ashtu, kishte ndërhy përsëri.

- Një gja due të di prej teje, Prenk, a më njeh akoma si Mbret ?

- Patjetër, Naltmadhni, sot ma tepër se kurrë e gjithmonë.

- Atëhere unë kërkoj që të zbatojsh urdhnin e fundit timin, të kthehesh e të marrësh me vete gjithë turmën e madhe të njerëzve. E di se asht një sakrificë e madhe për ty, por po ta kërkoj me besim se s'do ma prishish. Im at kishte mbet pa za. Mbreti e kishte zanë ngusht.

Pastaj Zogu kishte shtue që kur im at të kthehej në Shqipni, të fliste me besnikët e tjerë që të ruhej qetësia e mos të krijohëshn trazime që do t'i shkaktoni fatkeqësi e shakterrime popullin. Italianët do të mbanin një qëndrim formal ndaj nacionalistëve me influencë për të mos shkaktue incidente që mund të ju krijonin shqetësime e ngatërresa. Ai e ngarkoi tim etin me funksionin si përfaqësues i drejpërdrejtë i tij me kompetenca të plota si në kohnat e vjetra kur ishte me fuqi të jashtëzakonshme. Moralisht ia njihte gradën e gjeneralit që i ishte mohue padrejtësisht. Italianët patjetër do të ia njihnin sepse e kishit të kjartë përgatijën e tij të lartë.

- E shoh se kam gabue ndaj teje, duke ndigjue këshilltarë të këqij. Prenk, do ta keshë gjithmonë besimin e respektin tim, si miq të vjetër e shokë lufte e përpjekjesh që kemi qenë. Ta di për nder për gjithçka që ke ba për mue në situatat ma të vështira, siç e tregove dhe tashti që më prite e më përcolle burrnisht.

Im atë, siç tregonte, e ndjeu veten ngusht. Mos me e zbatue atë lloj urdhni, do të thoshte me ia përplas në sy Zogut se nuk e njihte si mbret dhe nuk e respektonte autoritetin e tij. Duke mos harrue, se ai kurrë nuk e kishte thirrë Zogun si Naltmadhni, sa ishte mbret në Shqipni, por me emën, Ahmet, që kur ishin njohun e kishn zanë shoqni e mësi në moshën e rinisë e deri në fund të mbretnisë. Vetëm në takimin te shpia e Kullajve në Zemblak ai e kishte perdorë termin Naltmadhni, dhe kur kaluen në Greqi, për t'i shprehë respektin e thellë në ato çaste që kishte humbë gjithçka. Një shprehje e naltë fisnikërije.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

- Po, Nalmadhni, të kam njohun e të njoh si Mbret dhe e marr përsipër ta kryej edhe këtë detyrë, e mos qoftë e fundit. Zogu m'u hodh në qafë krejt i emocionuem, tregonte im atë, duke me shprehë mirënjohjen e tij të pakufishme.

Në ato kushte kur autoriteti i tij kishte marrë fund, burrnia fisnike e babës e kishte prekë.

- Faleminderit Prenk. Dhashtë Zoti që të bashkohemi përsëri në Mbretninë Shqiptare, që të përbush ato detyrime ndaj teje, që për disa rrethana të ishin mohue.

Im atë kërkoi që Mbreti të përshëndetej me gjithë oficerët që e kishin ndjekun në këtë udhëtim, pasi të kishte mbajtë fjalimin para gjithë turmës e të bahëshiun gati me u nisë.

Sa u nda nga Mbreti, im atë shkoi e u takue me Hysen Selmanin e oficerët që prisnin përfundimin e atij takimi. Ata e kishin kuptue se aty do merrej një vendim i randësishëm. I porositi që të grumbullonin gjithë shqiptarët që kishin ndjek Mbretin në Greqi, sepse kishte porosi që tu fliste në emën të tij. Nuk vonoi edhe në sheshin para godinës ku rrinte mbreti, u mblodh turma e madhe e shqiptarve, krejt të shqetsuem e të mërzitun. Im atë kishte hypë mbi një stom prej ku do të fliste. Kishte ra një heshtje e madhe.

Të dashtun vllazën,

*Ju sjell përshëndetjet e dhimbshme të Mbreti Zog e të Mbretneshës Gjeraldinë, që m'u lutën të ju flas në emën të tyne, ne këtë ditë tragjike për Atdheun e Mbretninë shqiptare. Ata do të kishin dishrue me ju takue dhe me ju përshëndetë vetë, por nuk janë në gjëndje të përmbajnë emocionin e madh që i ka përfshi.**

Asht i padiskutueshëm roli udhëheqës i Mbretit Zog për krijimin e afirmimin e Shtetit të ri në një Mbretni Parlamentare që po ecte drej qytetnimit evropian me mençuri e largpamje për përparimin e zhvillimin e vendit në të gjitha fushat e mundshme njerëzore. Por ashtu nuk mendonin anmiqt e shqiptarve. U tradhëtue prej megalomanisë së Musolinit që synonte të rikrijonte perandorinë romake duke fillue me Shqipninë. Siç e dimë tashma, Italia fashiste e sulmoi dhe e pushtoi Shqipninë me pabesi e tradhëti të madhe, duke zgjedhë kastile kohën kur e gjithë Shqipnia gezonte e festonte linjen e princit trashëgimtar. Por ja, balozi i zi fashist përdori pabesinë dhe Mbreti e Mbretnesha me foshnjën e njomë dy ditëshe i detyruen të marrin rrugët e mërgimit. I gjithë gezimi dhe hareja u kthyen në trishtim e vajë. Keni të drejtë me mendue dhe me pyet, ku ishte ushtria shqiptare që nuk i doli zot atdheut ne diten ma tragjike te tij, për ta mbrojtë atë ashtu siç i ka hije shqiptarit, në shembullin e Gjergj Kastriotit Skanderbeut dhe të herojve të tjerë të Kombi? Duke qenë se, për tradhëtinë e pabesinë e madhe që ndodhi,

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

*nuk na u dha mundësia për të luftue kundër pushtuesit, na doli si detyrë kryesore me mbrojtë Mbretin nga rreziku mos e zinin rob italianët që po marshonin me shpejtësi drej jugut e Korçës. Mbreti nuk pranoi me fillue luftën popullore në mal, për të cilën i bamë thirrrje, sepse nuk donte qe vendi dhe populli i tij te damtohej e të shkatërrohej. Ai na besoi organizimin e daljes së tij në Greqi, siç ndodhi e ku ju e ndoqet për me tregue besnikërinë tuej të pakufishme.**

Megjithatë, Mbreti iu drejtue S hoqnisë së Kombëve dhe Fuqive të Mëdha protesta të forta duke kërkue ndërhymjen e tyne për ta detyrue Italinë të hiqte dorë nga pushtimi i Shqipnisë. Të gjithë e banë veshin e shurdhët. Bile pati nga ata që u shprehen me cinizëm të madh, si Lord Chambelaini, Kryeminitsri i Anglisë, që në Dhomën e Komunëve kur e pyetën për çeshtjen shqiptare, u shpreh : Anglia nuk ka ndonjë interes të veçantë në Shqipni! Në këto kondita kur askush nuk i doli përkrahës, ai më thirri e më ngarkoi që jo vetëm të ju përshëndes në emën të tij, por që të ju lutem, duke pa se gjithçka ka mbarue e nuk mund të ndreqet, me u kthye në shpitë e familjet e jueja, në pritje të një dite të volitshme, duke pa se së shpejti ka me fillue një luftë bontnore e dytë, që ka me sjellë ndryshime të mëdha, me shpresën e rikthimit të Mbretit e rivendosjes së Mbretnisë Shqiptare. E kuptoj se asnjë prej jush nuk dishron të largohet, as unë që po ju flas.

Si thoni ju, që më njihni mirë, a mund të pranosha unë me u kthye në Shqipni ? Jo kurrë ! Por përsëri ju pyes, a mundesha unë mos me ju bindë urdhnit të Mbretit ? Jo kurrë ! Aq ma tepër kur ai m'u drejtue e më tha, a më njeh akoma si Mbret ? Kështu u detyrova t'i bindem. Prandaj, unë vetë me gjithë oficerët e tjerë do të ju prijmë me u rikthye të gjithë së bashku në shpitë tona, të trishtuem e kokë ulun, për me çue ne vend urdhnin e vullnetin e tij të fundit. Me shpresën se një ditë ai do të rikthehet përsëri mbi fronin mbretnor shqiptar.

Vështroni drejt nga banesa ku ai rrin. Mbreti dhe Mbretnesha me foshnjen ne krah, po ju përshëndesin nga dritaret me lot ndër sy. Po ju drejtojnë lamtumirën e tyne të fundit. Por mos qoftë kurrë e tillë. E ardhmja ka me e tregue.

Të dashun vllazën, unë tashti po shkoj dhe e i takoj Mbretin dhe Mbretneshën për me i përshëndetë në emën tuej, e pastaj të gjithë si jemi, me mue dhe oficerët e tjerë në krye do të marrim rrugën e kthimit për në Atdhe. Rroftë Zogu i Parë Mbret i Shqiptarve ! (*)

Me këto fjalë im atë i dha fund fjalimit. Njerëzit nuk i përmbanin emocionin e lotët dhe herë pas here thërrisnin : Rroftë Mbreti ! Rroftë Mbretnesha ! Rroftë Princ Leka !

Im atë bashkë me grupin e oficerëve e shkuen dhe u rreshtuen para ndërtesës ku rrinte familja mbretnore. Mbreti Zog duel jashtë ku u prit me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

nderim ushtarak prej të gjithë oficerëve, të cilëve u dha me radhë dorën, ku asnjeni nuk mund të përmbante përmallimin e lotët, ndërsa Mbretnesha, që kishte dalë mbi shkallët me gjith foshnjën në krah, i përshëndeste krejt e përvajshme. I fundit qëndroi im atë, që u përshëndet me Mbretneshën dhe u përqafue me Mbretin me përmallim të madh. Fjalët nuk u dilnin dot prej gojës aq ishte i madh emocioni. Një ndarje e dhimbshme.

_____

(*) Ky fjalim pati jehonë në gjithë vendin prej atyne që e dëgjjuen dhe që u la mbresa emocionuese në ato çaste aq dramatike. Nuk kishte pjesmarrës në atë përcijellje të fundit të Mbretit Zog që të mos e përmendte. Pushtimi italian dhe ma vonë diktatura komuniste u banë pengesë për mos rrështimin e drejtë të historisë, ku fakte qe treguem u mbuluen me harresë, dhe u trilluen gjana të paqena me njerëz te paqenë e mashtrime neveritëse. Një shemboll : një far oficeri që e mbante vetën fort të lartë (që s'ishte fare), na paska shkrue ne një libër se Zogu me Gjeraldinën u larguen për ne Korçë me një varg 40 kamionash (?), ku 40 kamiona s'i ka pasë e tanë Shqipnia. E se Mbreti paskej kalue në Greqi me 7 prill (?), tjetër rrenë. Nuk permendet asgja nga sa thamë ma sipër. Ai si oficer e ka ditun mire se kolonel Prenk Pervizi ishte komandanti i qarkut Korçës që e priti e përcolli Mbretin në Greqi, jo me 7 prill, siç pretendon ky oficer i pa ndërgjegje , por në mengjesin e 9 prillit. Dhe jo me Mbretereshën Gjeraldinë, e cila kishte kalue në Jugosllavi pîkërish me 7 prill. Ndërsa Zogun autoritetet jugosllave nuk e kishin lejue, siç e kemi tregue. Në emën të një oficeri tjetër, gjysëm analfabet, që s'dinte me shkrue, dikush ka botue një libër me kujtime gjoja të tij, fund e maje rrena e mashtrime, duke fillue nga largimi i mbretit në Greqi (ku s'përmendet emni i Prenk Pervizit) e gjithë kohën e emigrimit deri ne vdekjën e Mbretit. Po pse me të tilla rrena do të shkruhet historia shqiptare ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2019)

. *Flamuri qendronte në ballkon*

Kështu filloi kthimi për në Shqipni i gjithë asaj turme të madhe të përlotun nga ndarja e dhimbshme me atë burrë shteti e Mbret që kishte sundue 15 vjet mbi Shqipninë. Ishte si me u kthye prej nje morti, dhe mort ishte: vdekja e Mbretnisë Shqiptare. Se si historia do të japë gjykimin mbi largimin e tij, në çastin ma të vështirë të Atdheut, ajo mbetët për t'u analizue, në bazë të dokumentëve që kanë me u gjetë dhe të dëshmive të ndryshme të njerëzve që e shoqnuen gjatë gjithë jetës e veprimtarisë së tij. Patjetër se një i tillë njeri ka qenë im atë, që nga fillimi deri në fund të afirmimit të Zogut si burrë e udhëheqës shteti dhe të hypjës në fronin mbretnor. Prenk Pervizit i takoi që t'i qëndronte pranë edhe në atë çast tragjik të largimit në Greqi, që shënonte fundin e Mbretinisë shqiptare.

Kalimi në kufi u ba i rregullt dhe bile ndodhi diçka befasuese. Kur vargu i shqiptarve filloi të kalonte para postës kufitare për me dalë në Shqipni, oficerët e rojet greke qëndruen gatitu e me nderim ushtarak deri sa karvani doli krej matanë. Ishte një respekt për këta njerëz që po kthehëshin në vendin e tyne tashma të pushtuem, e që kishin tregue vullnetin e tyne me ndjek Mbretin në largimin e tij, në pamundësi që të banin punë ma të mëdha për të dhe për Atdheun. E së fundi kishin pranue me u kthye me vetë urdhnin e porosinë e Mbretit tyne. Oficerëve e ushtarakëve të tjerë, u a kthyen të gjithë armët vetjake e me këtë rast im atë kishte kërkue t'i kthehej dhe maliherri me zbukurime t'arta, por mbeti keq sepse i thanë se ajo armë nuk ishte aty, dhe oficeri që kishte qenë ma përpara ishte transferue. Kështu ndodhi që pushka humbi për me zbukurue si antikë e rallë murin e sallonit të ndonjë vile greke. Kjo e mërziti shumë, po nuk kishte çka me ba. Me kushtët qe u krijuen ai nuk mund ta ndiqte çështjën për me e gjet atë oficerin e pabesë.

Njëherë që kaluen në tokën shqiptare njerëzit u shpërndanë secili në drejtimin e tij dhe im atë me grupin e oficerëve të Korçës u kthyen pranë familjeve. Mama u çudit fort kur im atë u kthye. Ajo kishte qenë e sigurt se ai nuk do të kthehej ma, dhe kishte marrë masa për me u transferue në shpinë e pronat e Laçit, ku rrinte gjyshja me njerëzit e tjerë. E para punë që i ra në sy tim etit ishte flamuri kombëtar që qëndronte akoma në ballkon të. e kishte vendosë me dorën e tij, ditën e zezë të shtatë prillit, kur radiot lajmeronin pushtimin e Shqipnisë nga Italia fashiste. Ndërkaq, mori vesh çka kishte ndodhë pas largimit të tij. Korçarët e kishin kuptue se me largimin e tij dhe të ushtarakëve të tjerë, diçka kishte ndodhun, dhe kur morën vesh se tashma trupat italiane po marshonin drejt Korçës, u kthyen në banesat e tyne. U pa se askush nuk mund ta kundërshtonte këtë invadim të Shqipnisë. Nga ana tjetër u

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIO BARLETI" SHKODËR (2018)

muer vesh se Prenk Pervizi ishte takue me Mbretin dhe kishte organizue kalimin e tij në Greqi, prej ku ishin të sigurtë se ai nuk do të kthehej ma. Trupat italiane hynë në një Korçë të heshtun e pa njerëz rrugëve, me flamurët kombëtarë akoma nëpër dritare e ballkone. Sigurisht se pati nga ata që pranuen të marrin detyra në administratën e qytetit. Tashma që gjithçka kishte mbarue dikush duhet ta drejtonte vendin, siç kishte thanë vetë Mbreti Zog ne Greqi në rrethin e besnikëve të tij. Në Tiranë ishte formue menjëherë një qeveri me Kryeministër Shefqet Verlacin, anmiku numër një i Zogut, sepse, siç e përmendëm ma sipër, ky e kishte prishë fejesen me të bijën e tij, duke u martue me konteshën e bukur hungareze. Të gjithë anmiq e Zogut, ish fanolistët e të tjerë, ishin kthye me trupat pushtuese italiane të veshun si fashistë e kishin zanë poste në qeverinë kukull. Kështu që edhe në Korçë ishte vendosë një administratë e re pro italiane. Ndërkaq një ditë prej ditësh, i bajnë vizitë mamës disa nga autoritetet e reja, për t'u informue si ishte puna me kolonelin, a do kthehej apo jo. Duke pa në ballkon flamurin dhe në sallon fotografitë e Mbretit dhe të Mbretneshës, i kishin thanë se tashma nuk kishte kuptim që ato të qëndronin aty. Mama ishte pergjigje :

- Zotnij, ato i ka vendosë i zoti i shpisë me dorën e vet, dhe veç ai mund t'i hjekë. Unë nuk i prek. Po deshet i hiqni ju vetë si flamurin ashtu dhe fotografitë. Personat ishin largue pa thanë fjalë. Por, pas një muej kishin ardhë përsëri, duke iu lutë që ta hiqte flamurin prej ballkonit, por kishin marrë të njëjtën përgjigje, e ma nuk ishin dukë deri me kthimin e kolonelit. Kurse dy ushtarët mirditorë, që kishin qendrue dhe i kishin thanë se nuk leviznin prej aty deri sa te qetesohej gjendja e ajo të transferohej në

Laç, për ku do ta shoqnonin, ai i lejoj të kthehëshin në familjet e tyne, duke i shpërblye për besnikërinë e tyne Ai nuk e dinte akoma se si do të vepronin italianët ndaj tij. Mbreti Zog, në takimin e fundit, i kishte thanë, se ai po e kthente në Shqipni, ku ushtria shqiptare kishte nevojë për të sepse italianët nuk do të ndërmerrnin masa drastike ndaj saj as ndaj oficerëve, e posaçërisht ndaj tij, nga frika mos ndodhnin trazira. Ata e dinin mirë se çfar influence e autoriteti gëzonte Prenk Pervizi në ushtri e në popull.

Prandaj ato merita që unë nuk t'i njoha dot, ishte shpreh Mbreti, ata do t'i njohin e ti duhet t'i pranojsh, ashtu dhe të tjerët. Veçse mos me u shty përtej disa caqeve. E kishte porositë që të njoftonte besnikët kudo ishin për sa kishin folë, që te ruhej gjendja e qetësisë për mos me i shkaktue dëmtime e shkatërrime popullit, siç e përmendem. Të rrinin në pritje, sepse diçka kishte me ndodhë gjatë e pas kësaj lufte botnore që ishte gati për me plasë. Ai do të gjente mënyrën për me pasë lidhje me ta. Ndoshta kujohështin kushtet për një rikthim të tij në Shqipni.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Fotografi e hyrjës së shtëpisë së Prenk Pervizit në Korçë. E shoqja, zoja Prena, në fustanin për festën në Pallatin e Mbretit në Tiranë për nder të 28 nëntorin , më 1938 , që do t' ishte i fundi i Mbretnisë shqiptare. Në këtë ballkon flamuri kuq e zi qëndroi ma se një muej të pushtimit e s'guxoi kush ta hiqte, veç kur u kthye i zoti nga Greqia. siç u tregue ma nalt. Kjo shtëpi për ironi të fatit, në luftën italo-greke pësoi një bobardim që e dëmtoi fare e s'i mbeti gjurmë veç truelli me gërmadha.

---

*-- Të gjithë ngjarjet e pâraqituna ma sipër lidhen me zhvillimin e vërtetë të rethanave që u krijuen ku edhe ato personale e familjare pasqyrojnë gjëndjën që u krijue, dhe përforcojnë realitetin tragjik e historik të atyne ditëve kur Shqipnia e shqiptarët pësonin një pushtim të huej të parapamë e të paralajmeruem, që s'u muer fare në konsideratë as nga Mbretnia as nga Qeveria e asaj kohë. Sot e kësaj dite po trillohën gjana të paqena të përbindshme, ku historianët mbesin jashtë loje deri aty që t'u nënshtrohën deformimëve e fallsifikimëve që u sërvirën nga individë, shoqata, organizat e deri parti. Keto kanë sajue një version historik të tyrin, të cilin ua imponojnë me fodullek të tjerëve dhe aq ma keq përèçudnojnë rinin, e cila tashma asht shumë larg asaj kohe dhe arrin t'i besoje çdo pralle që i sërviret nga njerëz pa cilësitë shqiptari. Kanë dalë disa libra me kujtime të paekzistueshme, të paqena, veçme i ndryshue fjedhën historisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Pasojat e pushtimit

Të rikthehemi në tregimin tonë. Pas do kohë, pa i komunikue asnjë lloj urdhni apo detyre, im atë thirret me marrë pjesë në një mbledhje të organizueme nga prefektura e re e Korçës me italianët, ku ishin thirrë gjithë personalitetet dhe njerëzit me influencë të qytetit. Im atë u detyrue të shkojë, dhe në çastin kur hyni në sallë ku ishin mbledhë autoritetet shqiptare e italiane dhe të ftuemit e tjerë, duke qenë se kishte ardhë me rroba civile, dhe ashtu siç ishte krejt i merzitun me mendje të bjerrun, kishte nderue alla zogiste me dorën e shtrime në zemër. Të gjithë po e shikonin me habi, a ishte në vete koloneli ? Një person që ishte pranë tij, e kishte prekë në brryl duke e sjellë në vete. Njerëzit e kuptonin hutimin e tij, sepse po aq të hutuem ishin ata vetë. Në këto rrethana ai u detyrue të kthehet në Tiranë, ku menjëherë u thirr në takim nga vetë, Gjenerali Pariani, Mëkambës i Mbretit të Italisë në Shqipni, me të cilin ai ishte njohun prej kohësh, qyshë kur vazhdonte Shkollën e Luftës në Torino

Fjalët e para që i kishte thanë Pariani, pasi e priti dhe u ulën për të bisedue ishin këto :

- Zotni Kolonel, ne e dimë mirë, se po ta çajmë zemrën tuej, aty do të gjenim të ulun kambëkryq Mbretin Zog. E kemi marrë vesh se ke përciellë Mbretin tand në largimin e tij nga Shqipnia. Një detyrë që të nderon. Gjithashtu e dimë se rrethanat që u krijuen nuk ju shkojnë fare përshtat. Por, ndodhi çka ndodhi, ne kërkojmë prej jush, si përfaqësues i naltë i ushtrisë shqiptare, që t'i përshtateni kesaj gjëndje, e të mos shkaktohen shregullime. Ne nuk do ta luejmë ushtrinë shqiptare, ajo do të qëndrojë siç ishte, si nga ana e kuadrove ashtu dhe nga ajo e trupave. Im atë e kishte pa veten ngushtë, por i kujtohëshin këshillat e Mbretit dhe u përmbajt.

- Zotni Gjeneral, nuk mund të them se jam i qetë, bile s'jam shumë i dishpruem, siç mund t'ishit ju ne vendin tim. Sa për ushtrinë shqiptare qe ju thoni do ta lini siç asht, me vjen mirë dhe po e pranoj një vendim të tillë. Por duhet të keni parasyshë, se ajo do të rrije e pavarun dhe pasive, e nuk do të pranojë kurrë që të veprojë kundër popullit të vet as kundër fqinjëve kufitarë, përkrah ushtrisë italiane, ishte përgjigjë im atë. Pariani kishte mbetë pak në heshtje e pastaj kishte folë:

- Mirë, zotni Kolonel, jemi dakord me këto kushtë. Ushtria shqiptare le të qendroje si e pavarun dhe inaktive. Veçse të keni parasyshë të mos na krijoni incidente që të kapërcejnë kushtet që ju kërkoni dhe që ne po i pranojmë.

Biseda u mbyll me aq. Pariani e njihte atë shumë mirë dhe kishte

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

respekt e konsideratë të madhe ndaj tij, për përgatitjen e lartë dhe horizontin e gjanë kulturor e si njeri me karakter të fortë, burrë besnik e trim dhe ushtarak me aftësi të ralla. Italianët e konsideronin edhe si një nga besnikët e miqt ma të ngushtë të Mbretit Zog. Ia kishin edhe frikën, në kuptimn se ai gëzonte influencë të madhe në popûll e në ushtri. Kompromisi i përshtatej të dy palëve. Mbreti Zog kishte pasë të drejtë. Të ruhej distanca me italianët me një qëndrim pasiv e të pavarun, aq sa ishte mundësia, pa u angazhue ma gjatë me ta. Kështu si prindi im ashtu dhe gjithë kuadrot oficerë të Mbretnisë Shqiptare mbetën në detyrat e tyne si komandantë të njësive të ndryshme të ushtrisë shqiptare, duke përjashtue ndonjë rast të rallë të ndonjënit që nuk pranoi, si zgjedhje individuale.

Përball këtij qëndrimi të ushtrisë shqiptare, se ajo do të rrinte si e pavarun dhe inaktive, autoritetet italiane në bashkëpunim me ata që kishin pranue të përqafonin fashzmin me detyra deri Ministra e Sekretarë të partisë fashiste, krijuen armën merçenare të "milicisë fashiste" me elementë fshatarë me pagesë e me oficerë kreshnikë pa ndonjë shkollë. Asnjë oficer efektiv i ushtrisë shqiptare nuk kishte pranue me u përfshi në atë "milici fashiste " merçenare, e cila ishte e kushtëzueme me marrë pjesë në aksione edhe kundër popullit të vet, përkrah armës së karabinierisë. Kështu u ba një ndarje e "shapit nga sheqerri", ku ushtria shqiptare shikohej si bijë i njerkës. Si im atë ashtu dhe oficerët e tjerë madhorë të quejtun zogistë, konsiderohëshin si anmiq të pa shpallun, por anmiq. Prenk Pervizi mbahej në dispozicion, me banim në Tiranë dhe ishte i survejuem nga SIMI, sherbimi sekret italian. Nuk kishte ndonjë detyrë të caktueme e nuk i ishte dhanë asnjë lloj komande mbi ushtrinë shqiptare. Por i njihej grada, autoriteti, influenca e konsiderohej si përfaqësues i saj. Në këto kushte, dy ishin oficerët më të naltë në Shqipni, kolonelat Aqif Permeti e Prenk Pervizi, që ma vonë u ngritën në gradat gjeneralë.

Aqif Permeti ishte caktue si komandant i trupave shqiptare në Kosovë, kur kjo krahinë iu bashkue Shqipnisë me 1941. Siç dihet kjo ndodhi pas shpartallimit të Jugosllavisë nga ana e forcave gjermane, ku Jugodllavia u shpatallue dhe iu hoqën disa krahina, që dolën shtete ne vete, si Kroacia e Sllovenia. Ndersa Kosova me pjesën shqiptare të Maqedonisë, tokat shqiptare në Malin e zi iu kthyen Shqipnisë, ku shqiptarët e panë veten të bashkuem në një shtet te vetëm etnik, si askurrë në historinë e tyne. Gjermanët mundësuen edhe përfshimjen e Çamerisë në Shqipninë Etrnike, kur u erdhën në ndihmë italianëve në luftën me Greqinë, duke i shpëtue nga disfata përfundimtare që mund të çonte në pushtimin e Shqipnisë nga forcat Greke, që kishin mbrritë deri në Tepelenë, me synim që të merrnin Vlorën., e t'i hidhnin italianët në det.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Përshtatje e detyrueme

Familja jonë u kthye në Laç e Tiranë. Ne kishim ardhë për pushimet verore. Unë e Genci kishim shkue në Laç ku rrinte gjyshja. Vellai i madh Valentin, që kishte mbarue shkollën ushtarake të Romës, qëndroi do kohë në Tiranë me prindët. Nji ditë prej ditësh të atij qërshori 1939, im atë e Valentini, kur po dilnin nga libraria "Argus", takohen ballë për ballë me Muharrem Bajraktarin e Fiqri Dinen. U perqafuen. Im atë u tha se i ftonte në shpinë e tij, sepse kishte porosi të randësishme nga vetë Mbreti Zog, por duhej lajmërue dhe ndonjë tjetër. Telefoni nuk funksiononte asokohë dhe e ngarkoi Valentinin, duke i dhanë adresat me njoftue Hysni Demën, Ali Erebarën dhe Sali Vuçiternin. Ishte pasdite. Ata u gjetën të bashkuem në shtëpinë që baba kishte zanë me qëra te pazari i ri. Aty ia shtruen bisedës.. Pasi shfaqen dishprimin e zhgënjimin e madh të tyne për këtë pushtim pa pushkë të shtime, dhe gabimet e qeverisë e të vetë mbretit Zog, që nuk i dolën para kësaj pune, im atë u tregoi si e priti dhe e përcolli mbretin, dhe si ai e urdhnoi me u kthye me porosinë që të mos ndërmerrëshin veprime të nxitueme që mund t'i sjellnin fatkeqësi e shkatërrime vendit e popullsisë. Të rrinin në pritje të një mesazhi të tij dhe të përfundimit të luftës botnore, ku e ardhmja i Shqipnisë do të gjente zgjidhje me kthimin e tij në fron. Miqtë ranë dakord për sa im atë u tha dhe vendosën që të vazhdonin të mbanin lidhje e të njoftonin dhe besnikë të tjerë mbi porositë e Mbretit Zog. Ndërkohë Muharrem Bajraktari largohet i pari, siç kishin vendosë me dalë veças, për mos me ra në sy. Në këtë takim ishte dhe Valentini, prej të cilit asht nxierrë ky përshkrim. Kur kishte dalë Muharremi, im atë iu ishte kthye miqve të tjerë:

- Mos kujtoni se Muharremi do të rrije rëhat ? Sa të mbrrije në Lumë, ka me ua vu pushkën italianëve. Të gjithë kishin qeshë me të madhe, sepse e njihnin karakterin e papërmbajtun e shpërthyes të Bajraktarit. Dhe ashtu ndodhi.

Ne shkakun ma të parë, Muharremi u vuni pushkën forcave italiane. Por keta ma vonë e lanë të qetë atje në Lumën e tij duke evitue incidente të tjera. Kjo tregonte se italianët ia kishin frikën këtyne burrave që ne rast ngacmimi e masash ekstreme ndaj tyne mund të shpërthenin trubullina të papërmbajtshme. Në këtë gjëndje, përveç Bajraktarit në Lumë, që u ishte kundërvue me pushkë italianëve, dhe keto pastaj nuk kishin tentue me e provokue, por e mbanin nën kontroll e vëzhgim të vazhdueshëm, ishin edhe disa oficerë të tjerë që rrinin në gjendje mali. Në Malësinë e Shkodrës, në Shkrel, ishte major Llesh Marashi, që kishte krijue forcat e veta luftarake, dhe ishte ndeshë me italianët. Këta si me Bajraktarin, nuk e ngacmonin dhe e linin

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

të qarkullojë në krahinën e tij, duke ia kontrollue lëvizjet. Pastaj ishte major Abaz Kupi, që edhe ai rrinte ne mal, kryesisht në krahinën e Matit me disa besnikë, por pa krye ndonjë veprim e pa e trazue kush. Me të, ma vonë, ishte bashkue një mision anglez i ardhun nga shtabi i Titos, i përbamë nga koloneli Meklin, koloneli David Smiley, kapiteni Julian Amery e të tjerë. Ma tepër si vëzhgues e agjentë të Aleatëve, që varëshin nga Komanda e Mesdheut. Edhe Abazin nuk e trazonte kush, dhe qarkullonte lirshëm atyne maleve, si shoqnues i anglezëve. Çdo paraqitje tjetër për këto njerëz e gjëndje, nuk i përgjigjet aspak së vërtetës. Në tregimet që janë dhanë, ka manipulime dhe trillime për lavdi vetjake. Im atë, sigurisht se mbante lidhje me ta, me anë njerëzish besnikë, që binin e çonin mesazhe, ma tepër gojore. Kjo ishte nje marrëveshje midis tyne për të ruejt nën kontroll gjëndjën, në pritje të një mesazhi nga ana e Mbretit Zog, siç Mbreti i kishte lanë porosi. Nuk dihet pse Zogu nuk u orvat të lidhet me besnikët e tij e të çojë edhe udhëzimet e rastit. Nga dokumentët në arkiven agleze, del se Bazi kishte çue fjalë me anë të misonin anglez, që Mbreti t'i dërgonte një mesazh, por Mbreti nuk kishte pranue me ia çue atij. Kishte kerkue që nje mesazh te tillë mund te ia çonte Dr. Sali Vuçiternit, ish Ministër i Arsimit. Anglezët nuk e kishin pranue këtë variant. Pse Zogu nuk ia dergoi atë mesazh Bazit Canës ? Kjo kuptohet, sepse Bazi nuk i plotësonte konditat e një njeriu të ngritun e me përvojë politike e ushtarake, duke qenë edhe i pashkollë e analfabet, veç një major kreshnik me mbajtë rendin e një qyteti, pa asnjë përvojë apo përgatitje, që s'kishte komandue një njësit të vetëm ushtarak.

Çudia vjen pse mbreti nuk u lidh me ato oficerë të shquem që kurdoherë i kishin përballue me nder e sukses situatat e rrezikshme që kishte kalue vendi, dhe që ishin ushtarakë të ngritun dhe me eksperiencë e gëzonin respekt e prestizh në ushtri e në popull. Përsëri dalim në përfundimin se edhe në jetën e mërgimit, ai vazhdoi të mbajë rreth vetes, njerëz servilë, intrigantë e smirëzez dhe pa aftësi politike dhe luftarake. Këta ndikonin me ia prish medjen me thashetheme intriguese. Ma vonë, kur atij iu mbush mendja se duhej çue një mesazh besnikëve në Shqipni, ketë punë nuk ia lejuen anglezët. Pse vallë ? Thjesht me u kuptue. Sepse organizimi i forcave nacionaliste do të thoshte, mbatjën e gjendjës se bashkimit kombëtar me Kosovën e trojet e tjera, që i ishin bashkangjitun Shqipnisë. Ketë punë nuk e donin anglezët, për mos me u prish me Titon, të cilin e kishin sigurue per Kosovën se do të hynte në po ato kufijt e parë, pra në Jugosllavi. Cërçilli nuk e kishte dergue kot pranë Titos djalin e tij. Kjo asht politika bazë e tradhëtisë që iu ba nacionalismit shqiptar, e nuk asht nevoja me kërkue tjetër shkak e argument justifikues. Gjithë sa u shkrue deri tani e që do të shkruhet në vazhdim, patjetër se do të tingëllojë si e panjohun nga pikpamja historike, për të vetmen arësye se ato historianë që e kane shkrue historinë shqiptare i përkisnin nomenklaturës komuniste, që do të përjashtonin nga faqet e librave të tyne jo vetëm njëjarjet por dhe njerëzit që i

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

përjetuen ato. Ky lloj zakoni po vazhdon edhe tani, me një theks edhe ma bajat, sepse po dalin njerëz që marrin përsipër gjana e veprime të pa qena, ose duke ia ngarkue lloj lloj sojsorollopit që nuk ka pasë asgja në dorë, përveç dredhjes se zinxhirit ose kalimit të rruazave të tespive nëpër gishta. Ose duke hangër dreka e darka në kullat shqiptare, e duke shetit si turista maleve. Duke kapërcye të gjithë imtësitë e vogëlsinat e ndrysme që shoqnojnë edhe ngjarje të mëdha, unë i jam kushtue atyne fakteve të përjetueme konkretisht nga prindi im, që ka qenë i pranishëm në to. Para shtatëdhjetë vjetëve nuk kishte shqiptar që nuk e dinte se kush ishte Prenk Pervizi e ç'rol kishte luejt në historinë e vendit dhe sa besnik i kishte qendrue Zogut e sa herë ia kishte zgjidhë problemet, por mjerisht nuk ka mbetun kush gjallë prej tyne, përveç ndonji ekzemplari të rallë siç jam unë vetë. Për ata që do të lëxojnë rrëfimet e tij, që shtjellohet dhe si një tregim i lirë, po t'i kushtojnë vëmendje do të marrin vesh si u zhvillue jeta dhe historia shqiptare dhe cilët ishin përsonazhet e ngjarjet që ndikuen në to. Libri pra shkruhet, jo vetëm për me tregue biografinë e tim etit, por me tregue edhe një pjesë të mirë të historisë së Shqipnisë, veçànërisht të asaj që u mbulue me harresë e u mohue. Do t'ishte shumë e dobishme për historianët e ri, qe ta lexojnë e t'i kushtojnë vemendje të posaçme këtij libri, sepse asht e vetmja vepër ku radhiten ngjarje te sakta, të mbetuna të fshehta qellimisht nga koha e gjatë gjysmëshekullore e diktaturës komuniste që i vuni kazmën gjithçkaje duke përfshi dhe historinë me njerëzit që e përcollën atë.

Ushtria Shqiptare nuk bahët mish për top

Për sa thamë ma sipër e gjitha konkretizohet në luftën italo-greke ku italianët përfshinë pa paralajmerim e pa pyetun njeri, disa trupa shqiptare. Siç dihet lufta italo-greke u provokue dhe u ndërmor prej vetë Musolinit, të cilit tashma i ishte mbushë mendja se po ecte mbi gjurmët e Romës, për me rikrijue një Perandori të re romake, duke mendue se edhe Greqinë do ta përlante si Shqipninë brenda tre ditëve.

Shkaku i luftës ishte krejt banal, gjoja vrasja e një bariut shqiptar çam, Daut Hoxha. I qenë a i pa qenë, u vra a s'u vra kush nuk dihet, por ky emën apo njeri u shpik e u përdor si "casus belli" (shkak lufte). Italia me këtë pretekst i shpalli luftë Greqisë, gjoja në mbrojtje të interesave të Shqipnisë vasale e saj. Dhe me marifet të madhja ngarkoi shpalljën e luftës qeverisë kukull shqiptare. Ndërsa faktikisht gjithçka ishte përgatitë e planifikue nga

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

vetë Musolinit, që më 28 tetor 1940 invadonte Greqinë, me mendimin se do ta pushtonte kollaj siç bani me vendin tonë. Ana qesharake ishte se ushtarëve italianë u kishin krijue përfytyrimin e vajzave të Athinës që i prisnin me padurim pipinot bukurosha, për të cilat bukuroshe sikur po shkonin për një vizitë turistike plot defrime.

Kështu ushtria shqiptare u gjend e përfshime në rang batalionesh të aneksueme në divizionet italiane, kryesisht ne divizionet "Venecia" e "Julia". Prenk Pervizit si kolonel iu dha komanda e një regjimenti ku ishte përfshi bataljone italiane dhe bataliomi shqiptar "Tomorri" me komandant major Spiro Moisun, që ishte edhe mik i tij. Ndonjë batalion tjetër shqiptar ishte përfshi në regjimentë të tjerë në pika të ndryshme të frontit. Prenk Pervizit i qëlloi fronti i krahinës së Korçës, në zonën e Bilishtit e t'Ersekës. Duhet theksue se ndërkaq, Ministria e Fashizmit, kishte krijue, siç kemi thanë, milicinë fashiste këmishëzezë me merçenarë, që nuk kishte te bante fare me ushtrinë efektive shqiptare, biles ishte në kundërvenje me të, sa që edhe ushtarët e thjeshtë t'ushtrisë efektive nuk i përfillnin as i nderonin oficerët e kësaj milicie fashistë. Aq sa i përbuznin. Një bataljon i tillë me milicë "Gramozi" nën komandën e majorit kreshnik Frrok Doda, ishte aneksue një regjimenti fashist ne një divizion të kemishave te zeza (camicenere), ku komanda efektive shqiptare nuk kishte të drejtë ndërhyrje e ndikimi.

Kësaj radhe Musolinit i ngeci sharra në gozhdë. Ndryshe nga shqiptarët që nuk morën asnjë masë mbrojtëse duke e ditun mire se Italia fashiste do t'i sulmonte, Grekët ishin përgatitë me i ba ballë sulmit Italian, qyshë kur u pushtue Shqipnia. Duke i dale para rrezikut, qeveria greke me kryeministër Metaksas e kishte përqendrue ushtrinë gjatë kufijvë të Shqipnisë. Megjithatë me 28 Tetor 1940 trupat italiane kaluen befasisht kufinin Grek duke perparue disa kilometra e pushtue disa fshatna kufitare, pa gjet një qendresë efektive. Keshtu dhe regjimenti i Prenk Pervizit hyni në një fshat grek i braktisun nga shumica e banorëve burra, që ishte në rrugën e Folorinës. Im atë vendosi komandën në një shtëpi te një kapiteni grek, ku thirri disa pleq te fshatit duke i sqarue se ai ishte oficer shqiptar dhe se ajo luftë nuk ishte e tyne, por e pushtuesit fashist italian, pra të mos kishin frikë e merak se ai nuk do të lejonte asnjë shkelje nga ana e trupave që komandonte. Banesën do ta përdorte si komandë, dhe ashtu siç e kishte gjete do ta linte, pa prekun asgjë në të, kur të largohej. I kishte porositë qe ta njoftonin për çdo shkelje të keqe nga ana e ushtarëve. Fshatarët kishin mbetë të befastem nga sjellja burrnore e fisnike të këtij komandanti shqiptar. Njëkohësish im atë kishte lëshue një urdhën dite, që për çdo shkelje e mbrapështine në dam të popullsisë së atij fshati nga ana e ushtarëve nën komandën e tij, do të merrte masa disiplinore të rrebta. Kështu për ato pak ditë që qëndroi aty, nuk ndodhi asnjë incident. Kur erdhi puna me u largue, prej kundërsulmit të ushtrisë greke, ai i mblodhi përsëri pleqt e fshatit dhe ua dorëzoj banesën ashtu siç e kishte gjetë, e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

gjithçka tjetër që ishte përdorë nga ushtria e tij. Kjo ngjarje mbeti ne mendjen e banorve, e për sa jetuen ata që e kishin përjetue, flisnin me admirim për atë oficer shqiptar qe ishte tregue aq i naltë e fisnik në mbrojtje të banorëve të atij fshati.

Megjithëse ushtria italiane ishte në terheqje të plotë ndaj sulmeve të papërbajtuna të ushtrisë greke, Musolini me 19 nendor do të mburrej me të madhe nga ballkoni i Palazzo Venezias :

- Ju thashë se do t'ia thyenim brinjët Negusit. Tani me te njejtën bindje absolute, e përsëris absolute, ju them se do t'ia thyejmë brinjët Greqisë !

Ndërsa po ndodhte e kundërta, sepse në frontin grek po i thyhëshin brinjët ushtrisë fashiste italiane.

Për Shqipninë nuk u fol asgja, për Greqinë, opinioni ndërkombëtar kishte marrë qëndrim ndaj sulmit të Italisë mbi Greqinë.

Pati disa reagime në favor të saj. Anglia ndërhyni menjëherë me ndihma në armatime e trupa. Aviacioni anglez filloi të bombardojë skelet e Italisë duke i shkaktue dame në flotën ushtarake te saj të përqendrueme ne skelen e qytetit detar të Tarantos. Gjithashtu mori pjesë në bombardime në frontn e luftës ku u bomabardue dhe Korça. Në këtë bombardim një bombë ra dhe shkatërroi shtëpinë e Prenk Pervizit.

Mbreti i Greqisë, ndryshe nga Mbreti Zog, nëpëmjet kryeminstrit Metaxas kishte shpallë mobilizimin e përgjitshëm për mbrojtjën e atdheut. Nga 14 deri 70 vjeç të rroknin armët për mbrojtjën e Patridës ! Kësaj thirrje iu përgijgj mbar populli dhe menjeherë filloi kundërofensiva e përgjithshme greke qe i detyroi italianët në një tërheqje shkatërruese për ta. Disfata e ushtrisë fashiste mori përpjestime të mëdha, që u keqësue edhe nga mbajtja e keqe e kohës, me shi e stuhi. Për të përballue këtë dështim ushtarak, komanda e naltë italiane vendosi të sakrifikojë njësitët shqiptare në mbrojtje të tërheqjes së ushrisë së saj. Duke e njohun karakterin e fortë e temperamentin impulsiv të kolonelit Prenk Pervizi si dhe ndikimin që ai kishte në trupat shqiptare, qoftë të vetat ose edhe të tjerat, komanda italiane e ngarkoi paprimas me detyrë me shkue në Tiranë për disa çeshtje dokumentash. Aty u detyrue te kryente atë punë, ku njëkohësisht do të shkonte me pa si shkonin punët e shpisë e familjës në Laç. Diten e trete që ishte në Tiranë, vjen ni nip i tij në shërbim të Spiro Mosisut i dërguem prej majorit, që të kthehej urgjentisht ne front sepse italianët po merrnin disa masa të këqia ndaj shqiptarve. Rrugës, i nipi, rreshter Nikoll Pali, i tregoi se si komanda italiane kishte caktue në mbrojtje të tërheqjes, batalionin e milicisë fashiste "Granozi" të Frrok Dodës, i cili pothuejse po rrethohej pa shpëtim prej grekëve. Sa ishte dukun makina e tim etit, komanda shqiptare me major Moisiun i kishin dalë para, ku menjëherië im atë kishte pyet:

- Çfar ka ndodhun Spiro ?
- Shumë keq asht puna, zoti Kolonel Batalioni i Frrok Dodës asht rrezik

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

t'asgjësohet. Në mungesën tuej, komanda italiane e ka caktue në vijën e parë të frontit, për me mbrojtë tërheqjen e ushtrisë se saj, në një pozicion fare te papërshtatshëm e të pashpëtim.

- Si mor këto qena po dashkan te na perdorin si mish per top ? Kishte shpërthye im atë. Prandaj me kanë largue, pse nuk do ta kisha lejue atë punë kurrë ! Horrat !

Ndërkaq Major Spiro dhe shtabi shqiptar dolën në një pikë vrojtimi ku im atë mundi me kuptue se fjalët e majorit ishin me vend.

Batalionin"Gramozi" e kishin caktue në një pozicion të tillë si gropore, prej ku nuk mund të dilte ma. Fronti ishte ne mbyllje e sipër. Atë e kishin zanë nervat dhe ashtu siç ishte i xhindosun kishte shkue drejt e në komandën italiane, ku nuk kishte lanë gja pa thanë në prani të vetë gjeneralit Soddu, Kryekomandant i ushtrisë, ndër të tjera duke u shprehun me forcë : "ushtria shqiptare nuk bahet mish për top" !

Sa u kthye prej andej, i dha urdhën shoferit Kol Prela të përgatisë makinën, një Fiat 1100, dhe kapitenit Prenk Marka Perzefi që ta shoqnonte. Gjallë a dek do të shkonte me i takue ato djem nanash. Major Moisiu me oficerët e tjerë iu lutën mos me e ba atë çmenduni, me rrezikue edhe veten, kur po shihej se fronti tashma po mbyllej. S'kishte burrë nane që me e ndalue. Makina u nis dhe pas pak kaloi në zonën e luftimëve. Komanda italiane kishte dalë e gjitha përjashta. E una pazzia ! Il colonello è impazzito ! Kjo asht çmenduni ! Koloneli ka falisë ! Ndërkaq artileria greke filloi të gjuej. Predhat binin sa para mbrapa. Shoferi që njihej si nga ma të mirët, kalonte me shpejtësi, rrugë pa rrugë e me dredha. Në këtë përshpejtim, ai nuk e kishte dallue një gropë të shkatueme nga predhat dhe ra mbi të papritun me një kundërgoditje të fortë që ua përplasi te treve kokat mbi tavan. Ata shpëtuen me disa gërvishtje e u gjakosën pak. Incidenti kaloi edhe ata mbrriten te batalioni. Frrok Doda me gjithë të tjerët mbetën të çuditun. Një takim dramatik !

- Jo kështu or Prenk, si me rrezikue jetën ? Ne të mbaruem se të mbaruem jemi ! I kishte folë Frrok Doda, me të cilin ishim miq të vjetër. Frroku ishte një degë e Gjomarkajve.

- Po kjo nuk ash luftë e jonë, or Frrok !... duhet ta kishi braktisë menjëherë këtë vend të papërshtatshëm. Sot e mira vesh sa t'kthehva nga Tirana, S'do ta kisha lejue kurrë ketë punë !

Si do të shkonte halli ? Me u dorëzue grekëve s'bahej fjalë. Ishin të gjithë mirditorë e nuk mund të çonin turp në shtëpitë e tyne. Do të përpiqeshin me ça rrethimin. Kjo e gjitha. Çaste tepër tronditëse. Ato djem të ri gjëndëshin para vdekjes te pa evitueshme. Një vdekje heroike, për idenin e shqiptarit. Im atë nuk kishte insistue me major Frrok Dodën, për mos me e fye e randue. U ndanë pa mundun me përmbajtë emocionin. Im atë e kapiten Prenga u përqafuen me Frrokun dhe me oficerët e tjerë. Ndërkaq nga rreshtat e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (C) 2018

ushtarëve ngrihëshin zana:

- Prenk Pervizi, t'i thoni Mirditës, se s'e turpnojmë atë e s'çojmë marre në shpitë tona ! Ngjarja ishte shumë ma dramartike se sa po e tregojmë.

Një ndarje e dhimbshme. Tregonte shoferi Kol Prela se aty kishte pa duke qa burra trima e komandantë të shquem. Kapiten Prenk Mark Përzefi, që njihej si një njëri trim me bre hekur me dhambë, qante si fëmijë për fatin e zi që priste ato djelm nanash. Kur makina u nis në rrugën e kthimit, për çudi të çudive, grekët nuk gjuejten fare. E kjo i çuditi të tre burrat, por dhe komandën italiane që e kishin ndjek me dylbi atë aksion tepër të rrezikshëm, ku guximi i kalonte caqet deri në çmenduri.

Im atë bashkoi shtabin shqiptar dhe i porositi që tash e tutje të mos zbatonin asnjë urdhën të komandës italiane pa e vu në dijeni atë. Në rast se ai nuk do të ishte aty, të merrnin urdhnat nga major Spiro Moisiu. Aty u vendos që, kur të fillonte ofensiva e metejshme greke dhe tërheqja e ushtrisë italiane, batalioni "Tomorri"do të tërhiqej menjëherë pa rrezikue sikur jetën e një ushtari, duke zanë një pozicion mbrojtës të sigurt, që u caktue që ma përpara. Pas këtij vendimi, im atë u drejtue në komandën italiane, e në mbledhjen që ajo bani, u shpreh se asnjë vendim i asaj komande në drejtim të njësive shqiptare, nuk do të bahej pa dijeninë e aprovimin e tij. Dhe u kishte tërheqë vrejtjen se si kishin mundun me e caktue njesitin shqiptar në një pozicion të tillë fare të papështatshëm dhe pa kriter strategjik. Si rrjedhim u vendos që batalioni do të braktiste vijën e frontit, ku ishte caktue, sa të fillonte ofensiva greke dhe tërheqja e ushtrisë italiane.

Ndërkaq, kur ra nata, matanë frontit, nisi sulmi i ushtrisë greke që u ndesh me batalionin e rrethuem. Luftimi vazhdoi gjithë natën. Shqiptarët të zanun ngusht, luftuen me tërbim duke u përpjekë me ça rrethimin, e mbetën të vramë puthuejse të gjithë. A shpëtoi a s'shpëtoi ndonjë prej tyne nuk u muer vesh. Asnjë sish nuk mund të pranonte të dorëzohej me armë në dorë, që do të thoshte një turp i madh për familjen, fisin e Mirditën. Një sakrificë heroike që do të mbetej ne kujtesën e mirditorve e që do të trashëgohej brez pas brezi me gojdhana e kangë heroike. Mbi batalionin "Tomorri", kishte ra një nije e zezë mortore. Asnjë ushtar e oficer nuk e njohu gjumin atë natë. Të gjithë kishin dalë nga llogoret për të ndjekun atë ngjarje tejet tragjike. Im atë me gjithë komandën shqiptare dhe ushtarët qëndruen përjashta në kambë gjithë kohën deri kur heshtën krismat e armëve, qe shënonin fundi e asaj tragjedie të madhe. Lotët rridhnin të papërmbajtun mbi faqet e atyne burrave. Një trishtim i madh që zgjati disa d

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



PRENK PERVIZI (Kolonel)
në frontin grek, 1940-1941, ku u dëshmoi braktisjën
e frontit nga trupat shqiptare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Braktisja e frontit grek

Sa filloi ofensiva e mëtejshme greke dhe tërheqja e trupave italiane, batalioni "Tomorri" e braktisi vijën e parë të frontit, dhe u tërhoq duke luftue, drejt pozicionit që ishte caktue mbi një kodër. Në këtë orvajtje një ushtar mbeti i plagosun në kambë nja pesedhjetë metra mbrapa. Ishte nga fisi i Margjonit të Skurajt të Kurbinit. Aty doli rrështer Nikoll Pal Gjini, nip i babës, i cili u lëshue me shpëtue bashkfshatarin e tij nën mbrojtjen e zjarrit të shokëve. Ai arriti ta marri në kurriz, dhe si i fuqishëm që ishte, iu ngjit përpjetës dhe e shpëtoi. Fakti ishte se dy fiset ishin në anmiqsi, por në atë rast, Nikolla tregoi një burrni e trimni të pashoqe, për të cilin veprim fitoi simpatinë e admirimin e të gjithëve. Nikollën, major Spiro e mbante gjithmonë pranë vetes, jo vetëm sepse ishte nip i komandantit, por dhe si një i ri trim e besnik.

Pasojat e këtij veprimi të batalionit ishin shumë të randa për ushtrinë italiane. Grekët duke mos gjetun një qëndresë mbrojtëse në vijën e parë të frontit, u sulën mbi ushtrinë italiane me tërbim duke e detyrue të tërhiqej në shregull e me humbje të mëdha. Kjo i hapi rrugë pushtimit të Korçës nga ana tyne. Disfata shkaktoi çoroditje në radhë të ushtrisë e të komandës italiane, e cila deshi të marrë masa drastike, e duke mos guxue ndaj Prenk Pervizit, për t'evitue çdo incident deshtën me nxierrë para gjyqit ushtarak major Spiro Mosiun, si komandant i batalionit. Në këtë mbledhje, ishte ngrit im atë, i cili kishte folë shprehimisht :

- Në qoftë se do të bahet ndonjë gjyq i tillë, gjyq, në të do të përfshihet e gjithë komanda shqiptare bashkë me të !

Para këtij qëndrimi, komanda italiane u tërhoq, duke pasë frikë mos shkaktohësih trazime të tjera. Ata e dinin mirë se influenca dhe autoriteti i Prenk Pervizit mbi ushtrinë shqiptare si dhe në mbarë vendin ishte mjaft e madhe. Kështu që e mbyllën atë punë dhe vendosën heqjen e ushtrisë shqiptare nga fronti. Babën e izoluen në malet e Pukës me një pjesë të shtabit shtabin e tij dhe të ushtrisë. Batalionin "Tomorri" e caktuen në Laç të Kurbinit, jo larg prej shpisë sonë, në një fushe afër kishës së Shën Mëhillit. Gjithë sa u tha ma sipër na e treghonte vetë major Moisiu që frekuentonte gati çdo ditë shpinë tonë, dhe nga protagonistët e tjerë, duke fillue nga ushtarët, e deri tek oficerët që kishin qenë të përfshimë në atë ngjarje. Patjetër dëshminë e rreshterit trim Nikoll Pali që shpëtoi shokun e plagosun. Kapiteni Preng Mark Perzefi dhe shoferi Kol Prela, na tregonin se si i shpetuen atij

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

aksioni tepër të guximshëm e të rrezikshëm që kishin përballue, dhe për çaste e fundit kur u ndanë nga ato bij të rrebtë të Mirditës, qe nuk e kishni vdekjën në hesap, për nderin e familjljëve dhe të Mirditës. Se si kapiten Frrok Doda ishte takue burrnisht me Prenk Pervizin dhe burrnisht ishte nda e përfalë me të. Çaste sublime të krenarisë e shpirtit të sakrificës për traditat e virtytet burrnore të shqiptarve. Çaste dramatike të paharrueshme. Por mbi të gjitha permendej se si im atë ishte shprehun në komandën italiane, para vete gjeneralit Soddu dhe generalëve e kolonelëve të tjerë kur u kishte than, Ushtria shqiptare nuk bahen mish për top !

Disfata në frontin grek shkaktoi termet në sferat e nalta te qeverisë italiane. Mareshalli i famshëm Badoljo u shkarkue nga detyra. Ai ishte justifikue para Qeverise fashiste dhe Musolinit se disfata e frontit grek ishte shkaktue nga tradhëtia e ushtrisë shqiptare. Nga ana tjetër Hitleri ishte nervozue e i kishte kërkue shpjegim kolegut të tij italian, Duçes. Ky i ishte përgjigje me të njejtin justifikim të tradhëtisë së ushtrisë shqiptare. Në vend të Badoljos, i shkarkuem nga detyra, ishte emnue gjenerali Ugo Cavallero. Unë asokohë vazhdoja shkollën në Romë, dhe profesori i latinishtës, Mançini, kishte qenë në frontin grek i mobilizuem si oficer rezervist. Ai më kishte me sy të mirë nga fakti se në landën e tij të latinishtës isha i shkelqyeshëm. Ai kishte marrë një leje e kishte ardhë me na vizitue, dhe kur më pa nuk tregoi perzemersi, u mpi në fytyre dhe nuk iu ndejt pa folë.

- Ah, ti Pervizi ? E kam njohun babën tand, e duke u kthye nga nxanësit e tjerë shtoi, ushtria shqiptare na tradhëtoi në frontin grek.

Mbeta haru. Por a don ti që gjithë klasa sa ishin mbajtën heshtje dhe ulën sytë, dhe profesor Mançini mbeti keq e u largue. Ishte një solidaritet nga ana e shokëve të bankove qe me bani përshtypje dhe me mbeti në kuijtesë tanë jetën. Si duket fëmijët i kuptojnë ma drejt disa sjellje të të rriturve dhe qendrojnë solidarë me shokët e tyne.

Kur u ktheva në Shqipni i mora vesh të gjitha, siç tregova ma sipër nga vetë pjesmarrësit në atë ngjarje, duke fillue nga ushtarët e thjeshtë, kushrini im, rrështer Nikoll Pali, shoferi Kol Prela, kapiteni Prenk Mark Perzefi, oficerë të tjerë, si Dod Bardhoku, Mark Arapi, nga vetë Major Spiro Moisiu, dhe sigurisht dhe nga prindi im. Prandaj rrefimit të mësipërm nuk mund t'i hiqet asnjë presje, veçse të shtohet. Ajo ngjarje e kundërvenjës së ushtrisë shqiptare, duhet kuptue si një akt kryengritës i parë kundër pushtuesit. Ajo duhet të përfshihet në historinë shqiptare, që deri me sot nuk i ka kushtue asnjë rresht, ose në qoftë se e përmend, e ka hequn emnin e Prenk Pervizit, sepse ato historianë që shkruenin historinë shqiptare, ishin vegla të regjimit komunist, që historinë kishte vendosë ta bante sipas qejfit e tekjes se diktatorit, duke e sakatue nga fillimi deri në fund. Në të famshmim "Fjalor

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Enciklopedik 1985" të Akademisë së Shkencave, kundërshtimi i ushtrisë shqiptare në luftën italo-greke i veshët Spiro Mosiut, ku emni i Prenk Pervizit nuk permendet. Kjo asht fare e qartë për t'u kuptue. Spiro Moisiu gjeneral i regjimit komunist, nuk kishte se si, dhe nuk ia mbante as guxonte me tregue të vërtetën e me thanë se ai në atë front ishte major i merrte urdhnat nga komandanti i tij, kolonel Prenk Pervizi, e si gjithë ngjarja e sipërtregueme kishte ndodhë në marrëveshje e sipas udhëzimit e i urdhnit të tij.

A e përmendi kush këtë ngjarje ? Shqiptar jo. Por patjetër se dikujt i kishte ra në vesh, dhe ky dikush ishte kapiteni anglez, Julian Amery (ma vonë Lord Amery), i cili shprehimisht shkruen në librin e tij anglisht, botue në Londër më 1946 : "Sons of the Eagle", faqe 304 :

"Italianët i kishin dhanë (Prenk Pervizit) një komandë gjatë luftës italo-greke, por duke dyshue se ai kishte ra në marrëveshje me anmikun, e kishi transferue në Shkodër...Ai u përpoq dy vjetët e fundi (1942-43) të krijoje nje organizatë me oficerët shqiptarë....duke u terhequn me mbeshtetësit kryesor në krahinën e tij të Kurbinit.

Pra kjo tregon se kundërvenja e ushtrisë shqiptare nën komandën e kolonelit Prenk Pervizi përfolej kudo, jo vetëm nga shqiptarët, por i kishin dhanë randësi edhe të huejt. Mjafton të shikosh Wikipedia në disa gjihe, deri dhe kineze. Nga ana italiane, mbahej heshtje, që u thye nga një historian ushtarak italian P. S. Monari. Por mund të ketë dhe të tjerë që kanë shkrue për atë ngjarje.

Nga e gjithë sa u tha, del fare qartë se im atë, Gjeneral Prenk Pervizi, ishte i vetmi ushtarak i lartë që iu kudërvue pushtuesit duke mos pranue me luftue krah ushtrisë italiane, jo vetëm kundër popullit të vet por edhe ndaj fqinjëve, për deri sa nuk ishin në konflikt direkt, sepse ajo luftë ishte sajue e shpallun nga Italia fashiste që donin ta përdornin ushtrinë shqiptare si mish për top në mbrojtje të disfatës tyne të turpshme. Im atë nuk nguroj aspak dhe urdhnoi braktisjen e frontit nga trupat shqiptare, duke marrë parasysh edhe masat drastike që mund të pësonte. Por italianët nuk guxuen ta provokonin sepse asokohë influeca e tij ishte shumë e madh në popull e sidomos në ushtri. Kuptohej se Mbreti Zog nuk e kishte kthye kot në Shqipni, dhe këtë pala italiane e dinte mirë. Atë që nuk e bani Zogu për me lshue kushtrimin e luftës

---

*-- Ndërhyrja ime herë pas herë, vlen për të përforcue gjithë përmbajtjën e rrëfimëve të tim etit, Prenk Pervizit, që lidhen edhe me dëshminë time, i përshirë gjithë kohën në ngarjet e ndryshme, jo vetëm si bir i tij, por edhe nëpërmjet njerëzve që e shoqnonin dhe ishin nën urdhnat e tij, me të cilët familja jonë kishte lidhje gjakun e miqësie të fortë. Nuk ka dyshim që jeta e veprimtaria e tij ndiqëshin hap pas hapi duke rue në fillin e së vërtetës. Asnjë nga ngjarjet e përmeduna në këtë libër nuk i shmagët së vërtetës, pavarësisht se ndiqet një vijë tregimtare e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

lirë për ta ba leximin ma të kandshëm.
popullore në malet, mund ta bante fort mirë Prenk Pervizi. Prandaj ai u izolue në Pukë dhe ndiqej e ruhej nga SIMI në gjithë lëvizjet e kontakte që bante. Këto rrethana nuk janë evidencue prej askujt, qoftë ushtarak, apo historian e shkrimtar shqiptar sepse edhe koha punoi kundër me marrjën e pushtetit nga ana e komunistëve dhe vebndosjës së diktaturës totalitare me terror e mizori të papame ndonjëherë nga shqiptarët. Ku s'guxonte kush të përmendte emnin dhe veprat e Prenk Pervizit.

Lidhun me ngjarjet që treguem të frontit grek jemi të detyruem me paraqit se ç'kanë shkrue vetë italianët e të huejt për të përgenjështrue me fa kte trillimet e fallsifikimet e historianëve komunistë. Ja si e ka paraqitë atë ngjarje historiani ushtarak Pietri Sebastiano Monari, në librin : L'Italia nella seconda guerra mondiale – Guerra di Grecia, Roma 2004.

Ruolo albanese

(Roli shqiptar).

Mbi luftën e Greqisë evitohët të flitet për forcat shqiptare që ishin përfshi në atë konflikt : disa bataljone të bashkuem në Divizionët « Venezia » e « Julia ». Një bataljon i milicisë merçenar shqiptare u sakrifikua e masakrua nga grekët në përparim, nga komanda italiane për të mbrojtur tërheqjën e tyre. Megjithese nuk i përkiste ushtrisë efektive shqiptare, komanda shqiptare e përfaqësuar nga koloneli Prenk Pervizi protestoi energjikisht për këtë përdorim të shqiptarve si « mish për top ». Komanda italiane vendosi që bataljoni efektiv « Tomorri » të mbronte terheqjën e tyre, si në rastin e parë. Koloneli Pervizi bashkë me majorin Spiro Moisu dhe oficerët e tjerë dakorduan që të tërhiqëshin nga fronti sapo të niste ofensiva greke dhe tërheqja e trupave italiane, me urdhër që të mos rrezikohej jeta e asnjë ushtari, duke zenë pozicione të sigurta. Faktikisht bataljoni u tërhoq pa pësuar asnjë humbje Ushtria italiane pësoi një disfatë të madhe që Marëshalli Badolio do të ia ngarkonte tradhëtisë së ushtrisë shqiptare. Në realitet disfata ndodhi si rrjedhim te nje dështimi politik, sepse disa ditë përpara të sulmit italian. Kryeministri grek Metaxaj zbuloi se disa oficerë të larte të ushtrisë si dhe funksionarë të qeverisë, ishin korruptuar nga ministri i Jashtëm italian, konti Ciano, që ushtria greke mos të ushtronte një qëndresë serioze invadimit italian. Prandaj u zevendesuan në kohë dhe u arrestuan. Ky fakt tregon pse sulmi u nis me forca të pakta nga ana e italianëve. Sidoqoftë trupat shqiptare u hoqën menjëherë nga fronti. Komanda italiane desh të qonte para gjyqit

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

ushtarak majorin Mosiun. Koloneli Pervizi që kishte inluencë të madhe e respekt si në ushtri ashtu në popull, e kundërshtoi : Ai gjyq duhej të përfhsinte gjithë komandën shqiptare bashkë me të. Italianët s'morën asnjë masë, nga frika mos ndodhnin incidente. Kolonel Pervizi me shtabin e oficeröve dhe një pjesë së trupave u izolua në malet e Pukës (Veri i Shqipërisë). Majori Moisiu me batalionin e tij u transferua në Laç (Shqpëria e mesme).



LUFTA ITALO-GREKE 1940-1941

Në hartë tregohet faza e kundër-ofensivës së ushtrisë greke, kur ne frontin e Korçës ushtria shqiptare e braktisi frontin e luftës me urdhn të Prenk Pervizit, ku grekët arritën të pushtojnë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

qytetin e Korçës, një disfatë e madhe për ushtrinë italiane. Musolini i zevendësoi disa gjeneralë, deri sa shkarkoi edhe Ministrin e Luftës, Marëshallin e famshëm Pietro Badoljo

Dy të rij trima e besnikë, heroj të vërtetë



NIKOLL PAL GJINI
Nip i Prenk Pervizit
nga Skuraj i Kurbinit, rreshteri trim
që shpetoi shokun e plagosun kur u
braktis frontit italo-grek.



LLAZI STERJO
Shoferi besnik e trim korçar
që përcolli Gjeneralin në kufi
kur ai u arratis në Greqi më 1946.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

---

*--Ne frontin grek, siç e kemi shpjegue, shoferi ishte shkodran Kol Preka. Pas lirimit tij nga ushtria, u ba shofer korçari Llazi Sterjo që u tregue besnik e guximtar duke e pereciellë Prenk Pervizin deri ne kufi, ku Gjenerali kaloi në Greqi. Për këte gjest heroik si në burg ashtu dhe ne jeten e lire ai gexoi respektin e simpatine e njerezve te veçanerisht te qytetit te Korçes.

Gjeneralet italianë në luftën italo - greke





Gjeneralët Visconti Praska e Ubaldo Soddu
të cilëve Prenk Pervizi ua tha në fytyrë se « Ushtria shqiptare nuk bahet mish për top »
dhe u dha urdhër trupave shqiptare të braktisin frontin e luftës.





Marëshall Pietro BADOLJO Gjen. Ugo KAVALLERO(2)

Mareshalli Badoljo ia ngarkoi "tradhëtisë së ushtyrisë shqiptare" dështatën në frontin grek
dhe u shkarkua nga detyra e në vend të tij u emrua gjenerali Ugo Kavallero

---

*--Me gjithë sa u tha për rolin e ushtrisë shqiptare ne luftën italo-greke i përgjigjet së vërtetës absoluteb pa i hequn një presje,, për të hedhun poshtë dëshmimet dhe fallsifikimet e paturpëshme rreth braktisjës së frontit nga ushtria shqiptare, ngjeshur tietë kujt, nga Akademia e Shkencave dhe historianët e saj komuniste që mbajnë përgjegjesi te randë për dëformimin e papërgjegjëshëm të historisë shqiptare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Disa shtjellime nën pushtim

Jemi të detyruem me u kthye pak mbrapa. Kur erdhi nëndori i po atij viti 1939, shqiptarët shpërthyen në demostrata të mëdha për heqjen e shpatave të liktorit nga flamuri. Edhe vetë kryeminisrtri Mustafa Kruja (ishte largue Verlaci) ishte shprehë për heqjen e tyne, sepse flamuri shqiptar ishte një flamur historik e kombëtar qyshë nga koha e Gjergj Kastriotit Skënderbeut e shqiptarët nuk e pranonin një dhunim të tillë të flamurit me shënja të hueja. Jo që flamuri shqiptar ishte një nga flamurët ma të vjetër të Evropës, i pandryshuem prej kohës se principatës së Kastriotëve. Me këtë rast u zhvilluen demostrata të mëdha nga rinia studentore e Tiranes e të tjera qytete. Italianët u detyruen t'i heqin simbolet e tyne fashiste. Nga ana tjetër në uniformat e ushtrisë shqiptare qendronte përkrenarja e Skënderbeut, që italianët nuk kishin guxue ta heqin. Simboli i liktorit mbeti veç për milcinë fashiste. Si në të gjithë rastet e tjera të pushtimeve të hueja, kishte nga ato individë që i servilohëshin zaptuesit, deri në mohimin e traditave historike kombëtare. Kjo ndodhi edhe në Shqipni, ku pati njerëz që u lidhen me Italinë për vdekje, musulmanë e të krishtenë pa dallim. Kështu u krijue një klimë kundërshtuese midis nacionalistëve që kërkonin të mbanin të pacenuem identitetin kombëtar, dhe atyne që perqafonin fashizmin për interesat meskine të tyne, me pozita e privilegje dhe përfitime ekonomike. Në këtë orvatje për ta paraqitë Shqipninë si një pjesë të pandame të Perandorisë italiane, u krijue garda mbretnore me shqiptarë me kostume tradicionale, toskë e gegë, siç ishte dhe garda libiane, etiopike, eritrease, etj. Garda shqiptare, që qëndronte në Romë, kryente shërbimin e rojës së nderit pranë pallatit mbretnor Kuirinale dhe merrte pjesë në të gjithë festat e mëdha, ku parakalonte dhe ngjallte entuziazmin e spektatorëve me ato kostume të bukura. U organizuen pushimet verore te nxanësve të shkollave shqiptare, me uniformë balilash në plazhet italiane. U krjuen forcat merçenare të milicisë fashiste shqiptare, që varej drejpërsëdrejti prej Ministrisë së Fashizmit, që do të vepronte përkrah ushtrisë e karabinierisë italiane. Kjo në kundërvenje ndaj ushtrisë efektive shqiptare, që italianët nuk e prishën dhe e mbanin formalisht vetëm nga zori për të shmangë trazime të mudshme. Prenk Pervizi ruhej e ndiqej në çdo veprim e lëvizje të tij nga sigurimi i fshehtë italian SIM. Ashtu edhe figura e përsonalitete të tjera ushtarake e civile që quhëshin zogistë e nacionalistë. Pas do kohë Pariani u zevendësue nga Jakomoni, dhe në vend të Gjenralit Guzzoni, si kryekomandant i ushtrisë italiane në Shqipni u caktue Gjenerali Dalmazzo. Im atë, asokohë kolonel, mbahej në dispozicion pa një detyrë komanduese. U përfshi papritun në luftën italo-greke, ku siç e shpjeguem mbajti një qëndrim kundërvenës se bashku me kuadrot e tjerë dhe ushtrinë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLEZI"
SHKODËR (2018)

shqiptare, për të cilin qëndrim dhamë shpjegime të mjafta e sa ma të sakta. Të gjithë këto ngjarje ne vllaznit, e gjithë studentët e tjerë shqiptarë, i ndiqnim dhe i merrnim vesh gjatë pushimeve tona verore, që i kalonim gjithmonë në Shqipni.

Ardhja e Mbretit të Italisë në Shqipni, kaloi në faza tragjike pas atentatit që iu ba midis Tiranës kur po kthehej nga vizita e tij në Shkodër, nga i riu Vasil Laçi. Ky i ri ishte punësue si shërbëtor pranë avokatit Ali Erebara. Aliu, kur ishim të izoluem e të burgosun në Kuç të Kurveleshit na kishte tregue se si Vasili dukej një djalosh i qetë, por që ne fakt kishte do sjellje të çuditshme, pothuej misterioze. Rrinte gjithmonë i vetmuem. Aliu na kishte tregue se si ai e fliste greqishtën. Do të kishte vu dorën në zjarr për ndonjë rrezikshmëni të tij. Dhe kur avokati mori vesh se shebëtori tij kishte gjuejt mbi Mbretin e Italisë, kishte mbetë fort i çuditun, e nuk do të ia kishte marrë mendja kurrë që ai të ishte i zoti për atë akt të tillë trimnor e vetmohues.

Unë me vëllanë Genc ishim në Bari, duke prit me u kthye për në atdhé për pushimet shkollore, ku dalluem alarmin e madh që po bahej në portin, ku vinin e shkonin anije luftarake. Dikush na tha se Mbreti Viktor ishte plagos në një atentat që i ishte ba me revolver. Pastaj kur arritëm në Shqipni i morëm vesh rrethanat se si ndodhi ngjarja. Po në Shqipni çpo ndodhte vallë që filluen të ndërrohen qeveritë njena pas tjerës, pas dorëheqjes së qeverisë së Mustafa Krujës ? U krijuen disa qeveri me Maliq Bushatin dhe pastaj me Eqrelm Libohovën. Gjëndja po shkonte drejt një çthurje politike që tregonte moskënaqësinë e popullit ndaj pushtuesve italianë, të cilët kërkonin me arnue thesin që kishte fillue me u shqerrë. Ndërsa për Mustafa Krujën, që çmohej si një intelektual i naltë dhe me veti patriotike, nuk pritej prej tij që të lidhej aq fort pas qerrës së Italisë fashiste. Pavarësisht se në disa raste ndërmori veprime positive siç ishte hapja e 200 shkollave shqipe në Kosovë dhe mbrojtja e qifutëve. Por nuk i falej veshja e këmishës zezë në familje e rrethin e tij. Sidoqoftë hisroria do të dije me ia caktue vendin e meriotueshëm në faqet e saj. Me tim etin ai ka pasë miqësi të vjetër si kruetanë aq ma tepër kur ishte ministër i brendshëm për do kohë, dhe nga fakti se me të dy me kulturë gjermane. Theksojmë se gjatë kohës pushtimit mes tim etit dhe shqiptarve që kishin përqafue fashizmin u krijue një hendek, ku ata kërkonin ta distanconin dhe manjanonin figurën e tij, një lloj lufte klasore ala fashiste, ku ata që konsiderohëshin si zogistë luftohëshin haptasi në çdo rast.

Pas luftës italo-greke, pjesa jugore e Shqipnisë ishte mbush me armë e municione të ndërluftuesve, dhe popullsia ishte armatosë. Si rrjedhim u krijuen disa grupe ose çeta të vogla, të cilat filluen të sulmojnë kolonat italiane. Këto grupe i perkisin Ballit Kombëtar dhe zogistëve. Njena nga këto çeta komandohej nga akademisti Asim Zeneli, shok i ngushtë i vellait tim Valentin. Në nji nga pritat që iu bane ushtrisë italiane, Asimi mbeti i vra. Ishte fillimi i asaj që u quejt luftë nacional çlirimtare e nisun nga nacionalistët

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

që u indentifikuen në Ballin Kombëtar, në një kohë kur komunistët kishin udhëzim që të mos vepronin kundër fashizmit italian e nazismit gjerman, sipas paktit gjermano-sovietik (1939-1941) ose Molotof-Ribentrop që zgjati deri kur Gjermania e sulmoi Bashkimin Sovjetik më qërshor 1941.

Ma vonë regjimi komunist do ta shpallte hero të vetin, ndërsa Asim Zeneli vinte nga një familje patriote dhe zogiste e nuk ishte fare komunist. Asimi, siç e permendëm, ishte shok i ngushtë i vëllajt tim Valentin nga shkolla ushtarake e Romës dhe Akademia e Modenas. Prandaj ne e dinim mirë se ai i përkiste krahut nacionalist të zogistëve. Lene pastaj që ai kishte një admirim të veçantë për prindin tonë, si ushtaraku ma i naltë e i aftë i ushtrisë shqiptare. Partia Komuniste Shqiptare të gjithë heronjt nacionalistë e zogistë që u vranë në fillim, që nga 7 prilli e pas, nga Mujo Ulqinaku deri te Asilm Zeneli e me radhë të tjerë, ua qëndisi biografinë si komunistë të orës së parë e dëshmorë të saj, pavarësisht se ishin shpallë heronj të Kombit, të cilin nder e meritonin. Por historia e Shqipnisë u shkrue krejt anapolla nga historianë e akademikët e diktaturës dhe gjithë mëritën e luftës dhe të rezistencës kundër pushtuesit e mori përsipër, me urdhën të peshkut, partia komuniste e udhëhequn dhe e organizueme nga agjentët e këshilltarët jugosllavë e sovietikë. Fakt, krijimi i ngutshëm i Partisë Komuniste Shqiptare me 8 nëndor 1941, me mbështetjën e agjentëve jugosllavë, Miladin Popoviç e Dushan Mugosha dhe të Vukmanoviç Tempos (në hije), me bekimin e Stalinit e të Titos, ku sekretar i dytë i saj u zgjodh Enver Hoxha, sepse i pari ishte Marëshalli Tito, në kuptimin që partia komuniste shqiptare ishte ne varesi, degë e asaj Jugosllave. Asht po fakt, se kur erdhi puna për të zgjedhë një njeri të përshtashëm si sekretar, Miladini shfaqi mendimin qe duhej t'ishte një njeri i pashëm, sepse edhe pamja lozte rol për afrimin e simpatinë e njerëzve. Nje nga të pranishmit tha se e kishin një komunist të tillë, që nuk ishte aty, Enver Hoxhën, që punonte në librarinë Flora. Menjëherë çuen dhe e morën dhe fap, Enveri u zgjodh. Kjo e gjitha për ata që duen të dijnë të vërtetën. Ata që nuk ishin fort dakord, dhe mund t'i prishnin punë, si Qemal Stafa e Vasil Shanto u zhdukën në mënyrën ma djallëzore. Ekziston diku dokumenti se ishte pikërisht Enver Hoxha, agjent sekret i SIMIT italian që dha informatën (spiunoi) se ku gjëndej Qemal Stafa atë natë të 5 majit 1942, sepse ai, pasi kishte bisedue me Qemalin deri vonë, ishte i vetmi që e dinte se ku do të flinte Qemali atë natë. Kurse edhe për Vasil Shanton, thuhej se ishte Enver Hoxha me spiunët e tij, që e kishte çue informatën e ditës dhe itinerarin e udhëtimit për me kalue në Malin e Zi. Prandaj çeshtja e rezistencës së shqiptarve ndaj pushtuesve të huej, nuk mund të tregohet me gënjeshtra e fallsifikime, siç u vepru nga regjimi e partia komuniste, që duke mendue se do të sundonin përgjithmonë, e manipuluen historinë për lavdinë e tyne të palavdishme. Nuk ka dyshim e dihet prej të gjithëve se Enver Hoxha jetonte për kukuri midis Tiranës në librarinë Flora, nën patronazhin, ndihmën e mbrojtjën e kunatit Bahri Omari.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Nuk kishte as një shqetësim as e kërkonte as e ndiqte kush, siç prallisin historianët e regjun komunistë, për t'ia zbukurue biografinë. Zoti Agim Karagjozi, kyetar i Vatrës në SHBA, ruente një fotografi të marrë midis Tiranës më verën 1942, me disa shokë, ku spikaste në mes Enver Hoxha. Një provë i jetës normale e pa trazime që ky far komunisti kalonte në Tiranë në kohën e pushtimit. Asht krejtësish e mundshme që ai të ishte i rekrutuem nga SIMI italian, me një pseudonim sekret, që dikush ma pat diftue por që me ka ikun nga mendja, sado që lodhëm me e kujtue.



Tirana më 1936 – pallatet qeveritare para se të kryhej sheshi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Joshjet e Komunistëve

E kemi tregue se si partia komuniste u krijue po në atë shpi ku kishim banue ne si familje deri me 1935. Një koincidencë e çuditshme. Por më 1941 im atë kishte zanë një shpi me qëra krejt ne veti në kodrën e Fuad Beut, me sallon e katër dhoma. Një banesë provizore tiranase, që ai e kishte zgjedhë kastile t'izolueme, sepse perreth saj nuk kishte banesa të tjera, veç një fushë që qonte deri te rruga kryesore. Do të thotë lexuesi si Prenk Pervizi nuk paskej ndertue një vilë si disa kolegë e miq të tij ? Në kishim tre troje prej nga një dynym, një në kodrën e Fuad Beut e tjetrën në Tiranë e re afër stadiumit dhe një parcelë prej 1100 m² në zonën e Bllokut, ku ndërtonte Xhenio italiane, ku im atë kishte derdh një kist të parë për ndërtimin të një banese, përtej universitetit, në rrugën Vaso Pasha, 19. Ndërsa për truellin, afër Pallatit të Kongresëve, italianët i kishin propozue të ndërtonin një kompleks apartamentësh, që ata do të shrytëzonin për pesë vjet e pasataj mbetëshin pronë e jona. Njëkohësisht i kishin ofrue 10.000 napolona ari për blerjën e terrenit. Im at nuk kishte pranue asnjënen nga ofertat. Në kushte e pushtimit ai nuk donte të kishte allisherishe perfitimi me italianët. Të merret vesh mire ! Por të kthehëmi aty ku e lamë. Poshtë kësaj rruge shtrihej një pjesë toke djerre e rrethueme me tel, prej një dynymi, që ishte pronë e jona. Ngjit me të ishte dhe një parcelë e kolonel Hysni Demës, që vinte me u takue herë pas here me t'im
atin. Ishte viti 1942. Im atë, tashma gjeneral, që e kishin hequn nga Puka, mbahej në dispozicion, pa detyrë të caktueme. Mama qendronte vazhdimisht aty, ne të tjerët vininm e shkonim. Me ne rrinn dy ushtarë mirditorë si ordinanca e roje. Makinën, Fiat 1100 e kishim në dispozicion, me shofer, rreshterin Llazi Sterjo, nga Korça. Nje djalë i ri shumë i dashtun. Ishte ai Llazi që ma vonë do të përfshihej në një aksion të guximshëm që do ta kryente me nder. Genci që duhej të jepte nje provim, merrte mësime matematike nga Prof. shkodran Anton Deda.

Nga mama morëm vesh se babës i kishin ardhë disa thirrje me shkrim nga ana e komunistëve, që të bashkohej me lëvizjen N.Ç.L., ku vlerësohej si një oficer i naltë e patriot, që duhej te bashkohej me atë lëvizje në luftën kundër okupatorit, ku aftësitë e tij ushtarake do të ishin shumë të dobishme për suksesin e luftës, e ku do të vlerësohej e nderohej me gradat ma të nalta. Im atë nuk ishte denjue me iu pergjigj fare atyne thirrjëve. Ai i konsideronte komunistët të lidhun pas politikës sllavo-sovjetike e veçanërisht pas Jugosllavisë, që i drejtonte dhe organizonte me agjentët e këshilltarët e saj. Ma vonë, pas atij që u quejt çlirim, unë pata rastin të takoj dy ish partizanë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

komunistë, që ma vonë u banë me pozita, të cilët e njihnin babën mirë, sepse kishin shërbye me të, që kur ishte në Korçë. Ata kur e morën vesh se kush isha, nuk treguen ndonjë urrejtje ndaj meje, por në të kundërtën, me thanë, se si im atë konsiderohej prej komunistëve si një ushtarak i shquem, njeri pozitiv e patriot (sipas tyne). Kur ai u ishte kundërvue gjermanëve e nuk kishe lejue që të krijohëshin forca SS në Shqipni, kishin shpresue se do të bashkohej me Nacional-çlirimtarën. Nga sa thamë, kuptohet se im at ishte i përfshimë në vemendjën e planet e komunistëve, por qëndronte i patundun e konseguent qenjës tij si patriot i ndershëm, siç e kishte tregue gjatë gjithë jetës. Ai priste, si edhe kolegët e patrotët e tjerë, që gjëndja të ndryshonte në favor të kauzës shqiptare për t'u shkëput nga pushtimi italian. Ndërkohë komunistët vinin e shkonin në atë zonë kodrinore ku niste pjesa jashtë Tiranës, dhe ku ishin disa kazerma italiane, që komunistët u kishin vu synin me i sulmue, por që asnjherë nuk ua mbajti me e ndërmarrë atë punë. Në qytet kishin fillue atentatët e para. U muer vesh se ishte vra Nok Gjeloshin. Prej komunistëve apo zogistëve ? Komunistët e morën përsipër për vete, se kishin vra një oficer fashist e tradhëtar. Zogiste gjithashtu se kishin marrë hak për atentatin që ai i bani Zogut në Vjenë. Kjo ngjarje nuk asht sqarue akoma edhe sot.

Siç thamë, Genci vazhdonte disa mesime private për landën e matmatikës, ku ishte pak i dobët, me Prof. Anton Dedën dhe ndodhi që profesori mungoi disa ditë. Kur manëfund erdhi, duke kërkue ndjesë për mungesën, tregoi se si atë ditë e çast që u vra Nok Gjeloshi, ai ishte duke shetitë krah për krah me të, në bulevardin e madh. Po kalonin para kishës katolike, qift me Nokën, me dy gratë e tyne disa hapa ma përpara, kur ja, përball Nokës se nga mbin një djalosh, flokë karré, i cili i dorëzon një biletë dhe duke thirrë, n'emen të popullit je denue me vdekje, ia shpraz në gjoks revolverin që mbante në dorë, dhe sa hap e mbyll sytë u zhduk në një rrugicë aty afër. Xhurulldi e madhe. Gratë duke britun e qa. Policë, karabinierë e milicë duke ardhë vërdallë, për me ndjek vrasësin që ishte zhduk pa lanë gjurmë. Thonë se ishte një far Vojo Kushi, që komunistët do ta shpallnin ma vonë si Hero. Por nuk dihet me siguri se kush ishte ai atentator.

E kisha fjalën se në atë banesë të izolueme, jashtë qytetit, prindi im nuk trazohej dhe nuk e çante hiq kokën. Pra komunsitët ndiqnin disa kritere te tyne, dhe versulëshin me atentat ndaj disa njerëzve që ishin përzi thelle me fashimin, duke veshun rrobat e tyne, siç ndodhi me Nok Gjeloshin, me uniformë të nënkolonelit fashist. Kur kapitulloi Italia, ata i banë atentat edhe Mustafa Krujës, por vetëm e plagosën lehtë, dhe s'rrjedhin e mori në mbrojtje Kapidan Gjoni, në Shkodër. Donin të vrisnin edhe Kol Bib Mirakën, ish Ministrin e sekretarin e partisë fashiste, por ky ruhej prej besnikëv të tij. I përmenda disa ngjarje jashtë kronologjisë, por që lidhen me ndjekjën e tregimit.

Gjatë ky qëndrimi në Tiranë, im atë takohej herëpashere me miq e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kolegë . Unë vetë kam qenë i pranishëm në disa takime miqsore, ku ai me merrte për qejf e ndoshta për të zbutë dyshimin , se mos ai merrej me qellime të caktueme. Kështu me ra rasti me kalue ndonjë darkë, ku ai kishte ftue miqt e vjetër, Fiqri Dinën e Hysni Demën, që banonin në Tiranë. Në këto takime vinte civil, prej miqve, të cilët nuk ishin angazhue në ushtri. Zakonisht në kafe-restorantin Bristol. Megjithëse nji kalama 13-14 vjeç, unë i ndiqnja bisedat që banin. Ata trajtonin gjendjen e luftës dhe situatën e vendit nën pushtimin italian. Im atë u tregonte për përcielljën e Mbretit Zog në Greqi e pastaj për ngjarjen e frontit grek. Përmendëshin aty emnat e Zogut, Mehdi Frashërit, Muharrem Bajraktarit, Llesh Marashit, Abas Kupit, Mitat Frashërit, Ballit Kombetar, zogistëve e komunistëve. Kush do t'ishte ky Enver Hoxha që përmendej si udhëheqës komunist. E mbaj mend kur Fiqri Dine i tha se ti Preng do ta keshë njohun në Korçë. Im atë shpjegonte se po, e kish njohun. Ai jepte mësim në Liceun Frances, dhe merrte pjesë në shoqninë korçare. Por nuk kishte dëgjue se ai t'ishte komunist. Ishte një i ri i pashëm, dhe gëzonte simpatinë e femnave. Ai sillej mirë e me respekt ndaj meje, u thoshte im atë miqve, dhe i kishte ndodhë me folë frëngjisht me të, në klubin ku mblidhëshim me pi kafe, ku ai vinte me Abaz Ermenin e profesorët francezë. Po jo që të kishte dyshue ose ta kishin informue se ishte komunist. Prandaj çuditej se si ai djalë i një familje të mirë Gjinokastrite dhe i trajtuem mirë nga qeveria, dhe nga vetë Mbreti Zog, të ishte ba komunist e të kishte arritë t'imponohej, sa të udhëhiqte partinë komuniste shqiptare. Patjetër se këtu lozte rol politika sllave, pse thonë se ajo parti ishte krijue nga disa agjentë të Jugosllavisë. Kështu pak a shumë rridhte biseda midis tyne, duke këmbye mendime të ndryshme rreth situatës. Në të tilla takime të tim etit, unë kisha rastin me dëgjue për ngjarje të ndryshme të shqyrtueme e komentueme prej atyne burrave që dikur kishin pasë në dorë fatet e Shqipnisë. Më pat ba përshtypje një gjykim i Fiqri Dinës, për ikjen e Zogut me 7 prill 1939. Ishte i vetmi veprim që Mbreti nuk duhet të kishte ba, thoshte ai, dhe ne nuk do ta kishim lejue, po të kishm qenë pranë tij. Ti Prenk i ke dalë borxhit kur je takue me të në Zemblak, duke i ba thirrje për kushtrim. Sa pare ban. C'do gja kishte marrë fund. Do të kishte qenë ma mirë të ia kishe imponue qëndrimin në Shqipnin. Shkurt, me e detyrue që të lëshonte kushtrimin e të dilte në mal, disa ditë. Gjithë populli do ishte çue në kambë. Neve si përfaqësues të ushtrisë shqiptare, na vjen shumë randë që u mbajtëm anash e nuk u informuem për asgja paraprakisht. Në asnjë mënyr nuk do të kishim lejue me shkue punët ashtu si shkuen. Hysni Dema, nga ana tij, aprovonte në heshtje, ngrysun e i mërzitun për sa kishte ndodhë. Mirë thotë Fiqriu or Prenk, ta kishe detyrue Mbretin me dalë në mal. Im atë ishte përgjigjë që nuk munt ta bante në asnjë mënyrë atë punë, sepse do i ngakohej si prej ne besë. Miqt i kishin dhanë të drejtë. Hysniu kishte shpreh mendimin se ndoshta Mbreti do ta çonte një mesazh sikur kishte premtue. Po kur ? Gjëndja po bahej e volitshme me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

veprue, por duhej një mbështetje. Pa mbështeje nuk bahet gja. Nuk pat thanë kot Arkimedi, me jepni një mbeshtëtje që ta ngrej tokën ! Aty mungonte vetëm Muharrem Bajraktari që të plotësohej katërshja e famshme e atyne katër kapidanave që mbështetën fuqimisht Zogun, i cili në ditën ma të zezë të tij e të Atdheut nuk i pati pranë e nuk u besoj mbrotjën e vendit, që ata do të kishin realizue ma së miri për nderin e Shqipnisë e të shqiptarve. Të gjithë justifikimet për largimin ose ikjën e Mbretit Zog, bien poshtë. Me gjuthë përpejkjet e disave për ta shfajsue. Zogu vetë, s'e ka trajtue kurrë atë çeshtje e s'ka lëshue asnjë deklaratë justifikuese. Të merret vesh mirë se ai s'ka lanë kujtime as me shkrim as me gojë, siç kërkojnë të trillojnë tashti pas 78 vjet të 7 prillit 1939.

Kapitullimi i Italisë

Situata e Luftës së Dytë botnore kishte arritë kulmin e saj, me gjermanët që kishin sosë në portat e Moskës dhe kërkonin ta rrethonin për sulmin final. Aviacioni rus nuk ekzistonte fare. Po ashtu mjetet e blindueme. Rusët mbrohëshin me forcën shumë ma të madhe njerëzore e me trimni të pashoqe. Stalini kishte hedhë në betejë me qindramijë ushtarë, të cilëve u kishe vu mbrapa trupâ speciale, që t'i vrisnin të gjithë ata që desërtonin frontin nga frika. Nuk mjaftonin masakrat që gjermanët banin mbi ta, por duhej edhe kasaphana nga ana e fanatikëve stalinistë. Shpirti xhelat i këtij soj njeriu nuk ndalej para asnjë krimi. Një front tjeter kryesor ishte ai i Leningradit (Petroburgut). Qytet që u kishte ba qendrese te vendosun gjermanevet, qe nuk arriten kurre qe ta pushtojnë, megjithë rrethimin e madh qe nga fillimi i luftës e deri ne fund të saj. Flitej se Hitleri kishte dhanë urdhën që ky qytet historik me pallate e monumente madhështore, të mos shkatërrohej. Prandaj gjermanët e kishin mbajtë të rrethuem pa ndërmarrë një sulm vendimtar, ku pasojat do t'ishin shkatërruese. S'ka dyshim se ajo qëndresë i dedikohet popullsisë së qytetit që përballuen gjendjën e urisë e s'dhanë asnjë shenjë dobësie e dëshpërimi. Nga ana tjetër qyetiti i vinin ndihma ushqimore nga deti, që gjermanët nuk arrinin të kontrollonin mirë. Ndërsa beteja vendimtare do të bahej në Stalingrad, prej ku, në rast fitoreje, gjermanët i binin Moskës, kur dihej se nga rreziku, Stalini me qeverí e bashkëpunorë ishin tërhequn në malet e Uralit. Stalingradi ishte beteja kyçe e luftës së dytë botnore. Në rast se gjermanët e thyenin frontn e Stalingradit, Moska e Rusia merrnin fund me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

gjithë Stalinin e sojsorollopët e tjerë rreth tij. Komunizmi merrte goditjën e vdekjës, e shuhej njiherë e mirë. Arësyeja e mos susksesit të ushtrisë gjermane ne Rusi ishte shpërdarja e saj në shumë fronte e vende të tjera, nga Norvegjia, Vendet e Ulta e gjithë bregu Atlantik deri ne Spanjë, kryesisht ai i Francës, ku ishin dislokue forca e mjete të shumta. Pastaj fronti ballkanik me Jugosllavinë, Greqinë dhe ishujt e detëve Egje dhe Jon, ku ishin shpërnda divizione të tjera. Ma e keqja i erdhi Gjermanisë nga Italia, që nuk ishte në gjëndje të luftonte ne frontin Afrikan të Libisë, ku Gjermania u detyrue të çojë trupa e mjete të shumta e gjeneralin ma të mirë të saj, Romel. Njëkohësisht forca të mëdha gjermane ishin edhe në Itali, nga rreziku i një zbarkimi të aleatëve aty. Prandaj, me një ushtri të tillë të shpërdame ne gjithë Evropen e deri ne Afrikë në Libi, Gjermania nuk mund t'i bante ballë fronti Rus qe edhe ai shtrihej në ma se 10 mijë km, nga Kaukazi deri në Finlandë. Ne kishim radion në Laç, dhe i ndjeknim lajmet dita ditës. Pas ngjarjës së Mukjës, ku parashijkohej fundi i pushtimit italian , ky erdhi me 8 shtator 1943 kur u shpall kapitullimi i Italisë. Gëzim e festë e madhe. Menjëherë ne vendosëm flamurët kombëtarë në dritaret. Vendasit vinin per urime. Dolën në shesh pushkët e fshehuna që u shprazëshin në shënjë gëzimi. Im atë, duke marrë me vete disa oficerë që gjeti në Tiranë, ndër ta Gjeneral Mirdashin, kolonelat Hysni Dema, Tahsim Bishqemi, e ndonjë tjetër, u paraqit në Komandën Italiane ku pati takim me Gjeneralin Dalmazzo, Kryekomandant i forcave italiane në Shqipni, të cilit i kërkoi dorëzimin e komandës. Dalmazzo pranoi dhe im atë i vuni një konditë, që të lëshonte urdhën garnizonëve e komandave lokale italiane që të dorëzohëshin pranë forcave efektive shqiptare ose pranë forcave të malit, pa dallim. Kështu duhet kuptue dorezimi masiv i ushtrisë italiane, dhe jo ashtu siç asht paraqitë nga disa njerëz të pa ndërgjegje historike, që i kanë tregue ngjarjet sipas dëshirës e qëllimeve të tyne, duke menjanue ato figura që kanë luejtë rol në ato ngjarje. Ose s'kanë ditur iose s' janë mundue të dijnë asgja për atë ngjarje. Ndër të tjera, pasi u mor në dorëzim komanda, im atë i drejtohet Gjeneralit Dalmazzo duke i thanë që të merrte me vete sa ma shumë italianë, sepse gjermanët mund te hakmerrëshin ndaj tyne, (siç ndodhi ma vonë në ishullin Cefalonia). Nga gjesti fisnik i shqiptarve, Dalmazzo e luti Prenk Pervizin që të pranonte si dhuratë e kujtim, dy kuajt e tij të bardhë. Im atë nuk e pranoi atë dhuratë, dhe kështu komanda italiane liroi lokalet. U hoq "trikolori" italian e nubi ballkonin e ndërtesës u vendos flamuri kuq e zi shqiptar. Këto janë fakte të gjalla të asaj pjesë të historisë që nuk asht shkrue, ose nuk kanë dashun e nuk duen ta shkruejnë. Aty im atë formoi menjëherë shtabin e tij me oficerët e naltë efektivë të ushtrisë shqiptare : Gjeneralët Aqif Permeti e Gustav Mirdashi, Kolonelët Tahsim Bishqemi, Sami Koka, Muharrem Liku, Hazis Blloshmi,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Daut Çarçani, etj. Kjo ishte një nismë e përkohëshme që do të sanksonohej në Asamblenë Kushtetuese të 23 shtatorit 1943, ku u zgjodh Keshilli i Naltë i Regjencës, prej kater vetësh : Mehdi Frashëri (kryetar), Anton Harapi, Lef Nosi e Fuand Dibra (anëtarë). Me vdekjën e Fuad Dibrës u emnue Caf Beg Ulqini. U krijue qeveria me Kryeministër Rexhepe Mitrovicën, ku Ministër i Mbrojtës u propozue im atë. Ai ndërhyni dhe tha se kjo detyrë i takonte Aqif Permetit, ma i vjetër në detyrë e moshë. Ky gjest fisnik u mirëprit, por pas një muej Aqif Permeti dha dorëheqje për shkaqe shëndetsore dhe me 23 tetot 1943 ai post i kaloi atij si Ministër i Mbrojtjës e Kryekomandant i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare me gradën Gjeneral Divizioni




Milicia merçenare fashiste u krtijua si kundërvenje ndaj ushtrisë shqiptare e cila nepërmjet gjeneral Prenk Pervizit, kishte shpallur se ajo nuk bashkepunonte me ushtrinë italiane kundër populli te vet. Ndërsa milicia fashiste ishte vënë në shërbim efektiv me forcat e karabinierisë italiane. Me kapitullimin e Italisë milicia u shpërbë, dhe udhëheqësit e saj u hoqën nga çdo funksion

.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Vendimi i emnimit të Prenk Pêrvizit, Komandant i Përgjithshëm i Uhstrisë Kombetar dhe Gjeneral Gustav Mirdashit Kryetar i Shtamadhorisë.



KOMITETI EKZEKUTIV I PËRKOHËSHËM

— V e n d i m —

Nr. 88 më 20 TETUER 1943

Komiteti Ekzekutiv i Përkohëshëm më mbledhjen e tij të sotshme të mbajtun nen kryesin e Z.Ibrahim Biçakçiu,Kryetar,me antare ZZ.Bedri Pejani, Xhafer Deva,Vehbi Frashëri,Mihal Zallari e Eqrem Telhaj;

Tue marrë parasysh vendimin mbi sqjidhjen e ushtrisë Kombtare nga ajo italjane,si edhe nevojën e ngutshme të ri-organizinit të Ushtrisë Kombtare ea ma parë me gjithë organet e veta,

V e n d o s i :

Revokimin e urdhënsit Nr.....datë 14.9.1943 me të cilin Z.Gjeneral Akif Permeti emnohesh Komandant i Përgjithshëm i Mbrojtjes Kombëtare dhe emnimin në vend të tij të Z.Gjeneral Prenq Previsi.-

Emnimin e Z.Gjeneral Gustav von Kyrdnes si Kryetar i Shtatmadhnorisë t'Ushtrisë Kombëtare dhe emnimin e Z.Baron von Kirchner si Inspektor i Përgjithshëm i Ushtrisë Kombëtare.-

Sekretari i Përgjithshëm:
(Nedim Kokona)

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

KRYESIA E KOMITETIT EKZEKUTIV TË PËRKOHËSHËM Tiranë,me

Nr. 490 13 TETUER 1943

1396. 15.X.43

— Q A R K O R E —

Ministris se Punve Botore

Tiranë.

Për dije e veprim ju dergohet kopja e siperm[ë]
Vendimit te Kryesis Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm.-

MINISTRIA E PUNVE BOTORE
MARRJTUN ME 25-X-1943
TE LIDH Nr. 1396/I

KRYETARI KOMITETIT EKZEKUTIV TË PËRKOHËSHËM:
(Ibrahim Biçakçiu)

Per mjetin

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Gjermanët : jemi kalimtarë

Nuk mund të vazhdojmë tregimin pa hedhun një shikim mbi situatën që ishte krijue pas kapitullimit të Italisë, që i hapi rrugën rikthimit të Shqipnisë në Lirinë e Pavarësinë e saj.

Menjëherë nga Greqia erdhën trupat gjermane nën komandën e gjeneralit Karshaniko, i cili gjeti e kontaktoi qeverinë e ish fashistëve, të cilët mendonin të vazhdonin të qeverisnin. Me kete rast gjenerali gjermani, së pari kishte kërkue të fala që kishin hy në Shqioni pa njoftue qeverinë shqiptare. Ai kishte deklarue se trupat gjermane ishin vetëm kalimtare e nuk përzihëshin në punët e shqiptarve. Ish autoritetet fashiste shprehen gatishmerinë e një bashkëpunimi me gjermanët. Por nuk vonoi dhe në Tiranë erdhi Gjenerali e Ministri Neubacher i ngarkuem për Ballkanin me qendër në Belgrad. Me ardhjen e tij qeveria fashiste u rrexua dhe u përjashtue nga politika kombëtare. U mblodh Asambleja Kushtetuese qe formoi një qeveri nacionaliste të Bashkimit Kombëtar. Vendin e gjeneralit Karshaniko e zuni Gjenerali SS Fistum, i cili përsëriti se gjermanët ishin kalimthi dhe e njihnin pavarësinë dhe neutralitetin e Shqipnisë si dhe funksionimin e pavarun të qeverisë dhe administratës së saj. Ata nuk përzihëshin në punët e Shtetit Shqiptar, dhe qellimi i tyne ishte vetëm rrugëkalimi i ushtrisë gjermane drejt veriut. Ne fakt kishte fillue tërheqja e trupave gjermane nga të gjithë frontet, pra edhe nga Greqia e Ballkani. Gjermania nuk kishte as një qëllim pushtimi të Shqipnisë. Por të kundërtën, forcimin e një shteti etnik të bashkuem me gjithë trojet e veta, si kundërvenje sllavëve të Ballkanit e kryesisht Serbisë, të cilën e kishte kthye në kufijt e saj fillestar rreth Belgradit, duke e shpërba Federatën Jugosllave.

Gjenerali Neubacher kishte deklarue gjithashtu se Gjeramia e bani Shqipninë e madhe duke ia kthye gjithë tokat, ku vetë Hitlkeri kishte dhanë porosi që Shqipërisë t'i respektohet liria, pavarësiae neutraliteti.

Këshilli i Naltë e Qeveria në fuqi, kishin pranue kete marrëveshje me fjalë, sepse me shkrim e me dokumentë nuk u nënshkrue asgja me Gjermanët. Një fakt i kësaj gjëndje neutrale ishte hapja e bisedeva telefonike me Evropën dhe me Amerikën. Nga kjo hapje im atë foli me një mik të tij ne New York, për një problem prone që e zgjidhi me vëllanë që miku kishte në Shqipni. Një aspekt tjetër ishte se gjermanët në Shqipni nuk prekën as italianët e fshehun nëpër familjet shqiptare as hebrejtë, që jetonin e punonin në Shqipni. Qeveria Shqiptare i kishin pajisun hebrejtë me dokumentë ku figuronin si shqiptare. Nga ana tjetër nuk pati asnjë denoncim ose spiunim ndaj tyne. Kurse italianët, ushtarë e oficerë, rrinin pranë familjeve shqiptare, ma tepër në veri, ku nuk ndodhi asnjë veprim ndërhymës i gjermanëve për t'i kërkue, kapë ose vra. Ndryshe nga jugu, ku italianët u detyruen të hynin në brigatat partizane, dhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

ne disa raste ata u pushkatuen nga komunistët, deri dhe u therën me thikë si berret, siç bani Mehmet Shehu në Mallakastër më 1943, gja që e pranon edhe Xhelal Staravecka në librin e tij. Këtu bie në sy ndryshimi midis gjermanëve, partizanëve e popullit. Populli i mbrojti si italianët ashtu dhe hebrejtë nga nazistët, por nuk i mbronte dot nga komunistët e vet. Brigatat partizane dhe qeveria komuniste që u vendos, nuk u ndalën para krimit edhe ndaj të huejve të pambrojtje, rob lufte ose të mbrojtun nga populli. I kapi, i vrau ose i burgosi, kot së koti, si hebrejtë ashtu italianët pa dallim (e kemi fjalën për ata që kishin mbetë në Shqipni). Ndër ta personalitete, si Gjenerali Gustav Mirdashi, hebré austriak, pushkatuar më 1945. Profesori i matematikës, hebreu Mak Maneheim, i burgosun. Një gjeolog hebré polak, i vdekun nga torturat në burg, e të tjerë, që nuk mbahën mend emnat e tyne. U pushkatua kirurgu i shquem Italian, Lozzi, dhe dy gjeometra në Maliq, me grupin e inxhenjerëve shqiptarë, Eugjenio Skaturo dhe Paolo Skalioti, për të mos përmendun ata që u zhdukën pa gjyqe nga partizanët, kryesisht oficerë italianë, dhe ata qe u burgosën e internuen. Rikujtojmë krimin e Mehmet Shehut të therjës së italianëve si berre. Ç'kerkojmë të themi me keto shembuj ? Asgja tjetër veçse krahasimin midis atyne qe u quejtën pushtues gjermanë dhe partizanëve komunistë që vetquhëshin "çlirimtarë" që nuk lanë krim pa krye mbi popullin e tyne, duke ua kalue pushtuesve ma t'egër qe kishin pa ndonjëherë Shqiptarët, edhe turqëve që nuk kursehëshin të banin piramida me kokat e shqiptarve. Komunistën nuk ngrinin piramida por i gropsosnin në dhé kushëdi se ku, sa që nuk u gjënedën varret.

Në këto kushte im atë, tashma Ministër i Mbrojtjës, vendosi të forcojë ushtrinë Shqiptare dhe u bani thirrje gjithë kuadrove nënoficerë e oficerë të paraqitëshin, për me fillue organizimin e ri të Ushtrisë mbi baza të shëndosha kombëtare. Për këtë punë bani nje projekt që ia paraqiti Keshiilit të Naltë të Regjencës e Qeverisë. Krijoi kursin e nënoficerëve në Tiranë. Një problem i madh ishte se ushtria shqiptare ishte shpërba me rastin e kapitullimit të Italisë, dhe duhej nisë nga e para. Si ndodhi kjo ? Kur mendon se me pushtimin e Italisë ushtria mbeti inaktive por pothuej e paprekun, kjo pyetje vjen vetvetiu. Pse të shpërbahej kur duhej të forcohej ma mirë ? Duke qenë shoqnues i gjithë këtyne ngjarjeve keni te drejtë të thoni se atë që lexoni tani nuk e keni dëgjue kurrë, sepse ashtu u krijuen situatat. Kur me të madhe u hap lajmi i kapitullimit të Italisë, e thamë ma sipër se si ne festuem në Laç me breshëri armësh e ngritjen e flamurit kombëtar, ku vinin nga gjithë krahina për urim. Me këtë rast aty erdhën disa oficerë të një batalioni shqiptar që rrinte në Lezhë, të cilët donin të dinin se ku gjëndej Gjenerali. Sepse në Lezhë kishte ardh lajmi se Gjeneral Prenk Pervizi kisht dale në mal e u bante thirrje trupave që të bashkohëshin me të, po ku ? Ata mendonin se me siguri ka dale në Skuraj. Nga kjo doli se dikush (komunistët ose dhe anglezët) e kishin përhapë këtë parrullë që të shpërbahej ushtria shqiptare, sepse u muer vesh ma vonë se

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

ajo parrullë kishte shkue edhe ne njësitë e tjera, deri dhe te batalioni i Spiro Moisiut në Lushnje, i cili doli ne mal dhe u bashkue me forcat partizane. Deri këtu asgja të keqe, por pastaj u pa se ajo punë ishte organizue mirë nga ata që nuk donin që Kosova t'i mbetej Shqipnisë, prej komunistëve dhe anglezëve. Çuditnisht në Kosovë kjo nuk ndodhi. Dy regjimentët që ishin dislokue atje nuk u shpërndanë, kjo për meritë të komandantëve të tyne. Komandant i trupave shqiptare ne Kosovë ishte gjeneral Aqif Permeti, i cili ishte kthye në Tiranë pas kapitullimit të Italisë. Ma vonë im atë si Minstër i Mbrohtjës caktoj atje dy kolonelët Fuad Dibra dhe Qazim Komani.

Në Shqipni njesitë ushtarake që u gënjyen e morën malin, u kthyen në shtëpitë e tyne. Ma vonë, kur shkoj urdhni i babës, e kuptuen se i kishin mashtrue, e u bashkuen me grupin e oficerëve që ishin mbledhë në Tiranë.

Ç'ndodh përsëri ? Në Tiranë, në kursin e nënoficerëve erdhën nja 150 vetë, ish nënoficera të Ushtrisë Shqiptare shumica nga veriu, dhe disa dhjetra oficerë efektivë, që do të shërbenin si bazë për krijimin e ushtrisë kombëtare shqiptare. Deri këtu asgja e keqe. Ndërkohë im atë ban thirrje të gjithë forcave të malit që t'i bashkangjiten ushtrisë shqiptare nën një komandë të vetëm, për të iu përgjigjë më mirë gjëndjes që po kalonte Shqipnia, dhe për të mbrojtë kufijt verior të Kosovës nga sulmet e çetnikëve serbë, që kërkonin të ripushtonin nga frika se kjo mos i mbetej Shqipnisë pas mbarimit të luftës, gja që ishte shumë e vërtetë. Dhe pikërsiht në Kosovë im atë e forcoi ushtrinë efektive që ishte atje, e për këtë punë shkoi ai vetë disa herë për të organizue sa ma mirë atë punë. Atje siç kemi thanë, ai kishte cajtue dy nga oficerët ma të mirë të kohës, siç ishin kolonelët Qaziml Komani, Fuad Dibra, me oficerë të tjerë si Shefki Shatku, Gjon Qipi, etj. Në Kosovë Prenk Pervizin e kishin pritë si një figurë të madhe të Kombit. Ishte hapë fjala se ai kishte qene mik i ngushtë i patriotit të madh Bajram Curri e se rridhte nga një fis i vjetër fisnik e familje e madhe patriote. Ai kishte shkue me pa në vend situatën dhe me forcue frontin e luftës kundër serbëve, duke iu bashkangjitë regjimentëve efektivë shqiptarë, forcat vullnetare të krenëve të ndryshëm të Kosovës, të cilëve u kishte njohë gradat dhe caktue rrogat, sipas rregullave ushtarake. Gjithë kjo i kishte gëzue pa masë kosovarët dhe u kishte dhanë kurajo e shpresë të madhe për të qenë pjesë e pandame e Shqipnisë, çyrtarisht e njohun para botës. Kjo pune do t'ishte e mundshme po qe se Kosova do të mbetej e bashkueme me Shqipninë në një Shtet të vetëm. Ky ishte qëllimi i nacionalistëve shqiptarë, që u vendos qyshë në mbledhjen e Mukjes. Qeveria e formueme pas kapitullimit të Italisë, për këtë përpiqesh prandaj në qeverinë e asaj kohë merrnin pjesë dhe ministra kosovarë. Dihet se kryeministër emnue Rexhep Mitrovica, Ministër i P. Brendshme Xhafer Deva, Ministër i Jashtëm, Bahri Omari, i Mbrojtjës Prenk Pervizi, e të tjerë ministra si Rexhep Krasniqi, Eqrem Çabej, Ago Agaj, Mehmet Konica, Vehbi Frasheri etj. Pra një qëveri vërtet kombëtare që i përgjgjej gjendjës së trojeve etnike të bashkueme në një

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

shtet. Por dikush, sigurisht anmiku, nuk flinte. Si gjarpni ai futej kudo për të kurdiste plane djallëzore.

Ndërkohë, siç thamë, im atë kishte përpilue projektin e formimit t'ushtrisë kombëtare shqiptare, të cilin ia kishte parashtrue Këshillit të Naltë të Regjëncës e Qeverisë për aprovim. Dukej se punët po shkonin mbarë.

Papritmas komanda gjermane, vetë gjenerali SS Fistum që kishte zevendesue kolegun e tij Karshaniko, i çon një mesazh Prenk Pervizit se komanda gjermane nuk do te lejonte që të shtohësh ma tepër numëri i nënoficerëve dhe i oficerëve në Tiranë se sa ai që ishte. Nga një shqiptar që punonte si përkthyes me gjermanët u muer vesh se atë kurdisje e kishin ba komunistët, duke u fut frikën gjermanëve se Prenk Pervizi po donte me krijue e armatosë ushtrinë shqiptare për me sulmue forcat gjermane.

Gjenerali Fistum kishte dashë me u takue me kolegun shqiptar, por ky kishte shkue në Kosovë, siç thamë. Në vend të tij ai kishte thirrë kolonel Hysni Demën, Komandant i xhandarmërisë, me të cilin kishte bisedue e kishte shfaqë dëshirën që me u takue me Gjeneral Pervizin, për të cilin kishte dëgjue e i kishin folë fjalë të mira, si një oficer me pregatitje të naltë dhe me eksperiencë të madhe e që gjermanishtën e fliste mirë. Kur im atë u kthye nga Kosova, Hysni Dema i tregoi për sa kishte bisedue me gjeneralin Fistum. Hysniu e kishte njoftue gjermanin se Prenk Pervizi ishte kthye nga Kosova, dhe nji ditë prej ditësh, Fistum e fton atë në zyrën e tij. Qyshë ne fjalët e para ai e pa se kishte të bante me një ushtarak tepër të pregatitur e të ngritun. E lavderoi për gjermanishtën që fliste aq mirë. Ndërkaq ia hynë bisedës serioze. Fistum, duke vu përpara rrezikun komunist, i kishte propozue t'im etit që të merrte përsipër të vendosej një diktaturë ushtarake, për të cilën do të kishin mbështetjen e plotë të gjemanëve, që ndonse ishin në kalim e sipër për t'u kthye në Gjermani, donin që Shqipninë ta linin në dorën e sigurtë të patriotëve shqiptarë, që ajo të mos binte në duer të komunistëve. Im atë e kishte falenderue për propozim, duke i thanë se atë detyrë ai nuk mund ta merrte përsipër pa u konsultue me Kshillin e Naltë e Qeverinë. Detyra e tij ishte me krijue ushtrinë shqiptare që ishte shpërda pas kapitullimit të Italisë. Ky ishte përfundimi i takimit me gjeneralin Fistum. Im atë e kishte kuptue se gjermanit i kishte mbetë hatri nga përgjigja pothuej negative. Im atë shkoi drejt te Keshill Naltë ku bisedoi me Mehdi Frasherin të cilit i tregoi për çka i kishte thanë Gjenerali gjerman dhe përgjigjen që i kishte dhanë.

- Mirë ke ba. Patjetër se çeshtja duhej te shtrohej midis nesh. S'asht punë me krjue diktaturë ushtarake. Kësaj i thonë me çfarosë rininé shqiptare. Punë që s'bahet ! Ishte shpreh Mehdiu.

Kjo tregon se edhe qeveria nacionaliste dhe Këshilli i Naltë e konsideronin luftën partizane, pavarësisht se me ngjyrë komuniste, si një luftë ku rinia ishte përfshi për idealin e naltë të lirisë, e se në mbarim të luftës botnore te gjithë forcat politike do të mblidheshin rreth tryezës së

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

marrëveshjës ndërshqiptare, ku edhe komunistët do ta kishin vendin e tyne. Një nënvleftësim i çuditshëm ndaj rrezikut që po u kanosej.

Ndërkohë do të ndodhnin ngjarje të tjera që do të çonin drejt prishjes përfundimtare me gjermanët. Gjermanët kishin afrue një oficer reservist dizertor shqiptar që kishte marrë përsipër të krijonte disa forca të veta me oficerë të tjerë disertorë, që nuk pranonin me shkue në Kosovë ku i kishte caktue me detyrë Komanda Shqiptare. Këta njerëz do të shërbenin për me krijue forcat SS në Shqipni të mbështetun nga gjermanët. Ky ishte kapiteni rezervist Selami Çela që i kishte veshë vetes gradën kolonel. Ai rekrutonte oficerët disertorë që nuk pranonin të shkonin me detyrë në Kosovë. Këtyne u njihte nga një gradë ma tepër se atë që kishin dhe i paguente me pare të mjeluna nga tregtarët, të cilët i kërcënonte dhe i terrorizonte vazhdimisht duke u vu haraçe të randa. Një sistem mafioz. Në këtë mënyrë kishte formue një grup besnikësh e përkrahej nga gjermanët, sepse ai ishte paraqitë se do të luftonte komunistët por kërkobnt mbështetjën e gjermanëve. Ndërkohë ai i kishte dergue një mesazh kërcënues gjeneralit Aqif Permetit, duke e fye si plak matuf të rrjedhun nga trutë, e se duhet të ua lironte vendin të rijve si ai. Ne këtë mes ndodhi që u arrestuen disa oficerë disertorë të rekrutuem prej tij, ndër ta edhe një nip i Aqif Permetit, të cilët i kaluen gjyqit ushtarak ku i priste një denim i randë. Me këtë rast doli sheshit veprimi i Çelës për të përgatitë një grusht shteti në bashkëpunim me gjermanët. Ai ndërhyni përsëri me një letër të hapun se si guxonte Komanda Shqiptare me arrestue njerëzit e tij, me shprehje fyese ndaj vetë Gjeneralit Prenk Pervizi. Kjo punë e acaroi atë, që njihej për rrebtësinë e tij n'ushtri. Çeshtja i kaloi gjykatës ushtarake qe e denoi kapitenin me vdekje në mungesë për disertim dhe ngritje krye kundër Shtetit. Për këtë punë u krijue një grup ndëshkues me nënoficerë të ushtrisë e të xhandarmerisë nën komandën e një kapiteni, që duhet të arrestonte ose të vriste disertorin në fjalë. Ato zunë pritë para ministrisë së Brendshme ku Çela do të vinte me forcat e veta me u takue me Xhaferr Deven për ti ba presion edhe atij. Bile u hap fjala për te pushtue atë Ministri. Aty krisi pushka dhe Selamiu mbeti i vramë, kurse forcat e tij u shpërdanë e u zbukën sa hap e mbyll sytë, sikur të mos kishin qenë kurrë. Ngjarja bani bujë për kenaqësinë e qytetarëve e të tregtarve që vuenin në dhunën e bandës së Çelës. Po japim përshkrimin e anglezit Julian Amery që atë ngjarje e kishte të freskët e për të cilën e kishin informue menjëherë, nxierrë nga libri "Bijt e Shqipës" në botimin anglisht, 1946, faqe 304-305:

"Karriera e Kryekomandantit ishte e stuhishme, sepse, ndërsa politika e Gjermanëve ishte përçaj e sundo, Prenk Pervizi ishte i vendosun të mbante nën urdhnat e tij të gjithë forcat e armatosuna shqiptare. Konflikti me gjermanët ishte i pabarabartë, por përfundimisht ai doli fitimtar në rastin e parë të sfidës që i bahej autoritetit të tij. Gjermanët kishin vendosë të krijonin në Shqipni një Division S.S. për ushtrinë e tyne dhe ia kishin besue komandën

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

e brigatës së parë një far Selami Çelës. Ky Çela ishte një kapiten rezervist dhe si i tillë ishte nën urdhnat e Prenk Pervizit. Natyrisht se Gjenerali ishte kundër formimit në Shqipni të një njësie ushtarake që nuk do t'ishte nën autoriretin e tij, dhe e kishte urdhnue Çelën që të hiqte dorë nga ajo punë. I këshilluem nga gjermanët sigurisht se Çela e hodhi poshtë atë urdhën. Një mëngjes Gjenerali e kishte pa atë që po hynte në shtabin e komandës gjermane i veshun me uniformën e kolonelit. I fyem në dinjitetin e tij, ai vendosi "ta bajë shëmbull" dhe dha urdhën për "ekzekutimin" e tij. Një orë ma vonë kur ky njeri i keq doli nga mbledhja, body garda e Gjeneralit e eliminoi atë në shkallët e Shtabit Gjerman me dy granata dhe një breshëri automatikësh. Gjenerali vetë e ndoqi ngjarjen nga dritarja e zyrës së tij ku një turmë e madhe njerëzish ishin grumbullue për të shfaqun aprovimin e tyne. Gjermanët nuk mund të mos inatosëshin nga një sfidë kaq e madhe dhe kërkuen dorëheqjen e menjëhershme të Prenk Pervizit dhe denimin e tij. Regjenti i vjetër Mehdi Beu që e kishte eksperiencën politike të Perandorisë Otomane, tue ia terhequn vrejtjen Gjeneralit para Komandantit Gjerman i tha :

- Ju ftoj t'u kërkoni falje miqve tanë Gjermanë për gabimin që keni lejue në shkallët e derës së tyne. Herën tjetër kur ju duhet të pushkatoni ndonjë oficer, ta bani në kazermat e jueja dhe jo në rrugë.

Gjermanët morën mësim.. Ma vonë ata e krjiuen një divison S.S. në Kosovë, por këtë punë nuk e përseriten brenda kufijve të Mbretnisë Shqiptare.

Prenk Pervizi i mbejetoi incidentit, por marëdhanjet me Gjermanët u prishën përfundimisht. Kërkesa e tij për armë dhe municione për ushtrinë shqiptare u refuzuen disa herë. Në një letër që ai i kishte adresue Gjeneralit Fistum me atë përmbajtje, iu kthye si një nxanësi për ushtrimin e pakënaqshëm me një "Nein" të zhgarravitun me bojë jeshile në gjithë letrën.

*Ky ishte shkaku që ai të vihej kundër gjermanëve dhe tani që u kthye anmik me ta u çlirue nga çdo zemërim i ndrydhun. Akuza për "kolaboracionizëm" ndaj tij asht pak e besueshme, por nga ana tjetër del e qartë pazotësia mjaft patologjike e gjermanëve për me fitue simpatinë e një njeriu që ma kollaj mund të kishte qenë mik i tyne".**

Amery e përfundon kështu tregimin e tij duke e ditun se Prenk Pervizi e kishte mbarue akademinë ushtarake ne Vjenë, pra sipas tij ishte ma lehtë që ai të bashkohej me gjermanët, pikërisht se kishte fitue një kulturë gjermane. Por anglezi nuk i kishte ba mirë hesapet, sepse shqiptaret nbesim gjithmonë shqiptarë. Një ushtri e tanë intelektualësh që ishte formue në universitetet dhe shkollat evropiane ishin kthye ne vendin e tyne për t'i shërbye atij me devocion. Siç del nga kjo dëshmi, tregimi i majorit anglez përputhet me atë të njohun prej çdo shqiptari që përjetoi atë periudhë 1943-44. Unë që shkruej sigurisht se i njoh ma mirë se kushdo tjetër ato ngjarje sepse kam njohun vetë pjesmarrësit e tyne, kryesorin prindin tim. Prandaj edhe po i radhis këtu që të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

iu shërbejnë historianëve të ardhshëm, për të cilët shpresohet se do të jenë të çliruem plotësisht nga ndikimet e ndryshme, politike, klanore, shoqnore, fetare e krahinore. Për sa i përket tim etit kuptohet fare qartë se ai mbi të gjitha i shërbente atdheut, dhe autoritetin e tij në ushtri ai e zbatonte konform rregullave e disiplinës ushtarake, siç veprohet në çdo vend të qytetnuem të rruzullit toksor, duke pasë për parim mos lejimin e ndërhyrjes së huej mbi problemet shqiptare. Kjo u pa edhe në luftën italo-greke, dhe operacionet e ndryshme që kreu në Shqipni, si dhe në qëdrimin e vendosun ndaj italianëve e gjermanëve, ku të huejve nuk pati kurrë ngurim që të ua përplaste në fëtyrë të vërtetën dhe pavarësinë e veprimeve të tij e të ushtrisë shqiptare që ai komandonte.

---

*-- Po të njejtin përshkri do të jepte oficeri gjerman, Walthet Peinshipp që kishte qënë me shërbim në Tiranë , pikërisht në atë kohë, në librin e tij " Das Folk der Schipetaren" Wien, 1985, (Populli i Shqiptarve, Vjenë 1985).

*-- Përvec Gjeneralit Fistum, të cilit Prenk Pervizi ia kundërshtoi formimin e forcave SS në Shipni, ai nuk deshi të takohej me asnjë nga gjenralët gjermanë, që patën ardhë në Tiranë, as me Gjeneralin Neubacher i dërguem i Hitlerit. Kjo për faktin se ai gjermanët i konsideronte si kalimtarë dhe s'kishte asnjë arësye që të kishte marëdhenje me ta.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Foto- galeri e karrierës ushtarake të Prenk Pervizit



Kapiten 1921



1922



1924-28



Major 1928



1929



1933



N/Kolonel 1933



kolonel 1937



Kolonel 1941



Gjneral 1942-1944
Ministër i Mbrojtës



Në mal 1944-46



Mërgim 1946-1977

Mungojnë fotografi të shumta. Ato që ruhëshin në familje humbën me djegien e shtëpive. Në Arkivat u zhdukën nga duar të këqia. Këto që paraqitëm janë mblmedhur nga të miq e të njohur.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Prenk Pervizi dhe oficerët anglezë me të cilët qëndroi në mal më gusht-tetor 1444.



Gjen. PRENK PERVIZI



Kap. JULIAN A1MERY



Kol. BILL MACLEAN



Kol. DAVID SMILEY

Me këta të tre oficerët anglezë u takue një Greqi pas dy vjet ku ata ishin në komisionin e marrjës në pyetje të të arratisurve politikë nga vendet komuniste, shqiptarë, bullgarë, rumunë e jugosllavë. Kështu miqësia me ta vazhdoi edhe në mërgim. Fatkeqësisht ka humbun korispondenca që ka pasë me ta.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

SHTABI I NALTE USHTRISE SHQIPTARE
NE NJE FOTOGRAFI HISTORIKE ME RASTIN E FESTES SE 28 NENDORIT 1943, NE ISH PALLATIN MBRETNOR.



Gjeneral Prenk Pervizi, Ministër i Mbrojtjsë, dhe Gjeneral Gustav Mirdashi me shtabin e Lartë t'Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Me radhë kolonelët : Muharrem Liku (pushkatuar), Sami Koka (vdekur në burg), Tahsim Bishqemi (pushkatuar),Gjen. Prenk Pervizi (arrtisur), Gjen. Gustav Mirdashi (pushkatuar), Kol. Haziz Blloshmi (pushkatuar), Kol. Baron von Kirshner (arratisur), Kol. Daut Çarçani (pushkatuar) të tjerëve mbrapa nuk ua dijmë emnat, por edhe ata u asgjesuan nga terrori komunist.

Një fotografi unuikale historike dhe e fundit të ketij grupi oficeresh madhorë të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)






.

Gjeneral Prenk Pervizi dhe bashkeshortja Znj. Prena (Ana) në foto të vitit 1943, të fundit të asaj periudhe. Në maj 1945 ato do të ndahëshin për të mos u pa ma kurrë. Gjenerali i arratisun jashtë shetit më 1946-1977. E shoqja e internueme më 1945-1977. Ato vdiqen ne te njejtin vit. Znj. Prena më Prill 1977, dhe Gjenerali më shtator 1977., i cili, ndonse grueja kishte vdekun katër muej përpara, nuk mori vesh asgja për të.

Tre gjenëralët e fubndit të Mbretnisë shqiptare



Gustav Von Myrdatzy
Shef i Shtamadhorisë
Pushkatue



Prenk Pervizi
Ministër i Mbrojtës
Arratisë



Aqif Permeti
Ministër i Mbrojtjë
Pushkatue

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Qëndrimi në mal me misionin anglez, gusht-tetor 1944.

(Fotiografitë nga kolonel anglez David Smiley)



Julian Amery (ma vonë Lord Amery) dhe Prenk Pervizi në mal, Velë 1944.



Gjeneral Pervizi dhe kapiteni anglez Julian Amery duke kaluar nga Skuraj i Kurbinit në Velë të Lezhës, më shtator 1944.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)





Prenk Pervizi, Ihsan Toptani e Julian Amery Gjeneral Prenk Pervizi

duke biseduar ne mal në Velë tetor 1944 ku Prenk Pervizi vahzhdonte të njihej si Shef i Ushtrisë Shqiptare deri më 1946 kur kaloi në Greqi.



Anëtarët e Këshillit të Naltë 1943-44, Prenk Pervizi i dyti nga e majta, Ministër i Mbrojtjës.Në mes, Mehdi Frasheri, Rexhep Mitrovica dhe me radhë ministrat e tjerë.
Në këto takime Prenk Pervizi paraqitej gjithmonë me rroba civile.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Rezistenca kundër komunizmit

Më 11 gusht 1944, Gjeneral Prenk Pervizi me 150 nënoficerë dhe disa dhjetra oficerë u detyruen me u largue nga Tirana, sipas një marrëveshje me misionin anglez, gjoja për të krijue forcat e armatosuna nacionaliste të malit. Kjo kërkesë u ba shumë insistuese, sepse sipas anglezëve duhej me tregue se edhe nacionalistët i luftonin gjermanët. Duhet ditun se ishte Prenk Pervizi që u ba shkak të një prishje me gjermanët për tre arësye. E para Gjenerali s'lejoi të krijohëshin forca SS në shqipni. E dyta ai e hodhi poshtë kërkesën e gjenerali gjerman SS Fistum për të vendosun një diktaturë ushtarake nën udhheqjën e tij, për të luftue komunistët. E treta gjermanët refuzuen të furnizonin me armatime ushtrinë shqiptare qe do të formohej. Kjo prishje çoj në largimin e Këshillit të Regencës, dhe të Qeverisë si Fiqri Dinës, ku përfshihej Prenk Pervizi si Ministër i Mbrojtjës. Ata kishin kalue në Zall Herr ku ishin përqëndrue disa forca civile të pa organizueme. Secili prej tyne me një pushkë personale në krah e që s'njihnin as të parë as të dytë, që vinin e shkonin sipas qejfit. Organizimi ushtarak i tyne ishte i pamundun. Doli problemi pse me u braktis Tirana. Kujt i bante lazëm ajo punë ? Sigurisht komunistëve. Këtu lindën kontradiktat midis nacionalistëve, sepse Bazi i Canës kishte propozue që të sulmohej e pushtohej Tirana. Po Tiranën e kishim, kishte thanë Fiqri Dine e ju me anglezët na imponuet për me e braktisë. Ç 'hyn kjo punë tashti për ta ripushtue? Një spekullim i hapun i dikujt për të fitue një lavdi të paqenë. Mbasi aty s'u ba gja, ato forca u shpërngulën në Skuraj, vendlindja e Prenk Pervizit. Këtu krenët nacionalisë u njohën me oficerët anglezë të Misionit. Prenk Pervizi zuni miqësi menjëherë me ta si ushtarak me pregatitje të lartë, nga fakti se ai fliste disa gjuhë e s'kihste nevojë për përkthyes. Në këtë rast Prenk Pervizi u propozon anglezëve, që të fortmohej një shtab i përbashkët dhe të organizohëshin forcat e malit në njësite të rregullta nën komandën e oficerëve efektivë dhe akademistë të ushrrisë shqiptare, që ishin nën urdhnat e tij. Anglezët e morën këtë punë me të qeshur, dhe koloneli MacLean u shpreh, po kur disiplinohën këta bashibuzhukë që vijnë e shkojnë sipas qejfit e s' duen të dijnë për dispilinë e rregulla ushtarake. Megjithatë britanikët pranuen të formohej një shtab formal, sa për të thanë. Në këtë kohë doli shesht paafalësia e Abaz Kupit për të pasun forca të organizueme ushtarakisht në shëmbëllin e komunistëve, me çeta, skuadra, kompani e brigata me komandantët përkatës. Gjëndja ishte e pakontrollueshme. Prenk Pervizi u detyrue me i paksue forcat e veta, sepse dilte problemi ku do ushqehëshin gjithë ato njerëz, apo me i ra në qafë popullsisë, që ishte në hall për vete. Në këto rrethana oficerët e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

misioni britanik qëndruen deri në largimin e tyne, nën mbrojtjën e Prenk Pervizit, gjë që ata do ta theksonin ma vonë në librat e tyne. Me largimin e Anglezëve forcat nacionaliste u shpërndanë. Edhe Prenk Pervizi i largoi forcat e tij, duke mbajtun vetëm katër-pesë vetë e duke u strehue në malet e Skurajt. Kjo u ba me këshillën e anglezëve, që krenët nacionalistë të qendronin në mal deri dy vjet, në pritje ië një ndërhyrje të Aleatëve për ta normalizue situatën brenda atij afati. Duke përjashtue Abaz Kupin që iku privatisht me një barkë peshkimi, gjithë krenët veriorë qëndruen në malet e krahinave të tyne, të mbeshtetun mbi fjalën e Aleatëve. Prenk Pervizi ndërkaq e kishte studiue e mat gjëndjën. Pushtimi komunist dhe instalimi i diktaturës, ishte tepër i organizuem ushtarrakisht qysh në mal në brigata. Të cilat ishin kthye në forca të ndjekjës që merrëshin me kapjën e vrasjë e të arratisunve politikë ndër male. S'ishte fare si nën pushtim, ku ata që qenronin malëve, gjoja si kundërshtarë të pushtuesve, e kalonin për bukuri duke shetit nga një shtëpi në tjetrën, për dreka e darka, pa i trazue kush. Ndersa forcat e sigurimit i ndiqin kamba kambës në male e fushë e kudo. Sigurisht se gjenerali e kishte ndermend krijimin e një force kundështuese, po me se e me kë ? Me terrorin e tyne komunstët masakruen ndër qytete shtresën intelektuale. Ndër fshatna banë kërdinë në njerëz të ndërshëm dhe njeni pas tjetrit i vranë ose i kapën të arratisunit. Mark Gjomarkaj në Mirditë krijoi Komitetin e Malëve me disa oficerë dhe mirditorë trima e besnikë, që ia njhnin autoritetin si Kapidan i Mirditës. Marku ishte i dipllomuem në Shkenca Politike e mjaft i pregatitun. Ai gezonte besimin e nacionlistëve në kundërvenje ndaj komunizmit. Marku binte nip i Prenk Pervizit, dhe kishte konsideratë të madhe për dajën gjeneral e personalitet i spikatun i nacionalizmit shqiptar. Kushtët ishin tepër të vështira, ku forcat e ndjekjës ose brigatat partizane kontrollinin gjith vendin. Në ato kushte, Marku, sado që shkoi në Skuraj tek njerëz besnikë, s'arriti ta kontaktojë dajën. Prenk Pervizit s'ia dinte kush vendin. Ai rrinte në lëvizje të vazhdueshme, dhe, ose vetë i dyti ose i vetëm fare. Qeshtja ishte me shpëtue, në pritje mos Aleatët banin diçka e ndërhynin për të normalizue gjendjën. Premtimet e tyne dolën flluska sapuni, boshe. Ata i lanë nacionalistët e malit në baltë e në mëshirë të diktaturës që s'rrinte duer kryq dhe pothuej i zhduku fare të arratisunit kryesorë. Kjo për shkak të Jugosllavisë, ku asnjë i arratisun s'mund të dilte atje. Ose po të ndodhte ndonjë trazirë në Shqipni ishte e gatshme të ndërhynte ushtarakisht. Shqipnia komuniste ishte lidhë fish e thue me Jugosllavinë. Në këto kushte, të arratisunit me të ranë sishëm të Veriut si Muharrem Bajraktari, Fiqri Dine, Hysni Dema e Prenk Pervizi ranë dakord që duke qenë se u mbushën dy vjetë e afatit të Aleatëve, pa ndodhë asgja për një ndërhyrje në Shqipni, të largohëshin në të vetmin vend ku mund të gjenin shpetim, që ishte Greqia. Kështu tre kolonelët e Mbretnisë shqiptare, Bajraktari, Dinëja e Dema, ranë për shkurt nga Maqedonia, rreth 84 vetë t'armatosun. Të diktuem e të ndjekun e në kuftime të rrebta me forcat

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

jugosllave, mezi shpëtuen 24 prej tyne me dalë në Greqi, të gjithë të plagosun. Të tjerët mbetën të vramë rrugës në luftime. Ishte kështu që Muharrelm Bajraktari, Fiqri Dine e Hysni Dema, kaluen në Greqi. Harruem me thanë, se Mark Gjomarku dhe i vëllai Lleshi u vranë në Mirditë. Vrasja e Mark Gjomarkut, e ftofi gjithë rezistencën e malëve që ai kishte krijue. Tani në Shqipni i arratisun ma i randësishëm i pakapshëm kishte mbetë vetëm Gjeneral Prenk Pervizi.

Forcat e mbrojtjës ishën përqëndrue në Kurbin, kryesisht në Skuraj, ku dihej se ai gjente mbështetje e strehim aq të sigurt sa që u fillue të dyshohej mos vallë ishte arratisë jashtë shtetit.

Një ndër strehuesit më besnikë ishte shtepia e Nikoll Llesh Gjokës, në Skuraj, kushërij me Prenk Pervizin. Djemt e kësaj familje, Llesh e Ndue Nikolla, kishin shërbye nën komandën e Gjenralit si nonoficerë. Të dalluem për trimni, besë e burrni. Sado që Sigurimi kishte informata, nuk arriti kurrë të thyeje besnikërinë e vendodmërinë e kësaj familje, nga ma i madhi deri tek me i vogli. Vërtet diçka e përmasava lëgjendare.

Një tjetër besnik i madh dhe i jashtëzakonshëm, ishte një nip i fisit, Bib Brozi, i cli ishte i vetmi njeri që e dinte, se ku strehohej Prenk Pervizi, si dhe lëvizjet e tij në jetën e malit. Ai I shërbente në ato kondita të rrezikshme dhe e furnizonte me gjithçka i nevojtej, deri dhe me gazetat e regjimit komunist. Dikur u arrestua e pësoi torura çnjerëzore, për të tregue se ku strehohej e gjëndej Gjenerali. I Shpëtoi mrekullisht vdekjës e pasi u shërue e filloj përsëri mbështetjën ndaj Prenk Pervizit, deri sa ky u largue
Jashtë shtetit.

Pas daljës në G reqi të kolegëve të tij, Prenk Pervizi po përgatitej me dalë edhe ai, por kur e si ? Pati takim me kushrijt e nipat e tij, ku ua shtroi problemin, dhe ata menjëherë e mbështetën atë plan, të gatshëm me u nisë e me ça përmes Shqipnisë deri në kufi. Gjenerali s'e pranoi atë propozim, sepse ishte e pamundun të kalohej ashtu grup i armatosun përmes vendit, para në përpjekje me forcat e ndjekës, ku ishte i sigurt asgjesimi tyne. Pastaj edhe sikur të ndodhte një gja e tillë, forcat komuniste do të banin kërdinë në Skuraj e Kurbin, me hekur e zjarr. Me djegëje shtëpishë, vrasje e burgosje të burrave e internim të familjve. Ai do të nisej fillikat e vetëm, sipas një plani që kishte hartue. Qëllimi ishte se me daljën në Greqi mund të krijoheshi kushte për një ndërhyrje ushtarake për rreximin e regjimit komunist me ndihmën e anglezëve. Kushrijt e nipat, si edhe besnikët e tjerë të banin si të banin e të shtynin kohën në kushtet e malit. Ai uronte që Aleatët mandfund do të mbeshtetnin një ndërhyrje të tillë kundër regjimit diktatorial komunist. Ai do të gjente mënyrën me u lidhë me ta. Një ndër nipat ma të aftë e trima ishte Ndue Gjergj Lleshi. Ai kishte mbaruë gjimanzin në Shkodër dhe një kurs ushtarak dy vjeçar tnë armën e financës në Itali. Me 1943-1944 ishte caktue si komandant i xhandarmërisë në Krujë, dhe do të vazhdonte kursin e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

plotësimit për oficerë në Tiranë më 1944, i hapun nga Ministria e Mbrojtjës. Këto kushte s'u arritën me marrjën e pushtetit nga komunistët. Mbi të dhe nipat e tjerë pështonte figura e Prenk Pervizit, kështu që me rastin ma të parë u arrëstue, me gjithë kushrin Ndue Pali, e pasi u mbajtën në qelitë e Krujës ku pësuen tortura të çdo lloji, u dënuen me vdekje me varje në Krujë, të dielën e Pashkëve 1948. Ata, natën para arritën të thyejnë burgun e të arratisën.
Kështu filloi jeta e malit. Prishja me Jugosllavinë, disi e lehtësoi gjendjën e të arratisunve që nisën të kalojnë në Jugosllavi. Duke gëzue besimin e të arratisunve të Kurbini e Mirditës, Ndue Gjergj vetë i 50 në krye të tyne, u prin e i kalon në Jugollavi nga Mali i Zi. Këtu ata paraqitën me krenari si kundërshtarë të regjimit komunist shqiptar. Autoritetet komuniste Jugosllave i morën me të keq, dhe kërkuen prej tyne që të kryeninn në Shqipni ndonjë aksion vrasjeje oficerësh të sigurimit apo funksionarësh të lartë të regjimi komunist pa t'i pranonin si refugjatë politikë. Këtë punë Ndue Gjergji me shokë s'e pranuen assesi. Jugosllavët atëherë u vunë prangat e i futën në Shqipni pa armë. Në këto kushte ishte Ndue Gjergji që u doli zot shokëve Ai u prini dhe arriti që t'iu hiqen prangat, t'i shpëtojë, një akt heroik tepër i veçantë. Ndërkohë Prenk Pervizi ishte orvat të dërgojë njerëz diversantë, për të krijue lidhje. Por fatkeqësisht ndodhi që disa u vranë e të tjerë përfunduen burgjëve. Më 1949 filluen të bien diversantë parashutistë për të organizue rezistencën e armatosun, por ndodhi qe nga tradhëtia e një spiuni angle në shërbim të Rusëve, Gim Filbi, ato aksione të dështonin, por jo të gjitha. Pati disa raste si ai Ndue Pjetër Gjomarkut, që mori udhëheqjën e të arratisunve të Mirditës. Kjo koincidoi me vrasjën e Bardhok Bibës, në gusht 1949, që nga fakte të dokumentueme del se u vra nga vetë sigurimi për të provokue katastrofën e Mirditës, ku u masakruen 14 vetë, u arrëstue e burgosën 500 të tjerë dhe u intenuen mbi 2500 familjarë, pleq, gra e fëmijë. Në një hedhje tjetër të diktueme u vra komandanti i diversantëve, Pashko Suma, i cili, i plagosun randë, para se me dek ia kaloi komandën Ndue Gjergjit. Kështu ai u njoh zyrtarish si udhëheqës i rezistencës kundër regjimit komunist në zonë e veriut, kryesisht Kurbin, Mirditë, Pukë e Lezhë. Po në këtë kohë, arrin të zbresë i padiktuem në Mirditë, Alush Lleshanaku me grupin e tij. Alushi bani një gabim sepse desh të lidhej me një shok tij të shkollës në Tiranë. Por ky ishte lidh me regjimin e ishte ba kampion në atletikë e profesor në Istitutin e Fiskulturës. Sepse pikërisht ky shok spiunoi dhe Sigurimi e mori vesh ardhjn e Lleshanaku dhe forcat e mbrojtjës u vërshuen në Mirditë, ku nisën luftimet dhe Alushi u plagos. Megjithatë, njerëz besnikë arritën ta çelllin deri në Milot ku u lidh me Ndue Gjergjin, dhe me ndërhymjën e tij u kurue nga plagët mu midis Milotit tek një njeri besnik, nën hundën e Sigurimit. Si u shërua, Alushi kaloi në Elbansan, ku sic dihet u tradhtue dhe u vra. Në këto kushte Ndue Gjergji i njihej nga qendra e organizative Italisë, udhëheqja e t'arratisunve me pseudonimin « Antonio Major (i madh) ». Ai e justifikoi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kete detyrë sepse u imponue si i arratisuni ma i randësishëm dhe i rrezikshëm për sistemin komunsit. Forcat e ndjekjës u përqendruen krejt në zonën e Kurbinit e të Mirditës, dhe në një rrethim të pabesë e përpjekje ai mbeti i vramë, duke kalue not lumin Mat në tentativën për me shpëtue shokun e plagosun. Kjo ndodhi më 15 mars 1951. Trupi i tij s'u gjet dhe ky trim e hero mbeti pa varr. Pas tij s'pati kush me ia zanë vendin dhe dy kushtrijtë e tij Ndue Pal Gjini e Preng Llesh Gjergji edhe ata u vranë në Korrik 1952 në Skuraj. Nga njerëz të sigurimit dhe të partisë asht marrë vesh se fshati Skuraj quhej i pa çliruar deri 1952 kur u vranë të gjithë të arratisunit te fisit të Prenk Pervizit. Lami i vrasjë së tyne, u dha në faqet e para te gazetave Zëri i Popullit e Bashkimi, me bujë të madhe më korrik 1952, se u vranë nipat e Prenk Pervizit e të Gjon Markagjonit. Kjo na shtyni më 2004 të kërkojmë në Bibliotekën Kombëtarte koleksioni e këtyne dy gazetave, mos gjenim ato gazeta. Poshterësi : prej gazetave ishte hequn aj i lajm e zevendesue me një plenium të partisë. Pra një provë tjetër flagrante e metodës fallsifikuese të zbatueme nga regjimi komunist kudo, deri edhe ne gazetat e perditshme, për të hequn prej tyne ato faqe që binin keq për atë regjim. Për të krijue kështu një histori fund e maje të rreme. Dhamë disa të dhëna mbi rezistencën e fisit të Prenk Pervizit, ku u shque sidomos Ndue Gjergji. Duhet të shtojme se ky fis asht i vetmi në Shqipni qe nuk pranoi asnje afrim me regjimin, e s'pati asnjë që të bahej komunist ose te merrte poste pune në administratën e tij. Nga ana tjetër familja e Prenk Pervizit, e ama, gruaja dhe djemtë, u mbajtn gjithë kohën 46 vje nën përsekutim, ne burgje e kampe internimi, bashkë me familjet e tjera, si të Ndue Gjergjit, grueja me dy fëmijët, Pjetër e Zef; familja e Nue Pali Gjinit, grueja me gjasht vajza e djalin, Mark; falmilja e Preng Llesh Gjergjit, grueja me nje vajzë që vdiqen ne kampin e Beratit, dhe e ama me të motrën e pagojë. Në kampin e Tepelenës vdiq e ama e Prenk Pervizi, edhe nipi Gjin Pali, si edhe një grue me gjithë fëmijën. Vellai i Ndue Gjergjit, Mëhilli, vdiq në burgun e Tiranës nga torturat më 1949. Pastaj nga sigurimi u vranë edhe të tjerë si Zef Gjok Pjetri, Nikoll Pal Gjini, (ky u vra në Jugosllavi, ku kishte dalë më 1950). E ama e Gjneralit, e shoqja dhe djali dytë Gene i vdiqën në kampet e Lushnjës. Pati dhe viktima të Tjera. Nga dokumentet del se viktimat e fisit të Prenk Pervizit arrijnë në 23 vetë, ku shumicës s'u dihen varret. Përveç këtyne pati me dhjetra të tjerë të burgosun e të internuem. Duke mos harrue se ky persekutim, siç e kemi permendë, nisi me djegien e shtëpive në Laç e Skuraj, dhe grabitjen e konfiskimin e pronave të Prenk Pervizt në fshat dhe ne Kryeqytet. I gjithë ky përsekutim e masakrim nuk ndikoi aspak në demoralizimin e këtij fisi krenar e i pamposhtun. Ac ma tepër i dha forcë për t'i qendrue balhaptas si një kundështar i pamposhtun. Tradita patriotike shekullore do të vazhdonte pandërprerje.

Një tjetër ngjajrje e randësishme që lidhet me nipat e Prenk Pervizit, asht ajo që përfshiu Ndue Gjergjin : orvajtja e komunistëve për ta mashtrue me një

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

plan djallëzor që ata kishin shpikun për kapjën e gjithë të arratisunve të veriut. Kryesori ishte Ndue Gjergji, i cili kishte ndikim në të arratisuni e veriut. Kjo lojë u sajue dhe u drejtue nga vetë Mehlmet Shehu dhe Kadri Hasbiu më 1950. Sigurimi kishte arrestue e mbyll në një qeli sekrete të Ministris Brendshme, Ded Gjomarkun, të cilin e kishin shpall të arratisun. Si Kapidan i Mirditës e me influencë të madhe në zonat veriore, d eshën ta fusin në lojën e organizonimit të një mbledhje me të arratisunit, për me krijue gjoja rezistencën e armatosun e me rrexue regjimin komunist. Deda s'kishte pranue me bashkëpunue e kishte refuzue prerazi të bante lojën e sigurimit. Kështu Kadri Hazbiu krijoi një Dedë fallso me tiranasin, Xhaferr Mema. Vetë Kadri Hazbiu shkon me disa shokë si grup komitësh jugorë për ta ftue Ndue Gjergjin në atë mbledhje, ku i çonte të falat e Ded Gjomarkut që e ftonte në Zall Herr, e të merrte me vete të arratisun tëtjerë, ku do bahej mbledhja. Ndue Gjergji që e kishte kuptue lojën përgjigjet se po qe se Ded Gjomarkaj ka dalë në mal, vendin e parë e ka këtu në Skuraj dhe jo në Zall Herr. Kështu Ndue Gjergj nuk ra në lojën e sigurimit komunist. Por sigurimi arriti që me Dedën e rremë të kapi një pjesë të mirë të arratisunve të Shqipnisë Mesme. Nga sa u tha kuptohët fare qartë, se Ndue Gjergji njihej si brenda vendit ashtu në mërgim si i arratisuni ma i randësishëm e veprues. Ai ndër të tjera e ndiente veten krenar që ishte nip i gjeneralit të famshëm Prenk Pervizi, shembullin e të cilit do të ndiqte dhe ai. Kjo thanje vjen nga oficeri i sigurimit Mark Dodani, që si mirditas i njihte mirë të arratisunin e dinte t'i vleresonte në aspktin e vërtetë të tyne. Në librat dhe intervistat e tij, Mark Dodani, pavarësish se komunist e oficer i sigurimit, ka ditë të vlerësojë edhe kundërshtarët dhe armiqt e regjimit pa ofendime e sharje, por duke rreshtue ngjarjet e fakte siç kanë ndodhun. Ai nga ana tjetër kishte respekt për Prenk Pervizin, se një oficer me pregatitje të lartë dhe cilësi burrërore. Përfundojmë, duke nënvizue se Ndue Gjergji përveç se luftëtar e udhëheqës luftëtarësh, ishte edhe një poet i talentuem, që edhe në gjëndje mali, kishte krijue disa kangë rapsodfike, të regjistrueme e te ruejtuna nga patrioti Pjetër Kadeli që kishte ndejt do kohë në mal me të. Pjetër Kadeli, të cilin e takuem më nëndor 1992 në New York na dorëzoj një bllok ku kishte shënue ato kangë që janë botue në revistën Kuq e Zi etjerë organe shtypi në kohën e demokracisë.

.

Nipat e Gjin Pjetrit e te Gjeneral Prenk Pervizit shkruen faqe të lavdishme heroizmi në rezistencën kundër diktaurës komuniste si Luftëtarë, Heroj e Martirë të Lirisë.

.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Libraria Peppo-Kote ku, Gjeneral Prenk Pervizi, u takua me djemte e tij, Genc e Lek, më 6 shtator 1946, prej ku filloj aksioni i arratisjes së tij. E çuditshmja është se Gjeneral Prenk Pervizi do të vdiste pikërisht me 6 shtator 1977, 31 vjet më vonë.

Për dijeni, e gjithë ndërtesa ishte pronë e patriotit korçar, Thoma Katundi. Libreria poshtë ishte e shtëpisë botuese italiane Marzoko (Marzocco). Sipër saj ishte klinika dentare e dentistit armen Markarjan. Në të ashtuquejtmen luftë të Tiranës, ndërtesa u dogj, por jo nga gjermanët por nga partizanët, për te tregue se luftonin. Partizanët e dogjën fillimisht librarinë italiane, si çerdhe e propagandës fashiste, nga mori zjarr e gjithë ndërtesa. Këto na i ka tregue vetëpromari, zoti Thoma Katundi, që kishte ba riparime dhe dhanë me qëra librarinë dhe disa dhoma të banesës. Me Thomain ne kishim zanë miqësi. Ai kishte jetue në Amerikë disa vjet. Mik i Fan Nolit. Kishte mbet në Shqipni prej Luftës. I ndjeri Thoma Katundi asht një nga 36 viktimave të pushkatuem pa gjyq me rastin e bombës në Ambasadën Sovjetike. Martir i Lirisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mërgim politik

1946-1977

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Lamtumirë Atedheut

Në atë fillim shtatori 1946, im atë vendosi të ndërmarrë aksionin e tij për t'u largue nga Shqipnia. Zarët ishin hedhun. Një të vendosun, një të veprue. U nis nga kulla e Nikoll Llesh Gjokës, ku u përshedet me ato njerëz besnikë që e kishin mbajtë të strehuem dhe e kishin mbrojtë aq mirë. Ai mori me vete ma të madhin e tre vllazënve, Llesh Nikoll Lleshin, e kaluen në Lestër të shtëpia e Gjin Pjetër Hidrit, nip i tyne, prej ku kontrollohej gjithë rruga, nga Laçi e tutje. Aty qëndroi një javë, për ta marrë vetën mirë nga jeta e malit. Tue gdhi dita e 5 shtatorit, u nis me Lleshin, vesh si kurbinas dhe me një palë hebe krahaqafë, ku kishte veshjën që i duhësh për atë aksion e disa bomba dore. Në brez revolverin "Browning". E morën rrugën në kambë, njëni pas tjetrit, Lleshi përpara dhe im atë pas tij, për një far sigurie, sa të kalonin Zhejën e Mamurrësin, ku Lleshin e njihnin, përveç miqësisë edhe pse atje kishin disa rranjë ullijsh, ku vinte e shkonte për t'u përkujdesue për to. Qarkullimi me makina atëhere ishte i rrallë, dhe lëvizje të pakta. Kur arritën të Ura e Zezë, e lanë rrugën kryesore duke marrë rrugën e dytë që qonte drejt e në Tiranë, nga ana tjetër dhe jo nga Vora, që i binte ma gjatë. Në këtë drejtim ecnin plot fshatarë të tjerë, për pazarin e s'enjtës që mbahej në Tiranë. Kështu të përziem me udhëtarë dhe duke ecun rregullisht e pushue nga pak e duke ndezë nga një duhan, arritën pasdreke në afërsi të qytetit. Aty pushuen nën hijen e një peme deri sa u afrue mbramja, ku im at u nda prej Lleshit tue e falënderue për gjithçka kishin ba për të, e tue sigurue që të mos shqetësohëshin, sepse do t'ia dilte në krye asaj nisme. Ai kishte zgjedhë ditën e mërkurë. Atë natë do rrinte te një familje mike, ku do t'informohej për ne, që t' nesërmen, e enjte e ditë pazari, të mund të qarkullonte pa ra në sy.

Mbërriti të rruga e Pishës, e u ndal para derës së madhe të shtëpisë së Bedri Toptanit. Lëshoj një vështrim përreth, asnjeri. Trokiti me dorëzën e hekurt. Nuk vonoi dhe dera u hap dhe u duk i biri i Bedriut, Salit, që e njohu në vend dhe e bani me hy menjëherë duke i hedhun edhe ai një vështrim rrugës mos kishte njerëz. Askush. Kur im atë hyni në dhomën e ndejës, aty gjeti zojën Nadiré me të bijën Denin, e djalin e vogël, Uranin, që fillimisht i kapi frika kur e njohën. Im atë u përfal me to, që ishin shumë të emocionueme duke e pa të katandisun ashtu si fshatar, ate që kishte qenë një njeri i shquem e i nderuem, mik i madh i familjës tyne. Si e morën veten nga tronditja, menjëherë u vunë në lëvizje për ta pritë e nderue siç duhej. Deni i përgatiti

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

banjon dhe ia pastroi rrobat.

Zoja Nadiré, shoqe e ngushtë e mamës sonë, mundohej ta përmbante veten, aq i kishte hy frika e pushtue emocioni. Megjithatë ia shtruen bisedës, dhe im atë u informue se ku mund të na gjente. Unë punoja te libraria Kote-Pepo, ish libreria Marzoko në hymje të rrugës për në ish shkollën "Nana Mbretneshë", ku vinte dhe Genci. Ndërkaq Saliu, dy vjeç ma i madh se unë, kishte dalë me kontrollue përjashta dhe u kthye duke i qetësue të vetët se s'kishte pse të merakosëshin, askush nuk mund të dyshonte se në shtëpinë e tyne ishte strehue gjenerali Prenk Pervizi. Për atë natë gjithçka shkoi mirë. Pritja e kujdesi i miqve ishte në naltësinë e duhun. Im atë bani një gjumë të rëhatshëm, po në atë krevat ku kishte fjetun dikur, ku kishte banue do kohë, deri sa zuni një shtëpi aty afër. Miqësia me Toptanët ishte e kahershme dhe historike. Gjithashtu me familjen e Petrelëve, ku zoja Nadire ishte bijë. I ndjeri Bedri Toptani ishte vellai i Nanës Mbretneshë e bashkë me Muratin, Avdiun, Fuadin dhe Refat Toptanin, ishin miq të Gjin Pjetrit, e kishin bashkëpunue me të në kryengritjen e Kurbinit. Gjithë këto rrethana e banin atë vizitë kuptimplote, sepse vetëm aty im atë e dinte se do të gjente mirëpritje e besnikëri të madhe. Kaloi nata, dhe të nesërmën, andej nga ora dhjetë, kur kishte fillue lëvizja e fshatarëve që vinin me ba pazar, ai u nis prej rrugës së Pishës, i ra përmes pazarit dhe u shmang te rrugica që çonte drej e te libraria. Kur kishte mbërritë aty, ishte ndalue para vetrinës së librave në gjuhë të hueja, ku na kishte dallue mue dhe Gencin, që për fat ndodhej aty e po lexonte një gazetë. Këtu fillon ajo aventurë e rrezikshme. Kur e pashë atë fshatar kurbinas, që po shikonte në vetrinën e librave të huej, thashë me vedi, ç'don ai katundar aty ? Kur ja, katundari ngre kokën dhe mi ngul sytë. Baba ! Në çast ai ma ban me sy e kokë nga Genci e shkon drejt çezmzes përballë librarisë ku ulët, gjoja me pi ujë. Unë i kthehëm Gencin me za t'ultë:

- Genc, baba ! Te çezmja.

Genci e len gazetën e fill e në derë, ku rrin në pritje. Im atë kthhet e kalon para tij duke i shushurit:

- Më ndiq, pesedhjetë.

Genci u kthye në librari dhe e përshëndeti zoti Lambin siç bante çdo herë, për mos me ngjall dyshim. Pastaj iu qep babës mbrapa deri në kodrat e Saukut, pak përtej shtëpisë ku banonim. Gjithë këto vjeprime po kryhëshin nën hundën e spiunëve që rrinin vazhdimisht përtej rrugës, t'ulun në murin e lulishtës përballë librarisë. Apo nuk ishin mbledhë nja katër atë ditë, por për fat po merreshin me fiqtë që ia kishin ble një fshatari në kalim. Unë i kotrolloja nga libraria. Asgja. Në këtë ngjarje, ishte hera e fundit që unë e shifsha babën, si para vetrinës ashtu kur kaloi mandej librarisë me hebet krahaqafë. Guximtarëve u prin fati. Dhe vërtet ashtu po ndodhte.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

S'vonoi në çerek ore, kur ia behu në librari Sali Toptani, krejt i shqetësuem, që m'u afrue te banaku e me kujdes më pyeti, si shkoi puna.
I tregova me pak fjalë. Ai u qetësue e me tga.

-Sa doli Prenka prej shtëpisë, unë me një revolver në xhep u nisa, nga frika mos i ndodhte gja, e dilte sikur ne besë time. Saliu tregoi kështu atë fisnikëri që e nderonte familjën e tij. E sigurova se im atë do të strehohej shumë mirë dhe se do ta njoftoja për çdo gja. Ai u largue i qetësuem.

Tani të kthehëmi në ngjarjën. Si shkoi puna ma gjatë ? Një aventurë e vërtetë, subjekt për film.Te kodrat e Saukut, ku u takuen pas disa pemëve e ferrave, jo larg nga banesa ku rrinim, im atë dhe Genci sajuen planin e veprimit. Duhej gjetun nje strehim, sepse tek ne nuk ishte e mundun. I vetmi vend do t'ishte te shtëpia e Llesh Gjeçit në Sauk, nja 100 metra përtej Pallatit Brigatave. Vërtet se kishte plot roje, por ato ishin në shërbim të Pallatit. Banesa ishte e izolueme, me një kopsht të madh përpara. Por për këtë punë duhej takue Ndou djali i madh i Lleshit, që punonte pranë ATSH, si daktilograf. Ndou ishte shok e mik i ngushtë ynë. Familje mirditore, ku besa ishte e shejtë. Genci i thotë babës të priste aty nën hijën e disa ullijve, deri sa të kontaktonte Nduen. Kështu u veprue. Genci shkon e takon Nduen të cilit i thotë si qendron puna. Ndou menjëherë pranon, por nuk mund të lëvizte prej aty para orës gjashtë. Largimi tij mund të binte në sy. Genci të priste te libraria, ku ai do të kalonte me e marrë për me shkue me takue babën te ullijtë, pastaj fill e te shtëpia e tij. Ky ishte një sukses i madh. Gjetja e strehimit ishte gjysma e punës. Askush nuk mund të dyshonte se Prenk Pervizi, ndodhej aty, për deri sa kërkohej ditë e natë në Skuraj e rrethina. Po im atë ç'bante gjatë kësaj kohë ? Duke prit aty, i shkon mendja mos vall mund të mësynte Qazim Zymën ish majorin e gardës, mik i tij e njeri i ndërshëm. Se nga i erdhi ai frymëzim zoti e di. Ndoshta nga fakti që ajo banesë ishte krejtësisht e izolueme e larg banesave të tjera, aty përballë stadiumit. Paraqitet para shtëpisë së majorit, dhe therret alla shqiptarshe:

- O i zoti i shtëpisë, a doni qymyr ?

Zoja e majorit, Nuria del në verandë, që baba e njihte mirë.

- Hej, shoko, ç'kërkon këtu, kush të thirri ?

- Mirëdita zojë. Unë prodhoj qymyr të mirë, dhe e shes me leverdi. A doni të ju bie një sasi ?

Zoja Nurie e kishte shikue me çudi fshatarin. Ç'ka që paska, sikur e kishte dëgjue diku. Por e nervozueme për shqetsimin i foli vrazhdë:

- More shok nuk te ka kërkue kush qymyr që vjen e na shqetëson në pikë të zhegut.

- Me falni zojë. Ditën e mirë, ia kishte kthye baba, duke u largue.

Ndërkohë, aty afër, pranë rrugës, Ibasanin, banonte Marta Doda,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

kushërina e mamës por edhe e babës, me të cilën ishim lidhë me miqësi të madhe. Marta banonte vetëm me vajzën e saj Frida. Ajo njihej edhe si Marta e Preng Pashës, sepse Preng Pasha (Preng Bib Doda), që s'kishte fëmijë dhe e kishte mbesë, e kishte marrë si bijë në shpirt. E kishte shkollue jashtë shtetit, në Francë e Itali. Grue intelektuale, me përvojë të madhe jetësore, e lidhun me miqësi të madhe me Francën, qyshë në kohën e Preng Pashës. Vazhdimisht në kontakte e vizita me Ambasadën e Francës në Tiranë, që e kishte nja 100 metra ma larg, përballë Ambasadës amerikane. Shtëpia e saj ishte një muzeum i vogël sendesh antike të trashëgueme nga Preng Pasha. Ajo kishte qenë e martueme me doktor Sadedinin me të cilin kishte atë vajzë, por ishte nda prej tij. Në këto kohë doktori kishte ra n burg i denuem 10 vjet prej komunistëve.

Nanë e bijë e pritën babën gjithë t'emocionueme e nuk i përmbanin lotët, kur e panë ashtu të transformueme në fshatar. Ai u tregoi se ishte nisë me kalue jashtë shtetit, dhe a do t'ishte e mundshme me njoftue Ambasadën franceze, se mos gjente mënyrën për me e nxierrë me anë të trupit diplomatik. Qendroi aty sa me pi një kafe sade e thithë nja dy cigare "Kamel" që shitëshin në dyqanin e valutës. U largue pa ra në sy, që nuk kishte kalimtarë dhe u kthye te ullijtë ku Genci i kishte thanë me prit. Por aty nuk e ndjente veten te qetë, se qarkullonin mjaft ushtarë të mbrojtjës e disa kishin ardhë edhe aty nën hijen e ullijve. U çue dhe drejt e te shtëpia e Llesh Gjeçit, ku e priti lehja e një qeni, dhe duel vetë Lleshi te dera. Im atë i thirri nga sgara e kopshtit:

- A pret miq or Llesh Gziqi ?
- Hajde burm or burrë !

Kur baba u afrue me u përfalë me të, Lleshi e njohu :

- Ti zoti gjeneral ? Mirësevjen në shtëpinë time, e i prini brenda, ku u prit si një mik i nderuem. Zunë vend me Lleshin në dy anët e oxhakut tuj ia shtrue muhabetit me raki, duhan e kafe, për shtatëpalëqejfe. Robt e shpisë u mobilizuem për këtë mik të rrallë, në një kohë aq të frikshme. I biri, Gega, rrinte si roje për çdo rast.

- Je i mirëpritun zoti Gjeneral, dhe mos u shqetëso fare, se pushkë, fishekë e bumje kemi boll. Apo nuk jemi veç 100 metra larg Pallatit të Brigatave, plot roje t'armatosuna deri në dhambë.

Dy miqt e ndjenin veten rehat me zotin, sikur s'kishte as një lloj rreziku që t'u kanosej. Ndërkaq Ndou që kishte mbarue punën erdh deri te libraria ku e priste Genci dhe së bashku u nisën për në Sauk. Kur mbërritën te ullijtë, s'gjetën njeri. E kuptuen se baba e kishte msy vetë shtëpinë e Lleshit. Si arritën atje, mbasi Ndou u njoh dhe u përfal me babën, e shtruen çeshtjën. Problemi ishte se nuk kishte asnjë mënyrë tjetër për me arrit deri në kufinin grek, përveç ndonjë shoferi besnik. Pra duhej gjet një nga ish shoferat e tij, që punonte me makinë, që ta përciellte deri në kufi. Dolën dy emna, ai i korçarit

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Llazi Sterjo, dhe i dibranit Qemal Lika, që punonin akoma si shoferë. Llazi vinte e shkonte nga Korça e takohej vazhdimisht me ne. I binte me kalue rrugës Elbasanit, e nganjëherë ndalohej te libraria, ku zakonisht me gjente mue dhe me merrte me më qeras në ndonjë pastiçeri. Unë isha ma i vogli i familjës, dhe me Llazin kisha udhëtue disa herë për punë e për qejf. Llazi asokohë flinte në shtëpinë që kishim zanë me qëra, në kodrën e Fuad Beut. Im atë vendosi për Llazin, që e bante vazhdimisht rrugën e Korçës dhe e njihte atë zonë kufitare. Po ku me e gjetë Llazin ? Kjo punë m'u ngarkue mue që të kisha kujdes mos e shifsha tue kalue aty së pari me kamionin e kuq Fiat 26, i vetmi që punonte atë rrugë. Kamioni ishte i familjës Demir Alizoti, që bante transport mallnash për hesap të tregtisë shtetnore. Kaluen tre dit e Llazi nuk dukej gjëkundi. Ditën e tretë që unë kisha dalë për një porosi të zotit të librarisë e po ecja në rrugën e sahatit, me kalon një kamion aty pranë e dëgjoj një za që therret emnin tim : Leka... Leka! Llazi ! Makina ndalet disa metra ma tutje. U përqafuem.

Menjëherë e njoftova për babën. Ai, në vend që të friksohej, u gëzue së tepërmi. I tregova dhe se ku gjendëj.

- Do ta takoj patjetër. Por me duhet me shkue me shkarkue mallin, pastaj shifemi me Gencin në ora tetë te Kafe Sahati.

Kështu ndodhi dhe bashkë me Gencin drejt e në Sauk, ku ai u përqafue me komandantin e dashtun. Nuk përshkruhet emocioni e mallëngjimi i tij. Llazi ishte një njeri shumë zemërmirë dhe i dashtun. U shtrue problemi e Llazi e mori përsipër pa hesitim. Veç i duhej të bante një rrugë me mall për në Korçë dhe vetëm pas tre ditësh ishte në dispozicion. S'mund ta merrte në këtë rrugë se kishte njerëz që shoqnonin mallin. Ashtu u la. Gjatë atyne tre ditëve qetësi. Qendrimi te shtëpia e Llesh Gjeçit i shërbeu babës me marrë vesh gjithë tmerret e terrorit komunist në Tiranë. Gjithë kolegët e miqt e tij, ushtarakë e civilë, personalitete e figura të shqueme të shoqnisë shqiptare, një pjesë i kishin pushkatue, të tjerë toturue e pllakosë në burgje. Një katastrofë. Një absurditet.

Pas tre ditëve Llazi kthehët e me takon në Librari. Po atë mbramje fill e në Sauk me Gencin, ku u përcaktue plani. Por komandanti i tij duhet të dilte diku në rrugën e Elbasanit. Kjo punë u zgjidh me atën e një mirditori tjetër, Ndue Pjetri, mik i Lleshit e burrë besnik, që banonte të Mullini i Farkës, ku kalonte xhadja. Mirë fort. U trasferuen atje, natën përpara. Të gjithë : Lleshi me të bijtë, Nduen, Gegën e Pjetrin, Genci dhe Ndue Pjetrin i zotin e shtëpisë. Të armatosun me pushkë, revole e bomba dore. Këto i kishte siguru Lleshi që i mbante të fshehuna në shtëpi. Nuk i duhej. Në mengjes herët vinte makina, dhe im atë duhej të dilte në rrugë me kërkue një kalim, si një xhaxho fshatar që po shkonte me takue djalin e tij ushtar në Korçë. Banesa e Ndout ishte afër

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

një reparti të forcave të ndjekjës e kishte lëvizje oficerësh që shkonin e vinin. Doli drita dhe erdhi ora e caktueme. Fshatari del buzë xhadës në pritje. Oficerët që kalonin e përshëndesnin:

- Mirëmëgjes xhaxho, je nisur për te djali ushtar ? Mos u merzit se ka makina. Hajt udha e mbarë !

Po hiqej valle në gojë t'ujkut siç do ta thoshte një kangë e mavonshme, por për tjetër kuptim. Kur ja nga kthesa poshtë duket turini i një kamioni të kuq. Llazi ! Fshatari ngre dorën. Makina ndalet.

- Për ku xhaxho ?
- Për në Korçë ku kam djalin ushtar.
- Hyp !

Këto fjalë u shkëbyen se aty po kalonin disa ushtarë. Fiati i kuq 26 u nis me shpejtësi duke lshue pluhn mbrapa. Miqt tanë që po e ndiqnin skenën nga larg morën frymë. Gjithçka po shkonte si s'ka ma mirë. Ndue Pjetri u poqi kafe e u shtroi rakinë për gëzimin e kësaj punë që u krye pa pengesa. Një mrekulli.

Si shkoi udhëtimi ? Llazin, që atë rrugë e bante vazhdimisht, e njihnin gjithë postoblloqet qe ruhëshin akoma nga partizanë. Sa vinte makina e tij, dyreku ngrihej e Llazi u hidhte dy tri paqeta partizani duke shkëmbye shaka me oficerin e rojës. Kështu ndodhi edhe kësaj radhe, me një shtesë, sepse e pyesnin,

- Po ky xhaxhoja ku shkon ?
- Ore, po të takojë djali ushtar, e ku do shkojë ?
- Udhë e mbarë !

Kështu arrtën pa telashe në Korçë dhe im atë e porositi ta çonte në Zemblak te shpia e Kullajve, ku kishte miqësi të fortë. Një t'arritun aty, ai shkon drejt te dera e katit përdhes të shtëpisë. Ai e njihte mirë atë banesë. Ndërkaq dallon lëvizje ushtarësh e oficerësh. Dera hapët dhe i del para një djal i Gani Kullës, që e njohu.

- Zoti gjeneral ku vete kështu ? A nuk e sheh ç'bëhet ? Ganiun e kanë pushkatuar dhe shtëpinë sipër e kanë bërë komandë të forcave kufitare. Ne na kanë lënë poshtë he për he, por me siguri do të na hegin. Largohu shpejt që këndej se je në rrezik. Shko në Bilisht ku e njeh mirë vendin. Vetëm atje mund të ia dalësh. Paç fat !

Llazit i kishte hy frika. Si shkon komandanti i tij ashtu esber midis oficerëve të sigurimit ? Apo nuk i flisnin:

- He xhaxho, kërkon djalin ushtar ?

Im atë i tha Llazit që ta çonte deri në zonën e Bilishtit afër rrugës së Kapshticës ose Folorinës. Ai e njihte mirë atë zonë ku kishte zhvillue operacione ushtarake. Djali i Gani Kullës e kishte këshillue mirë. Aty do ta

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kalonte kufinin.

Llazi e ndaloi makinën në një kthesë, gjoja për një difekt në motorr. . Im atë kishte hypë në karocerinë e mbulueme ku kishte hequn teshat fshatare e veshun rrobat që kishte në hebet. Kur doli para Llazit, ky u hutue. Xhaxhoja ishte kthye në një gazetar të huej. Me patallona kilote, këpucë me qafa me lidhëse. Bluzë të hirtë me xhepa. Dylbi e aparat fotografik. Çantë dokumentash. Kasketë. Syze dielli, që i hoqi e futi në xhepin e bluzës.

U përqafue me Llazin që nuk i përmbante lotët, duke i thanë:

- Mos u shqetëso Llazi, brenda dy orëve e shumta, unë jam matanë. Gjallë nuk më kap kush. Kam revolverin dhe disa bomba dore. Lamtumirë e të fala gjithë miqve që më dolën zot në këtë ditë të vështirë. Mi përqafo djemtë dhe nanën e gruen po mujte. Ndoshta vjen një ditë që të shifemi prap. Lamtumirë !

Kishte ra nata kur ai u nis nëpër shkurret e pemët. Ai u zhduk në errësinë nga sytë e Llazit, i cili qëndroi aty në pritje që të kalonte koha e mos ndodhte gja. Për fat, nuk kishte qarkullim makinash, që asokohë ishin shumë të pakta në Shqipni. Ai i mori plaçkat fshatare dhe i futi në një gropë aty pranë, duke hedhë do shkurre sipër. Kot, si për inerci.

Kaluen dy orët pa ndodhun asgja. Atëhere ai mori rrugën e kthimit për në Korçë, ku atë natë nuk e zuni gjumi. Të nesërmën qarkulloi nëpër disa lokale mos dëgjonte gja. Hiç. Mori dhe një gazetë. Asgja. Kaloi dita dhe nata tjetër. Duhej të nisej për Tiranë. Para se të nisej u ul në një lokal ku porositi një kafe e një fernet. Aty ishte një shok i tij i rinisë, i cili iu afrue te tavolina e i foli me za t'ultë:

- Ore Llazi, a e ke marrë vesh ? Ai komandanti yt, gjenerali Prenk Pervizi paskej dalë në Greqi. E tha mbramë radio e Folorinës, ku kishte dhanë edhe një intervistë, e kishte folë zi e ma zi për qeverinë tonë.

- Ashtu? Po habitëm fare. Po a nuk ke frikë që dëgjon radion greke? Mos vallë mashtrojnë e genjejnë.

- Ik or burrë ! A jemi a s'jemi shokë. Ty po ta them, se jemi miq dhe e ke pasë komandant.

Llazi si mori lajmin fluturoi në Berat, ku takoi gjyshën tonë, mamën dhe Valentinin, të cilin, nga burgu i Shkodrës e kishin internue në Berat. Ata u gëzuen së tepërmi, veçanërisht gjyshja, tashma 85 vjeçe, që gëzohej për shpëtimin e të birit.

Prej aty, Llazi erdhi në Tiranë, fill e në librari, ku më mori e më qerasi për këtë ngjarje tashma të shkallës lëgjendare. Të gjithë e gëzuem nga ky sukses, u mblodhëm të Llesh Gjeçi për ta festue me raki e meze. Kjo ishte pak a shumë e gjithë ngjarja që u zhvillue nën hundën e sigurimit e te qeverisë komuniste.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Siç ndodh në Shqipni që çuditërisht merret vesh çdo gja, u fol se kur Enveri e mori vesh atë punë, kishte thirrë Koçi Xoxën, duke i folun randë për këtë mungesë të madhe vigjilence.

- Si, or shoku Koçi, të na kalojë Prenk Pervizi nën hundë ? Të shkarkohën gjithë oficerët e sigurimit kufitar të zonës Bilishtit. Maskarejtë ! E të shikohet e të kapën e dënohët ata që e kanë ndihmuar e përkrahur.

Ky ishhte tregimi i arratisjes së Prenk Pervizit, që u përhap anëmbanë e u ba lëgjendë. Këtu mbyllet periudha kur ai jetoi e punoi në Shqipni.

Por do të kthehëmi pak mbrapa, për me tregue se kishte edhe të tjerë që ishin të interesuem e të vendosun për me e nxierrë babën në Greqi.

Një prej tyne ishte ish shoferi shkodran Kol Prela, që kishte ba luftën e grekut me babën, ku im atë pas kapitullimi të Italisë e kishte marrë prap shofer n'ushtri me gradën kapter. Kola vlerësohej nga shoqnia si një ndër shoferë ma të mirë, sa që kur hypnë në fuqi komunistët, udhëheqësit e morën si shofer të tynin. Ndodh që Kola udhëton për në Shkodër me Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxën. Gjatë rrugës duke bisedue, Koçi e pyet se ku kishte punue si shofer ma përpara. Kola, pa hiç drojë, i përgjigjet se kishte qenë shoferi i Gjeneral Prenk Pervizit. Kishte ndërhy Enver Hoxha:

- Po si or Kolë nuk e hodhe Prenk Pervizin në ndonjë humnerë ?

Kola ishte përgjigjë si pa të keq :

- Po ta kisha ba atë punë, ju nuk do të më kishi marrë kurrë n'e kurrës për shofer tuejin !

Sa i dhanë fund atij udhëtimi, e hoqën nga ajo punë dhe Kola mori një veturë dhe e punonte si taksist. Këtë ndodhi na e tregonte vetë Kola, kur na takonte në Tiranë. Sa herë që vinte me na pa, na kerkonte që t'i çonim fjalë babës në mal, së Kola ishte i gatshëm me e përciell në Greqi.

- Përderisa kam vendosë me hik vetë, pse mos ta marr dhe gjeneralin ?

Ne nuk e kishim atë mundësi kontakti me babën në mal. Kështu Kola vendosi me ikë, dhe në një rast që përcolli disa fuksionarë të partisë për në Korçë, duke e njohun mirë terrenin e Bilishtit nga koha e luftës italo-greke, kishte gjet një vend afër kufinit ku kalone një perrue. Një ta kalue atë megjithë makinë, dhe rrugë pa rrugë kishte kapërcye matanë në xhaden e Folorinës ku kishte arritë shëndosh e mirë për habinë e grekëve se si kishe mundun me kalue ashtu me gjith veturë rrugë pa rrugë. Ma vonë Kola ishte takue me babën në Greqi. Pastaj se si kishte ndodhun e ishte martue me një maqedonase, dhe kishte kalue në Maqedoni, në Shkup, pa pasë trazime, ku kishte jetue e vdekë, i respektuem prej të gjithë shqiptarve që e njihnin dhe e respektonin si shofer i gjeneral Prenk Pervizit. Të gjitha këto ne i morëm vesh kur dolëm në Belgjikë, prej ku unë shkova në Maqedoni i ftuem prej disa miqve e ku i mora vesh të gjitha sa thashë ma nalt për Kol Prelën.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Se si im atë arriti të kalojë kufinin nuk kishte si ta merrnim vesh. Ma vonë, nëpërmjet disa personave që, të gënjyem nga propaganda komuniste, ishin kthye nga Amerika, na erdhen lajme të ndryshme. Nga ana tjeter im atë na kishte thane se për t'u marrë vesh me ne, do të përdorte pseudonimin Aleksadër Rubin. Kështu ndodhi që pas një muej n'adresë të zojës Marta, erdhi një kartolinë nga Praga, dergue nga ky Aleksander Rubin, që uronte Krishtlendjet dhe shkruente se ishte mirë me shëndet e me punë. Në Pragë im atë kishte miqt e tij të vjetër, me te cilët ishte lidhë menjëherë. Me këtë kartolinë na linte me kuptue që të mos shqetësohëshim për të. Ai ishte i vetmi lajm që na erdhi prej tij. Sigurisht se çenzura komuniste nuk linte me kalue asgja, për familjet e përsonat që ishin në listat e zeza, të specifikuem si reaksionare e te prekun, aq ma keq t'internuem e të burgosun. Sigurimi kishte dëpërtue kudo e kontrollonte jetën e sjelljet e njerëzve. Ata mburrëshin se e dinin se ç'ziente nën kapakun e vorbës në çdo votër shqiptare.

Si thamë, për rastin e arratisjes së babës, u ba alarm e çeshtje në organet e Ministrisë së Brendshme. Pati shkarkime në komandat kufitare. Në Zemblak të Korçës u arrestuen e denuen disa pjestarë të familjes Kulla, të akuzuem se e kishin ndihmue arratisje e gjeneralit, mik i shtrejtë i Gani Kullës, të cilin e kishin pushkatue. Faktikisht, Kullajt nuk ishin implikue në atë arratisje. Por duke e ditun se im atë kishte miqësi të fortë me Gani Kullën, kryetarin e fisit, me deshmitarë të rremë e me tortura, sigurimi kishte krijue një proçes fallso, ku një prej djemve të Ganiut hangri 10 vjet burgun e Burrelit dhe gjithë familja Kulla, burra, gra e fëmijë u internuen në kampet e ndrysme gjatë gjithë kohës së diktaturës. Mbi ta pështone dhe fakti se aty kishte pushue Mbreti Zog para se me dalë në Greqi më 8-9 prill 1939 ku ishte takue me prindin tonë, të cilit i kishte besue organizimin e kalimit të tij në Greqi. Pra Kullajt përsekutohëshin edhe si një familje e randësishme zogiste. Çeshtja e arratisjes se babës mbeti mister e u duk se u mbyll me aq. Kur papritun në muejin janar 1947, u arrestuen njeni pas tjetrit ata që ishin implikue në atë aksion: Zoja Marta Doda, Ndue Lleshi Gjeçi, vllai im Genci dhe shoferi Llazi Sterjo. Si ndodhi kjo? Thjesht për një gabim trashanik të famulltarit të Tiranës, Dom Shtjefën Kurti, të cilit iu gjet në regjistrin e meshëve, shënimi : - Meshë për Prenk Pervizin, prej zojës Marta Doda, 200 lek.

Një t'u arrestue zoja Marta, dhe fill pas saj të tjerët. Hetuesia prej gjashtë muejsh në birucat e sigurimit bani të vetën dhe ata u denuenme nga 10 vjet. Ata patën kurajon e vendosmerinë mos me implikue askënd tjetër në atë punë, e kjo ishte nje meritë e madhe e tyne, që pësuen tortura mizore për të përfshi edhe të tjerë. Unë që shkruej, shpëtova kot gjoja si tepër i ri për me më besue, sikur vllai im Genci më kishte paraqitë, të tjerët po ashtu. Ndërsa

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

unë isha kambë e kokë i përfshimë në atë ngjarje. Ja pra ç'ban vendosmënia e shqiptarit, kur ia kërkon besa e burrnia. Jo që, për arratisjen e babës kishte të tjerë që e dinin dhe kishin kontribue e deri dhe takue e bisedue me të. Si familja e Toptanëve, e mirditori Ndue Pjetri. Asnjë emën nuk doli. Ky asht një rast unik, ku i gjithë aparati shtetnor e veçanërisht ai i Ministrisë Brendshme nuk qenë në gjendje me e diktue arratisjen e t'im etit, që për më tepër kishte qendrue ma se 10 ditë i strehuem në Tiranë, duke u tallë me vigjilencën e organëve të sigurimit e duke kalue nën hundë e tyre, siç ishte shfry vetë diktatori.

Ndërsa ne Kurbin, në Malsinë e Lezhës dhe në zonën e Mirditës kufitare me Skurajn, operativët u kishin thanë njerëzëve që kishin lidhje gjaku me ne, se tashma, që Prenk Pervizi ishte arratisë në Greqi i kishin shpëtue rrezikut t'arrestimit e denimit për shkak të tij.

Pasojat e kësaj ndërmarrje të guximëshme, ranë vetëm mbi ato të katërt që përmendëm. Ndërsa unë vazhdoja të punoja te libraria i pashqetësuem. Një ditë shkoj me u qethë dhe me ra si berbër i radhës, dibrani Tomini, bërberi personal i tim etit. Ai me njohu dhe gjatë qethjës me tregoi se si e kishin denue dy vjet burg, ku i kishte qëllue me ndejtë në një birucë me nja dy korçarë, me mbiemnin Bylykbashi, që kishin hy si diversantë nga Greqia, të dërguem prej Prenk Pervizit. Me porosi e letra dhe një shumë dollarësh për ne, por i kishin diktue e kapë rob në kufi. Ata i kishin tregue se im atë rrinte ne nje hotel të Athinës, ku gezonte respekt e nderime. Dhe se si ai, me shqiptarë të tjerë, si Muharrem Bajraktarin, Fiqri Dinen, Hysni Demën, Abaz Ermenit etj., merrej me organizimin e një ndërhyrje t'armatosun me rrexue regjimin komunist. Këto ishin të vetmet informata që rastësisht na vinin, për si jetonte e vepronte im atë në Greqi. Lajme të tjera erdhën nga një reportazh i gazetarit Aleks Çaçi, i cili kishte shoqnue një komison shqiptar për të asistue në marrjen ne pyetje te arratisunve shqiptarë, bullgarë, rumunë e jugosllavë, nga një komision ndërkombëtar, ku ishte i përqafuem misoni anglez në Shqipni, Koloneli Meklin, kapiteni Julian Amery e koloneli David Smiley, që kishin ndejtë në mal me babën deri në fund te tetorit 1944. Qeveria shqiptare paskej ndërhy që t'i dorëzohëshin gjithë kriminelët e luftës (siç i quenin nacionalistët) që kishin gjetë strehim në Greqi e Itali. Komisioni vepronte si gjykatë, dhe i merrte në pyetje me radhë t'arratisunit. Kur erdhi radha e Shqiptarve, Aleks Çaçi, përshkruen nje nga nië, si u morën ne pyetje, duke theksue se si Bajraktari, Fiqriu e Hysniu, flisnin me anë përkthyesish. Ndërsa Prenk Pervizi, i veshun elegant, përgjigjej direkt vetë, e që në një rast i kishte ban me qeshë ato të komisionit anglo-amerikan, që e merrnin në pyetje. Edhe Abaz Ermeni kishte folun vetë pa përkthyes. Siguruni se komisioni e refuzoi kerkesën e qeverisë shqiptare për dorëzimin e tyne. Këtë reportazh Aleks Çaçi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

e kishte nxierrë në gazetat "Zeri i Popullit" e "Bashkimi", si dhe e kishte botue në librin " Përmes Greqisë Heroike". Këto ishin të vetmet burime ku ne merrnim vesh ku gjendej prindi ynë e si jetonte e ç'bante.



Muharrem Bajraktari, Prenk Pervizi e Fiqri Dine në festën e
Flamurit e të Pavarësisë, 28 Nëntor 1952, mes shqiptarve të arratisur në Greqi,

Duhet shtue se situata në Greqi në ato vitet e para ishte mjaft e trubullt dhe e pasigurtë, prej veprimeve të komunistëve që kishin nisun luftën partizane kundër qeverisë greke e kundër forcave aleate të dislokueme aty, kryesish kundër anglezëve.

Në këto rrethana forcat komunsite kontrollonin disa zona të territorit, veçanërish ato në kufi me Shqipninë dhe Jugosllavinë, ku partizanët grekë hynin e dilnin sipas qejfit dhe furnizohëshin me armatime. Kjo gjendje kishte qenë dhe ishte e rezikshme për shqiptarët që kalonin në Greqi, pse po të binin në duer të komunistëve, këta ua kthenin autoriteteve shqiptare, siç ndodhi me ministrin Koço Kota, që e dorëzuen e i cili u denue 25 vjet e vdiq në burgun e Burrelit, që kishte ndërtue vetë kur ishte ministër i brendshëm në kohën e Zogut. Në raste të tjera, ata shqiptarë që komunistët grekë ua dorëzonin forcave të kufinit, i pushkatonin ne vend pa gjyq.

Ky rrezik qendronte dhe mbi kokën e tim eut, dhe ai e dinte dhe na kishte thanë se do ta gjente mënyrën me i shpëtue atij rrezku, siç ndodhi, që nuk pati ndonjë telashe në atë drejtim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)



Kampi i Tepelenës, që jepët në këtë vizatim të Lek Pervizi, që e përjetoi vetë atë kamp me familjën e me mija të dënuem të tjerë. Ky ishte kalvari që pësonte familja Prenk Perviizit dhe të tjera familje të patriotëve shqiptarë.

Kalvari i familjës

Siç dihet, përsekutimi i familjës së Prenk Pervizit, fillon nisun qyshë me shtator 1944, me djegien e shtëpive ne Laç e në Skuraj dhe qendrimi i fshehun në mal. Në shpëtuem mirë pa na diktue se do të na kishin eliminue në vend. Por mbas dorëzimi tonë më prill 1945, filluen masat e internimeve për ne dhe për të gjithë familjet që kishin njerëzit e tyne arratisun në mal ose jashtë shtetit, të cilëve u kishin vu vulën e armiqve të popullit, kriminela e tradhtarë. Kështu masa e internimit ra mbi mamën dhe gjyshën, që i çuen fillimisht në Lezhë, bashkë me familje të tjera të ciesueme armike e reaksionare. Unë e Genci shpëtuem kot, pse ishim në Tiranë dhe nuk e çoj kush zanin kundër nesh. Ndërsa vëllai madh Valentini i sapo ardhun nga Italia

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLEJTI" SHKODËR (2018)

u arrestue e u burgos në Shkodër qysh me dhjetor 1944, si bir i Prenk Pervizit, në shtetrrethimin që Mehmet Shehu kishte vendosë në atë qytet. Nga Lezha mamën e gjyshën me të tjerë i internuen ne Berat, që ishte caktue si qender internimi e ku u vendosën familjet ma të randësishme të veriut : Gjomarkaj, Pervizi, Bajraktari, Dine, Dema, , Kaloshi, Ndreu, Kolaj, Melyshi, Mirakaj, Merlika, Kupi, etj. Ku mbas do kohë internuen edhe Valentinin. Unë e Genci mbetëm akoma si të lirë deri kur Genci përfundoi në burg, për pjesmarrje në arratisjen e t'atit. Kisha mbetun vetëm unë, që kërkoja të mbijetoja në Tiranë, dhe përpiqësha me hy në jetën normale, që ishte vazhdimi i shkollës së ndërpreme prej dy vjetësh. Një mirënjohje e veçantë i shkon qiftit korçar Llambi Kote dhe Vrisidha Pepo që më pranuen e mbajtën në librarinë e tyne, që me vlejti si një mburoje. Si dhe të zotët e shtëpis ku banoja, Qazim e Nurie Zyma, që ndonse u banin presion, nuk pranuen kurrë që të më qitnin prej banesës e nuk me morën kurrë qera. Mirenjohja asht gjaja ma e çmueshme e njeriut.

Nuk më pranonin në asnjë shkollë, dhe disa herë që arrita të regjistrohëm më refuzuen që ditë e para, si ne Liceun Artistik ashtu ne një shkollë ekonomike dhe ne nje kurs gjeometrash. Por pas prishjes me Jugosllavinë, të gjitha fajet iu ngarkuen asaj, dhe keshtu u la një frymëmarrje për nxanësit e familjeve reaksonare qe nuk ishin pranue ose ishin përjashtue. Së pari arrita të vazhdoj gjimnazin natës, Qemal Stafa, në sajë të piktorit prof. Abdurrahim Buza, nëndrejtor, mik e admirues i prindit tim. Kështu u pajisa me një dokument shkollor, që nuk kisha si ta sjellja prej shkollës sim të Romës. Ndodhi që Liceu Artistik "Jordan Misja" i ripranoi përsëri nxanësit që kishte përjashtue me cerimoni, duke i rrahun. Unë mora zemër dhe u paraqita në konkursin paraprak që ishte shpallun, ku fitova dhe u pranova. Ndersa gjithe njerëzit e familjës edhe të mbarë fisit ishin mbyllun në burgje e kampe internimi, isha i vetmi që akoma vegjetoja i lirë, por gjithmonë si mbi gjemba. E ndodhi që edhe unë u arrestova më maj 1950 e drejt e në kalanë mesjetare të Porto Palermos, me gjithë vellain e madh Valentinin, si në Shpellën e Polifemit, por pa një Uliks që të na nxierrte prej andej. Prej aty në Tepelenë, ku u bashkuem me mamën. Gjyshja kishte vdekur, e semunë e plakë 90 vjeçe, me emnat tonë e të birit në gojë. Aty lexohej për çdo mbramje gazeta, prej së cilës morëm vesh gjyqin e Hamit Matjanit ku u fliste për Prenk Pervizin dhe kishte pasë punë me të. Gjenerali, sipas Hamitit, jetonte ne një hotel llukzos t'Athinës. Më 1954 kampi i Tepelenës mbyllet dhe gjithë t'internuemit vendosën ne rrethin e Lushnjë në disa kampe që ishin edhe sektorë të fermës Bujqësore 29 Nëndori, ku t'internuemi u caktuen me punë të detyrueshme në fushat e bujqësise e në sektorët e ndërtimit.

Në këto rrerthana jeta duhet të vazhdonte, dhe shpresat për shpëtim

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

ishin të pakta, kështu që t'internuemit filluen të krijojnë familje e të martohen mes tyne. Edhe vëllai im Genci që ishte lirue pas dhjet vjet burg, u martue me nje vajzë t'intenueme, e bija e Llesh Marashit, e radha me kalonte mue. Ndersa Valentini e kishte gruen e vet në Itali, prej së cilës i vinte ndonjë kartolinë, se letrat nuk kalonin dot. Ne këto kushte une u njoha me një vajzë të re t'intenueme që pothuej ishte rritë në mesin tonë qysh kur ishte një fëmi në kampin e Tepelnës, ku e kishin mbyllun me t'amën qyshë në moshën e njomë katër muejshe. Duke qenë se në atë kamp ra një semundje e randë epidemike në formë kolere, shumë fëmijë e pleq vdiqen, dhe ajo vetë shpëtoi kot dhe duke qene se e ama, Zorka, ishte malazeze, iu ngatërrue emni dhe bebe ketu e bebe atje, e i mbeti emni Beba. Emni i vërtetë Gjuliana, doli kur mbushi 15 vjeç dhe u pajis me letër njoftimi. Por emni Beba nuk iu hoq ma dhe kështu e njihte e gjithë shoqëria. Ndodhi që në u afruem, u deshëm dhe u martuem, ku u bamë me tre fëmijë, djem. Vellai, Genci, martue me të bijën e Llesh Matashit, Albina, u ba me katër djem e dy vajza. Keto ishin rrethana të diktueme nga gjendja e pa shpresë, ku pas vitit 1958 të iinternuemit filluen të martohën midis tyne. Sidoqoftë internimi nuk na hiqej nga kurrizi. Në këto rrethana ne patëm edhe humbje njerëzore, si gjyshja 90 vjeçe në Tepelën më 1950, mama 77 vjeçe në Pluk të Lushnjës, më prill 1977, baba 80 vjeç në Belgjikë më shtator 1977, një femijë e Gencit më 1960. Genci 63 vjeç në kampin e Gradishtës më prill 1989. Në Tepelënë kishin vdekur edhe disa kushrij tonë, Gjin Pali, nip i Gjin Pjetrit, e shoqja e kushrinit Preng Lleshit (vra në mal), me të bijën më 1948 në Berat dhe dy gra të kushrijve në Tepelenë me dy fëmijë të tyne. Pastaj tetë burra u vranë në përpjekje në mal. Me dhjetra të tjerë, kushërij tonë, të burgosun. Gjhithsejt 23 viktima. Një katastrofë. Ky ishte haraçi ose ma mirë me thanë, flijimi që i bahej idhullit të komunizmit nga familja jonë. E pamë t'arësyeshm të paraqesim shkurtazi se si u trajtue familja e Prenk Pervizit, pa i pasë ba asnjë të keqe askujt krejt të pafajshëm.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Shtëpia "kulla" e Prenk Pervizit në Laç, që u grabit dhe u dogj nga një brigatë komuniste partizane më shtator 1944, foto ne gjendje të rindertueme më 2002.

Si vinin lajmet

Ne nuk do të kishim marrë vesh asgja për prindin tonë kur ai kaloi në Greqi, por ja që rasti i krijon mundësitë, dhe asht më të vërtet për t'u tundtë.

Siç ishim të mbyllun në kampet e Tepelenës, Porto Palermos, Shtyllazit e Kuçit të Vlonës, ku nuk kalonte asnjë fjalë nga jashtë, ne, as që mendonim se do të na vinte ndonjë lajm prej tij, dhe jo ma me marrë vesh se si asht me shëndet, ç'ban e si e kalon, me kë rri, ku udhëton e shkon, etj.etj.

Kur na transferuen në kampet e Lushnjës, kontakti me njerëzit ishte ma i mundshëm. Ma e bukura ishte se shefi i degës i Lushnjes, koloneli Nuçi Tira, kur na mblidhte çdo tre muej në kampin e Savrës për me na mbajtë konferenca, nuk kishte rast pa përmendë babën tonë, duke tregue se si ai punonte kundër vendit e bashkëpunonte me anglo-amerikanët, duke ba nje jetë luksosze mes Athinës. Se si kishte shkue në Itali, ku kishte krijue Komiteti Shqipëria e Lirë, e takohej me kriminelët e tjerë si Xhef Palin, Muharrem Bajraktarin, Mehdi Frashërin, Ernest Koliqin, Gjon Markagjonin, e të tjerë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Prej fjalimeve te tij në mbledhje të tjera morëm vesh ma në fund se si ai kishte kalue ne Belgjikë dhe ishte fut në shërbim të imperializmit amerikan e te Natos. Nuçi Tira siduket e kish pas njohun babën tonë që kur ishte në Tiranë, në kohën e gjermanëve, ku kishte hy në punë në zyrat shtetnore, si agjent i fshehun i komunistëve i lidhun me grupet që kryenin atentate. Ai kryente punën e informatorit dhe korierit. Për çudinë tonë dhe t'internuemve të tjerë ai nuk shprehej me sharje. Ne një rast tjetër ai e kishte përmendë si një ushtarak e gjeneral të zotin por qe bani gabimin që nuk u lidh me partinë dhe kaloi në shërbim të anglo-amerikanëve.

Të gjithë çuditëshin, dhe ne ma tepër, për këtë përmendje të vazhdueshme në çdo mbledhje që ai mbante me t'internuemit. Por erdhi koha kur Nuçi Tira doli në pension dhe ne nuk dëgjonin ma lajme të tilla indirekte për prindin tonë. Ne ato kushte kur sa kishim dalë nga Tepelena dhe nga Kuçi i Kurveleshit krejt të çoroditun nga ato izolime të mjerueshme, filloj epoka Hrushoviane, dhe u banë disa lehtësina, si lejimi i marrjës së pakove dhe dollarëve nga jashtë edhe për t'internuemit.

Kështu më 1960, na vjen një dokument postar ku duhej të shkonim në Durrës ku paskej ardhë një pako e madhe nga Italia n'emnin të nanës me një vlerë prej 20.000 lekësh. Lista e plaçkave, kryesisht veshmbathje, ishte e gjatë. E kuptuem se ishte dergue prej babës n'emën të grues së Valentinit nga Bolonja. Si me ia ba ? Ne nuk mund të shkonim. Ku me i gjete paret ? Na dolën disa miq t'internuem që na ndihmuen, sepse parashikohej se plaçkat e pakos do ta nxirrnin e tejkalonin shpenzimin. Këtë punë e mori përsipër e shoqja e Lazër Radit që ishte e lirë, Vitore Radi, së cilës i leshuem nje autorizim n'emën të mamës që figuronte pakoja, e cila për shkak sëmundje nuk mund te shkonte vetë në Durrës. Pa permendun se ishte e internueme. Kështu ne e morëm atë pako, që ishte një mrekulli për ne, e u veshëm e u mbathëm si s'ka ku shko ma mirë, dhe shitëm disa plaçka për me shlye borxhin. U duk se keshtu do të kishim edhe ndihma te tjera, por nuk vonoi dhe u ndalue si marrja e pakove ashti e dollarëve. Këto ishin pra disa forma nga ma të ndrysmet qe ne mernnim vesh lajme nga prindi ynë. Nuk mbaroi me kaq, në një letër që i kishte ardhë një t'internuemi tjetër, jo aq ne sy, shkruhej se si im atë kishte nisë dy pako të tjera, po aq të mëdha, nga Austria me anën e miqve të tij. Ato nuk erdhën kurrë sepse u bllokuen e konfiskuen në doganë nga organet e Sigurimit, që e kishin kuptue se kush i conte. Nga një përson i lirë që kishte njerëz në Ministrinë e Brendëshme dhe kishte respekt për familjen tonë, morëm vesh se në atë Ministri, ishin disa letra dhe fotografi të babës që Sigurimi i kishte ndalue e marrë nga posta. Këto ishin ato raste që ne mundëm me pasë nje far lidhje me prindin tonë. Por ma e bukura do të vinte ma vonë. Diçka e pabesueshme. Një aventurë për film.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Duke qene se gjithë përmbajtja e librit i përgjigjet jetës dhe veprimeve të prindit tonë, duke kapercye mbi ngjarjet ku edhe ne vetë u përfshimë, që janë tregue në shkrime të tjera, do të flasim për kohën e qendrimit jashtë shtetit si i arratisun ose refugjat politik shqiptar. Patjetër se do të fillojmë nga qendrimi tij në Greqi, përsa kemi marrë vesh nga ata që i ndejtën pranë dhe bashkëpunuen me të.

Një nga keto ishte Kapllan Bylykbashi, nga Devolli, i arratisun në Greqi që më 1945, që e njihte tim etin dhe ishte takue me të shpesh. Bylykbashët ishin trima e besnikë, dhe me Prenk Pervizin ishin lidhun fort. Disa prej tyne kishin hy në Shqipni si diversantë nën urdhnat e tij. Nja dy që i kishin kapë i kishin burgosë. Thuhet se pati dhe të pushkatuem prej tyne. Ky Kapllani pasi ndejti 10 vjet në Greqi kishte kalue në Amerikë. Atje qëndroi 20 vjet. Se se si dikush ia mbushi mendjën të kthehej te familja në Shqipni, se nuk e gjente gjë e s'kishte kush punë me të, sepse gjendja ishte e qetë dhe Shqipëria lulëzonte. Ishin mashtrime të agjentëve të sigurimit. Ndërsa Bylykbashët ishin pushtaktue, burgoisë e internue. Kështu ndodhi që Kapllani u kthye andej nga viti 1980. Zhgënjimi i tij nuk mund të përshkruhet, mjafton të dihet se e arrestuen dhe internuen ne kampin e Gradishtës së Lushnjës, duke ia mbajtë edhe ato pak dollarë e plaçka që kishte sjellë me vete. I shkreti Kapllan, që ia sollën dhe familjën aty të detyruem me punue në bujqësi si të gjithë t'intenuemit e tjerë. Kishte ra nga tigani në zjarr ! Nuk kemi ndërmend të bajmë historinë e Kapllanit, por ai kishte sjellë lajme si për babën tonë ashtu dhe t'arratisuni e tjerë që i kishin familjet e internueme në atë kamp. Dihet se në Grandishtë ishin internue disa familje të njohuna të botës shqiptar, si e Prenk Pervizit, Hasan Dostit, Murat Kaloshit, Cen Elez Ndreut, Mustafa Krujës, Mirakaj, Demaj, Kupi, etj. Familje të tjera ishin në kampe të tjerë, si Savër, Grabian, Gjazë, Çermë etj.

Prej tij ne morëm vesh si e kaloi kufinin prindi ynë dhe si u paraqit në Greqi. Kapllani kishte pasë rast të shoqnohej shpesh me të, dhe kishte ra biseda e arratisjës tij. Aq ma tepër që i kishte dalë besnik një Korçar si shoferi Llazi Sterjo dhe djemt e Gani Kullës në Zemblak. Korçarët kishin pse të krenohëshin. Ja se ç'morën vesh nga Kapllani.

Atë natë kur ishte nda prej Llazit, që e kishte ndalë makinën aty pranë rrugës së Kapshticës, im atë kishte ndjekë atë rrugë paraleshit i fshehun ndër shkurret deri afër Doganës, siç quhej posta e kufinit. Aty kishte dredhue anash deri ne një pikë, ku kishte qendrue duke kontrollue lëvizjet e rojëve kufitare e duke iu afrue dalë nga dalë vijës së kufinit, që ai njihte mirë dhe që pika kufitare e Doganës e ndriçuar i shërbente si orientim. Kur ishte sigurue mirë, kishte ndërmarrë kalimin, duke ecun për aq kohë sa mendonte se gjendej ne tokën greke. Dritat e Doganës qendronin shumë mbrapa tij dhe nga ana tjetër

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

dukëshin dritat e fshatit grek Kristallopi që ai njihte mirë, sepse dikur aty kishte vendosë komandën në kohën e luftës italo-greke. Por ç'kishte bërë ? thoshte Kapllani, nuk ishte paraqitur gjekundi dhe kishte kalue natën bri rrugës së Folorinës deri sa kishte dalë drita. Pse? Për arësye se qendronte rreziku me ra në dorë elementësh komunistë e ta pësonte si miku i tij Koço Kota, e të tjerë që komunistët grekë i kishin pikasur e dorëzue shqiptarve. Kur kishte dalë mirë drita, ai kishte kaluar në rrugën kryesore duke ecur esber, me syze dielli, si nje gazetar i huaj. Kishte ndeshun në ndonjë kalimtar që e pershendeste me respekt, si turist ose gazetar të huej. Ndërsa ecte kështu, vjen një veturë nga pas e ndalët disa metra para tij, ku shoferi i bën me shenjë që të hypte, dhe i kishte folur nja dy fjalë italisht. Kjo i erdhi e papritun dhe e pranoi ftesën duke e falenderuar po italisht shoferin, i cili u gëzua pse italishtën e fliste disi dhe mundi të shkëmbente bisedën me të huajin, që doli që ishte një gazetar francez, Aleksandër Rubin. Kur arritën në Folorinë, ku im atë kishte qendrue do kohë kur përcolli Mbretin Zog, e falenderoi shoferin dhe shkoi te një bankë ku këmben në pare greke disa sterlina. Ai kishte edhe napolona florini, por paraqiti sterlinat qe te mos dyshonin, sepse dihej se napoloni përdorej zyrtarisht në Shqipni, dhe shkoi fill e ne një hotel ku zuni një dhomë për atë natë. Ai kishte një dokument njoftimi francez me emrin Aleksader Rubin, që e mbante për udhëtime "inkonjito", që kur ishte në Itali, kur i binte të udhëtonte për punë personale. Pastaj vendosi të paraqitet në policinë e qytetit, pse ishte informue prej shoferit se aty nuk kishte elementë komunistë. Kur ishte paraqitun në atë zyrë me dokumentë që tregonin se si ai ishte nje gjeneral shqiptar që ishte arratisë prej Shqipnie, dhe kur kishte tregue edhe karvizitat e tre gjeneralëve grekë që e i kishin ba vizitë në Korçë, ato të policisë u sollën me respekt ndaj tij, dhe nuk vonoi edhe aty erdhën gazetarë nga radio e Folorinës, të cilët donin t'i banin një intervistë me atë përsonalitet të naltë ushtarak që ishte arratisun prej një vendi komunist.

Për Folorinën ishte një lajm sensacional. Sepse u mor vesh se Gjenerali kishte shoqërue Mbretin Zog në Greqi më prill 1939, ku kishte qëndrue do kohë në Folorinë. Intevista u la për ditën tjetër, që t'i lejonin që të pushonte e të qetësohej. Ai u takue edhe me autoritetet e vendin të cilët i treguen respekt e nderime. Mori vesh se miqt e tij gjeneralë, dy ishin vra gjatë luftës italo-greke në një bombardim, dhe i treti kishte vdekur. Atë natë ai e kaloi në hotel, ku mundi ta marrë veten e të qetësohej. Të nesërmen mbrama ai dha intervistën në radion e Folorinës, ku lajmi shkoi edhe në Shqipni. Babai, juaj, tregonte Kapllani, nuk i besonte shumë grekëve, dhe për sa mori vesh, aty përreth qarkullonin grupe partizanësh komunistë. Për t'i ikur çdo rreziku ai u largua nga Folorina e drejt e në Athinë me një autobus udhëtarësh. As në Athinë nuk u paraqit gjëkundi, por zuri edhe aty një hotel të mesëm, si gazetar

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

francez, me emnin Aleksadër Rubin. Ai e kishte marrë vesh se qeveria shqiptare kishte kerkuar dorezimin e kriminelëve të luftës (siç i quente t'arratisurit), dhe donte të sigurohej nga çdo e papritur. Zuri miqësi me hotelxhiun, që dinte pakëz frëngjisht, i cili ishte një njeri i mirë dhe antikomunist. Ndërkaq prindi juaj merr vesh se në Athinë kishin ardhur ato të komisionit për shqyrtimin e çeshtjës së t'arratisurve nga Shqipëria, Bullagaria, Jugosllavia e Rumania, që mbahëshin në në qendrën e refugjatëve "Haxhi Qiriako" aty në Athinë. Ishin miqt e tij të malit, koloneli Meklin, koloneli David Smiley e kapiteni Julian Amery. Ai, nuk shkoi t'i takonte, por u kishte shkruar një letër drejt në adresën e qendrës n'emër të kolonelit Meklin. Nuk kaloi java dhe para hotelit u ndalën dy xhipsa, prej ku zbritën disa ushtarakë anglezë. Sa hynë në hollin e pritjës, ku Prenka po rrinte e po pinte kafe, e njohën prindin tuaj dhe u përfalën përzemërsish me të, nën sytë e zgurdullar të pronarit. E morën menjëherë me vete. Kështu mori fund aventura e prindit tuaj për arratisjën në Greqi. Ai u detyrua të vepronte kështu për t'i ikur çdo rreziku të mundshëm. Por babai juaj me të cilin zuna njohje tregoi se si pas disa ditësh ishte kthyer te hoteli, ku e kishte falënderuar pronarin për sjelljën e mirë ndaj tij. Pronari nga ana e tij, ishte inatosur e zemrue pse nuk i kishte treguar se kush ishte, se ai do ta kishte mbajtur si mik të nderuar. Tregimi i Kapllanin nuk mbaroi me kaq. Ai kishte shtue, se si pas do kohë, një ditë prej ditësh në kampin "Haxchi Qiriako" ishte paraqitun një zotni grek, pasunik i madh dhe i lidhur me personalitete të larta te shoqeris greke. Ai kishte kërkue të takohej me gjeneralin shqiptar Prenk Pervizi. Kur babai juej ishte gjetur para tij, vazhdonte Kapllani, nuk e kishte njohur dhe ishte çuditur pse e kishte kërkuar ky zotni i panjohur. Greku i ishte përgjigjur që e shoh se ti nuk po me njeh, por jam unë që të njoh mirë. Si qendronte puna ? Ky njeri në kohën e Zogut, paskej qendruar disa kohë në Shqipëri, për bisnesin e tij si argjëndar, ku kishte blerë shumë gjëra të çmueshme, xhevahirë, margaritarë, unaza me diamantë, e te tjera sende të vlefshme, me çmim shumë t'ultë. I kishte mbushur valigjet plot, por ishte puna si të kalonte doganën pa e kontrolluar. Drejtohet fill e te babai juaj që ishte komandant i qarkut Korçës, ku ia qan hallin, qe kishte ble disa mallna tregitie me vlerë dhe kishte frikë se ia ndalonin shqiptarët se për grekët nuk kishte problem. Babai juaj i pergjigjet se nuk merrej me asi punësh. Ai ishte një komandant i ushtrise e nuk përgjigjej për doganën. Greku i kishte thënë, se ashtu është, por ishte dhe ana tjetër, se emri tij njihej në gjithë Shqipërinë. Ai nuk kërkonte tjeter veçse një copë letër me firmën e tij, ku të shkruhej, se lejohet kalimi i këtij personi me plaçkat që ka. Kaq. Mirë, i kishte thënë, po ta bëj qejfin, por se sa të vlen nuk përgjigjem. Ato të doganës sa kishin pa firmën e Prenkës e kishin lënë të kalonte menjëherë. Me ato valixhe ai e kishte zgjëruar tregtinë e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

tij e ishte bërë milioner e personalitet i Athinës. Ai ishte i lidhur me figurat me të larta të Greqisë deri dhe me vete mbretin. Gezonte besimin e tyne e kishte influencë të madhe në qeveri. Ai e nxori Prenkën prej aty dhe mori përsipër gjithë shpenzimet për jetesën e tij midis Athinës, ku e kishte vendosë ne një hotel lukzoz, duke ia siguruar të gjithë nevojat materiale. Sa që e quente si vëlla. Nga ana tjetër duke e perkrahur ne aktivietin e tij politik, me shpenzimet qe ato punë kërkonin. Deri dhe udhëtime në Itali që të takohej e bashkëpunonte me patriitët e tjerë shqiptarë. Unë u largova pas 10 vjet vjet, më 1955, për në Amerikë, e nuk di tjetër për të, veçse dëgjoja se shqiptarët e respektonin dhe e nderonin. Mora vesh pastaj se si kishte kaluar në Belgjikë, dhe për vdekjen e tij atje. Kështu në ato kondita na erdhi një tregim ma i shkoqitun se si ai kishte kalue kufinin në atë natë dhe si ishte paraqitë.

Sipas dëshmisë së t"arratisurit Zef Luka, Prenk Pervizi, që jetonte në një hotel lukzos të Athinës, kishte një zyrë në kampin e Haxhi Qiriakos, ku vinte herë pas here. Ai merrej me organizimin e caktimin e njerëzve që do të hidhëshin si diversantë në Shqipni, nga Greqia ose Italia, siç kishte ndodhë me vetë Zef Lukën, një ndër diversantët ma të njohun që kishin veprue në Shqipni.

Siç e përmendëm për pakot e ndalueme nga Sigurimi, që ishim lajmërue nga një përson tjetër, të cilin e kishte njoftue babai, pati dhe raste te tjera ku na vinin te falat e tij. Një here i kishte ardhë një letër djalit të Muharrem Bajraktarit, Gencit, ku i shkruente se familja e Prenk Pervizit mos të bahej merak se ai i rrinte pranë e kujdesej për Prenkën për çdo gja. Edhe grueja e Valentinit nga Bologna, me ndonjë kartolinë, sepse letrat nuk kalonin, na siguronte here pas here për shëndetin e na bante të falat e tij, gjithmonë në emën të një gjoja tezës sonë Ana, që ishte vetë dora.

Së fundi, ishte miku i tij i ngushtë, Muharrem Bajraktari, që me anën e familjës tij na njoftonte dhe na ngushullonte për vdekjën e babes, më shtator 1977. Këto ishin të gjitha mundësitë e marrjës së ndonjë lajmi prej prindit tone sa qendruem në kampet e internimit. Njoftime të tjera do t'i merrnim gjatë qendrimit tone në Belgjikë, ku kaluem në tetor 1990 e deri më sot që po shkruejm këto kujtime.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Në botën e lirë

Në tetor 1990 arritëm me dalë familjarisht në Mbretninë e Belgjikës, me gruen e tre djemtë. Një mrekulli. Nga skëterra komuniste në botën e lirë. Nga Ferri në Parajzë. Në shtetin ku kishte jetue vitet e ditët e fundi prindi ynë. Ishim familja e vetme dhe e parë që vinte drejt nga kampet e internimit. Shqiptarë të ndryshëm të mërgatës vjetër erdhën me na takue. Njerëz që e kishin njoftë babën e ishin shoqnue me të.

Por kryesorja imediate për ne ishte rregullimi i gjendjës sonë. Duhej me u paraqitë patjetër në Komisariatin për refugjatët. Unë, grueja e djali i madh. I vogli nën 14 vjeç nuk merrej në pyetje.

Na intervistonin veç e veç. I fundit me takoi mue. Hetuesi ishte një burrë rreth 50 vjeç. Përkthyese frëngjisht, një zonjushë bionde kosovare. Nuk pata nevojë për përkthim. Me frëngjishtën që kisha mësue në shkollë në Itali dhe përmirësue në burgjet e kampet me intelektualët të mbyllun aty, veçanërisht në Kuç, ia dola vetë në krye punës. Relacioni im ishte tepër i plotë e tronditës për hetuesit belgë. Me vendet e internimëve, data dhe konditat. Sigurisht se aty doli pse keni zgjedhë Belgjikën. Këtu kishte jetue e vdekë prindi ynë, Prenk Pervizi, gjeneral shqiptar. Hetuesi në një çast mori leje dhe shkoi diku. U kthye pas 10 minutash.

- Zoti Pervizi, jeni te pranuar qe tani, komplet me gjithë familjën. Me urdhën e vendim të vetë Presidentit të Komisariatit. Mirësevini në Mbretninë e Belgjikës !

Ndërkaq, me dha një posulle, ku ishte shkrue adresa e qytetit ku kishte jetue e vdekë im atë dhe e varrezave ku ishte varrosë. Gjendja jonë u rregullue. Zumë një apartament dhe përfituem ndihmën e caktuemë për refugjatët. Kjo i habiti gjithë shqiptarët për shpejtësinë e rregullimit tonë. Faktikisht ato ishin t'ardhun atyqyshë nga viti 1956, me rregulla të tjera, e kishin hasë në veshtirësi në kohën e tyne. Me shëmbjen e komunizmit dhe vërshimin e refugjatëve n'Evropë, OKB-ja kishte marrë masa të reja për përballimin e situatës. Kjo me pak fjalë paraqitja dhe sistemimi yne në Belgjikë, ku u pritëm ma së miri. Aty grueja ime kishte dhe t'amën, Zorka Malaj e tre vllaznit për nanë, që edhe ato e kishin provue internimi deri sa u riatdhesuen në Mal të Zi, e pastaj kaluen në Belgjikë.

Puna e parë për t'u krye ishte gjetja e vorrit të babës. Kjo u arrit me adresën që më dhanë në Komisariat. Nga ana tjetër dolën dy puknjanë, Gjergj Tishi, bir' i Zef Tishit, që kishte shoqnue babën konët e fundit, dhe Ded Mjeku, të cilët na përcollën në spitalin ku im atë ishte shtrue e kishte ndërrue jetë. Ku na pritën mirë, dhe takuem edhe infermierën që ishte kujdesue për të.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Edhe ajo na dha adresën e varrezave dhe na tregoi se im atë ishte varros në atë që quhej parcela e herojve, ku varroseshin personalitete të larta ushtarake të ikun nga vendet komuniste.

Te varri shkova bashkë me Patër Ambroz Martinin, që kishte krye shërbimin e fundit fetar t'im etit dhe Ded Mjekun, i cili ishte shoqnue vazhdimisht me babën, dhe njihte gjithë mergatën shqiptare të Belgjikës. Ai punonte si përkthyes, sepse zotnonte, përveç shqipës, italishtën, frëngjishtë e serbo-kroatishtën. Prej Dedës dhe Patër Ambrozit mora informatat e para për babën. Ndër të tjera mora vesh se si, pas vdekjës së babës, të gjithë plaçkat, orenditë dhe sendet përsonale të tij, libra, letra, fotografi e shkrime, ndër to dhe një revolver, ishin mbyllun në një valixhe apo arkë të vulosun me dyll. Shqiptarët ndërhynë dhe propozuen se ato plaçka mund t'i dorëzohëshin në ruetje Pater Ambrozit. Kështu u la. Por kur ai u paraqit ditën e caktueme për t'i marrë, nuk ia dhanë dhe i thanë se po nuk doli kush i familjës, ato sende nuk i dorëzohën askujt. Për deri sa nuk kishte njerëz të familjës që t'i dorëzohëshin, ato ruhëshin 25 vjet, në pritje mos dilte një i afërm i tij. Pastaj digjeshin. Si me ia ba ? Doli se shqiptarët kishin vu dorë mbi atë arkë, duke ndërhy me anë të pëshkopit me origjinë polake, Jordan, që përgjigjej për shqiptarët. Arka u hap në prani të tre shqiptarve, të cilëve nuk po ua përmend emnat. Për disa sende personale, si orë dore, çakmak i markës « Dupont », stilograf e stilo-laps me veshje ari, çestek ari, unazë e martesës, një pako me letra, ndër to një letër drejtue Presidentit t'Amerikës, një sasi fotografishë dhe dy blok-shënimesh me adresa, pasaportë e letër njoftim të OKB-së, si refugjat politik, ia kishin dorëzue një far Ded Volaj, nga Puka Atë e kishin thirrë aty, sepse ai njihte disa nipa të Prenk Pervizit, që gjendëshin në Amerikë, prandaj ai të ua çonte. Ded Volaj e kishte pa arkën e hapun, me plaçkat dhe sendet e tjera, ndër to fletore me shkrime e libra, si dhe revolën. Për ato sende nuk u tha asnjë fjalë se si do shkonte puna e ku do të përfundonin.

Ai kishte pranue me e krye atë porosi. Deda më tregoi se kush ishin tre shqiptarët aty të pranishëm përveç pëshkopit. Ndërhyna pranë kryetarit të Komunës (Burgmestrit) ku kishte jetue im atë, në qytetin La Luvierë, i cili m'u përgjigj që kishte ngarkue komisariatin e policisë që ta ndiqnin çështjën. Nga policia erdhi njoftimi, që rezultonte se Prenk Pervizi nuk kishte lanë asgja. U kuptue se asaj pune i kishin vu kapak dhe kot që mundohësha me e zhbirilue. Njerëzit që e kishin organizue atë punë kishin vdekun, dhe kur unë shkova me kërkue llogari te familjet e tyne, se mos kishin lujtë ndonjë send të babës, veçanërsiht kutinë e cigarëve prej ari me emnin e firmën e tij të skalitun, dhe për dokumenta e dorëshkrime, ue qenë se kishin pasë miqësi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

me prindin tim, m'u përgjigjen që nuk kishin asgja nga sendet të tij dhe se nuk dinin asgja për to. Ndërsa ishte krejt e kundërta.

Kisha ardhë në një kohë kur të gjithë miqt e t'im etit kishin vdekun. Gjashtë muej përpara kishte vdekë Muharrem Bajraktari. Po në ato ditë që mbrritëm në Bruksel, kishte vdekë miku tjetër kurbinas, Brahim Bami, nga Zheja. Ky i shtruem në spital, kur kishte marrë vesh për ardhjën e birit të Prenk Pervizit, kishte shpreh dëshirën me më takue, por u njoftova pas vdekjës tij. Me rastin e vdekjës tij, vjen nga Amerika, Gjergj Qipi që me Brahimin kishin lidhë kumbarie. Ky Gjergji ishte nga një familje mike jona den baba den, nga Malibardhë i Kurbinit. Gjergji vjen më takon me djalin e Brahim Bamit, dhe me dorëzon disa sende të babës, që ia kishin dhanë nipat tonë në New York, Ndue e Martin Lala të cilëve ua kishte çue ai Ded Volaj. Mbeta i befasuem, sepse përveç disa fotografive, orës dorës dhe një stilo-lapsi, që unë i njihja, të tjerat ishin zevendesue me gjana pa vlerë. Pakoja e letrave mungonte me gjithëletrën dergue presidentit Knnedy. U detyrova me i pranue, ashtu siç mi kishin sjellë. Mos tjetër fotografitë, që nuk kishim asnji të tijën, dhe unazën e martesës, jo ajo që unë dija, me mbishkrimin e emnit tij dhe të datëlindjës, por se pakut florinit. Kur ia tregova Ded Mjekut ato sende, ai mbeti i çuditun, sepse kishte ndejtë vazhdimisht me babën dhe ia njifte gjanat që mbante. Ndër te tjera me tregonte se si i ishte prishë çakmaku « Dupont », prej florini, dhe se si Deda e kishte ndihmue me ia dergue me postë speciale fabrikës në Svicër, që ia kishte kthye të riparuem. Pastaj ku ishte kutija e cigarëve po prej florini, me emnin e firmën e tij të gdhendun në të ? Ma vonë kishte dalë se nje nga personat qe kishin vu dorë mbi plaçkat u muer vesh se përdorte e thyente pesë-napolonsha florini, që nuk kishte disponue as dispononte askush shqiptar. Përfundimi i sa thamë deri tani : edhe ato sende të fundit të Prenk Pervizit, ku kishte edhe dokumentë si dhe shkrime, shënime, kujtime dhe sende të tjera, ashtu dhe korispondenca, u zhdukën pa lanë gjurmë, humbën. Nipat ne Amerike, për letrat më thanë se ato ishin kalbë në bodrum prej lagështinës. Ec e merre vesh. Po pse në një bodrum me lagështinë ruhën letrat ? Kisha mbet krejt i pafuqishëm dhe i zgënjyem. Koha kishte ba të veten. 45 vjet i ndamë prej botës dhe jetës normale mierëzore.

Nuk më mbetej tjetër veçse me marrë informata gojore prej shqiptarve të mërgatës së vjetër, ose ma mirë me thanë prej fëmijeve të tyne. Me ra rasti me shkue edhe ne Paris qysh në verën 1991, ku u takova me Leka Zogun e disa shqiptarë të rrethit tonë miqësor. Rezultati ishte se informatat jepëshin me pikatore. Leka Zogu me tregonte, ndërsa gëlltiste konjak, se per Prenk Pervizin i kishte folë mirë Hysen Selmani, kujdestari tij pas vdekjës se Mbretit Zog. Aq. Si përfundim arrita te marr vesh sa ma poshtë vijon.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



Prenk Pervizi në Belgjikë
kaloi 11 vjetët e fundit, 1966-1977

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)




Gjenerali në Greqi ku qëndroi 19 vjet nga 1946 deri 1965




Prenk Pervizi në Belgjikë, ku vdiq më 6 shtator 1977.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Jetë e veprimtari në mërgim

Im atë kishte qëndrue 19 vjet në Greqi, ku, në periudhën 1950-1954, bashkë me Muharrem Bajraktarin, Fiqri Dinen, Hysni Demën, Abaz Ermenin e të tjerë shqiptarë, kishin nisë një organizim ushtarak për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipni. Puna kishte ecë mbarë, pse kishte mjaft shqiptarë t'arratisun dhe kishin edhe ndihmën e grekëve e t'anglezëve. Nga njoftime ma të sakta nga shërbimi i fshehtë amerikan dilte se Prenk Pervizi kishte mbështet planin anglez për atë organizim me anën e Greqisë, ndërsa Hasan Dosti atë armerikan me anë të Jugosllavisë. Për në Greqi pritej që të vinte aty vetë Mbreti Zog, me të cilin ishin në lidhje, për t'i dhanë fund organizimit dhe nisjes së aksionit. Por ç'ndodhi ? Anglezët e kishin pengue Mbretin e nuk e kishin lanë me ardhë në Greqi prej Egjyptit ku rrinte, nën mbrojtjën e Mbretit Faruk, që i i kishte krijue kushte të mira jetese. Ndërkohë, anglezët i kishin dredhue fjalët duke paraqitë si kusht të mbështetjës dhe ndihmës së tyne, kthimin e Korçës e Gjirokastrës Greqisë. Shqiptarët të revoltuem nuk kishin pranue të tilla kondita dhe organizimi u prish. Mësova pastaj se si ato ishin përpjekë me dërgue diversantë nepërmjet kufinit, ku ishte dallue Hamit Matjani e vllaznit Bylykbashi nga Devolli, të cilët kishin hy e dalë disa herë. Rezulton se ata kishin punue sipas udhëzimeve të Prenk Pervizit, dhe ishte shtrue mundësia që Hamiti të tërhiqte në Greqi djemt e tij, pra, mue dhe vëllain Valentin e ndonjë tjetër.

Më 1950-1951, një grup t'intenuemish, shumica gra e disa djem te ri në moshë pune, ishin transferue me punue në një fermë të Lushnjës, në sektorin Pluk. Hamit Matjani e kishte marrë vesh atë punë dhe ishte interesue deri aty sa kishte shkue fshehurazi në atë kamp, aq i zoti dhe i zhdërvjellte ishte, por doli se djemt e gjeneralit nuk ishin aty dhe s'kishte ndonjë tjetër person që t'ia vlente për ta marrë me vete. Në atë periudhë ne ishim të mbyllun në Porto Palermo e Tepelenë.

Organizimi i diverasantëve u shtue dhe filloj hedhja e tyne me parashuta, ku në Dibër u hodh kapiteni Zenel Shehu me të tjerë që u kapën, dhe Sigurimi i detyroi te punonin për të. Arriti puna që, gjoja ishte krijue një zonë e lirë dhe pritej të vinte ndonjë figurë udhëheqëse me emën, si Prenk Pervizi, Fiqri Dine, Muharrem Bajraktari, etj. Kjo mund të kishte ndodhë, por Zenel Shehu e paskej ruejt një kod të fshehtë që krijoi dyshim. Prandaj, kësaj punë do t'i paraprinte Hamit Matjani që do të konfirmonte e vërtetonte se ishte mundësia e ardhjës së personalitetëve që përmendëm, për të fillue luftën

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kundër komunizmit. Dihet si përfundoi misioni i Hamit Matjanit, që ra në kurthën e Sigurimit, që nga ana e tij priste mos zbriste ndonjë peshk ma i madh. Kështu Hamiti u sakrifikue për një çeshtje të madhe, dhe nuk u përkul e nuk pranoi të luej lojën e Sigurimit. U gjykue dhe u denue me varje midis Lushnjës, më 1954. Dega e Brednshme u dha lejë t'intenuemeve që të shkonin e ta shihnin Hamitin të varun me iu shti frikën dhe me i dëshperue. Shumë pak prej tyne shkuen, ma tepër çunakë.

Dështimi i ndërhyemjës me diversantë, si nga toka ashtu nga qielli, siç do të vazhdonte ma vonë, erdhi si rrjedhim i spiunit anglez Philby, që punonte per Sherbimin Sekret Rus, pranë shtabit të komandës aleate, i cili informonte për çdo hedhje të diversantëve në Shqipni, që kapëshin sa shkelnin në tokë. Pati dy raste të veçanta që nuk u diktuen, ai i Ndue Pjetër Gjomarkut, në maj 1949, që koincidoi me vrasjën e Bardhok Bibës dhe ai i grupit të Alush Lleshanakut, që u hodh në zonën e Mirditës mes dimnit e bores më 1949. Por edhe ai dështoi, sepse u diktue nga tradhtia e një shoku të ngushtë të tij që ishte lidh me sigurimin, të cilit ai i kishte besue. Alush Lleshanaku u vra në Elbasan.

Ndërkohë, im atë kishte udhëtue në Francë në Marseille ku ishte takue me Mbretin Zog, për të gjetun mundësinë e një ndërhyemje me forcën e armëve në Shqipni me ndihmën e shtetëve fqinje. Aty dolën kontradita. Zogu e kishte mendjën akoma te Jugosllavia, ku mund të gjenin mbështetje, tue kujtue se do të përseritej 24 dhjetori 1924. Prenk Pervizi insistonte se kësaj radhe ishte Greqia bashkë me anglezët që mund ta banin atë punë, që përmatepër ishte Mbretni. Kurse Jugosllavia ishte një vend komunist, dhe kurrë n'e kurrës nuk do të pranonte një gja të tillë, aq ma keq se do t'ua bante të zezën me i tradhtue e dorëzue te komunistët shqiptarë. Kështu ato u ndanë pa arritë në mirëkuptim. Ma vonë Zogu vdiq dhe nuk u ba gja. I biri ishte tepër i ri e vazhdonte shkollën. Ku u rrit, mori drejtim te gabuem duke u shkëputun prej atyne që i kishin ndejtë pranë babës tij, duke u rrethue me njerëz pa emën, pa nam e nishan, siç thotë populli. Një fakt i vogël që tregon punë ma të mëdha, ishte një shkëmbim fjalësh që unë pata me disa shqiptarë në nje kafe. Njerëz të mirë por me flutura në kokë. Aty unë kisha ndërhy se si mergata shqiptare nuk kishte qene aspaki e organizueme dhe e gatshme me i dalë punës në ballë pas shëmbjes së komunzmit. Mergata me mbretin Zog duhet të kishin organizueme një qeveri hije, me intelektualët shqiptarë në mergim. Po ku janë ata ? Jo ky i kuq, ai i zi, tjetri i bardhë apo i verdhë. Duke ba të tilla dallime ata i keni largue. Pastaj ku i keni djemtë e juej, që të kenë mbarue shkollat e të jenë të dipllomuem ? Jo, i keni ba shëgertë e kamerierë kafesh me fitue pare. Jeni marrë me bixhoz, me pijet e me lavire. Mbretin e keni rrethue me njerëz të pa nivel e të panjohun, bar dhnesh, anonimë. S'keni

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

organizue asgja të hajrit, as keni një shtyp që të ju perfaqësojë. Legaliteti ? Kush e ka shpikë këtë emërtim të panjohun e të pa vlerë ? Sigurisht një injorant, sepse asnjë zogist i ngritun e intelektual nuk merr pjesë në të. Zogizmi asht gja tjetër, dhe njihet në Mbretin Zog dhe jo në legalitetin, e udhëhequn nga njerëz të pashkolluem, analfabetë e pa asnjë vlerë. Pak a shumë kështu fola. Atëhere një shqiptar kërcej nga një tavolinë.

- Po ai baba yt, Prenk Pervizi ka dashtë me e vra Zogun e me i zanë vendin !

Ia ktheva aty për aty:

- Mor i shkretë, po ta kishte pasë atë mendje, jo një kokë por disa të kishte pasë Zogu ia kishte hjekë. Ndërsa ka qene besniku ma i madh i tij, si ne të mire ashtu në të keqe, nga fillimi deri ne fund të mbrenisë. Këtë e di çdo shqiptar deri dhe fëmijët në Shqipni, por siduket jeta në megrim ua ka marrë mend dhe ua ka hjek edhe ato pak që kishi. Isha i revlotuem. Mos je ti filani, nipi i filanit ? Atë axhën tand e kam pas në burg e internim, burrë i mirë e zogist i flakët, por jo legalist si pua juej !

Fjala ime i la në heshtje të gjithë sa ishin. Unë u kisha tregue atë të vërtetë që ata as e kuptonin as e njihnin, por që u detyruen ta pranonin. Këto ishin gjithë sa unë arrita me marrë vesh prej njerëzve të ndryshëm në Belgjikë e Francë, të mira apo të këqia.

Përsa i përket periudhës së Belgjikës, im atë erdhi aty më 1966. Duke qenë se nuk kishte familje as njeri të vetin, atë e caktuen në një hotel për refugjatë ku i caktuen një apartament të veçantë, nën kujdesin e Karitasit, në qytetin La Louviere, një gjysmë ore me tren nga Brukseli. Aty ishin dhe katër gjeneralë rumunë e bullgarë, edhe ata t'arratisun prej komunizmit, që trajtohëshin si prindi im. Ai vinte vazhdimisht në Bruksel, ku shkonin dhe e merrnin me makinë, ose me tren, që e kishte të paguem. Në Brukesl e kalonte kohën me miqt e tij, Muharrem Bajraktarin, Refat Kolgjinin, familja Duraku, Brahim Bamin, Tahir Zajmin, ku shpesh vinte dhe Abaz Kupi e të tjerë prej Parisi, e ia shtronin bisedës duke analizue shkaqet e gabimet që çuen ne deshtimin e nacioalistëve në kohën e luftës. Dhe ç'mund të bahej për imediatën e t'ardhmën.

Në një takim të tillë miqsor, im atë ishte shprehun :

- Dëgjoni, për si asht Shqipnia tash nën diktaturën komuniste, janë famimljet tona që ia njohin kriminalitetin, që po e pësojnë mbi kurrizin e tyne, si hakmarrje ndaj nesh, burrave të mirë. Ne jemi në parajzë ato në ferr. Kjo dihet. Si do shkojë puna thoni ? Dëgjoni pa u shemb komunizmi në Rusinë Staliniste, nuk shëmbet diktatura shqiptare, as të tjerat. Ajo kohë dotë vijë. Kur ? Ne do jemi a s'do jemi. Tjetër çgjidhje s'ka, për deri sa e lamë të na

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

fluturojë zogun nga dora. Na mashtruen të huejt që mbanim si miq. Na prenë në besë duke e shpërdorue mirëbesimin tonë. Kjo e gjitha.

Miqtë i kishin dhanë të drejtë, se edhe ata ishin të bindun për sa thoshte im atë, por banin gjoja se nuk e dinin, sipas shprehjës "bane zot andërr".

Aktivitete kulturore nuk kishte dhe jetohej me bindjen se agjentët komunistë vepronin lirisht në diasporë, kudo, nga Belgjika e Franca, në Itali, Angli e në Amerikë. Deri sa kishte arritë që një far Cuf Mullaj (me shokë), agjent e spiun komunist, të tërhiqte për hunde vetë Mbretin Zog bashkë me gjithë legalitetin e kur e mbaroj misionin të ikte duke u tallë me ta. Sa që këto agjentë bukurosha, Mbretnesha Gjeraldina i quente si bijt të saj.

Siç e thamë, kur vinte në Bruksel, im atë rrinte vazhdimishi me Muharrem Bajraktarin, dhe kryesisht në lokalin e nipave të tij Lita, por dhe të kafeneja e Rrok Çunit, nga Puka, që babën e donte dhe e respektonte shumë. Tregohen disa anekdota.

Sa herë që im atën vinte në lokalin e nipave të Bajraktarit, ky porosiste konjak « Metaxas ». Nipat e pyetën një ditë :

- Si asht puna or mixhë, që sa herë që vjen Prenk Pervizi, ti porosit konjak, e kur vijnë shqiptarë të tjerë porosit ujë.
- Ore djelm, Prenk Pervizi, asht nje burrë e general që meriton të nderohet me konjak. Të tjerët janë veç për ujë…

Një here tjetër kur e kishin pyet pse e nderonte e respektonte aq shumë Prenk Pervizin:

- Prenka na e ka kalue të gjithë neve të tjerëve për shkollat e nalta ushtarake që ka krye, për gjuhet e hueja që zotnon, dhe detyrat që ka përballue me nder. Nga kjo anë asnjë oficer madhor shqiptar nuk mund të matet me të. Ai ka qenë për mue dhe asht miku ma i shtrejt e i nderuem.

Ndodhte që vinin aty në tavolinën e tyne dhe njerëz të tjerë dosido me të cilët s' ecte biseda. Atëherë Prenk Pervizi, u drejtohej me gjentilesë të madhe :

-Ju lutemi zotnij të keni mirësinë të na lini të qetë se kemi disa çështje të randësishme për të diskutue me Bajraktarin.

Kështu të dy miqtë mund shkëmbenin mendime e gjykime mbi çështje të randësishme e të kujtonin edhe jetën dhe veprimtarënë e kalue me të tyne. Im atë e Muharrem Bajrktari dhe Fiqri Dine sa kje gjallë, nuk merrëshin me organizata politike as ishin në ndonjë parti. Ata banin thirrje gjithmonë për bashkim pa dallim feje, ideje, krahine e partie. Po me ke, që shqiptarët ishin përça, secili krah e grup pas kokës vet ?

Në Belgjikë i vetmi aktivitet i randësishëm ishe dita e Flamurit, 28 Nëndori, që festohej bashkarisht. Në këto festa i japej fjala Prenk Pervizit, i

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

cili vazhdimisht bante thirrje për bashkim. Nga këto fjalime ka shpetue vetëm një i mbajtun më rastin e 28 Nëndori 1971, organizue nga Blloku Indipendent, fatmirsisht i paraqitun në buletinin e Bllokut Indipendent të atij viti. Një fjalim që kishte lane mbresa të bashkahdetarët, që e përmendnin gjithmonë. Po e japim ma poshtë.

Shënim:

Përsa i përket veprimtariës së tij në mërgim, janë gjetur disa dokumentë në arkivin e Ministrisë së Brendshme italiane, se ai ndiqej nga sigurimi italian dhe mbahej nën vëzhgim për lëvizjet e kontaktet e tij në Itali, veçanërisht në vitët 1950-1954, kur paskej bërë disa udhëtime e kontakte ne qytetet Romë, Napoli e Gjenova. Janë 11 dokumentë që u gjetën dhe na u dërguen nga miku, histioriani e diplomati Bexhollah Destani në Ambasadën e Kosovës në Romë, të cilit i shkojnë falemenderimet tona. Jo vetëm kaq, po nga një dokument tjetër del se ai ndiqej e vëzhgohej nga shërbimi sekret italiane edhe ne kohën e Mbretërisë kur ishte kolonel, e ku cilësohej i rrezikshëm dhe besnik i Mbretit Zog, bashkë me diplomatin shkodran Çatin Saraçi.

Detyrohemi të paraqesim dy nga këto dokumentë si një provë e veprimtarisë tij edhe në kushtet e emigracionit politik kur u largua nga Shqipëria për në Greqi më 1946. Dhe për të tregue se edhe ne kohën e Mbretnisë ai vëzhgohej nga shërbimi sekret italian.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

Fjalimi i Gjeneral Prenk Pervizit
më 28 Nëndor 1971 në Bruksel

Zoja e Zotni të nderuem, bashkatdhetarë të pranishëm,

Jam i gezuem dhe i nderuem, që po marr pjesë në mbledhjen tuej, për të festue 25 vjetorin e Bllokut Kombtar Indipendent. Ju e dini se unë jam i deklaurem i pavarun, nuk baj pjesë në partinat politike t'emigracionit, por nuk jam kundra asnji partie apo rryme politike. Më mbetet të urrej vetëm ata elementa që shkaktojnë grindje e përçarje në radhët e mergatës. Mund të them, përsa i përket Bllokut Kombtar Indipendent, se asht një Organizatë me një program të përsosun, dhe që mbi të gjitha ven nevojen e një bashkimi të rrymave politike të mergatës sonë. Asht i kryesuem prej elementave t'ajkës Shqiptare, të pajisun me kulturë, të squet, patriotë të pastër e aktivistë. Zani i Bllokut, për bashkimin e mergatës gjen në mue admirim e kështu besoj se edhe ndër të tjera ambiente.

Për të pa se sa randësi ka bashkimi, le t'i hedhim një sy shkurtazi, historisë. Mbretnesha Teuta, ka pasë arritë me bashkue fiset ilire, e me këtë bashkim i pat dhanë lufta të rrepta Perandorisë Romake, që ishte fuqia ma e fortë e asaj kohë. Edhe Mbreti Genc, ndoqi shembullin e Teutës, e me atë bashkim u perballoi fuqive të mëdha romake, por mjerisht ra rob, pa mund të arrije synimet e veta. Po për atë kohë, vjen për t'u përmendë burri fatos, që dikush quen Burri e dikush Pirro, i cili bashkoi fiset iliriane prej jugut e deri ne zenrën e Ballkanit, e duke pase arrite nje lidhje historike, pat guximin, po me atë ushtri iliriane e mjetet e asaj kohë, me i ba luftë Perandorisë Romake në tokën e saj. Luftë e përgjakëshme, por megjithatë fatosat iliriane i mundën legjionet e shumta romake. Shqypja e zeze dy krenare u brohorit në fushën e asaj beteje për të parën herë, mbas kësaj fitoreje të shkëlqyeshme**.** E me qenë se qe shumë e përgjakshme, për të dy palët, historia e pagëzoi "Fitore e Pirros". Për mos me u zgjat tepër, t'i hedhim një sy kohës s'è Fatosit tonë Kombtar Gjergj Kastriot Skenderbegut, që qyshë në moshë të re u muer peng prej turqëve e u rrit me të tana miradinat e Pallatit të Sulltanit, e qe nderue e respektue prej të gjithëve. Por ai u ra shqelm të tana këtyne miradinave e u vue në shërbim të Atdheut. U shkëput prej ushtrisë turke, mbërriti në Krujë, e nbasi i dëboi turqit prej keshtjellës, bani mbledhjen historike ku mlodhi të gjithë Prijësat e fiseve shqiptare. N'atë mbledhje t'Lezhës, nën hijen e Flamurit Kombtar u lidh Besa Shqiptare e u ba «Bashkimi » u vendos Pamvarësia. Lidhen besë burrat e Shqipnisë, njohën për prijës të tyne Skenderbegun.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

24 vjet vazhdoi mbrojtja e Shqipnisë nën udhëheqjen e atij Fatosi, duke i dhane 22 beteja fuqisë shumfishe turke dhe duke ia thye hovin për të pushtue Europen. Mbas vdekjes së Heroit, Shqipnia ra nën okupacionin turk për ma së katër shekuj. Edhe gjatë kësaj kohë, shqiptarët u përpoqën ta rifitojnë lirinë, por intrigat e hueja nuk i lanë të zhvillohen përpjekjet shqiptare. Me fjalë të tjera, të rrethuem në të katër anët prej anmiqve, Pamvarësia u rifitue vetëm në vitin 1912. Konferenca e paqës në Londër, caktoi kufijt e vendit tonë, tue lanë gjysmën jashta nën sundimin e anmiqve tonë. Mbledhja e Patriotëve me 28 Nendor 1912, shpalli Pamvarësine Shqiptare, dhe pat për qellim me e mbrojtë Pamvarësine dhe me u perpjeke me i fut në gjinin e Nanës Shqipni të gjithë shqiptarët. Kaluen kohnat, përpjekje e shumë flijime u banë prej shqiptarve për të mbrojtë Pamvarësinë, por nuk u arrit «Bashkimi », ai Bashkim i të gjtha forcave të shëndosha shqiptare. Fatkeqësisht tue mos u ba Bashkimi, erdhen në fuqi komunistët internacionalë. Me ndihmen e sllavizmit morën frenat në dorë. Gjaku i shqiptarve të pastër rrodhi currila e rrëkaje për ti dalun zot Atdheut. Elementat ma të zgjedhun mbaruen nëpër burgje. Familjet shqiptare u morën nëpër kambë. Populli shqiptar u ba skllav i klikës së kuqe.

Vjen pyetja: cila asht detyra e emigracionit? Përgjigja asht krejt e thjeshtë : « Bashkimi ! Vetëm të bashkuem rrymat politike munden me i sherbye Atdheut. Rrofte Shqipnia e Lirë Etnike !

* * *

Para se të vinte në Belgjikë, im atë ishte ndalë në Itali, e kishte qendrue do kohë në Bolonja ku jetonte e grueja e Valentinit, me të cilën ishte kontaktue dhe n'emën të së cilës nëpërmjet shoqatave bamirëse ka kishte nisë një pako të madhe me plaçka, siç e kemi tregue, që e morem, e dy të tjera që nuk na i dhanë e i grabitën. Në qëndrimin në Itali, Ministria e Mbrojtjës Italiane i kishte propozue të ia njihte gradën e lartë si general divizioni, dhe t'i jepte një detyrë komanduese, por me konditën që ai të pranonte nënshtetësinë italiane. Ai nuk e pranoi asësi atë ofertë që e fyente në dinjitetin e tij si shqiptar, dhe prandaj kaloi në Belgjikë, si refugjat politik ONU. Në Itali, sa ndejt u takue me figurat e tjera shqiptare, miq të tij e t'afërm, si Gjon Marka Gjoni me të birin Nduen; Ernest Koliqin, ish shok shkolle e mik; Zef Palin, Kryetar i Komitetit Shqiperia e Lirë, Daf Parvizin, fis i vjetër dhe luftëtar i shquem, nga Hasi i Kosovës; Mehdi Frasherin, Namin Vlorën me të shoqin

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Renzo Falaski; kishte shkue e ba vizitë në Institutin Santa Maria, Kolezhi ku kishim studiue ne. Kishte takue edhe ish shokë të Shkollës së Luftës së Torinos, që ishin akoma në shërbim e me pozita. Kjo pak a shume sa morëm vesh nga grueja e Valentinit kur shkova me e takue me rastin e ardhjës së Valentinit nga Shqipnia, në shkurt 1991, ku ajo na tregoi për gjithë sa thamë. Aty mora vesh edhe një çudi tjetër që vetëm shqiptarët janë mjeshtra për të krye.

Ja se ç'më tregoi ajo. Kur ishte bashkue me Valentinin pas 47 vjet ndarje, ajo ndër të tjera i kishte tregue një paketë me letra të dërgueme nga baba kur ishte në Greqi dhe Belgjikë pra 30 vjet korepondencë. Valentini ishte gëzue dhe me padurim i merr zarfat dhe fillon t'i hapë. Ç'ka me pa e me diftue ? Zarfat ishin bosh ! Ku kishin shkue letrat ? Gori, e shoqja e Valentinit kishte mbetë pa mend. Atëherë ishte kujtue. Ajo paskej njohun disa shqiptarë, dhe paskej ra dakord me ta që t'ia blinin mobiljet e vjetra të familjës saj. Kështu ajo i kishte pranue me hy e me dale gjatë asaj kohë. Pra ato, sigurisht agjentë të Sigurimit shqiptar, kishin përfitue me vjedhë letrat me mjeshtri, duke i lane zarfat bosh siç ishin pakëtue. Poshtërsi e madhe që vetëm komunistët janë mjeshtra për me krye. Prej Gorit përfituem disa fotografi të babes dhe tonat që ajo kishte ruejtë e shyqyr që nuk ia kishin vjedhë edhe ato.

Shkova disa here në Romë, ku më mbajti dy javë shkolla ime ku isha kthye pas 50 vjet plot. Pata rast të takohëm me Nërmin Vlorën e te shoqin, Renzo Falaski, që kishte qenë oficer në Shqipni, pranë shtabit të Gjeneralit Dalmazzo, i cili më konfirmoi, se kur ndodhi kapitullimi i Italisë, Prenk Pervizi kishte ardhë me marrë në dorëzim komandën prej Dalmazzos, bashkë me oficerë të tjerë shqiptarë, ndër të cilët mbante mend gjeneralin Gustav Mirdashin. Në Romë jetonte edhe Taf Pervizi, fis i vjetër yni, i cili kishte qenë në grupin e Bajraktarit kur ishin nisë me dale në Greqi nga Maqedonia, dhe se nga 84 vetë vetëm 24 kishin mbrritë në Greqi, edhe ato të gjithë të plagosun. Të tjerët ishin vra në përpjekje. Ai me tregoi se si ishte takue me babën që ishte gëzue sikur t'ishte nje djalë i tij, pse edhe Tafa ishte një i ri shumë i pashëm e shtatnaltë që i përgjigjej races sonë. Mandej kishte ndejtë me tim atën në Romë, ku ai vinte prej Greqie në mbledhjet e "Komitetit Shqiperia e Lirë", me qendër në Romë e me Kryetar Dr. Zef Palin, nga Shkodra. Aty bashkohëshin ne ato vitet e para deri më 1954-56, im atë me Bajraktarin, Fiqri Dine, Abaz Kupin, Ernest Koliqin, Gjon Marka Gjoni e të birin, Nduen, si dhe Taf Pervizin e të tjerë për të trajtue problemin shqiptar dhe a mund te gjendej një zgjidhje. Asgja s'u ba. "Komiteti" u transferue nga Roma në New York, ku kryetar u caktue Rexhep Krasniqi. Përveç Bazit Canes asnjë prej tyne nuk shkoi në Amerikë. Një pjesë qëndruen ne Itali të tjerët u vendosën në Belgjikë, që ishte qendra ma e njohun e

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

mergatës shqiptare, qyshë me 1956. Im atë do të shkonte atje, 10 vjet ma vonë, më 1966.

Por ai, duke konsiderue se duhej gjetun një formulë për organizimin e shqiptarve të diasporës dhe nje far bashkimi të tyne, hartoi një projekt për formimn e një detashmenti ose batalion ushtarak të rregull shqiptar per me luftue në Vietnam si vullnetarë, bashkangjitun trupava te tjera të OKB, përkrah forcave amerikane. Kuadrot oficerë shqiptarë kishte, ashtu dhe ushtarë, që ishin gati me u përfshi të gjithë, kush mundte. Kishte bisedue me Bajraktarin e te tjerë oficerë që e kishin aprovue atë projekt. Po t'ishte se krijohej ajo force e rregullt shqiptare, atëhere hapej rruga për një organizim ma të gjanë, që bahej shkak për bashkimin e gjithë forcave shqiptare pa dallim rreth atij kontingjenti ushtarak, nën komandën e oficerëve ma të mire y të Shqipnisë.

Një të hartue projektin dhe ia nis drejt "Komitetit Shqipëria e Lirë" që t'ia paraqiste qeverisë amerikane dhe drejt Presidentit të asaj kohë, Kenedit, të cilit im atë i kishte shkrue një letër që mjerisht nuk me ra në dorë, por që miku ynë Ded Volaj e kishte pa me sytë e tij. Jo që kjo u vërtetue nga letërkëmbimi midis babës dhe Rexhep Krasniqit, ku Rexhepi e falënderonte dhe e përgëzonte atë për projektin, por qe qeveria amerikane nuk e kishte aprovue, sepse në Vietnam nuk pranohëshin forca vullnetare, por vetëm reparte t'ushtrisë efektive të shtetëve anëtare të OKB. Kështu kjo orvajtje nuk pati sukses, por qellimi dhe projekti mbetën të randësishëm e tregojnë se im atë çeshtjen shqiptare e mbante në mendje e në zemër për t'i gjet zgjidhje. Mjerisht nuk kam arritë që ta gjej projektin, megjithëse kam nderhy me anë të disa miqve që jetojnë në Washigton, mos ai projekt gjendët në arkivin e Shtëpisë së Bardhë a gjekund tjetër. Im atë bashkëpunoi vazhdimisht me Muharrem Bajraktarin me të ciilin e lidhte një miqësi e madhe e kalitur gjatë kohës së vështirë të krijimit e stabilizimit të shtetit shqiptar. Mbetët historike e lëgjndare koha e Belgjikës, ku dy miqtë gëzonin respektin dhe admirimin e bashkatdhetarëve për aftësitë e tyre ushtarake, mençurinë e virtësinë dhe virtytet e larta shqiptare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Leter e Gjeneral Prenk Pervizit
Kryetarit të Komitetit 'Shqpëria e Lire"
Z. Rexhep Krasniqi

Belgjike, Jolimont me 21 Shtator 1966

Zotni Rexhep!

Po ju njoftoj se jam transferue prej Greqie ktu ne Belgjike definitivisht me datë 15 Fruer 1966, me aprovimin e të Deleguemit te Kombeve te Bashkueme n 'Athine e t'Organizates se Pergjithshme te refugjateve t'Europes ne Gjeneve (Svicer).

Per nderimin e grades se nalte qe kam pase si dhe per rekomandimin e nje miku te madh, kan ba perjashtim, tue me vendose ne nje vend te zgjedhun ne nje apartament special...

Siç e dini, une at Komitet qe asht formue me at kriter te dijtun e kam njofte qyshe ne fillese, sepse un kam qene kurdohere edhe jam i idese se organizata te ketilla duhet te jene pa ngjyra partinash, per te ba orvajtje vetem per Shqipni e jo per interesa partinash meskine. Jam e mbetem i deklaruem indipendent (dmth. i pavarun).

Ne Greqi kam pase nje mik privat, qe ka qene zengjini ma i madh i Greqise e me influence te gjane. Ky mik i madh vullnetarisht e bujarisht me ka ndihmue financiarisht per 19 vjet rresht. Une kam ba nji jete princi e luksoze ne saje te tij, e po ne saj te tij te gjitha portat e atyne qe nuk ushqenin idena te mhrapshta per Shqipnine per mue rrishin te çeluna. Ky mik i jem, para disa muejsh vdiq befasisht nga zemra dhe une, mbas vdekjes se tij mbeta si peshku pa uje ....Greqia as zyrtarisht as anas nuk me ka pas ndihmue....Mbas vdekjes se ketij mikut nga qe edhe pak kam qene merzite aq gjate ne at vend, tue prite ndryshim te gjendjes kah Atdheu, pa muejt me pa rezultat etj., u shperngula në Belgjikë.

Bashkadhetaret tane te matun e te logjikshem e dijne ket te vertete se une ne Greqi rrnojshe me burim ekonomik privat e se me grek nuk kam pase asnje angazhim e nuk ka pase vend per as nje lloje fjale ose premtimi qe te cenoje çeshtjen kombetare tonen n'as nje pikpamje. Me gjithe kete asht per t'ardhe keq se pa e konstatue ket te vertete, disa shkatlane meskine nuk kan mungue me krijue fantazina te pa vend rrotull ndejtjes sime n'Athine e qe tani me ket transferim ose shperngulje s'andejmi, bjen poshte ky "myth" i tyne vetvetiu. Asht per t'i besue proverbit filosofik se "e vertetа mund te ndrydhet por nuk mund te shqymet nga se ma ne fund triumfon".

Per sa i takon demarsheve te mija ndeth thezes per « vullnetare » ne sherbin te USA per ne Vietnamin e Jugut, nuk me mbetet (veçse) te ju perseris

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

shenime tjera ne menyre private, perveç sa jane permende n'udhen zyrtare (me leter te drejtueme Komitetit t'uej, po me date te soçme e me te gjitha kopjet e dokumentave relative)

Une jam i bindun se nje intervenim i juej si Kryetar i Komitetit "Shqipnia e Lire" prane Departamentit te Shtetit te USA per Pune te]ashtme, me percjelljen e gjithe kopjeve te dokumentave (ashtu siç jane), jo vetem se kishte per ta forcue thezen e çeshtjes shqiptare, por kishte per te naltsue konsideraten e mire per ju personalisht, si edhe për Komitetin përgjithësisht.

Tue Ju urue suksese ne detyren e nalte t'uej, tue ju sigurue subordinimin t'em ne drejtimet e jueja, si per kohe paqe si per kohe lufte eventuale kah librimi i dishruem i Athdeut e tue ju paraqite te falat e perzemerta si ju personalisht, Z. Kryetar, si edhe bashkantareve, ZZ Neshat Peshkepise e Vasil Germenit. *

Mbetem i juej me stime e me bese.

Prenk Pervizi.

---

*Ky letërshkëmbim me Rexhep Krasniqit, vlen si një domument historik, që pasqyron ma së miri patriotizmin, qëndrimin dhe përkushtimn e Prenk Pervizit ndaj kauzës shqiptare me thirrje e përpjekje të vazhdueshme për bashkim. Mendohet se im atë ka pasë letërshkëmbim me patriotë të tjerë shqiptarë dhe me të huaj, që shpresojmë të gjëndën një ditë. S'ka dyshim se pranë Minstrisë Brendshme, në ndonjë skutë të arkivit ka dokumentë mbi Prenk Pervizin. Një kolonel i sigurimit ia kishte thanë një nipi të tij, i cili na njifte, se për Prenk Pervizit në Ministri kishte dokumentë e fotografi të jetës tij në mërgim. Ashtu dhe nga Ministria e Mbrojtjës, ku ishte i ikuadruem. Deri tani s'ka dalë asgja. E s'dihet a do të dalë një ditë, për si shkojnë punët. Tjetër çeshtje asht ajo e dokumentave të projektit të nje force ushtarake "vullnetare, për në Vienamin e Jugut, drejtue Qeverisë amerikane me anë to Komitetit Shqipëria e Lirë, më 1966, ku edhe ato s'janë gjendur. Ne s'i kemi pasut atoi mundësi që të ndërhyjmë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Pergjigje nga Kryetari i Komitetit Shqiperia e Lirë Z. Rexhep Krasniqi.

New York me 6 maj 1966

I nderëshëm Z. Gjeneral,

Para sa kohe e kemi marrë shkresen tuej te dates 21-4-66, bashhkë me kopjet e shkresave që ia keni dergue Ministrisë Mbrojtjtes së Shtetëve të Bashkueme t'Amerikës, percjellë me anën e Ambasadës Amerikane në Athinë (Greqi). Të gjitha shkresat në fjalë i kemi lexue me vemendje bashkë me antarët e Komitetit ZZ. Germenji e Peshkëpija, dhe ju pergëzojnë per idenë e bukur që keni pasë per me ofrue sherbimin e juej në luftën kundra agresionit komunist që po mundohet me robnue Vjetnamin e jugut, ashtu edhe me mund me formue një grup vullnetarësh prej bashkatdhetarëve tanë në botën e lirë. Megjithqë Komiteti asht në dijeni se Amerika per arsye parimore i asht shmangë idesë së formirnit të grupeve vullnetare të hueja që kishin me u perngja formacioneve merhume të legjionit t'huejve françez. Mbas hetimeve të rastit kopjet e shkresave t'jueja në fjalë i kemi dorzue aty ku duhet. Të shpresojmë se heret ase vonë, do të merrëni pergjegje në adresen e re t' Juejen. Na vjen keq per humbjen mikut të fort grek që keni pasë, gja që ju ka detyrue me lanë jeten e qetë dhe të sigurueme qe keni gëzue deri tani. Por n'anë tjeter gëzohemi bashkë me Ju që ma në fund me lidhjet që keni pasë, keni mujtë me i sigurue vetes nji vend aq të pershtatshëm në një nga vendet ma të shqueme të kulturës europiane, populli i të cilit asht diftue kaq bujar e zemerbardhë ndaj mija refugjatësh shqiptarë... Komiteti tash asht tue kalue një perjudhë kritike me veshtirësina financiare që na ka detyrue me kufizue veprimtarinë tonë në çfardo fushe të lufte antikomuniste. Kjo asht e verteta dhe vetem rrethana të papritshme mund të ndryshojnë ket realitet t'idhët.

Tue iu dishrue shëndet të plotë dhe të mira, edhe prej kolegëve t'mij Z.Z.Germenji dhe Peshkepisë, mbetem me nderime të posaçme . Rexhep Krasniqi.*

***--** Theksojmë një të metë nga Zoti Krasniqi, sepse ne s'dinim gja për projektin e krijimit trupash shqiptare per luftën e Vjetnamit, që e morëm vesh ma vonë. Ai duhet të na kishte dorëzue projektin po ta kishte ose udhëzue se ku mund ta kërkonim

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Ditët e fundit të një jete kushtue Atdheut

Nga mesi i muejt gusht im atë kishte marrë një ftohje që kaloi në bronkopneumoni të randë. I shtruem urgjëntisht në spitalin e madh Jolimont, të qytetiti La Luviere, nuk arriti me e marre veten, tashma në moshën 80 vjeç. Lajmi u hap dhe miqt e tij të përhershëm, Muharrem Bajraktari, me nipat e tij e miq të tjerë shkonin vazhdimisht me e pa e me u njoftue për shendetin e tij. Bajraktari i ndejti pranë gjithë kohën. Den Mjeku, nga Puka, me tregonte se nuk mbeti kush pa i ba vizitë dhe miqtë puknjanë e mirditorë aty i kishe gati përditë si dhe kurbinasit tij, si Brahim Bami e të tjerë. Edhe shqiptarë nga Parisi erdhën me e takue ne ato ditë të fundit të jetës tij. Me tregonte zoti Ramiz Zekolli, që rrinte vazhdimisht me Bajraktarin, dhe kishte shkue me të për me i ba vizitë të semurit deri në çastet e fundit, se Gjenerali e perballoi atë gjëndje me dinjitet e qendrim burrnor. Në ato çaste të fundit permendte emrin tim, duke u thanë të pranishëmve, se nga të gjithë njerëzi e tij i dhimbej ma shumë Leka, ma i vogli që ishte përfshi në moshë fare te re në terrorin komunist. Prej Ramizit kisha marre edhe njoftimin, për të cilin kemi shkrue ma nalt, se si im atë ishte takue me Zogun më Marseille, ku kishin shtrue çeshtjen e nje ndërhyemje në Shqipni, ku kishin ra në kontradita, sepse Zogu insistonte akoma te Jugosllavia (sipas kohës vjetër) që tani ishte krejt komuniste e Prenga te Greqia e cila se pakut ishte nje mbretni antikomuniste dhe e mbeshtetun nga Aleatët anglo-amerikanë. Te krevati i babës kishte ardhë edhe Pater Ambroz Martini, për funksionet fetare të rastit, në krahët e të cilit im atë kishte dhanë shpirt. Për varrimin e tij ishte interesue vetë shoqata e Karitasit në bashkëpunim me komunën ku ishte i regjistruem, që u ba në vorrezat Saint Pierre Lahay të qytetit La Louvière, në një parcelë që ishte enkas për ato personalitete që ishn arratisë nga vendet komuniste e quhej parcela e heronjve. Në cerimoninë e varrimit erdhën edhe nga Parisi dhe nga Londra. Atë folën me radhë, Pater Ambroz Martini, Muharrem Bajraktari dhe Refat Kolgjini. Por ishte fjala e Bajrktarit ajo që e nderoi kujtimin e Prenk Pervizit, mikut e kolegut tij të një jete të tanë kushtue Atdheut e Kombit shqiptar. Ky fjalim mu dha nga Ded Mjeku, që kishte ruejt edhe fotgrafinë e arkivolit të mbuluem me flamurin kombëtar.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Revista "KOHA E JONE"shtator 1977, botues Lec Shkreli

==========

VDIQ GJENERAL PRENK PERVIZI

Me 6 Shtator 1977 ne *JOLIIMONT (Begjlike)* vdiq Gjeneral *PRENK PREVIZI.* ku ishte strehue nga Caritas Catholica qe ne vitin 1966 kur emigroi nga Greqija.

Gjeneral Prenk Pervizi leu me 4 Mai 1997, ne *SKURAJ* (Krujë), dhe mesimet e para **i** kreu ne Shkoder. Me 1914-18 dergohet ne shkollen e oficicerave (Kadettenschule) ne Viene. Me 1918 kthehet ne Shqipni dhe si oficier i ri merr pjese me forcat vullnetare te *ELEZ ISUF NDREUT* e te *ALUSH AGE LUMES* te cilat aso kohe luftojshin kundra invazionit serb.

Me 1924 Gjeneral Pervizi largohet nga Shqipnija bashke me *ZOGUN* ne Jugosllavi dhe kthehet ne dhjetor te atij vjeti ne Tirane me graden Major. Tue qenese Shipnia ishte nda ne kater zona ushtarake. Gjeneral Pervizit i besohet zona ushtarake e Tiranes (1924-1929) e ma vone e Korçes (1936-1939 me graden N/Kolonel Prej vjetit 1939 deri 1943 me gradat suçesive Kolonel e Gieneral asht ne dispozicionit te Komandes se Pergjitheshme. Prej vitit 1943 deri ne Tetor 1944 Gjeneral Pervizi asht Komandant **i** Mbrojtjes Kombetare.

Trupi i Gjeneral Pervizit u varros me 7 shtator ne Jolimont, dhe ne Kishen e Institutit ku ishte strehue. Frati Shqiptar At *Ambroz MARTINI,* kreu funksionet fetare dhe e perkujtoi te ndjerin me fjale e shprehje prekese tue vue ne pah cilesinat dhe meritat e tija.

Trupj **i** Gjeneral Pervizit u percuell prej mase 300 Shqiptarve dhe mbajten fjalime shoku i tij i armeve Kolonel Muharrem Bajraktari dhe patrioti Rifat Kolgjini. Arkivolin te mbuluem me flamurin kombetar e stolisnin dy kurora: ajo e Kol. Bajraktarit dhe e Bllokut Kombetar Indipendent.

Redaksija e te perkoheshmes *Koha e Jone* gamilies e fare e fisit ne Shqipni u paraqet ngushllimet e veta.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2019)

Fjala e Kolonel Muharrem Bajraktarit në varrimin e Prenk Pervizit Saint Pierre de Lahay më 7 shtator 1977

Të Nderuem bashkatdhetarë,

Po përcjellim sot për në banesën e fundit një nga figurat më të shqueme të patrioizmit shqiptar dhe figurën ma të naltë ushtarake që ka pasun ushtria shqiptare, si edhe mikun më të shtrejtë timin, dhe bashkatdhetarin e nderuem e të dashun të mërgatës sonë, gjeneralin Prenk Pervizi.

E kam pasun mik të ngushtë, koleg e bashkëluftëtar të disa betejave, kundër forcave serbe, kundër banditizmit, kundër rebelizmit të nxitun nga armiqtë e huaj, serbë, grekë dhe italianë, për të copëtue vendin tonë edhe ma tepër nga ç'e kishin copëtue.

E kam njohun në detyrat më të vështira të përbashkëta, per afirmimin e shtetit të ri ligjor shqiptar, të sapo dalë nga Kongresi i Lushnjës më 1920, duke përballue operacione të vështira, për të vendosun rendin e qetësinë kudo. E kam admirue për cilësitë e rralla dhe për përgatitjen e naltë ushtarake. Ai ishte pajisun edhe me virtytet më të mira shqiptare, si besa, burrnia, trimnia, bujaria, urtësia, fisnikëria dhe dashunija për Atdhe e Komb. I doli zot Atdheut në ma shumë se një çast të vështirë e të rrezikshëm, duke zgjidhun situata kritike, për vetë ekzistencën e Shtetit shqiptar. Ndërhymjet e tij qenë vendimtare për fatet e Atdheut dhe koha e historia kanë për të nxjerrë në pah e në dritë veprimtarinë e tij patriotike në dobi të çështjes kombëtare. Si në Shqipni. ashtu edhe në mërgim, ai qëndroi i pavarun nga partitë politike, tue ba thirrje e tue na frymëzue vazhdimisht për Bashkim. Veçanërisht mbas ardhjes në fuqi të komunizmit ai u përpoq, bashkë me patriotët e tjerë, për të arritë atë Bashkim të nevojshëm që ti bante ballë gjëndjes së pushtimit të sllavo- komunistëve Me Prenkën më ka lidhë një jetë e tanë dhe asnjé çast nuk qëndruem pa qenë në marrëveshje me njëni-tjetrin si në kohën e Mbretnisë, po edhe gjatë pushtimi te huej italo-german dhe ma vonë në mal, në qëndresën kundër komunizmit. U detyruem të largohemi nga Shqipnia, sepse komunizmi po bahej gati për t'u bashkue me Federatën jugosllave e s'kishte vend ma për ne. Ndatët na lanë në baltë dhe ne vendosëm të krijojmë qëndresën jashtë kufijve. U perpoqëm, por

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARTI BARLETI" SHKODËR (2018)

gjithmonë na sabotuen të huejt. Prenka, siç dîhet u arratis nga Shqipnia në një mënyrë tepër të guximshme, që e bani Sigurimin të luej menç dhe kjo ishte një mëritë e aftësive dhe trimnisë së tij të pashoqe. Fjalimet e tij mbeten të paharrueshëm, për thellësinë e trajtimit për të nxitun Bashkimin e të gjitha forcave politike në mërgim, si e vetmja mënyrë për të arritun një sukses në luftën kundër komunizmit, që në Shqipni po bante namin mbi atdhetarët e mbi famijet tona.

Duke përciellur mikun e madh e bashkatdhetarin e shquem, patriot e burrë shteti, gjeneralin Prenk Pervizin, ne përcjellim një pjesë të randësishme të historisë se Shqipnisë që lidhet me emrin e tij, ku ai luejti gjithmonë një rol qendror e vendimtar! Deri në çastin e fundit ai qëndroi si burrë fisnik e nuk e dha kurrë veten, me pikëllimin e vetëm që nuk po vdiste në truellin e shejtë të atdheut të shtrejë e nuk do të varrosej atje ku janë varrosun prej shekujsh të parët e tij. Një pikëllim që mbetet për të gjithë mërgatën. Asnjë njeri i familjes së tij nuk gjendet këtu sot. Ata janë të mbyllun atje, ndër burgjet e kampet e internimit të diktaturës komuniste. Prandaj e ndjej për nder e detyrë t'ia bajmë varrimin edhe në emën të familjes së tij te martirizueme. Na takon t'u përcjellim amanetet e mikut e bashkatdhetarit tonë, djemve dhe nipave të Prenkës, kur të vijë koha e lirisë për Shqipninë.

Qoftë i përjetshëm dhe i nderuem kujtimi yt, or mik i shtrejtë Prenk Pervizi !

New York më Nëndor 1992 dhe përfundimi i librit

Në fillim të Nëndorit 1992 shkova në New York, për me u takue familjën e vëllait dytë Gencit, që kishte vdekë në kampin e Grandisihtës më prill 1989. E shoqja, Albina, me katër djem e dy vajza kishin shkue në New York ku e ama e tyne, Albina, kishte një vëlla t'arratisun qysh më 1952, Rudolf Marashi, djali i vogël i major Llesh Marashit, i cili i kishte tërhequn atje. Mbrritja ime në New York me bani të njoh mjaft shqiptarë të vjetër, ndër to kushrinin Ndue Gjomarkun, në moshën afro 80 vjeç ku i bana vizitë me dajën tim Preng Paçuku, që kishte ba burg me Gencin, dhe kur u dirue ishte arratisë.

Ndou u përmallue, se nuk shifëshim nga viti 1942 kur unë isha fëmijë. Aty ndër të tjera, Ndou me tregoi se si im atë kishte ba një gabim të madh mos me pranue nënshtetësinë italiane, ku do të kishte rueitë gradën e tij të naltë si gjeneral dhe do të kishte marrë rroga të majme dhe do të na kishte lanë një

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

trashëgim ligjor të pensionit të tij. Nga ana tjetër do ti kishte shërbye kauzës shqiptare kundër komunizmit, me autoritetin dhe influencën që do kishte fitue. Ndou më tregoi si Kapidan Gjoni i kishte folë me ia mbushë mendjën, por me kot se ai nuk e honepste fare atë nënshtetësi, biles e quente si një turp të madh po të kishte pranue.

Mora pjesë i ftuem në mbramjën e festës së 28 Nëndorit, ku u njoha me miq të vjetër të babës, ndër ta Rexhep Krasniqin, që u gëzue shumë kur me pa e njohu, dhe me foli fjalë të mira për tim atë, me të cilin ishte i miqësuem qysh në kohën kur ishte ministër. Rexhepi, e mori vesh se une do të kthehësha shpejt në Belgjikë e më mori adresën, sepse kishte një letër nga im atë, si dhe një fotografi të tij. U njoha me Kryetarin e Shoqatës Vatra që ishte zoti Karaxhozi dhe që drejtonte gazetën Dielli, ku ai më propozoi të merrja redaksinë, sepse gazeta ishte në gjendje të keqe e gati mos me u botue, për mungesë mjetësh, sepse nuk kishte t'ardhuna e shqiptarët nuk kontribonin as abonohëshin. Me ripërtrijen e saj, me ardhjen tuej (emigracioni i ri), më tha, ishte shpresa qe gazeta Dielli të vazhdonte të botohej. Unë nuk kisha si me pranue sepse tashma isha vendosë në Belgjikë, prej ku nuk do të largohësha.

Erdhi me më takue edhe Ndue Pjetër Gjomarku, me dy mirditas, ku ndër të tjerat më tregoi, se kur kishte kalue në Greqi me gjithë vëllanë Gjon, kishin mbetë të plagosun nga rojet shqiptare të kufinit. I kishin çue në Athinë ku i kishin shtrue në spital. Gjenerali, tregonte Ndou, erdhi me na pa, bashkë me Muharrem Bajraktarin, per me u sigurue për shëndetin tonë, sa e kishte marrë vesh, që ishim plagosë në kufi dhe na kishin shtrue në atë spital. Jo vetëm për ne, që na njifte se kush ishim, por edhe për shqiptarë të tjerë që plagosëshin në kufi prej rojëve komuniste, ai tregonte kujdes dhe shkonte me i pa në spitalet ku ishin shtrue për mjekim. Një sjellje fisnike e tij që e karakterizonte dhe për të cilën kishte fitue respektin dhe admirimin e shqiptarve që ishin arratisë duke rrezikue edhe jetën, dhe shpesh mbeteshin të plagosun dhe linin pas edhe shokë të vramë. Këto ishin disa të dhana për prindin tim nga shqiptarët emigrantë. Në përgjithësi jeta në emigracion nuk i jepte hapësinë veprimi shqiptarve, sepse të huejt nuk e kuptonin realitetin shqiptar, sa që pati orvatje nga vete ana amerikane për të lidhë marëdhanje diplomatike me regjimin diktatorial e tiranik t'Enver Hoxhës. Kjo do të kishte qenë një padrejtësi e madhe që u bahej atyne që vuenin të zezat e ullinit, të mbyllun në burgje e kampe internimi. Aq ma keq, kur mendon se sa mija vetë u pushkatuen, ndër ta, pjesa ma e ngritun e intelektualëve të shqipnisë. Në një bisedë kafeneje me Ded Mjekun, kur ky e kishte pyet pse nuk ishte angazhue në ndonjë institucion ushtarak, si Nato etjera, im atë i ishte përgjigjë, se të huejt sa do të mire që shiten, nuk ta lrojnë karrikën e tyne, prandaj or Dedë, ne këtu jemi si peshku jashtë ujit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Këtu i japim fund këtij përshkrimi të jetës dhe veprimtarisë të tim etit që ndonse me vonesë, arritëm të rreshtojmë e të përmbyllim, për të ia ba të njohun publikut shqiptar, e sidomos historianëve, ku patjetër do të gjajnë materiale mjaft intersante për ndriçimin sa ma të mire të historisë shqiptare. Sado që asht ndjekun një vijë tregimtare e lirë, gjithshka që asht shkrue lidhet me rrjedhën e vërtetë të ngjarjëve historike shqiptare ku Prenk Pervizi ka qene i përfshirë nga fillimi deri në fund, jo vetëm si shoqnues i saj, por edhe si faktor vendimtar në ngjarje jetike për Shqipninë e Kombin shqiptar.



Muharrem Bajraktari e Prenk Pervizi Nënkolonela 1936, shokë armësh e shokë detyrash.



PRENK PERVIZI



MUHARREM BAJRAKTARI

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Në mërgim në Belgjikë dy kolegët e miq të pandamë të një jetë të tanë kushtue Atdheut e Kombit Shqiptar.

Katër oficerët shqiptarë më të shquar të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare




PRENK PERVIZI
1897- 1977



M. BAJRAKTARI
1896-1990



FIQRI DINE
18977-1960



HYSNI DEMA
1898-1952

Katërshja dominuese e periudhës 1924-1929 që anglezi Julian Amery (Lord Amery) quajti "Kuadrumvirat (sundimi i të katërve). Këta burra u bënë në radhën e patriotëvee ushtarakë të cilët bashkëpunuan me Mbretin Zog për t'i shërbyer Atdheut.
Të katët këto burra u arratisën më 1946 e jetuan e vdiqen ne dhe të huaj.
Padyshim se u asht mohue e injorue gjithë jeta e veprimaria patriotik nga ana e historianëve të regjimit komunist e në vazhdim edhe sot e kësaj dite nga pasuesit e tyre që vazhdojnë të fallsifikojnë historinë shqiptare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

PERSONALITETE POLITIKE E USHTARAKE TE BOTES SHQIPTARE ME TE CILET PRENK PERVIZI KA PASE MIQESI DHE KA BANSHKEPUNUE PER TE MIREN E ATDHEUT.



AHMET ZOGU
Arratisur



MEHDI FRASHERI
arratisur



REXHEP MITROVICA
arratisur



MITAT FRASHERI
Arratisur



BAHRI OMARI
pushkatuar




IBRAHIM BIÇAKU
burgosur



LEF NOSI
Pushkatuar



XHAFERR DEVA
arratisur



KAPIDAN GJONI
arratisur

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



MIHAL ZALLARI
Burgosur




REXHEP KRASNIQI
arratisur



XHAFERR YPI
pushkatuar




GUSTAV MIRDASHI
Pushkatuar



AQIF PERMERTI
pushkatuar



SAMI KOKA
vdekur ne burg



ANTON HARAPI
Pushkatuar



GJERGJ FISHTA
çvarrosur e tretur eshtrat



MARK GJOMARKAJ
vrarë në mal

Këto janë disa figura të shquara te politikës dhe patriotizmit shqiptar, me të cilat Prenk Pervizin e lidhnin detyra dhe miqesia.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Dokumente sekrete nga Ministria e Brendshme e Italisë

Dokument sekret
Romë, 15 nëntor 1934
Nr.300/3590

Ne rrethet shqiptare është komentuar shumë qendrimi i gjatë i Çatn Saraçit që ishte ndaluar në Paris për më tepër se dy javë. Në atë qytet ai ka pasë takime me elementë të dyshimtë që janë nisur nga Tirana me detyra të rrezikshme. Prania e njëkohëshme e Çatin Saraçit e të Kolonel Prenk Pervizit të thirrur nga Qeveria shqiptare, ka rëndësinë e vet për karakterin e besimit absolut që gëzojnë këta dy personat e lartpërmandur pranë Mbretit Zog që për intrigat e tij përdor elemntin katolik dhe jo atë musulman, për t'i skredituar më tepër të pafetë (krishterët). Në Francë ka shumë agjentë të derguar jashtë shtetit për qëllime kriminale nga regjimi i Tiranës. *

---

*-- Në fakt Prenk Pervizi, mbasi mbaroi Shkollën e Luftës në Torino me qershor 1933, qëndroi në Firence me familjën deri në fund të 1934, si ispektor i studentëve shqiptarë të Italisë. Dyshimi i shërbimit italian, tregon se si Prenk Pervizi ndiqej e kontrollohej në lëvizjet e tij, edhe pse krejtësisht normale. Ndërsa Çatin Saraçi ishte një diplomat e mik i ngushtë e i besueshëm i Zogut, dhe sigurisht i kishte në detyrë lëvizjet e takimet e tij. Të dy këta persona i përkisnin një miqësie të lidhun me Zogun qyshë në Vjenë, 1914-1918, dhe pastaj në detyrat e ndrysme, Prenk Pervizi si ushtarak, e Çatin Saraçi si diplomat.

Tjetër dokument i Shërbimit Sekret italian mbi lëvizjet e Prenk Pervizit, emigrant politik në Greqi

Napoli 6.X.1953 - Nr.30/2576 - 224/31840 - SINJALIZIM -
z. DREJTUES ZYRES VIGJILENCES HUAJVE pranë Kuesturës GENOVA

Me dt 2 të këtij, i ardhur nga Roma ka arrit në Napoli duke u vendos në Hotel "S. Lucia" , qytetari shqiptar, PRENK DEFRROK PERVIZI, mbi kartvizitën e të cilit, të varur mbi valigjën, është shkruar, " PRENK DEFRROK PERVIZI, ish Gjeneral i Mbrohtjës Kombëtare të Shqipërisë.
Pasditën e djeshme, dt. 5 i këtij, është pâraqitur në hotel një individ, me theks te huaj, i cili ka kërkuar takim me Gjeneralin.
Personelit të hotelit, i panjohuri që s'ka pranuar të tregojë emrin e tj, ka deklaruar se duhet të dorëzojë PRENKES një biletë, që i përkthyer nga anglishtja, kishte ketë tekst

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

: “Koloneli JAMARAS Vasili nuk është në Napoli, por në Gjermani. pa firmë. I panjohuri si mori vesh se PRENK nuk ishte në hotel tha se do të vinte përsëri. Deri tani s’është dukur më. Gjen. PRENK, që është objekt mbikqyrje, nga mbramja, po nuk ndryshoi vendim, do të niset me tren për në Genova. Ai mban një valigje luksoze dhe pô ashtu sende përdorimi, si kuti cigarësh, çakmak, cigarishte dhe zinzxhir çelësash, të florijtë. Rezevohëmi të njoftojmë çdo gjë tjetër të dobishme që mund të jepët nga shërbimi i mbikqyrjës në vazhdim.* Përsa i përket veprimtarisë së tij në mërgim, flasin disa dokumentë të Ministrisë së Brendshme italiane, ku del se ai ndiqej nga sigurimi italian dhe mbahej nën vëzhgim për lëvizjet e kontaktet e tij në Itali , veçanërisht në vitin 1954, kur paskej bërë disa udhëtime e kontakte ne qytetet Romë, Napoli e Gjenova. Janë 11 dokumentë që na u dërguen nga miku dhe histioriani e diplomati Bejtollah Destani në Ambasadën e Kosovës në Romë, të cilit i shkojnë falemenderimet tona. Jo vetëm kaq, po nga një dokument tjetër del se ai ndiqej e vëzhgohej nga shërbimi sekret italiane edhe ne kohën e Mbretërisë kur ishte kolonel, e ku cilësohej i rrezikshën dhe besnik i Mbretit Zog, bashkë me diplomatin shkodran Çatin Saraçi. Dikush me pat njoftue se nje shkodran kishte gjashte letra të Prenk Pervizit dergue Mehmet Verlacit në Itali. Ky ishte i biri i Shefqet Verlacit e bante pjesë në Bllokun Indipendent. Këto letra nuk na kane ra ne dore sepse ai personi as lajmëroi as u interesue me i tërheqë se pakut si kopje.

---

*-- Dokumentët e mësipërm i kemi cituar si një provë e veprimtarisë të PrenK Pervizit edhe në kushtet e emigracionit politik kur u largua nga Shqipëria për në Greqi më 1946. Siç shihet, Prenk Pervizi, ndonse emigrant politik në Greqi, ndiqej e vëzhgohej në lëvizjet e tij, kur kalonte në Itali. Ai i kishte agjentët e fshehtë pas shpine kudo që shkonte e udhëtonte . Patjetër se do te këtë edhe dokumenta të tjerë të llojit. Për tani ne u mjaftuem me këto dy shembuj.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
“MARIN BARLETI”
SHKODËR (2018)

Përshkrim kronologjik

4 maj 1897, lindi në Skuraj të Kurbinit.
6 shtator 1977, vdiq në Jolimomt të Belgjikës.

Shkollat :

1904 – 1914, kreu fillorën dhe gjimnazin në Shkodër
1914 – 1918, kreu Akademinë Ushtarake në Austri, Vienë.
1929 – 1934, kreu Shkollën e Luftës (Shtatmadhorisë) në Torino

Karriera ushtarake.

1918:-1920 : Toger rethh komandanti i Krujës
1920-1922 : Kapiten me detyra të ndryshme.
1922 –1924 Kapiteni Kl. I-rë për merita lufte.
1924-1929- Zonë- komandant i Qendrës (Tiranë e rrethe)
1929- Major (në Shkollën e Luftës Torino)
1933 – N/Kolonel, pas mbarimit Shkollë Luftës.
1937 : Kolonel, më 25 vjetorin e Pavarësisë.
1942 -43: Gjeneral Brigate
1943-45 : General Divisoni, Ministër i Mbrojtjës.
1946-1977 : Gjeneral, emigrant politik.

Detyra e veprime ushtarake :

1918-1920. Reth komandan i Krujës
Janar 1920 : në mbrojtje të Kongresit të Lushnjë
1920-1921 : Në shtabin e operacionëve për dëbimin e Serbëve
1921 : në shtabin e operacionit për shuarjën e rebelizmit të Mirditës.
8-9 Mars 1922 : mbrojtja e Tiranës kundër rebelëve, shpartallimi i grushtit shtetit.
Nëntor –Dhjetor 1926 : shuarja e kryengritjës. Dukagjinit
1929-1933 : Shkolla e Luftës e Torinos.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

1933-1935 ; Ispektor i studenteve të Italisë.
1935-1936 : Në komisionin e Vezhguesve te Luftës së Abisinisë.
1936-1938 : Përfaqësues i Shqipërisë në Manovrat të Mëdha të Italisë.
7-9 prill 1939 : në Korçë, i panjoftuar për sulmin fashist, mbron e përciell Mbretin Zog në Greqi.
1941 : lufta italo-greke, urdhëron braktisjën frontit nga trupat shqiptare.
1941-1942 : si kundërmasë, izolohët në malet e Pukës.
Janar 1942, gradohet Gjeneral brigate.
8 shtator 1943 : kapituillimi Italisë, merr në dorëzim Komandën nga Gjenerali Dalmazzo.
1943 - 1944: Ministër i Mbrojtjës me gradën Gjeneral Divizioni.
1944 : gusht-tetoir, me misionin anglez në mal.
1944-1946 : I arratisur ne mal, largohët në Greqi.
1946-1977 : . emigrant politik në Greqi, Itali e Belgjikë ku vdes më 6 shtator 1977.

Dekorata :

- Medalje e Artë e Trimërisë (1922)
- Medalje e triumfit te Legalietit (1924)
- Urdheri Skendrbeut (1927)
- Urdhëri kalorsiak i SS. Maurizio e Lazzaro (1933)
- Urdhëri i Besës (1937)
- Urdhëri i Kurorës së Italisë (1937)

Ka dhe dekorata të tjera që duhet të verifikohën.

Tituj:

- Qytetar Nderi i Bashkisë Laç – Kurbin, 2002.
- Qytetar Nderi i Skurajt-Kurbin, (vendlidja),2005
- Qytetar Nderi i Komunës Milot-Kurbin, 2005

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Jeta, detyrat e veprimtaria, përmbledhje sipas datave kryesore

28 nëntor 1912, 15 vjeç, merr pjesë me studentë të tjerë e luftëtarët kurbinas, në ngritjen e flamurit kombëtar në Milot, pranë axhës tij Gjin Pjetër Mark Pervizit të Skurajve, udhëheqës i kryengritjes së Kurbinit kundër pushtimit turk. Ngritja e flamurit nga Gjin Pjetri ishte në marrëveshje (telegram) me Ismail Qemalin.

1904-1914, kryen gjimnazin në Shkodër.

1914-1918, kryen Akademinë ushtarake në Vjenë t'Austrisë. Njihet e miqësohet me Ahmet Zogun., me të cilin kthehët në Shqipni më nentor 1918.

.

1918 – 1920, toger, rrethkomandat i Krujës, kalon pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Martohet me Prena Gjokolaj (Paçukaj) nga Rrësheni.

Tetor 1920, merr pjesë aktivisht në mbrojtjen e Kongresit të Lushnjes me kuadrot e tjerë oficerë dhe forcat ushtarake shqiptare.

1920 – 1922, në Komandën e operacionëve për dëbimin e forcave serbe, dhe kundër bandave të veriut bashkë me, Ahmet Zogun, major Preng Jakun, Bajram Currin, Elez Isufin, Alush Agën e Lumës, Ahmet Satën, Dërvish Dumën, Muharrem Bajraktarin, Gjon Fushën, etj., ushtarakë. Njëkohësish më 1921 me major Preng Jakun, shuejnë kryengritjen e Mirditës, e nxitun prej Jugosllavisë.

8 mars 1922, i lidhur me Ahmet Zogun, mbron Tiranën, nga grushti i shtetit të Elez Isufit, duke i shpartalluar forcat rebele që ortaeshin të pushtonin kryeqytetin e Parlamentin e të rrëzonin Qeverinë ligjore. Kjo i dha mundësi Ambasadorit anglez Ayres të ndërhyntë për të qetësuar gjendjën. Gradohet kapiten i Kl. I-rë për merita të veçanta e dekorohet me medalje e trimnisë. Në Nëntor Ahmet Zogu bahet Kryeministër.

24 Qershor – 24 dhjetor 1924, Perkrah dhe ndjek Zogun në Jugosllavi, ku ban pjesë në shtabin qendror të operacioneve me në krye Zogun,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

kolonel. Shtabi Qendror i operacionëve përbahej nga: Kryetar Ahmet Zogu, dhe kapitenët, Prenk Pervizi, Muharrem Bajraktari, Fiqri Dine, Hysni Dema, Ceno Beg Kryeziu etj.

1924 – 1929, Presidenti A. Zog, ndan Shqipninë në katër zona e krijon një kuadrumvirat (sundimi i të katërve) në rang guvernatorësh ushtarakë ose zonë-komandantë, me Prenk Pervizin, Muharrem Bajraktarin, Fiqri Dinen e Hysni Demën, me fuqi të jashtëzakonshme që vareshin vetëm prej tij. Prenk Pervizi caktohet zonë-komandant i Qendrës (Tiranës). Mbrenda pesë vjetëve ky kuadrumvirat i çeliktë vendos rendin e stabilizon përfundimisht vendin. Kjo përiudhë mund të quhet si periudha që u dominua nga këto katër oficerë, në rang guvernatorësh ushtarakë, ku Prenk Pervizi luajti rol kryesor e qëndroi pranë Zogut, si krah i djathtë i tij.

Nendor - Dhjetor 1926, pelcet kryengritja antikombëtare separatiste e Dukagjinit me epiqendër Shalë e Shosh organizuar, nxitur e paguar nga Jugosllavia, që rrezikonte vetë ekzistencën e Shtetit Shqiptar. Zgjidhja e kësaj krize të rëndë, iu besua nga Presidenti A. Zog, Prenk Pervizit, që i dha komandën supreme të operacionëve me fuqi të jashtëzakonshme. Me një strategji befasuese e mposhti kryengritjen brenda një kohë rekord, që mrekulloi e çuditi edhe këshilltarë anglezë dhe hollandezë, dhe i dha lavdi të madhe emrit tij. . Gradohet major. Qëndron në këtë detyrë deri 1929. Gjatë kësaj kohë bashkëpunon me Gjeneralin Percy për formimin e kuadrove të Xhandarmërisë.

1929 – 1934 vazhdon e kryen Shkollën e Luftës (Shtatmadhorisë) në Torino. Dallohet në manovrat të përfunimit të shkollës. Dekorohet me urdhërin e lartë kalorsiak, SS Maurizio e Lazzaro. Gradohët Nënkolonel. Transferohet në Firence ku caktohet me detyrën e inspektorit të stundentëve shqiptarë në Itali. Kthehët në Shqipëri, ku caktohet pranë Ministrisë së Mbrojtjes me detyra organizative, ku punon e ndikon për modernizimin e ngritjen profesionale të ushtrisë. Krijon e derjton kurset e plotësimit ku jep vetë mësim.

1935 - 1936 përfaqëson vendin në Komisionin Ndërkombëtar të Vezhguesve në luftën e Abisinisë i përbërë nga oficerë (kolonela), amerikanë, austriakë, japonezë, portugezë, rumunë, hungarezë, që qëndrojnë pranë shtabëve të Gjeneralëve, De Bono, Badolio e Graziani. Kupton qëllimin e pushtimit të Shqipërisë nga Italia (nga Musolini).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

paralajmeron Mbretin Zog për këtë rrezik. Me rasin e 25 vjetorit të Pavarësisë, 28 nentor 1937, gradohet kolonel e dekorohet me urdhnin e lartë të "Besës", dhe me Urdhërin e Lartë të Kurorës së Italisë për misionin në Luftën e Abisinisë.



Fiqri Dine Prenk Pervizi Muharrem Bajraktari Hysni Dema

Katër Zonë Komandantët fuqiplotë të Shqipërisë, 1924-1929, qe bashkë me Zogun afirmuan Shtetin e Ri shqiptar, ku roli e ndikimi i tyne ka qenë vendimtar.

Një fotografi historike, prove e padiskutueshm e randësisë e autoritetit që kishin këta katër burra që me te drejtë, Julian Amery e quejti "Kuadrimvirat" (sundimi i te katërve) sipas termit latinisht të romakëve.

7 – 9 prill 1939 Pushtimi i Italisë fashiste e gjen në Korçë të palajmeruar e panjoftuar nga askush, as nga Ministria e Mbrojtjës as nga Mbreti Zog. E merr vesh vetëm nga radiot e huaja. Me trupa të pakta e pa armatime të mjaftueshme, vendos të organizojë luftën popullore me armët personale të popullit e furnizim armatimesh nga ana greke, të premtuara ne rast rreziku nga Italia. Ky plan dështon sepse detyrohet t'i dalë zot mbrojtes e përcielljes së Mbretit Zog në Greqi. Para se te dale ne Greqi, i ban thirrje mbretit për të leshuar kushtrimin dhe për të filluar luftën popullore në mal, por Zogu nuk pranon këtë propozim, sipas tij për të mos dëmtuar popullin e vendin. Kthehet në Shqipëri, me urdhër te fundit të vetë Zogut, ku mban një fjalim n'emër të tij. Ishte fundi i Mbretërnsë shqiptare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MAJIN BARLETI" SHKODËR (2015)

1939 – 1940 Ka takim me Gjeneral Pariani (Mëkëmbës), të cilit i parashtron se ushtria shqiptare do të qëndronte e pavarur dhe pasive, e nuk do të merrte pjesë në veprime kundër popullit të tij, krah ushtrisë italiane. Ai qëndroi përdokohë në dispozicion. Mbahet nën vëzhgimi te SIMI- it, (Shërbimi sekret italian).

1940 – 1941, Lufta italo – greke. Disa batalione shqiptare u përfshinë në divisionet italiane, Julia e Venecia. Prenk Pervizi u caktua në zonën e Korçës – Ersekë –Bilishtit, komandant regjimenti ku përfshihej batalioni "Tomorri" i major Spiro Mosiut. Lindën kundërshtime me italianët e ndodhën incidente, me asgjësimin e n jë njësiti shqiptar. Prenk Pervizi, kundësrhtoi pranë komandës italiane ku u shpre se "ushtria shqiptare s'bahej mish per top". Planifikon me komandën shqiptare e urdhëron braktisjen e frontit. Italianët pësojnë një disfatë të madhe. Ushtria shqiptare hiqet nga fronti. Prenk Pervizi, izolohet në malet e Pukës me një pjesë të ushtrisë. I pari oficer i lartë shqiptar në histori që nuk pranoi që ushtria shqiptare të luftojë përkrah një ushtrisë pushtuese. Në kundështim me pashallarët shqiptarë, që jo vetëm që luftuan përkrah ushtrisë së pushtuesit turk, por edhe kundër popullit të tyre.

8 shtator 1943, Kapitullimi i Italisë. Merr në dorëzim Komandën nga Gjenerali Dalmazzo, duke i imponuar lëshimin e urdhërit të dorëzimit të ushtrisë italiane, pranë komandave shqiptare efektive apo të malit (edhe NCl, etj.) Kështu u krye kapitullimi i Italisë në Shqipëri. Pas dorëheqjes së Gjeneral Aqif Permetit, në shtator 1943, emërohet Ministër i Mbrojtjës me gradën Gjeneral Divizioni.

1943 – 1944, në funksionin e Ministrit të Mbrojtjes (Komandant i Mbrojtjës Kombëtare), kërkon të riorganizojë Ushtrinë Kombëtare Shqiptare nën një komandë të vetme, por gjen kundërshtimin e gjermanëve, të cilëve u kundërvihet me vendosmëri duke mos i lejuar që të krijonin forcat SS në Shqipëri . Nga ky kundërshtim i acaruar, ai doli në mal bashkë me Keshillin e Lartë e Qeverinë dhe u bashkua me forcat e tjera nacionaliste të malit, si dhe me misionin anglez, me të cilin qëndroi deri në largimin e tyre në tetor 1944, duke i mbrojtur nga sulmet e gjermanëve dhe të komunistëve.

Sa ishte në Krye të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, rendësi e përparësi të madhe ai i dha frontit të Kosovës, për të përballuar sulmet e forcave serbe, ku kishte dislokuar dy regjimentë efektivë të përforcuara me njësi vullnetare kosovare, duke caktuar dy kolonelet, Qazim Komanin dhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Fuad Dibren, në komandën e atyne forcave. Plane qe u sabouan nga partia komunsite shqiptare, që ishte lidhur pas politikës jugosllave, ku Kosova ishte viktima e parë që iu dorëzua Serbisë „motër“. Ky sabotim e tradhëti ndodhi edhe nga ana e Aleatëve që hoqën dorë e nuk ndihmuan nacionalistët, që kërkonin ta mbanin Kosovën. Sa ishte ne krye ushtrisë kombëtare shqiptare, kambë serbi nuk shkeli ne Kosovë.

1944 – 1946, Me ardhjen e komunistëve në fuqi, qëndron dy vjet i shtrehuar në malet e forta të Kurbinit, i mbrojtur nga besnikëria e madhe e banorëve të kësaj krahine, në pritje të një veprimi të mbeshtetur nga Aleatët (sipas fjalës që kishin dhanë). Aleatët nuk ndërhynë fare. Në shtator 1946, ndërmerr aksionin tepër të guximshëm të arratisjes për në Greqi, duke kaluar përmes Tiranës, ku qëndron 10 dit i strehuar tek disa miq besnikë mirditorë (Llesh e Ndue Gjeçi). Përcillet me makinë deri në kufi nga ish shoferi i tij korçar, trim e besnik, LLazi Sterjo.

1946 – 1965, qëndron 19 vjet në Greqi. Orvatet të krijojë me atdhetarët e tjerë, një forcë ushtarake ndërhyrëse më 1950 – 54 (me Muharrem Bajraktari, Fiqri Dinen, Hysni Demen, (e të tjerë oficerë e patriotë) në marrëveshje me Mbretin Zog, që gjendej në Kajro. Por Grekët, dhe kryesisht Anglezët e pëngojnë këtë organizim, duke mos e lejue Mbretin të vinte në Greqi, e duke venë kondita të papranueshme.

1965 - kalon në Itali, ku i propozojnë të mbajë gradat e detyrat si Gjeneral, me kusht që të merrte nënshtetësinë italiane, gjë që ai nuk pranoi dhe kalon në Belgjikë si refugjat politik, ku u bashkua me mikun e madh, kolonel Muharrem Bajraktarin. Ndërkohë ai kishte hartuar një plan për krijimin e një detashment shqiptarësh për të luftuar në Vietnamin e Jugut, plan qe ia paraqiti qeverisë amerikane me një letër drejtue vetë Presidentit John Kennedy. Ky projekt s'u pranue nga fakti se në atë luftë merrnin pjesë vetëm forca të shtetëve anëtare OKB.

1966-1977, në Belgjikë, i nderuar e respektuar nga shqiptarët dhe belgët. Lidhur me miqësi të madhe me Muharrem Bajraktarin, në bashkëpunim për ceshtjën kombëtare shqiptare. U shqua për fjalimet e tij ne raste festash ku bente thirrje për Bashkim, ku kritikonte ndasirat në partina e organizata, që krijonin mosmarrëveshje e përçarje. Mosha bën të veten dhe me 6 shtator 1977, pas një sëmundje të rëndë e të shpejtë, ai ndërroi jetë në spitalin Jolimont, duke pasur të kryet, mikun e shtrenjtë Muharrem Bajraktarin e miq të tjerë shqiptarë. U përcoll në varrim nga

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

gjithë mërgata e Belgjikës dhe të vendeve të tjera. Mbajtën fjalimet e rastit, Patër Ambroz Martini, kolonel Muharrem Bajraktari e patrioti Rifat Kolgjini. Familjarët e tij gjendëshin të mbyllur në burgjet e kampet e diktaturës. Vetëm pas 45 vjetëve të bijtë, Valentini dhe Leka me familjet e tyre patën mundësi t'ia nderonin varrin ku prehej prej kohësh i vetmuar, e të vendosnin lule te freskëta mbi atë varr.

FIOTOGTRAFI HISTORIK3E E SHTABIT Të LARTë TE USHTRIS KOMBETARE SHQIPTARE TIRANE, 28 Nëntor 1944.



Gjeneral Prenk Pervizi, Ministër i Mbrojtës dhe Zv. tij Gjeneral Mirdashi mes oficerëve madhorë në festën e 28 Nëndorit 1943.

Këta oficerë shtamadhorë u masakruen nga diktatura komuniste, përveç Prenk Pervizit , dhe Kol.Von Kishner (me shërit të bardhë), të arratisur.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)





Mbreti Zog e Prenk Pervizi u takuen edhe në mërgim disa herë për çeshtjen shqiptare. Mbreti vdiq më 1963 në Paris 24 vjet pas largimit nga Shqipnia. Gjeneral Prenk Pervizi vdiq në Belgjikë më 1977 pas 31 vjet mërgim.

.



Në 100 vjetorin e lindjës dhe 20 vjetorin e vdekjes, 1997, shqiptarët e Belgjikës e nderuen kujtimin e Prenk Pervizit bashkë me familjarët e tij që te ky varr u gjetën vetem pas 45 vjet.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Arkivoli i Prenk Pervizit në kishë.
Fotografi e ruejtun nga miku Ded Mjeku nga Puka.



Lek Perviizi, i biri, te varri në 20 vjetori i vdekjës me djemi e nipin
e familjës së patriotit Refat Kolgjinit mik i Kojenerit

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



I nënshkruemi para spitalit “Jolimont” të qytetit La Louvière, ku im atë u shtrue dhe vdiq më 6 shtator 1977.

FUND

BIBLIOTEKA PUBLIKE
“MARIN BARLETI”
SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

TE HUEJT PER GJENERAL PRENK PERVIZIN

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Julian Amery (Lord Amery)
"Sons of the Eagle"
(Bijt(e Shqipës), përkthim nga origjinali

Parathanie, fq. 20 : …"

"Ishin Muharrem Bajraktari, Fiqri Dine, Prenk Pervizi e Hysni Dema[3], që kishin ndjekun Zogun në Jugosllavi ata që luejtën një rol të randësishëm në revolucionin që ndodhi. Me kryerjen e detyrave që kishin, ata fituen influencë të madhe, por kur ata e plotësuen qëllimin e mbretit, Zogu ua theu fuqinë, e cila një ditë mund të rrezikonte dhe atë vetë. Në vend të tyne ai vuni njerëz të rinj që tregohëshin ma të ndigjueshëm ndaj dëshirave të tij sepse ishin ma të varun ndaj privilegjeve që ai u jepte. Kështu mbrenda një periudhe prej pesë vjetësh diktatura mbretnore u ba absolute.

Fq. 304-306 :

Në mungesë të Bazit ne kaluem nën kujdesin e Gjeneral Prenk Pervizit, ish "bashkëpuntori", Kryekoamndanti i ushtrisë. Në u nisëm drejt veri-lindjës, nga Malibardhë, dhe pas dy orësh udhëtim arritëm të shtabi tij, në një shtëpi gurore ndër shtigje t'ashpra mes pyllit të Skurajt. Gjatë shtigjëve ishin vendosun roje për ruejtjën tonë, ku Gjenerali erdhi e na takoi i rrethuem nga shtabi tij. Ne shkëmbyem përshëndetjet e rastit, siç ishin nën shi, duke i shprehun mirësëardhjen. Oficerët shqiptarë u paraqitën me radhë, ndërsa Gjenerali jepte urdhna të përpikta dhe udhëzime taktike që ai kishte ndërmarrë për mbrojtjën tonë. Këto urdhna i çudisnin civilët që s'ishin mësue me disiplinë ushtarake, por që ishin të nëvojshme, dhe ne e falenderuem Gjeneralin duke e përmbajtun humorin që na kishte kapun, e duke e ftue Gjneralin që të inspektonte trupat tona të Turkomanëve.

Prenk Pervizi kishte qenë deri në ato çaste anmik yni, por duke e kuptuar se lufta ishte kthye ne favorin tonë, ai kërkonte të vendosej një lidhje profesionale ushtarake me ne si oficerë. Si hap të parë ai propozoi të mbeshtetur në zakonët e ushtrisë Britanike, që të bahej një dallim midis oficerëve dhe civilëve. Ndërsa ishte mjaft zor me dallue se kush ishte oficer në atë grumbull civilësh. Ne ishin mësue sipas kryetarëve të fisëve, të njihnim e dallonim rrethin tonë, në Zogistë e Ballistë, përkthyes, bodigardë, që na ndiqnin kudo që shkonim.. Ne s'e pranuem këtë lloj punë për me ka dallime, që do të ngallte xhelozi, dhe midis atyne njerëzve që mbahëshin trima nuk ishte e

[3] Siç e kemi thane, ishte Hysni Dema i katerti dhe jo Xhemal Herri, siç gabimisht ka venë Amery.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

këshillueshme. Në një çast sikur nuhasëm një krizë sociale, por befasisht m'erdhi një frymëzim. Unë i propozova Gjeneralit që organizimi ynë mund të njihëj si *Shtab-madhor.* Kështu kjo çështje, si me të qeshun, u mbyll për kënaqësinë tonë. ....

***

Miku dhe mbrojtësi ynë, Gjeneral Prenk Pervizi, pati një rol të randësishëm në revolucionin e 1924, dhe me Muharrem Bajrkatarin, Fiqri Dinën e Hysni Demën, formuen kuadrumviratin (sundimin e të katërve) me forcën e të cilëve pushteti i Zogut u vendos midis Gegëve. Kur ai e kreu detyrën e tij ndaj kauzës mbretrore, Zogu ia hoqi komandën dhe e caktoi në një detyrë pranë Shtabit të Pergjthshëm, ku ai gezone nderime por pa ushtrue influecë. Ma i zhdervjelltë se shokët e katërshës, Prenk Pervizi qëndroi jashtë ambicieve politike dhe iu kushtue përparimit të karrierës ushtarake. Ai kishte fitue favorin e Gjeneral Parianit, kryetar i Misionit italian,, dhe u caktue në shoqërimin e italia**në**ve në Luftën e Abisinisë si vëzhgues shqiptar. ... Italianët i dhanë një komandë gjatë fushatës së Greqisë, por ai u dyshua për marrëveshje me anmikun dhe u transferue në Shkodër si këshilltar shqiptar pranë komandës italiane. Dy vitet e fundit ai ia kushtoi krijimit të një fraksioni me oficerët shqiptarë, por ndejt jashtë revoltës kundër italianëve, duke u tërhequn me mbështetësit kryesor në krahinën e tij të Kurbinit. Këtu ai qëndroi deri më Nëntor 1943, kur Këshilli i Regjencës i besoi Komandën Supreme të Ushtrisë. Karriera e Kryekomandantit ishte e stuhishme, sepse, ndërsa politika e Gjermanëve ishte përçaj e sundo, Prenk Pervizi ishte i vendosun të mbante nën urdhnat e tij të gjithë forcat e armatosuna shqiptare. Konflikti me gjermanët ishte i pabarabartë, por përfundimisht ai doli fitimtar në rastin e parë të sfidës që i bahej autoritetit të tij. Gjermanët kishin vendosë të krijonin në Shqipni një Division SS për ushtrinë e tyne dhe ia kishin besue komandën e brigatës së parë një far Selami Çelës. Ky Çela ishte një kapiten rezervist dhe si i tillë ishte nën urdhnat e Prenk Pervizit. Natyrisht se Gjenerali ishte kundër formimit në Shqipni të një njësie ushtarake që nuk do t'ishte nën autoriretin e tij, dhe e kishte urdhnue Çelën që të hiqte dorë nga ajo punë. I këshilluem nga gjermanët sigurisht se Çela e hodhi poshtë atë urdhën. Një mëngjes Gjenerali e kishte pa atë që po hynte në shtabin e komandës gjermane i veshun me uniformën e kolonelit. I fyem në dinjitetin e tij, ai vendosi "ta bajë shëmbullë" dhe dha urdhën për "ekzekutimin" e tij. Një orë ma vonë kur ky njeri i keq doli nga mbledhja, body garda e Gjeneralit e eliminoi atë në shkallët e Shtabit Gjerman me dy granata dhe një breshëri automatikësh. Gjenerali vetë e ndoqi ngjarjen nga dritarja e zyrës së tij ku një turmë e madhe njerëzish ishin grumbullue për të shfaqun aprovimin e tyne. Gjermanët u inatosën nga një sfidë kaq e madhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2016)

dhe kërkuen dorëheqjen e menjëhershme të Prenk Pervizit dhe denimin e tij. Regjenti i vjetër Mehdi Beu që e kishte eksperiencën politike të Perandorisë Otomane, duke ia terhequn vrejtjen Gjeneralit para Komandantit Gjerman i tha :

- Ju ftoj t'u kërkoni falje miqve tanë Gjermanë për gabimin që keni lejue në shkallët e derës së tyne. Herën tjetër kur ju duhet të pushkatoni ndonjë oficer, ta bani në kazermat e jueja dhe jo në rrugë.

Gjermanët morën mësim... Ma vonë ata e krjiuen një divison SS në Kosovë, por këtë punë nuk e përseriten brenda kufijve të Mbretnisë Shqiptare.

Prenk Pervizi i mbejetoi incidentit, por marëdhanjet me Gjermanët u prishën përfundimisht. Kërkesa e tij për armë dhe municione për ushtrinë shqiptare u refuzuen disa herë. Në një letër që ai i kishte adresue Gjeneralit Fistum me atë përmbajtje, iu kthye si një nxanësi për ushtrimin e pakënaqshëm me një "Nein" të zhgarravitun me bojë jeshile në gjithë letrën.

Ky ishte shkaku që ai të vihej kundër gjermanëve dhe tani që u kthye anmik me ta u çlirue nga çdo zemërim i ndrydhun. Akuza për "kolaboracionizëm" ndaj tij asht pak e besueshme, por nga ana tjetër del e qartë pazotësia mjaft patologjike e gjermanëve për me fitue simpatinë e një njeriu që ma kollaj mund të kishte qenë mik i tyne".*

---

*-- Julian Amery e përfundon kështu shkrimin e tij, sepse Prenk Pervizi me kulturë gjermane, e kishte mundësinë që të afrohej e të bashkëpunonte me ta. E kundërta, ai i kundërshtoi gjermanët kur ata deshën të krijonin forca SS me oficerë shqiptarë dezertorë e renegatë në Shqipëri, dhe në të tjera raste.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Dr. Walther Peinsipp
" Das Volk der Schyptaren" Wien, 1985
(Populli i Shqiptarve) përkthim nga origjinali, fq.36.

Veshtrim historic

… Fill pas udhëzimit të Wermachtit, shefi i forcave të Himlerit, kreu i SS dhe Gjeneral i Policisë, Jozef Fistum, vendosi të krijojë në Shqipëri një division SS për forcimin e trupave të pushtimit. Komanda e një brigate iu besue kapitenit Selami Çelaj. Gjenerali i forcave t'armatosuna shqiptare, Preng Pervizi, vendosi, me mbeshtetjën e Regjencës, me e kundërshtue nismën e Fistumit e çdo orvatje tjetër për krijimin e atij divizioni. Një ditë, Pervizi, ndërsa hidhte një vështrim nga dritarja e zyrës mbi komandën gjermane kundruell, pa vartësin e tij me uniformë të një koloneli SS duke hy në atë komandë gjermane. Gjenerali shqiptar vendosi të nxierrë para përgjegjësisë vartësin në fjalë për mospërfilljën e komandës të ushtrisë shqiptare. Duke qenë se komandatura gjermane u tregue moskokëçarëse , kapiteni u ekzekutue me armë automatike prej njerëzve të shtabit të Pervizit. Gjenerali e kishte pa vetë skenën nga dritarja e zyrës. Po ashtu Fistumi , se si ai kishte dhanë atë urdhnën, ku nuk mund t'i ikte papërgjegjësisë. Fistumi kërkoi nga Regjenca shqiptare shkarkimin dhe denimin e Gjeneralit. Anëtari Regjencës, Mehdi Bej Frasheri, musulman me origjinë shqiptare dhe dikur guvernator i Jeruzalemit, e mori çështjen në dorë të tij, që gjeneralit t'i jepte një mësim të përshtatshëm. E thirri Pervizin dhe e ftoi Fistumin që të ishte i pranishëm në takim. Ai e qortoi Gjeneralin në prani të Kreut të SS : " Unë ju lus se pari * t'i kërkoni të fala mikut tone gjerman, për aktin që kanë krye njërëzit e tu para derës së shtëpisë tij, duke dhunue të drejtën e banesës. Unë ju kërkoj ngulmisht që here tjetër, kur të vendosni me ekzekutue ndonjë oficer, ta bani në kazermat e jueja dhe jo në rrugë". Fistumi u detyrue të anullojë krijimin e divizionit SS në Shqiperi, prej kundërshtimit të Pervizit. Këtë division ai e krijoi në Kosmet, ku nuk zbatohëshin urdhnat e shqiptarve. Përfaqësuesi i Himlerit u hakmuer ndaj Pervizit kur ky i kishte kërkue furnizim me armë e municione, që trupa e tij të kundështonin përpjekjet e komunistëve toskë për të marrë Tiranën. Kesaj kërkese Fistumi i kishte zhgarravitë sipër me bojë të kuqe një "Nein" të madh. Ky "Nein" i gjermanëve u vlejti Aleatëve, sepse idhë mundesi Pervizit të kalonte në krahun e tyne…

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Robert Elsie – The Tribes of Albania
(Kurbini)

Prenk Pervizi

Born in the village of Skuraj in Kurbini tribal territory, Prenk Pervizi (1897-1977), also known as Preng Previzi, was a noted military figure of the 1930s and 1940s. He attended secondary school in Shkodra and a military academy in Vienna. He returned to Albania in 1918 and played an active role in the creation of armed forces after the Congress of Lushnja in 1920. In June 1924 he followed Ahmet Zogu (1895-1961) into exile in Yugoslavia, and returned with him in December of that year, taking over the region of Lezha. Pervizi was one of Zogu's four officers (the quadrumvirate of chiefs) who played a major role in the Albanian military in the coming years, in particular in the suppression of anti-Zogist uprisings and in making Zogu's rule absolute. From 1929 to 1934, he attended military colleges in Turin and Florence and accompanied Italian troops as a representative of the Albanian army during the Italian military campaign in Abyssinia in 1935-1936. He was in Korça at the time of the Italian invasion in April 1939 and helped King Zog and his family escape to Greece. Pervizi, however, returned to Korça. In the Italo-Greek war of 1940-1941, working with the Italians, he commanded Albanian forces in the Korça region. In the end, he and his men retreated from the front and Mussolini subsequently used them as scapegoats to explain the Italian defeat in Greece. In April 1943, Pervizi was appointed to command a new Albanian brigade and then headed the Albanian army formed at the Conference of Mukja in August 1943. When Italy capitulated on 8 September 1943, he took over command of the Albanian armed forces from General Dalmazzo (b. 1886) and was named minister of defence in October of that year, with the rank of a general. His opposition to German interference in domestic Albanian military affairs caused him to take to the hills with his men and join the British mission, with which he remained until October 1944. When the communists took power in November 1944, he went into hiding, spending two years in the mountains of Kurbini while waiting for an Allied intervention that never materialised. In September 1946, he escaped to Greece and lived there for nineteen years. The final years of his life were spent in Belgium, where he died.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Robert Elsie : The Biografical Dictionary of Albanian History, Taurus, 2013. (p. 327-328)

PERVIZI, PRENK (04.05.1897-06.09.1977)

Military figure of the 1930s and 1940s. Born in the village of Skuraj in the district of Kurbin, Prenk Pervizi, also known as Preng Previzi, attended secondary school in Shkodra and a military academy in Vienna. He returned to Albania in 1918 and played an active role in the creation of armed forces after the Congress of Lushnja in 1920. In June 1924 he followed Ahmet Zogu into exile in Yugoslavia, and returned with him in December of that year, taking over the region of Lezha. Pervizi was one of Zogu's four officers (quadrumvirate of chiefs) who played a major role in the Albanian military in the coming years, in particular in the suppression of anti-Zogist uprisings and in making Zogu's rule absolute. From 1929 to 1934, he attended military colleges in Turin and Florence and accompanied Italian troops as a representative of the Albanian army during the Italian military campaign in Abyssinia in 1935-1936. He was in Korça at the time of the Italian invasion in April 1939 and helped King Zog and his family escape to Greece. Pervizi, however, returned to Korça. In the Italo-Greek war of 1940-1941, he commanded Albanian forces in the Korça region, working with the Italians. In the end, he and his men retreated from the front and Mussolini subsequently used them as scapegoats to explain his defeat in Greece. In April 1943, Pervizi was appointed to command a new Albanian brigade which was sent to Italy to be armed and equipped. He then headed the Albanian army formed at the Conference of Mukja in August 1943. When Italy capitulated on 8 September 1943, he took over command of Albanian armed forces from General Dalmazzo and was named minister of defence in October of that year, with the rank of a general. His opposition to German interference in domestic Albanian military affairs caused him to take to the hills with his men and join the British mission, with which he remained until October 1944. When the communists took power in November 1944, he went into hiding, spending two years in the mountains of Kurbin while waiting for an Allied intervention that never materialised. In September 1946, he escaped to Greece and lived there for nineteen years. The final years of his life were spent in Belgium, where he died.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Pietro Sebastiano Monari

« L'Italia nella Seconda guerra mondiale : La Guerra di Greqia - Roma, 2004.

Ruolo albanese

Sulla campagna di Grecia si evita di parlare delle forze albanesi che erano state coinvolte nel conflitto: alcuni battaglioni scaglionati nelle divisioni "Venezia e Giulia". Un battaglione della milizia mercenaria albanese fu sacrificato, e sterminato dai greci avanzanti, dal comando italiano per proteggere la ritirata italiana. Benché non appartenesse all'esercito effettivo albanese, il comando albanese rappresentato dal colonello Prenk Pervizi protestò vivamente per questo impiego degli albanesi come "carne da cannone". Il comando italiano decise che il battaglione effettivo albanese "Tomorri" avrebbe difeso la loro ritirata, come il primo. Il colonello Pervizi insieme al maggiore Spiro Moisiu e gli altri ufficiali convennero di ritirarsi dal fronte appena fosse cominciata l'offensiva greca e la ritirata delle truppe italiane, con l'ordine di non metter a repentaglio la vita di un sol soldato, insediandosi in posizioni sicure. Infatti il battaglione si ritirò senza alcuna perdita (un solo ferito). L'esercito italiano subì una disfatta memorabile che il maresciallo Badoglio avrebbe addebitato al "tradimento dell'esercito albanese". In realtà il disastro fu conseguenza di uno scacco politico in quanto pochi giorni prima dell'attacco italiano il primo ministro greco Metaxas scoprì che alcuni alti ufficiali dell'esercito, nonché funzionari del governo, erano stati corrotti dal ministro degli esteri italiano, conte Ciano, affinché l'esercito ellenico non esercitasse una seria resistenza all'avanzata italiana. Fu così che le personalità corrotte furono sostituite in tempo ed arrestate. Questo fatto spiega anche perché l'attacco fu iniziato con un numero esiguo di unità da parte italiana. Fatto sta comunque che le truppe albanesi furono tolte subito dal fronte. Il comando italiano volle portare davanti al tribunale militare il maggiore Moisiu. Il colonello Pervizi, che godeva di grande influenza e reputazione sia nell'esercito che nel popolo si oppose: "Quel tribunale doveva coinvolgere tutto il comando albanese compreso lui". Gli italiani non intrapresero niente, temendo disordini. Il colonello col suo staff di ufficiali e una parte delle truppe fu isolato nelle montagne di Puka (Nord d'Albania). Il maggiore Moisiu col suo battaglione fu trasferito a Laç (Albania centrale).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Paraqesim si shembëll versionin marrë nga Wikipedia anglisht, perdorur edhe nga nga Wikipedia në gjuhë të ndryshme dhe site të tjerë si : Military Wiki-Wikia, WOW, Wikiwand, Dbpedia, Medianer connects, Oppen access articles etj.

Oppen Acces Articles - Prenk Pervizi

From Wikipedia

Prenk Pervizi(1897–1977) was an Albanian military figure, General of the Albanian army, and Minister of Defense. High preparation: Kadettenschule in Vienna, Austria 1914–1918, and the War College in Turin, 1930–1933. Great military figure protagonist in the foreground of the history of Albania for the period 1918–1944. Friend and right-hand man of King Zog which solved critical situations and remain faithful from the beginning to the end of the Kingdom of Albania, 1939. He opposed Italians withdrawing the Albanian troops from the Greek-Italian war. He did not allow the Germans to create SS troops in Albania. Bitter opponent of the communists, he is forced to go abroad in Greece and Belgium, as a political refugee, where he died at age 80, on September 6, 1977.

Family roots

The Pervizi family from Skuraj village in Kurbin region were an important Catholic lineage from north of Albania. The name comes from its founder Pervizi the Great from Skuraj of Kurbini, who lived in the fourteenth and fifteenth centuries. It was said that he had strenuously opposed the Ottoman invasion and had not agreed to bow to their tempting offers, for which he was treacherously killed by the Turks. They had to spend five centuries that the name of Pervizi returned to prominence in the history of Albania. This happened in the period of the National Awakening, when Gjin Pjeter Mark Pervizi from Skuraj distinguished himself as head of the popular uprising of Kurbini-Kruja(1912) against the Turkish domination conducted successfully and raising of the national flag in Milot, regional center on the same day of the Albanian Declaration of Independence 28 November 1912 in Vlore, by patriots led by Ismail Qemali. Born May 4, 1897 at Skurai, Kurbin, Albania, Prenk Pervizi came from a Catholic family noble and important, that of Pervizi Skuraj of Kurbini, who had left traces in the struggle against the

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

domination Turkish. A character of great significance and importance in the modern history of Albania.

Initial engagement

Coming out from the Kadettenschule of Vienna in 1918, Pervizi was engaged in the army as commander of the Albanian district of Kruja in 1918, and later at the General Command of the Army, distinguishing himself in the operations for the expulsion of the Serbian armies from the north of the Albania, alongside of great patriots like Bajram Curri, Elez Isufi, Prenk Jaku ando others patriots during 1920–1921. Pervizi was a friend and collaborator of Ahmet Zogu, known each other since his stay in Vienna, and participating in the Congress of Lushnjë (1920) where Zogu became minister. Pervizi also defended Zogu and the government during the Albanian Revolt of 1922, when guerrillas of Elez Isufi and Zija Dibra marched down to Tirana and threatened to get control of the capital by force (March 8, 1922). The intervention of Pervizi and his gendarme units saved Albania from a crisis that could have had disastrous consequences for the very existence of it. This action earned him a promotion to *Captain* of First istance for war merits, and the "Gold Medal for Military Valor".[2]

Service to Zogu

Pervizi was not able to hold a subsequent coup d'état, which began June 24, 1924. Zog with his government and the military loyal to him fled to Yugoslavia. This is known as the June Revolution.

In December 1924 he took part in the operations that brought to power Ahmet Zogu and overthrew Fan Noli's government. Zog divided Albania into four military zones and Pervizi was in charge in the Center (Tirana) along with the other three captains (Muharrem Bajraktari to the north-est, Fiqri Dine for the north-west, an dHysni Dema to the south).

In November–December 1926, another rebellion had broken out in the Catholic regions of Dukagjin, Shala, and Shoshallegedly supported by Yugoslavia to destabilize the country. The rebels were initially successful in blocking the army and getting the local army commanders as prisoner. The rebels were preparing to attack and occupy Shkodra. At this point, Zogu called Pervizi giving full powers to quell the revolt. In three days the rebellion was quelled and its leaders Ndok Gjeloshi and Dom Loro Çaka fled from Albania while others were arrested and prosecuted. This success expanded Pervizi's fame and influence in the army and the population.[2]

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Relations with Italy

Pervizi remained in friendly relations with Italy. He had sent his children to educate themselves in Italy since elementary school, in Lanzo Torinese, in the College of Don Bosco, prestigious institution which enrolled also the children of the House of Savoy, the King and Prince Umberto II of Italy, with whom he followed the same course in the "School of War". Pervizi had brought the whole family inTorino, his mother, wife and three children. They would spend three years in Torino and another two years in Florence. Pervizi was a special guest invited to the wedding of Prince Umberto, whose mother was Elena of Montenegro and who supported the theory that Montenegrins and Albanians were of the same Illyrian origin. Pervizi received the title "Officer of the Order of Chivalry SS Maurice and Lazarus". The long stay in Italy allowed him to master the Italian language and to make many acquaintances and friendships in Italian society, particularly in the military. Later in 1965, when he would stop by in Italy as a political refugee, he would be asked to enroll as *General* in the Italian army, with the condition that he acquired Italian citizenship, which he did not accept and shortly after retired in Belgium.[3]

The Italian invasion of Albania

Further information:Albania under Italy

In 1929, now completed his duty, Pervizi was sent to the Military College of Torino, where he remained until 1933, then was appointed inspector of Albanian students in Italy until 1935.

On his return to Albania, he was in the "Commission of Foreign Observers" in the War of Abissinia (1935–1936) where he had the opportunity to meet the Generals Badoglio, De Bono and Graziani, besides other senior officers including several comrades of the Military College. For this war, Pervizi wrote a very detailed report and held a number of conferences in Albania.[3]

In this service he understood that the secon victim of Italy would be Albania, and inform the King Zog ti organize the defense of the ceoutry0 The King makes the deaf ear.

In August 1936, he represented Albania in a session of the Great Maneuvers of Italy in Irpinia, where he exchanged a few words with Benito Mussolini, who gave him to understand his intention to intervene in Albania. Pervizi went back and warned the King Zogu on intentions of Benito Mussolini. Ahmet Zogu was skeptical and did not give importance to the warning. On the occasion of the twenty-fifth anniversary of Albanian independence (1937),

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Pervizi advanced to the rank of colonel and received the "Order of Besa", becoming also "Grand Officer of the Order of the Crown of Italy".
At that time Italy was engaged in the war in Spain. But over this war, when April 1, 1939,Francisco Franco proclaimed victory and the end of Spanish Civil War, six days after Mussolini ordered the attack and invasion of Albania. In this situation Pervizi asked to King Zogu, while he fleeing the country, to proclaim the resistance over the mountains, but the King refused this proposal moving himself to Greece and sanctioning *de facto* the end of the Kingdom of Albania. Meanwhile, Albania was occupied by Italian in three days, without meeting any resistance. Pervizi with the order of King returns to Albania. He was convened by the Generals Alberto Pariani and Alfredo Guzzoni, asking him to adapt to the situation and explaining that they were not interested in losing the existing Albanian army. Pervizi showed himself available and requested that the Albanian army did not participate in any action against his people alongside the Italian army. His request was accepted. He was formally given the rank Colonel, as Italians were aware of her figure and patriotic influence and sympathy that he enjoyed in the army and the population, and they were afraid to give a discontent that could deteriorate into an armed rebellion.[4]

The Italo-Greek War

Further information:Italo-Greek War

On October 28, 1940 the Italian campaign in Greece began. Some battalions of Albanian army were staged into the divisions "Venezia" and "Julia" with Pervizi representing the Albanian army at the high command of the operations.
Returning to the front after being recalled shortly in Tirana, he would come to a conflict with Italian generals who were making fun of the "poor quality of Albanian soldiers", based on the fact that an Albanian unit had been decimated by the Greeks. Pervizi immediately returned to the headquarters and protested to the General Ubaldo Soddu and the Italian command about the fact that his men had been used as "cannon fodder", remembering also that the command of the Albanian soldiers was its sole responsibility.
Given the negative trend of the operations, the Italian General Staff ordered the general retreat and consequently Pervizi did the same, he ordered the Albanian army to abandon the front, leaving the city of Korca guarded only by a company under the command of Major Spiro Moisiu. Italians, angered by this act, asked to bring those responsible before a military tribunal, but in the end, fearing the worst consequences, the only procedure was the transfer of Albanian soldiers in the mountains of the north while Pervizi got dislocated

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

and isolated in the area of Puka. In the meantime, however, he was promoted to *General*, to calm the situation and the people.[2]
Pervizi he was presente in the Conference of Mukje, in August 1943, where he was proposed as commander in chief of the Albanian army (acting as Minister of Defence), after the surrender of Italy on September 8, 1943.[5]


German occupation
Further information:Albania under Nazi Germany
Pervizi moved to Shkodër as a simple counselor. On September 8, 1943, he resumed his old powers, taking over the command from the General Dalmazzo. On October 23, he was elected Minister of Defense and promoted to the rank of General of Division, thus endeavoring to reform the Albanian army and strengthening the northern border to prevent attempts on re-annexation of Kosovo by Serbia. He also hindered the Germans in their recruiting for the Waffen-SS, which led him, along with the rest of the government, to abandon Tirana in favor of the mountains, where it joins the British mission in Albania (August 1944) in its region of Kurbini (Skuraj) in an attempt to organize the struggle against the Communists.

Exile

Pervizi joined the British mission sent in Albania, making the acquaintance of Colonel Neil McLean, and other officers as Julian Amery and David Smiley, who went away in October 1944. Pervizi was an anti-communist.[4]He took refuge in the mountains of Skuraj during 1944–1946 and in September 1946 secretly reached Greece, where he acquired the status of political refugee. After 19 years in Greece, 1 year in Italy and 11 years in Belgium, he died on September 6, 1977 in Brussels. During all this time his family, mother, wife and three children were locked up in prisons and concentration camps in Albania. The mother, wife and second son, died i these conditions of condemnation.

Gjithë të dhanat e Wikipedia në gjuhë të kuaja janë marrë nga versioni i tekstit anglisht krijue nga ekipi i saj redaksional per fushat e ndryshme, ku zejne vend biografite e njerezve te permendur, ndër ta edhe ushtarakë të shquar.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Liber i botuar nga Wikipedia frëngjisht (edhe anglisht) për gjeneralë me emër ku asht radhit edhe Prenk Pervizi .
I pari ne radhe Alfredo Stroessner ish President i Parahguajt.

General: Alfredo Stroessner, Omar El-Bechir, Calixto Garcia, Adib Chichakli, Prenk Pervizi, Ioannis Metaxas, Omar Souleiman, etj. Ma (French) Paperback – 2011

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

PROJEKTI I
GJENERAL PRENG PERVIZIT
1943-1944
Si duhet të jenë Forcat e Armatosura

Nga Kastriot Dërvishi

Ky material u përdor në gjyqin special të mars – prillit 1945 si "prove hetimore" kundër të pandehurve Ishte një material studimor i cili në kushtet e luftës së përbotshme pas një pushimi thelbësor të shtetit shqiptar në vitet 1939 – 1943,
parashihte të ngrinte strukturën e re të një force të armatosur. Komandanti i Mbrojtjes Kombëtare gjeneral Preng Pervizi, i dërgonte më 5 dhjetor 1943 Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe për dijeni Këshillit të Naltë, propozimepër riorganizimin e Forcave të Armatosura të shtetit shqiptar. Ky projekt vinte pas kërkesës që kishte bërë kryesia në fjalë, rreth organizimit të këtyre forcave në kushtet e reja për shtetin shqiptar pas shtatorit 1943, në kushtet kur Italia fashiste kapitulloi.
Asokohe shteti shqiptar në ndodhur në konfliktin botëror u mundua të ruajë integritetin dhe statusin e vet. Natyrisht ishte e
vështirë. Riorganizimi që propozohej të ndodhte synonte të kryente edhe "spastrimin e turbulluesve, ndjekjen e çetave".
Projekti merrte në considerate se hëpërhë Forcat e Armatosura
të shtetit shqiptar mund të organizoheshin në tre pjesë kryesore:
-Ushtria (përfshi dhe Rojën e Kufirit).
-Xhandarmëria.
-Forcat kreshnike.
Ushtria
Projekti parashikonte që rekrutimi ishte në fuqi e në veprim vetëm në fokat e liruara, në të cilat ishin formuar 2 regjimente me nga dy batalione dhe ishin në formim e sipër 4 batalione të tjera, të gjitha të këmbësorisë. "

Gjendja kërcënuese e shkaktuar nga çetat sllave, nuk lejon përdorimin e këtyre reparteve gjetiu, pasi ata në dislokimet ku ndodhen, sigurojnë mbrojtjen e atyre viseve, jo vetëm për këtë arsye, por tërheqja prej andej e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2016)

tyre do të ulte moralin e popullatës dhe elementët ushtarakë të tokave të çliruara e një hap i tillë do të prodhonte dëshpërim” – thuhej në raport.

Projekti ndante mënyrën e rekrutimit në Shqipërinë e vjetër (atë të 1913-s d.m.th.) në dy mënyra:

a- Në Shkodër dhe Dibër. Panjë marrëveshje me krerët e vendittë bëhej thirrja e rezervistëve dherekrutëve. Kjo do të rregullohej menjë raport ku ¼ do të ishin rekrutëtdhe ¾ do të ishin rezervistët.Koha e shërbimit për rezervistët do të ishte 3 muaj dhe për rekrutët do të ishte 6 muaj. Në Shkodër do formohej një regjiment me 3 batalione këmbësorie dhe në Dibër 1 regjiment prej 3 batalionesh këmbësorie. Mundësia e formimit të kësaj trupe ishte në dorën e krerëve të zonave kua ato mendohej të
ngriheshin.

b - Në vise të tjera të Shqipërisë. në viset e Shqipërisë së vjetër do bëhej rekrutimi i detyrueshëm pasi të jetë stabilizuar qetësia. Vetëm me qetësi të plotë rekrutimi mundtë bëhej gradualisht. Gjykohej se rekrutimi në forma të tjera mund të lindte probleme dhe mund të sillte efekte negative. Rekrutimi gradual mendohej të bëhej së pari në Prefekturën e Tiranës e më tej në prefekturat e Durrësit, Elbasanit


Roja e Kufirit
Forcat e kësaj trupe, do të ishintë gjitha me pagesë si dhe të vendosura në vijën kufitare që ndante shtetin shqiptar me vendet
fqinjë. Për vetë natyrën e këtyre forcave, mendohej që këto të mos përdoreshin për veprime operacionalenë brendësi të territorit.

Xhandarmëria
Ishte forca që kishte pasur konsolidim edhe aftësi profesionale në të kaluarën. Pas shkrirjes së forcave të xhandarmërisë pas pushtimit fashist të 7 prillit 1939 dhe bashkimit të tyre me forcat e karabinierisë italiane, në mars 1943, u rikrijuaxhandarmëria nga qeveriae Maliq Bushatit. Ky “eksperiment” kishte rikrijuar kësisoj përherë të fundit në historinë e shtetitshqiptar armën e xhandarmërisë e cila do të jetonte e dobët vetëm në vitet 1943 – 1944. Tradita shqiptare e kishte pasur Shpreh bindjen time të plotë se libri "GjeneraJ Prenk Pervizi"do të ndikoje pozitivisht në edukimin atdhetar.

D okumenti I Projektit të Prenk Pervizit paraqitur Këshillit Ministrave dhe Këshillit të Lartë të Regjencës më 1943 .

BIBLIOTEKA PUBLIKE
“MARIN BARLETI”
SHKODËR (2018)

Komandanti i Mbrojtjes Kombëtare gjeneral Preng Pervizi, i dërgonte më 5 dhjetor 1943 Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe për dijeni Këshillit të Naltë, propozimet për riorganizimin e Forcave të Armatosura të shtetit shqiptar. Ky projekt vinte pas kërkesës që kishte bërë kryesia në fjalë, rreth organizimit të këtyre forcave në kushtet e reja për shtetin shqiptar pa shtatorit 1943, në kushtet kur Italia fashiste kapitulloi.



Kopie e dokumentit orgjinal

a- Kuadri. Për kohën që po shkruajmë shihej i nevojshëm plotësimi kuadrit organik të xhandarmërisë. Ishte vërejtur se mungontekuadri kryesor i kësaj arme,pra fillonte një vështirësi qysh në fillim nga koka. Ajo që bënte në sy ishte fakti se projekti parashikonte që rekrutimi i kuadrit duhej pranuar edhe me defekte dhe në të ardhmen ky defekt mund të korrigjohej.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

b- Formimi i njësive shëtitëse. Kërkohej të bëhej si shtesë e kuadrit të xhandarmërisë. Projekti parashihte që batalionet
shëtitëse të përdoreshin gjatë periudhës së parë. Regjistrimi i personelit duhet të bëhej nga vullnetarët që regjistroheshin si dhe nga ato që dërgonin prijësit e krerëve të vendit. Për t'i prerë hovin njerëzve të pakualifikuar ishte parashikuar që të jepej titulli ndihmësxhandar. Kjo sepse në kohëra të tjera të vendosej në vend emërtesa e duhur. Sasia e batalioneve shëtitëse do të varej nga mundësia financiare që do jepej. Mënyra e organizimit të xhandarmërisë, nuk ndryshonte nga ajo e traditës.

Forcat Kreshnike
Këto forca hynin pak a shumë në trupa të përzgjedhura, por me traditë popullore. Për nga ndarja ato vinin në dy kategori:

1- Forcat Kreshnike të Rojës së Kufirit. Këto forca mobilizoheshin nga banorët e rripit kufitar dhe kryetarët me ndikim të tyre emëroheshin "oficerë kreshnikë", sipas forcave që mblidhnin e komandonin. Kreshnikët paguheshin si rojet

kufitare vetëm gjatë kohës së ishin në shërbim. Këta kërkoheshin të ishin të gatshëm për veprime në kufi dhe jo në zona të tjera.

2. Forcat Kreshnike të Ushtrisë. Këto ishin fuqi vullnetareqë kur kërkoheshin, paraqiteshinnga prijësi i tyre.Kryetarëve të tyre ju jepeshin grada pikërisht për këtë lloj cilësie. Por për të bërë të mundur produktivitetin e këtyre forcave, ato duhet të regjistroheshin në Forcat e Armatosura. Forcat në fjalë liheshin të komandoheshin prej krerëve të lartë drejtues.

Konsideratat
Për trupat në fjalë jepej ideja që armatimi i përdorur duhej të ishte ai me pushkë, bomba dhe sipas rastit mitraloza e lehtë. Nevoja e koordinimit sillte nevojën e dekretimit prej Këshillit të Naltë të një komande operacionale, komandanti i së cilët duhej emëruar po nga Këshilli i Naltë. Po ashtu ky i fundit vendoste edhe ndjekjen e drejtimeve të operacioneve të forces në fjalë. Pjesa e fundit e propozimeve ka të bëjë me çështje të prapavijës, etj.
" "

Pas n"jë marrëveshje me " krerët e vendit të bëhej thirrja e rezervistëve dhe rekrutëve. Kjo do të rregullohej me një raport ku ¼ do të ishin rekrutët dhe ¾ do të ishin rezervistët. Koha e shërbimit për rezervistët do të ishte 3 muaj dhe për rekrutët do të ishte 6 muaj. Në Shkodër do formohej një regjiment me 3 batalione këmbësorie dhe në Dibër 1 regjiment prej 3 batalionesh këmbësorie

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Në vise të tjera të Shqipërisë:
Në viset e Shqipërisë së vjetër do bëhej rekrutimi i detyrueshëm pasi të jetë stabilizuar qetësia. Vetëm me qetësi të plotë rekrutimi mund të bëhej gradualisht. Gjykohej se rekrutimi në forma të tjera mund të lindte probleme dhe mund të sillte efekte negative.
I XOXES,


Lista e dokumentëve në shtesë të librit :

1. Vendim i emërimittë Gjenral Prenk Pervizit në postin e Ministri të Mbrojtës., fq. 378
2. Njoftim Ministrive Gjeneral Prenk Pervizi për marrjen e detyrës së ministri të Mbrojtjës, fq.379.
3. Formimi i Komandës Përgjitshme të Fuqive Vepruese, fq. 380-381.
4. Direktiva dhe ndarje në pesë zona ushtarake të Forcave Vepruese, fq.382-383
5. Raport për dergimin oficerë shqiptare për iorganizimin e forcava vullnetare çame kundër ZERVA-s, fq. 384.
6. Raport derguar Kesh3 Nlatë mbi pëngesat e gjermanëve, fq. 385
7. Mbi formimin e Bataljonëve Shëtitës, fq. 386-387
8. Gradim oficeri për merita lufte, fq. 388
9. Letër e major Preng Jakut Prenk Pervizit për ndërhyrje falje pranë Ahmet Zogu, fq. 389-390.
10. Projekti i krijimit të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. 39

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vendimi i emërimit të Gjeneral Prenk Pervizit në postin
e Ministrit të Mbrojtjes Kombëtare

1



KOMITETI EKZEKUTIV I PËRKOHËSHËM

— V e n d i m —

Nr. 88 më 20 TETUER 1943

Komiteti Ekzekutiv i Përkohëshëm në mbledhjen e tij të sotshme të mbajtun nen Kryesin e Z.Ibrahim Bigakçiu,Kryetar,me antare ZZ.Bedri Pejani, Xhafer Deva,Vehbi Frashëri,Mihal Zallari e Eqrem Telhaj;

Tue marë parasysh vendimin mbi ngjidhjen e ushtrisë Kombtare nga ajo italjane,si edhe nevojën e ngutshme të ri-organizimit të Ushtrisë Kombtare sa ma parë me gjithë organet e veta,

V e n d o s i :

Revokimin e urdhënit Nr.....datë 14.9.1943 me të cilin Z.Gjeneral Akif Permeti emnohesh Komandant i Përgjithshëm i Mbrojtjes Kombëtare dhe emnimin në vend të tij të Z.Gjeneral Preng Previzi.-

Emnimin e Z.Gjeneral Gustav von Kyrdacs si Kryetar i Shtatmadhnorisë t'Ushtrisë Kombëtare dhe emnimin e Z.Baron von Kirchner si Inspektor i Përgjithshëm i Ushtrisë Kombëtare.-

Sekretari i Përgjithshëm:
(Nedim Kokona)

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

KRYESIA E KOMITETIT EKZEKUTIV TË PËRKOHËSHËM Tiranë,më

Nr. 499 23 TETUER 1943

1396 25.X.43

— Q A R K O R E —

Ministris se Punve Botore

T i r a n ë.

Për dije e veprim ju dergohet kopja e siperme e Vendimit te Kryesis Komitetit Ekzekutiv të Përkohëshëm.-

KRYETARI KOMITETIT EKZEKUTIV TË PËRKOHËSHËM:
(Ibrahim Bigakçiu)

MINISTRIA E PUNVE BOTORE
MARRJTUN ME 25-X-1943
TE LIDH Nr. 1396/I

A014 f. 12 v. 1 d. 76 40

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Bibliografi :

Autorë të huaj

+ Julian Amery . Sons of the Eagle, London, 1946
+ Julian Amery (Lord Amery): Letër Lek Pervizit, 1991.
+ Julian Amery : Albania in WW, London, 1995.
+ Bernd J. Fischer : Albania at War, 1999
+ David Smiley: Leter Lek Pervizit, 1993.
+ David Smiley : "Assignement in Albania", London, 1984.
+ Dreyen Oakley-Hill and David Smiley, : An English Man in Albania
+ Reginald Hibert, *The Bitter Victory*, Londres, New York, Pinter, 1991.
+ Hubert Neuwirth : Wunderstand und Kollaborartion in Albanien, 1939-1944.
+ M.Shmidt-Neke: Enstellung und Ausbau der Köningsdiktatur in Albanien,1987.
+ Walther Speisipp, « Das Folk der Shchipetaren"
+ General: Alfred Stroessner, etj. Edit Wiki, 2011.
+ Robert Elsie:The Biogrfical Dictionary of Albanian , History, Taurys, 2013
+ Robert Elsie, The Tribes of Albania, Chapter 7, 2015.
+ Prenk Pervizi, Oppenn Access Artcles (Web)
+ Pietro Crociani : Gli Albanesi nelle Forze armate italiane, Roma, 2004
+ P. S. Monari, L'Irtalia nella seconda guerra monduiale – Guerra di Grecia, Milano, 2004.
+ Patrice Najbor : Histoire de l'Albanie et de sa Maison Royale, Tome II, 1925-1939. Paris, 2008.
+ Royaume d'Albanie (1928-1939)
+ Prenk Pervizi, Wikiwand, WW.Com, Alchetron, Military Wiki, Open Access Articles
+ Prenk Pervizi, Wikipedia në disa gjuhë të hueja : Italisht, Frengjisht, Anglisht, Spanisht, , Esperanto , Portugeze, Kineze, Hollandeze, Polake, etj.

Autorë shqiptarë

+ Pjetër Hidri : Gjeneral Prenk Pervizi
+ Gjovalin Kola : Pourquoi la Belgique dans l'Histoire albanaise ? 2006.
+ Myrteza Bajraktari : Një vështrim tjetër i historisë, Tiranë, 2012.
+ Gjeneral Prenk Pervizi në shtypîn shqiptar : Dorian, Bruksel, 2009.
+ Prenk Pervizi : Urdhra, vendime zyrtare si Min istër I Mbrojtjës, 1943-44.
+ Prenk Pervizi : Lufta e Abisinisë, Belgjikë, 2009, New York, 2012
+ Prenk Pervizi: Shënime mbi organizimin e Kombit për luftë, Sht. Ushtr., Tiranë, 1935.
  -Letërkëmbim me Rexhep Krasniqin, 1966.
  -Letër shkruar Atë Gjergj Fishtës, Korçë, 1936.
  -Fjalim në maj 1939, në Folorinë
  - Fjalim më 28 nëntor 1971 ne Bruksel.
  -Projekt për krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare Tiranë 1943-1944.
+ Hajrush Haliti-Akturk : Gjeneral Prenk Pervizi, shtigjeve të nacionalizmit, "Zeri", Prishtine, 1995..
+ Xhemil Frasheri, Lufta e armatosur e popullit shqiptar.
+ Eugjen Shehu: Prenk Previzi, Gjneral i Mbrojtjës Kombëtare, Tiranë, 2013.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

+ Muharrem Bajraktari : Fjalim në varrimin te Prenk Pervizit, 7 shtator 1977.
+ Eqrem Vlora : Kujtime
+ Avni Maritin : Gjenerali Prenk Pervizi dhe Kurbini, Laç, 2002.
+ Dashnor Kaloçi : Panteoni i Thyer, Tiranë, 1996
+ Dashnor Kaloçi : Gjeneral P. Pervizi, patriot e atdhetar i madh i çeshtjes shqiptare,"RD", 1995.
+ Dashnor Kaloçi : Prenk Pervizi ne Luften e Abisinise, Tirane, 2006.
+ Josephine Dedet : Geraldinë reine des albanais, Paris, 1997.
+ Maria Craipeau :Tania Visirova, du Caucase au Folies- Bergère
+ Uran Asllani : Studentët shqiptarë në Austri, Tiranë, 2003.
+ Beqir Ajazi : Nga shkaba me kurorë te drapëri me çekan, Mokra, 2000.
+ Aleks Çaçi : Përmes Greqisë Heroike, Tiranë, 1949.
-Reportazh nga Greqia, në Gazetën « Bashkimi », Tiranë 1948.
+ Abaz Ermeni : Historia e Shqipërisë,
+ Xhelal Staravecka : Perpara Gjyqit të Historisë, Tiranë, 2012
+ Proletar Hasani, Kush ka drejtuar Ushtrine Shqiptare, Tirana, 2001.
+ Ardian Bushi : Gjeneral Prenk Pervizi, Besniku i Ahmet Zogut,1999.
+ Gazeta "Besa" : Interviste - Relacione mbi Luften e Afrikes Lindore (Abisinise), Tirane, 1936.
+ Peter Tase, Gjeneral Prenk Pervizi dhe miqësia me Princin Umberto II , Savoja.
+ Peter Tase, Prenk Pervizi, Gjeneral i Mbretërisë.
+ Bajame Hoxha : Ate qe qeveria e Hoxhes e harroi per 50 vjet, "Bota Sot", 2011.
+ Mark Bregu : Gjenerali Prenk Pervizi, nje nder figurat me te shquara te ushtrise shqiptare, Shkoder, 1996.
+ Ministero degli Interni, 11 dokumenta për Prenk Pervizin, Romë, 1954.
+ Arkivat shqiptare: dokumentë, urdrar e vendime lëshuar nga Prenk Pervizi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Përmbajtje

.

Fq. 11-------Përse shkruhët ky libër

Kapitulli I -1897-1918

17-------Kur të qesh fati
27--------Midis historisë e lëgjendës
34--------Kur luftohej për liri
42--------Periudha e Vienës
48--------Krenët e Malsisë në Vjenë
62--------Kthimi në Shqipni

Kapitulli II - 1918- 1939

69--------Në shërbim t'Atdheut
75--------Operacione qetësuese
80--------Komandant operacionësh
83--------Lufta e Tiranës 8 mars 1922
92--------Një kurthë e pabesë
96--------24 qërshor-24 dhjetor 1924
102-------Katër zone-komndantët 1924-1929
107-------Kryengritja e Dukagjinit
120------Zogu I-rë Mbret i Shqiptarve
124------Afrimi i kundërshtarve
127------Aventura e Parisit
129------Shkolla e Luftës Torino
135------Disa mosmarrëveshje
138------Intriga e rreziqe
142------Një atentat i dështuem
147-----Përsëri në Atdhe
150------Me detyrë në Tiranë
152------Respekti për vendlidjën
159------Në Luftën e Abisinisë
162------Manovrat e Mëdha
168------25 vjetori i Pavarësisë
171------Prapaskenat vazhdojnë
179------Martesa e Mbretit Zog
181------Një pauzë e vogël

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kapitulli III - 1939-1946

183------Pushtim i Shqipnisë, 7 prill 1939
186------Kangë për 7 prillin
192------Korça me 7 Prill 1939
197------Të lëshojmë kushtrimin
201------Fundi i Mbretnisë Shqiptare
208------Flamuri qëndronte në ballkon
211------ Pasojat e pushtimit
213------Pershtatje e detyrueme
215------Nuk bahemi mish për top
221------Braktisja e frontit grek
228------Disa shtjellime nën pushtim
231------Joshjet e komunistëve

Kapitulli IV – 1946-1977

234------Kapitullimi i Italisë
238------Gjermanët : kalimtarë
251------Rezistenca kundër komunizmit
261------Lamtumirë Atdheut
272------Kalvari i familjës
295-----Si na vinin lajmet
281------Në botën e lirë
286------Jeta e veprimtaria në mërgim
291------Fjala Prenk Pervizit më 28 nëndor 1971
295------Letër drejtue Komiteti Shqipëria e Lirë
297------Përgjigje nga Rexhep Krasniqi
298------Ditët e fundit të Gjeneralit
299------Revista Koha e Jone
300------Fjala e Kol. M. Bajraktarit në varrimin e P. Pervizit
302------New York 1992
306-------Dokumenta sekrete
310------ Përshkrim kronologjik
312------ Jeta e detyrat
321------Te huajt për Gjeneralin
335------Projekti për Ushtrinë Kombëtare
341------Bibligrafia

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

© Editions Dorian
Rue de la Victoire, 18
.1060 Bruxelles

D/2015/11.451/10
ISBN 798-2-930531-11-3

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)